FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 74

Tiranë – E enjte, 9 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 1.4.2026	Për miratimin e rregulloreve për etiketimin e produkteve me ndikim në energji.....	5443

VENDIM
Nr. 218, datë 1.4.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE ME NDIKIM NË ENERGJI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 52/2024, "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të makinave larëse për përdorim shtëpiak dhe makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak", sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[1]

2. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të pajisjeve të ngrohjes lokale", sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[2]

3. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të ekraneve elektronike", sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[3]

4. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë dhe sistemet e përbëra nga kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, termostat dhe sistem diellor për ngrohjen e ujit", sipas aneksit nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[4]

5. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të ngrohësve të hapësirës, sistemet e integruara, sistemet që përfshijnë ngrohës hapësire, sisteme diellore dhe termostatë, si dhe sistemet që përfshijnë ngrohësit e integruar, sisteme diellore dhe termostatë", sipas aneksit nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[5]

6. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të enëlarëseve për përdorim shtëpiak", sipas aneksit nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[6]

7. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të kondicionerëve", sipas aneksit nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[7]

8. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të ndriçuesve", sipas aneksit nr. 8, që i

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 mars 2019, "Për etiketimin energjetik të makinave larëse për përdorim shtëpiak dhe makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak", si dhe për shfuqizimin e rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 1061/2010 dhe direktivës së Komisionit 96/60/BE. Numri CELEX 02019R2014, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 5.12.2019, f. 29.

[2] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2015/1186 të Komisionit, datë 24 prill 2015, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të pajisjeve të ngrohjes lokale". Numri CELEX 02015R1186, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 21.7.2015, f. 20.

[3] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2013 të Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të ekraneve elektronike", dhe shfuqizimin e rregullores deleguese (BE) nr. 1062/2010 të Komisionit. Numri CELEX 02019R2013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 5.12.2019, f. 1.

[4] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2015/1187 të Komisionit, datë 27 prill 2015, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë dhe sistemet e përbëra nga kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, termostat dhe sistem diellor për ngrohjen e ujit". Numri CELEX 02015R1187, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 21.7.2015, f. 43.

[5] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 811/2013 të Komisionit, datë 18 shkurt 2013, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të ngrohësve të hapësirës, sistemet e integruara, sistemet që përfshijnë ngrohës hapësire, sisteme diellore dhe termostatë, si dhe sistemet që përfshijnë ngrohësit e integruar, sisteme diellore dhe termostatë". Numri CELEX 02013R0811, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 239, datë 7.3.2017, f. 1.

[6] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2017 të Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin energjetik të enëlarëseve për përdorim shtëpiak", si dhe për shfuqizimin e rregullores deleguese (BE) nr. 1059/2010 të Komisionit. Numri CELEX 02019R2017, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 5.12.2019, f. 134.

[7] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 626/2011 të Komisionit, datë 4 maj 2011, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[8]

9. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të njësive të ventilimit të banesave", sipas aneksit nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[9]

10. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të ngrohësve të ujit, rezervuarëve të ujit të ngrohtë, paketave të ngrohësve të ujit dhe pajisjeve diellore", sipas aneksit nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[10]

11. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të frigoriferëve magazinues profesionalë", sipas aneksit nr. 11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[11]

12. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të pajisjeve frigoriferike për përdorim shtëpiak", sipas aneksit nr. 12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[12]

13. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të pajisjeve frigoriferike me funksion të shitjes direkte", sipas aneksit nr. 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[13]

14. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të telefonave inteligjentë dhe tabletave", sipas aneksit nr. 14, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[14]

15. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të makinave tharëse për përdorim shtëpiak", sipas aneksit nr. 15, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[15]

16. Miratimin e rregullores "Për etiketimin energjetik të furrave dhe aspiratorëve për përdorim shtëpiak", sipas aneksit nr. 16, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[16]

17. Miratimin e rregullores "Për etiketimin e gomave në lidhje me eficiencën e karburantit dhe parametrave të tjerë", sipas aneksit nr. 17, që i

---

energjetik të kondicionerëve". Numri CELEX 02011R0626, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 178, datë 6.7.2021, f. 1.

[8] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2015 të Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin e energjetik të ndriçuesve", si dhe për shfuqizimin e rregullores deleguese (BE) nr. 874/2012 të Komisionit. Numri CELEX 02019R2015, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 5.12.2015, f. 68.

[9] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 1254/2014 të Komisionit, datë 11 korrik 2014, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të njësive të ventilimit të banesave". Numri CELEX 02014R1254, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 337, datë 25.11.2014, f. 27.

[10] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 812/2013 të Komisionit, datë 18 shkurt 2013, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të ngrohësve të ujit, rezervuarëve të ujit të ngrohtë, paketave të ngrohësve të ujit dhe pajisjeve diellore". Numri CELEX 02013R0812, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 239, datë 6.9.2013, f. 83.

[11] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2015/1094 të Komisionit, datë 5 maj 2015, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të frigoriferëve magazinues profesionalë". Numri CELEX 02015R1094, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 177, datë 8.7.2015, f. 2.

[12] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2016 të Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin energjetik të pajisjeve frigoriferike për përdorim shtëpiak", si dhe për shfuqizimin e rregullores deleguese (BE) nr. 1060/2010 të Komisionit. Numri CELEX 02019R2016, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 5.12.2019, f. 102.

[13] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2018 të Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin e energjisë të pajisjeve frigoriferike me funksion të shitjes direkte". Numri CELEX 02019R2018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 5.12.2019, f. 155.

[14] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2023/1669 të Komisionit, datë 16 qershor 2023, për plotësimin e rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin energjetik të telefonave inteligjentë dhe tabletave". Numri CELEX 02023R1669, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 214, datë 31.8.2023, f. 9.

[15] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2023/2534 të Komisionit, datë 13 korrik 2023, për plotësimin e rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin energjetik të makinave tharëse për përdorim shtëpiak", si dhe për shfuqizimin e rregullores deleguese (BE) nr. 392/2012 të Komisionit. Numri CELEX 02023R2534, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 2534, datë 22.11.2023, f. 1.

[16] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 65/2014 të Komisionit, datë 1 tetor 2013, për plotësimin e direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të furrave dhe aspiratorëve pë përdorim shtëpiak". Numri CELEX 02014R0065, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 029, datë 31.1.2014, f. 1.

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.[17]

18. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

[17] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren (BE) 2020/740 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 maj 2020, "Për etiketimin e gomave në lidhje me eficiencën e karburantit dhe parametrave të tjerë" duke ndryshuar rregulloren (EU) 2017/1369 dhe shfuqizimin e rregullores (EC) No. 1222/2009". Numri CELEX 02020R0740, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 177, datë 5.6.2020, f. 1.

ANEKS NR. 1

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË MAKINAVE LARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK DHE MAKINAVE LARËSE-THARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK"[1]

I. QËLLIMI

Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin e pajisjeve nga pikëpamja energjetike dhe dhënien e informacionit plotësues për makinat larëse shtëpiake dhe makinat larëse-tharëse shtëpiake që furnizohen nga rrjeti elektrik, përfshirë pajisjet të cilat kanë mundësinë të punojnë edhe me bateri, por burimi kryesor i energjisë është rrjeti elektrik, si dhe për makinat larëse shtëpiake dhe makinat larëse-tharëse shtëpiake të parashikuara të instalohen në një dollap.

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore përcakton një kornizë për dhënien e informacionit mbi parametrat e makinave larëse për përdorim shtëpiak dhe makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak nëpërmjet etiketimit për të mundësuar që përdoruesit fundorë të jenë të informuar mbi zgjedhjen e produktit.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

a) makinat larëse dhe makinat larëse-tharëse me tension të ulët nën 50 V AC dhe 75 V DC;
b) makinat larëse shtëpiake me bateri dhe makinat larëse-tharëse shtëpiake të dizajnuara për t'u përdorur kryesisht me bateri, dhe jo me energji direkte nga rrjeti elektrik të cilat mund të lidhen me rrjetin elektrik nëpërmjet një konvertuesi AC/DC të blerë veçmas;
c) makinat larëse shtëpiake me kapacitet nominal deri në 2 kg dhe makinat larëse-tharëse shtëpiake me kapacitet nominal të larjes deri në ose të barabartë me 2 kg.

III. PËRKUFIZIMET

Për qëllim të kësaj rregullore, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Cikël i larjes"** është procesi i plotë i larjes, i përcaktuar nga një program i zgjedhur, i cili përbëhet nga një seri procesesh të ndryshme, duke përfshirë larjen, shpëlarjen dhe centrifugimin.

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 Mars 2019, "Për etiketimin e energjisë së makinave larëse për përdorim shtëpiak dhe makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak", si dhe për shfuqizimin e Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 1061/2010 dhe Direktivës së Komisionit 96/60/BE. Numri CELEX 02019R2014, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 05.12.2019, f. 29.

2. **"Cikël i plotë"** është procesi që përfshin larjen dhe tharjen, i përbërë nga një cikël i plotë larjeje dhe një cikël tharjeje.
3. **"Cikël i tharjes"** është procesi i plotë i tharjes, i përcaktuar nga programi i zgjedhur, i cili përfshin një sërë procesesh të ndryshme, si ngrohja dhe rrotullimi.
4. **"Cikël i vazhdueshëm"** është cikli i plotë i procesit që zhvillohet pa ndërprerje dhe pa kërkuar asnjë ndërhyrje nga përdoruesi gjatë gjithë programit.
5. **"E tharë për në raft"** është statusi i tekstileve të trajtuara që janë tharë në një cikël tharjeje deri sa të arrijnë një përmbajtje lagështie prej 0%.
6. **"Efiçenca e shpëlarjes"** është përqendrimi i mbetjeve të alkilbenzene sulfonate linear (LAS) në tekstilet e trajtuara pas ciklit të larjes në një makinë larëse ose larëse-tharëse për përdorim shtëpiak (I_R) ose ciklit të plotë të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak (J_R), i shprehur në gram për kilogram tekstili të thatë.
7. **"Ekran taktil"** eshte një ekran që përgjigjet ndaj prekjes, si ai i një tableti ose një telefoni inteligjent.
8. **"Fillim me vonesë"** është gjendja në të cilën përdoruesi ka zgjedhur një vonesë të caktuar për fillimin ose përfundimin e ciklit të programit të zgjedhur.
9. **"Funksioni i mbrojtës nga rrudhat"** është procesii makinës larëse ose larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, që aktivizohet pas përfundimit të programit për të parandaluar rrudhjen e tepërt të tekstileve.
10. **"Garanci"** është angazhimi i tregtarit ose furnizuesit ndaj konsumatorit për të:
    (a) rimbursuar çmimin e paguar; ose
    (b)zëvendësuar, riparuar ose trajtuar makinën larëse ose makinën larëse-tharësen për përdorim shtëpiak nëse nuk përmbush specifikimet e përcaktuara në deklaratën e garancisë ose reklamimin përkatës.
11. **"Gjendje e lënë ndezur (Standby)"** është gjendja e konsumit më të ulët të energjisë që vazhdon për një kohë të pacaktuar pas përfundimit të programit, pa ndërhyrje nga përdoruesi, përveç boshatisjes së pajisjes.
12. **"Gjendje e stakuar"** është gjendja kur makina larëse për përdorim shtëpiak ose makina larëse-tharëse për përdorim shtëpiak fiket, duke përdorur çelësa ose komanda të pajisjes që janë parashikuar për operim nga përdoruesi i fundit gjatë përdorimit normal. Kjo gjendje siguron konsumin më të ulët të mundshëm të energjisë dhe mund të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, ndërkohë që makina mbetet e lidhur me burimin e energjisë dhe është përdorur në përputhje me udhëzimet e furnizuesit.
    Gjendje e stakuar gjithashtu do të konsiderohet:
    (a) Kur ofrohet vetëm një tregues i gjendjes së stakuar;
    (b) Kur ofrohen vetëm funksionalitete të destinuara për të siguruar përputhshmërinë elektromagnetike, në përputhje me Vendimin Nr. 552, datë 31.7.2019, "Për miratimin e rregullit teknik për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara".
13. **"Indeksi i Efiçencës së Energjisë" (EEI)** është raporti i konsumit të ponderuar të energjisë ndaj konsumit të energjisë gjatë ciklit standard.
14. **"Kapaciteti nominal"** është masa maksimale e tekstileve të thata në kilogramë dhe e shprehur në shumëfish të 0,5 kg, e deklaruar nga furnizuesi, që mund të trajtohet në

një cikël larjeje të makinës larëse ose në një cikël të plotë të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak në programin e zgjedhur, kur është e ngarkuar në përputhje me udhëzimet e furnizuesit.

15. **"Kapaciteti nominal për larje"** është masa maksimale e tekstileve të thata në kilogram dhe e shprehur në shumëfish të 0,5 kg, e deklaruar nga furnizuesi, që mund të trajtohet në një cikël larjeje të një makine larëse për përdorim shtëpiak, ose në një cikël larjeje të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak përkatësisht, në programin e zgjedhur kur është e ngarkuar në përputhje me udhëzimet e furnizuesit.
16. **"Kapaciteti nominal për tharje"** është masa maksimale e tekstileve të thata në kilogram dhe e shprehur në shumëfish të 0,5 kg, e deklaruar nga furnizuesi, që mund të trajtohen në një cikël tharjeje të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak në programin e zgjedhur, kur ngarkohet në përputhje me udhëzimet e furnizuesit.
17. **"Kodi i përgjigjes së shpejtë" (QR)** nënkupton një kod matricor i përfshirë në etiketën e energjisë së një modeli produkti, që lidh informacionin e atij modeli me bazën publike të të dhënave të produktit.
18. **"Kohëzgjatja e ciklit" (t_{WD})** për ciklin e plotë të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak eshte kohëzgjatja që fillon me fillimin e programit të zgjedhur për ciklin e larjes, duke përjashtuar çdo ndryshim në program të bërë nga përdoruesi i fundit, deri në përfundimin e ciklit të tharjes.
19. **"Kohëzgjatja e programit" (t_W)** është koha që kalon nga fillimi i programit deri në përfundim të tij, duke përjashtuar çdo ndryshim në program të bërë nga përdoruesi.
20. **"Konsum i ponderuar i energjisë (E_W)"** është mesatarja e ponderuar e konsumit të energjisë gjatë ciklit të larjes së një makine larëse për përdorim shtëpiak ose një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, gjatë programit ekologjik 40°C-60°C, në kapacitetin nominal për larje, si dhe në gjysmën dhe një të katërtën e këtij kapaciteti, i shprehur në kilovat-orë për cikël.
21. **"Konsum i ponderuar i energjisë (E_{WD})"** është mesatarja e ponderuar e konsumit të energjisë të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak gjatë ciklit të larjes dhe tharjes, në kapacitetin nominal dhe në gjysmën e kapacitetit nominal, e shprehur në kilovat-orë për cikël.
22. **"Konsum i ponderuar i ujit (W_W)"** është mesatarja e ponderuar e konsumit të energjisë të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak gjatë ciklit të larjes dhe tharjes, për kapacitetin nominal dhe për gjysmën e kapacitetit nominal, e shprehur në kilovat-orë për cikël.
23. **"Konsum i ponderuar i ujit (W_{WD})"** është mesatarja e ponderuar e konsumit të ujit të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak gjatë ciklit të larjes dhe tharjes, për kapacitetin nominal dhe për gjysmën e kapacitetit nominal, e shprehur në litra për cikël.
24. **"Konsumi standard i energjisë së ciklit (SCE)"** është konsumi i energjisë i përdorur si referencë, si funksion i kapacitetit nominal të një makine larëse për përdorim shtëpiak ose të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, i shprehur në kilovat-orë për cikël.

25. **"Makinë larëse automatike"** është një makinë larëse që trajton ngarkesën plotësisht, pa kërkuar ndërhyrje nga përdoruesi në asnjë moment gjatë programit.
26. **"Makinë larëse e parashikuar të instalohet në një dollap"** është një makinë larëse për përdorim shtëpiak që është projektuar, testuar dhe tregtuar ekskluzivisht:
(a) për t'u instaluar brenda një kabineti ose të jetë e rrethuar (në pjesën e sipërme dhe/ose të poshtme, dhe anash) nga panele;
(b) për t'u fiksuar në mënyrë të sigurt në anët, sipër ose në dyshemenë e kabinetit ose paneleve; dhe
(c) për të qenë e pajisur me një pjesë ballore të përfunduar në fabrikë ose për t'u pajisur me një panel ballor të personalizuar.
27. **"Makinë larëse për përdorim shtëpiak"** është një makinë larëse automatike që lan dhe shpëlan tekstile duke përdorur ujë, dhe ka gjithashtu një funksion centrifugimi për heqjen e ujit, e projektuar kryesisht për përdorim joprofesional (më poshtë referohet si makinë larëse), dhe është deklaruar nga prodhuesi në Deklaratën e Konformitetit si në përputhje me Vendim Nr. 349, datë 29.4.2020 "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara" ose me Vendim Nr. 378, datë 5.6.2019 "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.".
28. **"Makinë larëse për përdorim shtëpiak me shumë kazanë"** eshte një makinë larëse për përdorim shtëpiak e pajisur me më shumë se një kazan, qoftë në njësi të ndara apo në të njejtën njesi.
29. **"Makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak"** është një makinë larëse për përdorim shtëpiak, e cila, përveç funksioneve të një makine larëse automatike, përfshin gjithashtu një mënyrë për tharjen e tekstileve në të njëjtin kazan, duke përdorur nxehtësi dhe rrotullim, dhe që është deklaruar nga prodhuesi në Deklaratën e Konformitetit si në përputhje me Vendim Nr. 349, datë 29.4.2020 "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara" ose me Vendim Nr. 378, datë 5.6.2019 "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara".
30. **"Makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak e parashikuar të instalohet në një dollap"** eshte një makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak që është projektuar, testuar dhe tregtuar ekskluzivisht:
(a) për t'u instaluar brenda një kabineti ose të jetë e rrethuar (në pjesën e sipërme dhe/ose të poshtme, dhe anash) nga panele;
(b) për t'u fiksuar në mënyrë të sigurt në anët, sipër ose në dyshemenë e kabinetit ose paneleve; dhe
(c) për të qenë e pajisur me një pjesë ballore të përfunduar në fabrikë ose për t'u pajisur me një panel ballor të personalizuar.

31. **"Makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me shumë kazanë"** eshte një makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak e pajisur me më shumë se një kazan, qoftë në njësi të ndara apo në të njëjtën njesi.
32. **"Mekanizmi i shfaqjes"** eshte çdo ekran, duke përfshirë ekranin taktil, ose teknologji tjetër vizuale e përdorur për shfaqjen e përmbajtjes së internetit për përdoruesit.
33. **"Përmbajtja e lagështisë së mbetur"** për makinat larëse për përdorim shtëpiak dhe për ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, është sasia e lagështisë e pranishme në ngarkesë në fund të ciklit të larjes.
34. **"Përmbajtja përfundimtare e lagështisë"** për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak është sasia e lagështisë e pranishme në ngarkesë në përfundim të ciklit të tharjes.
35. **"Pikë shitje"** eshte një vend ku makinat larëse për përdorim shtëpiak ose makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, ose të dyja, janë të ekspozuara ose ofrohen për shitje ose qira.
36. **"Program"** është një seri procesesh të paracaktuara, të cilat janë deklaruar nga furnizuesi si të përshtatshme për larjen, tharjen, ose për larjen dhe tharjen e vazhdueshme të llojeve të caktuara të tekstileve.
37. **"Program ekologjik 40^0C-60^0C"** është programi i deklaruar nga furnizuesi, i cili është i aftë të pastruar tekstilet e pambukut që janë të ndotura normalisht dhe që janë të deklaruara për t'u larë në 40°C ose 60°C, duke i larë ato së bashku në të njëjtin cikël larjeje, dhe për të cilin informacioni në etiketën e energjisë dhe në skedën e informacionit të produktit i referohet.
38. **"Rrjet"** është një infrastrukturë komunikimi me një topologji lidhjesh, një arkitekturë, duke përfshirë komponentët fizikë, parimet organizative, procedurat e komunikimit dhe formatet (protokollet).
39. **"Rrjeti elektrik" ose "rrjeti i energjisë elektrike"** eshte furnizimi me energji elektrike nga rrjeti me 230 (±10 %) volt rrymë alternative me frekuencë 50 Hz.
40. **"Shfaqja e ngjitur (nested)"** është ndërfaqja vizuale ku një imazh ose një set të dhënash bëhet i aksesueshëm përmes një klikimi me maus, rrotullimi të mausit, ose zgjerimit të ekranit taktil të një imazhi tjetër ose seti tjetër të dhënash.
41. **"Tekst alternativ"** është një shfaqje alternative e përmbajtjes grafike në formë teksti, e cila mundëson paraqitjen e informacionit në format jo-grafik në rast se ekrani nuk mund të shfaqë grafikën, ose përdoret si ndihmë për aksesueshmërinë, si input për aplikacionet e sintezës së zërit.
42. **"Vlerat e deklaruara"** jane vlerat e ofruara nga furnizuesi për parametrat teknikë të deklaruar, të llogaritur ose të matur, në përputhje me Nenin 6 të Ligjit 52/2024, dhe në përputhje me pikën 1 (ç) të kreut IV dhe shtojcën V të kësaj rregullore, për verifikimin e përputhshmërisë nga Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut.

IV. III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit duhet të sigurojnë që:

a) çdo makinë larëse për përdorim shtëpiak dhe makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak të kenë një etiketë të printuar në formatin e përcaktuar në shtojcën II dhe, për makinat larëse për përdorim shtëpiak me disa kazanë ose makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me disa kazanë, në përputhje me shtojcën IX;
b) vlerat e parametrave të përfshirë në skedën e informacionit të produktit, siç është përcaktuar në shtojcën IV, të regjistrohen në regjistrin publik të të dhënave të produktit;
c) në rast se kërkohet veçanërisht nga tregtari i makinave larëse për përdorim shtëpiak dhe makinave larëse-tharëseve për përdorim shtëpiak, skeda e informacionit produktit të bëhet e disponueshme në formë të printuar;
ç) përmbajtja e dokumentacionit teknik, e përcaktuar në shtojcën V, të regjistrohet në regjistrin publik të të dhënave të produktit;
d) çdo reklamë vizuale për një model të caktuar të makinës larëse për përdorim shtëpiak ose makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, të përmbajë klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës të energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcën VI dhe shtojcën VII;
dh) çdo material promovues teknik në lidhje me një model të caktuar të makinës larëse për përdorim shtëpiak ose makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, përfshirë ato të publikuara në internet, që përshkruan parametrat teknikë të veçantë të tij, të përmbajë klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcën VI;
e) etiketa elektronike në formatin dhe përmbajtjen e informacionit siç është përcaktuar në Shtojcën II, të jetë e disponueshme për shitësit për çdo model të makinës larëse për përdorim shtëpiak dhe makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak;
ë) skeda e informacionit elektronike e produktit, siç është përcaktuar në shtojcën IV, të jetë e disponueshme për shitësit për çdo model të makinës larëse për përdorim shtëpiak dhe makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak.

2. Klasa e efiçencës së energjisë dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ambient janë të përcaktuara në shtojcën I dhe do të llogariten në përputhje me shtojcën III.
3. Deri në gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, furnizuesit që prodhojnë makina larëse për përdorim shtëpiak ose makina larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, me ndikim në energji sipas kësaj rregullore, në Republikën e Shqipërisë, duhet të plotesojnë informacionin e përcaktuar në shtojcën IV dhe ta shfaqin në faqen e tyre të internetit përpara se të hedhin në treg çdo produkt të prodhuar pas këtij afati.
4. Për furnizuesit që prodhojnë produkte me ndikim në energji sipas kësaj rregullore në Republikën e Shqipërisë, dhe eksportojnë makinat larëse për përdorim shtëpiak ose makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, të prodhuara në bashkimin evropian, duhet të plotësojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën IV në bazën e të dhënave evropiane të produkteve përpara se të hedhin në treg çdo produkt të prodhuar pas këtij afati.

V. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

1. Tregtarët duhet të sigurojnë që:

a) çdo makinë larëse për përdorim shtëpiak ose makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, në pikën e shitjes, duke përfshirë panairet tregtare, të ketë etiketën e ofruar nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(a) të kreut IV, me etiketën e dukshme për pajisjet e parashikuara të instalohen në një dollap , dhe për të gjitha pajisjet e tjera, në mënyrë që të jetë qartë e dukshme, nga jashtë në pjesën e përparme ose të sipërme të makinës larëse për përdorim shtëpiak ose makinës larëse-tharëses për përdorim shtëpiak;

b) në rastin e shitjes në distancë dhe shitjes përmes internetit, etiketa dhe skeda e informacionit e produktit të ofrohet në përputhje me shtojcën VI dhe VII;

c) çdo reklamë vizuale për një model specifik makine larëse për përdorim shtëpiak ose makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, përmban klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcën VI;

ç) çdo material promovues teknik në lidhje me një model specifikmakine larëse për përdorim shtëpiak ose makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, duke përfshirë ato në internet, që përshkruan parametrat teknikë të tij specifik, të përfshijë klasën e efiçencë së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcën VI.

VI. DETYRIMET E E PLATFORMAVE HOSTING TË INTERNETIT

Kur një ofrues shërbimi pritës, siç referohet në Vendimin Nr. 676, datë 20.12.2017, lejon shitjen e drejtpërdrejtë përmes faqes së tij të internetit, të makinave larëse për përdorim shtëpiak ose makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, ofruesi i shërbimit duhet të mundësojë shfaqjen e etiketës elektronike dhe skedës së informacionit elektronike të produktit, të ofruara nga tregëtari në mekanizmin e shfaqjes, në përputhje me shtojcën VII dhe duhet të informojë tregatrin mbi detyrimin për t'i shfaqur.

VII. METODAT E MATJES

Informacioni që duhet të ofrohet në përputhje me kreun IV dhe V merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në shtojcën III.

VIII. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

IX. SHFUQIZIME

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, Vendimi Nr. 928, datë 19.12.2012 Për miratimin e rregullit teknik "Për etiketimin e makinave larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë" shfuqizohet.

SHTOJCA I

A. Klasat e efiçencë së energisë

Klasa e efiçencës së energjisë së një makine larëse për përdorim shtëpiak dhe e ciklit të larjes së një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak do të përcaktohet në bazë të Indeksit të Efiçencës së Energjisë (EEI_W), siç paraqitet në Tabelën 1.

EEI_W e një makine larëse për përdorim shtëpiak dhe e ciklit të larjes së një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak do të llogaritet në përputhje me shtojcën III.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë të makinave larëse për përdorim shtëpiak dhe ciklit të larjes së makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak

Klasa e efiçencës së energjisë	Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_W)
A	$\mathbf{EEI_W} \leq 52$
B	$52 < \mathbf{EEI_W} \leq 60$
C	$60 < \mathbf{EEI_W} \leq 69$
D	$69 < \mathbf{EEI_W} \leq 80$
E	$80 < \mathbf{EEI_W} \leq 91$
F	$91 < \mathbf{EEI_W} \leq 102$
G	$\mathbf{EEI_W} > 102$

Klasa e efiçencës së energjisë së ciklit të plotë të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak do të përcaktohet në bazë të Indeksit të Efiçencës së Energjisë (EEI_{WD}) siç përcaktohet në Tabelën 2.

EEI_{WD} e ciklit të plotë të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak do të llogaritet në përputhje me shtojcën III.

Tabela 2

Klasat e efiçencës së energjisë të ciklit të plotë të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak

Klasa e efiçencës së energjisë	Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{WD})
A	$\mathbf{EEI_{WD}} \leq 37$
B	$37 < \mathbf{EEI_{WD}} \leq 45$
C	$45 < \mathbf{EEI_{WD}} \leq 55$
D	$55 < \mathbf{EEI_{WD}} \leq 67$
E	$67 < \mathbf{EEI_{WD}} \leq 82$
F	$82 < \mathbf{EEI_{WD}} \leq 100$
G	$\mathbf{EEI_{WD}} > 100$

B. Klasa e efiçencës së tharjes me centrifugë

Klasa e efiçencës së tharjes me centrifugë e një makine larëse për përdorim shtëpiak dhe e ciklit të larjes së një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak do të përcaktohet në bazë të përmbajtjes së lagështisë së mbetur (D) siç përcaktohet në Tabelën 3.

D e një makine larëse për përdorim shtëpiak dhe e ciklit të larjes së një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak do të llogaritet në përputhje me shtojcën III.

Tabela 3

Klasa e efiçencës së tharjes me centrifugë

Klasa e efiçencës së energjisë	Përmbajtja e lagështisë së mbetur (D)
A	**D** < 45
B	45 ≤ **D** < 54
C	54 ≤ **D** < 63
D	63 ≤ **D** < 72
E	72 ≤ **D** < 81
F	81 ≤ **D** < 90
G	**D** ≥ 90

C. Klasa e emetimeve të zhurmës akustike

Klasa e emetimeve të zhurmës akustike e një makine larëse për përdorim shtëpiak dhe e ciklit të larjes së një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, do të përcaktohet në bazë të emetimeve të zhurmës akustike siç përcaktohet në Tabelën 4

Tabela 4

Klasa e emetimeve të zhurmës akustike

Procesi	Klasa e emetimeve të zhurmës akustike	Niveli i zhurmës (dB)
Centrifugë	A	n < 73
	B	73 ≤ n < 77
	C	77 ≤ n < 81
	D	n ≥ 81

SHTOJCA II

A. Etiketa për makinat larëse për përdorim shtëpiak

1. ETIKETA PËR MAKINAT LARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1.1 Etiketa



1.2 Informacioni në etiketë duhet të përfshijë:

I. Kodin QR;

II. Emrin ose markën tregtare të furnizuesit;

III. Identifikimin e modelit nga furnizuesi;

IV. Shkallën e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;
V. Klasën e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me shtojcën I;
VI. Konsumin i ponderuar i energjisë për 100 cikle në kWh, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt në përputhje me shtojcën III;
VII. Kapacitetin nominal, në kg, për programin ekologjik 40^0C-60^0C;
VIII. Konsumin e ujit të matur për cikël në litra, të rrumbullakosur në numrin më të afërt në përputhje me shtojcën III;
IX. Kohëzgjatjen e programit ekologjik 40^0C-60^0C me kapacitet nominal në orë:min, të rrumbullakosur në minutën më të afërt;
X. Klasën e efiçencës së tharjes me centrifugë, e përcaktuar në përputhje me pikën B të shtojcës I;
XI. Emetimet e zhurmës akustike gjatë fazës së centrifugës, shprehur në dB(A) kundrejt 1 pW dhe të rrumbullakosur në numrin më të afërt, dhe klasa e emetimeve të zhurmës akustike, e përcaktuar në përputhje me pikën C të shtojcës I;
XII. Numrin e këtij vendimi

2. FORMATI I ETIKETËS PËR MAKINAT LARËSE SHTËPIAKE

Formati i etiketës do të jetë si ne figurën më poshtë:



Ku:

(a) Etiketa duhet të jetë të paktën 96 mm e gjerë dhe 192 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj duhet të jetë proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi i etiketes duhet të jetë 100% i bardhë.

(c) Teksti duhet të jetë Verdana dhe Calibri.

(d) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketen duhet të jenë sipas formatit të etiketes për makinat larëse për përdorim shtëpiak.

(e) Ngjyrat duhet të jenë CMYK – e kaltër (cyan), e kuqe e purport (magenta), e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull: 0,70,100,0: 0% e kaltër, 70% e kuqe e purpurt, 100% e verdhë, 0% e zezë.

(f) Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës më sipër):

1. Ngjyrat e logos së BE-së duhet të jenë si më poshtë:
— Sfondi: 100,80,0,0;
— Yjet: 0,0,100,0;
2. Ngjyra e logos së energjisë duhet të jetë: 100,80,0,0;
3. Kodi QR duhet të jetë 100% e zezë;
4. Emri i furnizuesit duhet të jetë 100% e zezë dhe në Verdana Bold, 9 pt;
5. Identifikuesi i modelit duhet të jetë 100% e zezë dhe në Verdana Regular, 9 pt;
6. Shkalla A deri në G duhet të jetë si më poshtë:
- Shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë duhet të jenë 100% të bardha dhe në Calibri Bold, 19 pt; shkronjat duhet të jenë të vendosura në një rresht në 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave;
- Ngjyrat e shigjetave të shkallës A deri në G duhet të jenë si më poshtë:
  - Klasa A: 100,0,100,0;
  - Klasa B: 70,0,100,0;
  - Klasa C: 30,0,100,0;
  - Klasa D: 0,0,100,0;
  - Klasa E: 0,30,100,0;
  - Klasa F: 0,70,100,0;
  - Klasa G: 0,100,100,0;

7. Ndarjet e brëndshme duhet të kenë madhësi 0,5 pt dhe ngjyra e tyre duhet të jetë 100% e zezë;
8. Shkronja e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë 100% e bardhë dhe në Calibri Bold, 33 pt. Shigjeta e klasës së efiçencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën A deri në G duhet të jenë të pozicionuara në një mënyrë që të jenë të vendosura përballë dhe në të njejtën lartësi. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë e pozicionuar në qendër të pjesës katrore të shigjetës, e cila duhet të jetë 100% e zezë;
9. Vlera e konsumit të ponderuar të energjisë për 100 cikle duhet të jetë në shkronja Verdana Bold 28 pt; 'kWh' duhet të jetë në shkronja Verdana Regular, 18 pt; numri '100' në ikonën që përfaqëson 100 cikle duhet të jetë në Verdana Regular 14 pt. Vlera dhe njësia duhet të jenë në qendër dhe 100% të zeza;
10. Piktogramet duhet të jenë siç tregohet në formatin e etiketes dhe si më poshtë:
- Linjat e piktogrameve duhet të kenë një përmasë prej 1,2 pt, si dhe ato dhe tekstet (numrat dhe njësitë) duhet të jenë 100% të zeza;
- Tekstet nën 3 piktogramet e sipërme duhet të jenë në Verdana Bold 16 pt me njësitë në Verdana Regular 12 pt, dhe teksti duhet të jetë në qendër nën piktogramat;
- Piktograma e efiçencës së energjisë së tharjes me centrifugë: klasat e efiçencës së energjisë së tharjes me centrifugë (A deri në G) duhet të jetë në qendër të piktogramit, me shkronjën e klasës së efiçencës së energjisë së tharjes me

centrifugë në Verdana Bold 16 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të efiçencës së energjisë së tharjes me centrifugë në Verdana Regular 10 pt;

– Piktograma e emetimeve të zhurmës akustike: numri i decibeleve në altoparlant duhet të jetë në Verdana Bold 12 pt, me njësinë 'dB' në Verdana Regular 9 pt; klasat e zhurmës (A deri në D) duhet të jetë në qendër nën piktogram, me shkronjën e klasës së zhurmës përkatëse në Verdana Bold 16 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të zhurmës në Verdana Regular 10 pt;

11. Numri i rregullores duhet të jetë 100% i zi dhe në Verdana Regular 6 pt.

Furnitorët të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregullore, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal dhe të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian . Për këto produkte me ndikim në energji furnitorët duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës IV.

B. Etiketa për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak

1. ETIKETA PËR MAKINAT LARËSE-THARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1.1 Etiketa



1.2 Informacioni në etiketë duhet të përfshijë:

I. Kodin QR;
II. Emrin ose markën tregtare të furnizuesit;
III. Identifikuesin e modelit të furnizuesit;
IV. Shkallët e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G për ciklin e plotë (në anën e majtë) dhe për ciklin e larjes (në anën e djathtë);
V. Klasën e efiçencës së energjisë për ciklin e plotë (në anën e majtë) e përcaktuar në përputhje me shtojcën I; dhe për ciklin e larjes (në anën e djathtë) e përcaktuar në përputhje me shtojcën I;
VI. Konsumin e ponderuar të energjisë për 100 cikle në kWh, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt në përputhje me shtojcën III, për ciklin e plotë (në anën e majtë);
VII. Konsumin e energjisë të matur për 100 cikle në kWh, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt në përputhje me shtojcën III për ciklin e larjes (në anën e djathtë);
VIII. Kapacitetin nominal për ciklin e plotë (në anën e majtë) dhe për ciklin e larjes (në anën e djathtë);
IX. Konsumin e ujit të matur për ciklël në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt në përputhje me shtojcën III për ciklin e plotë (në anën e majtë) dhe për ciklin e larjes (në anën e djathtë);

X. Kohëzgjatjen e ciklit në kapacitetin nominal për ciklin e plotë (në anën e majtë) dhe për ciklin e larjes (në anën e djathtë);

XI. Klasën e efiçencës së centrifugimit, e përcaktuar në përputhje me pikën B të Shtojcës I;

XII. Klasën e emetimit të zhurmës akustike së fazës së centrifugës së programit ekologjik 40^0C-60^0C dhe vlera në dB(A) kundrejt 1 pW e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

XIII. Numrin e këtij vendimi.

2. SKICA E ETIKETËS PËR MAKINAT LARËSE-THARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK



Ku:

(a) Etiketa duhet të jetë të paktën 96 mm e gjerë dhe 192 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj duhet të jetë proporcionale me specifikimet e mësipërme.
(b) Sfondi i etiketes duhet të jetë 100% i bardhë.
(c) Tipet e shkronjave duhet të jenë Verdana dhe Calibri.
(d) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketen duhet të jenë sipas formatit të etiketes për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak.
(e) Ngjyrat duhet të jenë CMYK – e kaltër (cyan), e kuqe e purport (magenta), e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull: 0,70,100,0: 0% e kaltër, 70% e kuqe e purpurt, 100% e verdhë, 0% e zezë.
(f) Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës më sipër):

1. Ngjyrat e logos së BE-së duhet të jenë si më poshtë:
— Sfondi: 100,80,0,0;
— Yjet: 0,0,100,0;
2. Ngjyra e logos së energjisë duhet të jetë: 100,80,0,0;
3. Kodi QR duhet të jetë 100% e zezë;
4. Emri i furnizuesit duhet të jetë 100% e zezë dhe në Verdana Bold, 9 pt;
5. Identifikuesi i modelit duhet të jetë 100% e zezë dhe në Verdana Regular, 9 pt;
6. Shkalla A deri në G duhet të jetë si më poshtë:
- Shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë duhet të jenë 100% të bardha dhe në Calibri Bold, 19 pt; shkronjat duhet të jenë të vendosura në një rresht në qendër, 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave;
- Ngjyrat e shigjetave të shkallës A deri në G duhet të jenë si më poshtë:
  - Klasa A: 100,0,100,0;
  - Klasa B: 70,0,100,0;
  - Klasa C: 30,0,100,0;
  - Klasa D: 0,0,100,0;
  - Klasa E: 0,30,100,0;
  - Klasa F: 0,70,100,0;
  - Klasa G: 0,100,100,0;

7. Ndarjet e brendëshme duhet të kenë madhësi 0,5 pt dhe ngjyra e tyre duhet të jetë 100% e zezë;
8. Shkronja e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë 100% e bardhë dhe në Calibri Bold, 26 pt. Shigjeta e klasës së efiçencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën A deri në G duhet të jenë të pozicionuara në një mënyrë që të jenë të vendosura përballë dhe në të njejtën lartësi. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë e pozicionuar në qendër të pjesës katrore të shigjetës, e cila duhet të jetë 100% e zezë;

9. Vlera e konsumit të ponderuar të energjisë për 100 cikle duhet të jetë në fontin Verdana Bold 16 pt; 'kWh' duhet të jetë në fontin Verdana Regular, 10 pt; numri '100' në ikonën që përfaqëson 100 cikle duhet të jetë në Verdana Regular 6 pt. Vlera dhe njësia duhet të jenë në qendër dhe 100% të zeza;

10. Piktogramet duhet të jenë siç tregohet në formatin e etiketes dhe si më poshtë:

- Linjat e piktogrameve duhet të kenë një përmasë prej 1,2 pt, si dhe ato dhe tekstet (numrat dhe njësitë) duhet të jenë 100% të zeza;
- Tekstet në të majtë dhe të djathtë të piktogramës duhet të jenë në Verdana Bold 14 pt me njësitë në Verdana Regular 10 pt;
- Piktograma e efiçencës së energjisë së tharjes me centrifugë: klasat e efiçencës së energjisë së tharjes me centrifugë (A deri në G) duhet të jetë në qendër nën piktogram, me shkronjën e klasës së efiçencës së energjisë së tharjes me centrifugë në Verdana Bold 16 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të efiçencës së energjisë së tharjes me centrifugë në Verdana Regular 10 pt;
- Piktograma e emetimeve të zhurmës akustike: numri i decibeleve në altoparlant duhet të jetë në Verdana Bold 9 pt, me njësinë 'dB' në Verdana Regular 7 pt; klasat e zhurmës (A deri në D) duhet të jetë në qendër nën piktogram, me shkronjën e klasës së zhurmës përkatëse në Verdana Bold 16 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të zhurmës në Verdana Regular 10 pt;

11. Numri i rregullores duhet të jetë 100% e zezë dhe në Verdana Regular 6 pt.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III

Metodat e matjes dhe llogaritjet

Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e kësaj rregullore, matjet dhe llogaritjet duhet të kryhen duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

Kur një parametër deklarohet në përputhje me Ligjin Nr. 52/2024 dhe në përputhje me Tabelën 7 të shtojcës V për makinat larëse për përdorim shtëpiak ose Tabelën 8 të shtojcës V për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, vlera e deklaruar duhet të përdoret nga furnizuesi për llogaritjet në këtë shtojcë.

Programi ekologjik 40°C-60°C do të përdoret për matjen dhe llogaritjen e konsumit të energjisë, Indeksit të Efiçencës së Energjisë (EEI_W), temperaturës maksimale, konsumit të ujit, përmbajtjes së lagështisë të mbetur, kohëzgjatjes së programit, efiçencës së larjes, efiçencës së shpëlarjes, efiçencës së centrifugimit dhe emetimeve të zhurmës akustike në fazën e centrifugës për makinat larëse për përdorim shtëpiak dhe ciklin e larjes së makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak. Konsumi i energjisë, temperatura maksimale, konsumi i ujit, përmbajtja lagështisë së mbetur, kohëzgjatja e programit, efiçenca e larjes dhe efiçenca e shpëlarjes duhet të maten në të njejtën kohë.

Cikli i larjes dhe tharjes do të përdoret për matjen dhe llogaritjen e konsumit të energjisë, Indeksit të Efiçencës së Energjisë (EEI_{WD}), temperaturës maksimale në fazën e larjes, konsumit të ujit, përmbajtjes përfundimtare të lagështisë, kohëzgjatjes së ciklit, efiçencës së larjes dhe efiçencës së shpëlarjes për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak. Konsumi i energjisë, temperatura maksimale, konsumi i ujit, përmbajtja përfundimtare e lagështisë, kohëzgjatja e ciklit, efiçenca e larjes dhe efiçenca e shpëlarjes duhet të maten në të njejtën kohë.

Kur maten parametrat e kësaj shtojce për programin ekologjik 40°C-60 °C dhe për ciklin e larjes dhe tharjes, do të përdoret opsioni me shpejtësinë më të lartë të centrifugimit për programin ekologjik 40°C-60 °C në kapacitetin nominal, në gjysmën e kapacitetit nominal dhe, kur është e rëndësishme, në një të katërtën e kapacitetit nominal.

Për makinat larëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg dhe për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet larjeje më të ulët ose të barabartë me 3 kg, parametrat për programin ekologjik 40°C-60 °C dhe për ciklin e larjes dhe tharjes do të maten vetëm në kapacitetin nominal.

Kohëzgjatja e programit ekologjik 40°C-60 °C (t_W) në kapacitetin nominal të larjes, në gjysmën e kapacitetit nominal të larjes dhe në një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes, si dhe kohëzgjatja e ciklit të larjes dhe tharjes (t_{WD}) në kapacitetin nominal dhe në gjysmën e kapacitetit nominal, shprehen në orë dhe minuta dhe rrumbullakosen në minutën më të afërt.

Emetimet e zhurmës akustike maten në dB(A) kundrejt 1 pW dhe rrumbullakosen në numrin e plotë më të afërt.

1. KAPACITETI NOMINAL I MAKINAVE LARËSE-THARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

Kapaciteti nominal i makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak është kapaciteti nominal i ciklit të larjes dhe tharjes.

Nëse makina larëse-tharëse për përdorim shtëpiak ofron një cikël të pandërprerë, kapaciteti nominal i ciklit të larjes dhe tharjes duhet të jetë kapaciteti nominal për këtë cikël.

Nëse makina larëse-tharëse për përdorim shtëpiak nuk ofron një cikël të pandërprerë, kapaciteti i nominal i ciklit të larjes dhe tharjes do të jetë vlera më e ulët ndërmjet kapacitetit nominal të larjes në programin ekologjik 40°C-60 °C dhe kapacitetit nominal të tharjes të ciklit të tharjes së plotë.

2. INDEKSI I EFIÇENCËS SË ENERGJISË

2.1. Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_W) i makinave larëse për përdorim shtëpiak dhe ciklit të larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak

Për llogaritjen e EEI_W, konsumi i ponderuar i energjisë së programit ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes, në gjysmën e kapacitetit nominal të larjes dhe në një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes krahasohet me konsumimin standard të energjisë.

(a) EEI_W llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore:

$$EEI_W = (E_W/SCE_W) \times 100$$

Ku:

Ew është konsumi i ponderuar i energjisë së makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak;
SCEw është konsumimi standard i energjisë për ciklin e makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak.

(b) SCE_W llogaritet në kWh për cikël dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore si më poshtë:

$$SCE_W = -0{,}0025 \times c^2 + 0{,}0846 \times c + 0{,}3920$$

Ku **c** është kapaciteti nominal i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose kapaciteti nominal i larjes për makinën larëse-tharëse për përdorim shtëpiak për programin ekologjik 40°C-60 °C.

(c) E_W llogaritet në kWh për cikël si më poshtë dhe rrumbullakoset në tre shifra dhjetore:

$$E_W = A \times E_{W,full} + B \times E_{W,\frac{1}{2}} + C \times E_{W,\frac{1}{4}}$$

Ku:
$E_{W,full}$ është konsumi i energjisë i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të makinës larëse-tharëse, për programin ekologjik 40°C-60 °C në kapacitetin nominal të larjes dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore;
$E_{W,½}$ është konsumi i energjisë i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të makinës larëse-tharëse, për programin ekologjik 40°C-60°C, në gjysmën e kapacitetit nominal të larjes, dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore;
$E_{W,1/4}$ është konsumi i energjisë i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të makinës larëse-tharëse, për programin ekologjik 40°C-60°C, në një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes, dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore;
A është faktori i ponderuar për kapacitetin nominal të larjes dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore;
B është faktori i ponderuar për gjysmën e kapacitetit nominal të larjes dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore;
C është faktori i ponderuar për një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore.

Për makinat larëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg dhe për makinat larëse-tharëse me një kapacitet nominal të larjes më të ulët ose të barabartë me 3 kg, A do të jetë e barabartë me 1; B dhe C do të jenë të barabarta me 0.

Për makina të tjera larëse për përdorim shtëpiak dhe makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, vlerat e faktorëve të ponderuar varen nga kapaciteti nominal sipas ekuacioneve të mëposhtme:

$$A = -0{,}0391 \times c + 0{,}6918$$
$$B = -0{,}0109 \times c + 0{,}3582$$
$$C = 1 - (A + B)$$

Ku c është kapaciteti nominal i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose kapaciteti nominal i larjes për makinën larëse-tharëse për përdorim shtëpiak.

(d) Konsumi i ponderuar i energjisë për 100 cikle të makinës larëse për përdorim shtëpiak ose të ciklit të larjes të makinës larëse-tharëse llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në numrin më të afërt të plotë:

$$E_W \times 100$$

2.2. *Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{WD}) i ciklit të plotë të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak*

Për llogaritjen e EEI_{WD} për një model të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, konsumi i ponderuar i energjisë për ciklin e larjes dhe tharjes në kapacitetin nominal dhe në gjysmën e kapacitetit nominal krahasohet me konsumimin standard të energjisë për ciklin.

(a) EEI_{WD} llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore:

$$EEI_{WD} = (E_{WD}/SCE_{WD}) \times 100$$

ku:
E_{WD} është konsumi i ponderuar i energjisë për ciklin e plotë të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak;
SCE_{WD} është konsumimi standard i energjisë për ciklin e plotë të makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak.

(b) SCE_{WD} në kWh për cikël dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore si më poshtë:

$$SCE_{WD} = -0{,}0502 \times d^2 + 1{,}1742 \times d - 0{,}644$$

Ku **d** është kapaciteti nominal i makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak për ciklin e larjes dhe tharjes.

(c) Për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal të larjes më të ulët ose të barabartë me 3 kg, E_{WD} është konsumimi i energjisë në kapacitetin nominal dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore.

Për makina të tjera larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, E_{WD} llogaritet në kWh për cikël si më poshtë dhe rrumbullakoset në tre shifra dhjetore:

$$E_{WD} = \frac{[3 \times E_{WD,full} + 2 \times E_{WD,\frac{1}{2}}]}{5}$$

Ku:
$E_{WD,full}$ është konsumimi i energjisë i makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak për ciklin e larjes dhe tharjes në kapacitetin nominal dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore;
$E_{WD,½}$ është konsumimi i energjisë i makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak për ciklin e larjes dhe tharjes në gjysmën e kapacitetit nominal dhe rrumbullakoset në tre shifra pas presjes dhjetore.

(d) Konsumi i ponderuar i energjisë për 100 cikle të ciklit të plotë të makinës larëse-tharëse llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt:

$$E_{WD} \times 100$$

3. INDEKSI I EFIÇENCËS SË LARJES

Indeksi i efiçencës së larjes për makinat larëse për përdorim shtëpiak dhe për ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak (I_W) dhe indeksi i efiçencës së larjes për ciklin e plotë të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak (J_W) llogariten duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, dhe rrumbullakosen në tre shifra pas presjes dhjetore.

Për makinat larëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të lartë se 3 kg dhe për ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të lartë se 3 kg, I_W i treguar në skedën e informacionit të produktit do të jetë vlera më e ulët ndërmjet indeksit të efiçencës së larjes në kapacitetin e nominal të larjes, gjysmën e kapacitetit nominal të larjes, dhe një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes.

Për makinat larëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg dhe për ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg, I_W i treguar në skedën e informacionit të Produktit do të jetë indeksi i efiçencës së larjes në kapacitetin nominal të larjes.

Për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të lartë se 3 kg, J_W i treguar në skedën e informacionit të produktit duhet të jetë vlera më e ulët ndërmjet indeksit të efiçencës së larjes në kapacitetin nominal dhe gjysmën e kapacitetit nominal.

Për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg, J_W i treguar në skedën e informacionit të produktit duhet të jetë indeksi i efiçencës së larjes në kapacitetin nominal.

4. EFIÇENCA E SHPËLARJES

Efiçenca e shpëlarjes për makinat larëse për përdorim shtëpiak dhe për ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak (I_R) dhe efiçenca e shpëlarjes për ciklin e plotë të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak (J_R) llogariten duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, bazuar në zbulimin e treguesit së alkilbenzene sulfonat linear (LAS), dhe rrumbullakosen me një shifër pas presjes dhjetore.

Për makinat larëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të lartë se 3 kg dhe për ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të lartë se 3 kg, I_R i treguar në skedën e informacionit të produktit duhet të jetë vlera më e lartë ndërmjet efiçencës së shpëlarjes në kapacitetin nominal të larjes, gjysmën e kapacitetit nominal të larjes, dhe një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes.

Për makinat larëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg dhe për ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg, vlera për I_R në skedën e informacionit të produktit nuk do të publikohet.

Për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të lartë se 3 kg, J_R i shfaqur në skedën e informacionit të produktit duhet të jetë vlera më e lartë ndërmjet efiçencës së shpëlarjes në kapacitetin nominal dhe gjysmën e kapacitetit nominal.

Për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal më të ulët ose të barabartë me 3 kg, vlera për J_R në skedën e informacionit të produktit nuk do të publikohet.

5. TEMPERATURA MAKSIMALE

Temperatura maksimale e arritur për 5 minuta, brenda larjes që po trajtohet në makinat larëse për përdorim shtëpiak dhe në ciklin e larjes të makinave larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, do të përcaktohet duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

6. KONSUMI I PONDERUAR I UJIT

(1) Konsumi i ponderuar i ujit (W_W) i një makine larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak në litra dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt:

$$W_W = (A \times W_{W,full} + B \times W_{W,1/2} + C \times W_{W,1/4})$$

Ku:
$W_{W,full}$ është konsumi i ujit i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak për programin ekologjik 40ºC-60ºC në kapacitetin nominal të larjes, në litra dhe rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore;
$W_{W,½}$ është konsumi i ujit i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak për programin ekologjik 40ºC-60ºC në gjysmën e kapacitetit nominal të larjes, në litra dhe rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore;
$W_{W,1/4}$ është konsumimi i ujit i makinës larëse për përdorim shtëpiak ose i ciklit të larjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak për programin ekologjik 40ºC-60 ºC në një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes, në litra dhe rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore;
A, B, dhe C janë faktorët e ponderuar siç përshkruhet në pikën 2.1(c).

(2) Për makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak me një kapacitet nominal të larjes më të ulët ose të barabartë me 3 kg, konsumi i ponderuar i ujit i ciklit të larjes dhe tharjes është konsumi i ujit në kapacitetin nominal dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

Për makina të tjera larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, konsumi i ponderuar i ujit (W_{WD}) i ciklit të larjes dhe tharjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt:

$$W_{WD} = \frac{[3 \times W_{WD,full} + 2 \times W_{WD,\frac{1}{2}}]}{5}$$

ku:

$W_{WD,full}$ është konsumi i ujit i ciklit të larjes dhe tharjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak në kapacitetin nominal, në litra dhe rrumbullakoset në një shifër pas presjes dhjetore;
$W_{WD,½}$ është konsumimi i ujit i ciklit të larjes dhe tharjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak në gjysmën e kapacitetit nominal, në litra dhe rrumbullakoset në një shifër pas presjes dhjetore.

7. PËRMBAJTJA E LAGËSHTISË SË MBETUR

Përmbajtja e ponderuar e lagështisë së mbetur pas larjes (D) e një makine larëse për përdorim shtëpiak dhe e ciklit të larjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak llogaritet në përqindje si më poshtë dhe rrumbullakoset në një shifër pas presjes dhjetore:

$$D = \left[A \times D_{full} + B \times D_{\frac{1}{2}} + C \times D_{\frac{1}{4}}\right]$$

ku:

D_{full} është përmbajtja e lagështisë së mbetur për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes, në përqindje, dhe rrumbullakoset në dy shifra pas presjes dhjetore;
$D_{1/2}$ është përmbajtja e lagështisë së mbetur për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysmën e kapacitetit nominal të larjes, në përqindje, dhe rrumbullakoset në dy shifra pas presjes dhjetore;
$D_{1/4}$ është përmbajtja e lagështisë së mbetur për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes, në përqindje, dhe rrumbullakoset në dy shifra pas presjes dhjetore;
A, B, dhe C janë faktorët e ponderuar siç përshkruhen në pikën 2.1(c).

8.PËRMBAJTJA PËRFUNDIMTARE E LAGËSHTISË

Për ciklin e tharjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, statusi "plotësisht i tharë" korrespondon me 0% përmbajtje përfundimtare të lagështisë, e cila është ekuilibri termodinamik i ngarkesës me kushtet e ajrit të ambientit për temperaturën (testuar në 20 ± °C) dhe lagështinë relative (testuar në 65 ± 5%).

Përmbajtja përfundimtare e lagështisë llogaritet në përputhje me standardet e harmonizuara, dhe rrumbullakoset në një shifër pas presjes dhjetore.

9. "GJËNDJE E LËNË NDEZUR" (STANDBY)

Aty kur mund të zbatohet, konsumi i energjisë në gjëndjen "e fikur" (P_o), gjendjen "e stakuar" (P_{sm}) dhe fillimi i programit me vonesë (P_{ds}) matet, shprehet në W, dhe rrumbullakoset në dy shifra pas presjes dhjetore.
Gjatë matjeve të konsumit të energjisë në "Gjendjen e lënë ndezur", duhet të kontrollohen dhe të regjistrohen këto elemente:

—shfaqja ose jo e informacionit,
—aktivizimi ose jo i lidhjes me rrjetin.

Nëse një makinë larëse për përdorim shtëpiak ose një makinë larëse-tharëse për përdorim shtëpiak ofron funksionin anti-rrudhë, ky proces do të ndërpritet duke hapur derën e makinës larëse ose makinës larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, ose me ndonjë formë tjetër ndërhyrje të përshtatshme, 15 minuta përpara matjes së konsumit të energjisë.

10. EMETIMI I ZHURMËS AKUSTIKE

Emetimi i zhurmës akustike gjatë procesit të centrifugës për makinat larëse për përdorim shtëpiak dhe makinat larëse-tharëse për përdorim shtëpiak duhet të llogaritet për programin ekologjik 40°C-60°C me kapacitet të plotë larjeje, duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

11. SHPEJTËSIA E CENTRIFUGËS

Shpejtësia e centrifugës për një makinë larëse për përdorim shtëpiak dhe për ciklin e larjes të një makine larëse-tharëse për përdorim shtëpiak duhet të matet ose llogaritet në opsionin më të lartë të shpejtësisë së centrifugës për programin ekologjik 40°C-60 °C, duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

SHTOJCA IV
Skeda e informacionit të produktit

1. Makinë larëse shtëpiake

Në përputhje me pikën 1(b) të kreut IV, furnizuesi duhet të regjistrojë në regjistrin public të të dhënave të produktit informacionin e përcaktuar në Tabelën 5.

Manuali i përdoruesit ose çdo broshurë tjetër që shoqëron produktin, duhet të tregojë qartë lidhjen me modelin në bazën e të dhënave të produktit, si një Uniform Resource Locator (URL), ose si kod QR, ose duke ofruar numrin e regjistrimit të produktit.

Tabela 5
Përmbajtja, rendi dhe formati i skedës së informacionit të produktit

<table>
<tr><td colspan="5">Emri i furnizuesit ose marka tregtare:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Adresa e furnizuesit:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Identifikuesi i modelit:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Parametrat e përgjithshëm të produktit:</td></tr>
<tr><td>Parametri</td><td>Vlera</td><td>Parametri</td><td colspan="2">Vlera</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Kapaciteti nominal (kg)</td><td rowspan="3">x,x</td><td rowspan="3">Dimensionet në cm</td><td>Lartësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Gjerësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Thellësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Indeksi i efiçencës së energjisë
(EEI_W)</td><td>x,x</td><td>Klasa e efiçiencës së energjisë</td><td colspan="2">[A/B/C/D/E/F/G]</td></tr>
<tr><td>Indeksi I efiçencës së larjes</td><td>x,xxx</td><td>Efiçenca e shpëlarjes</td><td colspan="2">x,x</td></tr>
<tr><td>Konsumi i energjisë në kWh për cikël, bazuar në programin ekologjik 40°C-60 °C në një kombinim të ngarkesave të plota dhe të pjesshme. Konsumi aktual I energjisë do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes.</td><td>x,xxx</td><td>Konsumi i ujit në litër për cikël bazuar në programin ekologjik 40°C-60°C në një kombinim të ngarkesave të plota dhe të pjesshme. Konsumi actual I ujit do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes dhe fortësia e ujit</td><td colspan="2">x</td></tr>
</table>

Temperatura maksimale brenda tekstilit të trajtuar (°C)	Kapaciteti nominal	x	Përmbajtja e lagështisë së mbetur (%)	x,x
	Gjysëm të kapacitetit nominal	x		
	Një e katërta e kapacitetit nominal	x		
Shpejtësia e rrotullimit (rpm)	Kapaciteti nominal	x	Klasa e efiçencës së tharjes me centrifugim	[A/B/C/D/E/F/G]
	Gjysëm të kapacitetit nominal	x		
	Një e katërta e kapacitetit nominal	x		
Kohëzgjatja e programit (orë:min)	Kapaciteti nominal	x:xx	Lloji	[e parashikuar të instalohet në dollap/qëndrim i lirë]
	Gjysëm të kapacitetit nominal	x:xx		
	Një e katërta e kapacitetit nominal	x;xx		
Emetimet e zhurmës akustike në ambient gjatë procesit të centrifuges (dB(A) kundrejt 1 pW)	x		Klasat e emetimit të zhurmës akustike (faza e centrifugës)	[A/B/C/D]
Gjendja stakuar (Off Mode) (W) (nëse është e zbatueshme)	x,xx		Gjendje e lënë ndezur (Standby mode) (W) (nëse është e zbatueshme)	x,xx
Fillim me vonesë (Delay start) (W) (nëse është e zbatueshme)	x,xx		Networked standby (W)(nëse është e zbatueshme)	x,xx
Kohëzgjatja minimale e garancisë së ofruar nga furnizuesi				
Ky produkt është projektuar për të cliruar jone të argjendit gjatë ciklit të larjes			[Po/Jo]	

1.Makinë larëse-tharëse shtëpiake

Në përputhje me pikën 1(b) të kreut IV, furnizuesi duhet të regjistrojë në regjistrin publik të të dhënave të produktit informacionin e përcaktuar në Tabelën 6.

Manuali i përdoruesit ose çdo broshurë tjetër që shoqëron produktin, duhet të tregojë qartë lidhjen me modelin në bazën e të dhënave të produktit, si një Uniform Resource Locator (URL), ose si kod QR, ose duke ofruar numrin e regjistrimit të produktit.

Tabela 6
Përmbajtja, rendi dhe formati i skedës së informacionit të produktit

<table>
<tr><td colspan="6">Emri i furnizuesit ose marka tregtare:</td></tr>
<tr><td colspan="6">Adresa e furnizuesit:</td></tr>
<tr><td colspan="6">Identifikuesi i modelit:</td></tr>
<tr><td colspan="6">Parametrat e përgjithshëm të produktit:</td></tr>
<tr><td>Parametri</td><td colspan="2">Vlera</td><td>Parametri</td><td colspan="2">Vlera</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Kapaciteti nominal (kg)</td><td>Kapaciteti nominal</td><td>x, x</td><td rowspan="3">Dimensionet në cm</td><td>Lartësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Kapaciteti nominal i larjes</td><td>x, x</td><td>Gjerësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI_W)</td><td rowspan="2">Thellësia</td><td rowspan="2">x</td></tr>
<tr><td>EEI_W</td><td>x, x</td><td rowspan="2">Klasa e efiçiencës së energjisë</td><td>EEI_W</td><td>[A/B/C/D/E/F/G]</td></tr>
<tr><td>EEI_{WD}</td><td>x, x</td><td>EEI_{WD}</td><td>[A/B/C/D/E/F/G]</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Indeksi i efiçencës së larjes</td><td>I_W</td><td>x, x</td><td rowspan="2">Efiçenca e shpëlarjes (g/kg tekstile të thata)</td><td>I_R</td><td>x, x</td></tr>
<tr><td>J_W</td><td>x, x</td><td>J_R</td><td>x, x</td></tr>
<tr><td>Konsumi i energjisë në kWh për cikël, për ciklin e larjes, bazuar në programin ekologjik 40°C-60 °C në një kombinim të ngarkesave të plota dhe të pjesshme. Konsumi aktual i energjisë do të varet nga</td><td colspan="2">x,xxx</td><td>Konsumi i energjisë në kWh për cikël, për ciklin e larjes dhe tharjes, për makinën larëse-tharëse shtëpiake, në një kombinim të ngarkesave të plota dhe të pjesshme.</td><td colspan="2">x,xxx</td></tr>
</table>

mënyra e përdorimit të pajisjes.			Konsumi aktual i energjisë do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes.		
Konsumi i ujit në litër për cikël bazuar në programin ekologjik 40°C-60°C në një kombinim të ngarkesave të plota dhe të pjesshme. Konsumi aktual i ujit do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes dhe fortësia e ujit	x		Konsumi i ujit në litër për cikël për ciklin e larjes dhe tharjes, për makinën larëse-tharëse shtëpiake, në një kombinim të ngarkesave të plota dhe të pjesshme. Konsumi actual I ujit do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes dhe fortësia e ujit	x	
Temperatura maksimale brenda tekstilit të trajtuar (°C) për ciklin e larjes për makinën larëse-tharëse shtëpiake, në programin ekologjik 40°C-60°C	Kapaciteti nominal	x	Temperatura maksimale brenda tekstilit të trajtuar (°C) për ciklin e larjes për makinën larëse-tharëse shtëpiake, në ciklin e larjes dhe tharjes	Kapaciteti nominal	x
	Gjysëm të kapaciteti t nominal	x		Gjysëm të kapacitetit nominal	x
	Një e katërta e kapaciteti t nominal	x			
Shpejtësia e rrotullimit (rpm)	Kapaciteti nominal	x	Përmbajtja e lagështisë së mbetur (%)	x,x	
	Gjysëm të kapaciteti t nominal	x			
	Një e katërta e kapaciteti t nominal	x			
Kohëzgjatja e programit ekologjik 40°C-60°C (orë:min)	Kapaciteti nominal	x:xx	Klasa e efiçencës së tharjes me centrifugim	[A/B/C/D/E/F/G]	
	Gjysëm të	x:xx			

	kapaciteti t nominal				
	Një e katërta e kapaciteti t nominal	x;xx			
Emetimet e zhurmës akustike në ambient gjatë procesit të centrifugës për programin ekologjik 40°C-60°C, në kapacitetin nominal të larjes (dB(A) kundrejt 1 pW)	x		Kohëzgjatja e ciklit të larjes dhe tharjes (orë:min)	Kapaciteti nominal	x:xx
				Gjysëm të kapacitetit nominal	x:xx
Lloji	[e parashikuar të instalohet në dollap/qëndrim i lirë]		Klasat e emetimit të zhurmës akustike të fazës së centrifugës, për programin ekologjik 40°C-60°C, në kapcitetin nominal të larjes	[A/B/C/D] ([d])	
Gjendja stakuar (Off Mode) (W) (nëse është e zbatueshme)	x,xx		Gjendje e lënë ndezur (Standby mode) (W) (nëse është e zbatueshme)	x,xx	
Fillim me vonesë (Delay start) (W) (nëse është e zbatueshme)	x,xx		Networked standby (W)(nëse është e zbatueshme)	x,xx	
Kohëzgjatja minimale e garancisë së ofruar nga furnizuesi					
Ky product është projektuar për të cliruar jone të argjendit gjatë ciklit të larjes			[Po/Jo]		

SHTOJCA V
Dokumentacioni Teknik

1. Për makinat larëse shtëpiake, dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(ç) të kreut IV duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

   (a) një përshkrim të përgjithshëm të modelit që lejon qartësisht identifikimin e tij;
   (b) referencat për standardet e harmonizuara të aplikuara ose standardet e tjera të matjes që janë përdorur;
   (c) masat paraprake të nevojshme specifike gjatë montimit, instalimit, mirëmbajtjes ose testimit të modelit;
   (d) vlerat për parametrat teknikë të përcaktuara në Tabelën 7; këto vlera konsiderohen si vlerat e deklaruara për procedurën e verifikimit në shtojcën VIII;
   (e) detajet dhe rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me shtojcën III;
   (f) kushtet e testimit nëse nuk janë përshkruar mjaftueshëm në pikën (b);
   (g) modelet ekuivalente, nëse ka, duke përfshirë identifikuesit e modeleve.

Këto elemente gjithashtu përbëjnë pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi duhet të regjistrojë në bazën e të dhënave, në përputhje me pikën 11 të Nenit 9 të Ligjit 52/2024.

Tabela 7
Parametrat teknikë të modelit dhe vlera e deklaruar për makinat larëse shtëpiake

PARAMETRI	VLERA E DEKLARUAR	NJËSIA
Kapaciteti nominal për programin ekologjik 40°C-60°C, në intervale 0,5 kg (c)	X,X	kg
Konsumi i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal ($E_{W,full}$)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal ($E_{W,1/2}$)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal ($E_{W,1/4}$)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi i ponderuar i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C (E_W)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi standard i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C (SCE_W)	X,XXX	kWh/cikël
Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_W)	X,X	-
Konsumi i ujit për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal ($W_{W,full}$)	X,X	L/cikël

Konsumi i ujit për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal ($W_{W,1/2}$)	X,X	L/cikël
Konsumi i ujit për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal ($W_{W,1/4}$)	X,X	L/cikël
Konsumi i ponderuar i ujit (W_W)	X	L/cikël
Indeksi i Efiçencës së larjes për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal (I_W)	X,XXX	-
Indeksi i Efiçencës së larjes për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal (I_W)	X,XXX	-
Indeksi i Efiçencës së larjes për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal (I_W)	X,XXX	-
Efiçenca e shpëlarjes për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal (I_R)	X,X	g/kg
Efiçenca e shpëlarjes për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal (I_R)	X,X	g/kg
Efiçenca e shpëlarjes për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal (I_R)	X,X	g/kg
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal (t_W)	X:XX	h:min
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal (t_W)	X:XX	h:min
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal (t_W)	X:XX	h:min
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë programit ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal (T)	X	°C
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë programit ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal (T)	X	°C
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë programit ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal (T)	X	°C
Shpejtësia e centrifugimit gjatë fazës së centrifugës në programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal (S)	X	rpm
Shpejtësia e centrifugimit gjatë fazës së centrifugës në programin ekologjik 40°C-60°C në gjysmën e kapacitetit nominal (S)	X	rpm
Shpejtësia e centrifugimit gjatë fazës së centrifugës në programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën e kapacitetit nominal (S)	X	rpm
Përmbajtja e lagështisë së mbetur të matur (D)	X,X	%
Emetimet e zhurmës akustike në ambient gjatë programit ekologjik 40°C-60°C (faza e centrifugës)	X	dB(A) kundrejt 1 pW
Konsumi i energjisë në 'Gjendjen Stakuar/modalitetin off' (P_o) (nëse aplikohet)	X,XX	W

Konsumi i energjisë në 'Gjendje e lënë ndezur' (P_{sm}) (nëse aplikohet)	X,XX	W
A përfshin 'Gjendje e lënë ndezur' shfaqjen e informacionit?	Po/Jo	-
Konsumi i energjisë në Gjendje e lënë ndezur ' (P_{sm}) në kushtet e networked standby (nëse aplikohet)	X,XX	W
Konsumi i energjisë në 'Fillim me vonesë' (P_{ds}) (nëse aplikohet)	X,XX	W

2. Për makinat larëse-tharëse shtëpiake, dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(ç) të kreut IV duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

(a) një përshkrim të përgjithshëm të modelit që lejon qartësisht identifikimin e tij;
(b) referencat për standardet e harmonizuara të aplikuara ose standardet e tjera të matjes që janë përdorur;
(c) masat paraprake të nevojshme specifike gjatë montimit, instalimit, mirëmbajtjes ose testimit të modelit;
(d) vlerat për parametrat teknikë të përcaktuara në Tabelën 8; këto vlera konsiderohen si vlerat e deklaruara për procedurën e verifikimit në shtojcën VIII;
(e) detajet dhe rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me shtojcën III;
(f) kushtet e testimit nëse nuk janë përshkruar mjaftueshëm në pikën (b);
(g) modelet ekuivalente, nëse ka, duke përfshirë identifikuesit e modeleve.

Këto elemente gjithashtu përbëjnë pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi duhet të regjistrojë në bazën e të dhënave, në përputhje me pikën 11 të Nenit 9 të Ligjit 52/2024.

Tabela 8

Parametrat teknikë të modelit dhe vlera e deklaruar për makinat larëse-tharëse shtëpiake

PARAMETRI	VLERA E DEKLARUAR	NJËSIA
Kapaciteti nominal për ciklin e larjes për programin ekologjik 40°C-60°C, në intervale 0,5 kg (c)	X,X	kg
Kapaciteti nominal për ciklin e larjes dhe tharjes për programin ekologjik 40°C-60°C, në intervale 0,5 kg (c)	X,X	kg
Konsumi i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes ($E_{W,full}$)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal të larjes ($E_{W,1/2}$)	X,XXX	kWh/cikël

Konsumi i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal të larjes ($E_{W,1/4}$)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi i ponderuar i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C (E_W)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi standard i energjisë për programin ekologjik 40°C-60°C (SCE_W)	X,XXX	kWh/cikël
Indeksi i Efiçencës së Energjisë të ciklit të larjes (EEI_W)	X,X	-
Konsumi i energjisë për ciklin e larjes dhe tharjes në kapacitet nominal ($E_{WD,full}$)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi i energjisë për ciklin e larjes dhe tharjes në gjysëm të kapacitet nominal ($E_{WD,1/2}$)	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi i ponderuar i energjisë për ciklin e larjes dhe tharjes (E_{WD})	X,XXX	kWh/cikël
Konsumi standard i energjisë për ciklin e larjes dhe tharjes (SCE_{WD})	X,XXX	kWh/cikël
Indeksi i Efiçencës së Energjisë për ciklin e larjes dhe tharjes (EEI_{WD})	X,X	-
Konsumi i ujit për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes ($W_{W,full}$)	X,X	L/cikël
Konsumi i ujit për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal të larjes ($W_{W,1/2}$)	X,X	L/cikël
Konsumi i ujit për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal të larjes ($W_{W,1/4}$)	X,X	L/cikël
Konsumi i ponderuar i ujit për ciklin e larjes (W_W)	X	L/cikël
Konsumi i ujit për ciklin e larjes dhe tharjes në kapacitet nominal ($W_{WD,full}$)	X,X	L/cikël
Konsumi i ujit për ciklin e larjes dhe tharjes në gjysëm të kapacitetit nominal ($W_{WD,1/2}$)	X,X	L/cikël
Konsumi i ponderuar i ujit për ciklin e larjes dhe tharjes (W_{WD})	X	L/cikël
Indeksi i Efiçencës së larjes për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes (I_W)	X,XXX	-
Indeksi i Efiçencës së larjes për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal të larjes (I_W)	X,XXX	-
Indeksi i Efiçencës së larjes për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal të larjes (I_W)	X,XXX	-
Indeksi i Efiçencës së larjes për ciklin e larjes dhe tharjes në kapacitet nominal (J_W)	X,XXX	-
Indeksi i Efiçencës së larjes për ciklin e larjes dhe tharjes në gjysëm të kapacitetit nominal (J_W)	X,XXX	-
Efiçenca e shpëlarjes për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes (I_R)	X,X	g/kg
Efiçenca e shpëlarjes për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal të larjes (I_R)	X,X	g/kg

Efiçenca e shpëlarjes për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal të larjes (I_R)	X,X	g/kg
Efiçenca e shpëlarjes për ciklin e larjes dhe tharjes në kapacitet nominal (J_R)	X,X	g/kg
Efiçenca e shpëlarjes për ciklin e larjes dhe tharjes në gjysëm të kapacitetit nominal (J_R)	X,X	g/kg
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes (t_W)	X:XX	h:min
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal të larjes (t_W)	X:XX	h:min
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal të larjes (t_W)	X:XX	h:min
Kohëzgjatja e programit për ciklin e larjes dhe tharjes në kapacitet nominal (t_{WD})	X:XX	h:min
Kohëzgjatja e programit për ciklin e larjes dhe tharjes në gjysëm të kapacitetit nominal (t_{WD})	X:XX	h:min
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë programit ekologjik 40°C-60°C në kapacitet nominal të larjes (T)	X	°C
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë programit ekologjik 40°C-60°C në gjysëm të kapacitetit nominal të larjes (T)	X	°C
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë programit ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën të kapacitetit nominal të larjes (T)	X	°C
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë ciklit të larjes dhe tharjes në kapacitet nominal (T)	X	°C
Temperatura e arritur për minimumi 5 minuta brenda ngarkesës gjatë gjatë ciklit të larjes dhe tharjes në gjysëm të kapacitetit nominal (T)	X	°C
Shpejtësia e centrifugimit gjatë fazës së centrifugës në programin ekologjik 40°C-60°C në kapacitetin nominal të larjes (S)	X	rpm
Shpejtësia e centrifugimit gjatë fazës së centrifugës në programin ekologjik 40°C-60°C në gjysmën e kapacitetit nominal të larjes (S)	X	rpm
Shpejtësia e centrifugimit gjatë fazës së centrifugës në programin ekologjik 40°C-60°C në një të katërtën e kapacitetit nominal të larjes (S)	X	rpm
Përmbajtja e lagështisë së mbetur të matur pas larjes (D)	X,X	%
Përmbajtja përfundimtare e lagështisë së mbetur	X,X	%
Emetimet e zhurmës akustike në ambient gjatë programit ekologjik 40°C-60°C (faza e centrifugës)	X	dB(A) kundrejt 1 pË

Konsumi i energjisë në 'Gjendjëen Stakuar/modalitetin off' (P_o) (nëse aplikohet)	X,XX	W
Konsumi i energjisë në 'Gjendje e lënë ndezur' (P_{sm}) (nëse aplikohet)	X,XX	W
A përfshin 'Gjendje e lënë ndezur' shfaqjen e informacionit?	Po/Jo	-
Konsumi i energjisë në Gjendje e lënë ndezur ' (P_{sm}) në kushtet e networked standby (nëse aplikohet)	X,XX	W
Konsumi i energjisë në 'Fillim me vonesë' (P_{ds}) (nëse aplikohet)	X,XX	ËW

3. Kur informacioni i përfshirë në dokumentacionin teknik për një model të caktuar të makinës larëse shtëpiake ose makinës larëse-tharëse shtëpiake është përcaktuar me ndonjërën nga metodat e mëposhtme, ose të dyja:
   - nga një model që ka të njëjtat karakteristika teknike të rëndësishme për informacionin teknik që duhet të sigurohet, por që është prodhuar nga një furnizues tjetër,
   - me llogaritje bazuar në modelin ose me ekstrapolim nga një model tjetër i të njëjtit furnizues ose i një furnizuesi tjetër,

   dokumentacioni teknik duhet të përfshijë detajet e një llogaritjeje të tillë, vlerësimin e kryer nga furnizuesit për të verifikuar saktësinë e llogaritjes dhe, kur është e përshtatshme, deklaratën e identitetit midis modeleve të furnizuesve të ndryshëm.

SHTOJCA VI

Informacioni që duhet të shfaqet në reklamat vizuale, në materialin promovues teknik në shitjen në distanca dhe në telemarketing, përveç shitjes në distanca në internet

1. Në reklamat vizuale për makinat larëse shtëpiake ose makinat larëse-tharëse shtëpiake, me qëllim përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në pikën 1(d) të kreut IV dhe pikën (c) të kreut V, klasa e efiçencës së energjisë dhe diapazoni i klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë duhet të afishohet siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
2. Në materialin promovues teknik për makinat larëse shtëpiake ose makinat larëse-tharëse shtëpiake, me qëllim përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në pikën 1(dh) të kreut IV dhe pikën ç të kreut V, klasa e efiçencës së energjisë dhe diapazoni i klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, duhet të afishohen siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
3. Çdo shitje nga distanca nëpërmjet materialeve promovuese fizike të makinave larëse shtëpiake ose makinave larëse-tharëse shtëpiake, duhet të tregojë klasën e efiçencës së energjisë dhe diapazonin e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
4. Klasa e efiçencës së energjisë dhe diapazoni i klasave të efiçencës së energjisë duhet të afishohen, siç tregohet në Figurën 1, me:

   (a) për makinat larëse shtëpiake: një shigjetë, që përmban shkronjën e klasës së efiçencës të energjisë 100 % të bardhë, Calibri Bold dhe me madhësi të shkronjave të paktën të barabartë me atë të çmimit, kur çmimi publikohet;
   (b) për makinat larëse-tharëse shtëpiake: një shigjetë që përmban shkronjën e klasës së efiçencës së energjisë për ciklin e plotë në 100 % të bardhë, Calibri Bold dhe me madhësi të shkronjave të paktën të barabartë me atë të çmimit, kur çmimi publikohet;
   (c) ngjyra e shigjetës të përputhet me ngjyrën e klasës së efiçencës të energjisë;
   (d) diapazoni i klasave të efiçencës së energjisë të jetë 100 % e zezë; dhe,
   (e) madhësia duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë e vendosur në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufij 0.5 pt 100 % të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe shkronjës së klasës së efiçencës së energjisë.

   Si përjashtim, nëse reklama vizuale, materiali promovues teknik ose shitja nga distanca nëpërmjet materialeve promovuese fizike është e shtypur në njëngjyrësh, shigjeta mund të jetë në njëngjyrësh në atë reklamë vizuale, material promovues teknik ose shitje nga distanca nëpërmjet materialeve promovuese fizike.

Figura 1

Shigjeta me ngjyra/njëngjyrëshe majtas/djathtas, me diapazonin e klasave të efiçencës së energjisë



5. Shitja nga distanca përmes telemarketingut duhet të informojë në mënyrë specifike klientin për klasat e efiçencës së energjisë së produktit dhe për diapazonin e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, si dhe se klienti mund të ketë qasje në etiketë dhe në skedën e informacionit të produktit përmes faqes së internetit të bazës së të dhënave të produktit, ose duke kërkuar një kopje të shtypur.
6. Për të gjitha situatat e përmendura në pikat 1 deri në 3 dhe 5, duhet të mundësohet që klienti të marrë, me kërkesë, një kopje të shtypur të etiketës dhe skedës së informacionit të produktit.

SHTOJCA VII

Informacioni që duhet të sigurohet në rastin e shitjes nga distanca përmes internetit

1. Etiketa përkatëse e publikuar nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(e) të kreut IV duhet të shfaqet në mekanizmin e shfaqjes (display mechanism) pranë çmimit të produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që etiketa të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe të jetë në përpjesëtim me madhësinë e specifikuar në shtojcën II. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndarë (nested display), në të cilin imazhi i përdorur për të aksesuar etiketën duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 2 të kësaj shtojce. Nëse aplikohet një ekran i ndarë, etiketa duhet të shfaqet me klikimin e pare të mouse-it, me rrotullimin e mouse-it ose zgjerimin e ekranit taktil në imazh.

2. Imazhi i përdorur për të aksesuar etiketën në rastin e ekranit të ndarë, siç tregohet në Figurën 2, duhet të:

   (a) për makinat larëse shtëpiake: të jetë një shigjetë me ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë së produktit në etiketë;
   (b) për makinat larëse-tharëse shtëpiake: të jetë një shigjetë me ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë për ciklin e plotë në etiketë;
   (c) të tregojë klasën e efiçencës së energjisë së produktit në shigjetë 100 % të bardhë, Calibri Bold dhe me një madhësi shkronjash të barabartë me atë të çmimit;
   (d) të ketë diapazonin e klasave të efiçencës të energjisë të disponueshme 100 % të zezë; dhe,
   (e) të ketë një nga dy formatet e mëposhtme, dhe madhësia e tij duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë e pozicionuar në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me kufij të dukshëm 100 % të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe shkronjës së klasës së efiçencës së energjisë.

Figura 2

Shigjeta me ngjyra majtas/djathtas, me diapazonin e klasave të efiçencës së energjisë



3. Në rastin e ekranit të ndarë (nested display), renditja e shfaqjes së etiketës duhet të jetë si më poshtë:
(a) imazhet e përmendura në pikën 2 të kësaj shtojce duhet të shfaqen në mekanizmin e shfaqjes pranë çmimit të produktit;

(b) imazhet duhet të lidhen me etiketën e përcaktuar në Shtojcën II;
(c) etiketa duhet të shfaqet pas një klikimi të mouse-it, rrotullimit të mouse-it ose zgjerimit të ekranit taktil mbi imazhin;
(d) etiketa duhet të shfaqet si pop-up, në një skedë të re, faqe të re ose ekran të ndarë;
(e) për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, duhet të zbatohen standardet e pajisjes për zmadhimin me prekje;
(f) etiketa duhet të ndalojë së shfaquri përmes një opsioni mbylljeje ose mekanizmi tjetër standard të mbylljes;
(g) teksti alternativ për grafikun, që do të shfaqet në rast dështimi të shfaqjes së etiketës, duhet të përmbajë klasat e efiçencës së energjisë së produktit në një madhësi shkronjash të barabartë me atë të çmimit.

4. Skeda elektronike e informacionit të produktit e disponueshme nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(ë) të kreut IV duhet të shfaqet në mekanizmin e shfaqjes pranë çmimit të produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që skeda e informacionit të produktit të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Skeda e informacionit të produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndarë ose duke iu referuar bazës së të dhënave të produktit, në të cilin link-u i përdorur për të hyrë në skedën e informacionit të produktit duhet të tregojë qartësisht 'Skeda e informacionit të produktit'. Nëse përdoret një ekran i ndarë, skeda e informacionit të produktit duhet të shfaqet me klikimin e parë të mouse-it, rrotullimin e mouse-it ose zgjerimin e ekranit taktil në link.

SHTOJCA VIII
Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë shtojce lidhen vetëm me verifikimin nga Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut të vlerave të deklaruara dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesi si tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik ose për të interpretuar këto vlera me synimin e arritjes së përputhshmërisë ose për të komunikuar performancë më të mirë. Vlerat dhe klasat e publikuara në etiketë ose në skedën e informacionit të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara në dokumentacionin teknik.

Në rastin kur një model është projektuar për të qenë në gjendje të zbulojë se po testohet (p.sh. duke njohur kushtet ose ciklin e testit), dhe për të reaguar në mënyrë specifike duke ndryshuar automatikisht performancën e tij gjatë testit me qëllimin e arritjes së një niveli më të favorshëm për ndonjë nga parametrat e specifikuar në këtë rregullore ose të përfshirë në dokumentacionin teknik apo në ndonjë dokumentacion të dhënë, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente nuk do të konsiderohen në përputhje.

Si pjesë e verifikimit të përputhshmërisë së një modeli me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të zbatojë procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të verifikojnë një njësi të vetme të modelit.
2. Modeli do të konsiderohet në përputhje me kërkesat nëse:
   (a) vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik në përputhje me nenin 3(3) të Rregullores (BE) 2017/1369 (vlerat e deklaruara), dhe, kur është e aplikueshme, vlerat e përdorura për të llogaritur këto vlera, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testeve; dhe
   (b) vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën e informacionit të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e efiçencës së energjisë, klasa e emetimit të zhurmës akustike në ambient dhe klasa e efiçencës së tharjes me centrifugë nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe
   (c) kur Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) janë në përputhje me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 9.
3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2(a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen si jo në përputhje me këtë rregullore.
4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të zgjedhë tre njësi shtesë të modelit të njëjtë për testim. Si

alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve ekuivalente.

5. Modeli do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e aplikueshme nëse për këto tre njësi, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara është në përputhje me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 9.
6. Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen si jo në përputhje me këtë rregullore.
7. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do t'u sigurojë të gjitha informacionet përkatëse ministries përgjegjëse për tregtinë dhe te ministrisë përgjegjëse për energjinë pa vonesë pas marrjes së një vendimi mbi mos-përputhshmërinë e modelit sipas pikave 3, 6 ose paragrafit të dytë të kësaj shtojce.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut duhet të përdorë metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën IV.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut duhet të zbatojë vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 9 dhe duhet të përdorë vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 7 për kërkesat e përmendura në këtë shtojcë. Për parametrat në Tabelën 9, nuk duhet të aplikohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara apo në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 9

Tolerancat e verifikimit

Parametri	Toleranca e verifikimit
$E_{W,full}$, $E_{W,1/2}$, $E_{W,1/4}$, $E_{WD,full}$, $E_{WD,1/2}$	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të $E_{W,full}$, $E_{W,1/2}$, $E_{W,1/4}$, $E_{WD,full}$ dhe $E_{WD,1/2}$, përkatësisht, me më shumë se 10 %.
Konsumi i ponderuar i energjisë (E_W dhe E_{WD})	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të E_W dhe E_{WD}, përkatësisht, me më shumë se 10 %.
$W_{W,full}$, $W_{W,1/2}$, $W_{W,1/4}$, $W_{WD,full}$, $W_{WD,1/2}$	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të $W_{W,full}$, $W_{W,1/2}$, $W_{W,1/4}$, $W_{WD,full}$ dhe $W_{WD,1/2}$, përkatësisht, me më shumë se 10 %.
Konsumi i ponderuar i ujit (W_W dhe W_{WD})	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të W_W dhe W_{WD}, përkatësisht, me më shumë se 10 %.
Indeksi i efiçencës së larjes (I_W dhe J_W) në të gjitha kapacitetet relevante	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar e I_W dhe J_W, përkatësisht, me më shumë se 8 %.

Efiçenca e shpëlarjes (I_R dhe J_R) në të gjitha kapacitetet relevante	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të I_R dhe J_R, përkatësisht, me më shumë se 1,0 g/kg.
Kohëzgjatja e ciklit ose programit (t_W dhe t_{WD}) në të gjitha kapacitetet relevante	Vlera e përcaktuar (*) e kohëzgjatjes së programit ose ciklit nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të t_W dhe t_{WD}, përkatësisht, me më shumë se 5 % ose më shumë se 10 minuta, cilado që të jetë më e vogël.
Temperatura maksimale brënda ngarkesës (T) gjatë ciklit të larjes në të gjitha kapacitetet relevante	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar e T me më shumë se 5K dhe nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të T me më shumë se 5K.
Përmbajtja e lagështisë së mbetur pas larjes (D)	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar të D me më shumë se 10 %.
Përmbajtja përfundimtare e lagështise pas tharjes në të gjitha kapacitetet relevante	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë 3,0 %.
Shpejtësia e centrifugës (S) në të gjitha kapacitetet relevante	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar e S me më shumë se 10 %.
Konsumi i fuqisë në 'Gjendjëen Stakuar/modalitetin off' (P_o)	Vlera e përcaktuar (*) e konsumit të energjisë P_o nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 0,10 W.
Konsumi i fuqisë në Gjendje e lënë ndezur ' (P_{sm})	Vlera e përcaktuar (*) e konsumit të energjisë P_{sm} nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 10 % nëse vlera e deklaruar është më e madhe se 1,00 W, ose me më shumë se 0,10 W nëse vlera e deklaruar është më e vogël ose e barabartë me 1,00 W.
Konsumi i fuqisë në 'Fillim me vonesë' (P_{ds})	Vlera e përcaktuar (*) e konsumit të energjisë P_{ds} nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 10 % nëse vlera e deklaruar është më e madhe se 1,00 W, ose me më shumë se 0,10 W nëse vlera e deklaruar është më e vogël ose e barabartë me 1,00 W.
Emetimet e zhurmës akustike në ambient	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 2 dB(A) kundrejt 1 pW.
* Në rastin kur testohen tre njësi shtesë siç është përcaktuar në pikën 4, vlera e përcaktuar nënkupton mesataren aritmetike të vlerave të përcaktuara për këto tre njësi shtesë.	

SHTOJCA IX

Makinat larëse shtëpiake me shumë kazanë dhe makat larëse-tharëse me shumë kazanë

Parashikimet e shtojcave I dhe II, sipas metodave të matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në shtojcën III, do të aplikohen për çdo kazan me kapacitet nominal më të lartë se ose të barabartë me 2 kg të makinave larëse shtëpiake me shumë kazanë dhe për çdo kazan me kapacitet nominal të larjes më të lartë se ose të barabartë me 2 kg të makinave larëse-tharëse shtëpiake me shumë kazanë.

Parashikimet e Shtojcave I dhe II do të aplikohen për secilin kazan në mënyrë të pavarur, përveç rasteve kur kazanët janë ndërtuar në të njëjtën kasë dhe mund të operojnë vetëm në mënyrë të sinkronizuar në programin ekologjik 40°C-60°C ose në ciklin e larjes dhe tharjes. Në këtë rast, këto parashikime do të aplikohen për makinën larëse shtëpiake me shumë kazanë ose për makinën larëse-tharëse shtëpiake me shumë kazanë si tërësi, si më poshtë:

(a) kapaciteti nominal i larjes është shuma e kapaciteteve nominale të larjes të çdo kazani; makinën larëse-tharëse shtëpiake me shumë kazanë, kapaciteti nominal është shuma e kapaciteteve nominale të çdo kazani;
(b) konsumi i energjisë dhe ujit i makinës larëse shtëpiake me shumë kazanë dhe i ciklit të larjes së makinës larëse-tharëse shtëpiake me shumë kazanë, është shuma e konsumit të energjisë ose ujit të çdo kazani;
(c) konsumi i energjisë dhe ujit i ciklit të plotë të makinës larëse-tharëse shtëpiake me shumë kazanë, është shuma e konsumit të energjisë ose ujit të çdo kazani;
(d) Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_W) llogaritet duke përdorur kapacitetin nominal të larjes dhe konsumin e energjisë; për makinat larëse-tharëse shtëpiakë me shumë kazanë, Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{WD}) llogaritet duke përdorur kapacitetin nominal dhe konsumin e energjisë;
(e) kohëzgjatja është kohëzgjatja e programit më të gjatë ekologjik 40°C-60°C, ose cikli i larjes dhe tharjes, që operon në çdo kazan;
(f) përmbajtja e lagështisë së mbetur pas larjes llogaritet si mesatarja e ponderuar, sipas kapacitetit nominal të çdo kazani;
(g) për makinat larëse-tharëse shtëpiakë me shumë kazanë, përmbajtja përfundimtare e lagështisë së mbetur pas tharjes matet individualisht për çdo kazan;
(h) matja e gjendjeve me konsum të reduktuar të energjisë, e emetimeve të zhurmës akustike në ambient dhe klasa e emetimeve të zhurmës akustike në ambient i përkasin makinës larëse shtëpiake në tërësi.

Skeda e informacionit të produktit dhe dokumentacioni teknik duhet të përfshijnë dhe të paraqesin së bashku informacionin e kërkuar sipas Shtojcave IV dhe V, për të gjitha kazanët për të cilët aplikohen dispozitat e kësaj shtojce.

Dispozitat e shtojcave VI dhe VII aplikohen për secilin nga kazanët për të cilët aplikohen dispozitat e kësaj shtojce.

Procedura e verifikimit e përcaktuar në shtojcën VIII aplikohet dhe për makinat larëse shtëpiake me shumë kazanë dhe makinat larëse-tharëse shtëpiake me shumë kazanë si tërësi, me tolerancat e verifikimit që i përkasin secilit parametër të përcaktuar për zbatimin e kësaj shtojce.

ANEKSI NR. 2

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË PAJISJEVE TË NGROHJES LOKALE "[1]

I. QËLLIMI

1. Kjo rregullore përcakton një kornizë për dhënien e informacionit mbi parametrat e pajisjeve të ngrohjes lokale nëpërmjet etiketimit energjetik duke mundësuar që përdoruesit fundorë të bëjnë zgjedhje të informuara gjatë blerjes së pajisjeve të ngrohjes lokale, me qëllim të:
   a) Reduktimit të konsumit të energjisë;
   b) Mbrojtjes së mjedisit;
   c) Ndërgjegjësimit të konsumatorëve;
   ç) Nxitjes së inovacionit;

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore do të zbatohet për të gjitha pajisjet e ngrohjes lokale me kapacitet prodhimi të nxehtësisë deri në 50 kW, duke nxitur përdorimin e pajisjeve më efiçente dhe miqësore me mjedisin.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
   a) Pajisjet e ngrohjes lokale që përdorin energjinë elektrike;
   b) Pajisjet e ngrohjes lokale që përdorin cikël komprimimi dhe cikël absorbimi;
   c) Pajisjet e ngrohjes lokale që përdorin lëndë djegëse të ngurta;
   ç) Pajisjet e ngrohjes lokale që përdoren për qëllime të tjera, përveç ngrohjes së hapësirave të brendshme;
   d) Pajisjet e ngrohjes lokale që përdoren për ambientet e jashtme;
   dh) Pajisjet e ngrohjes lokale në të cilat prodhimi i drejtpërdrejtë i nxehtësisë përbën më pak se 6% të prodhimit total të nxehtësisë maksimale (duke përfshirë prodhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë);
   e) Pajisjet e ngrohjes lokale që përdorin lëndë djegëse të ngurta dhe që nuk mund të instalohen në formën e tyre origjinale të prodhimit;
   ë) Pajisjet e ngrohjes lokale me rezistencë elektrike dhe me tubacione;
   f) Produktet e ngrohjes së ajrit;
   g) Saunat.

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2015/1186 e Komisionit, datë 24 prill 2015, për plotësimin e Direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të pajisjeve të ngrohjes lokale". Numri CELEX 02015R1186, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 21.07.2015, f. 20

III. PËRKUFIZIMET

Për qëllim të kësaj rregullore, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Biomasë"** është fraksioni i biodegradueshëm i produkteve, mbetjeve dhe mbetjeve me natyrë bilogjike nga bujqësia (duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore), pylltarisë dhe industrive të lidhura me to, gjithashtu peshkimin dhe akuakulturën, si dhe fraksionet e biodegradueshme të mbetjeve industriale dhe komunale;
2. **"Biomase e drunjtë"** është biomasa me origjinë nga pemët, shkurret dhe gëmushat duke përfshirë drurët, ashklat e drurit, drurin e kompresuar në formë peletesh, drurët e kompresuar në formë briket dhe sanduiç;
3. **"Biomasa jo e drunjtë"** i referohet çdo lloji biomase përveç asaj drunjore, përfshirë, ndër të tjera, kashtën, barërat e egra, kallamat, kokrrat, drithërat, ullinjtë, pastën nga ullinjtë dhe guackat e arrave;
4. **"Biomasë tjetër druri"** është biomasa e drunjtë përveç blloqeve të drurit me përmbajtje lagështie më pak se 25%, plehut me përmbajtje lagështie nën 14%, ose drurëve të kompresuar me përmbajtje lagështie nën 12%. Kjo përfshin materiale të tjera drusore dhe mbetje të drurit që mund të përdoren si burim energjie ose material për prodhim energjie, si degë, shkurre, dhe mbetje të tjera drusore të papërpunuara;
5. **"E destinuar për përdorim të jashtëm"** tregon që produkti është i përshtatshëm dhe i sigurt për t'u përdorur jashtë hapësirave të brendshme, duke përfshirë përdorimin në ambiente të jashtme, të tilla si hapësira të ekspozuara ndaj kushteve të motit, si dielli, shiu, etj;
6. **"Funksioni i ngrohjes indirekte"** është aftësia që produkti të transferojë një pjesë të prodhimit total të nxehtësisë në një fluid transmetues nxehtësie, për përdorime si ngrohja e ambienteve ose prodhimi i ujit të ngrohtë për përdorime shtëpiake;
7. **"Gjendja e gatishmërisë"** është gjëndja ku pajisja është e lidhur me burimin kryesor të energjisë dhe është në pritje për të funksionuar sipas qëllimit të saj të përcaktuar. Ajo ka mundësinë të sigurojë vetëm funksionet e mëposhtme, të cilat mund të vazhdojnë për një periudhë të pacaktuar kohore: Funksioni i riaktivizimit: Pajisja mund të riaktivizohet dhe të fillojë të funksionojë pas një komande ose sinjali; Funksioni i riaktivizimit me tregues: Pajisja mund të shfaqë një tregues vizual ose sinjal që tregon se është e gatshme për t'u riaktivizuar;
8. **"Identifikuesi i modelit"** është një kod, zakonisht alfanumerik, që përdoret për të dalluar një model specifik të një pajisjeje ngrohëse nga modelet e tjera të së njëjtës markë, emër furnizuesi dhe tregtari;
9. **"I pajisur me termostat mekanik për kontrollin e temperaturës"** është që produkti është i pajisur me një sistem jo-elektronik, i cili i mundëson atij të ndryshojë automatikisht prodhimin e nxehtësisë në një periudhë të caktuar kohe, në përputhje me një nivel të caktuar temperature;

10. **"I pajisur me kontroll elektronik të temperaturës"** është që produkti është i pajisur me një sistem elektronik, i cili mund të jetë i integruar ose i jashtëm, dhe që lejon rregullimin automatik të prodhimit të nxehtësisë në përputhje me një temperaturë të caktuar gjatë një periudhe specifike kohore.
11. **"I pajisur me kontroll elektronik të temperaturës dhe kohëmatës ditor"** është që produkti është i pajisur me një sistem elektronik, i cili mundëson ndryshimin automatik të prodhimit të nxehtësisë për një periudhë të caktuar kohe, në përputhje me një nivel të caktuar temperature të mjedisit të brendshëm, brenda një intervali 24-orësh;
12. **"I pajisur me kontroll elektronik të temperaturës dhe kohëmatës javor"** është që produkti është i pajisur një sistem elektronik të integruar ose të jashtëm, i cili lejon që prodhimi i nxehtësisë të rregullohet automatikisht në varësi të temperaturës së brendshme të mjedisit, gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ky rregullim bëhet në një interval 7-ditor, duke mundësuar optimizimin e konsumit të energjisë dhe ruajtjen e një temperature konstante brenda hapësirës;
13. **"Kërkesa për energji elektrike në prodhimin maksimal të nxehtësisë (el_{max})"** është konsumi i energjisë elektrike nga një pajisje të ngrohjes lokale për të siguruar prodhimin e nxehtësisë në nivelin e tij nominal, pra kur funksionon në kapacitetin e plotë të kërkuar për ngrohje. Konsumi i energjisë elektrike përcaktohet pa marrë në konsideratë energjinë e konsumuar nga qarku elektrik nëse produkti ofron funksionalitete indirekte ngrohëse dhe përfshin gjithashtu një qark elektrik të integruar, i shprehur në kW;
14. **"Kërkesa për energji elektrike në prodhimin minimal të nxehtësisë (el_{min})"** është konsumi i energjisë elektrike të një pajisje të ngrohjes lokale për të siguruar prodhimin e minimumit të kërkuar të nxehtësisë. Konsumi i energjisë elektrike përcaktohet pa marrë parasysh konsumimin e energjisë nga ndonjë komponent tjetër të pajisjes, si për shembull, një qark elektrik që mund të ofrojë funksionalitet të tërthortë ngrohjeje, i shprehur në kW.
15. **"Kërkesa për energji elektrike në gjendje gatishmërie (el_{sb})"** tregon sasinë e energjisë elektrike që një pajisje, sistem ose produkt konsumon kur ndodhet në gjendje gatishmërie, kur është i ndezur dhe i gatshëm për të filluar punën, por ende nuk është në funksion aktiv. Ky konsum shprehet në kilovat (kW) dhe tregon energjinë e përdorur për të mbajtur pajisjen ose sistemin në gatishmëri për përdorim të ardhshëm;
16. **"Kërkesa e treguesit të ndezjes (p_{pilot})"** i referohet konsumit të lëndës djegëse në formë të gaztë, të lëngshme ose të ngurtë që përdoret për të siguruar një burim ndezjeje, i cili shërben për të filluar procesin e djegies dhe për të prodhuar nxehtësinë nominale ose të pjesshme, kur ndizet për më shumë se 5 minuta, para se të ndizet djegësi kryesor. Ky konsum shprehet në kW.
17. **"Koefiçienti i konvertimit" (CC)** është faktori që reflekton vlerësimin e rendimentit mesatar prej 40%. Vlera e koefiçientit të konvertimit është CC = 2.5 (do të thotë një

koeficient që pasqyron rendimentin mesatar të prodhimit prej 40% të gjeneratës së BE-së referuar Direktivës 2012/27/EU të Këshillit dhe Parlamentit Europian[2])

18. **"Lëndë djegëse e preferuar"** i referohet lëndës djegëse që rekomandohet të përdoret për pajisjet e ngrohjes lokale, sipas udhëzimeve dhe specifikimeve të furnizuesve të pajisjeve të ngrohjes lokale;
19. **"Lënda djegëse e ngurtë"** është një material që është në gjendje të ngurtë në kushte të zakonshme, përfshirë biomasën dhe lëndët djegëse fosile**;**
20. **"Lëndë djegëse fosile"** janë lëndët djegëse të ngurta, përveç lëndëve djegëse nga biomasa, duke përfshirë antracitet, qymyrin me avull të thatë, qymyri bituminoz, linjitin, ziftin me temperaturë të ulët, si dhe një përzierje të lëndëve djegëse fosile ose një përzierje të biomasës me lëndë djegëse fosile. Për qëllimet e këtij Vendimi, përfshihet gjithashtu plehu;
21. **"Lëndë djegëse të tjera të përshtatshme"** janë lëndët djegëse të ndryshme nga lënda djegëse e preferuar, të cilat mund të përdoren për pajisjet e ngrohjes lokale, sipas udhëzimeve të furnizuesve të pajisjeve. Kjo përfshin çdo lëndë djegëse të përmendur në manualet e udhëzimeve për instaluesit dhe përdoruesit përfundimtarë, duke përfshirë informacionet e disponueshme në faqet zyrtare të internetit dhe materialet promocionale teknike dhe reklamat;
22. **"Lëndë djegëse të tjera fosile"** janë lëndët fosile që nuk përfshijnë antracitin, qymyrin me avull të thatë, ziftin e fortë, ziftin me temperaturë të ulët, qymyrin bituminoz, linjitët, ose briketat dhe pastat e përziera me lëndë djegëse fosile;
23. **"Model ekuivalent"** është hedhja në treg e një modeli të njëjtë me të njëjtat parametra teknike.
24. **"Opsioni i kontrollit të temperaturës, me mbikëqyrje"** do të thotë që produkti është i pajisur me një pajisje elektronike, të integruar ose të jashtme, që automatikisht ul temperaturën deri në një nivel të caktuar, pa ndërhyrjen e përdoruesit;
25. **"Opsionin e kontrollit të temperaturës, i cili përfshin një sensor për dritaren e hapur**", do të thotë që produkti është i pajisur me një sistem elektronik, të integruar ose të jashtëm, që ul prodhimin e nxehtësisë kur dritarja ose dera është e hapur. Sensorët përdoren për të zbuluar hapjen e një dritareje ose dere dhe mund të instalohen brënda ose jashtë produktit, duke u integruar në strukturën e tij ose si një kombinim i të dyjave.
26. **"Opsioni i kontrollit në distancë"** është mundësia për të menaxhuar produktin përmes ndërveprimit në distancë, pa praninë fizike të përdoruesit jashtë ndërtesës ku është instaluar produkti.
27. **"Pajisje ngrohëse me djegie të hapur"** i referohet një pajisje ngrohëse që përdor lëndë djegëse në formë të gaztë, të lëngët ose të ngurtë, ku nxehtësia dhe gazet e djegies nuk shpërndahen jashtë hapësirës ku ndodhet pajisja. Kjo pajisje lidhet me një oxhak, vatër zjarri ose tubacion ventilimi, të cilët shërbejnë për largimin e produkteve të krijuara gjatë djegies;

[2] Direktiva 2012/27/EU e Parlamentit dhe Këshillit Europian e datës 25 Tetor 2012 për efiçencën e energjisë, ndryshuar me Direktivën 2009/125/EC dhe 2010/30/EU dhes shfuqizuar me Direktivat 2004/8/EC dhe 2006/32/EC (OJ L 315, 14.11.2012, p. 1).

28. **"Pajisje ngrohëse me djegie të mbyllur"** i referohet një pajisje ngrohëse lokale që përdor lëndë djegëse në formë të gaztë, të lëngët ose të ngurtë, ku procesi i djegies dhe gazret e krijuara gjatë tij janë të izoluara nga hapësira ku është vendosur pajisja. Kjo pajisje është e lidhur me një oxhak, vatër zjarri ose tubacion ventilimi, që shërben për largimin e produkteve të djegies jashtë mjedisit të brendshëm;
29. **"Pajisje ngrohëse me tubacione",** është një pajisje ngrohëse lokale që përdor lëndë djegëse në trajtë të gaztë ose të lëngshme, e cila është e pajisur me një djegës, që instalohet në pjesën ballore, e cila ngroh hapësirën përreth nëpërmjet rrezatimit infra të kuq me anë të tubacioneve.
30. **"Pajisje ngrohëse me oxhak"** janë ato pajisje ngrohëse lokale që përdorin lëndë djegëse në formë të gaztë, lëngët ose të ngurtë, të cilat lidhen me një oxhak pa qenë e nevojshme që pajisja dhe oxhaku të jenë të fiksuara. Kjo lloj pajisje lejon kalimin e produkteve të djegies pa u penguar nga shtrati i zjarrit, oxhaku ose tubacionet, duke siguruar një funksionim të pandërprerë dhe të sigurt;
31. **"Pajisje ngrohëse me rezistencë (me dritë)** janë ato pajisje ngrohëse lokale që përdorin lëndë djegëse në formë të gaztë ose të lëngët, i cili është i pajisur me një rezistencë të vendosur në pjesën ballore të tij. Kjo rezistencë ngrohet nga lënda djegëse dhe transmeton nxehtësinë përmes rrezatimit infra të kuq, duke ngrohur drejtpërdrejt mjedisin përreth. Emetimi i nxehtësisë realizohet kryesisht përmes rrezatimit infra të kuq, i cili buron nga produktet e djegies në hapësirën ku ndodhet pajisja;
32. **"Pajisje ngrohëse që përdorin lëndë djegëse të gazta"** janë ato pajisje ngrohëse lokale me djegie të hapur ose të mbyllur që përdor lëndë djegëse të gaztë për të prodhuar ngrohje;
33. **"Pajisje ngrohëse që përdorin lëndë djegëse të lëngshme"** janë ato pajisje ngrohëse lokale që funksionojnë duke djegur lëndë djegëse të lëngshme, si nafta, benzina ose vajra të tjera, për të prodhuar nxehtësi. Këto pajisje mund të përfshijnë djegien e hapur ose të mbyllur, në varësi të mënyrës se si ndodhin proçeset e djegies dhe menaxhimi i energjisë së prodhuar;
34. **"Pajisje ngrohëse që përdorin lëndë djegëse",** janë ato pajisje ngrohëse me djegie të hapur, pajisje ngrohëse me djegie të mbyllur ose sobë;
35. **"Pajisje ngrohëse që përdorin lëndë të ngurta"** është një pajisje ngrohëse që funksionon përmes djegies së lëndëve djegëse të ngurta, si druri, qymyri, peleti dhe materiale të tjera organike të ngurta. Këto pajisje mund të kenë djegie të hapur (si sobat tradicionale ose oxhakët) ose të mbyllur (si furrat moderne me djegie të kontrolluar), dhe përdoren për ngrohjen e hapësirave, shpesh duke ofruar një burim energjie efiçent dhe ekonomik për ambiente të ndryshme;
36. **"Pajisje ngrohëse që nuk përdorin lëndë djegëse"** është një pajisje ngrohëse që përdor burime energjie të tjera përveç lëndëve djegëse të gaztë, të lëngshëm ose të ngurtë, dhe që nuk emetojnë produkte djegieje në mjedisin ku janë instaluar. Ky përkufizim përjashton pajisjet ngrohëse me rezistencë (si ato me elemente ngrohës elektrikë), të cilat nuk përdorin lëndë djegëse dhe nuk shkaktojnë ndotje nga djegia;
37. **"Pajisjet e ngrohjes lokale"** janë pajisjet që lëshojnë nxehtësi përmes transferimit të drejtpërdrejtë të energjisë termike, ose përmes një kombinimi të këtij transferimi me

përdorimin e një fluidi, i cili mbart nxehtësinë dhe e shpërndan atë për të mbajtur një temperaturë të caktuar brenda një hapësire të mbyllur. Këto pajisje mund të integrohen edhe me burime të tjera nxehtësie që vijnë nga mjedise të jashtme. Pajisjet ngrohëse janë të pajisura me një ose më shumë gjeneratorë nxehtësie, të cilët konvertojnë energjinë elektrike ose djegien e lëndëve djegëse (gaz, lëndë djegëse të lëngshme ose të ngurta) në nxehtësi, përmes përdorimit të efektit Joule (ose djegies së lëndës djegëse përkatëse).

38. **Pajisje ngrohëse elektrike"** janë pajisjet ngrohëse që përdor efektin Joule për të gjeneruar nxehtësi;
39. **"Përmbajtja e lagështisë"** është sasia e ujit që ndodhet në një lëndë djegëse në lidhje me masën totale të saj. Ky tregues është i rëndësishëm për pajisjet e ngrohjes lokale, pasi sasia e ujit në lëndën djegëse ndikon në efiçencën e djegies.
40. **"Produkt për ngrohjen e ajrit"** është një produkt që ofron ngrohje për një pajisje ngrohjeje me bazë ajri dhe mund të jetë i pajisur me kanale ajri. Ky produkt është projektuar për t'u përdorur i fiksuar ose i siguruar në një vend specifik, ose i montuar në mur, dhe shpërndan ajrin nëpërmjet një pajisjeje për lëvizjen e ajrit, me qëllim arritjen dhe mirëmbajtjen e një niveli të caktuar të rehatisë termike për njerëzit brenda një hapësire të mbyllur ku ndodhet produkti;
41. **"Prodhimi i drejtpërdrejtë i nxehtësisë"** është procesi i prodhimit të nxehtësisë nga pajisja përmes rrezatimit dhe konveksionit të nxehtësisë, ashtu siç emetohet drejtpërdrejt nga pajisja në ajër, pa përdorur një medium të jashtëm për transmetimin e nxehtësisë. Ky proces është i shprehur në kW, dhe tregon sasinë e nxehtësisë që prodhohet nga pajisja në një periudhë të caktuar kohe;
42. **"Prodhimi i tërthortë i nxehtësisë"**tregon prodhimin e nxehtësisë nga një pajisje, përmes përdorimit të një fluidi transmetues të nxehtësisë, i cili kalon nëpër një proces që siguron prodhimin e drejtpërdrejtë të nxehtësisë për produktin. Ky proces ndodh si një efekt anësor, dhe nxehtësia e prodhuar në këtë mënyrë matet në kilovat (kW);
43. **"Prodhimi maksimal i nxehtësisë (Pmax)"** tregon prodhimit të nxehtësisë nga një pajisje ngrohëse lokale, që përfshin si prodhimin e drejtpërdrejtë të nxehtësisë ashtu edhe prodhimin e tërthortë të nxehtësisë (kur është e aplikueshme), kur pajisja funksionon në kapacitetin e saj maksimal të prodhimit të nxehtësisë, siç është përcaktuar nga prodhuesi, e shprehur në kW;
44. **"Prodhimi minimal i nxehtësisë (Pmin)"** tregon sasinë e nxehtësisë që prodhon një pajisje ngrohëse lokale, përfshirë si prodhimin e nxehtësisë së drejtpërdrejtë, ashtu edhe prodhimin e nxehtësisë së tërthortë (kur është e aplikueshme), kur operon duke realizuar nivelin minimal të prodhimit të nxehtësisë, siç është përcaktuar nga prodhuesi, e shprehur në kW;
45. **"Prodhimi i nxehtësisë në një fazë të vetme, pa kontroll të temperaturës"** është që produkti nuk është i aftë të rregullojë automatikisht prodhimin e tij të nxehtësisë dhe se nuk ka asnjë mekanizëm të brendshëm për monitorimin apo përshtatjen e temperaturës përmes një sistemi feedback;
46. **"Prodhimi i nxehtësisë me dy ose më shumë faza manuale, pa kontroll të temperaturës"** është që produkti ka aftësinë të ndryshojë manualisht nivelin e

prodhimit të nxehtësisë në dy ose më shumë faza. Ai nuk është i pajisur me një sistem automatik që rregullon prodhimin e nxehtësisë në bazë të një temperature të caktuar të ambientit;

47. **"Rendimenti i dobishëm në prodhimin nominal ose minimal të nxehtësisë (ηth, nom ose ηth, min)** është raporti ndërmjet energjisë së dobishme të nxehtësisë të prodhuar dhe energjisë totale të hyrjes, e shprehur në terma të NCV (vlera kalorifike neto), të një sistemi ngrohës, dhe është shprehur në përqindje (%);
48. **"Sauna"** është një pajisje ngrohëse e cila është e inkorporuar në një vend të caktuar për tu përdorur si sauna për të krijuar mjedise të thata, të lagështa ose mjedise të ngjashme me to;
49. **"Sobë"** është një pajisje ngrohëse që përdor lëndë djegëse të ngurta, i cili kryen dy funksione njëkohësisht: atë të ngrohësit dhe të furrës për gatim. Ajo është e lidhur me një oxhak, vatër zjarri, ose një sistem ventilimi që mundëson largimin e produkteve të djegies, si tymi dhe gazrat, nga ambienti ku ndodhet soba;
50. **"Vlera kalorifike neto (NCV)"** është sasia e energjisë që çlirohet kur një material digjet plotësisht me oksigjen dhe produktet e djegies (përfshirë avullin e ujit) nuk rikthehen në temperaturën e ambientit. Ky është procesi që ndodh kur uji që krijohet gjatë djegies mbetet në formën e avullit dhe nuk kondensohet për t'u kthyer në ujë. Në këtë rast, energjia që humbet gjatë kondensimit të avullit nuk merret parasysh, pasi nuk mund të shfrytëzohet për qëllime ngrohjeje.

IV. DETYRIMET E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit që tregtojnë pajisje ngrohëse lokale pa tubacione, ose pajisje ngrohëse me oxhak që nuk përdorin lëndë djegëse të ngurta, duhet të sigurojnë që:

a. Këto pajisje ngrohëse duhet të jenë të pajisura me një etiketë të shtypur që përmban informacionin e përcaktuar në Pikën 1 të Shtojcës II, në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë që përcaktohen në Shtojcën I.
b. Këto pajisje ngrohëse duhet të jenë të pajisura me një etiketë në format elektronik që përmban informacionet e përcaktuara në Pikën 1 të Shtojcës II, në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë të përcaktuara në Shtojcën I;
c. Të ofrohet skeda informative e produktit, në përputhje me Shtojcën III, për pajisjet ngrohëse lokale.
ç. Një skedë produkti elektronike, në përputhje me Shtojcën III, të vihet në dispozicion të tregtarëve për modelin përkatës të pajisjes ngrohëse lokale;
d. Dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në Shtojcën IV, të vihet në dispozicion me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut.
dh. Çdo reklamë e lidhur me një pajisje të ngrohjes lokale, që përmban informacione mbi energjinë ose çmimet, do të përfshijë gjithashtu një referencë për klasën e efiçencës së energjisë për atë model;
e. Çdo material promocional teknik në lidhje me një pajisje ngrohëse lokale dhe përshkrimi i parametrave teknikë të saj do të përfshijë një referencë për klasën e efiçencës së energjisë për atë model.

2. Furnizuesit që hedhin në treg ose vënë në shërbim pajisje ngrohëse lokale pa tubacione, ose pajisje ngrohëse me oxhak që përdorin lëndë djegëse të ngurta duhet të sigurojnë që:

a. Këto pajisje ngrohëse duhet të jenë të pajisura me një etiketë të shtypur që përmban informacionin e përcaktuar në Pikën 1 të Shtojcës II, në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë që përcaktohen në Shtojcën I.

b. Këto pajisje ngrohëse lokale duhet të jenë të pajisura me një etiketë në format elektronik që përmban informacionet e përcaktuara në Pikën 1 të Shtojcës II, në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë të përcaktuara në Shtojcën I;

c. Të ofrohet skeda e produktit, në përputhje me Shtojcën III, për pajisjet ngrohëse lokale.

ç. Të vihet në dispozicion të furnizuesve një etiketë informuese për produktet elektronike, në përputhje me Shtojcën III;

d. Secila pajisje ngrohëse duhet të ketë dokumentacionin teknik, siç është përcaktuar në Shtojcën IV;

dh. Çdo reklamë e lidhur me një pajisje të caktuar ngrohësish, që përmban informacione mbi energjinë ose çmimet, do të përfshijë gjithashtu një referencë për klasën e efiçencës së energjisë për atë model;

e. Çdo material promocional teknik në lidhje me një pajisje ngrohëse specifike dhe përshkrimi i parametrave teknikë të saj do të përfshijë një referencë për klasën e efiçencës së energjisë për atë model.

3. Deri në gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore, furnizuesit që prodhojnë produkte me ndikim në energji sipas kësaj rregullore, në Republikën e Shqipërisë duhet të plotesojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën IV dhe ta shfaqin në faqen e tyre të internetit përpara se të hedhin në treg çdo produkt të prodhuar pas këtij afati.

4. Për furnizuesit që prodhojnë produkte me ndikim në energji sipas kësaj rregullore në Republikën e Shqipërisë dhe eksportojnë produktet e prodhuara në Bashkimin Evropian, duhet të plotësojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën IV në bazën e të dhënave evropiane të produkteve përpara se të hedhin në treg çdo produkt të prodhuar pas këtij afati

V. DETYRIMET E TREGTARËVE

1. Tregtarët duhet të sigurojnë që:

a. Çdo pajisje ngrohëse në pikën e shitjes duhet të ketë etiketën e siguruar nga prodhuesi, në përputhje me Kreun II, në pjesën e jashtme ballore, në mënyrë që të jetë qartësisht i dukshëm;

b. Çdo pajisje ngrohëse që nxirret në shitje, ofrohet me qera, ose blihet me këste, ku përdoruesi fundor nuk mund ta shohë produktin fizikisht, duhet të ketë informacionin e siguruar nga furnizuesi, në përputhje me Shtojcën V, përveç në rastet kur oferta është bërë përmes internetit, ku në çdo rast duhet të aplikohen dispozitat e Shtojcës VI;

c. Çdo reklamë për një model të caktuar pajisjeje ngrohëse, e cila përmban informacione lidhur me energjinë ose çmimet, duhet të përfshijë një referencë për klasën e efiçencës së energjisë për atë model;

ç. Çdo material promocional teknik në lidhje me një model të caktuar pajisjeje ngrohëse, në të cilin përshkruhen parametrat e tij teknikë specifikë, duhet të përfshijë një referencë për klasën e efiçencës së energjisë për atë model.

VI. METODAT E TESTIMIT, MATJES DHE PROÇEDURAT E VERIFIKIMIT

Informacioni që jepet në përputhje me krerët IV dhe V merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes, të përcaktuara në shtojcën VII.

VII. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I

Klasat e efiçencës së energjisë

Klasa e efiçencës së energjisë për pajisjet ngrohëse lokale duhet të përcaktohet në bazë të indeksit të efiçencës së energjisë, siç përcaktohet në Tabelën 1.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë për pajisjet e ngrohjes lokale

Klasa e efiçencës së energjisë	Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI)
A++	$EEI \geq 130$
A+	$107 \leq EEI \leq 130$
A	$88 \leq EEI \leq 107$
B	$82 \leq EEI \leq 88$
C	$77 \leq EEI \leq 82$
D	$72 \leq EEI \leq 77$
E	$62 \leq EEI \leq 72$
F	$42 \leq EEI \leq 62$
G	$EEI < 42$

Indeksi i efiçencës së energjisë për një pajisje ngrohëse duhet të llogaritet në përputhje me Shtojcën VIII.

SHTOJCA II
Etiketa

1. Pajisjet e ngrohjes lokale



I, II
III
IV, V
VI, VII

a) Informacioni në etiketë duhet të përfshijë:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;
II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;
III. Klasën e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me Shtojcën I; koka e shigjetës, që përmban klasën e efiçencës së energjisë, duhet të vendoset në të njëjtën lartësi si titulli i klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;
IV. Simboli për nxehtësinë dalëse;
V. Prodhimi i drejtpërdrejtë i nxehtësisë, i shprehur në kW, i përafruar në vlerën më të afërt;
VI. Për pajisjet ngrohëse që transferojnë nxehtësinë në një fluid, simbolin e prodhimit te nxehtësisë indirekte;
VII. Për pajisjet ngrohëse lokale që transferojnë nxehtësinë në një fluid, nxehtësia indirekte dalëse shprehet në kW, e përafruar me vlerën më të afërt.

VIII. Numri i këtij vendimi.

b) Aspekte të projektimit të etiketës për pajisjet ngrohëse duhet të jetë në përputhje me pikën 2 të kësaj Shtojce.

2. FORMATI I ETIKETES PER PAJISJET E NGROHJES LOKALE

Formati i etiketës do të jetë si në figurën më poshtë:



Në të cilën:

a) Etiketa duhet të jetë të paktën 105 mm e gjerë dhe 200 mm e gjatë. Kur etiketa është e shtypur në një format më të madh përmbajtja e saj duhet të jetë në proporcionale me specifikimet e mësipërme;

b) Sfondi duhet të jetë i bardhë;

c) Ngjyrat janë të koduara si CMYK – e kaltër e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull 00-70-X-00: 0 % e kaltër, 70 % e kuqe e purpurt, 100 % verdhë, 0 % e zezë;

d) Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës më sipër):

1. **Kufiri i Standarteve të BE-së:** 4 pt, ngjyra: e kaltër 100%, me kënde: 3,5 mm
2. **Logo e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00;
3. **Etiketa e Energjisë**: Ngjyra: X-00-00-00. Simbol Grafik siç përshkruhet: Logo e BE-së + etiketa e energjisë, me gjerësi: 86 mm, lartësia: 17 mm.
4. **Kufiri i Nën-Logove:** 1 pt, Ngjyra: e kaltër 100%, gjatësia: 86 mm
5. **Shkalla e klasave të energjisë:**

- **Shigjeta:** lartësia: 6 mm, hapësira 1,3 mm, ngjyrat:
  Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  Klasa e pestë: 00-00-X-00,
  Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  Klasa e shtatë: 00-X-X-00,
  Klasa e tetë: 00-X-X-00,
  Klasa e fundit: 00-X-X-00.
- **Teksti:** Calibri bold 14 pt, capital bardhë, '+' simbole: mbishkrim, të rradhitura në një rresht të vetëm.

6. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
   - **Shigjeta:** Gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% e zezë.
   - **Teksti:** Calibri bold 24 pt, capitale, bardhë, '+' simbolet: mbishkrim, të rradhitura në një rresht të vetëm.
7. **Funksionaliteti i nxehtësisë së drejtpërdrejtë:**

   - **Piktogram:** siç përshkruhet
   - **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, me kënde: 3,5 mm.

8. **Funksionaliteti i nxehtësië së tërthortë, nëse është i zbatueshëm:**

   - **Piktogram:** siç përshkruhet
   - **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, me kënde: 3,5 mm.

9. **Prodhimi drejtpërdrejtë i nxehtësisë nominale:**

   - **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, me kënde: 3,5 mm.
   - **Vlera** XY, Z: Calibri bold 34 pt, 100 % e zezë,
   - **Teksti kW**': Calibri e rregullt 18 pt, 100 % e zezë.

10. Prodhimi drejtpërdrejtë i nxehtësisë nominale, nëse është i zbatueshëm:

- **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, kënde ovale: 3,5 mm.
- **Vlera X,Y, Z**: Calibri bold 34 pt, 100 % e zezë,
- **Teksti kW**: Calibri e rregullt 18 pt, 100 % e zezë.

11. Energjia:

- **Tekst:** Calibri e rregullt 18 pt, 100 % e zezë.

12. Viti i futjes së etiketës dhe numri i Vendimit:

- **Tekst:** Calibri bold 10 pt.

13. Emri i prodhuesit ose emri tregtar:

14. Modeli identifikues i prodhuesit:

- Emri i prodhuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit duhet të përshtaten në një hapësirë prej 86 × 12 mm.

Furnitorët të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregullore, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE-së (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal dhe të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian . Për këto produkte me ndikim në energji furnitorët duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës IV.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III

Skeda e informative e produktit

1. Informacioni i dhënë në skedën informative të produktit do të përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër të dhënë me pajisjet ngrohëse lokale dhe duhet të përfshijë sa vijon:

(a) emrin e furnizuesit ose markën tregtare;
(b) identifikimi i modelit të furnizuesit;
(c) klasën e efiçencës së energjisë së modelit, të përcaktuar në përputhje me Pikën 1 të Shtojcës I;
(d) prodhimin e drejtpërdrejtë të nxehtësisë në kW, e përafruar me vlerën më të afërt;
(e) prodhimi e tërthortë të nxehtësisë në kW, e përafruar me vlerën më të afërt;
(f) indeksi i efiçensës së energjisë, e përafruar me të panjohurën më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me Shtojcën VII;
(g) rendimenti i dobishëm, në prodhimin nominal të nxehtësisë, dhe në ngarkesë minimale, nëse është e zbatueshme, i përafruar me vlerën më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me Shtojcën VII;
(h) çdo masë paraprake specifike që duhet të merret kur pajisja ngrohëse është montuar, instaluar ose mirëmbajtur.

2. Skeda informative për një numër të caktuar modelesh të pajisjeve ngrohëse të furnizuara nga i njëjti furnitor.

3. Informacioni i dhënë në skedën informative mund të jepet në formën e një kopjeje të etiketave, me ngjyrë të zezë ose të bardhë. Aty ku është e nevojshme, informacioni i listuar në pikën 1 që nuk është shfaqur tashmë, do të sigurohet në etiketë.

SHTOJCA IV
Dokumentacioni teknik

Për pajisjet ngrohëse lokale dokumentacioni teknik i përmendur në Kreun IV (1)(d) dhe Kreun IV (2)(d) duhet të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e furnitorit;
(b) identifikuesin e modelit;
(c) referencat e harmonizuara të standarteve, kur është e përshtatshme;
(ç) kur lënda djegëse e preferuar është biomasa e drunjtë, biomasa jo e drunjtë, lëndë djegëse të tjera fosile ose përzierje të tjera të biomasës dhe lëndëve fosile, siç përmendet në Tabelën 2, duhet të jepet një përshkrim i lëndës djegëse mjaftueshëm për identifikimin e sigurtë të saj dhe standardet teknike ose specifikimet e lëndës djegëse, duke përfshirë përmbajtjen e lagështisë, matjen e përmbajtjes së hirit, dhe për lëndët djegëse fosile të tjera, si dhe përmbajtjen e lëndëve djegëse në trajtë të gaztë
(d) standartet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, kur është e përshtatshme;
(dh) Identifikimi dhe nënshkrimi i personit të autorizuar për të lidhur marrëveshje me furnizorin;
(e) Informacionin e përfshirë në Tabelën 2 (për pajisjet ngrohëse që përdorin lëndë djegëse të ngurtë) dhe në Tabelën 3 (për pajisjet ngrohëse që përdorin lëndë djegëse në formë gazore/lëngët), të matura dhe të llogaritura në përputhje me Shtojcën VII;
(ë) Raportet e testeve të kryera nga furnizuesit në emër të tyre, duke përfshirë emrin dhe adresën e grupit të punës që realizoi testet
(f) çdo masë paraprake specifike që duhet të merret kur pajisja ngrohëse është montuar, instaluar ose mirëmbajtur;
(g) një listë e modeleve ekuivalente, nëse është e përshtatshme.

Ky informacion mund të integrohet në dokumetacionin teknik të dhënë në përputhje me masat sipas në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji [3]

Tabela 2

Parametrat teknikë për pajisjet ngrohëse lokale që përdorin lëndë djegëse të ngurta

Identifikuesit e modelit		
Funksionaliteti i ngrohjes indirekte:[po/jo]		
Prodhimi direkt i nxehtësisë: …(kW)		
Prodhimi indirekt i nxehtësisë: …(kW)		
Lënda djegëse	Lënda djegëse e preferuar (vetëm një)	Lëndë djegëse të tjera të përshtatshme
Druri me përmbajtje lagështie ≤ 25 %	[po/jo]	[po/jo]

[3] LIGJI Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji"

Druri i kompresuar me përmbajtje lagështie ≤ 12 %	[po/jo]	[po/jo]
Biomasë tjetër e drunjtë	[po/jo]	[po/jo]
Biomasë jo – drunjtë	[po/jo]	[po/jo]
Antracitet dhe qymyri i thatë	[po/jo]	[po/jo]
Zifti i ngurtë	[po/jo]	[po/jo]
Zifti me temperaturë të ulët	[po/jo]	[po/jo]
Qymyri Bituminoz	[po/jo]	[po/jo]
Briketë Linjitesh	[po/jo]	[po/jo]
Briketë plehu	[po/jo]	[po/jo]
Briketë me përzierje lëndësh fosile	[po/jo]	[po/jo]
Lëndë të tjera fosile	[po/jo]	[po/jo]
Biomasë e përzier dhe brikete me lëndë fosile	[po/jo]	[po/jo]
Përzierje të tjera të biomasës dhe lëndëve djegëse të ngurta	[po/jo]	[po/jo]

Karakteristikat kur përdoret lënda djegëse e preferuar

Rendimenti sezonal i energjisë në ngrohjen e lokale η s [%]:

Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI)

Lënda	Simboli	Vlera	Njësia		Lënda	Simboli	Vlera	Njësia
Prodhimi i nxehtësisë					Rendimenti i dobishëm (NCV siç është marrë)			
Prodhimi maksimal i nxehtësisë	Pmax	x,x	kW		Rendimenti i dobishëm në prodhimin maksimal të nxehtësisë	ηth,max	x,x	%
Prodhim i nxehtësisë minimale (tregues)	Pmin	[x,x/N.A.]	kW		Rendimenti i dobishëm në	ηth,min	[x,x/N.A.]	%

					prodhimin minimal të nxehtësisë (tregues)			
Konsumi shtesë i energjisë elektrike					**Lloji i prodhimit të nxehtësisë/ kontrolli i temperaturës së dhomës (zgjidh një)**			
Prodhimi i nxehtësisë maksimale	elmax	x,xxx	kW		Prodhim i nxehtësisë në një fazë të vetme, pa kontroll të temperaturës	[po/jo]		
Prodhim i nxehtësisë minimale	elmin	x,xxx	kW		Dy ose më shumë faza manuale, pa kontroll të temperaturës	[po/jo]		
në modalitetin në gadishmëri	elsb	x,xxx	kW		Me termostat mekanik për kontroll të temperaturës	[po/jo]		
					Me kontrollin elektronik të temperaturës	[po/jo]		
					Me kontrollin elektronik të temperaturës plus kohëmatësin ditor	[po/jo]		
					Me kontrollin elektronik të temperaturës plus kohëmatësin javor	[po/jo]		
					Opsione të tjera kontrolli (mundësi			

					përzgjedhje të shumëfishta)	
					Kontroll i temperaturës, me mbikëqyrje	[po/jo]
					Kontroll i temperaturës, me zbulimin e një dritare të hapur	[po/jo]
					Me opsionin e kontrollit në distancë	[po/jo]
Kërkesa e treguesit së ndezjes						
Fuqia e flakës (nëse është e zbatueshme	Ppilot	[x,xxx/ N.A.]	kW			
Detajet e kontaktit	Emri dhe adresa e furnitorit					

Tabela 3

Parametrat teknikë për pajisjet ngrohëse me lëndë djegëse të gaztë/lëngët

Identifikuesi i modelit:								
Funksionaliteti i ngrohjes indirekte [po/jo]								
Prodhimi direkt i nxehtësisë (kW)								
Prodhimi indirekt i nxehtësisë (kW)								
Lënda djegëse								
Zgjidh llojin e lëndës djegëse			Gaz/ lëng		[specifiko]			
Lënda	Simboli	Vlera	Njësia		Lënda	Simboli	Vlera	Njësia
Prodhimi i nxehtësisë					**Rendimenti i dobishëm (NCV)**			
Prodhimi maksimal i nxehtësisë	P_{max}	x,x	kW		Efiçenca në prodhimin maksimal të nxehtësisë së dobishme	$\eta th,max$	x,x	**%**
Prodhimin minimal i	P_{min}	[x,x/N. A.]	kW		Efiçenca në prodhimin minimal	$\eta th,min$	[x,x/ N.A.]	**%**

nxehtësisë (tregues)					të nxehtësisë së dobishme (tregues)			
Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse					**Lloji i prodhimit të nxehtësisë/kontrolli i temperaturës (zgjidh një)**			
Në prodhimin e nxehtësisë maksimale	El_{max}	x,xxx	kW		Prodhimi i nxehtësisë në një fazë të vetme, pa kontroll temperature	[po/jo]		
Në prodhimin e nxehtësisë minimale	el_{min}	x,xxx	kW		Dy ose më shumë faza manuale, pa kontroll temperaturë	[po/jo]		
Në gjendje gadishmërie	el_{SB}	x,xxx	kW		Me thermostat mekanik për temperaturën	[po/jo]		
					Kontroll elektronik për temperaturën	[po/jo]		
					Me kontroll elektronik për temperaturën plus kohëmatësin ditor	[po/jo]		
					Me kontroll elektronik për temperaturën e plus kohëmatësin javor	[po/jo]		
					Opsione të tjera kontrolli (zgjidh disa opsione)			
					Kontroll i temperaturës me mbikëqyrje	[po/jo]		
					Kontroll i temperaturës me zbulimin e dritares së hapur	[po/jo]		
Kërkesa e treguesit të ndezjes					Me opsionin e kontrollit në distancë	[po/jo]		

Kërkesa e treguesit të ndezjes (nëse është e zbatueshme)	P_{pilot}	[x,xxx/ N.A.]	kW				
Detajet e kontaktit			Emri dhe adresa e furnitorit				

SHTOJCA V

Informacioni që sigurohet në rastet kur përdoruesit e fundit nuk mund të shikojnë shfaqjen e produktit, përveçse në internet

1. Informacioni i përmendur në Kreun IV (1)(b) do të jepet si më poshtë:
   a) Klasa e efiçencës së energjisë së modelit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I;
   b) Prodhimi direkt i nxehtësisë në kW i perafruar me vlerën më të afërt;
   c) Prodhimi indirekt i nxehtesisë në kW, i perafruar me vlerën më të afërt.

2. Madhësia dhe shkrimi më të cilën informacioni duhet të lejohet të shfaqet ose të printohet jepet në pikën 1.

SHTOJCA VI

Informacioni që duhet të sigurohet përmes internetit në rast shitjes, qerasë, ose blerjes me këste përmes internetit

1. Etiketa përkatëse e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me Kreun IV (1)(b) ose Kreun IV (2)(b) duhet të shfaqet në ekran në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia e etiketës duhet të jetë e tillë që të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme, dhe në përpjestim me madhësinë e specifikuar në pikën 2 të Shtojcës II. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një shfaqje të mbivendosur; në këtë rast, pamja që përdoret për të hyrë në etiketë duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 3 të kësaj Shtojce. Nëse përdoret shfaqja e mbivendosur, etiketa shfaqet me një klikim të mausit, mausit rrëshqitës ose me zgjerim të pamjes në ekranet e prekshëm."

2. Pamja e përdorur për mundësimin e etiketës në rastin e shfaqjes së mbivendosur duhet të jetë:
   a) Një shigjetë me ngjyrë që i korrespondon klasës së efiçencës së energjisë së produktit në etiketë;
   b) Të tregojë mbi shigjetën klasën e efiçencës së energjisë së produktit, me ngjyrë të bardhë, me madhësi ekuivalente me madhësinë e çmimit; dhe
   c) Të ketë një nga dy formatet e mëposhtme:



3. Në rastet e shfaqjes së mbivendosur, sekuenca e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:
   a) Pamja e referuar në pikën 3 të kësaj Shtojce shgaqet në ekran, në afërsi të çmimit të produktit;
   b) Pamja lidhet me etiketën;
   c) Etiketa shfaqet pas një klikim të mausit, mausit rrëshqitës ose zgjerimin e pamjes në ekranin me prekje;
   d) Etiketa shfaqet në faqen tjetër, në një skedë të re, faqe të re ose në ekran të ri;
   e) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen pajisjet standarte në prekjen për zmadhim);
   f) etiketa pushon së shfaquri me anë të një opsioni mbyllës apo mekanizmi tjetër standart për mbyllje.
   g) Teksti alternativ për grafikën që do të shfaqet me zhdukjen e etiketës, është klasa e efiçencës së energjisë së produktit në një madhësi shkrimi ekuivalente me atë të çmimit.

4. Skeda përkatëse informative e produktit, e vënë në dispozicion nga furnizuesit, në përputhje me Kreun IV (1)(ç) ose Kreun IV (2)(ç), duhet të shfaqet në ekran në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia e skedës informative duhet të jetë e tillë që

ajo të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Skeda informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur shfaqje të mbivendosur, në të cilën faqja që ka informacionin duhet të tregojë qartësisht 'fletën e produktit'. Nëse përdoret shfaqja e mbivendosur, skeda informative e produktit shfaqet pas një klikimi të mausit, mausit rrëshqitës, ose një klikimi të faqes me anë të ekraneve me prekje.

SHTOJCA VII
Matjet dhe llogaritjet

1. Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e kësaj rregullore, matjet dhe llogaritjet duhet të kryhen duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga pika 2 deri në pikën 4.

2. Kushtet e përgjithshme për matjet dhe llogaritjet
   a) Pajisjet ngrohëse lokale duhet të testohen për llojin e lëndës djegëse të preferuar në mënyrë që të përcaktohet indeksi i efiçencës së energjisë, prodhimi direkt dhe indirekt i nxehtësisë;
   b) Vlerat e deklaruara për prodhimin direkt dhe indirekt të nxehtësisë dhe indeksit të efiçenës të nxehtësisë duhet të përafrohet me vlerën më të afërt;

3. Kushtet e përgjithshme për indeksin e efiçencës dhe konsumit të energjisë të pajisjeve ngrohëse:
   a) Vlerat e rendimentit të dobishëm ηth,max, ηth,min dhe vlerat e prodhimit direkt dhe indirekt të nxehtësisë Pmax, Pmin maten kur janë të zbatueshme;
   b) Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI) duhet të llogaritet si rendimenti sezonal e energjisë për ngrohjen kur pajisja është e ndezur (ηS,on), dhe duhet të korrigjohet për pajisjet ngrohëse që përdorin biomasën si lëndë djegëse të preferuar, me një faktor që merr parasysh karakterin e rinovues të lëndës djegëse, si dhe të korrigjohet nga llogaritja e kontributeve për kontrollin e temperaturës, konsumin e elektricitetit ndihmës dhe konsumin e energjisë për ndezje.
   Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI) shprehet si një shifër ekuivalente me shifrën reale, e shprehur në përqindje.

4. Kushtet specifike për efiçencën sezonale të energjisë së ngrohjes lokale.
   a) Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI) i të gjithë pajisjeve ngrohëse lokale përkufizohet si:

$$EEI = (\eta S,on \cdot BLF) - 10\ \% + F(2) + F(3) - F(4) - F(5)$$

Ku:

- ηS,on është rendimenti sezonal e energjisë së ngrohjes lokale në gjendjen e ndezur, e shprehur në përqindje, e llogaritur siç përcaktohet në pikën 4(b);
- BFL është faktori i etiketës së biomasës, i cili është 1,45 për sistemet ngrohëse që përdorin biomasës dhe 1 për sistemet ngrohëse që përdorin lëndë djegëse fosile;
- F(2) është një faktor korrigjues që llogaritet për një kontribut pozitiv në indeksin e efiçencës së energjisë, për shkak të rregullimeve të kontributeve të kontrolleve

të nxehtësisë së brendshme, vlerat e tij janë reciprokisht ekskluzive, dhe nuk mund të shtohen mbi njëra-tjetrën, të shprehura në %;

- F(3) është një faktor korrigjues që llogaritet për një kontribut pozitiv në indeksin e efiçencës së energjisë, për shkak të rregullimeve të kontrolleve të nxehtësisë së brendshme, vlerat e tij mund të shtohen njëra mbi tjetrën, të shprehura në %;
- F(4) është një faktor korrigjues që llogaritet për një kontribut negativ në indeksin e efiçencës së energjisë, për shkak të konsumit të energjisë elektrike ndihmëse, të shprehura në %;
- F(5) është një faktor korrigjues që llogaritet për një kontribut negativ në indeksin e efiçencës së energjisë, për shkak të konsumit të energjisë elektrike ndihmëse të treguesit të ndezjes, të shprehura në %;

b) Rendimenti sezonal i energjisë së ngrohjes lokale nëgjendjen ndezur llogaritet si:

$$\eta S,on = \eta th,max$$

ku:

- ηth,nom është rendimenti i dobishëm në prodhimin maksimal të nxehtësisë bazuar në NCV.

c) Faktori korrigjues F(2), i cili llogaritet për një kontribut pozitiv në indeksin e efiçencës së energjisë për shkak të rregullimeve të kontributeve të kontrolleve të nxehtësisë së brendshme, ku vlerat janë reciprokisht ekskluzive ose nuk mund të shtohen njëra-tjetrës, llogaritet si më poshtë:
Për të gjithë ngrohësit e hapësirës, faktori korrigjues F(2) është i barabartë me një nga faktorët sipas **Tabelës 4**, në varësi të karakteristikës së kontrollit që aplikohet. Vetëm një vlerë mund të zgjidhet

Tabela 4

Faktori korrigjues F(2)

Nëse produkti është i pajisur me (vetëm një mundësi mund të aplikoni)	F(2)
	Pajisjet e ngrohjes lokale që përdorin lëndë djegëse
Prodhimi i nxehtësisë në një fazë të vetme, pa kontroll të temperaturës	0,0 %
Dy ose më shumë faza manuale, pa kontroll temperature	1,0 %
Me termostat mekanik për kontroll të temperaturës	2,0 %
Me kontroll elektronik të temperaturës	4,0 %
Me kontroll elektronik të temperaturës plus kohëmatësin ditor	6,0 %

Me kontroll elektronik të temperaturës plus kohëmatësin javor	7,0 %

Faktori korrigjues F(3) duhet të jetë zero për pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurta, ku kontrolli i temperaturës është vendosur në prodhimin minimal të nxehtësisë sipas legjislacionit ne fuqi. Prodhimi i nxehtësisë në këtë mjedis nuk duhet të jetë më i lartë se 50 % e prodhimit nominal të nxehtësisë.
Nëse F(2) nuk është zero, dokumentacioni teknik duhet të përfshijë informacion mbi emetimet gjatë prodhimit minimal të nxehtësisë.

d) Faktori korrigjues F(3) që llogaritet për një kontribut pozitiv në indeksin e efiçencës së energjisë për shkak të rregullimeve të kontributeve të kontrolleve të nxehtësisë së brendshme, vlerat e të cilit mund ti shtohen vlerave të tjera, llogaritet si më poshtë:

Për të gjithë pajisjet e ngrohjes lokale faktori korrigjues F(3) është shuma e vlerave sipas Tabelës 5, në varësi të karakteristikës së kontrollit që aplikohet.

Tabela 5

Faktori korrigjues F(3)

Nëse produkti është i pajisur me (mund të aplikohen opsione të shumta)	F(3)
	Pajisjet e ngrohjes lokale me lëndë djegëse
Kontrolli i temperaturës me mbikëqyrje	1,0 %
Kontrolli i temperaturës në rastin e dritareve të hapura	1,0 %
Me opsionin e kontrollit në distancë	1,0 %

Faktori korrigjues F(3) duhet të jetë zero për pajisjet ngrohëse lokale me lëndë djegëse të ngurta, ku kontrolli i temperaturës është vendosur në prodhimin minimal të nxehtësisë (më i lartë se ai i përcaktuar në Shtojcën II pika 2 të Rregullores (BE) 2015/1185)[4]. Prodhimi i nxehtësisë në këtë mjedis nuk duhet të jetë më i lartë se 50% e prodhimit nominal të nxehtësisë.
Nëse faktori korrigjues F(3) nuk është zero, dokumentacioni teknik duhet të përfshijë informacionin përkatës mbi emetimet gjatë prodhimit minimal të nxehtësisë. Faktori korrigjues F(4) i përdorimit së energjisë elektrike ndihmëse llogaritet si:
Ky faktor korrigjimi merr parasysh energjinë elektrike ndihmëse gjatë funksionimit në modalitetin e ndezur dhe modalitetin e gadishmërisë .

Për të gjithë pajisjet e ngrohjes lokale korrigjimi i konsumit të energjisë elektrike ndihmëse llogaritet si më poshtë:

$$F(4) = CC \ . \ \frac{0{,}2 \ . \ elmax + 0{,}8 \ . \ elmin + 1{,}3 \ . elsb}{Pmax} \cdot 100\ \%$$

Ku:

- el_{max} është konsumi i energjisë elektrike në prodhimin nominal të nxehtësisë, e shprehur në kW;

- el_{min} është konsumi i energjisë elektrike në prodhimin minimal të nxehtësisë, i shprehur në kW. Në rast se produkti nuk ofron minimum të prodhimit të nxehtësisë duhet të përdoret vlera për konsumin e energjisë elektrike në prodhimin nominal të nxehtësisë;

- el_{sb} është konsumi i energjisë elektrike të produktit ndërsa është në modalitetin e gadishmërisë, i shprehur në kW;

- P_{max} është prodhimi maksimal i nxehtësisë së produktit, i shprehur në kW.

e) Faktori korrigjues F(5) i lidhur me konsumin e energjisë për treguesin e ndezjes llogaritet si më poshtë:

Ky faktor korrigjimi merr parasysh fuqinë e kërkesës së treguesit të ndezjes.
Për të gjithë pajisjet e ngrohjes lokale faktori korrigjues llogaritet si:

$$F(5) = 0{,}5 \ . \ \frac{Ppilot}{Pmax} \cdot 100\ \%$$

Ku:

- P_{pilot} është konsumi i treguesit të ndezjes, i shprehur në kW;
- P_{max} është prodhimi maksimal i nxehtësisë së produktit, i shprehur në kW.

SHTOJCA VIII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Për qëllimet e vlerësimit të përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në Kreun 4 dhe 5, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të aplikojnë procedurën e mëposhtme të verifikimit:

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të testojnë njësi të vetme për çdo model. Njësia do të testohet me një karburant me karakteristika në të njëjtën gamë si karburanti që u përdor nga prodhuesi për të kryer matjet sipas Shtojces VII.
   Modeli do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e zbatueshme nëse:

a. vlerat dhe klasat në etiketë dhe në fletën e produktit përputhen me vlerat në dokumentacionin Teknik;
b. për ngrohësit lokalë me karburant të ngurtë, indeksi i efiçences energjetike (EEI) nuk është më pak se 8% më i ulët se vlera e deklaruar;
c. për ngrohësit lokalë me karburant të lëngshëm, EEI nuk është më pak se 8% më i ulët se vlera e deklaruar;
d. për ngrohësit lokalë me lende djegese te gazte, EEI nuk është më pak se 8% më i ulët se vlera e deklaruar

2. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(a) nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen të papajtueshëm me këtë Vendim. Nëse ndonjë nga rezultatet e përmendura në pikat nga 2(b) deri në 2(d) nuk arrihet, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të zgjedhin rastësisht tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësi shtesë të zgjedhura mund të jenë nga një ose më shumë modele ekuivalente që janë të listuara si produkte ekuivalente në dokumentacionin teknik të furnizuesit.
   Modeli do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e zbatueshme nëse:

a. vlerat dhe klasat e deklaruara në etiketë dhe në fletën e produktit për tre njësitë shtesë përputhen me vlerat në dokumentacionin teknik;
b. për ngrohësit lokalë me karburant të ngurtë, EEI mesatare e tre njësive shtesë nuk është më shumë se 8 % më e ulët se vlera e deklaruar;
c. për ngrohësit lokalë me karburant të lëngshëm, EEI mesatare e tre njësive shtesë nuk është më shumë se 8 % më e ulët se vlera e deklaruar;
d. për ngrohësit lokalë me karburant të gaztë, EEI mesatare e tre njësive shtesë nuk është më shumë se 8 % më e ulët se vlera e deklaruar

Nëse rezultatet e përmendura në pikën 2 nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen se nuk përputhen me këtë rregullore.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të sigurojnë rezultatet e testeve dhe informacionet e tjera të rëndësishme brenda një muaji nga marrja e vendimit për mos-përputhshmërinë e modelit.
Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të përdorin metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcen VII.

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojce lidhen vetëm me verifikimin e parametrave të matur dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik. Vlerat dhe klasat në etiketë ose në fletën e produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik.

ANEKSI NR. 3

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË EKRANEVE ELEKTRONIKE "[1]

I. QËLLIMI

1. Kjo rregullore vendos kërkesat e etiketimit, dhe sigurimin e informacionit shtesë të produkteve në ekranet elektronik, përfshirë televizorë, monitorë dhe ekrane digjitale.
2. Kjo rregullore nuk do të zbatohet në rastet:
(a) në ekrane elektronik me sipërfaqe më të vogël ose të barabartë me 100 centimetër katror;
(b) projektorët;
(c) sistemet e njësive të videokonferencave;
(ç) ekranet e mjekësisë;
(d) kufjet virtuale;
(dh) ekrane të integruar ose që integrohen në produktet e listuara:
(1) pajisje e cila është e nevojshme për mbrojtjen e interesave themelorë të sigurisë së Vendeve Anëtare, duke përfshirë armë, municione dhe materiale lufte që kanë synime ushtarake të specifikuara;
(2) pajisje dizenjuar për tu dërguar në hapësirë;
(3) mekanizmat e stacioneve industriale të dimensioneve masive;
(4) instalimet e dimensioneve massive të fiksuara, përjashtuar çdo pajisje e cila nuk është projektuar dhe instaluar specifikisht si pjesë e këtyre instalimeve.
(5) mjetet e transportit për njerëz apo mallra, me përjashtim të automjeteve elektrik me dy rrota tipet e të cilëve nuk janë aprovuar;
(6) makineri lëvizëse larg rrugës ekskluzivisht vetëm për përdorim profesional;
(7) pajisje specifikisht e dizenjuar vetëm për qëllime kërkimore dhe zhvilluese që aplikohet vetëm mbi bazat biznes me biznes;
(8) pajisjet mjekësore dhe pajisjet mjekësore diagnostikuese in vitro, kur këto pajisje pritet të jenë infektuar, dhe pajisjet mjekësore aktive të implantueshme;
(e) ekranet elektronike që janë komponentë ose pjesë përbërëse siç përcaktuar më poshtë: "Komponentë dhe elementë bashkimesh" nënkupton pjesë që kanë për qëllim tu bashkohen produkteve të cilët nuk gjenden në treg dhe/ose vendosen në përdorim si pjesë individuale për përdoruesit ose performanca mjedisore e të cilëve nuk mund të vlerësohet në mënyrë të pavarur;
(ë) ekranet e transmetimeve;
(f) ekranet e sigurisë;
(g) tabelat prezantuese digjitale interactive;
(gj) strukturat kufizuese (kornizat) të fotove digjitale.
(h)ekrane të sinjalistikës digjitale të cilët plotësojne një ose disa nga karakteristikat e mëposhtme:
(1) dizenjuar dhe ndërtuar si një modul tregues që do të integrohet si pjesë përbërëse e një ekrani tregues më të madh dhe nuk ka për qëllim të përdoret më vete;

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2013 e Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e Rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të ekraneve elektronike", dhe shfuqizimin e Rregullores Deleguese (BE) Nr. 1062/2010 të Komisionit. Numri CELEX 02019R2013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 05.12.2019, f. 1.

(2) shpërndarë si një e tërë në një zone të rrethuar për përdorim të përhershëm në ambient të jashtëm.
(3) shpërndarë si një e tërë në një zone të rrethuar me një sipërfaqe ekrani më të vogël se 30 dm^2 ose më i madh se 130 dm^2
(4) ekrani ka një densitet pixel më të vogël se 230 pixel/ cm^2 ose më të madh se 3 025 pixel/cm^2;
(5) një maksimum të ndriçimit të bardhë në kufirin dinamik standart (SDR – standard dynamic range) gjatë punës më të madh ose të barabartë me 1 000 cd/m^2.
(6) Pa ndërfaqe hyrjeje për sinjal video dhe pa drejtues ekrani që të mundësojë shfaqjen e saktë të një sekuence testimi video dinamike të standardizuar për qëllime matjeje të energjisë.

(i) ekranet e shfaqjes së statusit
(j) panelet e kontrollit

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1.	**"Disponueshmëria e rrjetit"** nënkupton aftësinë e një ekrani elektronik për të aktivizuar funksione pas një komandimi në distancë e dedektuar nga porta hyrëse e rrjetit;
2.	**"Ekran elektronik"** nënkupton një ekran tregues dhe elektronika shoqëruese që si funksion kryesor ka paraqitjen vizuale të informacionit të marrë nga burime fizikisht të lidhur ose jo;
3.	**"Ekran i sinjalistikës digjitale"** nënkupton një ekran elektronik i cili është projektuar kryesisht të dallohet nga disa persona në një mjedis publik. Karakteristikat e tij do të përfshijnë të gjitha veçoritë e mëposhtme: (a) identifikues unik për të lehtësuar dallueshmërinë e ekranit specifik. (b) një funksion për të eleminuar hyrjen e pa autorizuar në komandat e ekranit dhe në imazhin e shfaqur. (c) lidhje në rrjet (i realizuar fizikisht ose jo) për kontrollin, monitorimin ose marrjen e informacionit për ta transmetuar nga një ose disa burime të rrjetit por jo nga burime te tjera. (d) projektuar për tu montuar e varur, montuar ose fiksuar në një strukturë fizike për tu dalluar nga publiku dhe nuk mund të qëndrojë i vendosur mbi sipërfaqen e tokës. (e) nuk ka të instaluar një selektues kanalesh për shfaqur sinjale të transmetuara;
4.	**"Ekran mjekësor"** ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi pë pajisjet mjekësore;
5.	**"Ekran me taktil"** nënkupton një ekran që reagon ndaj prekjes, si kompjuter tablet ose telefoni inteligjent;
6.	**"Ekrani i rrjetit"** nënkupton një ekran elektronik që mund të lidhet me një rrjet duke përdorur njërën prej portave hyrëse të saj, nëse janë aktivizuar;
7.	**"EPS e standartizuar"** nënkupton një ushqyes energjie të jashtëm projektuar që të sigurojë energji në pajisje të ndryshme dhe që është në përputhje me një standart hartuar nga një autoritet standartizimi shqiptar ose ndërkombëtar;

8.	**"Funksioni i riaktivizimit"** nënkupton një funksion i cili nëpërmjet komandimit në distanë, një njesi kontrolli në distancë, një sensor i brendshëm, një kohëmatës ose, për ekranet në rrjet në gjendie pritje në rrjet, rrjeti, siguron një kalim nga gjendja në pritje ose gjendja e pritjes në rrjet në një gjendje, të ndryshme nga gjendaja e fikur, duke siguruar funksione shtesë;
9.	**"Garanci"** nënkupton çdo përgjegjësi të shitësit me pakicë apo furnizuesit ndaj konsumatorit për: (a) të kthyer paratë e paguara; ose (b) zëvendësojë, riparojë ose mirëmbajë ekranet elektronikë sipas çdo mënyre nëse nuk sigurohen karakteristikat e shprehura në garanci ose në reklamën përkatëse;
10.	**"Gjendje e fikur"** nënkupton kushtin në të cilën ekrani elektronik është lidhur me burimin e energjisë dhe nuk shfaq funksione: si më poshtë gjithashtu do të konsiderohen si gjendje e fikur: (1) konditat që sigurojnë vetëm një tregues të gjendies së fikur; (2) kondita që sigurojnë vetëm funksione që kanë për qëllim të sigurojnë pajtueshmërinë elektromagnetike në përputhje me Vendimin Nr. 552, datë 31.7.2019, "Për miratimin e rregullit teknik për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara";
11.	**"Gjendja në pritje"** nënkupton një konditë ku ekrani elektronik është lidhur me rrjetin ose burim energjie të rrymës vazhduar, varet nga kjo energji për të funksionuar dhe siguron vetëm funksionet e mëposhtme, të cilët mund të vazhdojnë për një kohë të pacaktuar: - funksioni i riaktivizimit, ose funksioni i riaktivizimit dhe vetëm një sinjalizues i funksionit të riaktivizimit të aktivizuar; dhe/ose - informacion ose paraqitja e statusit;
12.	**"Gjendja në pritje e rrjetit"** nënkupton një konditënë të cilën ekrani elektronik është i aftë të rifillojë një fuksion nëpërmjet një aktivizimi në distancë nga një portë hyrëse e rrjetit;
13.	**"HiNA"** nënkupton pajisje që kanë si funksion kryesor një ose më shumë nga funksionalitetet e mëposhtme, por asnjë tjetër: ruter, komutator rrjeti (network switch), pikë aksesi për rrjet pa tela (wireless access point), hub, modem, telefon VoIP, telefon me video
14.	**"Hyrja e rrjetit"** ose **"Porta e rrjetit"** nënkupton një portë fizike kabllore ose jo, që siguron lidhjen në rrjet, nëpërmjet të cilit funksionet e ekranit elektronik mund të aktivizohen në distancë si dhe shkëmbim të dhënash. Hyrje për futjen e të dhënave si sinjale audio dhe video, që nuk gjenerohen nga një burim në rrjet dhe që përdorin një adresë rrjeti, nuk konsiderohen si portë hyrëse të rrjetit;
15.	"i instaluar", i referohet një ekrani i cili është pjesë e një produkti tjetër si një komponent funksional, nënkupton ekranet elektronike të cilët nuk janë në gjendje të operojnë në mënyrë të pavarur nga produkti dhe që varet nga ky i fundit për të realizuar funksionet e tij, përfshirë dhe energjinë.
16.	**"Indeksi i efiçencës energjisë" (EEI)** nënkupton një numër indeksi për efiçencën e energjisë relative të një ekrani elektronik, siç paraqitet në pikën b të Shtojcës II;
17.	**"Kodi (QR) Përgjigje e Shpejtë"** nënkupton një barkod matricor i përfshirë në etiketën e energjisë të një produkti model që lidh këtë informacion të modelit me publikun nëpërmjet databazës së produktit;

18.	**"Konfigurimi i dyqanit"** nënkupton konfigurimin e ekranit elektronik që përdorim specifik në kontekstin e demostrimit të ekranit elektronik, për shembull në kushtet me ndriçim të lartë (shitja me pakicë) dhe që gjatë funksionimit nuk aplikohet fikja automatike nëse nuk konstatohet prezencë apo veprim i përdoruesit;
19.	**"Konfigurim normal"** nënkupton një menu funksionesh e cila është rekomanduar tek përdoruesi nga furnizuesi që nga konfigurimi fillestar apo konfigurimi i fabrikës që ekrani elektronik ka për të realizuar përdorimin e produktit. Produkti duhet të sigurojë cilësi optimale për përdoruesin në ambientin e parashikuar dhe për përdorimin e parashikuar. Konfigurimi normal është kushti në të cilën vlerat janë matur në gjëndjet fikur, pritje, pritje në rrjet dhe ndezur;
20.	**"Kontrolli i Shkëlqimit Automatik (ABC)"** nënkupton mekanizmin automatik i cili, kur është i aktivizuar, kontrollon shkëlqimin e një ekrani elektronik si një funksion i nivelit të ndriçimit të ambientit që ndriçon pjesën ballore të ekranit;
21.	**"Kornizë e fotove digjitale"** nënkupton një ekran elektronik që shfaq vetëm informacion viziv.
22.	**"Kufje të realitetit virtual"** nënkupton një pajisje që vendoset në kokë e cila siguron një realitet virtual tre-dimensional bazuar në imazhe stereoskopike për çdo sy së bashku me funksionet e gjurmimit të lëvizjes.
23.	**"Mekanizmi tregues"** nënkupton çdo ekran, duke përfshirë ekrane me prekje ose teknologji të tjera vizive përdorur për të shfaqur përmbajtjen e internetit tek përdoruesit;
24.	**"Menu e detyruar"** nënkupton një menu specifike, që shfaqet në ndezjen fillestare të ekranit elektronik ose në një rivendondosje konfigurimit të fabrikës, duke ofruar një paketë funksionesh të shfaqura, paracaktuar nga furnizuesi;
25.	**"Monitor"** ose "Monitor kompjuteri" ose "Ekran kompjuteri" nënkupton një ekran elektronik parashikuar për një person për shikim nga afër siç eshtë ambienti në një tavolinë pune.
26.	**"Monitor i klasës 1"** nënkupton një monitor profesional për vlerësim teknik të cilësisë së lartë të imazhit në pikat kyçe të rrjedhës së prodhimit ose transmetimit, si kapja e imazhit, post-produksioni, transmetimi dhe ruajtja.
27.	**"Ndriçimi"** nënkupton matjen fotometrike të intensitetit të ndriçimit për njesi të zonës së dritës që lëviz në një drejtim të caktuar, shprehur në njësi qirinjsh pë metër katror (cd/m2). Termi shkëlqim është përdorur shpesh për të përcaktuar "subjektivisht" ndriçimin e një ekrani elektronik;
28.	"ndriçimi në konfigurimin e gjendjes ndezur" nënkupton konfigurimin e ekranit elektronik, para-vendosur nga furnizuesi, që siguron një imazh të pranueshëm me ndriçimin maksimal të matur;
29.	**"Paneli i kontrollit"** nënkupton një ekran elektronik funksioni kryesor i të cilit është të shfaq imazhe të shoqëruara me statusin operacional të produktit; ajo mund të sigurojë ndërhyrjen e përdoruesit nëpërmjet prekjes ose mjeteve të tjera për të kontrolluar veprimtarinë e produktit. Ajo mund të jetë e instaluar brenda produktit ose specifikisht projektuar dhe tregtuar që të përdoret vetëm me produktin.

30.	**"Parazgjedhur"**, referohet në një karakteristikë të veçantë apo konfigurim, nënkupton vlerën e një karakteristike specifike siç është vendosur në fabrikë dhe e disponueshme kur blerësi përdor produktin për herë të parë dhe pas kryerjes së "rikonfigurim të funksioneve të fabrikës", nëse është lejuar nga produkti;
31.	**"Pika e shitjes"** nënkupton një vend ku ekranet elektronik janë ekspozuar ose ofruar për shitje, qira ose qira-blerje;
32.	**"Pixel (element imazhi)"** nënkupton zonën e elementit më të vogël në një imazh që mund të dallohet nga elementët e tij fqinj;
33.	**"Projektor"** nënkupton një pajisje optike që përpunon informacionin e imazheve të videove digjitale ose analoge, në çdo format, për të modifikuar një burim drite si dhe projektuar imazhin e përftuar në një sipërfaqe të jashtme.
34.	**"Raporti i kontrastit"** nënkupton ndryshimin ndërmjet shkëlqimit maksimal dhe nivelit të ngjyrës së zezë në një imazh;
35.	**"Rrjet"** nënkupton një infrastrukturë komunikimi me një topologji lidhjesh dhe një arkitekturë që përfshin komponentë fizik, principe organizative dhe proçedura komunikimi dhe formate (protokolle);
36.	**"Selektues frekuencash/marrës"** nënkupton një qark elektronik që dedekton sinjalin televiziv, si digjital tokësor ose satelitor, përjashtuar internetin, dhe lehtëson përzgjedhjen e një kanali TV nga një grup kanalesh të transmetuara.
37.	**"Sensori i prezencës në dhomë"** ose "sensori i dedektimit të gjesteve" ose "sensori i prezencës njerëzore" nënkupton një sensor që monitoron dhe reagon ndaj lëvizjeve në hapsirën përreth produktit sinjali i të cilit aktivizon ndezjen. Mungesa e dedektimit të lëvizjes për një kohë të paracaktuar shkakton kyçjen në statusin e pritjes ose statusin e pritjes në rrjet;
38.	**"Sistemi i video konferencës të-gjitha - në – një"** nënkupton një sistem i dedikuar projektuar për video konferencë dhe bashkëpunim, instaluar brenda një strukture të vetme kufizuese, karakteristikat e të cilit do të përfshijnë të gjitha veçoritë e mëposhtme: (a) suport për protokoll videokonferencë specifik ITU-T H.323 ose IETF SIP siguruar nga prodhuesi. (b) kamer/a, aftësitë përpunuese dhe shfaqëse për video dy-kalime kohë-reale përfshirë paketën e rikuperimit të humbjes. (c) altoparlant dhe aftësi përpunuese audio për audio me dy-kalime kohë-reale hands-free përfshirë eleminimin e ekos. (d) një funksion kodues.
39.	**"Statusi i ndezur"** ose "statusi aktiv" nënkupton një kusht në të cilin ekrani elektronik është i lidhur me një burim energjie, bëhet aktiv dhe siguron një ose më shumë nga funksionet e tij;
40.	**"Shfaqja e ngjitur (nested)"** është ndërfaqja vizuale ku një imazh ose një set të dhënash bëhet i aksesueshëm përmes një klikimi me maus, rrotullimi të mausit, ose zgjerimit të ekranit taktil të një imazhi tjetër ose seti tjetër të dhënash.

41.	**"Tabelë shkrimi ndërvepruese digjitale"** nënkupton një ekran elektronik që lejon ndërveprimin e drejtpërdrejtë të përdoruesit me imazhet e shfaqura. Tabela e shkrimit ndërvepruese digjitale është projektuar kryesisht për prezantime, mësimdhënie ose bashkëpunim në distancë, përfshirë transmetimin e sinjaleve audio dhe video. Karakteristikat e tij do të përfshijnë të gjitha veçoritë e mëposhtme: (a) kryesisht projektuar të instalohet duke u varur, montuar mbi një bazament, mbi një rraft ose tavolinë ose fiksuar në strukturë fizike për tu ndjekur nga disa persona. (b) domosdoshmërisht i përdorshëm me kompjuter me funksione specifike për të manaxhuar përmbajtjen dhe ndërveprimin. (c) integruar ose projektuar për tu përdorur specifikisht nga një kompjuter që operon programet në pikën (b). (d) një sipërfaqe ekrani më të madh se 40 dm2; (e) ndërhyrja e përdoruesit nëpërmjet gishtit ose penës prekëse ose mjete të tjera si dorë, lëvizje të krahëve ose zërit.
42.	**"Tekst alternativ"** nënkupton një tekst siguruar si një alternativë e një grafiku që lejon informacionin të paraqitet në formë jo-grafike ku pajisjet me ekran nuk mund të shfaqin grafikun ose si një ndihmë për akses në funksione si aplikacionet e zërit sintetik;
43.	**"Televizor"** nënkupton një ekran elektronik të projektuar kryesisht për shfaqjen dhe përthithjen e sinjaleve audioviziv dhe që konsiston në një ekran elektronik dhe një ose më shume frekuanca (turners/receivers).
44.	**"Treguesi i sigurisë"** nënkupton një ekran elektronik karakteristikat e të cilit do të përfshijnë të gjitha veçoritë e mëposhtme: (a) funksionin e monitorimit vetjak që mundëson garantimin e të paktën një prej informacioneve të më poshtme nga një server në distancë: i. statusi i fuqisë; ii. temperaturën e brendëshme nga sensori termik kundër mbingarkesës; iii. burimin video; iv. burimin audio dhe statusin e audio (volum/pa zë); v. modelin dhe versionin e softit operues. (b) strukturën fizike specifikuar për përdoruesin për të lehtësuar montimin e ekranit në studiot profesionale ose panele;
45.	**"Treguesi i statusit"** nëkupton një ekran i cili shërben për të paraqitur një informacion të thjeshtë por të ndryshueshëm si kanalet e përzgjedhur, ora ose konsumi i energjisë. Një indikator i thjeshtë i ndriçimit nuk konsiderohet si tregues i statusit.
46.	**"Treguesi i transmetimit"** nënkupton një ekran elektronik projektuar dhe tregtuar për përdorim profesional nga transmetuesit dhe studiot e video produksioneve për krijimin e videove. Karakteristikat e tij do të përfshijnë të gjitha veçoritë e mëposhtme: (a) funksionin e kalibrimit të ngjyrës. (b) funksioni analizës sinjalit hyrës për monitorim të sinjalit hyrës dedektimit të gabimit, si monitorimi i formës – valës/vektor shtrirjeje/, filtrimi RGB, lehtësi në kontrollin e statusit të sinjalit video në rezolucionin pixel aktual, mënyrën e ndërthurjes dhe shenjimin e ekranit; (c) ndërfaqe Digjitale Seriale (SDI) ose Video në internet Protokoll (VoIP) instaluar në produkt. (d) nuk ka qëllim përdorimi në zonat publike;

47.	**"Ushqyes i jashtëm energjie (EPS)"** nënkupton një pajisje që plotëson kushtet e mëposhtme (1): (a) është projektuar për të kthyer rrymën alternative (AC) nga burimi kryesor i energjisë elektrike në një ose më shumë dalje me tension më të ulët në rrymë të drejtë (DC) ose rrymë alternative (AC). (b) përdoret me një ose më shumë pajisje të veçanta që përbëjnë ngarkesën kryesore. (c) ndodhet në një mbështjellëse fizike të veçuar nga pajisja ose pajisjet që përbëjnë ngarkesën kryesore. (ç) është i lidhur me pajisjen ose pajisjet që përbëjnë ngarkesën kryesore përmes lidhjeve elektrike të shkëputshme ose të fiksuara me prizë/fishë mashkull/femër, kabllo, kordone ose instalime të tjera elektrike. (d) ka fuqi daljeje të deklaruar në pllakën e emërtimit që nuk i kalon 250 Wat; dhe (dh) përdoret me pajisje elektrike dhe elektronike shtëpiake dhe të zyrës të përfshira në Aneksin I.
48.	**"Variacioni i Dinamikës së Lartë (HDR)"** nënkupton një metodë për të ngritur raportin e kontrastit të imazhit të një ekrani elektronik duke përdorur "metadata" (të dhëna të rigrupuara/përpunuara) gjeneruar gjatë krijimit të një materiali video dhe ku qarqet manaxhues të ekranit ndërhyjnë për të prodhuar një raport kontrasti dhe rezultante ngjyrash të perceptuar nga syri i njeriut shumë më reale se sa çfarë është arritur në ekranet jo-HDR.
49.	**"Vlera të deklaruara"** jane vlerat e ofruara nga furnizuesi për parametrat teknikë të deklaruar, të llogaritur ose të matur, në përputhje me nenin 6 të Ligjit 52/2024, dhe në përputhje me Kreun III(1)(ç) dhe Shtojcën V të kësaj rregullore.
50.	**"Zona e ekranit"** nënkupton zonën e dukshme të ekranit elektronik e cila llogaritet duke shumëzuar gjerësinë maksimale të imazhit të dukshëm me lartësinë maksimale të imazhit të dukshëm përgjatë sipërfaqes së panelit (e sheshtë ose e kurbëzuar);

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit duhet të sigurojnë që:

(a) çdo ekran elektronik duhet të jetë i pajisur me etiketë në formë të printuar dhe përmban informacionin e paraqitur në Shtojcën II;

(b) vlerat e parametrave përfshirë në skedën informative shoqëruese të produktit, siç është paraqitur në Shtojcën IV, janë vendosur në regjistrin publik të të dhënave të produktit

(c) nëse specifikisht kërkohet nga tregtuesi, skeda informative e produktit duhet të jetë e disponueshme në formë të printuar;

(ç) përmbajtja e dokumentacionit teknik, paraqitur në Shtojcën V, është vendosur në databazën e produktit;

(d) çdo reklamë vizive për një model specifik të ekranit elektronik, përfshirë dhe internetin, përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe variacionin e klasave të efiçencës të disponueshme në etiketë në përputhje me Shtojcën VI dhe Shtojcën VII.

(dh) çdo material promocional teknik që lidhet me një model specifik të ekranit elektronik, përfshirë dhe internetin, i cili përshkruan parametrat teknik specifik të tij, përfshin klasën e efiçencës së energjisë së modelit dhe variacionin e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI;

(e) një etiketë elektronike, në format dhe që përmban informacionin siç paraqitet në Shtojcën II, do të jetë e disponueshme tek tregtarët për çdo model ekrani elektronik;

(ë) një skedë informative e produktit elektronik, siç është paraqitur në Shtojcën IV, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model ekrani elektronik.
(f) duke shtuar në pikën (a), etiketa duhet të printohet në ambalazhim ose të ngjitet në të.
2. Klasa e efiçencës së energjisë do të mbështetet në indeksin e kalkuluar në përputhje me Shtojcën I.
3. Deri në gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, furnizuesit që prodhojnë produkte me ndikim në energji sipas kësaj rregullore, në Republikën e Shqipërisë duhet të plotesojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën IV dhe ta shfaqin në faqen e tyre të internetit përpara se të hedhin në treg çdo produkt të prodhuar pas këtij afati.
4. Për furnizuesit që prodhojnë produkte me ndikim në energji sipas kësaj rregullore në Republikën e Shqipërisë dhe eksportojnë produktet e prodhuara në bashkimin evropian, duhet të plotësojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën IV në bazën e të dhënave evropiane të produkteve përpara se të hedhin në treg çdo produkt të prodhuar pas këtij afati.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

Tregtarët duhet të sigurojnë që:
(a) çdo ekran elektronik, në pikën e shitjes, duke përfshirë dhe panairet, mbartin etiketën siguruar nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(a) të Kreut 3 ekzpozuar në pjesën ballore të pajisjes ose varur në të ose vendosur në mëyrë të tillë që të jetë qartësisht e dukshme dhe në mënyrë të qartë e shoqëruar me modelin specifik; duke siguruar që ekrani elektronik eshtë në gjendje të ndezur kur vizitohet nga klientët gjatë shitjes, etiketa elektronike në përputhje me pikën 1(e) të Kreut 3 paraqitur në ekran mund të zëvendësojë etiketën e printuar.
(b) nëse një model ekrani elektronik është ekspozuar në një pikë shitje pa njesië dhe jashtë kutisë, etiketa e printuar mbi kuti ose e ngjitur në të duhet të jetë e dukshme;
(c) në rastet e shitjes në distancë ose telemarketingut, etiketa dhe skeda e informacionittë produktit janë siguruar në përputhje me Shtojcën VI dhe VII;
(ç) çdo reklamë vizive për një model specifik ekrani elektronik, përfshirë internetin, përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe variacionin e klasave të vlefshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI;
(d) çdo material promocional teknik që lidhet me një model specifik të ekranit elektronik, përfshirë materialet promocionale teknike në internet, i cili përshkruan parametrat teknik specifik, përfshin klasën e efiçencës së energjisë të modelit dhe variacionin e klasave të efiçencës të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI.

V. DETYRIMET E SIGURUESIT TË SHËRBIMIT NË PLATFORMAT E INTERNETIT

Nëse siguruesi i shërbimit, siç referohet në Ligjin Nr. 10 128, datë 11.05.2009 "Për Tregtinë Elektronike", Neni 17, lejon shitjen e ekranëve elektronik nëpërmjet faqeve të tij të internetit, siguruesi i shërbimit duhet të bëj të mundur ekspozimin e etiketës elektronike dhe skedën shoqëruese të produktit elektronik siguruar nga tregtari në mekanizmin e ekspozimit në përputhje me të dhënat e Shtojcës VII dhe duhet të informojë tregtarin për detyrimet e ekspozimit tyre.

VI. METODAT E MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni siguruar në përputhje me Kreun III dhe IV merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes.të përcaktuara në Shtojcën III.

VII. PROÇEDURAT E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I

A. **Klasat e efiçencës së energjisë**

Klasa e efiçencës e një ekrani elektronik do të përcaktohet në bazë të indeksit të tij të efiçencës së energjisë për etiketim ($EEI_{etiketë}$) siç është shprehur në Tabelën 1. $EEI_{etiketë}$ e një ekrani elektronik do të përcaktohet në përputhje me pjesën B të kësaj Shtojce.

Tabela 1

Klasat e efiçencës energjisë të ekranëve elektronik

Klasa Efiçencës Energjisë	Indeksi Efiçencës Energjisë ($EEI_{etiketë}$)
A	$EEI_{etiketë} < 0{,}30$
B	$0{,}30 \leq EEI_{etiketë} < 0{,}40$
C	$0{,}40 \leq EEI_{etiketë} < 0{,}50$
D	$0{,}50 \leq EEI_{etiketë} < 0{,}60$
E	$0{,}60 \leq EEI_{etiketë} < 0{,}75$
F	$0{,}75 \leq EEI_{etiketë} < 0{,}90$
G	$0{,}90 \leq EEI_{etiketë}$

B. **Indeksi Efiçencës Energjisë ($EEI_{etiketë}$)**

Indeksi Efiçencës Energjisë ($EEI_{etiketë}$) i ekranit elektronik do të kalkulohet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

$$EEIetiketw = \frac{(Pe\ matur + 1)}{(3\ x\ [90\ x \tanh(0{,}025 + 0{,}0035x(A - 11)) + 4] + corrI}$$

ku:

A paraqet zonën e sipërfaqes së shikueshmërisë në dm^2;

$P_{e\ matur}$ është fuqia e matur në gjendje të ndezur në Wat në konfigurimin normal dhe shprehur si në Tabelën 2; $corrI$: është një faktor korrigjimi i paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 2

Matja e $P_{e\ matur}$

Niveli Variacionit Dinamik	***P e matur***
Variacioni Dinamik Standard (SDR): $P_{e\ matur_{SDR}}$	Fuqia e kërkuar në Wat (W) në gjendje të ndezur, matur kur shfaqen sekuenca test të standardizuar të një imazhi me lëvizje nga një përmbajtje dinamike e transmetuar. Nëse reduktimet janë të lejuara sipas pjesës C të kësaj Shtojce, mund të zbritet nga $P_{e\ matur}$.
Variacioni Dinamik I Lartë (HDR) $P_{e\ matur\ HDR}$	Fuqia e kërkuar në Wat (W) në gjendje të ndezur, matur si $Pmeasured_{SDR}$ por me funksionet HDR të aktivizuar nëpërmjet metadata gjatë sekuencave test HDR të standardizuara. Nëse reduktimet janë të lejuara sipas pjesës C të kësaj Shtojce, mund të zbritet nga $P_{e\ matur}$.

Tabela 3

Vlera korr l

Tipi Ekranit Elektronik	***Vlera korr $_l$***
Televizor	0,0
Monitor	0,0
Sinjalistikë Digjitale	0,00062*(lum-500)*A *Ku "lum" është maksimumi i luminishencës së bardhë, në cd/ m^2 , në ndriçimin maksimal në gjendje konfigurimi të ekranit elektronik dhe A është sipërfaqja e ekranit në dm^2*

Vlerat e deklaruara të fuqisë për gjendjen e ndezur *(P matur)* dhe sipërfaqja e shikueshmërisë (A) siç janë paraqitur në Tabelën 5 të Shtojcës V do të përdoren për logaritjen e EEI.

C. **Tolerancat dhe përshtatjet për qëllime të logaritjes së *EEI etiketë***

Ekranet elektronike me kontroll automatik të ndriçimit (ABC) do të kualifikohen për një reduktim të *P matur* nëse plotësohen të gjitha kërkesat e mëposhtme:
(a) ABC është aktivizuar në konfigurimin normal të ekranit elektronik dhe vazhdon në çdo konfigurim tjetër të variacionit dinamik standard të disponueshëm tek konsumatori.
(b) vlera e *P matur* në konfigurimin normal, është matur, me ABC të çaktivizuar ose nëse ABC nuk mund të çaktivizohet, në një ambient me kushte ndriçimi 100 lux matur në sensorin ABC;
(c) nëse aplikohet, vlera e *P matur* me ABC të çaktivizuar duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se sa fuqia në gjendje të ndezur e matur me ABC të aktivizuar në një ambient të ndriçuar me 100 lux matur ne sensorin ABC;
(ç) me ABC të aktivizuar, vlera e matur e fuqisë në gjendje të ndezur duhet të ulet me 20% ose më shumë kur ndriçimi ambientit, matur në sensorin ABC, është reduktuar nga 100 lux në 12 lux;
(d) kontrolli ABC i luminishencës së ekranit plotëson të gjitha karakteristikat kur ndriçimi i ambientit matur në sensorin ABC ndryshon:

- luminishenca e matur e ekranit në 60 lux është ndërmjet 65 % dhe 95 % e luminishencës së ekranit matur në 100 lux;
- luminishenca e matur e ekranit në 35 lux është ndërmjet 50 % dhe 80 % e luminishencës së ekranit matur në 100 lux;
- luminishenca e matur e ekranit në 12 lux është ndërmjet 35 % dhe 70 % e luminishencës së ekranit matur në 100 lux;

SHTOJCA II
Etiketë për ekranet eletronik

1. ETIKETË



Informacioni i mëposhtëm duhet të përfshihet në etiketën ekranëve elektronik:
I. Kodi QR;
II. Emri ose marka tregtare e furnizuesit;
III. Identifikimi i modelit nga furnizuesi;
IV. Shkallëa e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;
V. Klasa efiçencës së energjisë përcaktuar në përputhje me me pikën B të Shtojcës I kur aplikohet *Pmatur* $_{SDR}$;
VI. Konsumi i energjisë në gjendje të ndezur në kWh për 1000 orë, gjatë shfaqjes me përmbajtje SDR, rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
VII. Klasa e efiçencës energjisë përcaktuar në përputhje me pikën B të Shtojcës I kur aplikohet *Pmatur* $_{HDR}$;
VIII. Konsumi i energjisë në gjendje të ndezur në kWh për 1000 orë, gjatë shfaqjes me përmbajtje HDR, rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
IX. Diagonalja e ekranit të shikueshëm në centimetra dhe inch dhe rezolucioni horizontal dhe vertical në pixels;
X. Numri i këtij vendimi.
2. DIZAJNI ETIKETËS



Ku:

(a) Etiketa duhet të jetë të paktën 96 mm e gjerë dhe 192 mm e lartë. Nëse etiketa është printuar në një format më të madh, përmbajtja e saj duhet të jetë proporcionale me specifikimet e mësipërme. Për ekranet eletronik me përmasë të diagonales së zones së shikueshme më të vogël se 127 cm (50 inches), etiketa mund të printohet më e zvogëluar, por jo më e vogël se 60% e përmasave normale të saj; përmbajtja e saj duhet të jetë proporcionale me specifikimet e mësipërme dhe kodi QR përsëri të jetë i lexueshëm nga një lexues i zakonshëm QR, si ato të integruar në telefonët inteligjent.
(b) Sfondi etiketës duhet të jetë 100% i bardhë.
(c) Teksti duhet të jetë Verdana dhe Calibri.
(ç) Dimensionet dhe specifikimet e elementëve që përbëjnë etiketën duhet të jenë siç janë treguar në formatin e etiketës.
(d) Ngjyrat duhet të jenë CMYK – cyan, magenta, e verdhë dhe e zezë sipas këtij shembulli: 0, 70, 100, 0: % cyan, 70 % magenta, 100 % e verdhë, 0 % e zezë.
(dh) Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat referuar në figurën e mësipërme):

❶ ngjyrat e logos së EU duhet të jenë si më poshtë:
- sfondi: 100, 80, 0, 0; -
- yjet: 0, 0, 100, 0;

❷ ngjyra e logos së energjisë duhet të jetë: 100, 80, 0, 0;

❸ kodi QR duhet të jetë 100 % i zi;

❹ emri i furnizuesit duhet të jetë 100 % i zi dhe në Verdana Bold 9 pt;

❺ identifikuesi i modelit duhet të jetë 100 % i zi dhe në Verdana Regular 9 pt;

❻ shkallëzimi nga A në G duhet të jetë si më poshtë:
- Shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë duhet të jenë 100% të bardha dhe në Calibri Bold, 19 pt; shkronjat duhet të jenë të vendosura në një rresht në qendër, 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave
- Ngjyrat e shigjetave të shkallës A deri në G duhet të jenë si më poshtë:
  - Klasa A: 100,0,100,0;
  - Klasa B: 70,0,100,0;
  - Klasa C: 30,0,100,0;
  - Klasa D: 0,0,100,0;
  - Klasa E: 0,30,100,0;
  - Klasa F: 0,70,100,0;
  - Klasa G: 0,100,100,0;

❼ Ndarjet e brendëshme duhet të jenë 0,5 pt dhe ngjyra duhet të jetë 100 % e zezë;

❽ Shkronja e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë 100% e bardhë dhe në Calibri Bold 33 pt. Shigjeta e klasës së efiçencës energjisë dhe shigjeta koresponduese në shkallëzimin nga A në G duhet të jetë e pozicionuar në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë e pozicionuar në qendër të pjesës katrore të shigjetës, e cila duhet të jetë 100% e zezë;

❾ vlera e konsumit të energjisë në SDR duhet të jetë në Veranda Bold 28 pt; "kWh/1 000 orë" duhet të jetë në Verdana Regular 16 pt. Teksti duhet të jetë i qendërzuar dhe 100 % i zi;

❿ HDR -ja dhe piktogramat e ekranit duhet të jenë 100 % të zeza dhe siç janë treguar në formatin e etiketës; tekstet (numrat dhe njesitë) duhet të jenë 100 % të zeza, dhe si më poshtë:

- mbi piktogramën e HDR, shkronjat e klasave të efiçencës së energjisë (A deri G) duhet të jenë të qendërzuar, me gërmën e klasës së efiçencës së energjisë që aplikohet në Verdana Bold 16 pt dhe shkronjat e tjera në Verdana Regular 10 pt; nën piktogramën e HDR-së, vlera e konsumit të energjisë në HDR duhet të jetë e qendërzuar, në Verdana Bold 16 pt me "kWh/1 000 orë" në Verdana Regular 10 pt;

- tekstet e piktogramës së ekranit duhet të jenë në Verdana Regular 9 pt dhe vendosur si në formatin e etiketës;

Nëse ekrani elektronik nuk suporton HDR, piktogrami i HDR-së dhe shkronjat e klasave të efiçencës së energjisë nuk paraqiten. Piktograma e ekranit, e cila tregon masën e ekranit dhe rezolucionin, duhet të jetë vertikalisht e qendërzuar në zonën poshtë treguesit të konsumit të energjisë.

⓫ numri i Vendimit duhet të jetë 100 % i zi dhe në Verdana Regular 6 pt.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar

në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës IV. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Metodat e matjes dhe llogaritjet

Për qëllime të pajtueshmërisë dhe verifikimit të pajtueshmërisë me kërkesat e kësaj rregullore, matjet dhe llogaritjet do të bëhen duke vendosur standarde të harmonizuar, numrat e references së të cilëve janë publikuar në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian* ose duke përdorur metoda të përseritëshme, të sakta dhe të besueshme të cilat bazohen në risitë teknologjike. Ato duhet të jenë në një linje me dispozitat e kësaj Shtojce.
Në mungesë të standardeve përkatëse dhe deri në publikimit të referencave të standardeve të harmonizuara përkatëse në Fletoren Zyrtare, do të përdoren metodat e testimit të përkohshëm si më poshtë në Tabelën 3b ([1]) ose do të përdoren metoda të tjera të përsëritëshme, të sakta dhe të besueshme, bazuar në risitë teknologjike.

Tabela 3b

Kërkesat për pajisjet e testimit dhe konfigurimi UUT (*)

Përshkrimi i Pajisjes	Aftësitë	Aftësi dhe karakteristika shtesë
Matja e energjisë elektrike	E përcaktuar në standardin përkatës	Funksioni i regjistrimit të të dhënave
Pajisja për matjen e luminancës (LMD)	E përcaktuar në standardin përkatës	Lloji i sondës kontakti me funksion regjistrimi të të dhënave
Pajisja për matjen e ndriçimit (IMD)	E përcaktuar në standardin përkatës	Funksioni i regjistrimit të të dhënave
Pajisja për gjenerimin e sinjalit	E përcaktuar në standardin përkatës	Shih Shënimet Përkatëse në Shtojcën III, Tabelën 3a. Referencat dhe shënimet kualifikuese
Burimi i dritës (projektor)	Duhet të sigurojë një ndriçim tek sensori ABC më pak se 12 lux dhe deri në 150 lux për televizorë dhe monitorë, dhe deri në 20,000 lux për Ekranet Digjitale të Sinjalistikës, nga një distancë minimale prej rreth 1,5 m nga sensori ABC.	Motor llambë me gjendje të ngurtë (LED, Laser ose kombinim LED/Laser). Gama e ngjyrave e projektorit duhet të jetë e barabartë ose më e mirë se REC 709. Platformë montimi e pjerrët që lejon rregullimin e saktë të rrezeve të projektorit. Kjo mund të kombinohet me ose zëvendësohet nga një veçori e integruar e rregullimit optik.
Burimi i dritës (llambë LED me mundësi rregullimi të ndriçimit)	Sipas specifikimeve në Seksionin 1.2.1	

Komputer për regjistrimin e të dhënave njëkohësisht mbi një shkallë kohore të përbashkët	Të paktën 3 porta të përshtatshme që lejojnë ndërfaqen me pajisjet për matjen e energjisë, luminancës dhe ndriçimit.	Portat USB dhe Thunderbolt konsiderohen si porta të përshtatshme.
Komputer me aplikacion për shfaqjen e prezantimeve ose për redaktimin e imazheve, i lidhur me projektorin.	Aplikacion që lejon projektimin e slide-ve me imazh të bardhë me kornizë të plotë, me kontroll të njëkohshëm mbi temperaturën e ngjyrës dhe nivelin e luminancës (gri).	

(*) Njësi nën test

Matjet dhe llogaritjet duhet të përkojnë me përcaktimet teknike, kushtet, ekuacionet dhe parametrat paraqitur në këtë Shtojcë. Ekranët elekronik të cilët mund të operojnë në gjendjet 2D dhe 3D do të testohen kur operojnë në gjendjen 2D.

Një ekran elektronik i cili është ndarë në dy ose më shumë njesi fizikisht të ndara, por vendosur në treg në një paketim, për arsye të kontrollit të përputhshmërisë me kërkesat e kësaj Shtojce, do të konsiderohet si një ekran elektronik i vetëm. Në rastet kur ekranet eletronik të shumëfishtë të cilët mund të vendosen në treg në mënyrë të ndarë janë kombinuar në një sistem të vetëm, ekranet elektronik individual do të konsiderohen si ekrane të veçanta.

1. MATJET E KONSUMIT TË ENERGJISË NË GJENDJE TË NDEZUR

Matjet në gjendje të ndezur duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e përgjithshme si më poshtë:

(a) ekrani elektronik duhet të matet matet në konfigurim normal;

(b) matjet duhet të kryen në ambient me temperaturë 23 °C +/- 5 °C;

(c) matjet duhet të kryen duke përdorur një nyjë testimi transmetimi dinamik të sinjalit video që paraqet përmbajtjen tipike të transmetuar për ekranet eletronike në variacionin dinamik standard (SDR). Për matjen HDR ekrani elektronik duhet ti përgjgjet automatikisht dhe me përpikmëri informacionit metadata HDR aplikuar në nyjën testuese. Matja do të jetë konsumi mesatar i energjisë përgjatë 10 minutave të njëpasnjëshme;

(ç) matjet duhet të bëhen pasi ekrani elektronik ka qënë në gjendje të fikur ose, nëse gjendja e fikur nuk është e mundur, në gjendje pritjeje për një minimum prej 1 ore dhe ndjekur nga një minimum prej 1 ore në gjendje të ndezur dhe do të realizohet përpara një maksimumi prej 3 orësh në gjendje të ndezur. Sinjali video përkatës duhet të shfaqet gjatë gjithë kohës në gjendje të ndezur. Për ekranet elektronike që stabilizohen brenda 1 ore, këto intervale kohore mund të reduktohen nëse matja e rezultuar tregon që ndodhet brenda 2 % të rezultateve që përndryshe do të arriheshin duke përdorur kohëzgjatjet e përshkruara këtu.

(d) Atje ku ABC është i disponueshëm, matjet duhet të bëhen duke e fikur këtë funksion. Nëse ABC nuk mund të fiket, atëhere matjet do të kryen në një ambient me ndriçim 100 lux i matur në sensorin e ABC.

1. MATJET E LUMINISHENCËS SË BARDHË MAKSIMALE

Matjet e luminishencës së bardhë maksimale do të bëhen:
(a) me një matës luminishence, duke dedektuar atë pjesë të ekranit që shfaq një imazh të plotë (100 %) të bardhë, e cila është pjesë e një modeli "test ekrani të plotë" duke mos kaluar pikën e nivelit mesatar të figures (APL) ku ndonjë kufizim energjie apo parregullsi tjetër mund të shfaqet.
(b) pa e ndryshuar pikën e dedektimit të matësit të luminishencës në ekranin elektronik ndërsa kalohet ndërmjet konfigurimit normal dhe ndriçimit maksimal në gjendje të ndezur.

Matjet e Variacionit Dinamik Standard, Variacionit Dinamik të Lartë, luminishenca e ekranit Kontrollin Automatik të Ndriçimit, raporti i luminishencës Maksimale të Bardhë dhe matje të tjera të luminishencës do të bëhen siç specifikohen në Tabela 3a ([2]) si më poshtë.

Tabela 3a

Referencat dhe shënimet kualifikuese

	Shenime
Pmatur Modaliteti "On" në Gamën Standarde Dinamike (SDR), "normal"	***Shënime për matjen e energjisë*** (Shih Shtojcën IIIa për shënime informative lidhur me testimin e ekraneve me furnizim DC të standardizuar ose me bateri të patjetërsueshme që siguron fuqinë kryesore. Për qëllimet e këtyre Metodave Transtitore të Matjes, një furnizim DC i standardizuar është vetëm ai që është i pajtueshëm me format e ndryshme të furnizimit të energjisë përmes USB.) ***Shënime për sinjalet e videos*** Seanca video dinamike e transmetimit 10-minutëshe, e përshkruar në standardet përkatëse ekzistuese, do të zëvendësohet me një seancë të përditësuar 10-minutëshe video dinamike të transmetimit. Ajo është e disponueshme për shkarkim në: link. https://circabc.europa.eu/ui/group/1582d77c-d930-4c0d-b163-4f67e1d42f5b/library/23ab249b6ebc-4f45-9b0e-

	df07bc61a596?p=1&n=10&sort=modified_DESC. Janë në dispozicion dy skedarë, në SD dhe HD, me tituj përkatësisht: “SD Dynamic Video Power.mp4” “HD Dynamic Video Power.mp4” Rezolucioni SD ofrohet për llojet e kufizuara të ekranëve që nuk mund të pranojnë ose shfaqin standarde me rezolucion më të lartë. Skedari me rezolucion HD përdoret për të gjitha rezolucionet e tjera të ekranit, pasi përshtatet më mirë me nivelin mesatar të imazhit (APL) të seancës dinamike të transmetimit HD sipas IEC, përshkruar në standardet ekzistuese përkatëse. Rritja e rezolucionit nga HD në një rezolucion më të lartë origjinal duhet të kryhet nga Njësia që testohet (UUT) dhe jo nga një pajisje e jashtme. Kur rritja e rezolucionit duhet të kryhet nga një pajisje e jashtme, duhet të regjistrohen të gjitha detajet e pajisjes dhe ndërfaqes së sinjalit me UUT. Sinjali i të dhënave nga sistemi i ruajtjes së skedarit të shkarkuar tek ndërfaqja digjitale e sinjalit të UUT-së duhet të konfirmohet që ofron nivelet e videos me bardhë maksimale dhe të zi të plotë. Nëse sistemi i riprodhimit të skedarëve ka veçori speciale për optimizimin e imazhit (p.sh. zeza të thella ose përpunim të përmirësuar të ngjyrave), këto duhet të çaktivizohen. Për qëllime të përsëritshmërisë së matjeve, duhet të regjistrohen detajet e sistemit të ruajtjes dhe riprodhimit të skedarëve, si dhe lloji i ndërfaqes digjitale me UUT (p.sh. HDMI, DVI etj.). Matja e energjisë PPP që merret është një vlerë mesatare nga e gjithë gjatësia 10-minutëshe e seancës dinamike të testimit, kryer me ABC të çaktivizuar.

	Shenime
Pmatur Gama e Lartë Dinamike (HDR) Modaliteti "On", konfigurimi "normal" (ndryshim automatik i modalitetit në HDR)	Asnjë standard përkatës ekzistues nuk është publikuar deri tani. Pas matjes së seancës dinamike të testimit Pmeasured në SDR, duhet të luhen dy seanca dinamike të testimit në HDR. Këto seanca 5-minutëshe riprodhohen vetëm në rezolucion HD, sipas standardeve të përbashkëta HDR HLG dhe HDR10. Rritja e rezolucionit nga HD në një rezolucion më të lartë origjinal të ekranit duhet të kryhet nga Njësia që testohet (UUT) dhe jo nga një pajisje e jashtme. Kur rritja e rezolucionit duhet të kryhet nga një pajisje e jashtme, duhet të regjistrohen të gjitha detajet e pajisjes dhe ndërfaqes së sinjalit me UUT. Këto dosje janë të disponueshme në: https://circabc.europa.eu/ui/group/1582d77c-d930-4c0d-b163-4f67e1d42f5b/library/38df374d-f3 67-4b72-93d6-3f48143ad661?p=1&n=10&sort=modified_DESC dhe kanë përmbajtje programi identike. Skedarët kanë titujt përkatësisht: "HDRHLG Power.mp4" dhe "HDR_HDR10 Power.mp4". "Është thelbësore që të konfirmohet kalimi i UUT në modalitetin e ekranit HDR në menunë e cilësimeve të imazhit para se të regjistrohen të dhënat e energjisë. Matja e integruar e energjisë për secilën sekuencë (Pav) duhet të mbledhet dhe të pjesëtohet në dy për llogaritjen e klasës së eficencës energjetike HDR të etiketës dhe deklaratës së fuqisë HDR në etiketë." Nëse UUT nuk mund të testohet në njërin nga këto formatet HDR, kjo duhet të shënohet, dhe fuqia e deklaruar do të jetë Pav e matur për formatin HDR që mbështetet. Një lejueshmëri ABC nuk lejohet në mënyrën HDR.

	P_{matur} HDR = 0.5 * (Pav HLG + Pav HDR10) Nëse një nga këto mënyra shfaqjeje HDR nuk mbështetet, vlera numerike e matur e (Pav HLG) ose (Pav HDR10), sipas rastit, duhet të përdoret për deklarimet e Etiketës VII dhe Etiketës VIII.
Matja e ndriçimit të ekranit për vlerësimin e karakteristikave të kontrollit të ndriçimit automatik (ABC) dhe çdo kërkesë tjetër për matjen e ndriçimit maksimal të bardhë.	Asnjë standard ekzistues i rëndësishëm nuk mund të përdoret. Duhet të përdoret një variant i ri i modelit dinamik "kuti dhe kontur", që siguron një format dinamik me ngjyra, për të gjitha matjet e ndriçimit maksimal të ekranit, dhe jo modeli tre shiritash bardh e zi. Duhet të përdoret një grup i këtyre varianteve të modeleve dinamike të testimit, të cilat kombinojnë formatin "kuti dhe kontur" dhe formatin e kutisë së matjes së bardhë VESA L10 deri L80, siç përshkruhet në Seksionin 1.2.4 të Aneksit IIIa, dhe janë të disponueshme për shkarkim në: https://circabc.europa.eu/ui/group/1582d77c-d930-4c0d-b163-4f67e1d42f5b/library/4f4b47a4-c078-49c4-a859-84421fc3cf5e?p=1&n=10&sort=modified_DESC. Ato ndodhen në nën-dosjet e etiketuar SD, HD dhe UHD. Çdo nën-dosje përmban tetë modele dinamike testimi me ndriçim maksimal të bardhë nga L10 deri L80. Mund të zgjidhet një rezolucion sipas rezolucionit natyror dhe kompatibilitetit të sinjalit të UUT. Zgjedhja e një modeli me rezolucionin e duhur duhet të bazohet në: a) dimensionet minimale të nevojshme të kutisë së bardhë për funksionimin korrekt të instrumentit të matjes së ndriçimit me kontakt, dhe b) fakti që nuk ka efekt kufizues të fuqisë demonstruar nga UUT (zona të mëdha të bardha mund të rezultojnë në ulje të niveleve të pikut të bardhë. Çdo përmirësim i rezolucionit (upscaling)

	duhet të kryhet nga UUT dhe jo nga një pajisje e jashtme. Sinjali i të dhënave nga sistemi i ruajtjes së skedarëve të shkarkuar drejt ndërfaqes dixhitale të UUT-it duhet të konfirmohet që ofron nivelet maksimale të të bardhës (peak white) dhe të zeza të plota (full black) dhe nuk duhet të ketë asnjë përpunim tjetër të videos (p.sh., deep blacks / përmirësim ngjyrash). Të dy, sistemi i ruajtjes dhe tipi i ndërfaqes së sinjalit, duhet të shënohen. Për ekranet e testuara duke përdorur një USB ose ndërfaqe të dhënash kompatibile me USB që ka funksionin e furnizimit me energji (power delivery), si UUT ashtu edhe burimi i sinjalit të lidhur me USB duhet të operojnë nga burimi i tyre i energjisë, duke u lidhur vetëm për rrugën e të dhënave.
Matjet që lidhen me ABC për "Lehtësirat dhe përshtatjet për qëllimet e llogaritjes së EEI-së dhe kërkesat funksionale.	Metodologjia për konfigurimin e burimit të dritës ambientale ABC dhe kontrollin e luminancës, siç specifikohet në standardet ekzistuese, **nuk duhet të përdoret** për qëllimet e matjeve lidhur me ABC sipas këtij rregullimi. Metodologjia që duhet të përdoret është përshkruar në Seksionin 1.2.5 të Aneksit IIIa.
Raporti i luminancës maksimale të të bardhës (Peak White Luminance Ratio).	Asnjë standard i rëndësishëm ekzistues nuk mund të përdoret. Pattern-i dinamik "box and outline" i përzgjedhur për matjet e luminancës maksimale të të bardhës (ABC peak white luminance) (Aneksi III.a Seksioni 1.2.4) duhet të përdoret për të matur luminancën maksimale të të bardhës në "konfigurimin normal" me ABC të aktivizuar. Nëse kjo është më pak se 150 cd/m² për monitorët ose 220 cd/m² për produktet e tjera të ekranit, atëherë duhet të kryhet një matje e mëtejshme e luminancës maksimale të të bardhës për konfigurimin më të ndritshëm të paracaktuar në menunë e përdoruesit (jo konfigurimi i dyqanit).

	ABC nuk është e nevojshme të jetë e aktivizuar për matjet e raportit të luminancës, por statusi i ABC (aktiv ose jo) duhet të aplikohet për të dy matjet. Kur ABC është aktiv, iluminanca duhet të jetë 100 lux për të dy matjet. Duhet të tregohet kujdes për të siguruar që pattern-i dinamik i përzgjedhur për matjen e luminancës maksimale të të bardhës në "konfigurimin normal" **nuk shkakton paqëndrueshmëri të luminancës** në konfigurimin më të ndritshëm të paracaktuar. Nëse ndodh paqëndrueshmëri, duhet të përzgjedhet një pattern më i vogël i kutisë së të bardhës për të dy matjet.
Shënime të përgjithëshme	Standardet e mëposhtme të testimit ofrojnë informacion të rëndësishëm mbështetës për specifikimin e pajisjeve të testimit dhe kushtet e nevojshme të testimit, të cilat lidhen me udhëzimet për matje dhe testim të dhëna në këtë Aneks. EN 50564:2011 EN 50643:2018 EN 62087-1:2016 EN 62087- 2:2016 EN 62087-3:2016 EN IEC 62680 seri të standardeve 2013 to 2020 IEC TR 63274 ED1:2020 (Raport teknik këshillues mbi kërkesat për testimin HDR).

SHTOJCA IV
Skeda informative e produktit

Sipas pikes 1(b) të Kreu III, furnizuesi duhet të regjistrojë në regjistrin public të të dhënave të produktit informacionin e përcaktuar në Tabelën 4.
Manuali i përdoruesit ose çdo broshurë tjetër që shoqëron produktin, duhet të tregojë qartë lidhjen me modelin në bazën e të dhënave të produktit, si një Uniform Resource Locator (URL), ose si kod QR, ose duke ofruar numrin e regjistrimit të produktit.

Tabela 4
Informacioni, renditja dhe formati i skedës informuese të produktit

Nr	Parametri	Vlera e parametrit dhe saktësia	Njësia	Shënime
1.	Emri I Furnitorit ose marka tregtare (2) (3).		TEKST	
	Adresa e Furnitorit (2) (3) (4).			Informacion nga rregjistrimi i furnizuesit në databazën e produktit.
2.	Identifikuesi i modelit(2)		TEKST	
3.	Klasa efiçencës energjisë për Variacionin Dinamik Standard (SDR)	[A/B/C/D/E/F/G]		
4.	Energjia e konsumuar në gjendje të ndezur në Variacionin Dinamik Standard (SDR)	X, X	W	Rrumbullakuar në vlerën e pare pas presjes dhjetore për vlera të fuqisë nën 100 W dhe rrumbullakuar në numrin e plotë pasardhës për vlera të fuqisë të barabarta ose më të mëdha se 100 W.
5.	Klasa efiçencës energjisë (HDR)	[A/B/C/D/E/F/G] ose nuk aplikohet		Nëse databaza e produktit gjeneron automatikisht përmbajtjen përfundimtare të qelizës, furnizuesi nuk do ta vendosë këtë të dhënë. Vendoset "n.a." (nuk

						aplikohet) nëse HDR nuk aplikohet.
6.	Konsumi i energjisë në gjendje të ndezur në Variacionin Dinamik të Lartë (HDR), nëse aplikohet	X, X			W	Rrumbullakuar në vlerën e pare pas presjes dhjetore për vlera të fuqisë nën 100 W, dhe rrumbullakuar në nunrin e plotë pasardhës për vlera të fuqisë nga 100 W (vlerë 0 (zero) nëse "nuk aplikohet").
7.	Gjendje e fikur, energjia e konsumuar, nëse aplikohet	X, X			W	
8.	Gjendje në pritje, energjia e konsumuar, nëse aplikohet	X, X			W	
9.	Gjendje në pritje në rrjet, energjia e konsumuar, nëse aplikohet	X, X			W	
10.	Kategoria e ekranit elektronik	[televizor/monitor/sinjalistikë/ të tjera]				Zgjidh një.
11.	Raporti i masës	X	:	Y	i plotë	p.sh. 16:9, 21:9, etj.
12.	Rezolucioni i ekranit	X	×	Y	pixel	Pixel horizontal dhe vertikal

Nr	Parametër	Vlera parametrit dhe saktësia	Njësia	Shënime
13.	Diagonale e ekranit	X, X	cm	Rrumbullakuar një shifër pas presjes dhjetore.
14.	Diagonale e ekranit	X	inches	Opsionale, në inches rrumbullakuar në numrin e plotë pasardhës.
15.	Zona e dukshme e ekranit	X, X	dm^2	Rrumbullakuar një shifër pas presjes dhjetore.
16.	Paneli teknologjik i përdorur	TEXT		P.sh. LCD/LED LCD/QLED LCD/OLED/MicroLED/ QDLED/SED/FED/EPD, etj.
17.	Kontrolli Automatik I Ndriçimit (ABC) i aplikueshëm	[PO/JO]		Duhet të jetë i aktivizuar paraprakisht (nëse PO).
18.	Sensori njohjes zërit i aplikueshëm	[PO/JO]		
19.	Sensori i prezencës në dhomë i aplikueshëm	[PO/JO]		Duhet të jetë i aktivizuar paraprakisht (nëse PO).
20.	Shkalla e frekuencës së përditësimit të imazhit (paracaktuar)	X	Hz	
21.	Disponueshmëria minimale e garantuar e përditësimeve software dhe firmware (2) (3)	X	Vite	Siç shpjegohet më poshtë: (a) Versioni më i fundit i firmuerit duhet të vihet në dispozicion për një periudhë minimale prej tetë vitesh pas hedhjes në treg të njësisë së fundit të një modeli të caktuar produkti, falas ose me një kosto të drejtë, transparente dhe jo diskriminuese. Përditësimi më i fundit i sigurisë për firmuerin duhet të vihet në dispozicion deri të paktën tetë vjet pas hedhjes në treg të produktit të fundit të një modeli të caktuar produkti, falas. (b) Informacioni mbi disponueshmërinë minimale

				të garantuar të përditësimeve të softuerit dhe firmuerit, disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe mbështetjen për produktin duhet të tregohet në skedën e informacionit të produktit sipas Shtojcës IV. (1)
22.	Disponueshmëria minimale e garantuar për pjesët e këmbimit (nga data e përfundimit të hedhjes në treg) (2) (3)	X	Vite	Siç shpjegohet më poshtë: (a) Versioni më i fundit i firmuerit duhet të vihet në dispozicion për një periudhë minimale prej tetë vitesh pas hedhjes në treg të njësisë së fundit të një modeli të caktuar produkti, falas ose me një kosto të drejtë, transparente dhe jo diskriminuese. Përditësimi më i fundit i sigurisë për firmuerin duhet të vihet në dispozicion deri të paktën tetë vjet pas hedhjes në treg të produktit të fundit të një modeli të caktuar produkti, falas. (b) Informacioni mbi disponueshmërinë minimale të garantuar të përditësimeve të softuerit dhe firmuerit, disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe mbështetjen për produktin duhet të tregohet në skedën e informacionit të produktit sipas Shtojcës IV. (1)
23.	Minimumi i garantuar i mbështetjes së produktit (2) (3)	X	Vite	Siç shpjegohet më poshtë: (a) Versioni më i fundit i firmuerit duhet të vihet në dispozicion për një periudhë minimale prej tetë vitesh pas hedhjes në treg të njësisë së fundit të një modeli të caktuar produkti, falas ose me një kosto të drejtë,

				transparente dhe jo diskriminuese. Përditësimi më i fundit i sigurisë për firmuerin duhet të vihet në dispozicion deri të paktën tetë vjet pas hedhjes në treg të produktit të fundit të një modeli të caktuar produkti, falas. (b) Informacioni mbi disponueshmërinë minimale të garantuar të përditësimeve të softuerit dhe firmuerit, disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe mbështetjen për produktin duhet të tregohet në skedën e informacionit të produktit sipas Shtojcës IV. (1)
	Kohëzgjatja minimale e garancisë së përgjithshme të ofruar nga furnizuesi (2) (3)	X	Vite	
24.	Lloji i ushqimit me energji:	E brendëshme/E jashtme/E jashtme e standardizuar		Zgjidh një.

25.	Furnizim i jashtëm me energji elektrike (jo i standardizuar dhe i përfshirë në kutinë e produktit)				
	i			TEKST	Përshkrimi
	ii	Tensioni në hyrje	X	V	
	iii	Tensioni në dalje	X,X	V	

Nr	Parametri	Vlera e parametrit dhe saktësia	Njësia	Shënime
26.	Furnizim i jashtëm i standardizuar me energji elektrike (ose një i përshtatshëm nëse nuk është i përfshirë në kutinë e produktit)			
	i	Emri ose lista e standardit të mbështetur	**TEKST**	

	ii	Tensioni i kërkuar në dalje	X,X	**V**	
	iii	Rryma e kërkuar (minimum i)	X,X	**A**	
	iv	Frekuenca aktuale e kërkuar	X,X	**Hz**	

SHTOJCA V
Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(ç) të Kreut III do të përfshijë:

(1) një përshkrim të përgjithshëm të modelit që lejon qartësisht identifikimin e tij;

(2) referencat për standardet e harmonizuara të aplikuara ose standardet e tjera të matjes që janë përdorur;

(3) masat paraprake të nevojshme specifike gjatë montimit, instalimit, mirëmbajtjes ose testimit të modelit;

(4) vlerat për parametrat teknikë të përcaktuara në Tabelën 5; këto vlera konsiderohen si vlerat e deklaruara për procedurën e verifikimit në shtojcën VIII;

(5) detajet dhe rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me shtojcën III;

Tabela 5

Parametrat teknikë të modelit dhe vlera e deklaruar për makinat larëse shtëpiake

Nr	Parametri	Vlera parametrit dhe saktësia	Njësia	Vlera e publikuar
	Të përgjithshme			
1	Emri i furnizuesit ose marka tregtare	TEKST		
2	Identifikuesi i modelit	TEKST		
3	Klasa efiçencës energjisë për Variacionin Dinamik Standard (SDR)	[A/B/C/D/E/F/G]	A – G	
4	Konsumi energjisë në gjendje të ndezur në Variacionin Dinamik Standard (SDR)	XXX,X	W	
5	Klasa e efiçencës energjisë për Variacionin e Dinamikës Lartë (HDR), nëse aplikohet	[A/B/C/D/E/F/G] ose n.a.	A – G	
6	Konsumi i energjisë në Variacionin Dinamik të Lartë (HDR)	XXX,X	W	

7	Konsumi energjisë në gjendje të fikur	X,X			W	
8	Konsumi energjisë në gjendje pritje	X,X			W	
9	Konsumi I energjisë në gjendje pritje në rrjet	X,X			W	
10	Kategoria ekranit elektronik	[televizor/monitor/sinjalistikë/ të tjera]			TEKST	
11	Raporti i masës	XX	:	XX		
12	Rezolucioni ekranit (pixels)	X	×	X		

	Parameteri	Vlera e parametrit dhe saktësia	Njësia	Vlera e publikuar
13	Diagonalia ekranit	XXX,X	cm	
14	Diagonalia ekranit	XX	inches	
15	Sipërfaqja e dukshme e ekranit	XXX,X	Dm^2	
16	Teknologjia e panelit e përdorur	TEKST		
17	Aplikueshmëria Kontrollit Ndriçimit Automatik (ABC)	[PO/JO]		
18	Aplikueshmëria e sensorit të njohjes zërit	[PO/JO]		
19	Aplikueshmëria e sensorit të prezencës në dhomë	[PO/JO]		
20	Raporti I frekuencës së përditësimit imazhit (konfigurim normal)	XXX	Hz	
21	Disponueshmëria minimale e garantuar e përditësimeve të softuerit dhe firmware-it (nga data e përfundimit të hedhjes në treg,	XX	Vite	

	sipas përcaktimeve në Shtojcën II E, pika 1 e Rregullores së Komisionit (BE) 2019/2021)			
22	Disponueshmëria minimale e garantuar e pjesëve të këmbimit (nga data e përfundimit të hedhjes në treg, sipas përcaktimeve në Shtojcën II E, pika 1 e Rregullores së Komisionit (BE) 2019/2021):	XX	Vite	
23	Mbështetja minimale e garantuar për produktin (nga data e përfundimit të hedhjes në treg, sipas përcaktimeve në Shtojcën II E, pika 1 e Rregullores së Komisionit (BE) 2019/2021):	XX	Vite	
	Kohëzgjatja minimale e garancisë përgjithshme ofruar nga furnizuesi	XX	Vite	

Gjendja e Ndezur

Nr	Parametri	Vlera parametrit dhe saktësia	Njësia	Vlera e publikuar
24	Luminanca maksimale e bardhë në konfigurimin e modalitetit më të ndritshëm	XXXX	cd/m2	
25	Luminanca maksimale e bardhë e konfigurimit normal	XXXX	cd/m2	
26	Raporti i luminancës së bardhë maksimale (i llogaritur si vlera e "Luminancës maksimale të bardhë në konfigurimin normal" e ndarë me vlerën e "Luminancës maksimale të bardhë në konfigurimin më të ndritshëm në modalitetin On" dhe shumëzuar me 100)	XX, X	%	

Për Fikjen Automatike të Energjisë (APD)

27	Kohëzgjatja e gjendjes "në punë" (on mode), përpara se ekrani elektronik të kalojë automatikisht në gjendjen "pritje" ose "fikur", ose në një gjendje tjetër që nuk e tejkalon kërkesën për konsum të energjisë për gjendjen "fikur" dhe/ose "në pritje"	XX:XX	mm:ss	
28	Për televizorët: vlera e matur e kohës para se televizori të arrijë automatikisht në gjendjen "në pritje", "fikur" ose në një gjendje tjetër që nuk e tejkalon kërkesat për konsum energjie për "gjendje të fikur" dhe/ose "gjendje në pritje", pas ndërveprimit të fundit të përdoruesit	XX:XX	mm:ss	
29	Për televizorët e pajisur me sensor të pranisë në dhomë: vlera e matur e kohës para se televizori të arrijë automatikisht në gjendjen "në pritje", "fikur" ose në një gjendje tjetër që nuk e tejkalon kërkesat për konsum energjie për "gjëndje të fikur" dhe/ose "gjendje në pritje", kur nuk zbulohet prania në dhomë.	XX:XX	mm:ss	
30	Pajisje të tjera elektronike me ekran përveç televizorëve dhe ekraneve transmetuese: vlera e matur e kohës para se ekrani elektronik të arrijë automatikisht në gjendjen "në pritje", "fikur" ose në një gjendje tjetër që nuk e tejkalon kërkesat për konsum energjie për "gjendje e fikur"	XX:XX	mm:ss	

	dhe/ose “gjendje në pritje”, kur nuk zbulohet asnjë sinjal hyrës			

Për ABC
Nëse aplikohet dhe aktivizuar paraprakisht

31	Përqindja e reduktimit të energjisë për shkak të aktivizimit të ABC në ambient me kondita ndriçimi ndërmjet 100 lux dhe 12 lux.	XX,X	%	
32	Energjia në modalitetin “On” me ndriçim ambjentual 100 lux tek sensori ABC	XXX,X	W	
33	Energjia në modalitetin “On” me ndriçim ambjentual 12 lux tek sensori ABC	XXX,X	W	

	Parameteri	Vlera e parametrit dhe saktësia	Njësia	Vlera e publikuar
34	Luminishenca e ekranit në ambient me ndriçim 100 lux në sensorin ABC (*)	XXX	cd/m$_2$	
35	Luminishenca ekranit në ambient me ndriçim 60 lux në sensorin ABC (*)	XXX	cd/m$_2$	
36	Luminishenca e ekranit në ambient 35 lux në sensorin e ABC(*)	XXX	cd/m$_2$	

37	Luminishenca ekranit në ambient me ndriçim 12 lux në sensorin ABC(*)	XXX	cd/m2	

Për Ushqyesin e Energjisë

38	Lloji i ushqyesit të energjisë	I brendshëm/I jashtëm	Njësia	Vlera e publikuar
39	Referenca standard (nëse lidhet)		TEKST	
40	Tensioni në hyrje	XXX,X	V	
41	Tensioni në dalje	XXX,X	V	
42	Rryma elektrike në hyrje (max)	XXX,X	A	
43	Rryma elektrike në dalje (min)	XXX,X	A	

(*) Vlerat e parametrave të ndriçimit të ABC janë treguese, dhe verifikimi bëhet në përputhje me kërkesat përkatëse të lidhura me ABC-në.

(6) kushtet e testimit nëse nuk janë përshkruar mjaftueshëm në pikën (2);
(7) modelet ekujvalent, nëse ndonjë, duke përfshirë idnetifikuesit e modelit;
Këto elemente gjithashtu përbëjnë pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi duhet të regjistrojë në bazën e të dhënave, në përputhje me pikën 11 të Nenit 9 të Ligjit 52/2024.
(9) Kërkesat për informacion shtesë:
(a) terminal hyrës për sinjalet test audio dhe video përdorur për testim;
(b) informacion dhe dokumentacion në instrumentim, konfigurim dhe qarqe të përdorura për testim elektrik;
(c) çdo konditë tjetër testimi që nuk është përshkruar ose përcaktuar në pikën (b);
(ç) për gjendjen në punë:
(i) karakteristikat e sinjalit video me përmbajtje dinamike të transmetimit që përfaqëson përmbajtjen tipike të transmetimit TV; për sinjalin video me përmbajtje transmetimi dinamik HDR ekrani elektronik duhet të kalojë automatikisht në gjendje HDR nga metadata HDR e sinjalit;
(ii) sekuenca e hapave për të arritur një konditë të qendrueshme në përputhje me nivelin e nevojës për energji; dhe
(iii) konfigurimi i figures përdorur për matjen e e luminishencës së bardhë maksimale dhe modeli i testimit për sinjalin video të përdorur për matje.
(d) Për gjendjet në pritje dhe të fikur:
(i) metoda e matjes së përdorur;
(ii) përshkrimi se si gjendja eshtë zgjedhur ose programuar duke përfshirë ndonjë funksion riaktivizues përforcues; dhe

(iii) sekuenca e veprimeve për të arritur konditën ku ekrani elektronik ndryshon gjendje automatikisht.

(dh) Për ekranet elektronik të projektuar me akses kompjuterik:

(i) konfirmimi që ekrani elektronik trajton me prioritet protokollet e manaxhimit të energjisë së kompjuterit shprehur në pikën 6.2.3 të Shtojcës II të Rregullores Komisionit (EU) Nr 617/2013 ([1]). Çdo devijim nga protokollet duhet të raportohet;

(e) Vetëm për ekranet elektronik në rrjet:

(i) numri dhe tipi i hyrjeve në rrjet, përjashtuar hyrjet jo kabllore, pozicioni i tyre në ekranin elektronik;

(ii) nëse ekrani elektronik cilësohet si ekran elektronik me funksionalitet HiNA; nëse nuk jepet informacion ekrani elektronik nuk konsiderohet ekran HiNA ose ekran me funksionalitet HiNA; dhe

(iii) informacion nëse ekrani elektronik në rrjet siguron një funksionim që lejon funksionin e menaxhimit të energjisë dhe/ose përdoruesin që të kalojë ekranin elektronik që ndodhet në një konditë që siguron gjendje pritje në rrjet në gjendje pritje, ose gjendje të fikur ose konditë tjetër e cila nuk e kalon konsumin e energjisë së aplikuar për gjendjen e fikur dhe/ose gjendjen në pritje duke përfshirë lejimin e funksionit të përforcuar riaktivizues atje ku aplikohet.

(ë) Për çdo tip të portave të rrjetit:

(i) koha e parazgjedhur (mm:ss) pas së cilës fiunksioni i manaxhimit të energjisë, kalon ekranin në një konditë që siguron gjendje në pritje në rrjet; dhe

(ii) kyçësi që do të përdoret për riaktivizimin e ekranit elektronik.

([1]) Rregullore e Komisionit (EU) No 617/2013 më 26 Qershor 2013 Direktivë 2009/125/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat "ecodesign" për kompjuterat dhe serverat kompjuterik (OJ L 175, 27.06.2013, fq. 13).

(10) nga është përftuar informacioni i përfshirë në dosjen e dokumentacionin teknik për një model specifik ekrani elektronik:

(a) nga një model që ka karakteristika teknike të njëjta që lidhen ngushtë me informacionin teknik që do të sigurohet por që është prodhuar nga një prodhues tjetër ose

(b) nga llogaritjet bazuar në modelinose nga ekstarpolimet nga një model tjetër i të njëjtit furnizues ose jo, ose të dyja;

dokumentacioni teknik duhet të përfshijë, në mënyrën e duhur, detajet e kësaj llogaritje, vlerësimin e marrë përsipër nga furnizuesi për të verifikuar saktësinë e llogaritjes dhe, kur nevojitet, deklaratën e ngjashmërisë ndërmjet modeleve të furnizuesve të ndryshëm; dhe

(11) detajet e kontaktit të personit autorizuar për lidhjen me furnizuesin, nëse nuk është përfshirë në informacionin teknik të ngarkuar në regjister, duhet të jenë të disponueshme, sipas kërkesës, nga Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut.

SHTOJCA VI

Informacioni që duhet të shfaqet në reklamat vizuale, në materialin promovues teknik në shitjen në distanca dhe në telemarketing, përveç shitjes në distanca në internet

1. Në reklamat visive, për qëllime të sigurimit të përputhjes me kërkesat paraqitur në pikën 1(d) të Kreut III dhe pikën (ç) të Kreut IV, klasa e efiçencës energjisë dhe variacioni i klasave të disponueshme të efiçencës në etiketë do të paraqiten sipas pikes 4 të kësaj Shtojce.
2. Në materialet promocionale teknike, për qëllim të garantimit të përputhshmërisë me kërkesat paraqitur në pikën 1(dh) të Kreut (3) dhe pikes (d) të Kreut 4 klasa e efiçencës së energjisë dhe diapazoni i klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, duhet të afishohen siç është treguar në pikën 4 të kësaj Shtojce.
3. Çdo shitje nga distanca nëpërmjet materialeve promovuese fizike duhet të tregojë klasën e efiçencës së energjisë dhe diapazonin e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj Shtojce.
4. Klasa e efiçencës energjisë dhe diapazoni i klasave të efiçencës energjisë do të paraqiten, siç tregohet në Figurën 1, me:
    a. një shigjetë, e cila përmban gërmën e klasës e efiçencës energjisë në 100% ngjyrë të bardhë, Calibri Bold dhe me masë fonti të paktën të barabartë me atë të çmimit, kur çmimi është paraqitur.
    b. ngjyra e shigjetës duhet të përputhet me me ngjyrën e klasës efiçencës energjisë;
    c. diapazoni i klasave të efiçencës së energjisë të jetë 100 % e zezë; dhe,
    d. (ç) madhësia duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë e vendosur në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufij 0.5 pt 100 % të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe shkronjës së klasës së efiçencës së energjisë.

Si përjashtim, nëse reklama vizuale, materiali promovues teknik ose shitja nga distanca nëpërmjet materialeve promovuese fizike është e shtypur në njëngjyrësh, shigjeta mund të jetë në njëngjyrësh në atë reklamë vizuale, material promovues teknik ose shitje nga distanca nëpërmjet materialeve promovuese fizike.

Figura 1

Shigjeta e ngjyrosur/njëngjyrëshe majtas/djathtas, që paraqet variacionin e klasave të efiçencës energjisë



5. Shitja nga distanca përmes telemarketingut duhet të informojë në mënyrë specifike klientin për klasat e efiçencës së energjisë së produktit dhe për diapazonin e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, si dhe se klienti mund të ketë qasje në etiketë dhe në skedën e informacionit të produktit përmes faqes së internetit të bazës së të dhënave të produktit, ose duke kërkuar një kopje të shtypur.
6. Për të gjitha situatat e përmendura në pikat 1 deri në 3 dhe 5, duhet të mundësohet që klienti të marrë, me kërkesë, një kopje të shtypur të etiketës dhe skedës së informacionit të produktit.

SHTOJCA VII

Informacioni që duhet të sigurohet në rastin e shitjes nga distanca përmes internetit

1. Etiketa përkatëse e publikuar nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(e) të Kreut III duhet të shfaqet në mekanizmin e shfaqjes (display mechanism) pranë çmimit të produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që etiketa të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe të jetë në përpjesëtim me madhësinë e specifikuar në pikën 2(a) të Shtojcës II. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndarë (nested display), në të cilin imazhi i përdorur për të aksesuar etiketën duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 3 të kësaj shtojce. Nëse aplikohet një ekran i ndarë, etiketa duhet të shfaqet me klikimin e pare të mouse-it, me rrotullimin e mouse-it ose zgjerimin e ekranit taktil në imazh
2. Imazhi i përdorur për aksesim në etiketë në rastin e shfaqes së ngjitur, siç tregohet në Figurën 2, duhet të:

   (a) të jetë një shigjetë në ngjyrën që korespondon me me klasën e efiçencës energjisë të produktit në etiketë.

   (b) të tregojë klasën e efiçencës së energjisë së produktit në shigjetë 100 % të bardhë, Calibri Bold dhe me një madhësi shkronjash të barabartë me atë të çmimit;

   (c) të ketë diapazonin e klasave të efiçencës të energjisë të disponueshme 100 % të zezë; dhe

   (d) të ketë një nga dy formatet e mëposhtme, dhe madhësia e tij duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë e pozicionuar në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me kufij të dukshëm 100 % të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe shkronjës së klasës së efiçencës së energjisë:

Figura 2

Shigjeta me ngjyra majtas/djathtas, me diapazonin e klasave të efiçencës së energjisë



3. Në rastin e ekranit të ndarë (nested display), renditja e shfaqjes së etiketës duhet të jetë si më poshtë:

   (a)imazhet e përmendura në pikën 2 të kësaj shtojce duhet të shfaqen në mekanizmin e shfaqjes pranë çmimit të produktit;

   (b) imazhet duhet të lidhen me etiketën e përcaktuar në Shtojcën II;
   etiketa duhet të shfaqet pas një klikimi të mouse-it, rrotullimit të mouse-it ose zgjerimit të ekranit taktil mbi imazhin;

   (c)etiketa duhet të shfaqet si pop-up, në një skedë të re, faqe të re ose ekran të ndarë;

   (d) për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, duhet të zbatohen standardet e pajisjes për zmadhimin me prekje;

   (e)etiketa duhet të ndalojë së shfaquri përmes një opsioni mbylljeje ose mekanizmi tjetër standard të mbylljes

(f) teksti alternativ për grafikun, që do të shfaqet në rast dështimi të shfaqjes së etiketës, duhet të përmbajë klasat e efiçencës së energjisë së produktit në një madhësi shkronjash të barabartë me atë të çmimit.

4. Skeda shoqëruese përkatëse e produktit përgatitur nga furnizuesi në përputhje me pikën 1(ë) të Kreut III duhet të shfaqet në mekanizmin e shfaqjes pranë çmimit të produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që skeda e informacionit të produktit të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Skeda e informacionit të produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndarë ose duke iu referuar bazës së të dhënave të produktit, në të cilin link-u i përdorur për të hyrë në skedën e informacionit të produktit duhet të tregojë qartësisht "Skeda e informacionit të produktit". Nëse përdoret një ekran i ndarë, skeda e informacionit të produktit duhet të shfaqet me klikimin e parë të mouse-it, rrotullimin e mouse-it ose zgjerimin e ekranit taktil në link.

SHTOJCA VIII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë shtojce lidhen vetëm me verifikimin nga Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut të vlerave të deklaruara dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesi si tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik ose për të interpretuar këto vlera me synimin e arritjes së përputhshmërisë ose për të komunikuar performancë më të mirë. Vlerat dhe klasat e publikuara në etiketë ose në skedën e informacionit të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara në dokumentacionin teknik.

Në rastin kur një model është projektuar për të qenë në gjendje të zbulojë se po testohet (p.sh. duke njohur kushtet ose ciklin e testit), dhe për të reaguar në mënyrë specifike duke ndryshuar automatikisht performancën e tij gjatë testit me qëllimin e arritjes së një niveli më të favorshëm për ndonjë nga parametrat e specifikuar në këtë rregullore ose të përfshirë në dokumentacionin teknik apo në ndonjë dokumentacion të dhënë, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente nuk do të konsiderohen në përputhje.

Si pjesë e verifikimit të përputhshmërisë së një modeli me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të zbatojë procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të verifikojnë një njësi të vetme të modelit.
2. Modeli do të konsiderohet në përputhje me kërkesat nëse:
   (a) Vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik sipas pikës 3 të nenit 9 të Ligjit 52/2024, dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit; dhe
   (b) vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën e informacionit të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e efiçencës së energjisë nuk është më e favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe
   (c) kur Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) janë në përputhje me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 9.
3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2(a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen si jo në përputhje me këtë rregullore.
4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të zgjedhë tre njësi shtesë të modelit të njëjtë për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve ekuivalente.
5. Modeli do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e aplikueshme nëse për këto tre njësi, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara është në përputhje me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 6.
6. Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen si jo në përputhje me këtë rregullore.

7. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do t"u sigurojë të gjitha informacionet pas marrjes së një vendimi mbi mos-përputhshmërinë e modelit sipas pikave 3, 6 ose paragrafit të dytë të kësaj shtojce.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut duhet të përdorë metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën III.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut duhet të zbatojë vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 6 dhe duhet të përdorë vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 7 për kërkesat e përmendura në këtë shtojcë. Për parametrat në Tabelën 6, nuk duhet të aplikohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara apo në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 6

Tolerancat e verifikimit

Parameteri	Tolerancat verifikuese
Fuqia e konsumuar në gjendje të ndezur (P_{matur}, Wat)	Vlera e përcaktuar (**) nuk duhet të kalojë më shumë se 7% të vlerës së publikur.
Konsumi i energjisë në gjendje të fikur, pritje, dhe pritje në rrjet në Wat, siç aplikohet.	Vlera e përcaktuar (**) nuk duhet të kalojë vlerën e publikuar në më shumë se 0,10 Wat nëse vlera e deklaruar është 1,00 Wat ose më pak, ose në më shumë se 10% nëse vlera e deklaruar është më shumë se 1,00 Wat.
Sipërfaqja e dukshme e ekranit	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të jetë më e vogël se se vlera e publikuar në më shumë se 1 % apo 0,1 dm^2, kushdo qoftë më e vogël.
Diagonalja ekranit të dukshëm në centimetra	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të ndryshojë nga vlera e publikuar në më shumë se 1 cm.
Rezolucioni horizontal dhe vertikal në pixels	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të devijojë nga vlera e deklaruar.

Luminishenca e bardhë maksimale	Vlera e përcaktuar (**) nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e publikuar në më shumë se 8 %.
Kohëzgjatja në gjendje të ndezur përpara se ekrani elektronik të kalojë automatikisht në gjendjet pritje, të fikur, ose konditë tjetër e cila nuk kalon kërkesat e konsumit të aplikuar të energjisë për gjendjet të fikur ose në pritje	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të kalojë vlerën e publikuar në më shumë se 5 sekonda.
Për televizorët: Kohëzgjatja, mbas ndërhyrjes së fundit të përdoruesit, përpara se televizori të kalojë automatikisht në gjendjet në pritje, fikur, ose gjendje tjatër në të cilën nuk kalohen kërkesat e aplikuara të konsumit të energjisë për gjendjet e fikur apo në pritje	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të kaloj vlerën e deklaruar në më shumë se 5 sekonda.

Parameter	Verification tolerances
Për televizorët pajisur me sensorin e prezencës në dhomë: kohëzgjatja, kur nuk konstatohet presence, përpara se televizori të kalojë automatikisht në gjendjet pritje, fikur, ose konditë tjetër e cila nuk kalon kërkesat e aplikuara për konsumin e energjisë	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të kalojë vlerën e publikuar për më shumë se 5 sekonda.

për gjendjet fikur ose në pritje	
Për ekranet elektronik përveç televizorëve dhe ekranëve transmetues: kohëzgjatja, kur nuk konstatohet sinjal në hyrje, përpara se ekrani elektronik të kalojë automatikisht në gjendjet pritje, të fikur, ose konditë tjetër në të cilën nuk kalohen kërkesat për konsumin e aplikuar të energjisë për gjendjet fikur ose në pritje	Vlera e përcaktuar (*) nuk duhet të kalojë vlerën e publikuar në më shumë se 5 sekonda.

(*) Në rast se vlera e përcaktuar për një njësi të vetme nuk është në përputhje, modeli dhe të gjithë modelet ekuivalente do të konsiderohen si jo në përputhje me këtë Rregullore.

(**) Në rastin e tre njësive shtesë të testuara sipas përcaktimit në pikën 4, vlera e përcaktuar nënkupton mesataren aritmetike të vlerave të përcaktuara për këto tre njësi shtesë.

ANEKSI NR. 4

RREGULLORE
"PËR ETIKETIMIN ENERGJETIK TË KALDAJAVE ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË DHE SISTEMET E PËRBËRA NGA KALDAJË ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË, NGROHËS SHTESË, TERMOSTAT DHE SISTEM DIELLOR PËR NGROHJEN E UJIT"[1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin e energjisë dhe dhënien e informacionit plotësues të produktit për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë me një fuqi termike të vlerësuar deri në 70 kW dhe sistemet e përbëra të kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë me fuqi termike nominale deri në 70 kW, pajisje ngrohëse shtesë, kontrolle të temperaturës dhe pajisje diellore.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
   a) Kaldajat që prodhojnë nxehtësi vetëm për qëllim të sigurimit të ujit të nxehtë të pijshëm ose sanitar;
   b) Kaldajat për ngrohjen dhe shpërndarjen e lëndëve të gazta të transmetimit të nxehtësisë si avulli ose ajri;
   c) Kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë me bashkëprodhim me kapacitet maksimal elektrik prej 50 kW ose më shumë;
   ç) Kaldajat me biomasë jo-drusore.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "**Biomasa e drunjtë"** është biomasa me origjinë nga pemët dhe shkurret, duke përfshirë drurin në formën e trungut, drurin e copëtuar, drurin e ngjeshur në formën e peletit, drurin e ngjeshur në formën e briketave dhe tallashin;

1 Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2015/1187 e Komisionit, datë 27 prill 2015, për plotësimin e Direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë dhe sistemet e përbëra nga kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, termostat dhe sistem diellor për ngrohjen e ujit". Numri CELEX 02015R1187, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 21.07.2015, f. 43.

2. **"Biomasa jo-drusore"** është biomasa e ndryshme nga biomasa drusore, duke përfshirë kashtën, miskanthusin, kallamat, bërthamat, drithërat, bërthamat e ullirit, bërsitë e ullirit, dhe lëvozhgat e arrave;
3. **"Biomasa"** është fraksion i biodegradueshëm i produkteve, i mbetjeve dhe tepricave me origjinë biologjike nga bujqësia (duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore), pylltaria dhe industritë e lidhura me to duke përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe fraksionin e biodegradueshëm të mbetjeve industriale dhe bashkiake;
4. **"Biomasë tjetër drusore"** është biomasë drusore, përveç: drurit në formë trungu me përmbajtje lagështie prej 25 % ose më pak, drurit të copëtuar me një përmbajtje lagështie prej 15 % ose më të lartë, drurit të ngjeshur në formën e peletit ose briketave, ose tallashit me përmbajtje lagështire të barabartë ose më pak se 50 %;
5. **"Depozita e ruajtjes së ujit të ngrohtë diellor"** është një depozitë që shërben për ruajtjen e ujit të ngrohtë që ruan energjinë e nxehtësisë të prodhuar nga një ose më shumë kolektorë diellorë;
6. **"Depozita e ruajtjes së ujit të ngrohtë"** është një enë që shërben për ruajtjen e ujit të ngrohtë me qëllim ngrohjen e ujit ose të hapësirës, duke përfshirë çdo aditiv, i cili nuk është i pajisur me ndonjë prodhues nxehtësie, përveç ndoshta të një ose më shumë ngrohësve me zhytje si sistem rezervë;
7. **"Efiçenca e dobishme"** ose "η"është raporti i nxehtësisë së dobishme në dalje dhe totalit të energjisë në hyrje të një kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë, ku totali i energjisë në hyrje shprehet në terma *GCV* ose në terma të energjisë përfundimtare të shumëzuar me *CC*;
8. **"Efiçenca elektrike"** ose "η_{el}" është raporti i energjisë elektrike në dalje me totalin e energjisë në hyrje e një kaldajë me bashkëgjenerim me lëndë djegëse të ngurtë, ku totali i energjisë në hyrje shprehet në terma *GCV* ose në terma të energjisë përfundimtare shumëzuar me *CC*;
9. **"Efiçenca sezonale e energjisë ngrohjes hapësirës"** ose "η_s" është raporti midis kërkesës për ngrohje të hapësirës për një sezon të caktuar ngrohjeje, të furnizuar nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë dhe konsumit vjetor të energjisë që kërkohet për të plotësuar këtë kërkesë, e shprehur në përqindje;
10. **"Efiçenca sezonale e energjisë së ngrohjes së hapësirës në modalitetin aktiv"** ose "η_{son}" është si më poshtë vijon:

    a) për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje automatike, një mesatare e ponderuar e eficencës së dobishme të prodhimit nominal të nxehtësisë në dalje dhe efiçencës së dobishëm të 30% të prodhimit nominal të nxehtësisë;

    b) për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje manuale që mund të përdoren në 50% të prodhimit nominal të nxehtësisë në modalitetin e vazhdueshëm, një mesatare të ponderuar e eficencës së dobishme të prodhimit nominal të nxehtësisë në dalje dhe e efiçencës së dobishëm në nivelin 50% të prodhimit nominal të nxehtësisë;

c) për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje manuale që nuk mund të përdoren në 50 % ose më pak të prodhimit nominal të nxehtësisë në modalitetin e vazhdueshëm, efiçenca e dobishme e prodhimit nominal të nxehtësisë;

ç) për kaldajat me funksion të dyfishtë me lëndë djegëse të ngurta, rendimenti i dobishëm e prodhimit nominal të nxehtësisë;

11. **"Ekran i ndërlidhur"** është ndërfaqja vizuale ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrotullim të mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi një imazh ose grup tjetër të dhënash;
12. **"Ekran me prekje"** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si p.sh., ai i një kompjuteri tablet, një kompjuter me ekran ose një telefon inteligjent;
13. **"Skeda informative e kaldajës"** është skeda e informative e produktit që kërkohet nga Kreun III(1)(c) të kësaj rregullore për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë, ndërkohë që për kaldajat që nuk janë kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë është dokumenti i produktit i siç parashikohet në Kreun III, pika 1(b), të Aneksit Nr. 5 bashkëlidhur këtij vendimi;
14. **"Skeda informative e kontrollit të temperaturës"** nënkupton skedën informative të produktit që kërkohet të ofrohet për kontrollet e temperaturës sipas Kreut III, pika 3 (a), të Aneksit Nr. 5 bashkëlidhur këtij vendimi;
15. **"Skeda informative e pajisjes diellore"** nënkupton skedë informative të produktit që kërkohet të ofrohet për sistemet diellore sipas Kreut III, pika 4 (a), të Aneksit Nr. 5 bashkëlidhur këtij vendimi;
16. **"Skeda informative e pompës së nxehtësisë"** nënkupton skedën informative e produktit që kërkohet të ofrohet për pompat e nxehtësisë sipas Kreut III, pika 1(b), të Aneksit Nr. 5 bashkëlidhur këtij vendimi;
17. **"Gjeneruesi i nxehtësisë me lëndë djegëse të ngurtë"** është pjesa e një kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë që prodhon nxehtësi përmes djegies së lëndëve djegëse të ngurta;
18. **"Identifikues i modelit"** është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model specifik që përfshin një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë ose një paketë të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare, me të njëjtin emër të furnizuesit ose me të njëjtin emër të shitësit;
19. "**Kaldajë e kombinuar"** është një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë projektuar që gjithashtu të sigurojë nxehtësi në shpërndarjen e ujë të ngrohtë të pijshëm ose sanitar në nivele të caktuara temperature, sasi dhe ritëm të rrjedhjes gjatë intervalesh të caktuara, dhe është i lidhur me një furnizim të jashtëm të ujit të pijshëm ose sanitar.
20. **"Kaldaja me biomasë jo drusore"** është një kaldajë me biomasë që përdor biomasë jo drusore si lëndë djegëse të preferuar dhe për të cilën biomasa drusore, lënda djegëse fosile ose një përzierje e biomasës dhe lëndëve djegëse fosile nuk renditen midis lëndëve djegëse të tjera të përshtatshme
21. **"Kaldaja me biomasë"** është një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë që përdor biomasën si lëndë djegëse të preferuar;

22. **"Kaldaja me kondensim"** është një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, në të cilën, në kushte normale funksionimi dhe në temperatura të caktuara të ujit të punës, avulli i ujit është pjesërisht i kondensuar në produktet e djegies, me qëllim që nxehtësia latente e këtij avulli të ujit të përdoret për qëllime ngrohjeje;
23. **"Kaldaja me lëndë djegëse fosile"** është një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë që ka lëndë djegëse fosile ose një përzierje të biomasës dhe lëndës djegëse fosile si lëndë djegëse të preferuar
24. **"Kaldajë e kombinuar me lëndë djegëse të ngurtë bashkëgjeneruese"** është një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, e aftë për të prodhuar nxehtësi dhe energji elektrike njëkohësisht;
25. **"Kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë"** është një pajisje që ka një ose më shumë gjenerues të nxehtësisë me lëndë djegëse të ngurtë që siguron ngrohje në një sistem ngrohjeje qendrore me bazë uji, në mënyrë që të arrijë dhe të mbajë në një nivel të dëshiruar temperaturën e brendshme të një ose disa hapësirave të mbyllura, me një humbje të nxehtësisë në mjedisin rrethues prej jo më shumë se 6% të nxehtësisë së vlerësuar në dalje;
26. **"Karburant tjetër i përshtatshëm"** është një lëndë djegëse e ngurtë, përveç lëndës djegëse të preferuar, e cila mund të përdoret në kaldajën me lëndë djegëse të ngurtë sipas udhëzimeve të furnizuesit dhe përfshin çdo lëndë djegëse që përmendet në manualin e udhëzimeve për instaluesit dhe përdoruesit përfundimtarë, dhe që ka akses falas në faqet e internetit të furnizuesve, në materialet teknike promovuese dhe në reklama;
27. **"Kërkesa për energji elektrike në prodhimin maksimal të nxehtësisë"** ose "el_{max}" është konsumi i energjisë elektrike i kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë në fuqinë nominale të nxehtësisë, i shprehur në kW, duke përjashtuar konsumin e energjisë elektrike nga një ngrohës rezervë dhe nga pajisjet dytësore të përfshira në reduktimin e emetimeve;
28. **"Kërkesa për energji elektrike në prodhimin minimal të nxehtësisë"** ose "el_{min}" është konsumi i energjisë elektrike të kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë në fuqinë nominale të nxehtësisë, i shprehur në kW, duke përjashtuar konsumin e energjisë elektrike nga një ngrohës ndihmës dhe nga pajisjet e integruara për reduktimin sekondar të emetimeve;
29. **"Koeficienti i konvertimit"** ose " ***CC*** "është koeficienti që pasqyron eficencën mesatare të vlerësuar të gjenerimit prej 40% ku vlera e koeficientit të konvertimit është $CC = 2{,}5$;
30. **"Kolektor diellor"** është një pajisje e projektuar për të thithur rrezatim global diellor dhe për të transmetuar energjinë e nxehtësisë së prodhuar tek një masë të lëngët që kalon përmes tij;
31. **"Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë"** ose " P_{SB}" është konsumi i energjisë së një kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë në modalitetin e gatishmërisë, duke përjashtuar pajisjet dytësore të reduktimit të emetimeve, i shprehur në kW;

32. **"Kontrolli i temperaturës"** është pajisja që ndërlidhet me përdoruesin fundor për sa i takon vlerave dhe kohës së temperaturës së dëshiruar të brendshme, dhe komunikon të dhënat përkatëse tek një ndërlidhje e kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë, siç është njësia qendrore e përpunimit, duke ndihmuar kështu në rregullimin temperaturës(ve) së brendshme të ambientit;
33. **"Lëndë djegëse e ngurtë"** është një lëndë djegëse që është në gjendje të ngurtë në temperatura normale të brendshme, duke përfshirë biomasën e ngurtë dhe lëndën djegëse fosile të ngurtë;
34. **"Lëndë djegëse e preferuar"** është lënda djegëse e vetme e ngurtë, i cili preferohet të përdoret për kaldajën sipas udhëzimeve të furnizuesit;
35. **"Lëndë djegëse fosile tjetër"** është lënda djegëse fosile, përveç qymyrit bituminoz, qymyrit të murrmë (përfshirë briketat), koksit, antracitit ose briketave të lëndëve djegëse fosile të përziera
36. **"Lëndë djegëse fosile"** është lënda djegëse që është e ndryshme nga biomasa, që përfshin antracitin, qymyrin kaf, koksin, qymyrin bituminoz; gjithashtu, përfshin edhe torfën për qëllimet e kësaj rregullore;
37. **"Mekanizmi i shfaqjes"** është çdo ekran, duke përfshirë ekranin me prekje, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;
38. **"Modaliteti i gatishmërisë"** është gjendja ku pajisja është e lidhur me burimin e energjisë elektrike, varet nga energjia e sjellë nga burimi i energjisë elektrike për të funksionuar sipas destinacionit dhe ofron vetëm funksionin e riaktivizimit, ose funksionin e riaktivizimit dhe vetëm një tregues të funksionit të aktivizuar të riaktivizimit, dhe /ose informacion ose shfaqjen e statusit që mund të vazhdojë për një kohë të pacaktuar;
39. **"Modeli i barasvlershëm"** është një model të vendosur në treg me të njëjtat parametra teknikë të përcaktuar në tabelën 4 të pikës 1 të Shtojcës IV, si një model tjetër i vendosur në treg nga i njëjti furnizues;
40. **"Ngarkesa e pjesshme e aplikueshme"** përdoret për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje automatike, ku funksionimi është në nivelin 30% të prodhimit nominal të nxehtësisë dhe për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje manuale që mund të përdoren me 50% të prodhimit nominal të nxehtësisë, ku funksionimi është në nivelin e 50% të prodhimit nominal të nxehtësisë;
41. **"Ngrohës plotësuese"** është një kaldajë dytësore ose pompë nxehtësie me karakteristikat e mëposhtme: me fuqi të vlerësuar termike ≤ 70 kW, paketa ngrohësi hapësire ≤ 70 kW, kontroll temperature dhe pajisje diellore, si dhe paketa ngrohësi të kombinuar ≤70 kW, kontroll temperature dhe pajisje diellore(*) ose një kaldajë dytësor me lëndë djegëse të ngurtë, i cili prodhon nxehtësi shtesë kur kërkesa për nxehtësi është më e madhe se fuqia e vlerësuar termike e kaldajës parësor me lëndë djegëse të ngurtë;
42. **"Ngrohës rezervë"** është një element rezistence elektrike me efekt Xhaul që prodhon nxehtësi vetëm për të parandaluar ngrirjen e kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë ose të

sistemit të ngrohjes qendrore me bazë uji ose kur furnizimi i burimit të jashtëm të nxehtësisë ndërpritet (duke përfshirë ndërprerjen gjatë periudhave të mirëmbajtjes) ose kur ndërpreja shkaktohet nga defekte;

43. **"Ngrohës rezervë i zhytur"** është një ngrohës me rezistencë elektrike sipas efektit Xhaul që është pjesë e një depozite të ruajtjes së ujit të ngrohtë dhe gjeneron nxehtësi vetëm kur furnizimi nga burimi i jashtëm i nxehtësisë është ndërprerë (përfshirë gjatë periudhave të mirëmbajtjes) ose është jashtë funksionit, ose që është pjesë e një depozite diellore për ruajtjen e ujit të ngrohtë dhe siguron nxehtësi kur burimi i nxehtësisë diellore nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nivelet e kërkuara të funksionimit;
44. **"Pajisje diellore "** është një sistem vetëm diellor, një kolektor diellor, një depozitë diellore për ruajtjen e ujit të ngrohtë ose një pompë në unazën e kolektorit, të cilat vendosen në treg veçmas
45. **"Përmbajtja e lagështirës"** është masa e ujit në lëndë djegëse në raport me masën totale të lëndës djegëse i cili përdoret në kaldaja me lëndë djegëse të ngurta;
46. **"Prodhimi i dobishëm i nxehtësisë"** ose **"*P*"** është nxehtësia në dalje në një kaldajeje me lëndë djegëse të ngurtë që transmetohet te zhvendosësi i nxehtësisë, i shprehur në kW;
47. **"Prodhimi nominal i nxehtësisë"** ose **"P_r"** është prodhimi i deklaruar i nxehtësisë së një kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë kur siguron ngrohjen e hapësirave të mbyllura me lëndeën djegëse të preferuar, të shprehur në kW;
48. **"Sistem i përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohësa shtesë, kontrolle të temperature dhe pajisje diellore"** është një sistem që i ofrohet përdoruesit fundor, i cili përmban një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë të kombinuar me një ose më shumë ngrohësa shtesë, një ose më shumë kontrolle të temperaturës ose një ose më shumë pajisje diellore;
49. **"Sistem vetëm diellor"** është një pajisje që ka një ose më shumë kolektorë diellorë dhe depozita diellore për ruajtjen e ujit të ngrohtë dhe ndoshta pompë në unazën e kolektorit dhe pjesë të tjera, e cila vendoset në treg si një njësi dhe nuk është e pajisur me asnjë gjenerues nxehtësie me përjashtim të një ose më shumë ngrohësve reserve të zhytur;
50. **"Sistemi i ngrohjes qendrore me bazë ujin"** është një sistem që përdor ujin si një mjedis për transmetimin e nxehtësisë për ta shpërndarë nxehtësinë e prodhuar nga qendra tek pajisjet që emetojnë nxehtësi për ngrohjen e hapësirave të mbyllura brenda ndërtesave ose pjesëve të tyre, duke përfshirë rrjetet e ngrohjes në bllok ose të ngrohjes qendrore;
51. **"Tekst alternativ"** është teksti që ofrohet si një alternativë për një informacion grafik, i cili lejon që informacioni të paraqitet në formë jo-grafike, kur pajisjet shfaqëse nuk mund të përmbajnë grafikë, ose si një ndihmesë për qasje të tilla si inputet për aplikacione të sintezës zanore;
52. **"Vlera kalorifike bruto pa lagështirë"** ose **"GCV_{mf}"**
është sasia totale e nxehtësisë që çlirohet nga një njësi e sasisë së lëndës djegëse që është e tharë nga lagështia natyrale, kur digjet plotësisht me oksigjen dhe kur produktet

e djegies kthehen në temperaturën e ambientit; kjo sasi përfshin nxehtësinë e kondensimit të avullit të ujit të krijuar nga djegia e hidrogjenit që mund përmbaj lënda djegëse;

53. **"Vlera kalorifike bruto"** ose **"*GCV* "**është sasia në total e nxehtësisë që çlirohet nga një njësi e sasisë së lëndës djegëse që ka përmbajtjen e duhur të lagështisë, kur digjet plotësisht me oksigjen dhe kur produktet e djegies kthehen në temperaturën e ambientit; kjo sasi përfshin nxehtësinë e kondensimit të avullit të ujit të krijuar nga djegia e hidrogjenit që përmban lënda djegëse;

III. DETYRIMET E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit që vendosin në treg kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë ose i vënë ato në shërbim, duke përfshirë ato të integruara në sistemet e përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontrollet e temperaturës dhe pajisjet diellore, sigurojnë që:
   a) Çdo kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë pajiset me një etiketë të printuar në formatin e përcaktuar në Pikën 1.2 të Shtojcës II që përmban informacionin e përcaktuar po aty dhe që është në përputhje me klasat e eficencës së energjisë të përcaktuara në Shtojcën I;
   b) Tregtarëve u vihet në dispozicion për çdo model kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë një etiketë elektronike në formatin e përcaktuar në Pikën 1.2 të Shtojcës II që përmban informacionin e përcaktuar po aty dhe që është në përputhje me klasat e eficencës së energjisë të përcaktuara në Shtojcën I.
2. Furnizuesit që vendosin në treg ose vënë në shërbim sisteme të përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontrolle të temperaturës dhe pajisje diellore, duhet të sigurojnë që:
   a) çdo sistem i përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontrolle të temperaturës dhe pajisje diellore, shoqërohet me një etiketë të printuar në formatin e përcaktuar në pikën 2 të Shtojcës II që përmban informacionin e përcaktuar, dhe është në përputhje me klasat e eficencës së energjisë të përcaktuara në Shtojcën I;
   b) për çdo model që përfshin një sistem të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontrolle të temperaturës dhe pajisje diellore, shitësve u vihet në dispozicion një etiketë elektronike në formatin e përcaktuar në pikën 2 të Shtojcës II që përmban informacionin e dhënë po aty, dhe është në përputhje me klasat e eficencës së energjisë të përcaktuara në Shtojcën I;
   c) çdo sistem i përbërë nga nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontrolle të temperaturës dhe pajisje diellore, shoqërohet me një skedë informative produkti, sipas pikën 2 të Shtojcës III;
   ç) çdo model që përfshin një sistem të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore, shitësve u vihet

në dispozicion skeda informative elektronike e produktit, sipas pikës 2 të Shtojcës III;

d) me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut vihet në dispozicion dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës IV;

dh) çdo reklamë që lidhet me një model specifik, i cili përfshin një sistem të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore, përmban klasën e efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin;

e) çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik që përfshin një sistem të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore që përshkruan parametrat e tij specifik teknik, përfshin një referencë për klasën e eficencës së energjisë për atë model.

IV. DETYRIMET E TREGTARËVE

1. Tregtarët sigurojnë që:
   a) Çdo kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë mban, në pikën e shitjes, etiketën e dhënë nga furnitorët sipas krerëve III(1) ose III(2) të vendosur në pjesën e jashtme të pjesës së përparme të kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë, me qëllim që të jetë e dukshme në mënyrë të qartë;
   b) Kur përdoruesi përfundimtar nuk mund të pritet të shohë produktin e shfaqur, kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë të ofruara për shitje, me qira ose qira-blerje tregtohen me informacionin e dhënë nga furnitorët sipas pikën 1 të Shtojcës V, përveç rasteve kur oferta është bërë përmes internetit, rast në të cilin të zbatohen dispozitat e dhëna në Shtojcën VI;
   c) Çdo reklamë për një model specifik kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, përfshin një referencë për klasën e eficencës së energjisë së atij modeli;
   ç) Çdo material teknik promovues në lidhje me një model të veçantë kaldaje me karburant të ngurtë, i cili përshkruan parametrat e tij specifikë teknik, përfshin një referencë për klasën e eficencës së energjisë së atij modeli.
2. Tregtarët e sistemeve të përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore sigurojnë që:
   a) çdo ofertë për një sistem specifik përfshin klasën e eficencës së energjisë për atë sistem, duke shfaqur në sistem etiketën e dhënë nga furnizuesi sipas kreut III (3)(a) dhe skedën informative të produktit të ofruar nga furnizuesi sipas kreut III (3)(c), e plotësuar me karakteristikat e këtij sistemi siç kërkohet;
   b) kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, sistemet e përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore të ofruara për shitje ose me qira, tregtohen me informacionin e dhënë sipas

pikën 2 të Shtojcës V, përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, rast në të cilin zbatohen dispozitat e dhëna në Shtojcën VI;

c) çdo reklamë për një model specifik të një sistemi të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe modele të pajisjeve diellore, përmban klasën e efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin

ç) çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik të një sistemi të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore, që përshkruan parametrat e tij specifik teknik, përmban një referencë për klasën e eficencës së energjisë për atë model.

V. METODAT E MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni që jepet në përputhje me krerët III dhe IV merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes., të përcaktuara në Shtojcën VII. Indeksi i eficencës së energjisë llogaritet siç përcaktohet në Shtojcën VIII.

VI. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën IX të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I

Klasat e eficencës së energjisë

Klasa e eficencës së energjisë së një kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë përcaktohet në bazë të indeksit të saj të eficencës së energjisë siç përcaktohet në Tabelën 1.
Indeksi i efiçencës së energjisë së një kaldaje me lëndë djegëse të ngurtë llogaritet sipas Shtojcës VIII.

Tabela 1

Klasat e eficencës së energjisë së kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë

Klasa e eficencës së energjisë	Indeksi i eficencës së energjisë (*EEI*)
A^{+++}	$EEI \geq 150$
A^{++}	$125 \leq EEI < 150$
A^{+}	$98 \leq EEI < 125$
A	$90 \leq EEI < 98$
B	$82 \leq EEI < 90$
C	$75 \leq EEI < 82$
D	$36 \leq EEI < 75$
E	$34 \leq EEI < 36$
F	$30 \leq EEI < 34$
G	$EEI < 30$

SHTOJCA II
Etiketa

1. KALDAJA ME LËNDË DJEGËSE TE NGURTË

1.2 **Etiketa 2**



I, II

III

IV

V

VI, VII

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1(a) të kësaj Shtojce.
(b) Aspektet e projektimit të etiketës për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë do të jenë në përputhje me pikën 3 të kësaj Shtojce. Në mënyrë përjashtimore, nëse një model zotëron "Ecoetiketë", një kopje e kësaj të fundit mund të shtohet.

2. SISTEMET E PËRBËRA NGA NJË KALDAJË ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË, NGROHËSA SHTESË, KONTROLLE TEMPERATURE DHE PAJISJE DIELLORE.

Etiketa e sistemeve të përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore në klasat e eficencës së energjisë nga A^{+++} deri tek G-ja



(a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i shitësit ose furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit(ve) të shitësit ose të furnitorit;

III. Funksioni i ngrohjes së hapësirës;

IV. Klasa e eficencës së energjisë së kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë, e përcaktuar sipas Shtojcës I;

V. Tregues nëse kolektori diellor, rezervuari i ruajtjes së ujit të nxehtë, kontrolli i temperaturës ose ngrohësit shtesë mund të përfshihen në paketën e përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohësit shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore;

VI. Klasa e eficencës së energjisë e paketës së përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohësit shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore, të përcaktuara sipas pikës 2 të Shtojcës III; koka e shigjetës që përmban klasën e eficencës së energjisë së paketës së përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore vendosen në të njëjtën lartësi me majën e klasës përkatëse të eficencës së energjisë.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për sistemet e përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohësit shtesë, kontroll temperature dhe pajosje diellore janë sipas pikës 4 të kësaj Shtojce. Për sistemet e përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohësit shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore në klasat e eficencës së energjisë nga A^{+++} deri tek D-ja, mund të hiqen klasat nga E-ja deri tek G-ja në shkallën A^{+++} deri tek G-ja.

3. FORMATI I ETIKETËS PËR KALDAJAT ME LËNDËT DJEGËSE TË NGURTË ËSHTË SI MË POSHTË:



ku:

(a) Etiketa është, të paktën, 105 mm e gjerë dhe 200 mm e gjatë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj duhet të mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është i bardhë.

(c) Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, sipas shembullit në vijim: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % e zezë.

(ç) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶ **Shtrirja e kufirit të etiketës së BE-së:** 4 pt , ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat : X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë:** Ngjyra : X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 86 mm, lartësia: 17 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt , ngjyra : cian 100 %, gjatësia: 86 mm.

❺ **Funksioni i ngrohjes së hapësirës:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet.

❻**A ⁺⁺-G dhe A ⁺⁺⁺-D, përkatësisht:**

- **Shigjeta:** lartësia: 5 mm, hapësira: 1,3 mm, ngjyrat :
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e shtatë: 00-XX-00,
  - Klasa e tetë: 00-XX-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 14 pt, shkronja kapitale, të bardha, simbolet "+": me mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm;
- **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm, ngjyrat :
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 16 pt, shkronja kapitale, të bardha, simbolet "+": me mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm.

❼ **Klasa e eficencës së energjisë:**

- **Shigjeta:** gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 24 pt , shkronja kapitale, të bardha, simbolet "+": me mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm.

❽**Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë:**

- **Kufiri:** 2 pt — ngjyra : cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm,
- **Vlera "YZ":** shkronjat në formatin Bold Calibri 45 pt , 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 30 pt , 100 % në ngjyrë të zezë.

❾ **Funksioni i ngrohjes së ujit**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Kufiri:** 2 pt , ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❿ **Funksioni i energjisë elektrike:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,

- **Kufiri:** 2 pt , ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

⓫ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Vendimit:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

⓬ **Emri i furnizuesit ose marka tregtare.**

⓭ **Identifikuesi i modelit të furnizuesit:**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 86 × 12 mm.

4. FORMATI I ETIKETËS PËR SISTEMET E PËRBËRA NGA NJË KALDAJË ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË, NGROHËSA SHTESË, KONTROLLE TEMPERATURE DHE PAJISJE DIELLORE ËSHTË SI MË POSHTË:



ku:

(a) Etiketa është, së paku, 210 mm e gjerë dhe 297 mm e gjatë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është i bardhë.

(c) Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, dhe ndjekin shembullin në vijim: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % magenta, 100 % e verdhë, 0 % e zezë.

(ç) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶ **Vija e kufirit të etiketës BE:** 6 pt , ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat : X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë:** Ngjyra : X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 191 mm, lartësia: 37 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 2 pt , ngjyra : cian 100 %, gjatësia: 191 mm.

❺ **Funksioni i ngrohjes së hapësirës:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet.

❻**Kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- Klasa e eficencës së energjisë së kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë:
- **Shigjeta:** gjerësia: 24 mm, lartësia: 14 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 28 pt , shkronja të mëdha, të bardha, simbolet "+": me mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm,
- **Kufiri:** 3 pt , ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❼ **Sistemi i përbërë nga kolektorë diellorë, depozita për ruajtjen e ujit të ngrohtë, kontroll temperature dhe ngrohës shtesë:**

- **Piktogramet** siç përshkruhen,
- **Simboli "+":** shkronjat në formatin Calibri bold 50 pt, cian 100 %,
- **Kutitë:** gjerësia: 12 mm, lartësia: 12 mm, kufiri: 4 pt, cian 100 %,
- **Kufiri:** 3 pt, ngjyra : cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❽ **Një shkallë $^{+++}$-G me kufi:**

- **Shigjeta:** lartësia: 15 mm, hapësira: 3 mm, ngjyrat :
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e shtatë: 00-XX-00,
  - Nëse aplikohet, klasat e fundit: 00-XX-00,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 30 pt, shkronja kapitale, të bardha, simbolet "+": me mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm,
- **Kufiri:** 3 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❾ **Klasa e eficencës së energjisë për paketën e përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore:**

- **Shigjeta:** gjerësia: 33 mm, lartësia: 19 mm, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 40 pt, shkronja kapitale, të bardha, simbolet "+": me mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm.

⑩ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Vendimit:**
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 12 pt.

⑪ **Emri ose marka tregtare e shitësit ose furnizuesit.**

⑫ **Identifikuesi i modelit të shitësit ose furnizuesit:**
Emri i shitësit ose furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 191 × 19 mm.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Skeda informative e produktit

1. KALDAJA ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË

1.1. Informacioni në skedën e produktit të kaldajës me lëndë djegëse të ngurtë jepet në rendin e mëposhtëm dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që jepet me produktin:
(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b) Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

(c) Klasa e eficencës së energjisë së modelit, e përcaktuar sipas Shtojcës I;

(ç) Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë në kW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(d) Indeksi i eficencës së energjisë, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe të llogaritur sipas Shtojcës VIII;

(dh) Eficenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur sipas Shtojcës VII;

(e) Çdo masë paraprake specifike që merret kur kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë montohet, instalohet ose mirëmbahet;

(ë) Në rastin e kaldajave me bashkëprodhim me lëndë djegëse të ngurtë, eficenca elektrike në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
1.2. Një skedë e produkti mund të mbulojë një numër modelesh kaldajash me lëndë djegëse të ngurtë të furnizuar nga i njëjti furnizues.
1.3. Informacioni i përfshirë në skedën e produktit mund të jepet në formën e një kopje të etiketës, me ngjyra ose bardh e zi. Kur ndodh kjo, jepet gjithashtu edhe informacioni i renditur në pikën 1.1 që nuk është shfaqur tashmë në etiketë.

2. SISTEMET E PËRBËRA NGA NJË KALDAJË ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË, NGROHËSA SHTESË, KONTROLLE TEMPERATURE DHE PAJISJE DIELLORE

Skeda informative e sistemeve të përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore përmban informacionin e përcaktuar në Figurën 1 ose Figurën 2, sipas rastit, për vlerësimin e indeksit të eficencës së energjisë së paketës së ofruar, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:
(a) **I**: Vlera e indeksit të eficencës së energjisë së kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë;

(b) **II**: Faktori i vlerësimit të fuqisë së nxehtësisë së kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë dhe ngrohësve shtesë të një pakete siç përcaktohet në tabelat 2 dhe 3 të kësaj Shtojce, sipas rastit;
(c) **III**: Vlera e shprehjes matematikore: 294 /(11 · Pr), ku Pr i referohet kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë;
(ç) **IV**: Vlera e shprehjes matematikore 115/(11 · Pr), ku Pr i referohet kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë.

Tabela 2

Vlerësimi i kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë dhe ngrohës shtesë, për qëllimet e figurës 1 të kësaj Shtojce(1)

Psup /(*Pr* + *Psup*) (*)	II, paketë pa depozitë uji të ngrohtë	II, paketë me depozitë uji të ngrohtë
0	0	0
0,1	0,30	0,37
0,2	0,55	0,70
0,3	0,75	0,85
0,4	0,85	0,94
0,5	0,95	0,98
0,6	0,98	1,00
≥ 0,7	1,00	1,00
(*) *Pr* i referohet kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë.		

Tabela 3

Vlerësimi i kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë me bashkëprodhim dhe ngrohës shtesë, për qëllimet e figurës 2 të kësaj Shtojce(1)

Pr /(*Pr* + *Psup*) (*)	II, paketë pa depozitë uji të ngrohtë	II, paketë me depozitë uji të ngrohtë
0	1,00	1,00

0,1	0,70	0,63
0,2	0,45	0,30
0,3	0,25	0,15
0,4	0,15	0,06
0,5	0,05	0,02
0,6	0,02	0
≥ 0,7	0	0
(*) Pr i referohet kaldajës kryesore me lëndë djegëse të ngurtë.		

(1) Vlerat e ndërmjetme janë llogaritur bazuar në interpolimin linear ndërmjet dy vlerave fqinje.

Figura 1

Për kaldaja kryesore me lëndë djegëse të ngurtë, informacioni që duhet të jepet në skedën e produktit për një sistem të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore, duke treguar indeksin e eficencës së energjisë së sistemit të ofruar



Efiçenca energjisë së paketës së produkteve paraqitur në këtë skedë informative mund të mos përputhet me efiçencën e energjisë aktuale pas instalimit në godinë, pasi kjo efiçencë ndikohet nga faktorët e tjerë si humbja e nxehtësisë në sistemin e shpërndarjes dhe dimensionet e produktit në raport me dimensionet e godinës dhe karakteristikat.

Figura 2

Për kaldaja kryesore me bashkëprodhim me lëndë djegëse të ngurtë, informacioni që duhet të jepet në fletën e produktit për një sistemit të përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore, duke treguar indeksin e eficencës së energjisë së sistemit të ofruar.



Efiçenca energjisë së paketës së produkteve paraqitur në këtë skedë informative mund të mos përputhet me efiçencën e energjisë aktuale pas instalimit në godinë, pasi kjo efiçencë ndikohet nga faktorët tjerë si humbja e nxehtësisë në systemin e shpërndarjes dhe dimensionet e produktit në mardhënie me diemsionet e godinës dhe karakteristikat.

SHTOJCA IV
Dokumentacioni teknik

1. KALDAJA ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË

Për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë, dokumentacioni teknik i përmendur në kreun III(1)(e) përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) Identifikuesin e modelit;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(ç) Kur lënda djegëse e preferuar është biomasë tjetër drusore, biomasë jo drusore, lëndë djegëse tjetër fosile ose përzierje tjetër e biomasës dhe lëndëve djegëse fosile siç referohet në tabelën 4, jepet një përshkrim i lëndës djegëse të mjaftueshme për identifikimin e saj të qartë dhe standardin teknik ose specifikimin e lëndës djegëse, duke përfshirë përmbajtjen e matur të lagështirës dhe përmbajtjen e matur të hirit, dhe për lëndët djegëse të tjera fosile edhe përmbajtjen e matur të avullueshme të lëndë djegëse;

(d) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(dh) Emrin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(e) Informacionin e përfshirë në Tabelën 4, me parametrat e tij teknikë të matur dhe të llogaritur sipas Shtojcave VII dhe VIII;

(ë) Raportet e testeve të ndërmarra nga furnizuesit ose në emër të tyre, duke përfshirë emrin dhe adresën e organit që ka kryer testin;

(f) Çdo masë paraprake specifike që duhet të merret kur kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë montohet, instalohet ose mirëmbahet;

(g) Një listë e modeleve të barasvlershme, nëse është e aplikueshme.

Ky informacion mund të bashkëlidhet me dokumentacionin teknik siguruar në përputhje me masat percaktuar nga dispozitat ligjore të projektimit mjedisor (Ecodesign).

Tabela 4

Parametrat teknikë për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë dhe kaldajat me bashkëprodhim me lëndë djegëse të ngurta

Identifikuesi i modelit
Modaliteti i ndezjes: [Manual: kaldaja duhet të përdoret me një depozitë uji të ngrohtë me një vëllim prej të paktën x (*) litër /Automatik: rekomandohet që kaldaja të përdoret me një depozitë uji të ngrohtë me një vëllim prej të paktën x (**) litër]

Kaldaja e kondensimit: [po/jo]		
Kaldaja me bashkëprodhim me lëndë djegëse të ngurtë: [po/jo]	Kaldaja e kombinuar: [po/jo]	
Lënda djegëse	**Lënda djegëse i preferuar (vetëm një):**	**Lëndë djegëse të tjera të përshtatshme:**
Druri në formë trungu, përmbajtja e lagështirës ≤ 25 %	[po/jo]	[po/jo]
Dru i copëtuar, përmbajtja e lagështirës 15-35 %	[po/jo]	[po/jo]
Dru i copëtuar, përmbajtja e lagështirës > 35 %	[po/jo]	[po/jo]
Dru i ngjeshur në formë peleti ose briketash	[po/jo]	[po/jo]
Tallashi, përmbajtja e lagështirës ≤ 50 %	[po/jo]	[po/jo]
Biomasë tjetër drusore	[po/jo]	[po/jo]
Biomasa jo drusore	[po/jo]	[po/jo]
Qymyr bituminoz	[po/jo]	[po/jo]
Qymyri kafe (përfshirë briketat)	[po/jo]	[po/jo]
Koksi	[po/jo]	[po/jo]
Antraciti	[po/jo]	[po/jo]
Briketa të përziera të lëndëve djegëse fosile	[po/jo]	[po/jo]
Lëndë djegëse të tjera fosile	[po/jo]	[po/jo]

Biomasa e përzier (30-70 %) dhe briketat e lëndëve djegëse fosile					[po/jo]		[po/jo]	
Përzierje të tjera të biomasës dhe lëndëve djegëse fosile					[po/jo]		[po/jo]	
Karakteristikat kur punohet me lëndën djegëse të preferuar:								
Efikasiteti sezonal i energjisë për ngrohjen e hapësirës η_s [%]:								
Indeksi i eficencës së energjisë *EEI* :								
Artikulli	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**		**Artikulli**	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**
Prodhimi i nxehtësisë së dobishme					Efiçenca e dobishme			
Në prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë	P_n (***)	x, x	Kw		Në prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë	η_n	x, x	%
Në [30 %/50 %] të prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, nëse është e aplikueshme	P_{fg}	[x,x /NA]	kW		Në [30 %/50 %] të prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, nëse është e aplikueshme	η_f	[x,x / NA]	%
Për kaldaja me funksion të dyfishtë me lëndë djegëse të ngurtë: Eficenca elektrike					**Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse**			
					Në prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë	el_{max}	x, xxx	kW
Në prodhimin e	$\eta_{el,n}$	x, x	%		Në [30 %/50 %] të prodhimit të	el_{min}	[x,xxx / NA]	kW

vlerësuar të nxehtësisë					vlerësuar të nxehtësisë, nëse është e aplikueshme			
					E pajisjeve dytësore të përfshira në pakësimin e emetimeve, nëse është e aplikueshme		[x,xxx / NA]	kW
					Në modalitetin e gatishmërisë	P_{SB}	x, xxx	kW
Të dhënat e kontaktit	Emri dhe adresa e furnizuesit							

(*) Volumi i depozitës = 45 x P_{rk} x (1-2,7/P_r) ose 300 litra cila të jetë me e madhe, me P_r shprehur në kW
(**) Volumi i depozitës = 20 x P_r me P_r shprehur në Kw
(***) Për lëndën djegëse të preferuar P_n e barabartë me P_r

2. SISTEMET E PËRBËRA NGA NJË KALDAJË ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË, NGROHËS SHTESË, KONTROLL TEMPEATURE DHE PAJISJE DIELLORE.

Për sistemet e përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temeprature dhe pajisje diellore, dokumentacioni teknik i përmendur në kreun III (3)(e) përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) Një përshkrim të modelit që përfshin sistemin e përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore të mjaftueshëm për identifikimin e tij të qartë;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(ç) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(d) Emrin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

d) Parametrat teknikë:

h (1) Indeksi i eficencës së energjisë, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(2) parametrat teknikë të përcaktuar në pikën 1 të kësaj Shtojce dhe atëherë kur është e nevojëshme, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. NGROHËSIT E HAPËSIRËS

(a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) një përshkrim të modelit të ngrohësit të hapësirës i mjaftueshëm për identifikimin e tij të qartë;

(c) referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(ç) standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(d) identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(dh) parametrat teknikë:

- Për kaldajat e ngrohjes së hapësirës dhe ngrohësit e hapësirës me bashkëprodhim, parametrat teknikë të përcaktuar në Tabelën 7, të matur dhe të llogaritur në përputhje me Nënshtojcën e mëposhtme;
- Për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, parametrat teknikë të përcaktuar në Tabelën 8, të matur dhe të llogaritur në përputhje me Nënshtojcën e mëposhtme;

Tabela 7

Parametrat teknikë të kaldajave të ngrohjes së hapësirës, kaldajave të kombinuara të ngrohjes dhe të ngrohësve të hapësirës me bashkëprodhim

Model(et): [informacion që identifikon modelin(et) me të cilët lidhet informacioni]							
Kaldaja e kondensimit: [po/jo]							
Kaldaja me temperaturë të ulët (***) : [po/jo]							
Kaldaja B11: [po/jo]							
Ngrohës i hapësirës me bashkëprodhim: [po/jo]				Nëse po, i pajisur me një ngrohës shtesë: [po/jo]			
Ngrohës të kombinuar: [po/jo]							
Artikulli	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**	**Artikulli**	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**
Prodhimi I I vlerësuar i nxehtësisë	P_{rated}	x	kW	**Eficenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës**	η_s	x	%

Për kaldajat e ngrohjes së hapësirës dhe kaldajat e kombinuara të ngrohjes: Prodhimi i dobishëm i nxehtësisë				Për kaldajat e ngrohjes së hapësirës dhe kaldajat e kombinuara të ngrohjes: Eficenca e dobishme			
Në fuqinë e vlerësuar të nxehtësisë dhe regjimin e temperaturës së lartë (*)	P_4	x, x	kW	Në fuqinë e vlerësuar të nxehtësisë dhe regjimin e temperaturës së lartë (*)	η_4	x, x	%
Në 30% të prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë dhe regjimit të temperaturës së ulët (***)	P_1	x, x	kW	Në 30% të prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë dhe regjimit të temperaturës së ulët (***)	η_1	x, x	%
Për ngrohësit e hapësirës me bashkëprodhim: Prodhimi i dobishëm i nxehtësisë				Për ngrohësit e hapësirës me bashkëprodhim: Eficenca e dobishme			
Në fuqinë e vlerësuar të nxehtësisë së ngrohësit të hapësirës me bashkëprodhim me ngrohës shtesë të çaktivizuar	$P_{CHP100+Sup0}$	x, x	kW	Në fuqinë e vlerësuar të nxehtësisë së ngrohësit të hapësirës me bashkëprodhim me ngrohës shtesë të çaktivizuar	$\eta_{CHP100+Sup0}$	x, x	%
Në fuqinë e vlerësuar të nxehtësisë së ngrohësit të hapësirës me bashkëprodhim me ngrohës shtesë të aktivizuar	$P_{CHP100+Sup100}$	x, x	kW	Në fuqinë vlerësuar të nxehtësisë së ngrohësit të hapësirës me bashkëprodhim me ngrohës shtesë të aktivizuar	$\eta_{CHP100+Sup100}$	x, x	%

Për ngrohësit e hapësirës me bashkëprodhim: Eficenca elektrike					Ngrohësi plotësues			
Në fuqinë e vlerësuar të nxehtësisë së ngrohësit të hapësirës me bashkëprodhim me ngrohës shtesë të çaktivizuar	$\eta_{el,CHP100+Sup0}$	x, x	%		Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë	P_{sup}	x, x	kW
Në fuqinë e vlerësuar të nxehtësisë së ngrohësit të hapësirës me bashkëprodhim me ngrohës shtesë të aktivizuar	$\eta_{el,CHP100+Sup100}$	x, x	%		Lloji i energjisë			
Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse					Artikuj të tjerë			
Me ngarkesë të plotë	elmax	x, x	kW		Humbja termike në modalitetin e gatishmërisë	P_{stby}	x, x	kW
Me ngarkesë të pjesshme	*elmin*	x, x	kW		Konsumi i energjisë për ndezje	P_{ign}	x, x	kW
Në modalitetin e gatishmërisë	P_{SB}	x, xxx	kW		Konsumi vjetor i energjisë	Q_{HE}	x	kWh ose GJ
					Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda	L_{WA}	x	dB
Për ngrohësit e kombinuar:								

Profili i ngarkesës së deklaruar					**Eficenca e energjisë së ngrohjes së ujit**	η_{wh}	x	%
Konsumi ditor i energjisë elektrike	Q zgjedh	x, xxx	kWh		Konsumi ditor i lëndë djegëse	*Q lëndë djegëse*	x, xxx	kWh
Konsumi vjetor i energjisë elektrike	*AEC*	x	kWh		Konsumi vjetor i lëndë djegëse	*AFC*	x	GJ
Detajet e kontaktit	Emri dhe adresa e furnizuesit							

(*) Regjimi i temperaturës lartë nënkupton 60 °C temperaturën kthyese në hyrjen e ngrohësit dhe 80 °C temperatura ushqyese në dalje të ngrohësit.
(**) Temperaturë e ulët nënkupton 30 °C për kaldajat me kondensim, 37 °C për kaldajat e temperaturës ulët, dhe 50 °C temperature kthyese për ngrohësit e tjerë (në hyrjen e ngrohësit).

Tabela 8

Parametrat teknikë të ngrohësve të hapësirës me pompë nxehtësie dhe të ngrohësve të kombinuar me pompë nxehtësie

Model(et): [informacioni që identifikon modelin(et) me të cilët lidhet informacioni]
Pompë nxehtësie ajër-ujë: [po/jo]
Pompë nxehtësie ujë-ujë: [po/jo]
Pompë nxehtësie ujë nëntokësor-ujë: [po/jo]
Pompë nxehtësie për përdorim në temperaturë të ulët: [po/jo]
E pajisur me një ngrohës shtesë: [po/jo]
Ngrohës të kombinuar me pompë nxehtësie: [po/jo]
Parametrat deklarohen për përdorim në temperaturë mesatare, me përjashtim të pompave të nxehtësisë për temperaturë të ulët. Për pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët, parametrat deklarohen për përdorim në temperaturë të ulët.
Parametrat deklarohen për kushtet klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta.

Artikulli	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**	**Artikulli**	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**
Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë(*)	Prated	x	kW	**Eficenca e energjisë së ngrohjes**	η_s	x	%

Kapaciteti i deklaruar i ngrohjes së ngarkesës së pjesshme në temperaturën e brendshme 20 °C dhe temperaturën e jashtme Tj			
T_j = – 7 °C	*Pdh*	*x, x*	*kW*
T j = + 2 °C	*Pdh*	*x, x*	*kW*
T j = + 7 °C	*Pdh*	*x, x*	*kW*
T j = + 12 °C	*Pdh*	*x, x*	*kW*
T j = temperaturë bivalente	*Pdh*	*x, x*	*kW*
T j = temperatura kufi e funksionimit	*Pdh*	*x, x*	*kW*
Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: T j = – 15 °C (nëse TOL < – 20 °C)	*Pdh*	*x, x*	*kW*
Temperatura bivalente	*T biv*	*x*	*°C*

sezonale të hapësirës			
Koeficienti i deklaruar i performancës ose raporti i energjisë parësore së ngarkesës së pjesshme në temperaturën e brendshme 20 °C dhe temperaturën e jashtme T j			
T j = – 7 °C	*COPd ose PERd*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
T j = + 2 °C	*COPd ose PERd*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
T j = + 7 °C	*COPd ose PERd*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
T j = + 12 °C	*COPd ose PERd*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
T j = temperaturë dyvalente	*COPd ose PERd*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
T j = temperatura kufi e funksionimit	*COPd ose PERd*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: T j = – 15 °C (nëse TOL < – 20 °C)	*COPd ose PERd*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: Temperatura kufitare e funksionimit	*TOL*	*x*	*°C*

Kapaciteti i intervalit të ciklit për ngrohje	*Pcych*	*x, x*	*kW*		Eficenca e intervalit të ciklit	*COPcyc ose PERcyc*	*x, xx ose x, x*	*– ose %*
Koeficienti i humbjes së eficencës (4)	*Cdh*	*x, x*	-		Temperatura kufi e funksionimit të ujit të ngrohjes	*WTOL*	*x*	*°C*
Konsumi i energjisë në modalitetet që janë të ndryshme nga modaliteti aktiv					Ngrohës plotësues			
Modaliteti i fikur	*P OFF*	*x, xxx*	*kW*		Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë (**)	*Psup*	*x, x*	*kW*
Modaliteti i fikur i termostatit	*P TO*	*x, xxx*	*kW*					
Modaliteti i gatishmërisë	P_{SB}	*x, xxx*	*kW*		Lloji i energjisë			
Modaliteti i ngrohësit të karterit	P_{CK}	*x, xxx*	*kW*					
Artikuj të tjerë								
Kontrolli i kapacitetit	Fiks/i ndryshueshëm				Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: Norma e vlerësuar e fluksit të ajrit, jashtë	-	*x*	*m 3 / orë*
Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda/jashtë	L WA	x / x	dB		Për pompat e nxehtësisë ujë ose ujë nëntokësor-ujë: norma e vlerësuar e fluksit të ujit të kripur ose e ujit,	-	x	*m 3 / orë*
Konsumi vjetor i energjisë	Q_{HE}	*x*	*kWh ose GJ*					

					shkëmbyesi i jas htëm i nxehtësisë			

Për ngrohësin e kombinuar me pompë nxehtësie:

Profili i ngarkesës së deklaruar	x				**Eficenca e energjisë së ngrohjes së ujit**	η_{wh}	x	%
Konsumi ditor i energjisë elektrike	Q_{zgjedh}	x, xxx	kWh		Konsumi ditor i lëndës djegëse	$Q_{lëndë djegëse}$	x, xxx	kWh
Konsumi vjetor i energjisë elektrike	*AEC*	x	kWh		Konsumi vjetor i lëndë djegëse	*AFC*	x	GJ
Detajet e kontaktit	Emri dhe adresa e furnizuesit.							

(*) Për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësat e kombinuar me pompë nxehtësie, nxehtësia e vlerësuar në dalje P_{rated} është e barabartë ngarkesë e projektuar për ngrohje $P_{designh}$, dhe nxehtësia në dalje e vlerësuar e nje ngrohësi shtesë P_{sup} është e barabartë kapacitetin shtesë për ngrohje sup(Tj).

(**) Nëse Cdh nuk është përcaktuar nëpërmjet matjejes atëhere koefiçenti I parazgjedhur I degradimit është Cdh=0,9.

Nënshtojcë

Matjet dhe llogaritjet e parametrave

1. Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të respektimit të kërkesave të kësaj rregullore, matjet dhe llogaritjet bëhen duke përdorur standarde të harmonizuara, numrat e referencës së të cilave janë publikuar për këtë qëllim në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, ose duke përdorur të tjera metoda të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme që marrin parasysh metodat më të fundit përgjithësisht të njohura. Ato plotësojnë kushtet dhe parametrat teknikë të përcaktuar në pikat 2 deri në 6.

2. Kushtet e përgjithshme për matjet dhe llogaritjet

(a) Për qëllimet e matjeve të përcaktuara në pikat 3 deri në 7, temperatura e ambientit të brendshëm vendoset në 20 °C.

(b) Për qëllimet e llogaritjeve të përcaktuara në pikat 3 deri në 7, konsumi i energjisë elektrike shumëzohet me një koeficient konvertimi *CC* prej 2,5, përveç rasteve kur konsumi vjetor i energjisë elektrike shprehet në energjinë përfundimtare për përdoruesin fundor, siç përcaktohet në pikat. 3(b), 4(g), 5(e) dhe 6.

(c) Për ngrohësit e pajisur me ngrohës shtesë, matja dhe llogaritja e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, eficenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës, eficenca e energjisë së ngrohjes së ujit, niveli i fuqisë së zhurmës dhe emetimet e oksideve të azotit marrin parasysh ngrohësin plotësues.

(ç) Vlerat e deklaruara për prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë, eficenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës, eficenca e energjisë së ngrohjes së ujit, konsumi vjetor i energjisë dhe niveli i fuqisë së zhurmës rrumbullakosen në numrin e plotë më të afërt.

3. Eficenca sezonale e energjisë së ngrohjes së hapësirës dhe konsumi i kaldajave të ngrohjes së hapësirës, kaldajave të kombinuara dhe e ngrohësve të hapësirës me bashkëprodhim

(a) Eficenca sezonale e energjisë së ngrohjes së hapësirës η_s llogaritet si eficenca sezonale e energjisë së ngrohjes së hapësirës në modalitetin aktiv η_{son}, e korrigjuar nga kontributet që llogariten për kontrollet e temperaturës, konsumin energjisë elektrike ndihmëse, humbjen e nxehtësisë në modalitetin e gatishmërisë, konsumin e energjisë së aparatit të ndezjes (nëse përdoret) dhe, për ngrohësit e hapësirës me bashkëprodhim, e korrigjuar duke shtuar eficencën elektrike të shumëzuar me një koeficient konvertimi *CC* prej 2,5.

(b) Konsumi vjetor i energjisë Q_{HE} në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose në GJ në terma të *GCV*-së llogaritet si raport i kërkesës referuese vjetore për ngrohje dhe eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës.

4. Eficenca sezonale e energjisë së ngrohjes së hapësirës dhe konsumi i ngrohësve të hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësve të kombinuar me pompë nxehtësie

(a) Për përcaktimin e koeficientit të vlerësuar të performancës COP_{rated} ose për përcaktimin e raportit të vlerësuar të energjisë parësore PER_{rated}, ose për përcaktimin e nivelit të fuqisë së zhurmës, kushtet e funksionimit përbëhen nga kushtet standarde të klasifikimit të përcaktuara në Tabelën 9 dhe përdoret i njëjti kapacitet i deklaruar për ngrohje.

(b) Koeficienti i modalitetit aktiv të performancës $SCOP_{on}$ llogaritet, për kushtet klimatike mesatare, të ftohta dhe të ngrohta, në bazë të ngarkesës së pjesshme të ngrohjes $Ph(T_j)$, kapacitetit plotësues për ngrohjen $sup\ (T_j)$ (nëse përdoret), në bazë të koeficientit specifik të të performancës së periudhës së ngrohjes $COPbin\ (Tj)$ ose në bazë të raportit të energjisë parësore specifike për periudhën e ngrohjes $PERbin(T_j)$, i ponderuar me orët e periudhës së ngrohjes për të cilat zbatohen kushtet e periudhës së ngrohjes, nëpërmjet përdorimit të kushteve të mëposhtme:

- Kushtet referencë të projektimit të përcaktuara në Tabelën 10;
- Sezoni i referencës evropian i ngrohjes në kushtet klimatike mesatare, të ftohta dhe të ngrohta të përcaktuara në Tabelën 12;
- Efektet e çdo humbje të eficencës së energjisë, nëse përdoret, e shkaktuar nga cikli, në varësi të llojit të kontrollit të kapacitetit të ngrohjes.

(c) Kërkesa vjetore e referencës për ngrohje Q_H është ngarkesa e projektimit për ngrohjen e *Pdesignh* për kushte klimatike mesatare, të ftohta dhe të ngrohta, shumëzuar me orët të barasvlershme vjetore të modalitetit aktiv H_{HE} prej 2 066, 2 465 dhe 1 336 për kushtet klimatike, respektivisht, mesatare, të ftohta dhe të ngrohta.

(ç) Konsumi vjetor i energjisë Q_{HE} llogaritet si shuma e:

- Raportit të kërkesës vjetore të referencës për ngrohje Q_H dhe e koeficientit të modalitetit aktiv të performancës $SCOP_{on}$ ose e raportit të energjisë parësore të modalitetit aktiv $SPER_{on}$; dhe
- Konsumi i energjisë për modalitetin e fikur, modalitetin e fikur të termostatit, modalitetin e gatishmërisë dhe modalitetin e ngrohësit të karterit gjatë sezonit të ngrohjes

(d) Koeficienti sezonal i performancës *SCOP* ose raporti sezonal i energjisë parësore *SPER* llogaritet si raporti i kërkesës referencë vjetore për ngrohje Q_H dhe i konsumit vjetor të energjisë Q_{HE}.

(dh) Eficenca sezonale e energjisë së ngrohjes së hapësirës η_s llogaritet si koeficienti sezonal i performancës *SCOP* i pjesëtuar me koeficientin e konvertimit *CC* ose raportin sezonal të energjisë parësore *SPER*, korrigjuar nga kontributet që llogariten për kontrollet e temperaturës dhe, për ngrohësit e hapësirës të llojit ujë/ujë i kripur -ujë me pompë nxehtësie dhe ngrohësit e kombinuar me pompë nxehtësie, konsumi i energjisë elektrike i një ose më shumë pompave të ujit.

(e) Konsumi vjetor i energjisë Q_{HE} në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose GJ në terma të *GCV*-së llogaritet si raport i kërkesës vjetore të referencës për ngrohje Q_H dhe eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës η_s.

5. Eficenca e energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësve të kombinuar

Eficenca e energjisë së ngrohjes së ujit η_{wh} e një ngrohësi të kombinuar llogaritet si raport ndërmjet energjisë referencë Q_{ref} dhe energjisë së nevojshme për prodhimin e tij në kushtet e mëposhtme:

(a) Matjet kryhen duke përdorur profilet e ngarkesës të përcaktuara në Tabelën 15;

(b) Matjet kryhen duke përdorur një cikël matjeje 24-orësh si më poshtë

-00:00 deri në 06:59: pa shkarkim uji;

- Nga ora 07:00: shkarkim i ujit sipas profilit të ngarkesës së deklaruar;

- Nga përfundimi i shkarkimit të fundit të ujit deri në orën 24:00: pa shkarkim uji;

(c) Profili i deklaruar i ngarkesës është profili i ngarkesës maksimale ose profili i ngarkesës një nën profilin maksimal të ngarkesës;

(ç) Për ngrohësit e kombinuar me pompë nxehtësie, zbatohen kushtet e mëposhtme shtesë:

- Ngrohësit e kombinuar me pompë nxehtësie testohen sipas kushteve të përcaktuara në Tabelën 9;

- Ngrohësit e kombinuar me pompë nxehtësie që përdorin ajrin e shkarkimit të ventilimit si burim nxehtësie testohen sipas kushteve të përcaktuara në Tabelën 11;

(d) Konsumi vjetor i energjisë elektrike *AEC* në kWh në terma të energjisë përfundimtare llogaritet si konsumi ditor i energjisë elektrike Q_{elec} në kWh në terma të energjisë përfundimtare shumëzuar me 220;

(dh) Konsumi vjetor i lëndë djegëse *AFC* në GJ në terma *GCV-së* llogaritet si konsumi ditor i lëndës djegëse Q_{fuel} shumëzuar me 220.

6. Kushtet për matjet dhe llogaritjet e pajisjeve diellore

Kolektori diellor, depozita e ujit të ngrohte diellor dhe pompa në unazën e kolektorit (nëse përdoret) testohen veçmas. Kur kolektori diellor dhe depozita e ujit të ngrohte diellor nuk mund të testohen veçmas, ato testohen në kombinim me njëra tjetrën.Rezultatet përdoren për përcaktimin e humbjes termike S dhe llogaritjet e eficencës së kolektorit η_{col}, të kontributit vjetor të ngrohjes jo diellore Q_{nonsol} të profileve të ngarkesës M, L, XL dhe XXL në kushtet mesatare klimatike të përcaktuara në Tabelat 13 dhe 14, dhe të konsumit vjetor i energjisë elektrike ndihmëse Q_{aux} në kWh në terma të energjisë përfundimtare.

Tabela 9

Kushtet standarde të vlerësimit të ngrohësit të hapësirës me pompë nxehtësie dhe të ngrohësit të kombinuar me pompë nxehtësie

Burimi i nxehtësisë	Shkëmbyesi i jashtëm i nxehtësisë		Shkëmbyesi i brendshëm i nxehtësisë			
	Gjendja klimatike	Temperatura e ambientit në hyrje (ambient i lagësht).	Ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësit e kombinuar me pompë nxehtësie, përveç pompave të nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët		Pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët	
			Temperatura e hyrjes	Temperatura e daljes	Temperatura e hyrjes	Temperatura e daljes
Ajri i jashtëm	Mesatare	+ 7 °C (+ 6 °C)	+47 °C	+55 °C	+30 °C	+35 °C
	Më e ftohtë	+ 2 °C (+ 1 °C)				
	Më e ngrohtë	+ 14 °C (+ 13 °C)				
Ajri i shkarkimit	Të gjitha	+ 20 °C (+ 12 °C)				
		Temperatura e hyrjes / daljes				
Uji	Të gjitha	+ 10 °C / + 7 °C				
Ujë nëntokësor	Të gjitha	0 °C/– 3 °C				

Tabela 10

Kushtet referencë të projektimit për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësit e kombinuar me pompë nxehtësie, temperaturat e ajrit të ambientit (temperatura e ajrit të lagësht të ambientit tregohet në kllapa)

Gjendja klimatike	Temperatura e referencës së projektimit	Temperatura bivalente	Temperatura kufi e funksionimit
	Tdesignh	T_{biv}	*TOL*
Mesatare	– 10 (– 11) °C	Maksimale + 2 °C	Maksimale – 7 °C
Më të ftohtë	– 22 (– 23) °C	Maksimale – 7 °C	Maksimale – 15 °C
Më të ngrohtë	+ 2 (+ 1) °C	Maksimale + 7 °C	Maksimale + 2 °C

Tabela 11

Ajri i shkarkimit maksimal të ventilimit i disponueshëm [m^3/h], me lagështirë 5,5 g/m^3

Profili i ngarkesës së deklaruar	XXS	XS	S	M	L	XL	XXL
Ajri i shkarkimit maksimal të ventilimit i disponueshëm	109	128	128	159	190	870	1 021

Tabela 12

Sezoni evropian i referencës i ngrohjes në kushte klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohës të kombinuar me pompë nxehtësie

Periudha e ngrohjes j	T_j [°C]	Kushtet mesatare klimatike	Kushtet klimatike më të ftohta	Kushtet klimatike më të ngrohta
		H_j [h/annum]	H_j [h/annum]	H_j [h/annum]
1 deri në 8	–30 deri në –23	0	0	0
9	– 22	0	1	0
10	– 21	0	6	0
11	– 20	0	13	0
12	– 19	0	17	0
13	– 18	0	19	0
14	– 17	0	26	0
15	– 16	0	39	0
16	– 15	0	41	0
17	– 14	0	35	0
18	– 13	0	52	0
19	– 12	0	37	0
20	– 11	0	41	0
21	– 10	1	43	0
22	– 9	25	54	0
23	-8	23	90	0
24	–7	24	125	0
25	-6	27	169	0
26	-5	68	195	0

27	-4	91	278	0
28	-3	89	306	0
29	–2	165	454	0
30	– 1	173	385	0
31	0	240	490	0
32	1	280	533	0
33	2	320	380	3
34	3	357	228	22
35	4	356	261	63
36	5	303	279	63
37	6	330	229	175
38	7	326	269	162
39	8	348	233	259
40	9	335	230	360
41	10	315	243	428
42	11	215	191	430
43	12	169	146	503
44	13	151	150	444
45	14	105	97	384
46	15	74	61	294
Orët në total:		4 910	6 446	3 590

Tabela 13

Temperatura mesatare e ditës [°C]

	Janr	Shkurt	Mars	prill	Maj	Qersho	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Kushtet klimati	+2,8	+2,6	+7,4	+12,2	+16,3	+19,8	+21,0	+22,0	+17,0	+11,9	+5,6	+3,2

Tabela 14

Rrezatimi mesatar global diellor [W/m ^{2}]

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Kushtet	70	104	149	192	221	222	232	217	176	129	80	56

Tabela 15

Profilet e ngarkesës së ngrohjes së ujit e ngrohësve të kombinuar

h	**3XS**			**XXS**			**XS**			**S**			
	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	T_p
	kWh	l/min	°C	**kWh**	**l/min**	°C	**kWh**	l/min	°C	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**

07:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
07:05	**0,015**	2	25										
07:15	**0,015**	2	25										
07:26	**0,015**	**2**	25										
07:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25	**0,525**	3	35	**0,105**	3	25	
07:45													
08:01													
08:05													
08:15													
08:25													
08:30				**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
08:45													
09:00	**0,015**	2	**25**										
09:30	**0,015**	2	**25**	**0,105**	2	**25**				**0,105**	3	**25**	

ora 10:00													
10:30													
11:00													
11:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
11:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
12:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
12:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
12:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25	**0,525**	3	35	**0,315**	4	10	55
14:30	**0,015**	2	**25**										
15:00	**0,015**	2	**25**										
15:30	**0,015**	2	**25**										
16:00	**0,015**	2	25										
16:30													
17:00													

ora 18:00				**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
18:15				**0,105**	2	25				**0,105**	3	40	
18:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
ora 19:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
19:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
20:00				**0,105**	2	**25**							
20:30							**1,05**	3	**35**	**0,42**	4	**10**	**55**
20:45				**0,105**	2	**25**							
20:46													
21:00				**0,105**	2	**25**							
21:15	**0,015**	2	**25**	**0,105**	2	**25**							
21:30	**0,015**	2	**25**							**0,525**	5	**45**	
21:35	**0,015**	2	**25**	**0,105**	2	25							
21:45	**0,015**	2	**25**	**0,105**	2	**25**							

Q_{ref}	0,345	2100	2100	2100

Vazhdim Tabela 15

Profilet e ngarkesës për ngrohjen e ujit të ngrohësve të kombinuar

h	M				L				XL			
	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m
	kWh	**l/min**	**°C**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**
07:00	**0,105**	3	**25**		**0,105**	3	**25**		**0,105**	3	**25**	
07:05	**1,4**	6	**40**		**1,4**	6	**40**					
07:15									**1,82**	6	**40**	
07:26									**0,105**	3	25	
07:30	**0,105**	3	**25**		**0,105**	3	**25**					
07:45					**0,105**	3	**25**		**4,42**	**10**	**10**	**40**
08:01	**0,105**	3	**25**						**0,105**	3	25	
08:05					**3605**	10	10	40				
08:15	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	
08:25					**0,105**	3	25					
08:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
08:45	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
09:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	

09:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
ora 10:00									**0,105**	3	25	
10:30	**0,105**	3	10	40	**0,105**	3	10	40	**0,105**	3	10	40
11:00									**0,105**	3	25	
11:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
11:45	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
12:00												
12:30												
12:45	**0,315**	4	10	55	**0,315**	4	10	55	**0,735**	4	10	55
14:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
15:00									**0,105**	3	25	
15:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
16:00									**0,105**	3	25	
16:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
17:00									**0,105**	3	25	
ora 18:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
18:15	**0,105**	3	40		**0,105**	3	40		**0,105**	3	40	
18:30	**0,105**	3	40		**0,105**	3	40		**0,105**	3	40	
ora 19:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
19:30												
20:00												

20:30	**0,735**	4	10	55	**0,735**	4	10	55	**0,735**	4	10	55
20:45												
20:46									**4,42**	10	10	40
21:00					**3605**	10	10	40				
21:15	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	
21:30	**1,4**	6	40		**0,105**	3	25		**4,42**	10	10	40
21:35												
21:45												
Q_{ref}	5845				11655				19,07			

Vazhdim Tabela 15

Profilet e ngarkesës së ngrohjes së ujit e ngrohësve të kombinuar

H	XXL			
	Q_{tap}	f	T_m	T_p
	kWh	l/min	°C	°C
07:00	**0,105**	3	25	
07:05				
07:15	**1,82**	6	40	
07:26	**0,105**	3	25	
07:30				
07:45	**6,24**	16	10	40
08:01	**0,105**	3	25	
08:05				

08:15	**0,105**	3	25	
08:25				
08:30	**0,105**	3	25	
08:45	**0,105**	3	25	
09:00	**0,105**	3	25	
09:30	**0,105**	3	25	
ora 10:00	**0,105**	3	25	
10:30	**0,105**	3	10	40
11:00	**0,105**	3	25	
11:30	**0,105**	3	25	
11:45	**0,105**	3	25	
12:00				
12:30				
12:45	**0,735**	4	10	55
14:30	**0,105**	3	25	
15:00	**0,105**	3	25	
15:30	**0,105**	3	25	
16:00	**0,105**	3	25	
16:30	**0,105**	3	25	
17:00	**0,105**	3	25	
ora 18:00	**0,105**	3	25	
18:15	**0,105**	3	40	

18:30	**0,105**	3	40	
ora 19:00	**0,105**	3	25	
19:30				
20:00				
20:30	**0,735**	4	10	55
20:45				
20:46	**6,24**	16	10	40
21:00				
21:15	**0,105**	3	25	
21:30	**6,24**	16	10	40
21:35				
21:45				
Q_{ref}	**24,53**			

-për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie ku informacioni lidhur me një model specifik që përbëhet nga një kombinim i njësive të brendshme dhe të jashtme merret nga llogaritja në bazë të projektimit dhe/ose të ekstrapolimit nga kombinimet e tjera, nga detajet e këtyre llogaritjeve dhe/ose të ekstrapolimeve, dhe nga çdo test të kryer për të verifikuar saktësinë e llogaritjeve, duke përfshirë detajet e modelit matematik të llogaritjes së performancës së kombinimeve të tilla dhe detajet e matjet e marra për të verifikuar këtë model;

(g) Çdo masë paraprake specifike që merret kur ngrohësi i hapësirës montohet, instalohet ose mirëmbahet. ([1])

(1) Pika 1, Shtojca V, RREGULLORE E DELEGUAR E KOMISIONIT (BE) Nr. 811/2013 e datës 18 shkurt 2013 mbi "ETIKETIMI I ENERGJISË PËR NGROHËSIT E HAPËSIRËS, NGROHËSIT ME FUNKSION TË DYFISHTË, SISTEMET QË

PËRFSHIJNË NGROHËS HAPËSIRE, PAJISJE DIELLORE DHE KONTROLL TEMPERATURE, SI DHE SISTEMET QË PËRFSHIJNË NGROHËSIT ME FUNKSION TË DYFISHTË, PAJISJE DIELLORE DHE KONTROLL TEMPERATURE".

(3) parametrat teknik si më poshtë:

KONTROLLET E TEMPERATURËS

(a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b)një përshkrim të modelit të kontrollit të temperaturës i mjaftueshëm për identifikimin e tij të qartë;

(c)referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(ç) standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(d)identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(dh) parametrat teknikë:

- klasa e kontrollit të temperaturës;
-kontributi i kontrollit të temperaturës në eficencën e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në përqindje, i rrumbullakosur në një numër dhjetor;

(e) Çdo masë paraprake specifike që merret kur kontrolli i temperaturës montohet, instalohet ose mirëmbahet.

4. PAJISJET DIELLORE

(a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b)një përshkrim të modelit të pajisjes diellore i mjaftueshëm për identifikimin e tij të qartë;

(c)referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(ç) standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(d)Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(dh) parametrat teknikë (për pompat në unazën e kolektorit, nëse përdoret):

- Zona e hapjes së kolektorit A_{sol} në m^2, me dy shifra dhjetore;
- Eficenca e kolektorit η_{col} në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
- Klasa e eficencës së energjisë së depozitës së ujit të ngrohtë diellor, e përcaktuar në përputhje me pikën 3 të Aneksit II;
- Humbja termike S e depozitës diellore të ujit të ngrohtë në W, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
- Vëllimi i ruajtjes V i depozitës diellore të ujit të ngrohtë në litra dhe m^3;
- Kontributi vjetor i nxehtësisë jo diellore Q_{nonsol} në kWh në terma të energjisë parësore për energjinë elektrike dhe/ose në kWh në terma të *GCV*-së për lëndët djegëse, për profilet e ngarkesës M, L, XL dhe XXL në kushte mesatare klimatike, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;
- *Solpompa* e konsumit të energjisë së pompës në W, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
- Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë *solstandby* në W, deri në dy shifra dhjetore;

(g) Çdo masë paraprake specifike që merret kur pajisja diellore montohet, instalohet ose mirëmbahet.

(e) çdo masë paraprake specifike që duhet marrë kur montohet, instalohet ose mirëmbahet sistemi i përbërë nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore.

---

(1) Direktiva 2009/125/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 tetorit 2009 për krijimin e kuadrit për përcaktimin e kërkesave të projektimit ekologjik për produktet që lidhen me energjinë (GZ L 285, 31.10.2009, f. 10).

(2) Vëllimi i depozitës = $45 \times P_r \times (1 - 2{,}7/P_r)$ ose 300 litra cilado qoftë më e lartë, me P_r e shprehur në kW

(3) Vëllimi i depozitës = $20 \times P_r$ me P_r e treguar në kW

(4) Për lëndën djegëse të preferuar P_n të barabartë *me* P_r

SHTOJCA V

Informacioni që jepet në rastet kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, përjashtuar rastet përmes internetit

1. KALDAJA ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË

1.1. Informacioni i përmendur në kreun IV(1)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) Klasa e eficencës së energjisë së modelit, e përcaktuar sipas Shtojcës I;

(b) Nxehtësia nominale në dalje në kW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(c) Indeksi i eficencës së energjisë, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur sipas Shtojcës VIII;

(ç) Në rastin e kaldajave të bashkëprodhim me lëndë djegëse të ngurtë, rendimenti elektrik në përqindje i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

1.2. Madhësia dhe formati i shkronjave, në të cilat shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikën 1.1 duhet të jenë të lexueshme.

2. SISTEMET E PËRBËRA NGA NJË KALDAJË ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË, NGROHËS SHTESË, KONTROLL TEMPERATURE DHE PAJISJE DIELLORE

2.1. Informacioni i përmendur në kreun IV(2)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) Klasa e eficencës së energjisë së modelit, e përcaktuar sipas Shtojcës I;

(b) Indeksi i eficencës së energjisë, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(c) Informacioni i përcaktuar në Figurën 1 dhe Figurën 2 të Shtojcës III, sipas rastit.

2.2. Madhësia dhe formati i shkronjave, në të cilat shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikën 2.1 duhet të jenë të lexueshme.

SHTOJCA VI

Informacioni që jepet në rastin e shitjes, qiradhënies ose blerjes me këste, përmes internetit

1. Etiketa e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas kreut III ose në rastin e një pakete, kur është e përshtatshme, e plotësuar siç duhet duke u bazuar në etiketën dhe skedat e ofruara nga furnizuesit sipas kreut III, shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit ose paketimit sipas detajeve të përcaktuar në kreun III. Nëse shfaqen edhe një produkt edhe një paketë, por me një çmim të paraqitur vetëm për paketën, atëherë shfaqet vetëm etiketa e paketës. Madhësia është e tillë që etiketa të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë dhe të jetë proporcionale me madhësinë e specifikuar në Shtojcën II. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 2 të kësaj Shtojce. Nëse aplikohet ekrani i ndërlidhur, etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi imazh.
2. Imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë në rastin e ekranit të ndërlidhur:
   (a) Është një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e eficencës së energjisë së produktit ose të paketës në etiketë;
   (b) Tregon në shigjetë klasën e eficencës së energjisë së produktit ose paketën me ngjyrë të bardhë në një madhësi shkronje të barabartë me atë të çmimit; dhe
   (c) Ka një nga dy formatet e mëposhtme:



3.Në rastin e ekranit të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:
   (a) Imazhi i përmendur në pikën 2 të kësaj Shtojce shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit ose paketimit;
   (b) Imazhi lidhet me etiketën;
   (c) Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, pas rrotullimit të mausit ose zgjerimit të ekranit me prekje mbi imazh;
   (ç) Etiketa shfaqet në një dritare të re, skedë të re, faqe të re ose ekran të integruar;
   (d) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen konventat e pajisjeve për zmadhimin me prekje;
   (dh) Shfaqja e etiketës ndalohet me anë të opsionit të mbylljes ose mekanizmit tjetër standard të mbylljes;
   (e)Teksti alternativ për grafikun, i cili shfaqet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e eficencës së energjisë së produktit ose e paketimit në një madhësi shkronje të barabartë me atë të çmimit.
4. Skeda informative e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas kreut III shfaqet në mekanizmin e ekspozimit në afërsi të çmimit të produktit ose paketimit. Madhësia është e tillë që skeda e produktit të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Skeda e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin lidhja e përdorur për

aksesin në skedë tregon qartë dhe në mënyrë të lexueshme "Skeda e produktit". Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, skeda e produktit shfaqet në klikimin e parë të mausit, në rrotullimin e mausit ose zgjerimin e ekranit me prekje mbi lidhje.

SHTOJCA VII
Matjet dhe llogaritjet

1. Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të respektimit të kërkesave të kësaj rregullore, matjet dhe llogaritjet bëhen duke përdorur metoda të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme që merr në konsideratë metodat e matjes dhe të llogaritjes në fuqi, duke përfshirë standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian. Ato plotësojnë përkufizimet teknike, kushtet, ekuacionet dhe parametrat e përcaktuar në 2 deri 5.

2. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR MATJET DHE LLOGARITJET

(a) Kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë testohet me lëndën djegëse të preferuar.

(b)Vlera e deklaruar për eficencën e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

3. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR EFIÇENCËN SEZONALE TË ENERGJISË TË NGROHJES HAPËSIRËS TË KALDAJAVE ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË

(a) Vlerat e efiçencës dobishme η_n, η_p dhe vlerat e nxehtësisë së dobishme në dalje P_n, P_p duhet të maten në mënyrën e duhur. Për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë dhe me bashkëprodhim gjithashtu matet dhe vlera e efiçencës elektrike $\eta_{el,\,n}$.

(b) Efiçenca sezonale e energjisë ngrohjes hapësirës η_s duhet të llogaritet si efiçenca sezonale e energjisë ngrohjes së hapësirës në modalitetin aktiv η_{son} , e korrigjuar nga ndikimet që lidhen me kontrollin e temperaturës, konsumin ndihmës të energjisë elektrike, dhe, për kaldajat me lëndë djegëse të ngurtë dhe bashkëprodhim, duke shtuar efiçencën elektrike të shumëzuar me një koeficient konvertimi CC prej 2,5;

(c) Konsumi i energjisë elektrike shumëzohet me një koeficient konvertimi CC prej 2,5.

4. KUSHTET SPECIFIKE PËR EFIÇENCËN SEZONALE TË ENERGJISË NGROHJES HAPËSIRËS TË KALDAJAVE ME LËNDË DJEGËSE TË NGURTË

(a) Efiçenca sezonale e energjisë ngrohjes hapësirës η_s përkufizohet si:

$$\eta_s = \eta_{son} - F(1) - F(2) + F(3)$$

ku:

(1) η_{son} është efiçenca sezonale e energjisë ngrohjes në modalitetin aktiv, e shprehur në përqindje, e siç përcaktohet në pikën 4(b);

(2) *F(1)* lidhet me humbjen e efiçencës sezonale të ngrohjes hapësirës për shkak të ndikimit të rre kontrollit të temperaturës; *F(1) = 3 %;*

(3) *F(2)* lidhet me një ndikim negativ në efiçencën energjisë ngrohjes hapësirës i shkaktuar nga energjisë elektrike ndihmëse, i shprehur si për llogaritet siç përcaktohet në pikën 4(c);

(4) *F(3)* lidhet me një kontribut pozitiv në efiçenc të energjisë ngrohjes së hapësirës nga efiçenca kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë dhe bashkëprodhim, i shprehur si përqindje, d si më poshtë:
$F(3) = 2,5 \times \eta_{el,n}$

(b) Efiçenca sezonale energjisë ngrohjes së h modalitetin aktiv, η_{son}, llogaritet si më posh

(1) për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë n manuale që mund të funksionojnë në nxehtësisë nominale në dalje në moc vazhduar, dhe për kaldaja me lëndë d ngurtë me ndezje automatike:

$$\eta_{son} = 0,85 \times \eta_p + 0,15 \times \eta_n$$

(2) Për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë n manuale që nuk mund të funksionojnë ose më pak të nxehtësisë nominale në modalitet të vazhduar, dhe për kaldaja lëndë djegëse të ngurtë dhe bashkëprodhim:

$$\eta_{son} = \eta_n$$

(c) *F(2)* llogaritet si më poshtë:

(1) Për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje manuale që mund të funksionojnë në 50 % të nxehtësisë nominale në dalje në modalitet të vazhduar, dhe për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje automatike:

$$F(2) = 2,5 \times (0,15 \times el_{max} + 0,85 \times el_{min} + 1,3 \times P_{SB})/(0,15 \times P_n + 0,85 \times P_p)$$

(2) Për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë me ndezje manuale që nuk mund të funksionojnë në 50 % ose më pak të nxehtësisë nominale në dalje në modalitet të vazhdueshëm, dhe për kaldaja me lëndë djegëse të ngurtë dhe bashkëprodhim:

$F(2) = 2,5 \times (el_{max} + 1,3 \times P_{SB})/P_n$

5. LLOGARITJA E VLERËS KALORIFIKE

Vlera kalorifike bruto *(GCV)* do të përftohet nga vlera kalorifike bruto pa lagështirë (GCV_{mf}) duke aplikuar konvertimin e mëposhtëm:

$$GCV = GCV_{mf} \times (1 - M)$$

ku:

(a) *GCV* dhe GCV_{mf} shprehen në megaxhaul për kilogram;

(b) *M* është përmbajtja e lagështirës së lëndës djegëse, e shprehur si raport.

SHTOJCA VIII
Metoda e llogaritjes së Indeksit të Eficencës së Energjisë

1. Indeksi i Efiçencës së Energjisë (*EEI*) i kaldajave me lëndë djegëse të ngurtë llogaritet për lëndën djegëse të preferuar dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt si:

$EEI = \eta_{son} \times 100 \times BLF - F(1) - F(2) \times 100 + F(3) \times 100$

ku:

(a) η_{son} është efikasiteti sezonal i energjisë për ngrohjen e hapësirës në modalitetin aktiv, e llogaritur siç përcaktohet në pikën 4(b) të Shtojcës VII;

(b) *BLF* është faktori i etiketës së biomasës, i cili është 1,45 për kaldaja me biomasë dhe 1 për kaldaja me lëndë djegëse fosile;

(c) *F(1)* është një kontribut negativ në indeksin e eficencës së energjisë për shkak të koeficientëve të rregulluar të kontrolleve të temperaturës; *F(1)* = 3;

(ç) *F(2)* është një koeficient negativ në indeksin e eficencës së energjisë nga konsumi ndihmës i energjisë elektrike dhe llogaritet siç përcaktohet në pikën 4(c) të Shtojcës VII;

(d) *F(3)* është një koeficient pozitiv në indeksin e eficencës së energjisë nga efiçenca elektrike e kaldajave me bashkëprodhim me lëndë djegëse të ngurta dhe llogaritet si më poshtë:
F(3) = 2,5 × $\eta_{el,n}$

2. Indeksi i Efiçencës së Energjisë (*EEI*) për sistemet e përbëra nga një kaldajë me lëndë djegëse të ngurtë, ngrohës shtesë, kontroll temperature dhe pajisje diellore përcaktohet sipas pikës 2 të Shtojcës III.

SHTOJCA IX
Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Për qëllime të vlerësimit dhe të respektimit të kërkesave të përcaktuara në krerët III dhe IV, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston një njësi të vetme të modelit

2. Modeli konsiderohet në përputhje me kërkesat nëse:
   (a) vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik në (vlerat e deklaruara), dhe, kur është e zbatueshme, vlerat e përdorura për të llogaritur këto vlera, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit.
   (b) vlerat e publikuara në etiketë dhe në fletën e produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e efikasitetit energjetik e treguar nuk është më e favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe
   (c) kur struktura pergjegjese e mbikeqyrjes teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura gjatë testimit dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit, siç jepen në Tabelën 5. Njësia testohet me një lëndë djegëse me karakteristika brenda të njëjtit interval si lënda djegëse që është përdorur nga furnizuesi për të kryer matjet sipas Shtojcës VII.

3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2(a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet që janë listuar si modele ekuivalente në dokumentacionin teknik të furnizuesit konsiderohen se nuk përputhen me këtë Rregullore.
4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, struktura pergjegjese e mbikeqyrjes përzgjedh tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të përzgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve të ndryshme që janë listuar si modele ekuivalente në dokumentacionin teknik të furnizuesit.
5. Modeli konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse, për këto tre njësi, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të verifikimit të dhëna në Tabelën 5.
6. Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet që janë listuar si modele ekuivalente në dokumentacionin teknik të furnizuesit konsiderohen se nuk përputhen me këtë Rregullore.
7. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes duhet të ofrojë të gjitha informacionet përkatëse pas marrjes së një vendimi mbi mos-përputhshmërinë e modelit sipas pikave 3 dhe 6.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes duhet të përdorë metodat e matjes dhe të llogaritjes të përcaktuara në Shtojcat VII dhe VIII.
Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes duhet të aplikojë vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 5 dhe duhet të përdorë vetëm procedurën të përshkruar në pikat 1 deri

7 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë. Asnjë tolerancë tjetër, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje, nuk duhet të aplikohet.

Tabela 5

Tolerancë verifikimi

Parametri	Tolerancë verifikimi
Indeksi i efikasitetit energjetik	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar për më shumë se 6 %.

ANEKS NR.5

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË NGROHËSVE TË HAPËSIRËS, SISTEMET E INTEGRUARA, SISTEMET QË PËRFSHIJNË NGROHËS HAPËSIRE, SISTEME DIELLORE DHE TERMOSTATË, SI DHE SISTEMET QË PËRFSHIJNË NGROHËSIT E INTEGRUAR, SISTEME DIELLORE DHE TERMOSTAT"[1]

I. QËLLIMI

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin e energjisë dhe dhënien e informacionit plotësues të produktit për ngrohësit e hapësirës dhe ngrohësit e integruar me fuqi të vlerësuar të nxehtësisë ≤ 70 kW, sistemet e përbëra nga ngrohës hapësire me fuqi termike ≤ 70 kW, termostat dhe sistemet diellore dhe sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar me fuqi termike ≤ 70 kW, termostat dhe sisteme diellore.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
(a) Ngrohësit e projektuar posaçërisht për përdorimin e lëndëve djegëse të gazta ose të lëngshme të prodhuara kryesisht nga biomasa;
(b) Ngrohës që përdorin lëndë djegëse të ngurta;
(c)Ngrohësit e hapësirës që janë pjesë e instalimeve në aktivitetet industriale sipas Ligji Nr.10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" (konsoliduar).
(ç) Ngrohësit që prodhojnë nxehtësi vetëm për qëllim të prodhimit të ujit të ngrohtë të pijshëm ose sanitar;
(d) Ngrohësit për ngrohjen dhe shpërndarjen e lëndëve të gazta të transmetimit të nxehtësisë si avulli ose ajri;
(dh) Ngrohës të hapësirës me kogjenerim me një kapacitet maksimal elektrik prej 50 kW ose më shumë.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Biomasa"** është fraksioni i biodegradueshëm i produkteve, i mbetjeve dhe tepricave me origjinë biologjike nga bujqësia (duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore),

1 Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 811/2013 e Komisionit, datë 18 shkurt 2013, për plotësimin e Direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me etiketimin e energjisë së ngrohësve të hapësirës, ngrohësve të integruar, sistemeve të përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore dhe sistemeve tw përbëra nga ngrohës të integruar,termostat dhe sisteme diellore.

pylltarinë dhe industritë e lidhura me to si dhe duke përfshirë peshkimin dhe akuakulturën dhe fraksionin e biodegradueshëm të mbetjeve industriale dhe bashkiake;

2. **"Depozita diellore e ujit të ngrohtë"** është një rezervuar i krijuar për të ruajtur ujin e ngrohtë dhe për të mbajtur energjinë termike të prodhuar nga një ose më shumë kolektorë diellorë;
3. **"Depozita e ujit të ngrohtë"** është një enë e krijuar për të ruajtur ujin e ngrohtë që përdoret për ngrohjen e ujit dhe/ose të hapësirës. Ajo përfshin çdo pajisje shtesë dhe nuk është e pajisur me një prodhues të integruar të nxehtësisë, përveç ndoshta një ose disa ngrohësve me zhytje të përdorur si rezervë;
4. **"Eficenca e intervalit të ciklit"** (*COPcyc* ose *PERcyc*) është koeficienti mesatar i performancës ose raporti mesatar i energjisë parësore gjatë intervalit të testit të ciklit. Ajo llogaritet si kapaciteti i integruar i ngrohjes gjatë intervalit, i shprehur në kWh, i ndarë me energjinë e integruar të përdorur gjatë atij intervali, gjithashtu i shprehur në kWh, bazuar në GCV-në dhe/ose në kWh në terma të energjisë përfundimtare të shumëzuar me koeficientin e konvertimit (CC);
5. **"Energjia e referencës"** (Q_{ref}) është sasia e energjisë së dobishme të shkarkimeve të ujit, e shprehur në kWh, në një profil ngarkese të caktuar, siç është specifikuar në Tabelën 15 të Shtojcës VI;
6. **"Humbja e nxehtësisë në gatishmëri"** (P_{stby}) është humbja e nxehtësisë së një kaldaje për ngrohjen e hapësirës, kaldajës së integruar, ose ngrohësit të hapësirës me kogjenerim, kur ato funksionojnë në modalitetet e gatishmërisë pa kërkesë për ngrohje, e shprehur në kW;
7. **"Humbje termike"** (S) është fuqia e nxehtësisë që humbet nga një depozitë diellore për ruajtjen e ujit të nxehtë, në temperaturat e dhëna të ujit dhe ambientit, e shprehur në W;
8. **"Identifikuesi i modelit"** është një kod, zakonisht alfanumerik, që përdoret për të dalluar një ngrohës specifik të hapësirës, ngrohës të integruar, termostat, sisteme diellore, sisteme që përfshijnë ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore, ose sistemet që përfshijnë ngrohës të integruarr, termostat dhe sisteme diellore, nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare, emër furnizuesi ose emër shitësi.
9. **"Kaldajë e kombinuar"**, për qëllimet e figurave 1 deri në 4 në Shtojcën III, e referuar si "kaldaja", është një kaldajë për ngrohjen e hapësirës që është projektuar për të siguruar nxehtësi dhe për të ofruar ujë të nxehtë të pijshëm ose sanitar në nivele të caktuara të temperaturës, sasisë dhe normës së fluksit gjatë periudhave të caktuara. Ajo është e lidhur me një furnizim të jashtëm me ujë të pijshëm ose ujë sanitar;
10. **"Kaldajë e ngrohjes së hapësirës"**, për qëllimet e Figurave 1 deri në 4 të dhëna në Shtojcën III, e referuar si "kaldaja", është një ngrohës hapësire që prodhon nxehtësi duke përdorur djegien e lëndëve djegëse fosile dhe/ose lëndë djegëse të biomasës, dhe/ose duke përdorur efektin Xhaul në elementet e ngrohjes me rezistencë elektrike.
11. **"Kaldajë kondensuese"** është një kaldajë e ngrohjes së hapësirës ose një kaldajë e integruar ku, në kushte normale funksionimi dhe në temperaturat e dhëna të ujit të punës,

avulli i ujit është pjesërisht i kondensuar në produktet e djegies, me qëllim që të përdoret nxehtësia latent (e fshehur) e këtij avulli të ujit për qëllime ngrohjeje;

12. **"Kapaciteti i deklaruar i ngrohjes"** ($Pdh(T_j)$) është kapaciteti i ngrohjes së një ngrohësi të hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie i cili është në gjendje të prodhojë nxehtësi, për një temperaturë të jashtme të caktuar, e shprehur në kW;
13. **"Kapaciteti i intervalit të ciklit të ngrohjes"** ($Pcych$) është kapaciteti i ngrohjes së integruar gjatë intervalit të testit të ciklit të ngrohjes, i shprehur në kW;
14. **"Kapaciteti plotësues i ngrohjes"** ($sup(Tj)$ është prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë (Psup) nga një ngrohës shtesë, i cili realizon kapacitetin e deklaruar për ngrohje për të plotësuar ngarkesën e pjesshme për ngrohje, në rast se kapaciteti i deklaruar për ngrohje është më i vogël se ngarkesa e pjesshme për ngrohje, e shprehur në kW.
15. **"Kërkesa e referencës vjetore të ngrohjes"** (Q_h) është kërkesa e referencës për ngrohje për një sezon të caktuar ngrohjeje, e cila do të përdoret si bazë për llogaritjen e SCOP-it ose SPER-it. Kjo kërkesë është llogaritur si produkt i ngarkesës së projektuar për ngrohje dhe orëve vjetore të barasvlershme të modalitetit aktiv, e shprehur në kWh;
16. **"Koeficienti i deklaruar i performancës"** ($COPd(T_j)$) ose "raporti i deklaruar i energjisë parësore" ($PERd(T_j)$) është koeficienti i performancës ose raporti i energjisë parësore gjatë një numri të kufizuar periudhash të specifikuara për ngrohje;
17. **"Koeficienti i humbjes së eficencës"** (Cdh) është masa e humbjes së eficencës për shkak të ciklit të një ngrohësi të hapësirës me pompë nxehtësie ose një ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie. Nëse Cdh nuk përcaktohet me matje, atëherë koeficienti i humbjes së eficencës i paracaktuar është Cdh = 0,9.
18. **"Koeficienti i konvertimit"** (CC) është një koeficient që pasqyron eficencën mesatare të vlerësuar të prodhimit prej 40%. Vlera e koeficientit të konvertimit është CC = 2,5;
19. **"Koeficienti i performancës së modalitetit aktiv"** ($SCOP_{on}$) ose "raporti i energjisë parësore të modalitetit aktiv" ($SPER_{on}$) është koeficienti mesatar i performancës së një ngrohësi hapësire me pompë nxehtësie, ose i një ngrohësi të kombinuar me pompë nxehtësie që përdor energji elektrike në modalitetin aktiv, ose raporti mesatar i energjisë parësore të një ngrohësi hapësire me pompë nxehtësie, ose i një ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie që përdor lëndë djegëse në modalitetin aktiv për sezonin e caktuar të ngrohjes;
20. **"Koeficienti i vlerësuar i performancës"** (COP_{rated}) ose "raporti i vlerësuar i energjisë parësore" (PER_{rated}) është kapaciteti i deklaruar e nxehtësisë, i shprehur në kW, pjesëtuar me energjinë që përdoret, i shprehur në kW në terma të GCV-së dhe/ose në kW në terma të energjisë përfundimtare të shumëzuar me CC-në, për ngrohjen e siguruar në kushte standarde të klasifikimit;
21. **"Koeficienti sezonal i performancës"** ($SCOP$) ose "raporti i energjisë parësore sezonale" ($SPER$) është koeficienti i përgjithshëm i performancës së një ngrohësi hapësire me pompë nxehtësie, ose i një ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie që përdor energji

elektrike, ose raporti i përgjithshëm i energjisë parësore të një ngrohësi hapësire me pompë nxehtësie, ose i një ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie që përdor lëndë djegëse. Ky koeficient përfaqëson sezonin e caktuar të ngrohjes dhe llogaritet si kërkesa vjetore e referencës për ngrohjen, e ndarë me konsumin vjetor të energjisë;

22. **"Koeficienti specifik i performancës së periudhës së ngrohjes"** (*COPbin(T_j)* ose "raporti i energjisë parësore specifike për sezonin e ngrohjes" (*PERbin (T_j)* është koeficienti i performancës së ngrohësit të hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohësit të integruar me pompë nxehtësie që përdor energji elektrike, ose raporti i energjisë parësore të ngrohësit të hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohësit të integruar me pompë nxehtësie që përdor lëndë djegëse specifike për çdo periudhë ngrohje në një sezon. Ky koeficient përcaktohet nga ngarkesa e pjesshme e ngrohjes, kapaciteti i deklaruar i ngrohjes dhe koeficienti i deklaruar i performancës për periudhën specifike të ngrohjes. Ai mund të llogaritet për periudha të tjera përmes interpolimit ose ekstrapolimit dhe, kur është e nevojshme, mund të korrigjohet me koeficientin e humbjes së efikasitetit;
23. **"Kolektor diellor"** është një pajisje e projektuar për të thithur rrezatim diellor global dhe për ta transmetuar energjinë e nxehtësisë së prodhuar tek një fluid që kalon përmes tij;
24. **"Konsumi ditor i energjisë elektrike"** (Q_{elec}) është sasia e energjisë elektrike e përdorur për ngrohjen e ujit gjatë 24 orëve të plota, sipas profilit të deklaruar të ngarkesës, e shprehur në kWh, në terma të energjisë përfundimtare;
25. **"Konsumi ditor i lëndës djegëse"** (Q_{fuel}) është konsumi i lëndës djegëse për ngrohjen e ujit për 24 orë rresht sipas profilit të deklaruar të ngarkesës, i shprehur në kWh në terma të *GCV*-së dhe, për qëllimet e pikës 5(dh) të Shtojcës VI, i shprehur në GJ (gigaxhaul) në terma *GCV*-së;
26. **"Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse"** (Q_{aux}), për qëllimin e Figurës 5 në Shtojcën III të referuar si "energji elektrike ndihmëse", është konsumi vjetor i energjisë elektrike të një sistemi të vetëm diellor, që ndodh për shkak të konsumit të energjisë nga pompa dhe konsumit të energjisë në gatishmëri, e shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare;
27. **"Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse"** është energjia elektrike vjetore e nevojshme për funksionimin e caktuar të një kaldaje të ngrohjes së hapësirës, kaldajës së integruar ose të ngrohësit të hapësirës me kogjenerim, e llogaritur në bazë të konsumit të energjisë elektrike në ngarkesë të plotë (*elmax*), në ngarkesë të pjesshme (*elmin*), në modalitetin e gatishmërisë dhe në orët e paracaktuara të funksionimit në çdo modalitet, të shprehura në kWh në terma të energjisë përfundimtare;
28. **"Konsumi i energjisë në modalitetin e fikur të termostatit"** (P_{TO}) është konsumi i energjisë së ngrohësit të hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohësit të integruar me pompë nxehtësie në modalitetin e fikur të termostatit, i shprehur në kW;
29. **"Konsumi i energjisë në modalitetin e fikur"** (P_{OFF}) është konsumi i energjisë së një ngrohësi të hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie në modalitetin e fikur, i shprehur në kW;

30. **"Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë"** (P_{SB}) është konsumi i energjisë së një ngrohësi në gjendje gatishmërie, i shprehur në kW;
31. **"Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë"** (*solstandby*) është konsumi i vlerësuar i energjisë elektrike të një sistemi të vetëm diellor kur pompa dhe prodhuesi i nxehtësisë janë joaktivë, i shprehur në W;
32. **"Konsumi i energjisë së ndezësit"** (P_{ign}) është konsumi e energjisë së një aparati ndezës që përdoret për të ndezur djegësin kryesor, i shprehur në W në terma të *GCV-së*;
33. **"Konsumi i fuqisë së pompës"** (*solpump*) është konsumi i vlerësuar i energjisë elektrike të pompës në unazën e kolektorit të një sistemi të vetëm diellor, i shprehur në W;
34. **"Konsumi vjetor i energjisë elektrike"** (*AEC*) është konsumi vjetor i energjisë elektrike së një ngrohësi të integruar për ngrohjen e ujit sipas profilit të deklaruar të ngarkesës dhe në kushtet e dhëna klimatike, i shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare;
35. **"Konsumi vjetor i energjisë"** (Q_{HE}) është sasia e energjisë që një ngrohës përdor në vit për ngrohjen e hapësirës, në përputhje me kërkesën vjetore të ngrohjes për një sezon të caktuar, e shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose në gigaxhaul (GJ) në terma të (GCV) -së;
36. **"Konsumi vjetor i lëndës djegëse"** (*AFC*) është sasia e lëndës djegëse fosile dhe/ose biomasës së përdorur nga një ngrohës i integruar për ngrohjen e ujit, në përputhje me profilin e ngarkesës së deklaruar dhe kushtet klimatike të dhëna, e shprehur në gigaxhaul (GJ) në terma të vlerës së përshkruar të energjisë kalorifike të ulët (GCV);
37. **"Konsumimi i energjisë në modalitetin e ngrohësit të karterit"** (P_{CK}) i referohet konsumit të energjisë nga ngrohësi i hapësirës që përdor pompë nxehtësie ose një ngrohës i integruar me pompë nxehtësie gjatë periudhës kur është në modalitetin e ngrohësit të karterit, e shprehur në kW;
38. **"Kontributi vjetor i ngrohjes jo diellore"** (Q_{nonsol}), është kontributi vjetor i energjisë elektrike (i shprehur në kWh në terma të energjisë parësore) dhe/ose i lëndëve djegëse (i shprehur në kWh në terma të GCV-së) në prodhimin e nxehtësisë së dobishme nga një sistem të përbërë nga ngrohës të integruar, thermostat dhe sisteme diellore, duke marrë parasysh sasinë vjetore të nxehtësisë së kapur nga kolektori diellor dhe humbjet e nxehtësisë nga depozita diellore e ujit të ngrohtë;
39. **"Kontrolli i kapacitetit"** është aftësia e një ngrohësi të hapësirës me pompë nxehtësie, ose e një ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie, për të ndryshuar kapacitetin e tij duke rregulluar normën vëllimore të fluksit të së paku njërit prej fluideve të nevojshme për funksionimin e ciklit të ftohjes. Ky kapacitet është i quajtur "i fiksuar" nëse norma vëllimore e fluksit nuk mund të ndryshohet, ose "i ndryshueshëm" nëse norma vëllimore e fluksit mund të ndryshojë në një seri prej dy ose më shumë hapash;
40. **"Termostat"** është një pajisje që ndërvepron me përdoruesin për të vendosur vlerat dhe kohën e dëshiruar të temperaturës së brendshme. Ajo transmeton të dhënat përkatëse tek ndërfaqja e ngrohësit, si një njësi qendrore përpunimi, duke mundësuar rregullimin e temperaturës së brendshme;

41. **"Kushte mesatare klimatike"**, "kushte klimatike më të ftohta" dhe "kushte klimatike më të ngrohta" përfaqësojnë temperaturat dhe rrezatimin diellor global që janë karakteristike për qytetet e Strasburgut, Helsinkit dhe Athinës, përkatësisht;
42. **"Kushtet e referencës së projektimit"** përfaqësojnë kombinimin e temperaturës së referencës për projektim, temperaturës maksimale bivalente dhe temperaturës maksimale kufitare të funksionimit, siç përcaktohet në Tabelën 10 të Shtojcës VI;
43. **"Kushtet standarde të vlerësimit"** janë ato kushte funksionimi të ngrohësve që përdoren për të përcaktuar prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë, efikasitetin sezonal të energjisë për ngrohjen e hapësirës, efikasitetin e energjisë për ngrohjen e ujit dhe nivelin e fuqisë së zhurmës, bazuar në kushtet mesatare klimatike;
44. **"Lëndë djegëse e biomasës"** i referohet lëndëve djegëse, në formë gazi ose lëngu, e prodhuar nga biomasa;
45. **"Lëndë djegëse fosile"** janë lëndët djegëse të gazta ose të lëngëta me origjinë fosile;
46. **"Modaliteti aktiv"** është gjendja që përfshin orët e ngrohjes për hapësirën e mbyllur, kur funksioni i ngrohjes është aktiv. Kjo gjendje mund të përfshijë ciklin e funksionimit të ngrohësit të hapësirës me pompë nxehtësie ose të një sistemi të integruar me pompë nxehtësie, për të arritur ose ruajtur temperaturën e dëshiruar të ajrit të brendshëm;
47. **"Modaliteti i fikur i termostatit"** i referohet një gjendjeje kur funksioni i ngrohjes është i aktivizuar, por nuk ka ngarkesë për ngrohje, që do të thotë se ngrohësi i hapësirës me pompë nxehtësie ose sistemi i integruar i ngrohjes me pompë nxehtësie nuk është në funksion. Gjithashtu, cikli aktiv i modalitetit nuk përfshihet në këtë gjendje dhe nuk konsiderohet si "modalitet i fikur" i termostatit;
48. **"Modaliteti i fikur"** është gjendja në të cilën ngrohësi i hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohësi të integruar me pompë nxehtësie është i lidhur me burimin e energjisë elektrike dhe nuk kryen asnjë funksion. Kjo përfshin raste kur pajisja ofron vetëm një tregues të gjendjes së fikur ose funksione të kufizuara për të garantuar përputhshmërinë elektromagnetike;
49. **"Modaliteti i gatishmërisë"** i referohet një gjendjeje ku ngrohësi është i lidhur me burimin e energjisë elektrike, mbështetet në fuqinë e tij për funksionim dhe kryen vetëm funksionet e mëposhtme, të cilat mund të vazhdojnë për një kohë të pacaktuar: funksioni i riaktivizimit, ose funksioni i riaktivizimit së bashku me një tregues të aktivizuar të këtij funksioni dhe/ose shfaqjen e informacionit ose statusit të pajisjes;
50. **"Modaliteti i ngrohësit të karterit"** i referohet një gjendjeje ku një pajisje ngrohëse aktivizohet për të parandaluar kalimin e materialit ftohës në kompresor. Kjo bëhet për të kufizuar përqendrimin e materialit ftohës në vaj gjatë nisjes së kompresorit, duke siguruar funksionim më të sigurtë dhe efikas;
51. **"Ngarkesa e pjesshme për ngrohje"** ($Ph(T_j)$) i referohet ngarkesës së ngrohjes në një temperaturë të caktuar të jashtme. Ajo llogaritet duke shumëzuar ngarkesën e projektuar me raportin e ngarkesës së pjesshme dhe shprehet në kilovat (kW);

52. **"Ngarkesa e projektuar e ngrohjes"** (*Pdesignh*) përfaqëson prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë (Prated) të një ngrohësi hapësinor me pompë nxehtësie ose të një sistemi të integruar ngrohësish me pompë nxehtësie, në temperaturën e referencës së projektimit. Kjo ngarkesë korrespondon me ngarkesën e pjesshme për ngrohje, kur temperatura e jashtme e ambientit është e barabartë me temperaturën e referencës së projektimit, dhe shprehet në kilovat (kW);
53. **"Ngrohës"** i referohet një pajisjeje që mund të jetë ose një ngrohës hapësire ose një ngrohës i integruar;
54. **"Ngrohës hapësire"** është një pajisje që:
    a. Siguron nxehtësi për një sistem ngrohjeje qendrore me bazë uji, duke ndihmuar në arritjen dhe mbajtjen e një temperature të dëshiruar në një hapësirë të mbyllur, si një ndërtesë, banesë ose dhomë; dhe
    b. Është e pajisur me një ose më shumë gjeneratorë të nxehtësisë.
55. **"Ngrohës i hapësirës me kogjenerim"** është një pajisje ngrohëse që, gjatë një procesi të vetëm, prodhon njëkohësisht nxehtësi dhe energji elektrike;
56. **"Ngrohës i hapësirës me pompë nxehtësie"**, për qëllimet e figurave 1 dhe 3 në Shtojcën III e referuar si "pompë nxehtësie", është një pajisje ngrohëse që shfrytëzon nxehtësinë e ambientit të marrë nga burime si ajri, uji, toka dhe/ose nxehtësinë e mbetjeve për të prodhuar nxehtësi. Ky ngrohës mund të pajiset me një ose më shumë ngrohës shtesë që përdorin: efektin Xhaul në elementët ngrohës me rezistencë elektrike; djegien e lëndëve djegëse fosile, dhe/ose djegien e biomasës;
57. **"Ngrohës i kombinuar me pompë nxehtësie"**, për qëllimet e figurave 1 dhe 3 në Shtojcën III e referuar si "pompë nxehtësie", është një ngrohës i hapësirës me pompë nxehtësie i projektuar për të siguruar ngrohje, si dhe për të prodhuar ujë të pijshëm ose sanitar në nivele të caktuara temperature, sasi dhe norma fluksi gjatë periudhave të specifikuara. Ai lidhet me një furnizim të jashtëm me ujë të pijshëm ose sanitar;
58. **"Ngrohës me zhytje rezervë"** është një ngrohës me rezistencë elektrike dhe efekt Xhaul, që është pjesë e një depozite të ujit të ngrohtë. Ai prodhon nxehtësi vetëm kur burimi i jashtëm i nxehtësisë është i ndërprerë (përfshirë ndërprerjet gjatë periudhave të mirëmbajtjes), ose kur ngrohësi është jashtë funksionit. Ky ngrohës gjithashtu mund të jetë pjesë e një depozite diellore të ujit të ngrohtë dhe siguron nxehtësi kur burimi i nxehtësisë diellore nuk është i mjaftueshëm për të arritur nivelet e kërkuara të temperaturës;
59. **"Ngrohës plotësues"** është një ngrohës jo-preferencial që siguron nxehtësi kur kërkesa për ngrohje është më e madhe se kapaciteti i prodhimit të nxehtësisë nga ngrohësi preferencial;
60. **"Ngrohës të kombinuar"** është një ngrohës hapësire i projektuar për të siguruar nxehtësi që përdoret për prodhimin e ujit të ngrohtë të pijshëm ose sanitar në nivele të caktuara të temperaturës, sasisë dhe normës së fluksit gjatë periudhave të caktuara. Ky ngrohës është i lidhur me një furnizim të jashtëm me ujë të pijshëm ose sanitar;

61. **"Niveli i fuqisë së zhurmës"** (L_{WA}) është niveli i fuqisë së zhurmës së ponderuar në shkallën A, brenda dhe/ose jashtë, i shprehur në dB;
62. **"Norma e dobishme e fluksit të ujit"** (f) është norma minimale e fluksit, e shprehur në litra për minutë, ku uji i nxehtë kontribuon në energjinë e referencës, siç specifikohet në Shtojcën VI, Tabela 15;
63. **"Orët e periudhës të ngrohjes"** (H_j) janë orët e periudhës gjatë të cilës arrihet një temperaturë e jashtme për çdo periudhë ngrohjeje, të shprehura në orë për vit, siç përcaktohet në Tabelën 12 të Shtojcës VI;
64. **"Orët vjetore të barasvlershme të modalitetit aktiv"** (H_{HE}) është numri i supozuar vjetor i orëve që një ngrohës i hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohës i integruar me pompë nxehtësie duhet të sigurojë për ngarkesën e projektuar të ngrohjes për të përmbushur kërkesën e referencës vjetore të ngrohjes, të shprehur në h;
65. **"Pajisje diellore"** është një sistem diellor i vetëm, një kolektor diellor, një depozitë diellore për ruajtjen e ujit të ngrohtë, ose një pompë në unazën e kolektorit, të cilat ofrohen në treg si produkte të veçanta;
66. **"Paketa e përbërë nga ngrohës hapësire, kontroll temperature dhe pajisje diellore"** është një sistem që ofrohet për përdoruesin fundor dhe përmban një ose më shumë ngrohës hapësire të integruar me një ose më shumë termostat dhe/ose një ose më shumë sisteme diellore;
67. **"Paketë e kombinuar ngrohës, kontroll temperature dhe pajisje diellore"** është një sistem që i ofrohet përdoruesit fundor dhe që përmban një ose më shumë ngrohës të integruar që kombinohen me një ose më shumë termostat dhe/ose një ose më shumë sisteme diellore;
68. **"Përdorimi ne temperaturë mesatare"** i referohet situatës kur ngrohësi i hapësirës me pompë nxehtësie, ose ngrohësi i integruar me pompë nxehtësie, arrin kapacitetin e tij të deklaruar të ngrohjes në një temperaturë të jashtme prej 55 °C me shkëmbyesin e nxehtësisë të brendshëm;
69. **"Përdorimi në temperaturë të ulët"** i referohet situatës kur ngrohësi i hapësirës me pompë nxehtësie arrin kapacitetin e tij të deklaruar për ngrohje në një temperaturë të jashtme prej 35 °C me shkëmbyesin e nxehtësisë të brendshëm;
70. **"Periudhë ngrohje"** (bin_j) është një kombinim i temperaturës së jashtme dhe orëve të sezonit të ngrohjes, siç përcaktohet në Tabelën 12 të Shtojcës VI;
71. **"Përmbajtja e dobishme e energjisë"** (Q_{tap}) është sasia e energjisë që përmban uji i ngrohtë, e shprehur në kWh, e siguruar në një temperaturë të barabartë ose më të lartë se temperatura e kërkuar e ujit dhe me normë fluksi të ujit të barabartë ose më të lartë se norma e kërkuar e fluksit të ujit, siç është përcaktuar në Tabelën 15 të Shtojcës VI;
72. **"Përmbajtja energjetike e ujit të ngrohtë"** është produkti i kapacitetit specifik të nxehtësisë së ujit, ndryshimi mesatar i temperaturës midis ujit të ngrohtë dhe të ujit të ftohtë, dhe masës totale të ujit të ngrohtë të prodhuar;

73. **"Pompë nxehtësie për temperaturë të ulët"** është një ngrohës hapësire me pompë nxehtësie, i cili është projektuar posaçërisht për t'u përdorur në kushte me temperatura të ulëta. Ky lloj sistemi nuk mund të prodhojë ujë për ngrohje me një temperaturë të jashtme prej 52 °C, kur temperatura e brendshme e ambientit është –7 °C (ose –8 °C) në kushtet e referencës së projektimit për klimën mesatare;
74. **"Prodhimi i nxehtësisë së dobishme"** (*P*) i referohet sasisë së nxehtësisë së prodhuar nga një kaldajë e ngrohjes së hapësirës, kaldajë të integruar, ose një ngrohësi hapësire me kogjenerim, e cila dërgohet te transmetuesi i nxehtësisë. Ky prodhim shprehet në kW;
75. **"Prodhimi i vlerësuar e nxehtësisë"** (*Prated*) është sasia e nxehtësisë së deklaruar që një ngrohës prodhon kur siguron ngrohjen e hapësirës dhe, nëse përdoret, ngrohjen e ujit, në kushtet standarde të vlerësimit, të shprehura në kW. Për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, kushtet standarde të vlerësimit për përcaktimin e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë janë ato të kushtet e referencës së projektimit, siç përcaktohen në Tabelën 10 të Shtojcës VI;
76. **"Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë së ngrohësit plotësues"** (*Psup*) është sasia e nxehtësisë së deklaruar që një ngrohës plotësues prodhon kur siguron ngrohjen e hapësirës dhe, nëse është e aplikueshme, ngrohjen e ujit, në kushtet standarde të klasifikimit, të shprehura në kË. Në rastin kur ngrohësi plotësues është një ngrohës hapësire me pompë nxehtësie ose ngrohës i integruar me pompë nxehtësie, kushti standard i vlerësimit për përcaktimin e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë së ngrohësit plotësues është temperatura e jashtme Tj = +7 °C;
77. **"Prodhues i nxehtësisë"** është pjesa e një ngrohësi që krijon nxehtësi duke përdorur një ose më shumë nga proceset e mëposhtme:
    (a) Djegia e lëndëve djegëse fosile dhe/ose lëndëve djegëse të biomasës;
    (b) Përdorimi i efektit Xhaul në elementët e ngrohjes me rezistencë elektrike;
    (c) Kapja e nxehtësisë së ambientit nga një burim ajri, burim uji ose burimi tokësor dhe/ose nxehtësia e mbetjeve;
78. **"Profili i deklaruar i ngarkesës"** është profili i ngarkesës i përdorur gjatë përcaktimit të efikasitetit të energjisë për ngrohjen e ujit;
79. **"Profili i ngarkesës maksimale"** është profili i ngarkesës që ka energjinë më të lartë të referencës, të cilën një ngrohës i integruar është në gjendje ta sigurojë, duke përmbushur kushtet e temperaturës dhe të normës së fluksit të atij profili të ngarkesës;
80. **"Profili i ngarkesës"** është një seri e caktuar e shkarkimeve të ujit, e përcaktuara në Tabelën 15 të Shtojcës VI. Çdo ngrohës i integruar duhet të plotësojë të paktën një profil ngarkese;
81. **"Raporti i ngarkesës së pjesshme"** ($pl(T_j)$) është temperatura e jashtme minus 16 °C pjesëtuar me temperaturën e referencës së projektimit minus 16 °C;
82. **"Rendimenti elektrik "** (η_{el}) është raporti i prodhimit të energjisë elektrike dhe totalit të energjisë të një ngrohësi të hapësirës me kogjenerim, i shprehur në %, ku totali i energjisë

së përdorur shprehet në terma të *GCV*-së dhe/ose në terma të energjisë përfundimtare të shumëzuar me *CC*-në;

83. **"Rendimenti i energjisë së ngrohjes së ujit"** (η_{eh}) është raporti midis energjisë së dobishme të siguruar në ujin e pijshëm ose sanitar nga një ngrohës i integruar ose një sistem i përbërë nga një ngrohës i integruar, me termostat dhe pajisje diellore, dhe energjisë së nevojshme për prodhimin e tij, i shprehur në përqindje (%);
84. **"Rendimenti i energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës"** (η_s) është raporti midis kërkesës për ngrohje të hapësirës gjatë një sezoni të caktuar ngrohjeje, e ofruar nga një ngrohës hapësire, një ngrohës i integruar, një sistem i përbërë nga një ngrohës hapësire, me termostat dhe pajisje diellore, ose një sistem i përbërë nga ngrohës të integruar, me termostat dhe sisteme diellore, dhe konsumit vjetor të energjisë që kërkohet për të plotësuar këtë kërkesë, i shprehur në përqindje (%);
85. **"Rendimenti i energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në modalitetin aktiv"** (η_{son}) është:

    -Për kaldajat e ngrohjes së hapësirës me lëndë djegëse dhe kaldajat e integruara me lëndë djegëse, një mesatare e ponderuar e eficencës së dobishme të prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë dhe e eficencës së dobishme në 30 % të prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, e shprehur në %;

    -Për kaldajat elektrike të ngrohjes së hapësirës dhe kaldajat e integruara elektrike, eficenca e dobishme e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, e shprehur në %;

    -Për ngrohësit e hapësirës me kogjenerim që nuk janë të pajisur me ngrohës shtesë, eficenca e dobishme e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, e shprehur në %;

    -Për ngrohësit e hapësirës me kogjenerim të pajisur me ngrohës shtesë, një mesatare e ponderuar e eficencës së dobishme e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë me ngrohës shtesë të çaktivizuar, dhe eficenca e dobishme e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë me ngrohës shtesë të aktivizuar, e shprehur në %;
86. **"Rendimenti i dobishëm "** (η) është raporti midis prodhimit të nxehtësisë së dobishme dhe totalit të energjisë së përdorur të një kaldaje të ngrohjes së hapësirës, kaldajës së integruar ose ngrohësit të hapësirës me kogjenerim, i shprehur në përqindje (%), ku totali i energjisë së përdorur shprehet në terma të GCV-së dhe/ose në terma të energjisë përfundimtare të shumëzuar me CC-në;
87. **"Rendimenti i kolektorit"** (η_{col}) është efikasiteti i kolektorit diellor në një ndryshim të temperaturës midis kolektorit diellor dhe ajrit rrethues prej 40 K dhe një rrezatimi diellor global prej 1.000 W/m², i shprehur në përqindje (%);
88. **"Sezoni i ngrohjes"** përfaqëson një grup kushtesh funksionimi të klimës mesatare, duke përfshirë periudhat më të ftohta dhe më të ngrohta. Ai përshkruan kombinimin e temperaturave të jashtme dhe numrin e orëve gjatë të cilave këto temperatura ndodhin gjatë sezonit të ngrohjes;

89. **"Sistemi i ngrohjes qendrore me bazë uji"** është një sistem që përdor ujin si mjet për transmetimin e nxehtësisë së prodhuar në mënyrë qendrore tek emetuesit e nxehtësisë, për ngrohjen e hapësirave të ndërtesave ose pjesëve të tyre;
90. **"Sistemi i vetëm diellor"** është një pajisje që përmban një ose më shumë kolektorë diellorë dhe depozita për ruajtjen e ujit të ngrohtë, dhe mund të përfshijë gjithashtu pompa në unazën e kolektorit dhe pjesë të tjera. Ky sistem ofrohet në treg si një njësi e plotë dhe nuk është i pajisur me asnjë prodhues nxehtësie përveç një ose më shumë ngrohësve me zhytje, të cilët përdoren si rezerve;
91. **"Shkarkimi i ujit"** është një kombinim i caktuar i normës së dobishme të fluksit të ujit, temperaturës së dobishme të ujit, përmbajtjes së energjisë së dobishme dhe temperaturës maksimale, siç specifikohet në Tabelën 15 të Shtojcës VI;
92. **"Temperatura bivalente"** (T_{biv}) është temperatura e jashtme e deklaruar nga furnizuesi për ngrohjen, ku kapaciteti i deklaruar për ngrohje është i barabartë me ngarkesën e pjesshme të ngrohjes. Nën këtë temperaturë, kapaciteti i deklaruar për ngrohje kërkon kapacitet shtesë për të realizuar ngarkesën e pjesshme për ngrohje, e shprehur në gradë Celsius;
93. **"Temperatura e dobishme e ujit"** (T_m) është temperatura e ujit, e shprehur në gradë Celsius, në të cilën uji i nxehtë fillon të kontribuojë në energjinë e referencës, sipas specifikimeve në Tabelën 15 të Shtojcës VI;
94. **"Temperatura e jashtme"** (T_j) është temperatura e ajrit të jashtëm të ambientit, e shprehur në gradë Celsius. Lagështia relative mund të shprehet përmes temperaturës së lagështirës së ambientit;
95. **"Temperatura e pikut"** (T_f) është temperatura minimale e ujit, e shprehur në gradë Celsius, që duhet arritur gjatë shkarkimit të ujit, siç specifikohet në Tabelën 15 të Shtojcës VI;
96. **"Temperatura e referencës së projektimit"** (*Tdesignh*) është temperatura e jashtme, e shprehur në gradë Celsius, siç përcaktohet në Tabelën 10 të Shtojcës VI, ku raporti i ngarkesës së pjesshme është i barabartë me 1;
97. **"Temperatura kufi e funksionimit të ujit të ngrohjes"** (*WTOL*) është temperatura e ujit në dalje, e deklaruar nga furnizuesi për ngrohje, mbi të cilën ngrohësi i hapësirës me pompë nxehtësie ose ngrohësi i integruar me pompë nxehtësie nuk do të jetë në gjendje të realizojë asnjë kapacitet ngrohjeje, dhe kapaciteti i deklaruar i ngrohjes bëhet i barabartë me zero, e shprehur në gradë Celsius;
98. **"Temperatura kufi e funksionimit"** (*TOL*) është temperatura e jashtme e përcaktuar nga furnizuesi për ngrohje, poshtë së cilës ngrohësi i hapësirës me pompë nxehtësie ajër-ujë, ose ngrohësi i kombinuar me pompë nxehtësie ajër-ujë, nuk është në gjendje të prodhojë asnjë kapacitet ngrohjeje. Në këtë temperaturë, kapaciteti i deklaruar për ngrohje bëhet i barabartë me zero, e shprehur në gradë Celsius;

99. **"Vëllimi i depozitës"** (*V*), për qëllimet e figurave 1 deri në 4 në Shtojcën III të referuara si "vëllimi i depozitës", është vëllimi i vlerësuar i një depozite diellore të ujit të ngrohtë, i shprehur në litra ose m^3;
100 **"Vlera kalorifike bruto"** (*GCV-së*) është sasia totale e nxehtësisë që çlirohet nga një njësi e sasisë së lëndë djegëse kur digjet plotësisht me oksigjen dhe kur produktet e djegies kthehen në temperaturën e ambientit; Kjo sasi përfshin nxehtësinë e kondensimit të çdo avulli të ujit që përmban lënda djegëse dhe të avullit të ujit të formuar nga djegia e hidrogjenit që gjendet në lëndën djegëse;
101 **"Zona e hapjes së kolektorit"** (A_{sol}), për qëllimet e figurave 1 deri në 4 të Shtojcës III të referuara si "madhësia e kolektorit", është zona maksimale e projektuar përmes së cilës hyn në kolektor rrezatimi diellor i pakoncentruar, i shprehur në m^2;

III. DETYRIMET E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit që vendosin në treg ngrohës të hapësirës dhe/ose i vënë ata në shërbim, përfshirë ngrohësit e integruar në sistemet e përbëra nga ngrohës hapësire, me termostat dhe të sisteme diellore, duhet të sigurojnë që:

a. Një etiketë e printuar që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1.1 të Shtojcës II të jepet për çdo ngrohës hapësire që është në përputhje me klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të përcaktuara në pikën 1 të Shtojcës I, ku: për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, etiketa e printuar të jepet në sistemin e prodhuesit të nxehtësisë; për ngrohësit e hapësirës të destinuar për përdorim në sistemet e përbëra nga ngrohës të hapësirës, me termostat dhe sisteme diellore, të jepet një etiketë e dytë për çdo ngrohës hapësire që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës II;
b. Për çdo ngrohës hapësire të jepet një skedë informative produkti, siç përcaktohet në pikën 1 të Shtojcës III, ku: për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, skeda informative e produktit të jepet për prodhuesin e nxehtësisë; ndërkohë për ngrohësit e hapësirës të destinuar për t'u përdorur në sistemet e integruara nga ngrohës të hapësirës, me termostat dhe sisteme diellore, të jepet një skedë informativee dytë, siç përcaktohet në pikën 5 të Shtojcës III;
c. Dokumentacioni teknik t'u jepet me kërkesë strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut siç përcaktohet në pikën 1 të Shtojcës IV;
ç Çdo reklamë që lidhet me një model specifik ngrohës hapësire dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës sipas kushteve mesatare klimatike për atë model;
d. Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik ngrohës hapësire dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik të përfshijë një referencë të klasës së eficencës

së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës sipas kushteve mesatare klimatike për atë model.

f. Te behet e disponueshme për tregtarët një etiketë elektronike në formatin që përmban informacionin e përcaktuar në pikën 1.1 të Shtojces II për çdo model ngrohësi hapësire që përputhet me klasat e efiçences energjetike të ngrohjes hapësinore sezonale të përcaktuara në pikën 1 të Shtojces I;

g. Te vihet në dispozicion të tregtarëve një etikete elektronike e produktit siç përcaktohet në pikën 1 të Shtojces II për çdo model ngrohësi hapësire, ku për modelet e ngrohësve të hapësirës me pompë nxehtësie, fleta elektronike e produktit vihet në dispozicion të tregtarëve të paktën për gjeneratorin e nxehtësisë.

Çdo ngrohës hapësire që vendoset në treg pajiset me një etiketë të printuar që përputhet me klasat të efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të përcaktuara në pikën 1 të Shtojcës I, ku: për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, etiketa e printuar të jepet në sistemin e prodhuesit të nxehtësisë, që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1.2 të Shtojcës II.

2. Furnizuesit që vendosin në treg ngrohës të integruar dhe/ose i vënë ata në shërbim, duke përfshirë ata që janë të integruar në sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, me termostat dhe me sisteme diellore, duhet të sigurojnë që:

a. Për çdo ngrohës hapësire të jepet një etiketë e printuar që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1.1 të Shtojcës II dhe që është në përputhje me klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I, ku: për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, etiketa e printuar të jepet në paketën e prodhuesit të nxehtësisë; ndërkohë që për ngrohësit e integruar të destinuar për përdorim në paketat e përbëra nga ngrohës të hapësirës, me termostat dhe me sistem diellore, të jepet një etiketë e dytë për çdo ngrohës hapësire që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës II;

b. Për çdo ngrohës të integruar të jepet një skedë informative produkti, siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës III, ku: për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, skeda informative e produktit të jepet për prodhuesin e nxehtësisë; për ngrohësit e integruar të destinuar për t'u përdorur në sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, me termostat dhe sisteme diellore, të jepet një skedë informative e dytë, siç përcaktohet në pikën 6 të Shtojcës III;

c. Strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut t'u jepet me kërkesë dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës IV;

ç. Çdo reklamë që lidhet me një model të veçantë ngrohësi të integruar dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale së hapësirës dhe klasën e eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model;

d Çdo material teknik promovues në lidhje me një model të veçantë ngrohësi të integruar dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik duhet të përfshijë një referencë të klasës të

eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasën e eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model.

f Një etiketë elektronike në formatin dhe që përmban informacionin e vendosur në pikën 2.1 të Shtojces II bëhet e disponueshme për tregtarët për secilin model ngrohësish me funksion te dyfishte që përputhet me klasat e efiçences së energjisë për ngrohjen e hapësirave sezionale dhe klasat e efiçences të energjisë për ngrohjen e ujit të vendosura në pikat 1 dhe 2 të Shtojces I;

f. një etikete elektronike e produktit siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojces II te vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model ngrohësish me funksion te dyfishte, ku për modelet e ngrohësve me funksion te dyfishte me pompë nxehtësie, etiketa elektronike e produktit te vihet në dispozicion të tregtarëve të paktën për gjeneratorin e ngrohjes.

Çdo ngrohës me funksion të dyfishtë që vendoset në treg pajiset me një etiketë të printuar që përputhet me klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I, ku: për ngrohësit me funksion të dyfishtë me pompë nxehtësie, etiketa e printuar të jepet në paketën e prodhuesit të nxehtësisë me formatin dhe përmbajtjen e informacionit e përcaktuar në pikën 2.2 të Shtojcës II.

3. Furnizuesit që vendosin në treg termostat dhe/ose i vënë ato në shërbim duhet të sigurojnë që:

a. Të pajisen me një skedë informative produkti, siç përcaktohet në pikën 3 të Shtojcës III

b. Strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut t'u jepet me kërkesë dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 3 të Shtojcës IV.

c. Një etikete elektronike e produktit, siç përcaktohet në pikën 3 të Shtojces II, te bëhet e disponueshme për tregtarët për çdo model termostatesh.

4. Furnizuesit që vendosin në treg sisteme diellore dhe/ose i vënë ato në shërbim duhet të sigurojnë që:

a. Të pajisen me një skedë informative produkti, siç përcaktohet në pikën 4 të Shtojcës III;

b. Strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut t'u jepet me kërkesë dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 4 të Shtojcës IV;

c. Një etikete elektronike e produktit, siç përcaktohet në pikën 4 të Shtojces II, te bëhet e disponueshme për tregtarët për çdo model sistemesh diellore.

5. Furnizuesit që vendosin në treg sistemet e përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore dhe/ose i vënë ato në shërbim duhet të sigurojnë që:

a. Të pajisen me një etiketë të printuar që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës II për çdo sistem të përberë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore në përputhje me klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të përcaktuara në pikën 1 të Shtojcës I;

b. Për çdo sistem të përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore të sigurohet një skedë informative produkti, siç përcaktohet në pikën 5 të Shtojcës III;

c. Strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut t'u jepet me kërkesë dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 5 të Shtojcës IV;

ç. Çdo reklamë që lidhet me një sistem specifik të përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushtet mesatare klimatike për atë model;

d. Çdo material teknik promovues në lidhje me një sistem specifik të përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushtet mesatare klimatike për atë model.

6. Furnizuesit që vendosin në treg sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore dhe/ose i vënë ato në shërbim duhet të sigurojnë që:

a. Të pajisen me një etiketë të printuar që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 4 të Shtojcës II për çdo sistem të përbërë nga ngrohës të kombinuar, termostat dhe sisteme diellore në përputhje me klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I;

b. Për çdo sistem të përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore të sigurohet një skedë informativeprodukti, siç përcaktohet në pikën 6 të Shtojcës III;

c. strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut t'u jepet me kërkesë dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 6 të Shtojcës IV;

ç. Çdo reklamë që lidhet me një sistem specifik të përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasën e eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model;

d. Çdo material teknik promovues në lidhje me një sistem specifik të përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasën e eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model.

IV. DETYRIMET E TREGTARËVE

1. Tregtarët e ngrohësve të hapësirës sigurojnë që:

a. Çdo ngrohës i hapësirës, në pikën e shitjes, duhet të ketë etiketën e dhënë nga furnizuesit në përputhje me kreun 3(1), siç përcaktohet në pikën 1 të Shtojcës II, në pjesën e jashtme të pjesës së përparme të pajisjes, në mënyrë të tillë që të jetë sa më e dukshme;

b. Ngrohësit e hapësirës të ofruar për shitje, qira ose qira-blerje, ku nuk mund të pritet që përdoruesi përfundimtar të shohë ngrohësin e hapësirës të ekspozuar, tregtohen me

informacionin të ofruar nga furnizuesit në përputhje me pikën 1 të Shtojces V, përveç rastit kur oferta bëhet përmes internetit, në këtë rast zbatohen dispozitat e ShtojcesVIII.

c. Çdo reklamë që lidhet me një model specifik ngrohësish të hapësirës dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushtet mesatare klimatike për atë model;

ç. Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik të ngrohësve të hapësirës dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushtet mesatare klimatike për atë model.

2. Tregtarët e ngrohësve të integruar duhet të sigurojnë që:

a. Çdo sistem i integruar ngrohësish, në pikën e shitjes, duhet të ketë etiketën e dhënë nga furnizuesit në përputhje me kreun 3(2), siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës II, në pjesën e jashtme të pjesës së përparme të pajisjes, në mënyrë të tillë që të jetë qartësisht e dukshme;

b. Ngrohësit e integruar të ofruar për shitje, qira ose qira-blerje, ku përdoruesi përfundimtar nuk mund ta shohë ngrohësin me sisteme të integruara të ekspozuar, merren në treg me informacionin e ofruar nga furnizuesit në përputhje me nenin 2 të Shtojces IV, përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, në të cilën rast zbatohen dispozitat e Shtojces VII;

c. Çdo reklamë që lidhet me një model të veçantë sistemi të integruar ngrohësish dhe që përmban informacione lidhur me energjinë ose çmimin duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model;

ç. Çdo material teknik promovues në lidhje me një model të veçantë të sistemesh të integruara ngrohësish dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik duhet të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model.

3. Tregtarët e sistemeve të përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore, bazuar në etiketën dhe skedat informativenga furnizuesit në përputhje me kreun 3 (1), (3), (4) dhe (5), duhet të sigurojnë që:

a. Çdo ofertë për një sistem specifik të përfshijë eficencën e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasën e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës për atë sistem në kushte klimatike mesatare, më të ftohta ose më të ngrohta, sipas rastit, duke shfaqur me anë të sistemit etiketën e përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës II dhe duke siguruar skedë informative të përcaktuar në pikën 5 të Shtojcës III, të plotësuar siç duhet sipas karakteristikave të atij sistemi;

b. sistemeve të përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore të ofruara për shitje, qira ose qira-me-blerje, ku përdoruesi përfundimtar nuk mund të pritet të shohë paketën e sistemeve të përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore të ekspozuara, tregtohen me informacionin e dhënë në përputhje me pikën 3 të Shtojces IV,

përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, në këtë rast zbatohen dispozitat e Shtojces VII;

c. Çdo reklamë që lidhet me një sistem specifik të modelit të përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sistem diellore dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushtet mesatare klimatike për atë model;

ç. Çdo material teknik promovues në lidhje me një sistem specifik të përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik të përfshijë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushtet mesatare klimatike për atë model.

4. Tregtarët e sistemeve të përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore, bazuar në etiketën dhe skedat informative e ofruara nga furnizuesit në përputhje me kreun 3, pika 2, 3, 4 dhe 6, duhet të sigurojnë që:

a. Çdo ofertë për një sistem specifik të përbërë nga ngrohës të integruar, thermostat dhe sisteme diellore të përfshijnë eficencën e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës, eficencën e energjisë së ngrohjes së ujit, klasën e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasën e eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit për atë sistem në kushte klimatike mesatare, më të ftohta ose më të ngrohta, sipas rastit, duke shfaqur së bashku me sistemin etiketën e përcaktuar në pikën 4 të Shtojcës II dhe duke siguruar skedë informative të përcaktuar në pikën 6 të Shtojcës III , të plotësuar siç duhet sipas karakteristikave të atij sistemi;

b. sistemeve të përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore të ofruara për shitje, qira ose blerje me qira, ku përdoruesi përfundimtar nuk mund të pritet të shohë sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore të ekspozuar, shiten me informacionin e dhënë në përputhje me pikën 4 të Shtojces IV, përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, në këtë rast zbatohen dispozitat e Shtojces VII.

c. Çdo reklamë që lidhet me një sistem specifik të përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, të përfshijnë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model;

ç. Çdo material teknik promovues në lidhje me një sistem specifik të modelit të përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore dhe që përshkruajnë parametrat e tij specifik teknik duhet të përfshijnë një referencë të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe të klasës së eficencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model.

V. METODAT E MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni që jepet në përputhje me krerët III dhe IV merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes, siç përcaktohet në Shtojcën VI.

VI. PROÇEDURA E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I
Klasat e efiçencës së energjisë

1. KLASAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË SË NGROHËSVE SEZONALE TË HAPËSIRËS

Me përjashtim të pompave të nxehtësisë dhe ngrohësve të hapësirës me pompë nxehtësie të destinuara për përdorim në temperatura të ulëta, klasa e efiçencës të energjisë për ngrohjen sezonale të hapësirës përcaktohet sipas efikasitetit të saj sezonal të ngrohjes, siç specifikohet në Tabelën 1.
Klasat e efiçencës të energjisë për ngrohjen sezonale të hapësirës për një pompë nxehtësie dhe një ngrohës hapësire me pompë nxehtësie për përdorim në temperatura të ulëta përcaktohen bazuar në efiçencës e tyre sezonal të ngrohjes së hapësirës, siç përcaktohet në Tabelën 2.
Efiçenca e energjisë për ngrohjen sezonale të hapësirës së një ngrohësi llogaritet sipas pikave 3 dhe 4 të Shtojcës VI, për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie dhe pompat e nxehtësisë të destinuara për përdorim në temperatura të ulëta, në kushte klimatike mesatare.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të ngrohësve, me përjashtim të pompave të nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët dhe ngrohësve të hapësirës me pompë nxehtësie për përdorim në temperaturë të ulët

Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës	Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës η_s në %
A+++	$\eta_s \geq 150$
A++	$125 \leq \eta_s < 150$
A+	$98 \leq \eta_s < 125$
A	$90 \leq \eta_s < 98$
B	$82 \leq \eta_s < 90$
C	$75 \leq \eta_s < 82$
D	$36 \leq \eta_s < 75$
E	$34 \leq \eta_s < 36$

F	$30 \leq \eta_s < 34$
G	$\eta_s < 30$

Tabela 2

Klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës së pompave të nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët dhe ngrohësve të hapësirës me pompë nxehtësie për përdorim në temperaturë të ulët

Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës	Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës η_s ne %
Një +++	$\eta_s \geq 175$
Një ++	$150 \leq \eta_s < 175$
A +	$123 \leq \eta_s < 150$
A	$115 \leq \eta_s < 123$
B	$107 \leq \eta_s < 115$
C	$100 \leq \eta_s < 107$
D	$61 \leq \eta_s < 100$
E	$59 \leq \eta_s < 61$
F	$55 \leq \eta_s < 59$
G	$\eta_s < 55$

2. KLASAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË SË NGROHJES SË UJIT

Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit së një ngrohësi të integruar përcaktohet në bazë të efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit, siç përshkruhet në Tabelën 3.
Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit e një ngrohësi të integruar llogaritet në përputhje me pikën 5 të Shtojcës VI .

Tabela 3

Klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësve të integruar, të kategorizuara sipas profileve të ngarkesës së deklaruar, η_{eh} në %

	3XS	XXS	XS	S	M	L	XL	XXL
A+++	$\eta_{eh} \geq 62$	$\eta_{eh} \geq 62$	$\eta_{eh} \geq 69$	$\eta_{eh} \geq 90$	$\eta_{eh} \geq 163$	$\eta_{eh} \geq 188$	$\eta_{eh} \geq 200$	$\eta_{eh} \geq 213$
A++	$53 \leq \eta_{eh} < 62$	$53 \leq \eta_{eh} < 62$	$61 \leq \eta_{eh} < 69$	$72 \leq \eta_{eh} < 90$	$130 \leq \eta_{eh} < 163$	$150 \leq \eta_{eh} < 188$	$160 \leq \eta_{eh} < 200$	$170 \leq \eta_{eh} < 213$
A+	$44 \leq \eta_{eh} < 53$	$44 \leq \eta_{eh} < 53$	$53 \leq \eta_{eh} < 61$	$55 \leq \eta_{eh} < 72$	$100 \leq \eta_{eh} < 130$	$115 \leq \eta_{eh} < 150$	$123 \leq \eta_{eh} < 160$	$131 \leq \eta_{eh} < 170$
A	$35 \leq \eta_{eh} < 44$	$35 \leq \eta_{eh} < 44$	$38 \leq \eta_{eh} < 53$	$38 \leq \eta_{eh} < 55$	$65 \leq \eta_{eh} < 100$	$75 \leq \eta_{eh} < 115$	$80 \leq \eta_{eh} < 123$	$85 \leq \eta_{eh} < 131$
B	$32 \leq \eta_{eh} < 35$	$32 \leq \eta_{eh} < 35$	$35 \leq \eta_{eh} < 38$	$35 \leq \eta_{eh} < 38$	$39 \leq \eta_{eh} < 65$	$50 \leq \eta_{eh} < 75$	$55 \leq \eta_{eh} < 80$	$60 \leq \eta_{eh} < 85$
C	$29 \leq \eta_{eh} < 32$	$29 \leq \eta_{eh} < 32$	$32 \leq \eta_{eh} < 35$	$32 \leq \eta_{eh} < 35$	$36 \leq \eta_{eh} < 39$	$37 \leq \eta_{eh} < 50$	$38 \leq \eta_{eh} < 55$	$40 \leq \eta_{eh} < 60$
D	$26 \leq \eta_{eh} < 29$	$26 \leq \eta_{eh} < 29$	$29 \leq \eta_{eh} < 32$	$29 \leq \eta_{eh} < 32$	$33 \leq \eta_{eh} < 36$	$34 \leq \eta_{eh} < 37$	$35 \leq \eta_{eh} < 38$	$36 \leq \eta_{eh} < 40$
E	$22 \leq \eta_{eh} < 26$	$23 \leq \eta_{eh} < 26$	$26 \leq \eta_{eh} < 29$	$26 \leq \eta_{eh} < 29$	$30 \leq \eta_{eh} < 33$	$30 \leq \eta_{eh} < 34$	$30 \leq \eta_{eh} < 35$	$32 \leq \eta_{eh} < 36$
F	$19 \leq \eta_{eh} < 22$	$20 \leq \eta_{eh} < 23$	$23 \leq \eta_{eh} < 26$	$23 \leq \eta_{eh} < 26$	$27 \leq \eta_{eh} < 30$	$27 \leq \eta_{eh} < 30$	$27 \leq \eta_{eh} < 30$	$28 \leq \eta_{eh} < 32$
G	$\eta_{eh} < 19$	$\eta_{eh} < 20$	$\eta_{eh} < 23$	$\eta_{eh} < 23$	$\eta_{eh} < 27$	$\eta_{eh} < 27$	$\eta_{eh} < 27$	$\eta_{eh} < 28$

3. KLASET E EFIÇENCËS SË ENERGJISË SË DEPOZITAVE DIELLORE TË UJIT TË NGROHTË, NËSE (JANË PJESË E) NJË SISTEMI DIELLOR

Klasa e efiçencës së energjisë së një depozite diellore e ujit të ngrohtë, nëse (është pjesë) e një sistemi diellor, përcaktohet në bazë të humbjes termike, siç përcaktohet në Tabelën 4.

Tabela 4

Klasat e efiçencës së energjisë së depozitave diellore të ujit të ngrohtë , nëse (është pjesë e) një sistemi diellor

Klasa e efiçencës së energjisë	Humbja termike S e shprehur në Ëatt, me vëllim ruajtjeje V të shprehur në litra
A+	$S < 5,5 + 3,16 \cdot V^{0,4}$
A	$5,5 + 3,16 \cdot V^{0,4} \leq S < 8,5 + 4,25 \cdot V^{0,4}$
B	$8,5 + 4,25 \cdot V^{0,4} \leq S < 12 + 5,93 \cdot V^{0,4}$
C	$12 + 5,93 \cdot V^{0,4} \leq S < 16,66 + 8,33 \cdot V^{0,4}$
D	$16,66 + 8,33 \cdot V^{0,4} \leq S < 21 + 10,33 \cdot V^{0,4}$
E	$21 + 10,33 \cdot V^{0,4} \leq S < 26 + 13,66 \cdot V^{0,4}$
F	$26 + 13,66 \cdot V^{0,4} \leq S < 31 + 16,66 \cdot V^{0,4}$
G	$S > 31 + 16,66 \cdot V^{0,4}$

SHTOJCA II
Etiketat

1. NGROHËSIT HAPËSIRËS

1.1. Etiketa 1

1.1.1. ***Kaldajat e ngrohjes së hapësirës në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A⁺⁺ deri në G***



I, II

III

IV

VI, V

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:
I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;
II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;
III. Funksioni i ngrohjes së hapësirës;
IV. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I ; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të kaldajës, e cila vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;
V. Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë në kW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
VI. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në ambiente të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për kaldajat e ngrohjes së hapësirës janë në përputhje me pikën 5 të kësaj Shtojce.

1.1.2. ***Ngrohësit e hapësirës me kogjenerim në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A^{++} deri në G***



I, II

III

IV

VI, V

VII

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Funksioni i ngrohjes së hapësirës;

IV. Klasa e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I ; koka e shigjetës që përmban klasën e eficencës së

energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të ngrohësit të hapësirës me kogjenerim vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të eficencës së energjisë;

V. Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë në kW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VI. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në ambiente të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

VII. Funksioni shtesë i prodhimit të energjisë elektrike.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e hapësirës me kogjenerim janë në përputhje me pikën 6 të kësaj Shtojce.

1.1.3. *Ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, përveç pompave të nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët, në klasat e eficencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A ++ deri në G*



I, II

III

IV

VII, V

VI

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Funksioni i ngrohjes së hapësirës për përdorim përkatësisht në temperaturë mesatare dhe të ulët;

IV. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushte mesatare klimatike për përdorim, përkatësisht, në temperaturë mesatare dhe të ulët, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I ; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të ngrohësit të hapësirës me pompë nxehtësie për përdorim, përkatësisht, në temperaturë mesatare dhe të ulët, e cila vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të eficençës së energjisë;

V. Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë, duke përfshirë prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë së çdo ngrohësi shtesë, në kW, në kushte klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta për përdorim, respektivisht, në temperaturë mesatare dhe të ulët, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VI. Harta e temperaturës evropiane që shfaq tre zona treguese të temperaturës;

VII. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, brenda (nëse është e aplikueshme) dhe jashtë, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie janë në përputhje me pikën 7 të kësaj Shtojce. Përjashtimisht, mund të shtohet një kopje e Etiketës ekologjike të BE-së kur një modeli i është dhënë një "Etiketë ekologjike) nëse do të jetë i disponueshëm në legjislacionin shqiptar.

1.1.4. *Pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A ++ deri në G*



I, II

III

IV

VII, V

VI

(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm :

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Funksioni i ngrohjes së hapësirës për përdorim në temperaturë të ulët;

IV.Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushte mesatare klimatike, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I ; koka e shigjetës që përmban

klasën e eficçncës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të pompës së nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të eficencës së energjisë;

V. Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë, duke përfshirë prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë së çdo ngrohësi shtesë, në kW, në kushte mesatare klimatike, më të ftohta dhe më të ngrohta, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

VI. Harta e temperaturave evropiane që shfaq tre zona treguese të temperaturës;

VII. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, brenda (nëse është e aplikueshme) dhe jashtë, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët janë në përputhje me pikën 8 të kësaj Shtojce. Përjashtimisht, mund të shtohet një kopje e Etiketës ekologjike të BE-së kur një modeli i është dhënë një "Etiketë ekologjike nëse do të jetë i disponueshëm në legjislacionin shqiptar.

1.2. Etiketa 2

1.2.1. *Kaldajat e ngrohjes së hapësirës në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A $^{+++}$ deri në D*



I, II

III

IV

VI, V

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.1(a) të kësaj Shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për kaldajat e ngrohjes së hapësirës janë në përputhje me pikën 5 të kësaj Shtojce.

1.2.2. ***Ngrohësit e hapësirës me kogjenerim në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A +++ deri në D***



I, II

III

IV

VI, V

VII

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.2(a) të kësaj Shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e hapësirës me kogjenerim janë në përputhje me pikën 6 të kësaj Shtojce.

1.2.3. ***Ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, përveç pompave të nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët, në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A +++ deri në D***



I, II

III

IV

VII, V

VI

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.3(a) të kësaj Shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie janë në përputhje me pikën 7 të kësaj Shtojce.

1.2.4. ***Pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A +++ deri në D***



I, II

III

IV

VII, V

VI

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.4(a) të kësaj Shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët janë në përputhje me pikën 8 të kësaj Shtojce.

2. NGROHËSIT E INTEGRUAR

2.1. Etiketa 1

2.1.1 ***Kaldajat e integruara të ngrohjes në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A ++ deri në G dhe në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A deri në G***



I, II

III

IV

VI, V, VII

(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm :

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Funksioni i ngrohjes së hapësirës dhe funksioni i ngrohjes së ujit, duke përfshirë profilin e ngarkesës së deklaruar të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 15 të Shtojcës VI;

IV. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit, të përcaktuara në përputhje me pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I; koka e shigjetave që përmbajnë klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të kaldajës së integruar të ngrohjes, që vendosen në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

V. Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë në kW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VI. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në ambiente të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

VII. Për kaldajat e intergruara të ngrohjes që janë në gjendje të punojnë vetëm gjatë orëve jashtë pikut, mund të shtohet piktogrami i përmendur në pikën 9(ç)(11) të kësaj Shtojce.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për kaldajat e integruara të ngrohjes janë në përputhje me pikën 9 të kësaj Shtojce.

2.1.2. ***Ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A ++ deri në G dhe në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A deri në G***



I, II

III

IV

VII, VI, V

VIII

(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm :

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III.Funksioni i ngrohjes së hapësirës për përdorim në temperaturë mesatare dhe funksioni e ngrohjes së ujit, duke përfshirë profilin e deklaruar të ngarkesës të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 15 të Shtojcës VI ;

IV. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në kushtet klimatike mesatare për përdorim në temperaturë mesatare dhe klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushte mesatare klimatike, e përcaktuar në përputhje me pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I; koka e shigjetave që përmbajnë klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësit të integruar me pompë nxehtësie vendosen në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

V. Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë, duke përfshirë prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë së çdo ngrohësi shtesë, në kW, në kushte klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VI. Harta e temperaturave evropiane që shfaq tre zona treguese të temperaturës;

VII. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, brenda (nëse aplikohet) dhe jashtë, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VIII. Për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie të aftë për të punuar vetëm gjatë orëve jashtë pikut, mund të shtohet piktogrami i përmendur në pikën 10(ç)(12) të kësaj Shtojce.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie janë në përputhje me pikën 10 të kësaj Shtojce.

2.2. Etiketa 2

2.2.1. *Kaldajat e integruara të ngrohjes në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A^{+++} deri në D dhe në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A^{+} deri në F*



I, II

III

IV

VI, V, VII

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 2.1.1(a) të kësaj Shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për kaldajat e integruara të ngrohjes janë në përputhje me pikën 9 të kësaj Shtojce.

2.2.2. ***Ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A +++ deri në D dhe në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A + deri në F***



I, II

III

IV

VII, VI, V

VIII

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 2.1.2(a) të kësaj Shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës së ngrohësit të integruar me pompë nxehtësie janë në përputhje me pikën 10 të kësaj Shtojce.

3. SISTEMET E PËRBERA NGA NGROHËS HAPËSIRE, TERMOSTAT DHE SISTEME DIELLORE

Etiketa për sistemet e përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A +++ deri në G



(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm :

I. Emrin ose marka tregtare e shitësit dhe/ose e furnizuesit;

II. Identifikuesi i modelit(ve) të shitësit dhe/ose të furnizuesit;

III. Funksioni i ngrohjes së hapësirës;

IV.Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës së ngrohësit të hapësirës, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I ;

V. Treguesi që tregon se nëse kolektori diellor, depozita e ujit të ngrohtë, termostati dhe/ose ngrohësi shtesë i hapësirës mund të përfshihen, apo jo, në sistemin e përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore;

VI. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të sistemit së përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore, e përcaktuar në përputhje me pikën 5 të Shtojcës III; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të sistemit të përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore që vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për sistemet e përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore janë në përputhje me pikën 11 të kësaj Shtojce. Për sistemet e përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës A $^{+++}$ deri në D, në shkallën A $^{+++}$ deri në G mund të hiqen klasat e fundit nga E deri në G.

4. SISTEMET E PËRBERA NGA NGROHËS TË INTEGRUAR, TERMOSTAT DHE SISTEME DIELLORE

Etiketa për sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe ngrohjes së ujit nga A $^{+++}$ deri në G



(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm :

I. Emri ose marka tregtare e shitësit dhe/ose e furnizuesit;

II. Identifikuesi i modelit(ve) të shitësit dhe/ose e furnizuesit;

III.Funksioni i ngrohjes së hapësirës dhe funksioni i ngrohjes së ujit, duke përfshirë profilin e ngarkesës së deklaruar të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 15 të Shtojcës VI ;

IV.Klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe ngrohjes së ujit të ngrohësit të integruar, të përcaktuara në përputhje me pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I ;

V. Treguesi që tregon se nëse një kolektor diellor, një depozitë e ujit të ngrohtë, termostat dhe/ose një ngrohës shtesë, mund të përfshihen, apo jo, në sistemin e përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore;

VI. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës së sistemit të përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore, e përcaktuar në përputhje me pikën 6 të Shtojcës III; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës të sistemit së përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore që vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

VII. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të sistemit së përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore, e përcaktuar në përputhje me pikën 6 të Shtojcës III ; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të sistemit së përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore janë në përputhje me pikën 12 të kësaj Shtojce. Për sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe/ose të ngrohjes së ujit nga A^{+++} deri në D, në shkallën A^{+++} deri në G mund të hiqen klasat e fundit nga E deri në G.

5. Projektimi i etiketës së kaldajës së ngrohjes së hapësirës është si më poshtë:


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
3 mm
3 mm
1
2
ENERG
енергия · ενεργεια
Y
IJA
IE
IA
11
12
4
I
II
5
6
A++
A+
A
B
C
D
E
F
G
A++
7
12 mm
5 mm
200 mm
8
YZ dB
YZ kW
9
10
2015
811/2013
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
105 mm

Ku:

(a) Etiketa është, së paku, 105 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.
(b) Sfondi është i bardhë.
(c) Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % e zezë.
(ç) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶**Shtrirja e kufirit të etiketës së BE-së:** 4 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
❸**Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 86 mm, lartësia: 17 mm.
❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 86 mm.
❺ **Funksioni i ngrohjes së hapësirës:**
- **Piktogrami** siç përshkruhet.

❻**A $^{++}$-G dhe A $^{+++}$-D, përkatësisht:**
- **Shigjeta:** lartësia: 5 mm, hapësira: 1,3 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e shtatë: 00-XX-00,
  - Klasa e tetë: 00-XX-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 14 pt, kapitale, të bardha, simbolet "+": mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm;
- **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, kapitale, të bardha, simbolet "+": mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm.

❼**Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës:**

- **Shigjeta:** gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 24 pt, kapitale, të bardha, simbolet "+": mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm.

❽ **Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda** :
- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,
- **Vlera "YZ":** në formatin Calibri bold 20 pt, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti "dB":** shkronjat në formatin Calibri regular 15 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❾ **Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë:**
- **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,
- **Vlera "YZ":** në formatin Calibri bold 45 pt, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti "kË":** shkronjat në formatin Calibri regular 30 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❿ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Vendimit:**
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

⓫ **Emri i furnizuesit ose marka tregtare.**

⓬ **Identifikuesi i modelit të furnizuesit:**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 86 × 12 mm.

6. Projektimi i etiketës së ngrohësit e hapësirës me kogjenerim është si më poshtë:


3
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3 mm
3 mm
1
2
ENERG
Y
IJA
IE
IA
енергия · ενεργεια
12
13
4
I
II
5
6
A++
A+
A
B
C
D
E
F
G
A++
7
12 mm
5 mm
200 mm
8
YZ dB
YZ kW
9
10
11
2015
811/2013
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
105 mm

Ku:

(a) Etiketa është, së paku, 105 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është i bardhë.

(c) Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt , e verdhë dhe e zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % e zezë.

(ç) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶**Shtrirja e kufirit të etiketës së BE-së:** 4 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸**Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 86 mm, lartësia: 17 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 86 mm.

❺ **Funksioni i ngrohjes së hapësirës:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet.

❻**A $^{++}$-G dhe A $^{+++}$-D, përkatësisht:**

- **Shigjeta:** lartësia: 5 mm, hapësira: 1,3 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
Pompë nxehtësie për përdorim në temperaturë të ulët: [po/jo]								
E pajisur me një ngrohës shtesë: [po/jo]								
Ngrohës të integruar me pompë nxehtësie: [po/jo]								
Parametrat deklarohen për përdorim në temperaturë mesatare, me përjashtim të pompave të nxehtësisë për temperaturë të ulët. Për pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët, parametrat deklarohen për përdorim në temperaturë të ulët.								
Parametrat deklarohen për kushtet klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta.								
Artikulli	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**		**Artikulli**	**Simboli**	**Vlera**	**Njësia**
Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë(3)	*Prated*	x	kW		**Efiçenca e energjisë së ngrohjes**	η_s	x	%

					sezonale të hapësirës			
Kapaciteti i deklaruar i ngrohjes së ngarkesës së pjesshme në temperaturën e brendshme 20 °C dhe temperaturën e jashtme T_j					Koeficienti i deklaruar i performancës ose raporti i energjisë parësore së ngarkesës së pjesshme në temperaturën e brendshme 20 °C dhe temperaturën e jashtme T_j			
T_j = – 7 °C	*Pdh*	x, x	kW		T_j = – 7 °C	*COPd ose PERd*	x, xx ose x, x	– ose %
T_j = + 2 °C	*Pdh*	x, x	kW		T_j = + 2 °C	*COPd ose PERd*	x, xx ose x, x	– ose %
T_j = + 7 °C	*Pdh*	x, x	kW		T_j = + 7 °C	*COPd ose PERd*	x, xx ose x, x	– ose %
T_j = + 12 °C	*Pdh*	x, x	kW		T_j = + 12 °C	*COPd ose PERd*	x, xx ose x, x	– ose %
T_j = Temperaturë bivalente	*Pdh*	x, x	kW		T_j = Temperaturë dyvalente	*COPd ose PERd*	x, xx ose x, x	– ose %
T_j = Temperatura kufi e funksionimit	*Pdh*	x, x	kW		T_j = Temperatura kufi e funksionimit	*COPd ose PERd*	x, xx ose x, x	– ose %
Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: T_j = – 15 °C (nëse *TOL* < – 20 °C)	*Pdh*	x, x	kW		Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: T_j = – 15 °C (nëse *TOL* < – 20 °C)	*COPd ose PERd*	x, xx ose x, x	– ose %
Temperatura bivalente	T_{biv}	x	°C		Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: Temperatura kufitare e funksionimit	*TOL*	x	°C

Kapaciteti i intervalit të ciklit për ngrohje	*Pcych*	x, x	kW		Efiçenca e intervalit të ciklit	*COPcyc ose PERcyc*	x, xx ose x, x	– ose %
Koefiçienti i humbjes së efiçencës (4)	*Cdh*	x, x	-		Temperatura kufi e funksionimit të ujit të ngrohjes	*WTOL*	x	°C
Konsumi i energjisë në modalitetet që janë të ndryshme nga modaliteti aktiv					Ngrohës plotësues			
Modaliteti i fikur	P_{OFF}	x, xxx	kW		Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë (4)	*Psup*	x, x	kW
Modaliteti i fikur i termostatit	P_{TO}	x, xxx	kW					
Modaliteti i gatishmërisë	P_{SB}	x, xxx	kW		Lloji i energjisë			
Modaliteti i ngrohësit të karterit	P_{CK}	x, xxx	kW					
Artikuj të tjerë								
Kontrolli i kapacitetit	Fiks/i ndryshueshëm				Për pompat e nxehtësisë ajër-ujë: Norma e vlerësuar e fluksit të ajrit, jashtë	-	x	m^3/ orë
Niveli i fuqisë së zhurmës,	L_{EA}	x / x	dB		Për pompat e nxehtësisë ujë ose ujë	-	x	m^3/ orë

brenda/jashtë					nëntokësor-ujë: norma e vlerësuar e fluksit të ujit të kripur ose e ujit, shkëmbyesi i jashtëm i nxehtësisë			
Konsumi vjetor i energjisë	Q_{HE}	x	kWh ose GJ					
Për ngrohësin e integruar me pompë nxehtësie:								
Profili i ngarkesës së deklaruar	X				**Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit**	η_{wh}	x	%
Konsumi ditor i energjisë elektrike	Q_{zgjedh}	x, xxx	kWh		Konsumi ditor i lëndës djegëse	$Q_{lëndë djegëse}$	x, xxx	kWh
Konsumi vjetor i energjisë elektrike	*AEC*	x	kWh		Konsumi vjetor i lëndë djegëse	*AFC*	x	GJ
Detajet e kontaktit	Emri dhe adresa e furnizuesit.							

3. KONTROLLET E TEMPERATURËS

Dokumentacioni teknik i përmendur në kreun 3(3)(b) për termostatet, përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) Një përshkrim të modelit të termostatit i mjaftueshëm për identifikimin e tij të qartë;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(ç) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(d) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(dh) Parametrat teknikë:

- Klasa e termostatëve;
- Kontributi i termostatëve në efiçencën e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në %, i rrumbullakosur në një numër dhjetor;

(e)Çdo masë paraprake specifike që merret kur termostati montohet, instalohet ose mirëmbahet.

4. SISTEMET DIELLORE

Dokumentacioni teknik i përmendur në kreun 3(4)(b) për sistemet diellore, përfshin:
(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;
(b)Një përshkrim të modelit të sistemit diellor i mjaftueshëm për identifikimin e tij të qartë;
(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;
(ç) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;
(d) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;
(dh)Parametrat teknikë (për pompat në unazën e kolektorit, nëse përdoret):
- Zona e hapjes së kolektorit A_{sol} në m^2, me dy shifra dhjetore;
- Efiçenca e kolektorit η_{col} në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
- Klasa e efiçencës së energjisë së depozitës së ujit të ngrohtë diellor, e përcaktuar në përputhje me pikën 3 të Shtojcës I ;
- Humbja termike S e depozitës diellore të ujit të ngrohtë në W, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
- Vëllimi i ruajtjes V i depozitës diellore të ujit të ngrohtë në litra dhe m^3;
- Kontributi vjetor i nxehtësisë jo diellore Q_{nonsol} në kWh në terma të energjisë parësore për energjinë elektrike dhe/ose në kWh në terma të GCV-së për lëndët djegëse, për profilet e ngarkesës M, L, XL dhe XXL në kushte mesatare klimatike, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;
- *Solpompa* e konsumit të energjisë së pompës në W, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
- Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë *solstandby* në W, deri në dy shifra dhjetore;
- Konsumi vjetor i energjisë elektrike ndihmëse Q_{aux} në kWh në terma të energjisë përfundimtare, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(e)Çdo masë paraprake specifike që merret kur sistemi diellor montohet, instalohet ose mirëmbahet.

5. SISTEMET E PËRBËRA NGA NGROHËS HAPËSIRE, TERMOSTAT DHE SISTEME DIELLORE

Dokumentacioni teknik i përmendur në kreun 3(5)(c) për sistemet e përbëra nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore , përfshin:
(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;
(b)Një përshkrim të sistemit të modelit të përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore i mjaftueshëm për identifikimin e saj të qartë;
(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;
(ç) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;
(d) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(dh)Parametrat teknikë:

-Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

- Parametrat teknikë të përcaktuar në pikat 1, 3 dhe 4 të kësaj Shtojce;

(e)Çdo masë paraprake specifike që merret kur montohet, instalohet ose mirëmbahet sistemi i përbërë nga ngrohës hapësire, termostat dhe sisteme diellore .

6. SISTEMET E PËRBERA NGA NGROHËS TË INTEGRUAR, TERMOSTAT DHE SISTEME DIELLORE

Dokumentacioni teknik i përmendur në kreun 3(6)(c) për sistemet e përbëra nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore, përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b)Një përshkrim i sistemit së modelit të përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe i sistemeve diellore i mjaftueshëm për identifikimin e saj të qartë;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(ç) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(d) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(dh)Parametrat teknikë:

-Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

- Parametrat teknikë të përcaktuar në pikat 2, 3 dhe 4 të kësaj Shtojce;

(g)Çdo masë paraprake specifike që merret kur montohet, instalohet ose mirëmbahet sistemi i përbërë nga ngrohës të integruar, termostat dhe sisteme diellore.

SHTOJCA V

Informacioni që duhet të jepet në rastet kur përdoruesit fundore nuk pritet t shohin produktin të ekspozuar, përveç në internet

1. NGROHËSIT E HAPËSIRËS

1.1. Informacioni i përmendur në kreun 4(1)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës së modelit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I ;

(b) Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë, duke përfshirë prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë së çdo ngrohësi shtesë, në kW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt (për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike);

(c) Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikat 3 dhe 4 të Shtojcës VI (për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike);

(ç) Konsumi vjetor i energjisë në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose në GJ në terma të *GCV*-së, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikat 3 dhe 4 të Shtojcës VI (për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike) ;

(d) Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në ambiente të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt (për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie, nëse përdoret);

Përveç kësaj, për ngrohësit e hapësirës me kogjenerim:

(dh) Efiçenca elektrike në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Gjithashtu, për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie:

(e) Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë, duke përfshirë prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë së çdo ngrohësi shtesë, në kW, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(ë) Efiçenca sezonale e energjisë së ngrohjes e hapësirës në %, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VI ;

(f) Konsumi vjetor i energjisë në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose në GJ në terma të *GCV*-së, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VI ;

(g) Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, jashtë, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Përveç kësaj, për pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët:

(gj) Një tregues që pompa e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët është e përshtatshme vetëm për përdorim në temperaturë të ulët;

1.2. Madhësia dhe shkronja në të cilin shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikën 1.1 duhet të jenë të lexueshme.

2. NGROHËSIT E INTEGRUAR

2.1.Informacioni i përmendur në kreun 4(2)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a)Për ngrohjen e hapësirës, përdorimi në temperaturë mesatare; për ngrohjen e ujit, profili i deklaruar të ngarkesës, i shprehur si shkronja e duhur dhe përdorimi tipik në përputhje me Tabelën 15 të Shtojcës VI ;

(b)Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të modelit, të përcaktuara në përputhje me pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I ;

(c)Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë, duke përfshirë prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë së çdo ngrohësi shtesë, në kW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt (për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike);

(ç)Për ngrohjen e hapësirës, konsumi vjetor i energjisë në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose në GJ në terma të *GCV*-së, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikat 3 dhe 4 të Shtojcës VI (për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, në kushtet mesatare klimatike); për ngrohjen e ujit, konsumi vjetor i energjisë elektrike në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëse në GJ në terma *GCV*-së, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 5 të Shtojcës VI (për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike);

(d)Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikat 3 dhe 4 të Shtojcës VI (për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike); efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikën 5 të Shtojcës VI (për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike);

(dh)Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në ambiente të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt (për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, nëse përdoret);

(e)Një tregues që tregon se një ngrohës i integruar është në gjendje të punojë vetëm gjatë orëve jashtë pikut, nëse përdoret;

Përveç kësaj, për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie:

(ë)Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë, duke përfshirë prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë së çdo ngrohësi shtesë, në kW, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(f)Për ngrohjen e hapësirës, konsumi vjetor i energjisë në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose në GJ në terma të *GCV*-së, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VI ; për ngrohjen e ujit, konsumi vjetor i energjisë elektrike në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëse në GJ në terma *GCV*-së, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 5 të Shtojcës VI ;

(g)Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në %, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VI ; efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikën 5 të Shtojcës VI ;

(gj)Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, jashtë, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

2.2.Madhësia dhe shkronja në të cilin shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikën 2.1 duhet të jenë të lexueshme.

3. SISTEMET E PËRBËRË NGA NGROHËS HAPËSIRE, TERMOSTAT DHE SISTEME DIELLORE

3.1.Informacioni i përmendur në kreun 4(3)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a)Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës së modelit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I ;

(b)Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(c)Elementet e përcaktuara përkatësisht në Figurën 1, Figurën 2, Figurën 3 dhe Figurën 4 të Shtojcës III .

3.2.Madhësia dhe shkronja në të cilën shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikën 3.1 duhet të jenë të lexueshme.

4. SISTEMET E PËRBËRA NGA NGROHËS TË INTEGRUAR, TERMOSTAT DHE SISTEME DIELLORE

4.1.Informacioni i përmendur në kreun 4(4)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a)Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të modelit, të përcaktuara në përputhje me pikat 1 dhe 2 të Shtojcës I ;

(b)Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(c) Elementet e përcaktuara përkatësisht në Figurën 1 dhe Figurën 3, , të Shtojcës III ;

(ç) Elementet e përcaktuara në Figurën 5 të Shtojcës III .

4.2.Madhësia dhe shkronja në të cilën shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikën 4.1 duhet të jenë të lexueshme.

SHTOJCA VI
Matjet dhe llogaritjet

1. Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të respektimit të kërkesave të kësaj rregullore, matjet dhe llogaritjet bëhen duke përdorur standarde të harmonizuara, numrat e referencës së të cilave janë publikuar për këtë qëllim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, ose duke përdorur të tjera metoda të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme që marrin parasysh metodat më të fundit përgjithësisht të njohura. Ato plotësojnë kushtet dhe parametrat teknikë të përcaktuar në pikat 2 deri në 6.

2. Kushtet e përgjithshme për matjet dhe llogaritjet

(a)Për qëllimet e matjeve të përcaktuara në pikat 3 deri në 7, temperatura e ambientit të brendshëm vendoset në 20 °C.

(b)Për qëllimet e llogaritjeve të përcaktuara në pikat 3 deri në 7, konsumi i energjisë elektrike shumëzohet me një koeficient konvertimi *CC* prej 2,5, përveç rasteve kur konsumi vjetor i energjisë elektrike shprehet në energjinë përfundimtare për përdoruesin fundor, siç përcaktohet në pikat. 3(b), 4(e), 5(d) dhe 6.

(c)Për ngrohësit e pajisur me ngrohës shtesë, matja dhe llogaritja e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës, eficenca e energjisë së ngrohjes së ujit, niveli i fuqisë së zhurmës dhe emetimet e oksideve të azotit marrin parasysh ngrohësin plotësues.

(ç)Vlerat e deklaruara për prodhimin e vlerësuar të nxehtësisë, efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës, efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit, konsumi vjetor i energjisë dhe niveli i fuqisë së zhurmës rrumbullakosen në numrin e plotë më të afërt.

3. Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe konsumi i kaldajave të ngrohjes së hapësirës, kaldajave të integruara dhe e ngrohësve të hapësirës me kogjenerim

(a)Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës η_s llogaritet si efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës në modalitetin aktiv η_{son}, e korrigjuar nga kontributet që llogariten për termostatët, konsumin energjisë elektrike ndihmëse, humbjen e nxehtësisë në modalitetin e gatishmërisë, konsumin e energjisë së aparatit të ndezjes (nëse përdoret) dhe, për ngrohësit e hapësirës me kogjenerim, e korrigjuar duke shtuar efiçencën elektrike të shumëzuar me një koefiçient konvertimi *CC* prej 2,5.

(b)Konsumi vjetor i energjisë Q_{HE} në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose në GJ në terma të *GCV*-së llogaritet si raport i kërkesës referuese vjetore për ngrohje dhe efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës.

4. Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës dhe konsumi i ngrohësve të hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësve të integruar me pompë nxehtësie

(a)Për përcaktimin e koefiçientit të vlerësuar të performancës COP_{rated} ose për përcaktimin e raportit të vlerësuar të energjisë parësore PER_{rated}, ose për përcaktimin e nivelit të fuqisë së zhurmës, kushtet e funksionimit përbëhen nga kushtet standarde të klasifikimit të përcaktuara në Tabelën 9 dhe përdoret i njëjti kapacitet i deklaruar për ngrohje.

(b)Koefiçienti i modalitetit aktiv të performancës $SCOP_{on}$ llogaritet, për kushtet klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta, në bazë të ngarkesës së pjesshme të ngrohjes $Ph(T_j)$, kapacitetit plotësues për ngrohjen $sup\ (T_j)$ (nëse përdoret), në bazë të koeficientit specifik të performancës së periudhës së ngrohjes $COPbin\ (Tj)$ ose në bazë të raportit të energjisë parësore specifike për periudhën e ngrohjes $PERbin(T_j)$, i ponderuar me orët e periudhës së ngrohjes për të cilat zbatohen kushtet e periudhës së ngrohjes, nëpërmjet përdorimit të kushteve të mëposhtme:

- Kushtet referencë të projektimit të përcaktuara në Tabelën 10;
-Sezoni i referencës evropian i ngrohjes në kushtet klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta të përcaktuara në Tabelën 12;
-Efektet e çdo humbje të efiçencës së energjisë, nëse përdoret, e shkaktuar nga cikli, në varësi të llojit të kontrollit të kapacitetit të ngrohjes.

(c)Kërkesa vjetore e referencës për ngrohje Q_H është ngarkesa e projektimit për ngrohjen e $Pdesignh$ për kushte klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta, shumëzuar me orët të barasvlershme vjetore të modalitetit aktiv H_{HE} prej 2 066, 2 465 dhe 1 336 për kushtet klimatike, respektivisht, mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta.

(ç)Konsumi vjetor i energjisë Q_{HE} llogaritet si shuma e:

-Raportit të kërkesës vjetore të referencës për ngrohje Q_H dhe e koefiçientit të modalitetit aktiv të performancës $SCOP_{on}$ ose e raportit të energjisë parësore të modalitetit aktiv $SPER_{on}$; dhe
-Konsumi i energjisë për modalitetin e fikur, modalitetin e fikur të termostatit, modalitetin e gatishmërisë dhe modalitetin e ngrohësit të karterit gjatë sezonit të ngrohjes.

(d)Koefiçienti sezonal i performancës $SCOP$ ose raporti sezonal i energjisë parësore $SPER$ llogaritet si raporti i kërkesës referencë vjetore për ngrohje Q_H dhe i konsumit vjetor të energjisë Q_{HE}.

(dh)Efiçenca e energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës η_s llogaritet si koeficienti sezonal i performancës $SCOP$ i pjesëtuar me koefiçientin e konvertimit CC ose raportin sezonal të energjisë parësore $SPER$, korrigjuar nga kontributet që llogariten për termostatët dhe, për ngrohësit e hapësirës të llojit ujë/ujë nëtokësor -ujë me pompë nxehtësie dhe ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, konsumi i energjisë elektrike i një ose më shumë pompave të ujit nëntokësor.

(e)Konsumi vjetor i energjisë Q_{HE} në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose GJ në terma të GCV-së llogaritet si raport i kërkesës vjetore të referencës për ngrohje Q_H dhe efiçencës së energjisë së ngrohjes sezonale të hapësirës η_s.

5. Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësve të integruar

Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit ηëh e një ngrohësi të integruar llogaritet si raport ndërmjet energjisë referencë Q*ref* dhe energjisë së nevojshme për prodhimin e tij në kushtet e mëposhtme:

(a) Matjet kryhen duke përdorur profilet e ngarkesës të përcaktuara në Tabelën 15;
(b) Matjet kryhen duke përdorur një cikël matjeje 24-orësh si më poshtë:
- 00:00 deri në 06:59: pa shkarkim uji;
- Nga ora 07:00: shkarkim i ujit sipas profilit të ngarkesës së deklaruar;
- Nga përfundimi i shkarkimit të fundit të ujit deri në orën 24:00: pa shkarkim uji;

(c)Profili i deklaruar i ngarkesës është profili i ngarkesës maksimale ose profili i ngarkesës nën një profil maksimal të ngarkesës;
(ç)Për ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, zbatohen kushtet e mëposhtme shtesë:
-Ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie testohen sipas kushteve të përcaktuara në Tabelën 9;
-Ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie që përdorin ajrin e shkarkimit të ventilimit si burim nxehtësie testohen sipas kushteve të përcaktuara në Tabelën 11;
(d)Konsumi vjetor i energjisë elektrike *AEC* në kWh në terma të energjisë përfundimtare llogaritet si konsumi ditor i energjisë elektrike Q_{elec} në kWh në terma të energjisë përfundimtare shumëzuar me 220;
(dh)Konsumi vjetor i lëndë djegëse *AFC* në GJ në terma *GCV-së* llogaritet si konsumi ditor i lëndës djegëse Q_{fuel} shumëzuar me 220.

6. Kushtet për matjet dhe llogaritjet e sistemeve diellore

Kolektori diellor, depozita e ujit të ngrohte diellor dhe pompa në unazën e kolektorit (nëse përdoret) testohen veçmas. Kur kolektori diellor dhe depozita e ujit të ngrohte diellor nuk mund të testohen veçmas, ato testohen në kombinim me njëra tjetrën.
Rezultatet përdoren për përcaktimin e humbjes termike S dhe llogaritjet e efiçencës së kolektorit ηcol, të kontributit vjetor të ngrohjes jo diellore Q*nonsol* të profileve të ngarkesës M, L, XL dhe XXL në kushtet mesatare klimatike të përcaktuara në Tabelat 13 dhe 14, dhe të konsumit vjetor i energjisë elektrike ndihmëse Q*aux* në kWh në terma të energjisë përfundimtare.

Tabela 9

Kushtet standarde të vlerësimit të ngrohësit të hapësirës me pompë nxehtësie dhe të ngrohësve të integruar me pompë nxehtësie

Burimi i nxehtësisë	Shkëmbyesi i jashtëm i nxehtësisë		Shkëmbyesi i brendshëm i nxehtësisë	
	Gjendja klimatike	Temperatura e ambientit në hyrje (ambient i lagësht).	Ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, përveç pompave të nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët	Pompat e nxehtësisë për përdorim në temperaturë të ulët

			Temperatura e hyrjes	Temperatura e daljes	Temperatura e hyrjes	Temperatura e daljes
Ajri i jashtëm	Mesatare	+ 7 °C (+ 6 °C)	+47 °C	+55 °C	+30 °C	+35 °C
	Më e ftohtë	+ 2 °C (+ 1 °C)				
	Më e ngrohtë	+ 14 °C (+ 13 °C)				
Ajri i shkarkimit	Të gjitha	+ 20 °C (+ 12 °C)				
		Temperatura e hyrjes / daljes				
Uji	Të gjitha	+ 10 °C / + 7 °C				
Ujë nëntokësor	Të gjitha	0 °C/– 3 °C				

Tabela 10

Kushtet referencë të projektimit për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësit e integruar me pompë nxehtësie, temperaturat e ajrit të ambientit (temperatura e ajrit të lagësht të ambientit tregohet në kllapa)

Gjendja klimatike	Temperatura e referencës së projektimit	Temperatura bivalente	Temperatura kufi e funksionimit
	Tdesignh	T_{biv}	***TOL***
Mesatare	– 10 (– 11) °C	Maksimale + 2 °C	Maksimale – 7 °C
Më të ftohtë	– 22 (– 23) °C	Maksimale – 7 °C	Maksimale – 15 °C
Më të ngrohtë	+ 2 (+ 1) °C	Maksimale + 7 °C	Maksimale + 2 °C

Tabela 11

Ajri i shkarkimit maksimal të ventilimit i disponueshëm [m³/h], me lagështirë 5,5 g/m³

Profili i ngarkesës së deklaruar	XXS	XS	S	M	L	XL	XXL
Ajri i shkarkimit maksimal të ventilimit i disponueshëm	109	128	128	159	190	870	1 021

Tabela 12

Sezoni evropian i referencës i ngrohjes në kushte klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta për ngrohësit e hapësirës me pompë nxehtësie dhe ngrohësve të integruar me pompë nxehtësie

Periudha e ngrohjes	T_j [°C]	Kushtet mesatare klimatike	Kushtet klimatike më të ftohta	Kushtet klimatike më të ngrohta
		H_j [h/annum]	H_j [h/annum]	H_j [h/annum]
1 deri në 8	–30 deri në –23	0	0	0
9	– 22	0	1	0
10	– 21	0	6	0
11	– 20	0	13	0
12	– 19	0	17	0
13	– 18	0	19	0
14	– 17	0	26	0
15	– 16	0	39	0
16	– 15	0	41	0
17	– 14	0	35	0
18	– 13	0	52	0
19	– 12	0	37	0
20	– 11	0	41	0

21	– 10	1	43	0
22	– 9	25	54	0
23	-8	23	90	0
24	–7	24	125	0
25	-6	27	169	0
26	-5	68	195	0
27	-4	91	278	0
28	-3	89	306	0
29	–2	165	454	0
30	– 1	173	385	0
31	0	240	490	0
32	1	280	533	0
33	2	320	380	3
34	3	357	228	22
35	4	356	261	63
36	5	303	279	63
37	6	330	229	175
38	7	326	269	162
39	8	348	233	259
40	9	335	230	360
41	10	315	243	428
42	11	215	191	430
43	12	169	146	503

44	13	151	150	444
45	14	105	97	384
46	15	74	61	294
Orët në total:		4 910	6 446	3 590

Tabela 13

Temperatura mesatare e ditës [°C]

	Janar	Shkurt	Mars	prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Kushtet klimatike mesatare	+2,8	+2,6	+7,4	+12,2	+16,3	+19,8	+21,0	+22,0	+17,0	+11,9	+5,6	+3,2

Tabela 14

Rrezatimi mesatar global diellor [W/m ^{2}]

Kushtet klimatike mesatare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Kushtet klimatike mesatare	70	104	149	192	221	222	232	217	176	129	80	56

Tabela 15

Profilet e ngarkesës së ngrohjes së ujit e ngrohësve të integruar

H	3XS			XXS			XS			S			
	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	T_p
	kWh	l/min	°C	kWh	l/min	°C	kWh	l/min	°C	kWh	l/min	°C	°C
07:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
07:05	**0,015**	2	25										
07:15	**0,015**	2	25										
07:26	**0,015**	2	25										
07:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25	**0,525**	3	35	**0,105**	3	25	
07:45													
08:01													
08:05													
08:15													
08:25													
08:30				**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	

08:45													
09:00	**0,015**	2	25										
09:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
ora 10:00													
10:30													
11:00													
11:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
11:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
12:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
12:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
12:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25	**0,525**	3	35	**0,315**	4	10	55
14:30	**0,015**	2	25										
15:00	**0,015**	2	25										
15:30	**0,015**	2	25										
16:00	**0,015**	2	25										

16:30													
17:00													
ora 18:00				**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
18:15				**0,105**	2	25				**0,105**	3	40	
18:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
ora 19:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
19:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
20:00				**0,105**	2	25							
20:30							**1,05**	3	35	**0,42**	4	10	55
20:45				**0,105**	2	25							
20:46													
21:00				**0,105**	2	25							
21:15	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
21:30	**0,015**	2	25							**0,525**	5	45	

21:35	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
21:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
Q_{ref}	0,345			2100			2100			2100			

Vazhdim Tabela 15

Profilet e ngarkesës për ngrohjen e ujit të ngrohësve të integruar

H	M				L				XL			
	Q_{np}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{tap}	f	T_m	Q_{np}	f	T_m
	kWh	**l/min**	**°C**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**
07:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
07:05	**1,4**	6	40		**1,4**	6	40					
07:15									**1,82**	6	40	
07:26									**0,105**	3	25	
07:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25					
07:45					**0,105**	3	25		**4,42**	10	10	40
08:01	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	
08:05					**3605**	10	10	40				
08:15	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	

08:25					**0,105**	3	25					
08:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
08:45	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
09:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
09:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
ora 10:00									**0,105**	3	25	
10:30	**0,105**	3	10	40	**0,105**	3	10	40	**0,105**	3	10	40
11:00									**0,105**	3	25	
11:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
11:45	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
12:00												
12:30												
12:45	**0,315**	4	10	55	**0,315**	4	10	55	**0,735**	4	10	55
14:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
15:00									**0,105**	3	25	

15:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
16:00									**0,105**	3	25	
16:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
17:00									**0,105**	3	25	
ora 18:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
18:15	**0,105**	3	40		**0,105**	3	40		**0,105**	3	40	
18:30	**0,105**	3	40		**0,105**	3	40		**0,105**	3	40	
ora 19:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
19:30												
20:00												
20:30	**0,735**	4	10	55	**0,735**	4	10	55	**0,735**	4	10	55
20:45												
20:46									**4,42**	10	10	40
21:00					**3605**	10	10	40				

21:15	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	
21:30	**1,4**	6	40		**0,105**	3	25		**4,42**	10	10	40
21:35												
21:45												
Q_{ref}	5845				11655				19,07			

Vazhdim Tabela 15

Profilet e ngarkesës së ngrohjes së ujit e ngrohësve të integruar

h	XXL			
	Q_{up}	f	T_m	T_p
	kWh	l/min	°C	°C
07:00	**0,105**	3	25	
07:05				
07:15	**1,82**	6	40	
07:26	**0,105**	3	25	
07:30				
07:45	**6,24**	16	10	40
08:01	**0,105**	3	25	
08:05				
08:15	**0,105**	3	25	
08:25				
08:30	**0,105**	3	25	

08:45	**0,105**	3	25	
09:00	**0,105**	3	25	
09:30	**0,105**	3	25	
ora 10:00	**0,105**	3	25	
10:30	**0,105**	3	10	40
11:00	**0,105**	3	25	
11:30	**0,105**	3	25	
11:45	**0,105**	3	25	
12:00				
12:30				
12:45	**0,735**	4	10	55
14:30	**0,105**	3	25	
15:00	**0,105**	3	25	
15:30	**0,105**	3	25	
16:00	**0,105**	3	25	
16:30	**0,105**	3	25	
17:00	**0,105**	3	25	
ora 18:00	**0,105**	3	25	
18:15	**0,105**	3	40	
18:30	**0,105**	3	40	
ora 19:00	**0,105**	3	25	
19:30				

20:00				
20:30	**0,735**	4	10	55
20:45				
20:46	**6,24**	16	10	40
21:00				
21:15	**0,105**	3	25	
21:30	**6,24**	16	10	40
21:35				
21:45				
Q_{ref}				24,53

SHTOJCA VII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojce lidhen vetëm me verifikimin e parametrave të matur nga autoritetet e Mbikeqyrjes se Tregut dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik. Vlerat dhe klasat në etiketë ose në fletën e produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik.

Kur verifikohet pajtueshmëria e një modeli produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të aplikojnë procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të verifikojnë një njësi të vetme të modelit.

2. Modeli do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e zbatueshme nëse:

(a) vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik sipas Ligjit Nr. 52/2024 PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE ME NDIKIM NË ENERGJI (vlerat e deklaruara), dhe, kur është e aplikueshme, vlerat e përdorura për të llogaritur këto vlera, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit.

(b) vlerat e publikuara në etiketë dhe në fletën e produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e efikasitetit të energjisë e treguar nuk është më e favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe

(c) kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut testojnë njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matur gjatë testimit dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç jepen në Tabelën 16.

3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2(a) ose (b) nuk arrihen, modeli do të konsiderohet se nuk përputhet me këtë rregullore.

4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregutduhet të zgjedhin tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim.

5. Modeli do të konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 16.

6. Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli do të konsiderohet se nuk përputhet me këtë rregullore.

7. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut jep të gjithë informacionin përkatës pa vonesë, pasi të merret një vendim për mosrespektimin e kërkesave nga ana e modelit sipas pikave 3 dhe 6 të kësaj Shtojce.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të përdorin metodat e matjes dhe llogaritjes të parashikuara në Aneksin VI.

Strukturës përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të aplikojnë vetëm tolerancat e verifikimit që

janë të përcaktuara në Tabelën 16 dhe do të përdorin vetëm procedurën të përshkruar në pikët 1 deri 7 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojce. Nuk do të aplikohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 4

Tolerancat e verifikimit

Parametrat	Tolerancat e verifikimit
Efiçienca e energjisë për ngrohjen e hapësirave, ηs	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar për më shumë se 8%.
Eficienca e energjisë për ngrohjen e ujit, ηwh	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar me më shumë se 8 %.
Niveli i fuqisë së zërit	Vlera e përcaktuar nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 2 dB(A).
Klasa e kontrollit të temperaturës	Klasa e kontrollit të temperaturës përputhet me klasën e deklaruar të njësisë.
Efiçenca e kolektorit, ηcol	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar për më shumë se 5%.
Humbje konstante S	Vlera e përcaktuar nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 5%.
Konsumi i energjisë ndihmëse, Qaux	Vlera e përcaktuar nuk duhet të tejkalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 5%.

SHTOJCA VIII

Informacioni që jepet në rast të shitje, dhënie me qera, ose blerje me këste përmes internetit

1. Etiketa e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me kreun III (1)(ë) paraqitet në mekanizmin e shfaqjes pranë çmimit të produktit sipas afateve kohore të treguara në pikat (4), (5) dhe (6) të kreut III. Madhësia e etiketës është e tillë që të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe është proporcionale me madhësinë e specifikuar në Shtojcën II. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë përputhet me specifikimet e dhëna në pikën 3 të kësaj Shtojce. Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi imazh.
2. Imazhi që përdoret për të aksesuar etiketën në rastin e ekranit të ndërlidhur:
   a) Është një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë së produktit në etiketë;
   b) Tregon në shigjetë klasën e efiçencës së energjisë së produktit në ngjyrë të bardhë në të njëjtën madhësi fonti si ajo e përdorur për çmimin; dhe
   c) Është në një nga dy formatet e mëposhtme:



3. Në rastin e ekranit të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:
   a) Imazhi i përmendur në pikën 3 të kësaj Shtojce shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit;
   b) Imazhi lidhet me etiketën;
   c) Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, rrotullimit të mausit ose zgjerimit të ekranit me prekje mbi imazh;
   ç) Etiketa shfaqet nga një dritare e re, skedë e re, faqe e re ose nga shfaqja e ekranit të integruar;
   d) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;
   dh) Shfaqja e etiketës ndalohet me anë të një opsioni mbylljeje ose mekanizmi tjetër standard të mbylljes;
   e) Teksti alternativ për pamjen grafike, që do të paraqitet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e efiçencës së energjisë së produktit në të njëjtën madhësi shkronjash si ajo e përdorur për çmimin.

4. Skeda informative e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(f) të kreut III shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia është e tillë që skeda informative e produktit të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Skeda informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin lidhja e përdorur për të hyrë në skedën informative të produktit tregon qartë dhe në mënyrë të lexueshme "Skeda informative e produktit". Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, skeda informative e produktit do të shfaqet në klikimin e parë të mausit, rrotullimin e mausit ose zgjerimin e ekranit me prekje mbi link.

ANEKS NR.6

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË ENËLARËSEVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK"[1]

I. QËLLIMI

Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin dhe dhënien e informacionit plotësues të produktit për enëlarëset për përdorim shtëpiak me energji elektrike, duke përfshirë enëlarëset për përdorim shtëpiak të integruara dhe enëlarëset për përdorim shtëpiak me energji elektrike, të cilat gjithashtu mund të punojnë me bateri.

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
a) Enëlarëset për përdorim shtëpiak me bateri që mund të lidhen me rrjetin elektrik nëpërmjet një konvertuesi AC/DC të blerë veçmas.
b) Enëlarëset që janë objekt i Vendimit Nr. 1060, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për makineritë" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara".

III. PËRKUFIZIMET

Për qëllim të kësaj rregullore, termat e përcaktuar në Ligjin Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim

1. **"Cikël"** është një proces i plotë pastrimi, shpëlarjeje dhe tharjeje, siç përcaktohet nga programi përzgjedhur, i përbërë nga një sërë operacionesh derisa të pushojë i gjithë aktiviteti;
2. **"Ekologjike"** është emri i programit të një enëlarëseje për përdorim shtëpiak të deklaruar nga prodhuesi si i përshtatshëm për pastrimin e enëve normalisht të ndotura dhe të cilit i referohet informacioni në etiketën e energjisë dhe në fletën e informacionit të produktit;
3. **"Ekran i ndërlidhur"** është çdo ndërfaqe vizuale ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrotullim të mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi një imazh ose grupi tjetër të dhënash;

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2017 e Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e Rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin energjetik të enëlarëseve për përdorim shtëpiak", si dhe për shfuqizimin e Rregullores Deleguese (BE) Nr. 1059/2010 të Komisionit. Numri CELEX 02019R2017, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 05.12.2019, f. 134.

4. **“Ekran me prekje”** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si p.sh., ai i një kompjuteri tablet, kompjuteri me ekran me prekje ose një telefoni inteligjent;
5. **“Enëlarëse për përdorim shtëpiak”** është një makinë që pastron dhe shpëlan pajisjet e tavolinës, dhe që deklarohet nga prodhuesi në Deklaratën e Konformitetit se është në përputhje me Vendim Nr. 349, datë 29.4.2020 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” ose me Vendim Nr. 378, datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
6. **"Enëlarëse për përdorim shtëpiak e integruar"** është një enëlarëse për përdorim shtëpiak që është projektuar, testuar dhe tregtuar në mënyrë ekskluzive që:
   (a) Të instalohet në një mobilie ose e mbërthyer (sipër, poshtë dhe anash) me panele;
   (b)Të fiksohet mirë në anët, në pjesën e sipërme ose në dyshemenë e mobiles ose paneleve; dhe
   (c) Të ketë pamje integrale të prodhuar nga fabrika ose të pajiset me një panel të përparmë të posaçëm për të.
7. **“Fillimi me vonesë”** është një gjendje ku përdoruesi ka zgjedhur një vonesë të specifikuar për fillimin e ciklit të programit të zgjedhur;
8. **“Garanci”** është çdo angazhim nga ana e tregtarit ose e furnizuesit ndaj konsumatorit për sa më poshtë vijon:
   a) Rimbursimin e shumës së paguar; ose
   b) Zëvendësimi, riparimi ose trajtimi në çfarëdo mënyre i enëlarësve për përdorim shtëpiak nëse ato nuk plotësojnë specifikimet e përcaktuara në deklaratën e garancisë ose në reklamën përkatëse;
9. **“Indeksi i Eficencës së Energjisë' (EEI)** është raporti i konsumit të energjisë së programit ekologjik ndaj konsumit standard të energjisë së programit;
10. **“Indeks i performancës së tharjes” (I_D)** është raporti i performancës së tharjes së një enëlarëseje për përdorim shtëpiak me performancën e tharjes së një enëlarëseje për përdorim shtëpiak referuese;
11. **“Indeksi i performancës së pastrimit” (I_C)** është raporti i performancës së pastrimit të një enëlarëseje për përdorim shtëpiak me performancën e pastrimit të një enëlarëseje për përdorim shtëpiak referuese;
12. **"Kapaciteti nominal"** është numri maksimal i pajisjeve të tavolinës së bashku me pajisjet për servirje, të cilat mund të pastrohen, shpëlahen dhe thahen në një enëlarëse për përdorim shtëpiak në një cikël kur ngarkohen në përputhje me udhëzimet e furnizuesit;
13. **“Kodi “përgjigje e shpejtë” (QR)”** është një kod shifror tip matricë i përfshirë në etiketën e energjisë së modelit të një produkti që lidhet me informacionin e atij modeli në pjesën publike të bazës së të dhënave të produktit;
14. **“Kohëzgjatja e programit” (T_t)** është kohëzgjatja që fillon me fillimin e programit të zgjedhur, duke përjashtuar çdo vonesë të programuar nga përdoruesi, derisa në përfundim të programit dhe përdoruesi të ketë akses në ngarkesë;

15. **"Konsumi standard i programit të energjisë" (SPEC)** është konsumi i energjisë i marrë si referencë si funksion i kapacitetit nominal të enëlarëses për përdorim shtëpiak, i shprehur në kilovat orë për cikël (kWh/cikël);
16. **"Mekanizmi i shfaqjes"** është çdo ekran, duke përfshirë ekranin me prekje, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;
17. **"Modaliteti i fikur"** është gjendja në të cilën enëlarësja për përdorim shtëpiak është e lidhur me rrjetin elektrik dhe nuk kryen asnjë funksion; kushtet e mëposhtme konsiderohen gjithashtu si modaliteti i fikur:
    a) Kushte që ofrojnë vetëm një tregues të modalitetit të fikur;
    b) Kushte që ofrojnë funksionalitete të destinuara vetëm për të siguruar përputhshmërinë elektromagnetike në përputhje me Vendimin Nr. 552, datë 31.7.2019, "Për miratimin e rregullit teknik për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara";
18. **"Modaliteti i gatishmërisë"** është gjendja ku enëlarësja për përdorim shtëpiak është e lidhur me rrjetin elektrik dhe ofron vetëm funksionet e mëposhtme, të cilat mund të vazhdojnë për një kohë të pacaktuar:
    a) Funksioni i riaktivizimit, ose funksioni i riaktivizimit dhe një tregues i thjeshtë i funksionit të riaktivizimit të vënë në funksionim, dhe/ose
    b) Funksioni i riaktivizimit përmes një lidhjeje me një rrjet; dhe/ose
    c) Shfaqja e informacioni ose e statusit dhe/ose
    ç) Funksioni i zbulimit për masat emergjente;
19. **"Pajisje për servirje"** janë artikujt që përdoren për përgatitjen dhe servirjen e ushqimit, të cilat mund të përfshijnë tenxhere, tasa e pjata për servirje, thika, lugë e pirunë shërbimi dhe një pjatë të madhe;
20. **"Pajisje tavoline" (ps)** është një grup pajisjesh tavoline për përdorim nga një person, duke mos përfshirë pjesët e servirjes;
21. **"Pika e shitjes"** është një vend ku enëlarëset për përdorim shtëpiak ekspozohen ose ofrohen për shitje, për qira ose për qira-blerje.
22. **"Programi ekologjik i konsumit të energjisë" (EPEC)** është konsumi i energjisë së një enëlarëseje për përdorim shtëpiak për programin ekologjik, i shprehur në kilovat orë për cikël (kWh/cikël);
23. **"Programi ekologjik i konsumit të ujit" (EPWC)** është konsumi i ujit të një enëlarëseje për përdorim shtëpiak për programin ekologjik , i shprehur në litra për cikël (l/cikël);
24. **"Programi"** është një seri operacionesh që janë të paracaktuara dhe deklarohen nga furnizuesi si të përshtatshme për nivele të caktuara të papastërtisë ose lloje të ngarkesës, ose të dyja;
25. **"Rrjet"** është një infrastrukturë komunikimi me një topologji lidhjesh, një arkitekturë, duke përfshirë komponentët fizikë, parimet organizative, procedurat dhe formatet e komunikimit (protokollet);
26. **"Rrjeti" ose "rrjeti elektrik"** është furnizimin me energji elektrike nga rrjeti prej 230 (± 10 %) volt të rrymës alternative në 50 Hz;

27. **"Tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një grafiku që bën të mundur që informacioni të paraqitet në formë jo grafike ku pajisjet e ekranit nuk mund të japin grafikun ose shërben si një ndihmë për aksesueshmërinë, siç është hyrja në aplikacionet e sintezës së zërit.
28. **"Vlerat e deklaruara"** jane vlerat e ofruara nga furnizuesi për parametrat teknikë të deklaruar, të llogaritur ose të matur, në përputhje me nenin 6 të Ligjit 52/2024, dhe në përputhje me pikën 1 (d) të Kreut IV dhe Shtojcën V të kësaj rregullore, për verifikimin e përputhshmërisë.

IV. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit sigurojnë që:

a) Çdo enëlarëse për përdorim shtëpiak pajiset me një etiketë të printuar në formatin e përcaktuar në Shtojcën II;
b) Vlerat e parametrave të përfshirë në fletën e informacionit të produktit, siç është përcaktuar në Shtojcën IV, të regjistrohen në regjistrin publik të të dhënave të produktit;
c) Fleta e informacionit të produktit vihet në dispozicion në formë të printuar nëse kërkohet në mënyrë specifike nga tregtari;
ç) Përmbajtja e dokumentacionit teknik, të përcaktuar në Shtojcën V, hidhet në bazën e të dhënave të produktit;
d) Çdo reklamë vizuale për një model specifik të enëlarëses për përdorim shtëpiak përmban klasën e eficencës së energjisë dhe gamën e klasave të eficencës së energjisë të disponueshme në etiketë në përputhje me Shtojcën VI dhe Shtojcën VII;
dh) Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik të enëlarëses për përdorim shtëpiak, përfshirë materialin në internet, i cili përshkruan parametrat e saj specifikë teknikë, përfshin klasën e eficencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të eficencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI;
e) Për çdo model të enëlarëses për përdorim shtëpiak, tregtarëve u vihet në dispozicion një etiketë elektronike në formatin e përcaktuar në Shtojcën II dhe që përmban informacionin e përcaktuar në këtë Shtojcë;
ë) Për çdo model të enëlarëseve për përdorim shtëpiak, tregtarëve u vihet në dispozicion një fletë elektronike informacioni për produktin, siç përcaktohet në Shtojcën IV.

2. Klasa e eficencës së energjisë dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër përcaktohen në Shtojcën I dhe llogariten në përputhje me Shtojcën III.

V. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

1. Tregtarët sigurojnë që:

a) Çdo enëlarëse për përdorim shtëpiak, në pikën e shitjes, duke përfshirë panairet tregtare, mban etiketën e dhënë nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(a) të Kreut IV, ku etiketa

e enëlarëseve për përdorim shtëpiak të integruara të shfaqet në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme në mënyrë të qartë dhe ndërkohë etiketa shfaqet për të gjitha enëlarëset e tjera për përdorim shtëpiak në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme në mënyrë të qartë në anën e jashtme të pjesës së përparme ose të sipërme të enëlarëses për përdorim shtëpiak;

b) Në rast të shitjes në distancë, etiketa dhe fleta e informacionit të produktit jepen në përputhje me Shtojcat VI dhe VII;

c) Çdo reklamë vizuale për një model specifik të enëlarëses për përdorim shtëpiak përmban klasën e eficencës së energjisë së atij modeli dhe gamën e klasave të eficencës së energjisë të disponueshme në etiketë, sipas Shtojcës VI;

ç) Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik të enëlarëses për përdorim shtëpiak, përfshirë materialin në internet, i cili përshkruan parametrat e saj specifik teknik, përfshin klasën e eficencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të eficencës së energjisë të disponueshme në etiketë, sipas Shtojcës VI.

VI. DETYRIMET E PLATFORMAVE PRITËSE (HOSTING) TË INTERNETIT

Kur një ofrues shërbimi pritës, siç referohet në Vendimin Nr. 676, datë 20.12.2017, mundëson shitjen e drejtpërdrejtë të enëlarëseve për përdorim shtëpiak nëpërmjet faqes së tij të internetit, ofruesi i shërbimit bën të mundur shfaqjen e etiketës elektronike dhe fletës elektronike të informacionit të produktit të ofruar nga tregtari në mekanizmin e shfaqjes në përputhje me dispozitat e Shtojcës VII dhe informon tregtarin për detyrimin për t'i ekspozuar ato.

VII. METODAT E MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni që do të jepet në përputhje me Krerët IV dhe V merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën III.

VIII. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I

A. Klasat e eficencës së energjisë

Klasa e eficencës së energjisë së një enëlarëseje për përdorim shtëpiak përcaktohet në bazë të Indeksit të saj të Eficencës së Energjisë (EEI) siç jepet në Tabelën 1.
EEI e një enëlarëseje për përdorim shtëpiak llogaritet në përputhje me Shtojcën III.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë të enëlarëseve për përdorim shtëpiak

Klasa e eficencës së energjisë	Indeksi i Eficencës së Energjisë
A	EEI < 32
B	32 ≤ EEI < 38
C	38 ≤ EEI < 44
D	44 ≤ EEI < 50
E	50 ≤ EEI < 56
F	56 ≤ EEI < 62
G	EEI ≥ 62

B. Klasat e emetimit të zhurmës akustike në ajër

Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër e një enëlarëseje për përdorim shtëpiak përcaktohet në bazë të emetimeve të zhurmës akustike në ajër, siç përcaktohet në Tabelën 2.

Tabela 2

Klasat e emetimit të zhurmës akustike në ajër

Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër	Zhurma (dB(A)
A	n < 39
B	39 ≤ n < 45
C	45 ≤ n < 51
D	51 ≤ n

SHTOJCA II
Etiketa

1. Etiketa



Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Kodi QR;
II. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;
III. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;
IV. Shkalla e klasave të eficencës së energjisë nga A-ja tek G-ja;
V. Klasa e eficencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me pikën A të Shtojcës I;
VI. Konsumi i Energjisë së Programit ekologjik (EPEC) në kWh për 100 cikle, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
VII. Kapaciteti nominal në cilësimet standarde të pajisjeve të tavolinës, për programin ekologjik;
VIII. Konsumi i ujit të programit ekologjik (EPWC) në litra për cikël, i rrumbullakosur në një numër dhjetor;
IX. Programi ekologjik në h:min (orë:minuta) i rrumbullakosur në minutën më të afërt;

X. Emetimet e zhurmës akustike në ajër, të shprehura në dB(A) në lidhje me 1 pW dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt, dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër, e përcaktuar në përputhje me pikën B të Shtojcës I;

XI. Numri i këtij Vendimi

2. FORMATI I ETIKETËS

Formati i etiketës është si në figurën më poshtë.



Ku:

(a) Etiketa është së paku 96 mm e gjerë dhe 192 mm e gjatë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme;
(b)Sfondi i etiketës është 100% i bardhë;
(c)Shkronjat janë në formatin Verdana dhe Calibri;
(d) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketën janë siç tregohet në formatin e etiketës për enëlarëset për përdorim shtëpiak;
(e) Ngjyrat janë CMYK – cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, sipas shembullit në vijim: 0,70,100,0: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % e zezë;
(f) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶ Ngjyrat e logos së BE-së janë si më poshtë :
- Sfondi: 100,80,0,0;
- Yjet: 0,0,100,0;

❷ Ngjyra e logos së energjisë është: 100,80,0,0;
❸ Kodi QR është 100% në ngjyrë të zezë;
❹ Emri i furnizuesit është 100% në ngjyrë të zezë e me shkronjat janë në formatin Verdana, 9 pt;
❺ Identifikuesi i modelit është 100% në ngjyrë të zezë e me shkronjat në formatin Verdana Regular 9 pt;
❻ Shkalla nga A-ja deri tek G-ja është si më poshtë:
- Shkronjat e shkallës së eficencës së energjisë janë 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronjat në formatin Calibri Bold 19 pt; shkronjat përqendrohen në një bosht në hapësirën 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave;
- Ngjyrat e shigjetave të shkallës nga A-ja deri tek G-ja janë si më poshtë:
  - Klasa-A: 100,0,100,0;
  - Klasa-B: 70,0,100,0;
  - Klasa-C: 30,0,100,0;
  - Klasa-D: 0,0,100,0;
  - Klasa-E: 0,30,100,0;
  - Klasa-F: 0,70,100,0;
  - Klasa-G: 0,100,100,0;

❼ Ndarësit e brendshëm kanë një nuancë prej 0,5 pt dhe ngjyra është 100% e zezë;
❽ Shkronja e klasës së eficencës së energjisë është 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja në formatin Calibri Bold 33 pt. Shigjeta e klasës së eficencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën nga A-ja deri tek G-ja pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara. Shkronja në shigjetën e klasës së eficencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, e cila është 100 % në ngjyrë të zezë;
❾ Vlera e konsumit të energjisë së programit ekologjik për 100 cikle është me shkronja në formatin Verdana Bold 28 pt; "kWh" është me shkronja në formatin në Verdana Regular 18 pt; numri "100" në piktogramin që përfaqëson 100 cikle është me shkronja në formatin Verdana Regular 14 pt. Vlera dhe njësia janë në qendër dhe 100% në ngjyrë të zezë;

⓾ Piktogramet janë siç jepen në modelet e etiketave dhe si më poshtë:
- Vijat e piktogrameve kanë një nuancë prej 1,2 pt, ndërkohë që ato dhe tekstet (numrat dhe njësitë) janë 100 % në ngjyrë të zezë;
- Tekstet poshtë piktogrameve janë me shkronja në formatin Verdana 16 pt ndërkohë që njësia është me shkronja në formatin në Verdana Regular 12 pt , dhe ato janë të përqendruara poshtë piktogrameve;
- Piktogrami i emetimit të zhurmës akustike në ajër: numri i decibelëve në altoparlant është me shkronja në formatin Verdana Bold 12 pt, pt ndërkohë që njësia në "dB" është me shkronja në formatin Verdana Regular 9 pt; gama e klasave të zhurmës (nja A-ja deri tek D-ja) përqendrohet poshtë piktogramit, ku shkronja e klasës së zhurmës së aplikueshme është me shkronja në formatin Verdana Bold 16 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të zhurmës janë në formatin Verdana Regular 10 pt;

⓫ Numri i Vendimit është 100 % në ngjyrë të zezë dhe shkronjat janë në formatin Verdana Regular 6 pt.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Metodat e matjes dhe llogaritjet

Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e kësaj rregullore, matjet dhe llogaritjet duhet të kryhen duke përdorur standarde të harmonizuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

Kur një parametër deklarohet në përputhje me Ligjin Nr. 52/2024 dhe në përputhje me Tabelën 4 të Shtojcës V, vlera e deklaruar duhet të përdoret nga furnizuesi për llogaritjet në këtë shtojcë.

Konsumi i energjisë, EEI, konsumi i ujit, kohëzgjatja e programit, performanca e pastrimit dhe tharjes dhe emetimet e zhurmës akustike në ajër të një modeli të pjatalarëses për përdorim shtëpiak maten dhe/ose llogariten duke përdorur programin ekologjik ku enëlarësja për përdorim shtëpiak është e ngarkuar me kapacitetin nominal. Konsumi i energjisë, konsumi i ujit, kohëzgjatja e programit, performanca e pastrimit dhe tharjes maten njëkohësisht.
EPWC-ja shprehet në litra për cikël dhe rrumbullakoset në një shifër dhjetore.
Kohëzgjatja e programit ekologjik (T_t) shprehet në orë dhe minuta dhe rrumbullakoset në minutën më të afërt.
Emetimet e zhurmës akustike në ajër maten me dB(A) në lidhje me 1 pW dhe rrumbullakohen në numrin e plotë më të afërt.

1. INDEKSI I EFICENCËS SË ENERGJISË

Për llogaritjen e EEI-së së një modeli të enëlarëses për përdorim shtëpiak, EPEC-ja e enëlarëses për përdorim shtëpiak krahasohet me SPEC-në e saj.
(a) EEI-ja llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në një shifër dhjetore:
EEI = (EPEC/SPEC) × 100
Ku:
EPEC-ja është programi ekologjik i konsumit të energjisë i enëlarëses për përdorim shtëpiak, i matur në kWh/cikël dhe i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;
SPEC-ja është programi standard i konsumit të energjisë së enëlarëses për përdorim shtëpiak.
(b) SPEC-ja llogaritet në kWh/cikël dhe rrumbullakoset në tre shifra dhjetore si më poshtë:
(1) Për enëlarëses për përdorim shtëpiak me kapacitet nominal ps ≥ 10 dhe gjerësi > 50 cm:
SPEC = 0,025 × ps + 1,350
(2) Për enëlarëses për përdorim shtëpiak me kapacitet nominal ps ≤ 9 ose gjerësi ≤ 50 cm:
SPEC = 0,090 × ps + 0,450
ku ps është numri i pajisjeve të tavolinës.

2. INDEKSI I PERFORMANCËS SË PASTRIMIT

Për llogaritjen e indeksit të performancës së pastrimit (I_C) të një modeli të enëlarëses për përdorim shtëpiak, performanca e pastrimit të programit ekologjik krahasohet me performancën e pastrimit të një enëlarëses referuese.
I_C llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në tre shifra dhjetore:
$I_C = \exp(\ln I_C)$
dhe

$$\ln I_C = (1/n) \times \sum_{i=1}^{n} \ln (C_{T,i}/C_{R,i})$$

ku:
$C_{T,i}$ është performanca e pastrimit të programit ekologjik të enëlarëses për përdorim shtëpiak nën testim për një provë (i), e rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;
$C_{R,i}$ është performanca e pastrimit të enëlarëses referuese për një provë (i), e rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;
n është numri i testeve.

3. INDEKSI I PERFORMANCËS SË THARJES

Për llogaritjen e indeksit të performancës së tharjes (I_D) të një modeli enëlarëseje për përdorim shtëpiak, performanca e tharjes së programit ekologjik krahasohet me performancën e tharjes së enëlarëses referuese.
I_D llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në tre shifra dhjetore:
$I_D = \exp(\ln I_D)$
dhe

$$\ln I_D = (1/n) \times \sum_{i=1}^{n} \ln (I_{D,i})$$

ku:
$I_{D,i}$ është indeksi i performancës së tharjes i programit ekologjik të enëlarëses për përdorim shtëpiak nën test për një provë (i);
n është numri i testeve të kombinuara të pastrimit dhe tharjes.
$I_{D,i}$ llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në tre shifra dhjetore :
Në $I_{D,i} = \ln (D_{T,i} / D_{R,t})$
ku:
$D_{T,i}$ është rezultati mesatar i performancës së tharjes i programit ekologjik të enëlarëses për përdorim shtëpiak nën test për një provë (i), i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;
$D_{R,t}$ është rezultati i synuar i tharjes së enëlarëses referente, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore.

4. MODALITETET E FUQISË SË ULËT

Kur aplikohet, matet konsumi i energjisë së modalitetit të fikur (P_o), i modalitetit të gatishmërisë (P_{sm}) dhe, aty ku kërkohet, modaliteti i fillimit me vonesë ($P_{ds.}$). Vlerat e matura shprehen në W dhe rrumbullakosen në dy shifra dhjetore.

Gjatë matjeve të konsumit të energjisë në modalitete me fuqi të ulët, kontrollohen dhe regjistrohen sa më poshtë vijon:

- Shfaqja ose jo e informacionit;
- Aktivizimi ose jo i një lidhjeje rrjeti.

SHTOJCA IV
Skeda informacionit të produktit

Sipas pikës 1 (b) të Kreut IV, pjesa e të dhënave që ka fleta e informacionit të produktit të enëlarëses për përdorim shtëpiak hidhet në bazën e të dhënave të produktit nga furnizuesi sipas Tabelës 3.
Manuali i përdorimit ose literatura tjetër e ofruar me produktin tregon qartë lidhjen me modelin në bazën e të dhënave të produktit si një Lokalizues Uniform i Burimit (URL) i lexueshëm nga njerëzit ose si kod QR ose nëpërmjet dhënies së numrit të regjistrimit të produktit.

Tabela 3
Përmbajtja, renditja dhe formati i fletës së informacionit të produktit

<table>
<tr><td colspan="5">Emri i furnizuesit ose marka tregtare:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Adresa e furnizuesit:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Identifikuesi i modelit:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Parametrat e përgjithshëm të produktit:</td></tr>
<tr><td>Parametri</td><td>Vlera</td><td>Parametri</td><td colspan="2">Vlera</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Kapaciteti nominal (ps)</td><td rowspan="3">x</td><td rowspan="3">Dimensionet në cm</td><td>Lartësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Gjerësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Thellësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>EEI</td><td>x, x</td><td>Klasa e eficencës së energjisë</td><td colspan="2">[A/B/C/D/E/F/G]</td></tr>
<tr><td>Indeksi i performancës së pastrimit</td><td>x, xxx</td><td>Indeksi i performancës së tharjes</td><td colspan="2">x, xxx</td></tr>
<tr><td>Konsumi i energjisë në kWh [për cikël], bazuar në programin ekologjik duke përdorur mbushjen me ujë të ftohtë. Konsumi faktik i energjisë do të varet nga mënyra se si përdoret pajisja.</td><td>x, xxx</td><td>Konsumi i ujit në litra [për cikël], bazuar në programin ekologjik. Konsumi faktik i ujit do të varet nga mënyra se si përdoret pajisja dhe nga fortësia e ujit.</td><td colspan="2">x, x</td></tr>
</table>

Kohëzgjatja e programit (h:min)	x:xx	Lloji	[i integruar/i paintegruar]
Emetimet e zhurmës akustike në ajër (dB(A) në lidhje me 1 pW)	x	Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër	[A/B/C/D]
Modaliteti i fikur (W)	x, xx	Modaliteti i gatishmërisë (W)	x, xx
Fillimi me vonesë (W) (nëse aplikohet)	x, xx	Gatishmëria e rrjetëzuar (W) (nëse aplikohet)	x, xx
Kohëzgjatja minimale e garancisë së ofruar nga furnizuesi:			
Informacion shtesë:			
Lidhja me faqen e internetit të furnizuesit			

SHTOJCA V
Dokumentacioni teknik

1. Dokumentacioni teknik i referuar në pikën 1 (ç) të Kreut IV duhet të përfshijë elementët e mëposhtëm:

(a) një përshkrim të përgjithshëm të modelit që lejon qartësisht identifikimin e tij;
(b) referencat për standardet e harmonizuara të aplikuara ose standardet e tjera të matjes që janë përdorur;
(c) masat paraprake të nevojshme specifike gjatë montimit, instalimit, mirëmbajtjes ose testimit të modelit;
(d) vlerat për parametrat teknikë të përcaktuara në Tabelën 4; këto vlera konsiderohen si vlerat e deklaruara për procedurën e verifikimit në Shtojcën VIII;
(e) detajet dhe rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me Shtojcën III;
(f) kushtet e testimit nëse nuk janë përshkruar mjaftueshëm në pikën (b);
(g) modelet ekuivalente, nëse ka, duke përfshirë identifikuesit e modeleve.

Këto elemente gjithashtu përbëjnë pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi duhet të regjistrojë në bazën e të dhënave të produktit, në përputhje me pikën 11 të nenit 9 të Ligjit 52/2024.

Tabela 4
Informacioni që duhet të përfshihet në dokumentacionin teknik

PARAMETRI	VLERA	NJËSIA
Kapaciteti nominal për ngarkesën me pajisje tavoline	X	-
Konsumi i energjisë i programit ekologjik (EPEC) i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore	X, XXX	kWh/cikël
Konsumi i energjisë i programit standard (SPEC) i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore	X, XXX	kWh/cikël
Indeksi i Eficencës së Energjisë (EEI)	X, X	-

Konsumi i ujit i programit ekologjik (EPWC) i rrumbullakosur në një numër dhjetor	X, X	l/cikël
Indeksi i performancës së pastrimit (I_C)	X, XX	-
Indeksi i performancës së tharjes (I_D)	X, XX	-
Kohëzgjatja e programit ekologjik (T_t) e rrumbullakosur në minutën më të afërt	X:XX	h:min
Konsumi i energjisë në modalitetin e fikur (P_o) i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore	X, XX	W
Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë (P_{sm}) i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore	X, XX	W
A përfshin modaliteti i gatishmërisë shfaqjen e informacionit?	Po/Jo	-
Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë (P_{sm}) në gjendje gatishmërie në rrjet (nëse është e aplikueshme), e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore	X, XX	W
Konsumi i energjisë në fillimin me vonesë (P_{ds}) (nëse aplikohet) i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore	X, XX	W
Emetimet e zhurmës akustike në ajër	X	dB(A) në lidhje me 1 pW

2. Kur informacioni i përfshirë në dokumentacionin teknik për një model të veçantë enëlarëseje për përdorim shtëpiak është marrë me ndonjë nga metodat e mëposhtme, ose me të dyja:

- Nga një model që ka të njëjtat karakteristika teknike që janë të rëndësishme për informacionin teknik që do të jepet, por që është gjeneruar nga një furnizues i ndryshëm;
- Me anë të llogaritjes në bazë të projektimit ose ekstrapolimit nga një model tjetër i të njëjtit furnizues ose i një furnizuesi të ndryshëm,

Dokumentacioni teknik përfshin detajet e një llogaritjeje të tillë, vlerësimin e ndërmarrë nga furnizuesit për të verifikuar saktësinë e llogaritjes dhe, sipas rastit, deklaratën e identitetit midis modeleve të furnizuesve të ndryshëm.

SHTOJCA VI

Informacioni që duhet të jepet në reklamat vizuale, në materialet promovuese teknike në shitjet në distancë dhe në telemarketing, përveç shitjeve në distancë në internet

1. Për qëllime të sigurimit të respektimit të kërkesave të përcaktuara në pikën 1 (d) të Kreut IV dhe pikën (c) të Kreut V, klasa e eficencës së energjisë dhe gama e klasave të eficencës së energjisë të disponueshme në etiketë tregohen në reklamat vizuale, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj Shtojce.
2. Për qëllime të sigurimit të respektimit të kërkesave të përcaktuara në pikën 1(dh) të Kreut IV dhe pikën (ç) të Kreut V, klasa e eficencës së energjisë dhe gama e klasave të eficencës së energjisë së disponueshme në etiketë tregohet në materialin teknik promovues, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj Shtojce.
3. Çdo shitje në distancë e bazuar në letër tregon klasën e eficencës së energjisë dhe gamën e klasave të eficencës së energjisë të disponueshme në etiketë, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj Shtojce.
4. Klasa e eficencës së energjisë dhe gama e klasave të eficencës së energjisë paraqiten, siç tregohet në Figurën 1, me sa më poshtë vijon:

(a) Një shigjetë, që përmban shkronjën e klasës së eficencës së energjisë në ngjyrë 100% të bardhë, me shkronjat në formatin Calibri Bold, dhe me një madhësi shkronje, të paktën, ekuivalente me atë të çmimit, kur tregohet çmimi;

(b) Ngjyra e shigjetës që përputhet me ngjyrën e klasës së eficencës së energjisë;

(c) Gamën e klasave të disponueshme të eficencës së energjisë në ngjyrë 100% të zezë; dhe,

(d) Madhësia duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Shkronja në shigjetën e klasës së eficencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi prej 0,5 pt në ngjyrë 100% të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe shkronjës së klasës së eficencës së energjisë.

Si përjashtim, nëse reklama vizuale, materiali promovues teknik ose shitja në distancë e bazuar në letër është e printuar në pikturë njëngjyrëshe, atëherë në atë reklamë vizuale, material promovues teknik ose shitje në distancë e bazuar në letër shigjeta mund të jetë pikturë njëngjyrëshe.

Figura 1

Shigjeta majtas/djathtas me ngjyrë/njëngjyrëshe, me gamën e treguar të klasave të eficencës së energjisë



5. Shitja në distancë e bazuar në telemarketing duhet të informojë në mënyrë specifike klientin për klasën e eficencës së energjisë së produktit dhe për gamën e klasave të eficencës së energjisë të disponueshme në etiketë, dhe se klienti mund të aksesojë etiketën dhe fletën e informacionit të

produktit përmes faqes së internetit të bazës së të dhënave të produktit ose duke kërkuar një kopje të printuar.

6. Për të gjitha situatat e përmendura në pikat 1 deri në 3 dhe 5, duhet të jetë e mundur që klienti të marrë, sipas kërkesës, një kopje të printuar të etiketës dhe fletën e informacionit të produktit.

SHTOJCAI VII

Informacioni që duhet dhënë në rastin e shitjes në distancë përmes internetit

1. Etiketa elektronike e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas pikës 1(e) të Kreut IV shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit. Përmasa është e tillë që etiketa të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë dhe është proporcionale me përmasën e specifikuar në pikën 2 të Shtojcës II. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë respekton specifikimet e përcaktuara në pikën 2 të kësaj Shtojce. Nëse aplikohet ekrani i ndërlidhur, atëherë etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose në zgjerimin e ekranit me prekje mbi imazh.

2. Imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë në rastin e ekranit të ndërlidhur, siç tregohet në Figurën 2:

(a) Eshtë një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e eficencës së energjisë së produktit në etiketë;

(b) Tregon klasën e eficencës së energjisë së produktit në shigjetë në ngjyrë 100% të bardhë, me shkronjat në formatin Calibri Bold dhe me një madhësi shkronjash ekuivalente me atë të çmimit;

(c) Ka gamën e klasave të disponueshme të eficencës së energjisë së në ngjyrë 100% të zezë; dhe,

(d) Ka një nga dy formatet e mëposhtme dhe përmasa e tij është e tillë që shigjeta të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Shkronja në shigjetën e klasës së eficencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi të dukshëm në ngjyrë 100% të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe germën e klasës së eficencës së energjisë:

Figura 2

Shigjeta me ngjyrë majtas/djathtas, me gamën e treguar të klasave të eficencës së energjisë



3. Në rastin e ekranit të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:

(a) Imazhi i përmendur në pikën 2 të kësaj Shtojce paraqitet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit;

(b)Imazhi lidhet me etiketën e përcaktuar në Shtojcën II;

(c) Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, pas rrotullimit të mausit ose pas zgjerimit të ekranit me prekje mbi imazh;

(d)Etiketa shfaqet me anë të një dritareje të re, skedës së re, faqes së re ose ekranit të ndërlidhur;

(e) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;

(f) Shfaqja e etiketës ndalohen me anë të opsionit të mbylljes ose mekanizmit tjetër standard të mbylljes;
(g)Teksti alternativ për grafikun, i cili do të shfaqet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e eficencës së energjisë së produktit në një madhësi shkronje të barabartë me atë të çmimit.

4. Fleta elektronike e informacionit të produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas pikës 1(ë) të Kreut IV shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit. Përmasa është e tillë që fleta e informacionit të produktit të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Fleta e informacionit të produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur ose duke iu referuar bazës së të dhënave të produktit, rast në të cilin lidhja e përdorur për të hyrë në fletën e informacionit të produktit duhet të tregojë në mënyrë qartë dhe të lexueshme "Fletën e informacionit të produktit". Nëse përdoret një ekran i ndërlidhur, fleta e informacionit të produktit shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi lidhje.

SHTOJCA VIII
Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë lidhen vetëm me verifikimin nga Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut të vlerave të deklaruara dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesi si tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik ose për të interpretuar këto vlera me synimin e arritjes së përputhshmërisë ose për të komunikuar performancë më të mirë. Vlerat dhe klasat e publikuara në etiketë ose në skedën e informacionit të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara në dokumentacionin teknik.

Kur një model është projektuar në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të zbulojë se është duke u testuar (p.sh., njeh kushtet e testimit ose ciklin e testimit) dhe të reagojë në mënyrë të posaçme duke ndryshuar automatikisht performancën e tij gjatë testit me objektivin për të arritur një nivel më të favorshëm për secilin nga parametrat e specifikuar në këtë rregullore ose të përfshirë në dokumentacionin teknik ose të përfshirë në ndonjë nga element e dokumentacionit të ofruar, atëherë vetë modeli si dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen të papajtueshme me kërkesat.

Si pjesë e verifikimit të përputhshmërisë së një modeli me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të zbatojë procedurën e mëposhtme:

Kur verifikohet respektimi i kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore nga ana e një modeli të produktit, atëherë Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

(1) Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut verifikon një njësi të vetme të modelit.
(2) Modeli konsiderohet se respekton kërkesat e zbatueshme nëse:
   (a) Vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik sipas pikës 3 të nenit 9 të Ligjit 52/2024, dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit; dhe
   (b) Vlerat e publikuara në etiketë dhe në fletën e informacionit të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e eficencës së energjisë dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe
   (c) Kur Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 5.
(3) Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen se nuk respektojnë këtë rregullore.

(4) Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut zgjedh tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund t'i përkasin një ose më shumë modeleve ekuivalente.
(5) Modeli quhet se respekton kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 5.
(6) Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente quhen se nuk respektojnë këtë rregullore.
(7) Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut jep të gjithë informacionin përkatës pa vonesë, pasi të merret një vendim për mosrespektimin e kërkesave nga ana e modelit sipas pikave 3 dhe 6, ose paragrafit të dytë të kësaj Shtojce.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në
Shtojcën IV.
Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut zbaton vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 5 si dhe përdorin vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 7 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojca. Për parametrat në Tabelën 5, nuk zbatohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 5

Tolerancat e verifikimit

Parametri	Tolerancat e verifikimit
Konsumi i energjisë i programit ekologjik (EPEC)	Vlera e përcaktuar (*1) nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të EPEC për më shumë se 5%.
Konsumi i ujit i programit ekologjik (EPWC)	Vlera e përcaktuar (*1) nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të EPWC për më shumë se 5%.
Indeksi i performancës së pastrimit (I_C)	Vlera e përcaktuar (* 1) nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar e I_C për më shumë se 14 %.
Indeksi i performancës së tharjes (I_D)	Vlera e përcaktuar (* 1) nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar e I_D për më shumë se 12 %.
Kohëzgjatja e programit (T_t)	Vlera e përcaktuar (*1) nuk duhet t'i kalojë vlerat e deklaruara T_t për më shumë se 5% ose 10 minuta, cilado qoftë më e gjatë.

Konsumi i energjisë në modalitetin e fikur (P_o)	Vlera e përcaktuar ([*1]) e konsumit të energjisë P_o nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 0,10 W.
Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë (P_{sm})	Vlera e përcaktuar ([*1]) e konsumit të energjisë P_{sm} nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 10 % nëse vlera e deklaruar është më e lartë se 1,00 W, ose me më shumë se 0,10 W nëse vlera e deklaruar është më e ulët se ose e barabartë me 1,00 W.
Konsumi i energjisë në fillimin me vonesë (P_{ds})	Vlera e përcaktuar ([*1]) e konsumit të energjisë P_{ds} nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 10 % nëse vlera e deklaruar është më e lartë se 1,00 W, ose me më shumë se 0,10 W nëse vlera e deklaruar është më e ulët se ose e barabartë me 1,00 W.
Emetimet e zhurmës akustike në ajër	Vlera e përcaktuar ([*1]) nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 2 dB(A) për 1pW.

([*1]) Në rastin e tre njësive shtesë të testuara siç përcaktohet në pikën 4, vlera e përcaktuar është mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara për këto tre njësi shtesë.

ANEKS NR.7

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË KONDICIONERËVE"[1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin dhe dhënien e informacionit shtesë të produktit për kondicionerët që funksionojnë me energji elektrike nga rrjeti, me kapacitet të vlerësuar deri në 12 kW për ftohje, ose ngrohje, nëse produkti nuk ka funksion ftohës.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
   a) Pajisjet që përdorin burime energjie jo elektrike;
   b) Kondicionerët, në të cilët ana e kondensatorit ose avulluesit, ose të dyja, nuk përdorin ajrin si instrument për transmetimin e nxehtësisë.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Ekran i ndërlidhur"** është ndërfaqja pamore ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrotullim të mausit ose me zgjerimin në ekranin me prekje të një imazhi ose grupi tjetër të dhënash;
2. **"Ekran me prekje"** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si p.sh., ai i një kompjuteri tablet, kompjuteri me ekran me prekje ose i një telefoni inteligjent;
3. **"Funksion"** është treguesi nëse njësia është e aftë të ftohë ajrin e brendshëm, të ngrohë ajrin e brendshëm, ose të dyja;
4. **"Funksioni i riaktivizimit"** është një funksion që lehtëson aktivizimin e opsioneve të tjera, duke përfshirë opsionin aktiv, me anë të çelësit në distancë duke përfshirë telekomandën, sensorin e brendshëm, kohëmatësin në një gjendje që ofron funksione shtesë, duke përfshirë funksionin kryesor;
5. **"Kapaciteti i deklaruar"** [kW] është kapaciteti i ciklit të ngjeshjes së avullit të njësisë për ftohje (*Pdc(Tj)*) ose ngrohje (*Pdh(Tj)*), që i përket temperaturës së jashtme Tj dhe temperaturës së brendshme (*Tin*), siç deklarohet nga prodhuesi.
6. **"Kapaciteti i ngrohësit elektrik rezervë"** (*elbu(Tj)*) është kapaciteti ngrohës [kW] i një ngrohësi elektrik rezervë real ose të supozuar me COP-in prej 1 që plotëson kapacitetin e deklaruar të ngrohjes (*Pdh(Tj)*) me qëllim që të arrihet ngarkesa e

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren Nr 626/2011 e datës 4 maj 2011 që plotëson Direktivën 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me: "Etiketimin energjetik të kondicionerëve". Numri CELEX 02011R0626-20230930, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 178, datë 6.7.2011, f. 1.

pjesshme për ngrohje (*Ph(Tj)*) në rast se *Pdh(Tj)* është më e vogël se Ph(Tj), për temperaturën e jashtme (Tj);

7. **"Kapaciteti i vlerësuar"**(P_{rated}) është kapaciteti ftohës ose ngrohës i ciklit të komprimimit të avullit të njësisë në kushtet standarde të vlerësimit;
8. **"Kërkesa vjetore referente për ftohjes"** (*QC*) është kërkesa referente për ftohje [kWh/a] që përdoret si bazë për llogaritjen e SEER-it dhe që llogaritet si produkt i ngarkesës së projektuar pë ftohje (*Pdesignc*) dhe orët e barasvlershme në opsionin ndezur për ftohje (*HCE*);
9. **"Kërkesa vjetore referente për ngrohje"** (*QH*) është kërkesa referente për ngrohje [kWh/a], që i përket një sezoni të caktuar ngrohjeje, që përdoret si bazë për llogaritjen e SCOP-it dhe që llogaritet si produkt i ngarkesës së projektuar për ngrohje (*Pdesignh*) dhe orëve të barasvlershme në opsionin ndez për ngrohje (H_{AI});
10. **"Koeficienti i deklaruar i performancës"** (*COPd(Tj)*) është koeficienti i performancës në një numër të kufizuar periudhash të specifikuara (*j*) me temperaturë të jashtme (*Tj*), siç deklarohet nga prodhuesi;
11. **"Koeficienti i performancës sipas periudhës specifike"** (*COPbin(Tj)*) është koeficienti i performancës specifik për çdo periudhë j me temperaturë të jashtme Tj në një sezon, që rrjedh nga ngarkesa e pjesshme, kapaciteti i deklaruar dhe koeficienti i deklaruar i performancës (*COPd(Tj)*) për periudhat e specifikuara *(j)* dhe që llogaritet për periudhat e tjera nëpërmjet inter/ekstrapolimit, kur korrigjohet në mënyrë të domosdoshme me koeficientin e humbjes së efiçencës;
12. **"Koeficienti i vlerësuar i performancës"** (*COP*$_{rated}$) është kapaciteti i deklaruar i ngrohjes [kW] pjesëtuar me fuqinë e vlerësuar hyrëse për ngrohje [kW] të një njësie kur sigurohet ngrohje në kushte standarde të vlerësimit;
13. **"Koeficienti sezonal i performancës në opsionin ndezur"** (*SCOPo*n) është koeficienti mesatar i performancës së njësisë në opsionin ndezur për sezonin e caktuar të ngrohjes, i përbërë nga ngarkesa e pjesshme, kapaciteti i ngrohjes rezervë elektrike (kur kërkohet) dhe koeficientet specifikë të performancës së periudhës (*COPbin(Tj)*) dhe i ponderuar me orët e periudhës kur krijohen kushtet e kësaj periudhe.
14. **"Koeficienti sezonal i performancës"** (*SCOP*) është koeficienti i përgjithshëm i performancës së njësisë, që përfaqëson të gjithë sezonin e caktuar të ngrohjes (vlera e SCOP-it i përket një sezoni të caktuar ngrohjeje), i llogaritur si kërkesa referente vjetore për ngrohje, pjesëtuar me konsumin vjetor të energjisë elektrike për ngrohje;
15. **"Kondicioner me cikël të kthyeshëm"** është një kondicioner që është i aftë të prodhojë si ftohje ashtu edhe ngrohje;
16. **"Kondicioner me dy kanale ajri"** është një kondicioner në të cilin, ajri që hyn në kondensator ose tek avulluesi gjatë ftohjes ose ngrohjes vjen nga mjedisi i jashtëm për tek njësia me anë të një kanali ajri dhe shkarkohet në mjedisin e jashtëm nga një kanal ajri i dytë, dhe i cili është i vendosur tërësisht brenda hapësirës që do të jetë me ajër të kondicionuar, pranë një muri:
17. **"Kondicioner me një kanal ajri"** është një kondicioner në të cilin, ajri që hyn në kondensator ose tek avulluesi gjatë ftohjes ose ngrohjes vjen nga hapësira që përmban njësinë dhe shkarkohet jashtë kësaj hapësire;

18. **"Kondicioner"** është një pajisje që shërben për të ftohur ose ngrohur ajrin e brendshëm, ose që shërben për t"i bërë të dyja, duke përdorur të një cikli të ngjeshjes së avullit që operohet nga një kompresor elektrik, duke përfshirë kondicionerët që ofrojnë funksione shtesë si heqja e lagështirës, pastrimi i ajrit, ventilimi ose ngrohja shtesë e ajrit me anë të ngrohjes me rezistencë elektrike dhe pajisje që mund të përdorin ujë (qoftë uji i kondensuar që formohet në anën e avulluesit ose ujë të shtuar nga jashtë) për avullimin në kondensator, me kusht që pajisja të jetë në gjendje të funksionojë edhe pa përdorimin e ujit shtesë, duke përdorur vetëm ajër;
19. **"Konsumi vjetor i energjisë elektrike për ftohje"** (*QCE*) është konsumi i energjisë elektrike [kWh/a] që kërkohet për të përmbushur kërkesën vjetore referente për ftohje dhe llogaritet si kërkesa vjetore referente për ftohje e pjesëtuar me raportin e efiçencës sezonale të energjisë në opsionin ndezur (*SEERon*) dhe konsumi i energjisë elektrike i njësisë për opsionin me termostat të fikur, opsionin e gatishmërinë,opsionin e fikur dhe të opsionit të ngrohjes së kompresorit gjatë sezonit të ftohjes;
20. **"Konsumi vjetor i energjisë elektrike për ngrohje"** (Q_{HE}) është konsumi i energjisë elektrike [kWh/a] që kërkohet për të plotësuar kërkesën e referente vjetore për ngrohje dhe që i përket një sezoni të caktuar ngrohjeje; dhe llogaritet si kërkesa vjetore referente për ngrohje pjesëtuar me koeficientin sezonal të performancës në opsionin ndezur (*SCOPo*n) dhe konsumi i energjisë elektrike së njësisë në opsionin me termostat të fikur, opsionin e gatishmërisë, opsionin e fikur dhe në opsionin të ngrohjes së kompresorit gjatë sezonit të ngrohjes;
21. **"Konsumimi i energjisë elektrike i kondicionerëve me nje kanal dhe me dy kanale"** (*QSD* përkatësisht *QDD*) është konsumi i energjisë elektrike të kondicionerëve me një ose dy kanale për opsionin e ftohjes dhe/ose ngrohjes (cilado që përdoret) [me një kanal në kWh/h, me dy kanale në kWh/h];
22. **"Kushtet referente të projektimit"** janë kombinimi i kërkesave për temperaturën referente të projektimit, temperaturën maksimale bivalente dhe temperaturën maksimale kufi të funksionimit, siç përcaktohet në Tabelën 3 të Shtojcës VI;
23. **"Kushtet standarde të vlerësimit"** është kombinimi i temperaturave të brendshme (Tin) dhe të jashtme (*Tj*) që përshkruan kushtet e funksionimit teksa përcakton nivelin e fuqisë së zhurmës, kapacitetin e vlerësuar, prujen e ajrit të vlerësuar, raportin e vlerësuar të efiçencës së energjisë (EER_{rated}) dhe/ose koeficientin e vlerësuar të performancës (COP_{rated}), siç përcaktohet në Tabelën 2 të Shtojcës VI;
24. **"Mekanizmi i shfaqjes"** është çdo ekran, duke përfshirë ekranin me prekje, ose teknologji të tjera pamore që përdoren për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;
25. **"Ngarkesë e pjesshme"** është ngarkesa e ftohjes (*Pc(Tj)*) ose ngarkesa e ngrohjes (*Ph(Tj)*) [kW] në një temperaturë specifike të jashtme *Tj*, e llogaritur si ngarkesa e projektuar e shumëzuar me raportin e ngarkesës së pjesshme;
26. **"Ngarkesë e projektuar"** është ngarkesa e deklaruar e ftohjes (*Pdesignc*) dhe/ose ngarkesa e deklaruar e ngrohjes (*Pdesignh*) [kW] në temperaturën e referente të projektimit, ku:

a) Për opsionin e ftohjes, *Pdesignc* është e barabartë me kapacitetin e deklaruar *të* ftohjes për *Tj* të barabartë me *Tdesignc;*
b) Për opsionin e ngrohjes, *Pdesignh* është e barabartë me ngarkesën e pjesshme për *Tj* të barabartë me *Tdesignh;*

27. **"Niveli i fuqisë së zhurmës"** është niveli i fuqisë së zhurmës i ponderuar në shkallën A [*dB(A)*] brenda dhe/ose jashtë, i matur në kushtet standarde të vlerësimit të ftohjes (ose ngrohjes, nëse produkti nuk ka funksion ftohjeje);
28. **"Opsioni i fikur"** është gjendja në të cilën kondicioneri ose ventilatori është i lidhur me burimin e energjisë elektrike dhe nuk kryen asnjë funksion. Si opsion i fikur konsiderohen gjithashtu edhe kushtet që sigurojnë vetëm një tregues të gjendjes së opsionit të fikur, si dhe kushtet që kryejnë vetëm funksionalitete të destinuara për të siguruar përputhshmërinë elektromagnetike sipas Vendimit Nr. 552, datë 31.7.2019;
29. **"Opsioni i funksionimit të ngrohësit të kompresorit"** është një gjendje ku njësia ka aktivizuar pajisjen ngrohëse për të shmangur kalimin e materialit ftohës tek kompresori në mënyrë që të kufizojë përqendrimin e materialit ftohës në vaj kur hyn në punë kompresori;
30. **"Opsioni i gatishmërisë"** është gjendja ku pajisja është e lidhur me burimin e energjisë elektrike, varet nga energjia që merr nga burimi i energjisë elektrike për të punuar siç synohet dhe kryen vetëm funksionet e mëposhtme, të cilat mund të vazhdojnë për një kohë të pacaktuar: funksioni i riaktivizimit, ose funksioni i riaktivizimit dhe vetëm një tregues i funksionit të aktivizuar të riaktivizimit dhe/ose informacioni ose shfaqja e statusit;
31. **"Opsioni i termostatit të fikur"** është opsioni që korrespondon me orët pa ngarkesë ftohjeje ose ngrohjeje ku funksioni i ftohjes ose ngrohjes i njësisë është i ndezur, por njësia nuk është në funksion pasi nuk ka ngarkesë ftohjeje ose ngrohjeje. Kjo gjendje lidhet me temperaturat e jashtme dhe jo me ngarkesat e brendshme. Ndezja/fikja në opsionin ndezur nuk konsiderohet si termostat i fikur;
32. **"Opsioni ndezur"** është opsioni që korrespondon me orët që kanë ngarkesë ftohjeje ose ngrohjeje të ndërtesës dhe kur aktivizohet funksioni i ftohjes ose ngrohjes së njësisë. Kjo gjendje mund të përfshijë ndezjen/fikjen e njësisë për të arritur ose ruajtur temperaturën e kërkuar të ajrit të brendshëm;
33. **"Orë të barasvlershme në opsionin aktiv për ftohje"** (*HCE*) është numri i supozuar vjetor i orëve [h/a] që njësia duhet të sigurojë ngarkesën e projektuar për ftohje (*Pdesignc*) në mënyrë që të përmbushë kërkesën vjetore referente për ftohje, siç përcaktohet në Tabelën 4 të Shtojcës VI;
34. **"Orët e barasvlershme në opsionin ndez për ngrohje"** (H_{AI}) është numri i supozuar vjetor i orëve [h/a] kur njësia duhet të sigurojë ngarkesën e projektuar të ngrohjes (*Pdesignh*) në mënyrë që të plotësojë kërkesën vjetore referente për ngrohje, siç përcaktohet në Tabelën 4 të Shtojcës VI;
35. **"Orët e funksionimit në opsionin e gatishmërisë"** (*HSB*) është numri vjetor i orëve [h/a] që njësia konsiderohet të jetë në opsionin e gatishmërisë, vlera e të cilave varet nga sezoni dhe funksioni i caktuar;

36. **"Orët e funksionimit në opsionin e ngrohësit të kompresorit"** (*HCK*) është numri vjetor i orëve [h/a] që njësia konsiderohet të jetë në opsionin e funksionimit të ngrohësit të kompresorit, vlera e të cilit varet nga sezoni dhe funksioni i caktuar;
37. **"Orët e funksionimit të opsionit të termostatit të fikur"** (*HTO*) është numri vjetor i orëve [h/a] që njësia konsiderohet të jetë në opsionin e termostatit të fikur, vlera e të cilave varet nga sezoni dhe funksioni i caktuar;
38. **"Orët e opsionit fikur"** (*HOFF*) është numri vjetor i orëve [h/a] që njësia konsiderohet të jetë në opsionin e fikur, vlera e të cilave varet nga sezoni dhe funksioni i caktuar;
39. **"Orët e periudhës"** është numri i orëve në sezon (*hj*) kur temperatura e jashtme arrihet për çdo periudhë, siç përcaktohet në Tabelën 1 të Shtojcës VI;
40. **"Paraqitja e informacionit ose e statusit"** është një funksion i vazhdueshëm që ofron informacion ose tregon statusin e pajisjes në një ekran, duke përfshirë orët;
41. **"Përdorues fundor"**është konsumatori që blen ose pritet të blejë një kondicioner;
42. **"Periudhë"** (me treguesin "*j*") është një kombinim i temperaturës së jashtme (Tj) dhe numrit të orëve të periudhës (hj), siç përcaktohet në Tabelën 1 të Shtojcës VI;
43. **"Pika e shitjes"** është një vend ku kondicionerët ekspozohen ose ofrohen për shitje, qira ose blerje me këste;
44. **"Potenciali i ngrohjes globale"** (*GWP*) është masa që tregon se sa vlerësohet se kontribuon në ngrohjen globale 1 kg material ftohës i përdorur në ciklin e komprimimit të avullit, i shprehur në kg CO_2 të barasvlershëm gjatë një periudhe kohore 100-vjeçare;
    Vlerat e GWP-së që janë marrë në konsideratë janë ato të përcaktuara në Ligjin Nr. 2/2023 "Për Gazet Serrë Të Fluoruara";
    Për gazet pa fluor, vlerat e GWP-së janë ato të publikuara në vlerësimin e parë të IPCC-së për një periudhë-100 vjeçare;
    Vlerat totale të GWP-së për përzierjet e materialeve ftohëse bazohen në formulën e deklaruar në Aneksin IV të Ligjit Nr. 2/2023 "Për Gazet Serrë Të Fluoruara".
    Për materialet ftohëse që nuk përfshihen në referencat e mësipërme, përdoret si referencë raporti i IPCC-së UNEP-it 2010 mbi ftohjen, kondicionimin dhe pompat e nxehtësisë, i muajit shkurt 2011 ose më i ri;
45. **"Raporti i deklaruar i efiçencës së energjisë"** (*EERd(Tj)*) është raporti i efiçencës së energjisë në një numër të kufizuar periudhash të specifikuara (*j*) me temperaturë të jashtme (*Tj*), siç deklarohet nga prodhuesi;
46. **"Raporti i efiçencës së energjisë për një periudhë specifike"** (*EERbin(Tj)*) është raporti i efiçencës së energjisë specifik për çdo periudhë me temperaturën e jashtme Tj në një sezon, që rrjedh nga ngarkesa e pjesshme, kapaciteti i deklaruar dhe raporti i deklaruar i efiçencës së energjisë (*EERd(Tj)*) për periudhat e specifikuara (j) dhe që llogaritet për periudhat e tjera nëpërmjet inter/ekstrapolimit, kur korrigjohet në mënyrë të domosdoshme nga koeficienti i humbjes së efiçencës;
47. **"Raporti i efiçencës sezonale të energjisë në opsionin ndezur"** (*SEERon*) është raporti mesatar i efiçencës së energjisë së njësisë në opsionin ndezur për funksionin e ftohjes, i përbërë nga ngarkesa e pjesshme dhe raporti specifik i efiçencës së energjisë së periudhës (EERbin(Tj)) dhe i ponderuar me orët e periudhës kur krijohen kushtet e periudhës;

48. **"Raporti i kapacitetit"** është raporti i kapacitetit total të deklaruar të ftohjes ose ngrohjes të së gjitha njësive të brendshme që funksionojnë me kapacitetin e deklaruar të ftohjes ose ngrohjes së njësisë së jashtme në kushtet standarde të vlerësimit;
49. **"Raporti i ngarkesës së pjesshme"** (*pl(Tj)*) është temperatura e jashtme minus 16°C, pjesëtuar me temperaturën referente të projektimit minus 16°C, qoftë për ftohje apo ngrohje;
50. **"Raporti i vlerësuar i efiçencës së energjisë"** (EER_{rated}) është kapaciteti i deklaruar i ftohjes [kW] pjesëtuar me fuqinë e vlerësuar hyrëse për ftohje [kW] të një njësie kur sigurohet ftohje në kushtet standarde të vlerësimit;
51. **"Raporti sezonal i efiçencës së energjisë"** (*SEER*) është raporti i përgjithshëm i efiçencës së energjisë së njësisë, që përfaqëson të gjithë sezonin e ftohjes, i llogaritur si kërkesa vjetore e referente për ftohje, pjesëtuar me konsumin vjetor të energjisë elektrike për ftohje;
52. **"Sezoni"** është një nga katër grupet e kushteve të funksionimit (të disponueshme për katër sezone: një sezon ftohjeje, tre sezone ngrohjeje: mesatare/më i ftohtë/më i ngrohtë) që përshkruan sipas periudhës kombinimin e temperaturave të jashtme dhe numrin e orëve ku arrihen këto temperatura në sezon, për të cilat njësia shpallet e përshtatshme për qëllimin e saj;
53. **"Tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një pamjeje grafike, që bën të mundur që informacioni të paraqitet në formë jo grafike kur pajisjet e shfaqes nuk mund të paraqesin pamjen grafike ose që shërben si një ndihmë për aksesueshmërinë, siç është hyrja në aplikacionet e sintezës së zërit.
54. **"Temperatura bivalente"** (*Tbiv*) është temperatura e jashtme (*Tj*) [°C] e deklaruar nga prodhuesi për ngrohje, në të cilën kapaciteti i deklaruar është i barabartë me ngarkesën e pjesshme dhe poshtë së cilës kapaciteti i deklaruar duhet të plotësohet me kapacitetin e ngrohësit elektrik rezervë për të realizuar ngarkesën e pjesshme *p*ër ngrohje;
55. **"Temperatura e brendshme"** (*Tin*) është temperatura e ajrit të brendshëm të llambës së thatë [*°C*] (ku lagështia relative tregohet nga temperatura përkatëse me llambë të lagur);
56. **"Temperatura e jashtme"** (*Tj*) është temperatura e ajrit të jashtëm të llambës së thatë [*°C*] (ku lagështira relative tregohet nga temperatura përkatëse me llambë të lagur);
57. **"Temperatura kufi e funksionimit"** (*Tol*) është temperatura e jashtme [°C] e deklaruar nga prodhuesi për ngrohje, poshtë së cilës kondicioneri nuk do të jetë në gjendje të realizojë asnjë kapacitet ngrohjeje. Nën këtë temperaturë, kapaciteti i deklaruar është i barabartë me zero;
58. **"Temperatura referente e projektimit"** është temperatura e jashtme [*°C*] e ftohjes (*Tdesignc*) ose e ngrohjes (*Tdesignh*), siç përshkruhet në Tabelën 3 të Shtojcës VI, në të cilën raporti i ngarkesës së pjesshme është i barabartë me 1 dhe ndryshon sipas sezonit të caktuar të ftohjes ose ngrohjes;

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit sigurojnë që:

a) çdo kondicioner pajiset me një etiketë të printuar që respekton klasat e efiçencës së energjisë sipas përcaktimeve të Shtojcës I. Formati i etiketës dhe përmbajtja e informacioni në etiketë është në përputhje me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në Shtojcën II. Me përjashtim të kondicionerëve me një dhe me dy kanale ajri, kondicionerët e tjerë pajisen me një etiketë të printuar dhe të vendosur në paketimin e njësisë së jashtme, lidhur me të paktën një kombinim të njësive të brendshme dhe të jashtme në raportin e kapacitetit të brabartë me 1. Për kombinimet e tjera, informacioni mund të ofrohet në mënyrë alternative në një faqe interneti me akses të lirë;

b) çdo kondicioner pajiset me një skedë informative sipas përcaktimeve të Shtojcës III. Me përjashtim të kondicionerëve me një dhe me dy kanale ajri, kondicionerët e tjerë pajisen me një skedë informative të produktit të vendosur në paketimin e njësisë së jashtme, lidhur me të paktën një kombinim të njësive të brendshme dhe të jashtme në raportin e kapacitetit të brabartë me 1. Për kombinimet e tjera, informacioni mund të ofrohet në mënyrë alternative në një faqe interneti me akses të lirë;

c) dokumentacioni teknik, ashtu siç përcaktohet në shtojcën IV, vihet në dispozicion në format elektronik në rast kërkese nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut;

ç) çdo reklamë për një model specifik kondicioneri, e cila publikon informacione të lidhura me energjinë ose çmimin përfshin gjithashtu klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli; Në rastet kur produkti mund të ketë më shumë se një klasë efiçence, furnizuesi ose prodhuesi, sipas rastit, deklaron klasën e efiçencës së energjisë për ngrohje të paktën në sezonin e ngrohjes 'mesatare'.Në rastet kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, jepet informacioni siç përcaktohet në Shtojcën V;

d) çdo material teknik reklamimi në lidhje me një model specifik kondicioneri, që përshkruan parametrat e tij specifikë teknik, përfshin gjithashtu klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli siç përcaktohet në Shtojcës I ;

dh) udhëzimet e përdorimit të jenë të disponueshme;

e) Kondicionerët me një kanal emërtohen si "*kondicionerë lokalë* "në paketim, në dokumentacionin e produktit dhe në çdo material reklamues, qoftë elektronik apo në letër;

ë) një etiketë elektronike, në formatin dhe me përmbajtje informacioni sipas përcaktimeve të shtojcës II, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model kondicioneri të vendosur në treg nga data 1 Janar 2015 me një identifikues të ri modeli, duke respektuar klasat e efiçencës së energjisë të përcaktuara në Shtojcën I. Mund të vihet gjithashtu në dispozicion të tregtarëve për modele të tjera të kondicionerëve;

f) një skedë informacioni e pajisjes, u vihet në dispozicion tregtarëve në format elektronik për çdo model kondicioneri, të vendosur në treg nga data 1 Janar 2015 me një identifikues të ri modeli, siç përcaktohet në Shtojcën III. Mund të vihet gjithashtu në dispozicion të tregtarëve për modele të tjera të kondicionerëve;

2. Klasa e efiçencës së energjisë përcaktohet në përputhje me Shtojcën VI.
3. Formati i etiketës së kondicionerëve, me përjashtim të kondicionerëve me një dhe me dy kanale ajri, është sipas përcaktimeve të Shtojcës II.

4. Me përjashtim të kondicionerëve me një dhe me dy kanale ajri, formati i etiketës së kondicionerëve të tjerë i përcaktuar në Shtojcën II zbatohet sipas radhitjes kohore të mëposhtme:
   a) Me përjashtim të kondicionerëve me një kanal dhe me dy kanale ajri, në rastin e kondicionerëve të tjerë të vendosur në treg nga data 1 janar 2013, etiketat me klasat e efiçencës së energjisë A, B, C, D, E, F, G janë në përputhje me pikën 1.1 të Shtojcës II për kondicionerët me cikël me drejtim të kthyeshëm, etiketat për kondicionerët vetëm për ftohje janë në përputhje me pikën 2.1 të Shtojcës II dhe etiketat për kondicionerët vetëm për ngrohje janë në përputhje me pikën 3.1 të Shtojcës II;
   b) Me përjashtim të kondicionerëve me një kanal dhe me dy kanale ajri, në rastin e kondicionerëve të tjerë të vendosur në treg nga data 1 janar 2015, etiketat me klasat e efiçencës së energjisë A+, A, B, C, D, E, F, janë në përputhje me pikën 1.2 të Shtojcës II për kondicionerët me cikël me drejtim të kthyeshëm, etiketat për kondicionerët vetëm për ftohje janë në përputhje me pikën 2.2 të Shtojcës II dhe etiketat për kondicionerët vetëm për ngrohje janë në përputhje me pikën 3.2 të Shtojcës II;
   c) Me përjashtim të kondicionerëve me një kanal dhe me dy kanale ajri, në rastin e kondicionerëve të tjerë të vendosur në treg nga data 1 janar 2017, etiketat me klasat e efiçencës së energjisë A++, A+, A, B, C, D, E, janë në përputhje me pikën 1.3 të Shtojcës II për kondicionerët me cikël me drejtim të kthyeshëm, etiketat për kondicionerët vetëm për ftohje janë në përputhje me pikën 2.3 të Shtojcës II dhe etiketat për kondicionerët vetëm për ngrohje janë në përputhje me pikën 3.3 të Shtojcës II;
   ç) Me përjashtim të kondicionerëve me një kanal dhe me dy kanale ajri, në rastin e kondicionerëve të tjerë të vendosur në treg nga data 1 janar 2019, etiketat me klasat e efiçencës së energjisë A+++, A++, A+, A, B, C, D janë në përputhje me pikën 1.4 të Shtojcës II për kondicionerët me cikël me drejtim të kthyeshëm, etiketat për kondicionerët vetëm për ftohje janë në përputhje me pikën 2.4 të Shtojcës II dhe etiketat për kondicionerët vetëm për ngrohje janë në përputhje me pikën 3.4 të Shtojcës II;
5. Formati i etiketës për kondicionerët me dy kanale ajri të vendosur në treg nga data 1 janar 2013 me klasat e efiçencës së energjisë A+++, A++, A+, A, B, C, D është në përputhje me pikën 4.1 të Shtojcës II për kondicionerët me cikël me drejtim të kthyeshëm, për kondicionerët me dy kanale ajri vetëm për ftohje është në përputhje me pikën 4.3 të Shtojcës II dhe për kondicionerët me dy kanale ajri vetëm për ngrohje është në përputhje me pikën 4.5 të Shtojcës II.
6. Formati i etiketës për kondicionerët me një kanal ajri të vendosur në treg nga data 1 janar 2013 me klasat e efiçencës së energjisë A+++, A++, A+, A, B, C, D, është në përputhje me pikën 5.1 të Shtojcës II për kondicionerët me cikël me drejtim të kthyeshëm, për kondicionerët me një kanal ajri vetëm për ftohje është në përputhje me pikën 5.3 të Shtojcës II dhe për kondicionerë me një kanal ajri vetëm për ngrohje është në përputhje me pikën 5.5 të Shtojcës II.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

1. Tregtarët garantojnë që:
   a) çdo kondicioner i paraqitur në pikën e shitjes, përmban etiketën e dhënë nga furnizuesi në përputhje me pikën 1 të kreut III, me etiketën që shfaqet në anën e jashtme të pjesës së përparme ose të sipërme të pajisjes në mënyrë që të jetë qartësisht e dukshme;
   b) kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, kondicionerët e ofruar për shitje, me qira, ose për blerje me këste, shiten me informacionin e dhënë nga furnizuesit në përputhje me Shtojcat IV dhe V të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit. Kur oferta bëhet përmes internetit dhe është vënë në dispozicion një etiketë elektronike dhe një skedë informative e produktit në format elektronik në përputhje me pikën 1 (ë) dhe 1 (f) të Kreut, zbatohen dispozitat e Shtojcë VIII;
   c) çdo reklamë në lidhje me një model specifik kondicioneri përmban një referencë të klasës së efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin. Në rastet kur produkti mund të ketë më shumë se një klasë efiçence, furnizuesi ose prodhuesi, sipas rastit, deklaron klasën e efiçencës së energjisë për ngrohje të paktën në sezonin e ngrohjes 'mesatare';
   ç) çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik që përshkruan parametrat teknikë të një kondicioneri përfshin klasën e efiçencës së energjisë së modelit dhe udhëzimet për përdorim të ofruara nga furnizuesi. Në rastet kur produkti mund të ketë më shumë se një klasë efiçence, furnizuesi ose prodhuesi, sipas rastit, deklaron klasën e efiçencës së energjisë për ngrohje të paktën në sezonin e ngrohjes 'mesatare';
   d) Kondicionerët me një kanal ajri emërtohen *"kondicionerë lokal"* në paketim, në dokumentacionin e produktit dhe në çdo material promovues ose reklamues, qoftë elektronik ose në letër.

V. METODAT MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni që jepet në përputhje me kreun III merret me metoda të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes, të cilat marrin parasysh metodat më moderne të matjes dhe llogaritjes siç përcaktohet në Shtojcën VI.

VI. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR QËLLIME TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VII të kësaj rregulloreje.

VII. SHFUQIZIMI

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Vendimi Nr. 865, datë 21.10.2015.

SHTOJCA I
Klasat e efiçencës së energjisë

1. Efiçenca e energjisë së kondicionerëve përcaktohet në bazë të matjeve dhe llogaritjeve të përcaktuara në Shtojcën VI.

Si SEER-i ashtu edhe SCOP-i marrin parasysh kushtet referente të projektimit dhe orët e funksionimit sipas opsionit përkatës të funksionimit, dhe SCOP-i lidhet me "mesataren" e sezonit të ngrohjes, siç përcaktohet në Shtojcën VI. Raporti i vlerësuar i efiçencës së energjisë (EER_{rated}) dhe koeficienti i vlerësuar i performancës (COP_{rated}) lidhen me kushtet standarde të vlerësimit, siç përcaktohet në Shtojcën VI.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë së kondicionerëve, përveç atyre me një dhe dy kanale ajri

Klasa e Efiçencës së Energjisë	SEER	SCOP
A+++	SEER ≥ 8,50	SCOP ≥ 5,10
A++	6,10 ≤ SEER < 8,50	4,60 ≤ SCOP < 5,10
A+	5,60 ≤ SEER < 6,10	4,00 ≤ SCOP < 4,60
A	5,10 ≤ SEER < 5,60	3,40 ≤ SCOP < 4,00
B	4,60 ≤ SEER < 5,10	3,10 ≤ SCOP < 3,40
C	4,10 ≤ SEER < 4,60	2,80 ≤ SCOP < 3,10
D	3,60 ≤ SEER < 4,10	2,50 ≤ SCOP < 2,80
E	3,10 ≤ SEER < 3,60	2,20 ≤ SCOP < 2,50
F	2,60 ≤ SEER < 3,10	1,90 ≤ SCOP < 2,20
G	SEER < 2,60	SCOP < 1,90

Tabela 2

Klasat e efiçencës së energjisë së kondicionerëve me një dhe dy kanale kanale ajri

Klasa e Efiçencës së Energjisë	Me dy kanale		Me një kanal	
	EER_{rated}	COP_{rated}	EER_{rated}	COP_{rated}
A+++	≥ 4,10	≥ 4,60	≥ 4,10	≥ 3,60
A++	3,60 ≤ EER < 4,10	4,10 ≤ COP < 4,60	3,60 ≤ EER < 4,10	3,10 ≤ COP < 3,60

A+	3,10 ≤ EER < 3,60	3,60 ≤ COP < 4,10	3,10 ≤ EER < 3,60	2,60 ≤ COP < 3,10
A	2,60 ≤ EER < 3,10	3,10 ≤ COP < 3,60	2,60 ≤ EER < 3,10	2,30 ≤ COP < 2,60
B	2,40 ≤ EER < 2,60	2,60 ≤ COP < 3,10	2,40 ≤ EER < 2,60	2,00 ≤ COP < 2,30
C	2,10 ≤ EER < 2,40	2,40 ≤ COP < 2,60	2,10 ≤ EER < 2,40	1,80 ≤ COP < 2,00
D	1,80 ≤ EER < 2,10	2,00 ≤ COP < 2,40	1,80 ≤ EER < 2,10	1,60 ≤ COP < 1,80
E	1,60 ≤ EER < 1,80	1,80 ≤ COP < 2,00	1,60 ≤ EER < 1,80	1,40 ≤ COP < 1,60
F	1,40 ≤ EER < 1,60	1,60 ≤ COP < 1,80	1,40 ≤ EER < 1,60	1,20 ≤ COP < 1,40
G	< 1,40	< 1,60	< 1,40	< 1,20

SHTOJCA II
Etiketa e kondicionerëve

1. ETIKETA E KONDICIONERËVE, PËRVEÇ ATYRE ME NJË DHE DY KANALE AJRI

1.1. Kondicioner me cikël të kthyeshëm klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A deri në G



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII
IX
X
XI

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti “SEER”dhe “SCOP” për ftohjen dhe ngrohjen, me një ventilator blu dhe tregues të valës së ajrit për SEER-in dhe ventilator të kuq dhe tregues të valës së ajrit për SCOP-in;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë. Efiçenca e energjisë tregohet për ftohje dhe ngrohje. Efiçenca e energjisë së ngrohjes për sezonin mesatar të ngrohjes është e detyrueshme. Tregimi i efiçencës për stinët më të ngrohta dhe më të ftohta është opsional;

V. Për opsionin e ftohjes: ngarkesa e projektuar në kW, e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

VI. Për opsionin e ngrohjes: ngarkesa e projektuar në kW, për periudhën deri në 3 sezone ngrohjeje e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore. Vlerat e sezoneve të ngrohjes për të cilat ngarkesa e projektuar nuk është dhënë, tregohen si “X;

VII. Për opsionin e ftohjes: raporti sezonal i efiçencës së energjisë (vlera SEER), i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

VIII. Për opsionin e ngrohjes: koeficienti sezonal i performancës (vlera SCOP), për periudhën deri në 3 sezone ngrohjeje i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore. Vlerat për sezonet e ngrohjes për të cilat nuk ofrohet SCOP tregohen si “X”;

IX. Konsumi vjetor i energjisë në kWh në vit, për ftohje dhe ngrohje, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Vlerat për profilet klimatike, për të cilat nuk ofrohet konsumi vjetor i energjisë, tregohen si “X”;

X. Nivelet e fuqisë së zhurmës për njësitë e brendshme dhe të jashtme të shprehura në dB(A) re1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

XI. Harta evropiane me paraqitje treguese të tre sezoneve të ngrohjes dhe kutitë me ngjyra përkatëse.

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 1.5. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

1.2. Kondicionerët me cikël të kthyeshëm të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+ deri në F



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII
IX
X
XI

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 1.5.

1.3. Kondicionerët me cikël të kthyeshëm të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A++ deri në E



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII
IX
X
XI

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.

b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 1.5.

1.4. Kondicionerët me cikël të kthyeshëm të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 1.5.

1.5. Skicimi i etiketës



Ku:

i. Etiketa është, së paku, 120 mm e gjerë dhe 210 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):
    1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
    2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
    3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 102 mm, lartësia: 20 mm.
    4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 103,6 mm.
    5. **Ekspozimi i SEER-it dhe i SCOP-it:**
       Kufiri: 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
       Teksti: shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    6. **Shkalla AG:**
        - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm
        - **Ngjyrat**:
            - Klasa më e lartë: X-00-X-00
            - Klasa e dytë: 70-00-X-00
            - Klasa e tretë: 30-00-X-00
            - Klasa e katërt: 00-00-X-00
            - Klasa e pestë: 00-30-X-00
            - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
            - Klasat e fundit: 00-XX-00
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë
    7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
        - **Shigjeta:** gjerësia: 11 mm, lartësia: 10 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë.
    8. **Energjia**
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 9 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    9. **Kapaciteti i vlerësuar për ftohje dhe ngrohje në kW**
        - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
        - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

10. **Vlerat e SCOP dhe SEER, të rrumbullakosura në shifrën e parë dhjetore**
    - **Teksti "SEER"/"SCOP":** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit**
    - **Teksti "kWh/vjetor":** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:**
      - Shkronjat në formatin Calibri bold 15 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
      - Shkronjat në formatin Calibri regular 12 pt, 100% në ngjyrë të zezë.
13. **Harta evropiane dhe kutitë me ngjyra**
    - **Ngjyrat:**
      - Portokalli: 00-46-46-00.
      - E gjelbër: 59-00-47-00
      - Blu: 54-08-00-00
14. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
15. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**
    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 102 × 13 mm.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

2. ETIKETA E KONDICIONERËVE, PËRVEÇ ATYRE ME NJË DHE DY KANALE AJRI

2.1. Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A deri në G



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "SEER" me një ventilator blu dhe tregues të valës së ajrit;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë.
V. Ngarkesa e projektuar për ftohje në kW, e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VI. Raporti sezonal i efiçencës së energjisë (vlera SEER), i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VII. Konsumi vjetor i energjisë në kWh në vit, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.
VIII. Nivelet e fuqisë së zhurmës për njësitë e brendshme dhe të jashtme të shprehura në dB(A) re1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 2.5. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

2.2. Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+ deri në F



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 2.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 2.5.

2.3. Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A++ deri në E



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 2.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 2.5.

2.4. Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 2.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 2.5.

2.5. Skicimi i etiketës



Ku:

i. Etiketa është, së paku, 120 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme

ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.

iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.

iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë : gjerësia: 93 mm, lartësia: 18 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 93,7 mm.
5. **Treguesi SEER:**
   Teksti: shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
6. **Shkalla AG:**
   - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1.3 mm
   - **Ngjyrat**:
     - Klasa më e lartë: X-00-X-00
     - Klasa e dytë: 70-00-X-00
     - Klasa e tretë: 30-00-X-00
     - Klasa e katërt: 00-00-X-00
     - Klasa e pestë: 00-30-X-00
     - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
     - Klasat e fundit: 00-XX-00
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë
7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
   - **Shigjeta:** gjerësia: 23 mm, lartësia: 15 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 29 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë.
8. **Energjia**
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
9. **Kapaciteti i vlerësuar në kW**
   - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
   - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
10. **Vlera e SEER, e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore**
    - **Kufiri:** 3 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Teksti "SEER":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.

- **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

11. **Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit**
    - **Teksti "kWh/vjetor":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** Shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
    - **Teksti :** Shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
13. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
14. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**

    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 90 × 15 mm.
15. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

3. ETIKETA E KONDICIONERËVE, PËRVEÇ ATYRE ME NJË DHE DY KANALE AJRI

3.1. Kondicionerët vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A deri në G



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII
IX

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "SCOP", me ventilator të kuq dhe tregues të valës së ajrit;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të

efiçencës së energjisë. Efiçenca e energjisë për sezonin mesatar të ngrohjes është e detyrueshme. Paraqitja e efiçencës për klimat më të ngrohta dhe më të ftohta është opsional

V. Ngarkesa e projektuar për ngrohje në kW, për periudhën deri në 3 sezone ngrohjeje e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore. Vlerat për sezonet e ngrohjes, për të cilat nuk ofrohet ngarkesa e projektuar, tregohen si "X";

VI. Koeficienti sezonal i performancës (SCOP) për periudhën deri në 3 sezone ngrohjeje, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore. Vlerat për sezonet e ngrohjes, për të cilat nuk ofrohet SCOP-i, tregohen si "X";

VII. Konsumi vjetor i energjisë në kWh në vit, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Vlerat për sezonet e ngrohjes, për të cilat nuk sigurohet konsumi vjetor i energjisë, tregohen si "X";

VIII. Nivelet e fuqisë së zhurmës për njësitë e brendshme dhe të jashtme të shprehura në dB(A) re1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

IX. Harta evropiane me paraqitje treguese të tre sezoneve të ngrohjes dhe kutitë me ngjyra përkatëse

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 3.5. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

3.2. Kondicionerët vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+ deri në F



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII
IX

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 3.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 3.5.

3.3. Kondicionerët vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A++ deri në E



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII
IX

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 3.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 3.5.

3.4. Kondicionerët vetëm me ngrohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII
IX

a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 3.1.
b) Aspektet e skicimit të etiketës janë në përputhje me pikën 3.5.

3.5. Skicimi i etiketës


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
1
2
ENERG
Y
IJA
IE
IA
енергия · ενεργεια
13
4
5
I
II
14
SCOP
A
B
C
D
E
F
G
A
B
C
7
6
8
9
10
kW XY,Z XY,Z XY,Z
SCOP X,Y X,Y X,Y
kWh/annum XY XY XY
11
ZYdB
ZYdB
12
200 mm
15
ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ΕΝΕΡΓΕΙΑ · ENERGIJA · ENERGY · ENERGIE · ENERGI
16
626/2011
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
100 mm

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):
    1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
    2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
    3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë : gjerësia: 93 mm, lartësia: 18 mm.
    4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 93,7 mm.
    5. **Treguesi SCOP:**
       Teksti: shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    6. **Shkalla AG:**
        - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1,3 mm
        - **Ngjyrat**:
            - Klasa më e lartë: X-00-X-00
            - Klasa e dytë: 70-00-X-00
            - Klasa e tretë: 30-00-X-00
            - Klasa e katërt: 00-00-X-00
            - Klasa e pestë: 00-30-X-00
            - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
            - Klasat e fundit: 00-XX-00
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë
    7. **Klasat e efiçencës së energjisë:**
        - **Shigjeta:** gjerësia: 11 mm, lartësia: 10 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë.
    8. **Kapaciteti i vlerësuar në kW**
        - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
        - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    9. **Vlerat e SCOP të rrumbullakosura në shifrën e parë dhjetore**
        - **Teksti "SCOP":** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.

- **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

10. **Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit**
    - **Teksti "kWh/vjetor":** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** shkronjat janë në formatin Calibri regular 15 pt, 100% në ngjyrë të zezë.
    - **Teksti:** shkronjat janë në formatin Calibri regular 12 pt, 100 % në ngjyrë të zezë
12. **Harta evropiane dhe kutitë me ngjyra**
    - **Ngjyrat:**
      - Portokalli: 00-46-46-00.
      - E gjelbër: 59-00-47-00
      - Blu: 54-08-00-00
13. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
14. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**

    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 90 × 15 mm.
15. **Energjia**
    - **Teksti:** shkronjat janë në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

4. ETIKETA E KONDICIONERËVE ME DY KANALE

4.1. Kondicionerët me cikël të kthyeshëm me dy kanale të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "EER"dhe "COP" për ftohjen dhe ngrohjen, me një ventilator blu dhe tregues të valës së ajrit për EER-in dhe ventilator të kuq dhe tregues të valës së ajrit për COP-in;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë. Efiçenca e energjisë tregohet për ftohje dhe ngrohje.

V. Kapaciteti i vlerësuar në opsionin e ftohjes dhe ngrohjes në kW, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

VI. EER_{rated} dhe COP_{rated} rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

VII. Konsumi i energjisë për orë në kWh në 60 minuta, për ftohje dhe ngrohje, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.;

VIII. Nivelet e fuqisë së zhurmës për njësitë e brendshme i shprehur në dB(A) re1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 4.2. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

4.2. Skicimi i etiketës


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
1
2
14
4
5
15
7
6
10
11
12
13
8
9
16
ENERG
енергия · ενέργεια
Y
IJA
IE
IA
I
II
EER
COP
A+++
A++
A+
A
B
C
D
XY,ZkW
X,YEER
XYkWh/60min*
XY,ZkW
X,YCOP
XYkWh/60min*
ZYdB
ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ΕΝΕΡΓΕΙΑ · ENERGIJA · ENERGY · ENERGIE · ENERGI
* Минута · perc · Λεπτά
626/2011
200 mm
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
100 mm

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 82 mm, lartësia: 16 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 92,5 mm.
5. **Treguesi EER dhe COP :**
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
6. **Shkalla AG:**
   - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1,3 mm
   - **Ngjyrat**:
     - Klasa më e lartë: X-00-X-00
     - Klasa e dytë: 70-00-X-00
     - Klasa e tretë: 30-00-X-00
     - Klasa e katërt: 00-00-X-00
     - Klasa e pestë: 00-30-X-00
     - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
     - Klasat e fundit: 00-XX-00
   - **Teksti:**
     - shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë
     - shkronjat në formatin Calibri bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë

7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
   - **Shigjeta:** gjerësia: 11 mm, lartësia: 10 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
   - **Teksti:**
     - shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë
     - shkronjat në formatin Calibri bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë

8. **Energjia**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.

9. **"Minutat"-përkthim**
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 7 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
10. **Kapaciteti i vlerësuar për ftohje dhe ngrohje në kW**
    - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Vlerat e COP dhe EER, të rrumbullakosura në shifrën e parë dhjetore**
    - **Teksti "EER"/"COP":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Konsumi i energjisë në orë në kWh/60 min:**
    - **Teksti "kWh/60 min":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
13. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** Shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
    - **Teksti:** shkronjat janë në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë
14. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
15. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**

    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 82 × 10,5 mm.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

4.3. Kondicionerë me dy kanale ajri vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "EER" me një ventilator blu dhe tregues të valës së ajrit ;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;
V. Kapaciteti i vlerësuar në opsionin e ftohjes në kW, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VI. EER_{rated} i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VII. Konsumi i energjisë për orë në kWh në 60 minuta, i rrumbullakosur shifrën e parë dhjetore;
VIII. Niveli i fuqisë së zhurmës për njësinë e brendshme i shprehur në dB(A) re1 pW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 4.4. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

4.4. Skicimi i etiketës


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
1
2
14
4
5
6
10
13
8
9
16
15
7
11
12
ENERG
енергия · ενεργεία
I
II
EER
A+++
A++
A+
A
B
C
D
A+++
XY,Z
kW
X,Y
EER
ZYdB
XY
kWh/60min*
ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ΕΝΕΡΓΕΙΑ · ENERGIJA · ENERGY · ENERGIE · ENERGI
* Минута · perc · Λεπτά
626/2011
200 mm
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
100 mm

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë : gjerësia: 82 mm, lartësia: 16 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 92,5 mm.
5. **Treguesi EER:**
   Teksti: shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
6. **Shkalla AG:**
   - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1.3 mm
   - **Ngjyrat**:
     - Klasa më e lartë: X-00-X-00
     - Klasa e dytë: 70-00-X-00
     - Klasa e tretë: 30-00-X-00
     - Klasa e katërt: 00-00-X-00
     - Klasa e pestë: 00-30-X-00
     - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
     - Klasat e fundit: 00-XX-00
   - **Teksti:**
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë.
7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
   - **Shigjeta:** gjerësia: 20 mm, lartësia: 15 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
   - **Teksti:**
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 30 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 14 pt, në ngjyrë të bardhë.
8. **Energjia**
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
9. **"Minuta"- përkthim**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 7 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

10. **Kapaciteti i vlerësuar në kW**
    - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Vlera e EER, e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore**
    - **Teksti "EER":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Konsumi i energjisë në orë në kWh/60min**
    - **Teksti "kWh/60min":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
13. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** Shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
    - **Teksti :** Shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
14. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
15. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**

    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 82 × 10,5 mm.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

4.5. Kondicionerë me dy kanale vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "COP", me ventilator të kuq dhe tregues të valës së ajrit;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë.
V. Kapaciteti i vlerësuar për ngrohje në kW i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VI. Koeficienti i performancës (COP), i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.
VII. Konsumi i energjisë për orë në kWh për 60 minuta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
VIII. Niveli i fuqisë së zhurmës për njësinë e brendshme i shprehur në dB(A) re1 pW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 4.6. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

4.6. Skicimi i etiketës


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
1
2
14
4
5
15
ENERG
Y
IJA
IE
IA
енергия · ενεργεια
I
II
COP
A+++
7
6
A+++
A++
A+
A
B
C
D
10
11
XY,Z
kW
X,Y
COP
13
12
ZYdB
XY
kWh/60min*
8
9
16
ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ΕΝΕΡΓΕΙΑ · ENERGIJA · ENERGY · ENERGIE · ENERGI
* Минута · perc · Λεπτά
626/2011
200 mm
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
100 mm

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):
    1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
    2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
    3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë : gjerësia: 82 mm, lartësia: 16 mm.
    4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 92,5 mm.
    5. **Treguesi COP:**
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    6. **Shkalla AG:**
        - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1,3 mm
        - **Ngjyrat**:
            - Klasa më e lartë: X-00-X-00
            - Klasa e dytë: 70-00-X-00
            - Klasa e tretë: 30-00-X-00
            - Klasa e katërt: 00-00-X-00
            - Klasa e pestë: 00-30-X-00
            - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
            - Klasat e fundit: 00-XX-00
        - **Teksti:**
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë
    7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
        - **Shigjeta:** gjerësia: 20 mm, lartësia: 15 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
        - **Teksti:**
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 30 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 14 pt, në ngjyrë të bardhë
    8. **Energjia**
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    9. **"Minuta"-përkthim:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 7 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.

10. **Kapaciteti i vlerësuar në kW**
    - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Vlera e COP e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore**
    - **Teksti "COP":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Konsumi i energjisë në orë në kWh/60min:**
    - **Teksti "kWh/60min":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
13. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** shkronjat janë në formatin Calibri bold 22 pt, 100% në ngjyrë të zezë.
    - **Teksti:** shkronjat janë në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë
14. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
15. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**
    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 82 × 10,5 mm.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

4. ETIKETA E KONDICIONERËVE ME NJË KANAL

5.1. Kondicionerët me cikël të kthyeshëm me një kanal të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "EER"dhe "COP" për ftohjen dhe ngrohjen, me një ventilator blu dhe tregues të valës së ajrit për EER-in dhe ventilator të kuq dhe tregues të valës së ajrit për COP-in;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë. Efiçenca e energjisë tregohet për ftohje dhe ngrohje.

V. Kapaciteti i vlerësuar në opsionin e ftohjes dhe ngrohjes në kW, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

VI. EER_{rated} dhe COP_{rated} rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

VII. Konsumi i energjisë për orë në kWh në 60 minuta, për ftohje dhe ngrohje, i rrumbullakosur në në shifrën e pare dhjetore;

VIII. Nivelet e fuqisë së zhurmës për njësitë e brendshme i shprehur në dB(A) re1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 5.2. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

5.2. Skicimi i etiketës


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
1
2
14
4
5
15
7
6
10
11
12
13
8
9
16
ENERG
енергия · ενεργεια
I
II
EER
COP
A+++
A++
A+
A
B
C
D
XY,ZkW
X,YEER
XYkWh/60min*
XY,ZkW
X,YCOP
XYkWh/60min*
ZYdB
ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ΕΝΕΡΓΕΙΑ · ENERGIJA · ENERGY · ENERGIE · ENERGI
* Минута · perc · Λεπτά
626/2011
200 mm
100 mm

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë : gjerësia: 82 mm, lartësia: 16 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 92,5 mm.
5. **Treguesi EER dhe COP :**
   - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
6. **Shkalla AG:**
   - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1,3 mm
   - **Ngjyrat**:
     - Klasa më e lartë: X-00-X-00
     - Klasa e dytë: 70-00-X-00
     - Klasa e tretë: 30-00-X-00
     - Klasa e katërt: 00-00-X-00
     - Klasa e pestë: 00-30-X-00
     - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
     - Klasat e fundit: 00-XX-00
   - **Teksti:**
     - shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë
     - shkronjat në formatin Calibri bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë
7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
   - **Shigjeta:** gjerësia: 11 mm, lartësia: 10 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
   - **Teksti:**
     - shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë
8. **Energjia**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.

9. **"Minutat"-përkthim**
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 7 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
10. **Kapaciteti i vlerësuar për ftohje dhe ngrohje në kW**
    - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Vlerat COP dhe EER, të rrumbullakosura në shifrën e parë dhjetore**
    - **Teksti "EER"/"COP":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Konsumi i energjisë në orë në kWh/60 min:**
    - **Teksti "kWh/60 min":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
13. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** Shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
    - **Teksti:** shkronjat janë në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë
14. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
15. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**
    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 82 × 10,5 mm.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

5.3. Kondicionerët me një kanal ajri vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "EER" me një ventilator blu dhe tregues të valës së ajrit ;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;
V. Kapaciteti i vlerësuar në opsionin e ftohjes në kW, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VI. EER_{rated} i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VII. Konsumi i energjisë për orë në kWh në 60 minuta, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VIII. Niveli i fuqisë së zhurmës për njësinë e brendshme i shprehur në dB(A) re1 pW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

b) Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 5.4. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

5.4. Skicimi i etiketës


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
1
2
14
4
5
15
ENERG
енергия · ενεργεια
Y
UA
IE
IA
I
II
EER
A+++
A++
A+
A
B
C
D
6
7
10
11
12
13
XY,Z
kW
X,Y
EER
XY
kWh/60min*
ZYdB
8
9
16
ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ΕΝΕΡΓΕΙΑ · ENERGIJA · ENERGY · ENERGIE · ENERGI
* Минута · perc · Λεπτά
626/2011
200 mm
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
100 mm

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë : gjerësia: 82 mm, lartësia: 16 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 92,5 mm.
5. **Treguesi EER:**
   Teksti: shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
6. **Shkalla AG:**
   - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1.3 mm
   - **Ngjyrat**:
     - Klasa më e lartë: X-00-X-00
     - Klasa e dytë: 70-00-X-00
     - Klasa e tretë: 30-00-X-00
     - Klasa e katërt: 00-00-X-00
     - Klasa e pestë: 00-30-X-00
     - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
     - Klasat e fundit: 00-XX-00
   - **Teksti:**
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë.
7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
   - **Shigjeta:** gjerësia: 20 mm, lartësia: 15 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
   - **Teksti:**
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 30 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
     - Shkronjat në formatin Calibri bold 14 pt, në ngjyrë të bardhë.
8. **Energjia**
   - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
9. **"Minuta"- përkthim**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 7 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

10. **Kapaciteti i vlerësuar në kW**
    - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Vlera e EER, e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore**
    - **Teksti "EER":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Konsumi i energjisë në orë në kWh/60min**
    - **Teksti "kWh/60min":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
13. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** Shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
    - **Teksti :** Shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100% në ngjyrë të zezë;
14. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
15. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**

    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 82 × 10,5 mm.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

5.5. Kondicionerët me një kanal vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D



I
II
III
IV
V
VI
VII
VIII

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Teksti "COP", me ventilator të kuq dhe tregues të valës së ajrit;

IV. Efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë.
V. Kapaciteti i vlerësuar për ngrohje në kW i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;
VI. Koeficienti i performancës (COP), i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.
VII. Konsumi i energjisë për orë në kWh për 60 minuta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
VIII. Niveli i fuqisë së zhurmës për njësinë e brendshme i shprehur në dB(A) re1 pW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me Shtojcën VI.

b) Skicimi i etiketës është në përputhje me pikën 5.6. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

5.6. Skicimi i etiketës


5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
3
1
2
14
4
5
15
ENERG
енергия · ενεργεια
Y
UA
IE
IA
I
II
COP
A+++
7
A++
A+
A
B
C
D
6
10
XY,Z
kW
X,Y
COP
11
13
ZYdB
XY
kWh/60min*
12
8
9
16
ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ΕΝΕΡΓΕΙΑ · ENERGIJA · ENERGY · ENERGIE · ENERGI
* Минута · perc · Λεπτά
626/2011
200 mm
5 mm
5 mm
5 mm
5 mm
100 mm

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme
ii. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
iii. Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.
iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):
    1. **Kufiri i etiketës së BE-së:** shtrirja 5 pt – ngjyra: cian 100 % – kënde të rrumbullakëta: 3,5 mm.
    2. **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
    3. **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: logoja e BE-së + etiketa e energjisë : gjerësia: 82 mm, lartësia: 16 mm.
    4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt – ngjyra: cian 100 % – gjatësia: 92,5 mm.
    5. **Treguesi COP:**
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    6. **Shkalla AG:**
        - **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1,3 mm
        - **Ngjyrat**:
            - Klasa më e lartë: X-00-X-00
            - Klasa e dytë: 70-00-X-00
            - Klasa e tretë: 30-00-X-00
            - Klasa e katërt: 00-00-X-00
            - Klasa e pestë: 00-30-X-00
            - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
            - Klasat e fundit: 00-XX-00
        - **Teksti:**
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë
    7. **Klasa e efiçencës së energjisë:**
        - **Shigjeta:** gjerësia: 20 mm, lartësia: 15 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
        - **Teksti:**
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 30 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë;
            - Shkronjat në formatin Calibri bold 14 pt, në ngjyrë të bardhë
    8. **Energjia**
        - **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 8 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    9. **"Minuta"-përkthim:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri regular 7 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.

10. **Kapaciteti i vlerësuar në kW**
    - **Teksti "kW":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY,Z":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Vlera e COP e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore**
    - **Teksti "COP":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, kapitale, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "X,Y":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
12. **Konsumi i energjisë në orë në kWh/60min:**
    - **Teksti "kWh/60min":** shkronjat në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
    - **Vlera "XY":** shkronjat në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
13. **Emetimet e zhurmës**
    - **Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.
    - **Vlera:** shkronjat janë në formatin Calibri bold 22 pt, 100% në ngjyrë të zezë.
    - **Teksti:** shkronjat janë në formatin Calibri regular 14 pt, 100 % në ngjyrë të zezë
14. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
15. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**
    Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 82 × 10,5 mm.
16. **Periudha e references**
    - **Teksti:** Shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Skeda informative e produktit

1. Informacioni në skedën informative të produktit jepet sipas rendit të mëposhtëm dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që ofrohet me produktin.

   a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

   b) Identifikuesi i modelit të kondicionerit të brendshëm ose i elementëve të brendshëm dhe të jashtëm të kondicionerit

   c) Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

   ç) Nivelet e fuqisë së zhurmës brenda dhe jashtë në kushte standarde të vlerësimit, në opsionin e ftohjes dhe/ose ngrohjes

   d) Emri dhe Potenciali i Ngrohjes Globale (GWP-ja) e ftohësit të përdorur dhe një tekst standard si më poshtë:
   "Rrjedhja e fluidit ftohës kontribuon në ndryshimin e klimës. Fluidi ftohës me një Potencial të Ngrohjes Globale (GWP-ja) më të ulët, nëse çlirohet në atmosferë, kontribuon më pak në ngrohjen globale krahasuar me një fluid ftohës që ka një Potencial të Ngrohjes Globale (GWP-ja) më të lartë. Kjo pajisje përmban një lëng ftohës me një GWP të barabartë me [*xxx*]. Kjo do të thotë se nëse 1 kg i këtij fluidi ftohës çlirohet në atmosferë, ndikimi në ngrohjen globale do të ishte [*xxx*] herë më i lartë se 1 kg CO_2, gjatë një periudhe 100 vjeçare. Asnjëherë mos u përpiqni të ndërhyni vetë në qarkun e ftohësit ose të çmontoni vetë produktin, por kërkoni gjithmonë një profesionist."

2. Gjithashtu, informacioni i mëposhtëm përfshihet në skedën informative të kondicionerëve në opsionin e ftohjes, kur efiçenca deklarohet në bazë të raportit sezonal të efiçencës së energjisë (SEER) :

   a) SEER-i dhe klasa e efiçencës së energjisë së modelit (modeli i një njësie ose një kombinimi njësish) të përcaktuara në përputhje me përkufizimet dhe procedurat e testit të dhëna në Kreun II dhe Shtojcën VI për opsionin e ftohjes, si dhe në përputhje me kufijtë e klasës të përcaktuara në Shtojcën I;

   b) Konsumi orientues vjetor i energjisë elektrike Q_{CE} në kWh/a gjatë sezonit të ftohjes, i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe procedurat e testit të dhëna, përkatësisht, në Kreun II dhe Shtojcën VI. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "XYZ" kWh në vit, bazuar në rezultatet standarde të testit. Konsumi faktik i energjisë varet nga mënyra se si përdoret pajisja dhe se ku ndodhet ajo.";

   c) Ngarkesa e projektuar *Pdesignc* në kW e pajisjes në opsionin e ftohjes e përcaktuar në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI;

3. Përveç kësaj, shënimet e mëposhtme përcaktojnë informacionin që përfshihet në skedën informative të kondicionerëve për opsionin e ngrohjes, kur efiçenca deklarohet në bazë të koeficientit sezonal të performancës (SCOP) :

a) SCOP-i dhe klasa e efiçencës së energjisë së modelit, ose e kombinimit, në opsionin e ngrohjes, të përcaktuara në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI, si dhe në përputhje me kufijtë e klasës të përcaktuar në Aneksin II

b) Konsumi orientues vjetor i energjisë elektrike për një sezon mesatar ngrohjeje Q_{HE} në kWh/a, i përcaktuar përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "XYZ" kWh në vit, bazuar në rezultatet standarde të testit. Konsumi faktik i energjisë varet nga mënyra se si përdoret pajisja dhe se ku ndodhet ajo.";

c) Stinët e tjera të përcaktuara të ngrohjes, për të cilat njësia deklarohet e përshtatshme për qëllimin, me opsionet e sezoneve më të ngrohta (opsionale) ose më të ftohta (opsionale), siç përcaktohet në në Kreun II;

ç) Ngarkesa e projektuar *Pdesignh* në kW e pajisjes në opsionin e ngrohjes e përcaktuar në përputhje me me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI.

d) Kapaciteti i deklaruar dhe një tregues i kapacitetit të ngrohjes rezervë të supozuar për llogaritjen e SCOP-it në kushtet referente të projektimit.

4. Gjithashtu, shënimet e mëposhtme japin informacionin që përfshihet në skedën informative të kondicionerëve, kur efiçenca deklarohet në bazë të raportit të efiçencës së energjisë (EER_{rated}) ose koeficientit të performancës (COP_{rated}):

a) Klasa e efiçencës së energjisë së modelit, e përcaktuar në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI, si dhe kufijtë e klasës të përcaktuar në Shtojcën I;

b) Për kondicionerët me dy kanale, konsumi orientues i energjisë elektrike në orë Q_{DD} në kWh/60 minuta, i përcaktuar në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "X,Y" kWh për 60 minuta, bazuar në rezultatet standarde të testit. Konsumi faktik i energjisë varet nga mënyra se si përdoret pajisja dhe se ku ndodhet ajo.";

c) Për kondicionerët me një kanal, konsumi orientues i energjisë elektrike në orë Q_{SD} në kWh/60 minuta, i përcaktuar në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "X,Y" kWh për 60 minuta, bazuar në rezultatet standarde të testit. Konsumi faktik i energjisë varet nga mënyra se si përdoret pajisja dhe se ku ndodhet ajo.";

ç) Kapaciteti ftohës P_{rated} në kW i pajisjes i përcaktuar në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI;

d) Kapaciteti i ngrohjes P_{rated} në kW i pajisjes i përcaktuar në përputhje me përkufizimet e dhëna në Kreun II dhe procedurat e testit të dhëna në Shtojcën VI.

5. Një skedë informative mund të mbulojë disa modele pajisjesh të furnizuara nga i njëjti furnizues.
6. Informacioni i përfshirë në skedën informative mund të jepet në formën e një kopje të etiketës, me ngjyra ose bardh e zi. Kur veprohet në këtë mënyrë, atëherë jepet gjithashtu edhe informacioni i renditur në pikat 1-4, i cili nuk është shfaqur tashmë në etiketë.

SHTOJCA IV
Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(c) të kreut III përfshin :

a) Emrin dhe adresën e furnizuesit
b) Një përshkrim të përgjithshëm të modelit të pajisjes, i mjaftueshëm që ai të identifikohet qartësisht dhe lehtësisht. Kondicionerët me një kanal quhen *"kondicionerë lokalë";*
c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;
ç) Metodat e tjera të llogaritjes, standardet e matjes dhe specifikimet e përdorura, aty ku është e përshtatshme;
d) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;
dh) Parametrat teknikë për matjet, të përcaktuara në përputhje me Shtojcën VI, aty ku është e përshtatshme:
   i. Dimensionet e përgjithshme;
   ii. Specifikimin e llojit të kondicionerit;
   iii. Specifikimin nëse pajisja është projektuar vetëm për ftohje ose ngrohje, apo për të dyja;
   iv. Klasën e efiçencës së energjisë së modelit, siç përcaktohet në Shtojcën I;
   v. Raporti i efiçencës së energjisë (EER_{rated}) dhe koeficienti i performancës (COP_{rated}) për kondicionerët me një kanal dhe me dy kanale ose raporti i efiçencës së energjisë sezonale (SEER) dhe koeficienti sezonal i performancës (SCOP) për kondicionerët e tjerë;
   vi. Sezoni i ngrohjes, për të cilin pajisja është deklaruar e përshtatshme për qëllimin;
   vii. Nivelet e fuqisë së zhurmës të shprehura në dB(A) re1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;
   viii. Emrin dhe GWP-në e fluidit ftohës të përdorur
e) Rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me Shtojcën VI.

Furnizuesit mund të përfshijnë informacion shtesë në fund të listës së mësipërme.
Kur informacioni i përfshirë në dosjen e dokumentacionit teknik për një model të caktuar kondicioneri është marrë nga llogaritjet e bëra në bazë të projektimit, ose në bazë të ekstrapolimit nga pajisje të tjera të barasvlershme, ose të dyja, atëherë dokumentacioni përfshin detaje të këtyre llogaritjeve ose ekstrapolimeve, ose të dyja, dhe të testeve të ndërmarra nga furnizuesit për të verifikuar saktësinë e llogaritjeve të kryera. Informacioni përfshin gjithashtu edhe një listë të të gjitha modeleve të tjera të barasvlershme të pajisjes ku informacioni është marrë mbi të njëjtën bazë.

SHTOJCA V
Informacioni që jepet në rastet kur përdoruesi fundor nuk shikon produktin të ekspozuar

1. Informacioni i përmendur në pikën (b) të kreut IV jepet në rendin e mëposhtëm :

a) Klasa e efiçencës së energjisë së modelit siç përcaktohet në Shtojcën I;
b) Për kondicionerët, përveç atyre me një dhe dy kanale ajri:
   i. Raporti sezonal i efiçencës së energjisë (SEER) dhe/ose koeficienti sezonal i performancës (SCOP);
   ii. Ngarkesa e projektuar (në kW);
   iii. Konsumi vjetor i energjisë elektrike;
   iv. Çdo sezon ftohje dhe/ose ngrohje ("Mesatar, Më i Ftohtë, Më i Ngrohtë") kur pajisja deklarohet e përshtatshme për qëllimin;

c) Për kondicionerët me një dhe me dy kanale ajri:
   i. Raporti i efiçencës së energjisë (EER) dhe/ose koeficienti i performancës (COP);
   ii. Kapaciteti i vlerësuar (kW);
   iii. Për kondicionerët me dy kanale, konsumi orar i energjisë elektrike për ftohje dhe/ose ngrohje;
   iv. Për kondicionerët me një kanal, konsumi orar i energjisë elektrike për ftohje dhe/ose ngrohje;
ç) Nivelet e fuqisë së zhurmës të shprehura në dB(A) re1 pW, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;
d) Emri dhe GWP-ja e fluidit ftohës të përdorur

2. Kur jepen edhe informacione të tjera që përmbahen në skedën informative e produktit, ato duhet të jenë në formën dhe rendin e specifikuar në Shtojcën III.
3. Madhësia dhe formati i shkronjave në të cilat shkruhen ose paraqiten të gjitha informacionet e përmendura në këtë Shtojcë duhet të jenë të lexueshme.

SHTOJCA VI
Matjet dhe llogaritjet

1. Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të respektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, matjet dhe llogaritjet bëhen duke përdorur standarde të harmonizuara, numrat e referencës së të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të njohura, rezultatet e të cilave konsiderohen metoda që kanë siguri të lartë.
2. Përcaktimi i konsumit sezonal të energjisë, i raportit sezonal të efiçencës së energjisë (SEER) dhe i koeficientit sezonal të performancës (SCOP) merr parasysh:

a) Kushtet sezonale evropiane, të përcaktuara në Tabelën 1 të kësaj Shtojce;
b) Kushtet referente të projektimit, siç përcaktohen në Tabelën 3 të kësaj Shtojce;
c) Konsumin e energjisë elektrike për të gjitha opsionet përkatëse të funksionimit, duke përdorur periudhat kohore të përcaktuara në Tabelën 4 të kësaj Shtojce;
ç) Efektet e renies së efiçencës së energjisë të shkaktuar nga cikli i ndezje/fikjes (nëse përdoret) në varësi të llojit të kontrollit të kapacitetit të ftohjes dhe/ose ngrohjes;
d) Korrigjimet e koeficientëve sezonalë të performancës në kushtet kur ngarkesa e ngrohjes nuk mund të plotësohet nga kapaciteti i ngrohjes;
dh) Kontributin e një ngrohësi rezervë (nëse ka) në llogaritjen e efiçencës sezonale të një njësie në opsionin e ngrohjes.

3. Kur informacioni në lidhje me një model specifik, që është një kombinim i njësive të brendshme dhe të jashtme, është marrë nga llogaritja në bazë të projektimit dhe/ose ekstrapolimit nga kombinime të tjera, dokumentacioni përfshin detajet e këtyre llogaritjeve dhe/ ose ekstrapolimeve, dhe të testeve të ndërmarra për të verifikuar saktësinë e llogaritjeve të kryera (përfshirë detajet e modelit matematik të llogaritjes së performancës së kombinimeve dhe matjeve të bëra për të verifikuar këtë model).
4. Raporti i efiçencës së energjisë (EER_{rated}) dhe, kur përdoret, koeficienti i performancës (COP_{rated}) për kondicionerët me një dhe me dy kanale ajri përcaktohen sipas kushteve standarde të vlerësimit siç jepet në Tabelën 2 të kësaj Shtojce.
5. Llogaritja e konsumit të energjisë elektrike për ftohje dhe/ose ngrohje merr parasysh konsumin e energjisë elektrike të të gjitha opsioneve përkatëse të funksionimit, kur është e përshtatshme, duke përdorur periudha kohore të dhëna në Tabelën 4 të kësaj Shtojce.

Tabela 1

Numri i periudhës (j), temperatura e jashtme (Tj) në °C dhe numri i orëve sipas periudhës (hj) për sezonin e ftohjes dhe për sezonet e ngrohjes "mesatare", "më të ngrohta"dhe "më të ftohta". "db" temperatura me termometër të thatë

SEZONI I FTOHJES				SEZONI I NGROHJES				
						Mesatare	Më të ngrohtë	Më të ftohtë
j #	Tj °C	hj h		j #	T j °C	hjA h	hj W h	hjC h
	db				db			
1	17	205		1 deri në 8	- 30 deri - 23	0	0	0
2	18	227		9	– 22	0	0	1
3	19	225		10	– 21	0	0	6
4	20	225		11	– 20	0	0	13
5	21	216		12	– 19	0	0	17
6	22	215		13	– 18	0	0	19
7	23	218		14	– 17	0	0	26
8	24	197		15	– 16	0	0	39
9	25	178		16	– 15	0	0	41
10	26	158		17	– 14	0	0	35
11	27	137		18	– 13	0	0	52
12	28	109		19	– 12	0	0	37
13	29	88		20	– 11	0	0	41
14	30	63		21	– 10	1	0	43
15	31	39		22	– 9	25	0	54

16	32	31		23	-8	23	0	90
17	33	24		24	–7	24	0	125
18	34	17		25	-6	27	0	169
19	35	13		26	-5	68	0	195
20	36	9		27	-4	91	0	278
21	37	4		28	-3	89	0	306
22	38	3		29	–2	165	0	454
23	39	1		30	– 1	173	0	385
24	40	0		31	0	240	0	490
				32	1	280	0	533
				33	2	320	3	380
				34	3	357	22	228
				35	4	356	63	261
				36	5	303	63	279
				37	6	330	175	229
				38	7	326	162	269
				39	8	348	259	233
				40	9	335	360	230
				41	10	315	428	243
				42	11	215	430	191
				43	12	169	503	146
				44	13	151	444	150
				45	14	105	384	97
				46	15	74	294	61

Gjithsej		2602				4 910	3590	6446

Tabela 2

Kushtet standarde të vlerësimit, temperaturat ajrit me termometër të thatë ("temperaturat ajrit me termometër të lagësht" e treguar në kllapa)

Pajisje	**Funksioni**	**Temperatura e ajrit të brendshëm (°C)**	**Temperatura e ajrit të jashtëm (°C)**
Kondicionerët, me përjashtim të kondicionerëve me një kanal ajri	ftohje	27 (19)	35 (24)
	Ngrohje	20 (maksimumi 15)	7 (6)
Kondicionerët me një kanal	Ftohje	35 (24)	35 (24) (*1)
	Ngrohje	20 (12)	20 (12) (*1)

(*1) Në rastin e kondicionerëve me një kanal, kondensatori (avulluesi) gjatë ftohjes (ngrohjes), nuk furnizohet me ajër të jashtëm, por me ajër të brendshëm.

Tabela 3

Kushtet referente të projektimit, temperaturat ajrit me termometër të thatë ("temperaturat ajrit me termometër të lagësht" e treguar në kllapa)

Funksioni / sezoni	**Temperatura e ajrit të brendshëm (°C)**	**Temperatura e ajrit të jashtëm (°C)**	**Temperatura bivalente (°C)**	**Temperatura kufi e funksionimit (°C)**
	Kallaj	**Tdesignc/Tdesignh**	**Tbiv**	**Tol**
ftohje	27 (19)	Tdesignc = 35 (24)	na	na
ngrohje / Mesatare	20 (15)	Tdesignh = – 10 (– 11)	maksimumi 2	maksimumi – 7
ngrohje / Më të ngrohtë		Tdesignh = 2 (1)	maksimumi 7	maksimumi 2
ngrohje / Më të ftohtë		Tdesignh = – 22 (– 23)	maksimumi – 7	maksimumi – 15

Tabela 4

Orët e funksionimit sipas lloji të pajisjes dhe sipas opsionit të funksionimit që përdoret për llogaritjen e konsumit të energjisë elektrike

Lloji i pajisjes / funksionalitet i (nëse ka)		**Njësia**	**Sezoni i ngrohjes**	**Opsioni ndezur**	**Opsioni i termostatit të fikur**	**Opsioni i gatishmërisë**	**Opsioni i fikur**	**Opsioni i ngrohësit të karterit**
				Ftohje: H_{CE} Ngrohje: H_{HE}	**H_{TO}**	**H_{SB}**	**H_{OFF}**	**H_{CK}**
Kondicionerët, përveç kondicionerëve me një dhe me dy kanale ajri								
Opsioni i ftohjes, nëse pajisja ofron vetëm ftohje		h/vit		350	221	2 142	5 088	7 760
Opsionet e ftohjes dhe ngrohjes, nëse pajisja ofron të dy opsionet	Opsioni i ftohjes	h/ vit		350	221	2 142	0	2 672
	Opsioni i ngrohjes	h/ vit	Mesatar	1400	179	0	0	179
			Më i ngrohtë	1400	755	0	0	755
			Më e ftohtë	2 100	131	0	0	131
Opsioni i ngrohjes, nëse pajisja ofron vetëm ngrohje		h/vjetor	Mesatar	1400	179	0	3 672	3 851
			Më i ngrohtë	1400	755	0	4 345	4 476

		Më i ftohtë	2 100	131	0	2 189	2 944
Kondicioner me dy kanale ajri			**Ftohje: H_{CE} Ngrohje: H_{HE}**	**H_{TO}**	**H_{SB}**	**H_{OFF}**	**H_{CK}**
Opsioni i ftohjes, nëse pajisja ofron vetëm ftohje		h/60 min	1	n/a	n/a	n/a	n/a
Opsionet e ftohjes dhe të ngrohjes, nëse pajisja ofron të dy opsionet	Opsioni i ftohjes	h/60 min	1	n/a	n/a	n/a	n/a
	Opsioni i ngrohjes	h/60 min	1	n/a	n/a	n/a	n/a
Opsioni i ngrohjes, nëse pajisja ofron vetëm ngrohje		h/60 min	1	n/a	n/a	n/a	n/a
Kondicioneri me një kanal			**Ftohje: H_{CE} Ngrohje: H_{HE}**				
Opsioni i ftohjes		h/60 min	1	n/a	n/a	n/a	n/a

Opsioni i ngrohjes	h/60 min		1	n/a	n/a	n/a	n/a

SHTOJCA VII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë lidhen vetëm me verifikimin e parametrave të matur nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut dhe nuk do të përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik. Vlerat dhe klasat në etiketë ose në skedën informative të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik. Kur verifikohet përputhshmëria e një modeli produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

1) struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston një njësi të vetme.
2) Modeli përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse :
   a) vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin se vlerat korresponduese të dhëna në raportet e testimit; dhe
   b) vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën informative të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e efiçencës së energjisë nuk është më e favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara;
   c) kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në tabelën. 4
3) Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet e tjera të barasvlefshme konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.
4) Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zgjedh tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim.
5) Modeli konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 4.
6) Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet e tjera të barasvlefshme konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të dhëna në Shtojcën VI.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në tabelën 1 dhe përdor vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 6 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë. Nuk do të zbatohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 4

Tolerancat e verifikimit

Parametrat	Tolerancat e verifikimit
Raporti sezonal i efiçencës së energjisë (SEER)	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar me më shumë se 8 %.
Koeficienti sezonal i performancës (SCOP)	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar me më shumë se 8 %.
Konsumi i energjisë në opsionin fikur	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 10 %
Konsumi i energjisë në opsionin e gatishmërisë	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 10 %
Raporti i efiçencës së energjisë (EER_{rated})	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar me më shumë se 10 %.
Koeficienti i performancës (COP_{rated})	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar me më shumë se 11 %.
Niveli i fuqisë së zërit	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar me më shumë se 2 dB(A).

SHTOJCA VIII

Informacioni që jepet në rast të shitje, dhënie me qera, ose blerje me këste përmes internetit

1. Etiketa e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me kreun III (1)(ë) paraqitet në mekanizmin e shfaqjes pranë çmimit të produktit sipas afateve kohore të treguara në pikat (4), (5) dhe (6) të kreut III. Madhësia e etiketës është e tillë që të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe është proporcionale me madhësinë e specifikuar në Shtojcën II. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë përputhet me specifikimet e dhëna në pikën 3 të kësaj Shtojce. Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi imazh.
2. Imazhi që përdoret për të aksesuar etiketën në rastin e ekranit të ndërlidhur:
   a) Është një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë së produktit në etiketë;
   b) Tregon në shigjetë klasën e efiçencës së energjisë së produktit në ngjyrë të bardhë në të njëjtën madhësi fonti si ajo e përdorur për çmimin; dhe
   c) Është në një nga dy formatet e mëposhtme:



3. Në rastin e ekranit të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:
   a) Imazhi i përmendur në pikën 3 të kësaj Shtojce shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit;
   b) Imazhi lidhet me etiketën;
   c) Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, rrotullimit të mausit ose zgjerimit të ekranit me prekje mbi imazh;
   ç) Etiketa shfaqet nga një dritare e re, skedë e re, faqe e re ose nga shfaqja e ekranit të integruar;
   d) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;
   dh) Shfaqja e etiketës ndalohet me anë të një opsioni mbylljeje ose mekanizmi tjetër standard të mbylljes;
   e) Teksti alternativ për pamjen grafike, që do të paraqitet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e efiçencës së energjisë së produktit në të njëjtën madhësi shkronjash si ajo e përdorur për çmimin.

4. Skeda informative e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(f) të kreut III shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia është e tillë që skeda informative e produktit të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Skeda informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin lidhja e përdorur për të hyrë në skedën informative të

produktit tregon qartë dhe në mënyrë të lexueshme “Skeda informative e produktit”. Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, skeda informative e produktit do të shfaqet në klikimin e parë të mausit, rrotullimin e mausit ose zgjerimin e ekranit me prekje mbi link.

ANEKS NR.8

RREGULLORE

"PËR

ETIKETIMIN ENERGJETIK TË NDRIÇUESVE"

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore përcakton një kornizë për dhënien e informacionit mbi parametrat e ndriçuesve me ose pa pajisje kontrolli të integruar në to, nëpërmjet etiketimit për të lejuar përdoruesit fundorë të bëjnë një zgjedhje të informuar.

1. Kjo rregullore zbatohet për:

a) ndriçues me ose pa pajisje kontrolli të integruar në to, të cilët vendosen në treg.
b) ndriçues që përmbahen brenda pajisjeve të tjera, të cilët vendosen në treg.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për ndriçues posacërisht të testuar dhe të miratuar që operojnë:

a) në instalimet e mjekësisë radiologjike dhe bërthamore;

b) për përdorim urgjence;

c) në ose mbi institucione të mbrojtjes ushtarake ose civile, pajisje, mjete tokësore, pajisje detare ose avionë;

ç) në ose mbi mjetet motorike, rimorkiot dhe sistemet e tyre, pajisjet e këmbyeshme të tërheqjes (rimorkimit), përbërësit dhe njësitë teknike të veçanta;

d) në ose mbi makineri të lëvizshme jo-rrugore;

dh) në ose mbi pajisje të ndërrueshme (në gjendje të ndryshojë funksionin e saj) të destinuara për t'u tërhequr ose për t'u montuar dhe ngritur tërësisht nga toka, ose që nuk mund të rrotullohet rreth një boshti vertikal kur mjeti në të cilin është montuar është në përdorim në një rrugë nga automjetet;

e) në ose mbi avionë të aviacionit civil;

ë) për ndriçimin e mjeteve hekurudhore;

f) në pajisjet detare;

g) në pajisjet mjekësore dhe pajisjet mjekësore "in vitro";

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren Nr 2019/2015 e datës 11 mars 2019 që plotëson Direktivën 2017/1369/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me etiketimin e energjisë të ndriçuesve". Numri CELEX 02019R2015-20230930, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 05.12.2019, f. 68.

gj) në ekranet elektronike (p.sh. televizorë, monitorë kompjuteri, fletore, tableta, telefona celularë, libra-lexues elektronikë, konsole lojërash);

h) në aspiratorët e kuzhinave;

i) në ndriçues në produktet që funksionojnë me bateri, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në p.sh. dritat e dorës, telefonat celularë me një dritë të integruar, lodrat me ndriçues të përfshirë, llambat e tavolinës që funksionojnë vetëm me bateri, shiritat ndriçuese për çiklistët, llambat e oborreve me energji diellore;

j) në ndriçues në biçikleta dhe mjete të tjera jo motorike.

k) ndriçues për spektroskopi dhe aplikime fotometrike, si për shembull spektroskopia UV-VIS, spektroskopia molekulare, spektroskopia e përthithjes atomike, drita infra të kuqe jo-të përhapshme (NDIR), infra të kuqe me transformim të Fourierit (FTIR), analiza mjekësore, elipsometria, matja e trashësisë së shtresës, monitorimi i procesit ose monitorimi i mjedisit;

3. Kjo rregullore nuk zbatohet për ndriçues të projektuar dhe tregtuar në mënyrë specifike për përdorimin e synuar në të paktën një prej zbatimeve e mëposhtme:

a) sinjalizimi (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, sinjalizimin rrugor, hekurudhor, detar ose ajror, kontrollin e trafikut ose llambat ndriçuese të pistave të aeroportit);

b) kapja e imazhit dhe projeksioni i imazhit (përfshirë, por pa u kufizuar në, fotokopjimin, printimin (drejtpërsëdrejti ose në përpunim paraprak), litografinë, projeksionin e filmave dhe videove, holografinë);

c) ndriçues me fuqi specifike efektive ultravjollcë > 2 mW/klm dhe të destinuar për përdorim në aplikime që kërkojnë përmbajtje të lartë UV;

ç) ndriçues me një rrezatim maksimal rreth 253,7 nm dhe të destinuar në përdorim për ngordhjen e mikrobeve (shkatërrimi i ADN-së);

d) ndriçues që emetojnë 5% ose më shumë të fuqisë totale të rrezatimit në intervalin 250-800 nm në intervalin 250-315 nm dhe/ose 20% ose më shumë të fuqisë totale të rrezatimit në intervalin 250-800 nm në intervalin 315- 400 nm, dhe të destinuar për dezinfektim ose kapje të mizave;

dh) ndriçues që kanë qëllimin kryesor të emetojnë rrezatim rreth 185,1 nm dhe të destinuar për t'u përdorur për gjenerimin e ozonit;

e) ndriçues që emetojnë 40% ose më shumë të fuqisë totale të rrezatimit të intervalit 250-800 nm në intervalin 400-480 nm, dhe të destinuar për simbiozat e koraleve

zooxanthellae;

ë) ndriçues FL që lëshojnë 80% ose më shumë të fuqisë totale të rrezatimit të intervalit 250-800 nm në intervalin 250-400 nm, dhe të destinuar për rrëzitje nga dielli;

f) ndriçues HID që lëshojnë 40% ose më shumë të fuqisë totale të rrezatimit të intervalit 250-800 nm në intervalin 250-400 nm, dhe të destinuar për rrezitje nga dielli;

g) ndriçues me një efikasitet fotosinteze > 1,2 µmol/J dhe/ose që lëshojnë 25 % ose më shumë të fuqisë totale të rrezatimit në intervalin 250-800 nm në intervalin 700-800 nm dhe të destinuar për përdorim në hortikulturë;

gj) ndriçues LED ose OLED, që përputhen me përkufizimin e "veprave origjinale të artit" e punuar nga vetë artisti në një numër të kufizuar nën 10 copë;

h) ndriçues inkandeshent me kontakt me teh, tub metalik, kabllo, tela litz, fije metrike, ose ndërfaqe elektrike të personalizuar jo standarde, mbështjellës i bërë nga tuba qelqi kuarci, i projektuar posaçërisht dhe i tregtuar ekskluzivisht për industriale ose pajisje profesionale për elektrongrohje (p.sh. procesi i derdhjes me fryrje në industrinë PET, printim 3D, fotovoltaik dhe proceset e prodhimit elektronik, tharja ose ngurtësimi i ngjitësve, bojërave, bojrave ose veshjeve).

4. Për ndriçues të specifikuar në pikën 3 të kreut I , përdorimi i synuar i tyre duhet të tregohet në të gjitha format e ambalazhimit, informacionit të produktit dhe reklamës, së bashku me një tregues të qartë se ndriçuesi nuk është i destinuar për përdorim në aplikime të tjera.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Ndriçues"** është një produkt me funksion elektrik që synon të lëshojë, ose në rastin e një ndriçuesi jo-inkandeshent, i projektuar që të rregullohet për të rrezatuar dritë, ose të dyja, me të gjitha karakteristikat optike të mëposhtme :

(a) koordinatat e kromaticitetit x dhe y në diapazonin:

i. $0{,}270 < x < 0{,}530$; dhe

ii. $-2{,}3172\,x^2 + 2{,}3653\,x - 0{,}2199 < y < -2{,}3172\,x^2 + 2{,}3653\,x - 0{,}1595$;

(b) një fluks ndriçimi < 500 lumen për mm^2 të sipërfaqes së projektuar që lëshon dritë siç përcaktohet në përkufizimet për shtojcat ;

(c) një fluks ndriçues midis 60 dhe 82 000 lumen;

(ç) një indeks i interpretimit të ngjyrave (CRI) > 0;

duke përdorur inkandeshencë, fluoreshencë, shkarkim me intensitet të lartë, dioda jo organike që lëshojnë dritë (LED) ose dioda organike që lëshojnë dritë (OLED), ose kombinime të tyre si teknologji ndriçimi dhe që mund të verifikohen si ndriçues sipas procedurës së Shtojcës VII.

Ndriçuesit me natrium me presion të lartë (HPS) që nuk plotësojnë kushtin (a) konsiderohen ndriçues për qëllimet e kësaj rregulloreje.

Ndriçuesit nuk përfshijnë:

(a) Diodat LED ose çipat LED;

(b) Ambalazhet e dritave LED;

(c) produktet që përmbajnë ndriçues nga të cilat këto ndriçues mund të hiqen për verifikime;

(ç) pjesë që lëshojnë dritë të përfshira në një ndriçues, nga i cili këto pjesë nuk mund të hiqen për verifikim si ndriçues.

2. **"pajisje kontrolli"** është një ose më shumë pajisje që mund ose jo të integrohen fizikisht në një ndriçues, të destinuara për përgatitjen e rrjetit për formatin elektrik të duhur nga një ose më shumë burime specifike drite brenda kushteve kufi të përcaktuara nga siguria elektrike dhe përputhshmëria elektromagnetike. Mund të përfshijë transformimin e furnizimit dhe tensionin fillestar, kufizimin e rrymës funksionale dhe të ngrohjes paraprake, parandalimin e fillimit në të ftohtë, korrigjimin e faktorit të fuqisë dhe/ose uljen e radio-interferencës.

   Termi "pajisje kontrolli" nuk përfshin kërkesat e projektimit ekologjik në lidhje me konsumin e energjisë elektrike në kushte pa ngarkesë dhe efiçencën aktive mesatare të furnizimit me energji elektrike. Termi gjithashtu nuk përfshin pjesët e kontrollit të ndriçimit dhe pjesët jo-ndriçuese (siç përcaktohen në përkufizimet për shtojcat), edhe pse pjesë të tilla mund të integrohen fizikisht me një pajisje kontrolli ose të tregtohen së bashku si një produkt i vetëm.
   Një pajisje e furnizimit me energji elektrike dhe njëkohësisht sigurimin e të dhënave të konsumit (anglisht njihet: Power over Ethernet dhe shkurt "PoE" nga inxhinierët elektrik) nuk është një pajisje kontrolli në kuptimin e kësaj rregulloreje. "Pajisja PoE" ose "çelësi PoE" është një pajisje për furnizimin me energji elektrike dhe për trajtimin e të dhënave.

   Kjo pajisje instalohet midis rrjetit dhe pajisjeve të zyrës dhe/ose burimeve të dritës për qëllime të transferimit të të dhënave dhe furnizimit me energji elektrike;

3. **"Produkt i përbërë (kompleks)"** është një produkt që përmban një ose më shumë ndriçues, ose pajisje të veçanta kontrolli, ose të dyja. Shembuj të produkteve të përbërë janë ndriçuesit që mund të shkëputen nga pajisja që lëshon dritë për të lejuar verifikimin veçmas të tyre, pajisjet shtëpiake që përmbajnë ndriçues, mobiljet (raftet, pasqyrat, kanata me ekran) që përmbajnë ndriçues. Nëse një produkt i përbërë nuk mund të shkëputet për verifikimin e ndriçuesit dhe pajisjeve të veçanta të kontrollit, i gjithë produkti i përbërë

konsiderohet ndriçues;

4. **"dritë"** është rrezatimi elektromagnetik me një gjatësi vale në intervalin 380-780 nm;

5. **"rrjeti"** ose **"rrjetit i tensionit"** (MV) është furnizimi me energji elektrike prej 230 (± 10 %) volt të rrymës alternative në frekuencën 50 Hz;

6. **"Diodë LED"** ose **"Çip LED"** është një pjesë e vogël e materialit gjysmëpërçues që lëshon dritë, mbi të cilën është vendosur një qark funksional LED;

7. **"Paketë LED"** është një pjesë e vetme elektrike që përbëhet kryesisht nga të paktën një diodë LED. Nuk përfshin pajisje kontrolli apo pjesë të saj, kapak apo përbërës elektronikë aktivë, dhe nuk është e lidhur drejtpërdrejt me rrjetin e tensionit. Mund të përfshijë një ose më shumë nga sa vijon: elementë optikë, konvertues të dritës (fosforike), ndërlidhjet termike, mekanike dhe elektrike, ose pjesë për zgjidhjen e problemeve të shkarkimeve elektrostatike. Çdo pajisje e ngjashme që lëshon dritë që përdoret drejtpërdrejt në një ndriçues LED, konsiderohet ndriçues;

8. **"kromaticiteti"** është vetia e një stimuli ngjyrash e përcaktuar nga koordinatat e tij kromatike (x dhe y);
9. **"fluksi ndriçues"** ose **"fluksi" (Φ)**, i shprehur në lumen (lm), është sasia e ndriçimit që rrjedh nga rrezatimi (fuqia rrezatuese) duke vlerësuar rrezatimin elektromagnetik, sipas ndjeshmërisë së spektrit të syrit të njeriut. Fluksi është sasia totale e ndriçimit e emetuar nga një ndriçues në një kënd izometrik prej 4π steradianësh, në kushte (rrymë, tension, temperaturë) të specifikuara në standardet e zbatueshme. Për ndriçues që nuk zbehet pas një periudhe të shkurtër funksionimi fluksi është sasia fillestare e ndriçimit e emetuar, me përjashtim të rasteve kur specifikohet qartë që synohet që të jetë një fluks në një gjendje të zbehtë ose fluksi pritet pas një periudhe të caktuar funksionimi. Për ndriçues që mund të rregullohen për të lëshuar spektra të ndryshëm drite dhe/ose intensitete të ndryshme maksimale të dritës, fluksi është sasia e ndriçimit e emetuar në "cilësimet e kontrollit të referencave" siç përcaktohet në përkufizimet për shtojcat;

10. **"indeksi i paraqitjes së ngjyrave" (CRI)** është njësi matëse e efektit të një ndriçuesi në ngjyrën e paraqitur të objektit, përmes një krahasimi të vetëdijshëm ose jo me ngjyrat e paraqitura nën ndriçuesin e referencës, dhe është Ra-ja mesatare e paraqitjes së ngjyrave për 8 provat e para të ngjyrave (R1-R8) të përcaktuara në standarde;

11. **"inkandeshencë"** është proçesi i prodhimit të dritës nga nxehtësia. Në ndriçuesit inkandeshentë, drita prodhohet zakonisht nëpërmjet një përçuesi fije ("filament") i cili nxehet nga kalimi rrymes elektrike;

12. **"ndriçues halogjen"** është një ndriçues inkandeshent me një përcjellës në formë filli të bërë nga tungsteni, i rrethuar nga një gaz që përmban halogjene ose përbërës halogjen;

13. **"fluoreshencë"** ose **"ndriçues fluoreshent"** (FL) është një proçes ose një ndriçues që përdor një shkarkim elektrik në gjendjen e gaztë të një lënde të ngjashme me zhivën me presion të ulët, në të cilin pjesa më e madhe e dritës emetohet nga një ose më shumë shtresa fosforesh të nxitura nga shkarkimi i rrezatimit ultravjollcë. Ndriçues fluoreshente mund të kenë një ("me një kapak") ose dy ("kapakë të dyfishtë") lidhje ("tapa") për furnizimin e tyre me energji elektrike. Për qëllime të kësaj rregulloreje, ndriçuesit me

induksion magnetik konsiderohen gjithashtu si ndriçues fluoreshent;

14. **"Shkarkim me intensitet të lartë"** (HID) është një shkarkim elektrik në një masë të gaztë në të cilin harku që prodhon dritë stabilizohet nga temperatura e murit të llambës dhe dhoma e harkut ka një ngarkesë të murit të llambës më të madhe se 3 vat për centimetër katror. Ndriçuesit HID kufizohen në halide metalike, natrium me trysni të lartë dhe avuj të llojit të zhivës.

15. **"Shkarkim elektrik në gaz"** është proçesi i prodhimit të dritës, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një shkarkesë elektrike përmes një mase gazi, plazme, avujsh metalikë, ose përzierje gazesh dhe avujsh;

16. **"Diodë inorganike që lëshon dritë"** (LED) është teknologjia në të cilën drita prodhohet nga një pajisje në gjendje të ngurtë që ka brenda saj një nyje të llojit p-n me material jo organik. Pika e bashkimit (nyja) lëshon rrezatim optik kur ngacmohet nga një rrymë elektrike;

17. **"Diodë organike që lëshon dritë"** (OLED) është teknologjia në të cilën drita prodhohet nga një pajisje në gjendje të ngurtë që ka brenda saj një nyje të llojit p-n me material organik. Pika e bashkimit (nyja) lëshon rrezatim optik kur ngacmohet nga një rrymë elektrike;

18. **"Burim drite natriumi me presion të lartë"** (HPS) është një burim drite i krijuar nga shkarkesa me intensitet të lartë, në të cilin drita prodhohet kryesisht nga rrezatimi i avullit të natriumit që vepron me një trysni të pjesshme të rendit prej 10 kilo paskal. Burimet e dritës HPS mund të kenë një ("me një skaj") ose dy ("me dy skaje") lidhëse në furnizimin e tyre me energji elektrike;

19. **"pika e shitjes"** është vendndodhja fizike ku produkti shfaqet ose u ofrohet klientëve për shitje, qira ose për pagesë me këste;

20. **"ndriçues nga rrjeti elektrik"** (MLS) është një ndriçues që mund të përdoret drejtpërdrejt në rrjetin e furnizimit me energji elektrike. Ndriçuesit që funksionojnë drejtpërdrejt në rrjet, dhe gjithashtu mund të funksionojnë në mënyrë indirekte në rrjet duke përdorur një pajisje kontrolli të veçantë, do të konsiderohen si ndriçues të rrjetit;
Si përjashtim, nëse reklama vizuale, materiali promovues teknik ose shitja në distancë me bazë letre është e printuar në pikturë njëngjyrëshe, shigjeta mund të jetë pikturë njëngjyrëshe në atë reklamë vizuale, material promovues teknik ose shitje në distancë me bazë letre.

Figura 2

Shigjeta me ngjyra/njëngjyrëshe majtas/djathtas, me gamën e klasave të efiçencës së energjisë të treguar



5. Shitja në distancë e bazuar në telemarketing duhet të informojë në mënyrë specifike klientin për klasën e efiçencës së energjisë të produktit dhe për gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, dhe se klienti mund të ketë qasje në etiketën e plotë dhe skedën e informacionit të produktit përmes një faqe interneti me akses falas, ose duke kërkuar një kopje të printuar;
6. Për të gjitha situatat e përmendura në pikat 1 deri në 3 dhe 5, duhet të jetë e mundur që klienti të ketë akses në etiketën dhe skedën e informacionit të produktit nëpërmjet një lidhjeje në faqen e internetit të bazës së të dhënave të produktit ose të kërkojë një kopje të printuar.

SHTOJCA VI

Informacioni që jepet në rastin e shitjes në distancë në internet

1. Etiketa e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnitorët në përputhje me pikën 1(e) të kreut 3 duhet të shfaqet në mekanizmin e ekspozimit, në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që etiketa të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe duhet të jetë proporcionale me madhësinë e specifikuar për etiketën standarde në Shtojcën II.

   Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran me paraqitje të integruar, në këtë rast imazhi i përdorur për të shfaqur etiketën duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 3 të kësaj shtojce. Nëse aplikohet ekrani me paraqitje të integruar, etiketa do të shfaqet pas klikimit të parë të mousit, të rrotullimin e mausit ose pas zgjerimit të ekranit me prekje në imazh.

2. Imazhi i përdorur për të shfaqur etiketën në rastin e ekranit me paraqitje të integruar, siç tregohet në Figurën 3, duhet:

   a) të jetë një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë të produktit në etiketë;
   b) të tregohet klasa e efiçencës energjetike të produktit në shigjetë me ngjyrë 100% të bardhë, me germa Calibri Bold dhe me një madhësi fonti ekuivalent me atë të çmimit;
   c) të ketë gamën e klasave të disponueshme të efiçencës së energjisë në 100% të zezë; dhe,
   ç) të ketë një nga dy formatet e mëposhtme dhe madhësia e tij duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës energjetike duhet të vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi të dukshëm në ngjyrë të zezë 100% të vendosur rreth shigjetës dhe germës së klasës së efiçencës së energjisë:

Figura 3

Shigjeta me ngjyrë majtas/djathtas, me gamën e klasave të efiçencës së energjisë të treguar



3. Në rastin e ekranit me paraqitje të integruar, sekuenca e shfaqjes së etiketës do të jetë si më poshtë:

   (a) imazhi i përmendur në pikën 2 të kësaj shtojce do të shfaqet në mekanizmin e ekspozimit në afërsi të çmimit të produktit;

   (b) imazhi duhet të ketë një link që çon te etiketa e përcaktuar në Shtojcën II;

   (c) etiketa do të shfaqet pas një klikimi të mausit, rrotullimit të mausit ose zgjerimit të prekshëm të ekranit në imazh;

(ç) etiketa do të shfaqet me një dritare pop-up, skedë e re, faqe e re ose ekran i vendosur mbi pajisjen;

(d) për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, do të zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;

(dh) etiketa do të reshtë së shfaquri me anë të opsionit të mbylljes ose mekanizmit tjetër standard të mbylljes

(e) në rast të dështimit të shfaqjes së etiketës, teksti zëvendësues që shfaqet në ekran është klasa e efiçencës së energjisë së produktit në një madhësi fonti të barabartë me atë të çmimit

4. Skeda informative e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(ë) të kreut III duhet të shfaqet në mekanizmin e ekspozimit në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që skeda informative e produktit të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Skeda informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të vendosur mbi produkt ose duke iu referuar bazës së të dhënave të produktit, rast në të cilin lidhja e përdorur për të hyrë në skedën e informacionit të produktit duhet të tregojë qartë dhe në mënyrë të lexueshme "Skeda informative e produktit". Nëse përdoret ekrani i vendosur mbi pajisjen, skeda informative e produktit do të shfaqet në klikimin e parë të mausit, rrotullimin e mausit ose zgjerimin e ekranit me prekje mbi link.

SHTOJCA VII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë kanë të bëjnë vetëm me verifikimin e parametrave të matur nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut. Këto toleranca nuk do të përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik. Vlerat dhe klasat në etiketë ose në skedën informative të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik.

Kur verifikohet përputhshmëria e një modeli produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut verifikon një njësi të vetme të modelit për pikat 2(a) dhe 2(b) të kësaj shtojce.

   Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut verifikon 10 artikuj të modelit të ndriçuesit për pikën 2(c) të kësaj shtojce. Tolerancat e verifikimit janë përcaktuar në Tabelën 6 të kësaj Shtojce.

2. Modeli do të konsiderohet se përputhet me kërkesat e aplikueshme nëse:

   a) vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik sipas pikës 3 të nenit 3 të ligjit 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji (vlerat e deklaruara), dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit;

   b) vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën informative të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e efiçencës së energjisë nuk është më e favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara;

   c) kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston njësitë e modelit, vlerat e përcaktuara përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në tabelën 9, ku "vlera e përcaktuar" është mesatarja aritmetike mbi njësitë e testuara të vlerave të matura për një parametër të caktuar, ose mesatarja aritmetike e vlerave të parametrave të llogaritur nga vlerat e tjera të matura.

3. Nëse rezultatet e përmendura në pikën 2 (a), (b) ose (c) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet që janë renditur si modele ekuivalente në dokumentacionin teknik të furnitorit, do të konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të zbatojë vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në tabelën 9 dhe do të përdorin vetëm procedurën e përshkruar në këtë shtojcë. Për parametrat në Tabelën 9, nuk do të zbatohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 9

Tolerancat e verifikimit

Parametri	Madhësia e kampionit	Tolerancat e verifikimit
Fuqia në modalitet ndezur (ON) me ngarkesë të plotë P_{on} [W]:		
Pon ≤ 2W	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 0,20 W.
2W < P_{on} ≤ 5W	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 10 %.
5W < P_{on} ≤ 25W	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 5 %.
25W < P_{on} ≤ 100W	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 5 %.
100W < P_{on}	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 2,5 %.
Faktori i zhvendosjes [0-1]	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar minus 0,1 njësi.
Fluksi i dobishëm ndriçues Φ_{use} [lm]	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar minus 10 %.
Fuqia e gatishmërisë (standby) P_{sb} dhe fuqia e gatishmërisë (standby) në rrjet P_{net} [W]	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 0,10 W.
CRI dhe R9 [0-100]	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar për më shumë se 2,0 njësi.
Dridhja [P_{st} LM] dhe efekti stroboskopik	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën

[SVM]		e deklaruar për më shumë se 10 %.
Konsistenca e ngjyrave [hapat e elipseve të MacAdam]	10	Numri i caktuar i hapave nuk duhet të kalojë numrin e deklaruar të hapave. Qendra e elipsës MacAdam do të jetë qendra e deklaruar nga furnizuesi me një tolerancë prej 0,005 njësi.
Këndi i rrezes (gradë)	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të devijojë nga vlera e deklaruar për më shumë se 25%.
Efiçenca totale e rrjetit ηTM [lm/W]	10	Vlera e përcaktuar (koeficienti) nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar minus 5 %.
Faktori i mirëmbajtjes së lumenit (për LED dhe OLED)	10	XLMF% e përcaktuar e kampionit nuk duhet të jetë më e vogël se XLMF, MIN%
Faktori i mbijetesës (për LED dhe OLED)	10	Të paktën 9 ndriçues të mostrës së provës duhet të jenë funksionale pas përfundimit të testit të qëndrueshmërisë
Faktori i mirëmbajtjes së lumenit (për FL dhe HID)	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se 90 % e vlerës së deklaruar.
Faktori i mbijetesës (për FL dhe HID)	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar.
Pastërtia e ngacmimit [%]	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar minus 5 %.
Temperatura e ndërlidhur e ngjyrave [K]	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të devijojë nga vlera e deklaruar për më shumë se 10 %.
Intensiteti i pikut të dritës [cd]	10	Vlera e përcaktuar nuk duhet të devijojë nga vlera e deklaruar për më shumë se 25%.

Për ndriçuesit me gjeometri lineare që janë të shkallëzueshme, por me gjatësi shumë të gjatë, siç janë shiritat ose vargjet LED, testimi i verifikimit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut do të marrë në konsideratë një gjatësi prej 50 cm, ose, nëse ndriçuesi nuk është i shkallëzueshëm atje, vlerën më të afërt deri në 50 cm. Furnizuesi i ndriçuesit duhet të tregojë se cila pajisje kontrolli është e përshtatshme për këtë gjatësi.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, nëse një produkt rezulton ndriçues, pas verifikimit, krahason vlerat e matura për koordinatat e kromaticitetit (x dhe y), fluksin e dritës, densitetin e fluksit të dritës dhe indeksin e paraqitjes së ngjyrës drejtpërdrejt me vlerat kufi të përcaktuara në përkufizimin e ndriçuesit kreu II (a) të kësaj rregulloreje, pa aplikuar asnjë tolerancë. Nëse ndonjë nga 10 njësitë në kampion i plotëson kushtet për të qenë ndriçues, modeli i produktit do të konsiderohet si një ndriçues.

Ndriçuesit që lejojnë përdoruesin fundor të kontrollojë, manualisht ose automatikisht, drejtpërdrejt ose në distancë, intensitetin e ndriçimit, ngjyrën, temperaturën e ngjyrave të ndërlidhura, spektrin dhe/ose këndin e rrezes së dritës së emetuar do të vlerësohen duke përdorur cilësimet e kontrollit të referencës.

ANEKS NR.9

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN E NJËSIVE TË VENTILIMIT TË BANESAVE"[1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore përcakton një kornizë për dhënien e informacionit mbi parametrat e njësive të ventilimit të banesave, nëpërmjet etiketimit të energjisë.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për njësitë e ventilimit të banesave që:
   a) funksionojnë vetëm në një drejtim (shkarkim ose furnizim) me fuqi elektrike në hyrje më të vogël se 30 W;
   b) specifikohet që operojnë ekskluzivisht në një atmosferë potencialisht shpërthyese siç përcaktohet në Vendimin Nr. 1066 datë 12.12.2015;
   c) specifikohet që funksionojnë ekskluzivisht për përdorim emergjent, për periudha të shkurtra kohore, dhe që përmbushin kërkesat bazë për punimet e ndërtimit në lidhje me sigurinë në rast zjarri.
   ç) specifikohet që funksionojnë ekskluzivisht:
      i. kur temperaturat e funksionimit të ajrit që lëviz tejkalojnë 100 °C;
      ii. kur temperatura në ambientin e funksionimit të motorit që vë në punë ventilatorin, nëse ndodhet jashtë rrymës së ajrit, tejkalon 65 °C;
      iii. kur temperatura e ajrit që lëviz ose temperatura në ambientin e funksionimit të motorit, nëse ndodhet jashtë rrymës së ajrit, është më e ulët se – 40 °C;
      iv. kur voltazhi i furnizimit kalon 1 000 V për rrymën e ndryshueshme (AC) ose 1 500 V për rrymën e vazhduar (DC);
      v. në mjedise toksike, shumë korrozive, që marrin flakë ose në mjedise me substanca gërryese;
   d) përmbajnë një shkëmbyes nxehtësie për rikuperimin e nxehtësisë, dhe një pompë nxehtësie që mundëson transmetimin e nxehtësisë shtesë përtej nxehtësisë së transmetuar nga sistemi I rikuperimit të nxehtësisë, përveç transmetimit të nxehtësisë për mbrojtjen nga ngrirja ose për shkrirjen e pajisjes;
   dh) Janë klasifikuar si aspiratorë për përdorim shtëpiak që mbulohen nga një rregullore tjetër sipas dispozitave të ligjit 52/2024;

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 1254/2014 e Komisionit, datë 11 korrik 2014, për plotësimin e Direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të ventilatorëve për banesa". Numri CELEX 02014R1254, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 337, datë 25.11.2014, f. 27.

1. **"Njësi ventilimi (NJV)"** është një pajisje që punon me energji elektrike e pajisur me, të paktën, një volan, një motor dhe një mbështjellje, synimi i të cilës është të zëvendësojë ajrin e përdorur me ajrin e jashtëm në një ndërtesë ose në një pjesë të një ndërtese;
2. **"Njësi e ventilimit të banesave (NJVB)"** është një njësi ventilimi ku :
   a) Prurja maksimale nuk kalon 250 m^3/orë;
   b) Prurja maksimale është ndërmjet 250 dhe 1 000 m^3/h dhe prodhuesi deklaron se përdorimi i synuar është ekskluzivisht për ventilimin e banesave;
3. **"Prurja maksimale"** është vlera maksimale e deklaruar e prurjes së ajrit të një njësie ventilimi që mund të arrihet me kontrolle të integruara ose të bashkëfurnizuara veçmas në kushtet standarde të ajrit (temperature 20 °C) dhe (presioni 101 325 Pa), ku njësia është instaluar e plotë (p.sh., duke përfshirë filtrat) dhe sipas udhëzimeve të prodhuesit, për NJVB-të me kanale ajri, prurja maksimale i referohet prurjes së ajrit në kushtet e diferencës së presionit të jashtëm statik prej 100 Pa, dhe për NJVB -të pa kanale ajri i referohet prurjes së ajrit në diferencën më të ulët të presionit total të arritshëm që zgjidhet nga një grup vlerash prej 10 (minimumi)-20-50-100-150-200-250 Pa, cilado qoftë e barabartë ose pak më e vogël se vlera e matur e diferencës së presionit;
4. **"Njësi ventilimi me një drejtim"** është një njësi ventilimi që prodhon një rrjedhë ajri vetëm në një drejtim, ose nga ambientet e brendshme në drejtim të ambientit të jashtëm (shkarkimi) ose nga jashtë në ambientet e brendshme (furnizimi), ku rrjedha e ajrit e prodhuar mekanikisht balancohet nga furnizimi ose shkarkimi natyral i ajrit;
5. **"Njësi ventilimi me dy drejtime"** është një njësi ventilimi që prodhon një rrjedhë ajri midis ambienteve të brendshme dhe të jashtme dhe që është e pajisur me ventilatorë të shkarkimit dhe furnizimit;
6. **"Modeli i barasvlershëm i njësisë së ventilimit"** është një njësi ventilimi me të njëjtat karakteristika teknike sipas kërkesave që zbatohen për informacionin e produktit, por e vendosur në treg si një model i ndryshëm i njësisë së ventilimit nga i njëjti prodhues, përfaqësues i autorizuar ose importues;

7. **"Konsumi specifik i energjisë (SEC)"** (i shprehur në kWh /(m^2 .a)) është koeficienti që shërben për të shprehur energjinë e konsumuar për ventilim për m^2 të sipërfaqes me dysheme të ngrohtë të një banese ose ndërtese, e llogaritur për NJVB-në sipas Shtojcës VII;
8. **"Niveli i fuqisë së zhurmës (L_{WA})"** është niveli mesatar vjetor i fuqisë së zhurmës së çliruar nga ventilatori, i shprehur në decibel (dB) duke iu referuar fuqisë së zhurmës prej një pikovat (1 pW), të transmetuar nga ajri në rrjedhën e ajrit referente;
9. **"Motor me disa shpejtësi"** është një motor ventilatori që mund të funksionojë me tre ose më shumë shpejtësi fikse plus opsionin me shpejtësi zero ("fikur");
10. **"Motor me shpejtësi të ndryshueshme"** është një kontrollues elektronik, i integruar ose që funksionon si një sistem i vetëm ose si një sistem shpërndarje i veçantë me

motorin dhe ventilatorin, i cili përshtat vazhdimisht fuqinë elektrike që hyn në motor për të kontrolluar shpejtësinë e rrymës së ajrit;

11. **"Sistemi i rikuperimit të nxehtësisë"** është pjesa e një njësie ventilimi dydrejtimëshe e pajisur me një shkëmbyes nxehtësie të projektuar për të transmetuar nxehtësinë midis dy rrymave të ajrit, pa pasur një përzierje fizike të tyre;
12. **"Eficenca termike e një sistemi të rikuperimit të nxehtësisë së banesave (η_t)"** është raporti ndërmjet rritjes së temperaturës së ajrit të furnizuar dhe uljes së temperaturës së ajrit të shkarkuar, të dyja në lidhje me temperaturën e jashtme, të matur në kushtet e thata të sistemit të rikuperimit të nxehtësisë, dhe kushtet standarde të ajrit, me prurje të balancuar në një shpejtësi referente, me një ndryshim të temperaturës midis ambientit brenda dhe jashtë prej 13 K, pa korrigjim të rritjes së nxehtësisë nga motorët e ventilatorit;
13. **"Norma e rrjedhjes së brendshme"** është pjesa e ajrit të nxjerrë që ndodhet në ajrin e furnizimit të njësive të ventilimit me sistem të rikuperimit të nxehtësisë si rezultat i rrjedhjes që ndodh ndërmjet rrymave të ajrit të shkarkimit dhe të furnizimit brenda shkëmbyesit të nxehtësisë kur njësia operon me prurje ajri në kushtet e referencës, të matur në kanalet e ajrit; testi kryhet në presion 100 Pa;
14. **"Rikthimi"** është përqindja e ajrit të shkarkimit që kthehet në ajrin e furnizimit të shkëmbyesit rigjenerues të nxehtësisë sipas prurjes referente;
15. **"Norma e rrjedhjes së jashtme"** është pjesa e prurjes referente të ajrit që del nga mbështjellja e një njësie kur ajo i nënshtrohet një testi presioni, testi kryhet në presion 250 Pa si për nën presion ashtu edhe për mbi presion;
16. **"Përzierje"** është ri-qarkullimi i menjëhershëm ose krijimi i qarkut të shkurtër të rrymave të ajrit midis portave të shkarkimit dhe të furnizimit në terminalet e brendshme dhe të jashtme, në mënyrë që ato të mos kontribuojnë në ventilimin efektiv të një hapësire ndërtese, kur njësia funksionon sipas prurjes referente të ajrit;
17. **"Norma e përzierjes"** është pjesa e rrymës së shkarkimit të ajrit, si pjesë e vëllimit total referent të ajrit, që qarkullon midis portave të shkarkimit dhe të furnizimit në terminalet e brendshme dhe të jashtme, kështu që nuk kontribuon në ventilimin efektiv të një hapësire ndërtese, kur njësia funksionon në prurjen referente (e matur në 1 m distancë nga kanali i brendshëm i furnizimit me ajër), pa normën e rrjedhjes së brendshme;
18. **"Energjia elektrike hyrëse efektive"** (e shprehur në W) është energjia elektrike hyrëse në prurjen referente të ajrit dhe diferencën e presionit total të jashtëm përkatës dhe përfshin kërkesën e energjisë elektrike për ventilatorët, kontrollet (përfshirë telekomandat) dhe pompën e nxehtësisë (nëse është e integruar);
19. **"Energjia elektrike hyrëse specifike (SPI)"** (e shprehur në W/(m^3/h)) është raporti ndërmjet energjisë elektrike efektive (në W) dhe prurjes referente (në m^3/h);
20. **"Diagrami prurje/presion"** është një grup kurbash të prurjes (boshti horizontal) dhe të diferencës së presionit të një njësie ventilimi për banesa me një drejtim ose ana e furnizimit e një njësie ventilimi për banesa me dy drejtime, ku secila kurbë përfaqëson një shpejtësi ventilatori me, të paktën, tetë pika testimi në distance të barabartë ndërmjet tyre ndërkohë që numri i kurbave përcaktohet nga numri i opsioneve të

shpejtësisë së ventilatorit (një, dy ose tre), ose në rastin e një ventilatori me shpejtësi të ndryshueshme, përfshin një kurbë minimale, maksimale dhe një kurbë të ndërmjetme të përshtatshme afër vëllimit të ajrit dhe diferencës së presionit referente për testimin e energjisë elektrike hyrëse specifike;

21. **"Prurja referente"** (e shprehur në m^3/s) është vlera e abshisës e një pike në një kurbë të diagramit prurje/presion, e cila është e mbivendosur ose me distancën më të afërt nga një pike referimi në të paktën 70 % të prurjes maksimale dhe presion 50 Pa për njësitë me kanale ajri dhe në një presion minimal për njësitë pa kanale ajri. Për njësitë e ventilimit me dy drejtime, prurja e ajrit referente aplikohet në daljen e furnizimit me ajër;
22. **"Faktori i kontrollit" (** *CTRL* është një faktor korrigjimi për llogaritjen e konsumit specifik të energjisë (SEC) në varësi të llojit të kontrollit që është pjesë e njësisë së ventilimit, sipas përshkrimit të dhënë në Tabelën 1 të Shtojcës VII;
23. **"Parametër kontrolli"** është një parametër i matshëm ose grup parametrash të matshëm që supozohet se janë përfaqësues të kërkesës për ventilim, p.sh., niveli i lagështisë relative, dioksidi i karbonit (CO2), komponimet organike volative (VOC) ose gazrat e tjerë, zbulimi i pranisë, lëvizjes ose i okupimit nga nxehtësia e trupit me rreze infra të kuqe ose nga reflektimi i valëve ultrasonike, sinjaleve elektrike si pasojë e përdorimit të dritave ose pajisjeve nga ana e njeriut;
24. **"Kontroll manual"** është çdo lloj kontrolli që nuk përdor kontrollin e kërkesës;
25. **"Kontroll sipas kërkesës"** është një pajisje ose grup pajisjesh, të integruara ose si një njësi e veçantë, që mat një parametër kontrolli dhe përdor rezultatin për të rregulluar automatikisht prurjen e ajrit të njësisë dhe/ose prurjen e ajrit të kanaleve;
26. **"Kontroll i orës"** është një ndërfaqe njerëzore me programim kohor (e kontrolluar sipas orëve) që shërben për të kontrolluar shpejtësinë/prurjen e ventilatorit të njësisë së ventilimit, që ka cilësime manuale të shtatë ditëve të javës për prurjen e rregullueshme për dy periudha kohore të programuara, d.m.th., periudha në të cilat zbatohet një prurje e reduktuar ose nuk zbatohet fare;

27. **"Ventilim i kontrolluar sipas kërkesës (DCV)"** është një njësi ventilimi që përdor kontroll sipas kërkesës;
28. **"Njësi me kanale ajri"** është një njësi ventilimi e synuar për të ajrosur një ose më shumë dhoma ose një hapësirë të mbyllur në një ndërtesë nëpërmjet përdorimit të kanaleve të ajrit, të destinuara për t'u pajisur me bashkuese kanalesh;
29. **"Njësi pa kanale ajri"** është një njësi ventilimi për një dhomë të vetme, e synuar për të ajrosur një dhomë të vetme ose hapësirë të mbyllur në një ndërtesë, dhe që nuk është e destinuar të montohet me kanale ajri;
30. **"Kontrolli qëndror i kërkesës"** është kontrolli në varësi të kërkesës së një njësie ventilimi me kanale ajri që rregullon vazhdimisht shpejtësinë dhe prurjen e ventilatorit bazuar në një sensor për të gjithë ndërtesën e ajrosur ose për një pjesë të ndërtesës në nivel qëndror;
31. **"Kontrolli lokal i kërkesës"** është kontrolli në varësi të kërkesës për një njësi ventilimi që rregullon vazhdimisht shpejtësinë dhe prurjen e ventilatorit bazuar në më

shumë se një sensor për një njësi ventilimi me kanale ajri, ose një sensor për një njësi ventilimi pa kanale ajri;

32. **"Presion statik (p_{sf})"** është diferenca midis presionit total dhe presionit dinamik të ventilatorit;
33. **"Presioni total (p_f)"** është diferenca midis presionit të stagnimit në daljen e ventilatorit dhe atij në hyrjen e ventilatorit;
34. **"Presion stagnimi"** është presioni i matur në një pikë të një gazi që rrjedh nëse ai do të vihej në qetësi me anë të një procesi izoentropik;
35. **"Presion dinamik"** është presioni i llogaritur bazuar në prurjen dhe dendësinë mesatare të gazit në dalje dhe në sipërfaqen e daljes së njësisë;
36. **"Shkëmbyes rikuperues i nxehtësisë"** është shkëmbyesi i nxehtësisë i cili transferon energjinë termike nga një rrymë ajri në tjetrën pa pjesë lëvizëse, si shkëmbyes nxehtësie me pllakë, ose shkëmbyes nxehtësie me kanale me rryma ajri paralele, të kryqëzuara ose me drejtim të kundërt, ose një kombinim i këtyre, ose shkëmbyes nxehtësie me pllaka ose kanale me difuzion avullimi.
37. **"Shkëmbyes rigjenerues i nxehtësisë"** është shkëmbyesi rrotullues i nxehtësisë që përfshin një rrotë rrotulluese për qëllimin e transmetimit të energjisë termike nga një rrymë ajri në tjetrën, duke përfshirë materialin që lejon transferimin e nxehtësisë latente, një mekanizëm ndezjeje, një mbështjellje ose kornizë dhe izoluesit për të reduktuar tejkalimin dhe rrjedhjen e ajrit nga një rrymë në një tjetër; shkëmbyes të tillë të nxehtësisë kanë norma të ndryshme të rikuperimit të lagështirës në varësi të materialit të përdorur;
38. "**Ndjeshmëria e rrymës së ajrit ndaj variacioneve të presionit"** të një NJVB pa kanale ajri është raporti midis devijimit maksimal të prurjes maksimale të NJVB në presion + 20 Pa dhe atij në presion – 20 Pa diferencë presioni total të jashtëm;
39. **"Ngjeshja e ajrit të brendshëm/të jashtëm"** të një NJVB -je pa kanal është prurja (e shprehur në m^3/h) midis ambienteve të brendshme dhe të jashtme kur ventilatori/ventilatorët është/janë të fikur.

40. **"Mekanizmi i shfaqjes"** është çdo ekran, duke përfshirë ekranin me prekje, ose teknologji të tjera pamore që përdoren për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;
41. **"Ekran i ndërlidhur"** është ndërfaqja pamore ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrotullim të mausit ose me zgjerimin në ekranin me prekje të një imazhi ose grupi tjetër të dhënash;
42. **"Ekran me prekje"** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si p.sh., ai i një kompjuteri tablet, kompjuteri me ekran me prekje ose i një telefoni inteligjent;
43. **"Tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një pamjeje grafike, që bën të mundur që informacioni të paraqitet në formë jo grafike kur pajisjet e shfaqes nuk mund të paraqesin pamjen grafike ose që shërben si një ndihmë për aksesueshmërinë, siç është hyrja në aplikacionet e sintezës së zërit.

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit e njësive të ventilimit të banesave sigurojnë që:
   a) çdo njësi ventilimi e banesave, pajiset me një etiketë që të jetë e printuar dhe ngjitur mbi ambalazh, në formatin dhe me përmbajtje informacioni sipas përcaktimeve të Shtojcës II. Një etiketë elektronike, në formatin dhe me përmbajtje informacioni sipas përcaktimeve të Shtojcës II, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model të njësive të ventilimit të banesave;
   b) çdo njësi ventilimi e banesave, pajiset me një skedë informative të produktit që të jetë e printuar dhe ngjitur mbi ambalazh, sipas përcaktimeve të Shtojcës III.
   c) një skedë informative e produktit, u vihet në dispozicion tregtarëve, në format elektronik dhe me akses të lirë në faqet e internetit, për çdo model njësie të ventilimit të banesave, ashtu siç përcaktohet në Shtojcën III;
   ç) dokumentacioni teknik, ashtu siç përcaktohet në shtojcën IV, vihet në dispozicion në rast kërkese nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut;
   d) udhëzimet e përdorimit të jenë të disponueshme;
   dh) çdo reklamë për një model specifik njësie të ventilimit të banesave, e cila publikon informacione të lidhura me energjinë ose çmimin përfshin gjithashtu klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli;
   e) çdo material teknik reklamimi në lidhje me një model specifik njësie të ventilimit të banesave, që përshkruan parametrat e tij specifik teknik, përfshin gjithashtu klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli ;
2. Njësitë e ventilimit të banesave të vendosura në treg pajisen me një etiketë në formatin e përcaktuar në pikën 1 të Shtojcës II nëse janë njësi ventilimi me një drejtim, dhe me një etiketë në formatin e përcaktuar në pikën 2 të Shtojcës II nëse janë njësi ventilimi me dy drejtime.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

Tregtarët sigurojnë që:
   a) çdo njësi e ventilimit të banesave e paraqitur në pikën e shitjes, përmban etiketën e dhënë nga furnizuesi në përputhje me pikën 1/a të Kreut III, me etiketën që shfaqet në anën e jashtme të pjesës së përparme ose të sipërme të pajisjes në mënyrë që të jetë qartësisht e dukshme;
   b) kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, ventilatorët e ofruar për shitje, me qira, ose për blerje me këste, siç specifikohet në nenin 6 të ligjit nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" shiten me informacionin e dhënë nga furnizuesit sipas Shtojcës V të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, rast në të cilin zbatohen dispozitat e Shtojcës VI;
   c) çdo reklamë në lidhje me një model specifik të njësisë së ventilimit të banesave përmban një referencë të klasës së efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin;

ç) çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik që përshkruan parametrat teknikë të njësisë së ventilimit të banesave përfshin klasën e efiçencës së energjisë së modelit dhe udhëzimet për përdorim të ofruara nga furnizuesi.

V. METODAT MATJES DHE LLOGARITJES

Për qëllim të informacionit që jepet në përputhje me krerët III dhe IV, klasa specifike e konsumit të energjisë përcaktohet në përputhje me tabelën e dhënë në Shtojcën I. Konsumi specifik i energjisë, konsumi vjetor i energjisë elektrike, kursimi vjetor për ngrohje, prurja maksimale dhe niveli i fuqisë së zhurmës, përcaktohen në përputhje me metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën VII, dhe marrin parasysh metodat e njohura moderne të matjes dhe të llogaritjes.

VI. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR QËLLIME TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I
Klasat e konsumit specifik të energjisë

Klasat e konsumit specifik të energjisë (SEC) të njësive të ventilimit të banesave të llogaritura për klimën mesatare:

Tabela 1
Klasifikimi (nga 1 janari 2016)

Klasa SEC	**SEC në kWh/am ^{2}**
A+ (më eficente)	SEC < – 42
A	– 42 ≤ SEC < – 34
B	– 34 ≤ SEC < – 26
C	– 26 ≤ SEC < – 23
D	– 23 ≤ SEC < – 20
E	– 20 ≤ SEC < – 10
F	– 10 ≤ SEC < 0
G (më pak eficente)	0 ≤ SEC

SHTOJCA II
Etiketa

1. Etiketa për njësitë e ventilimit me një drejtim (të shitura pas 1 janarit 2016)



I, II

III

IV, V

Etiketa jep informacionin e mëposhtëm:

I. Emrin e furnizuesit ose markën tregtare;
II. Identifikuesin e modelit të furnizuesit;
III. Efiçencën e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë të pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës të klasës përkatëse të efiçencës së energjisë. Efiçenca e energjisë paraqitet për një klimë "mesatare";
IV. Nivelin e fuqisë së zhurmës (L_{WA}) në dB të rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
V. Prurjen maksimale në m^3/h të rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, e shoqëruar nga një shigjetë që përfaqëson njësitë e ventilimit me një drejtim.

2. Etiketa për njësitë e ventilimit me dy drejtime të shitura pas 1 janarit 2016



I, II

III

IV, V

Etiketa jep informacionin e mëposhtëm:

I. Emrin e furnizuesit ose markën tregtare
II. Identifikuesin e modelit të furnizuesit

III. Eficencën e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e eficencës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të eficencës së energjisë. Eficenca e energjisë paraqitet për një klimë "mesatare";

IV. Nivelin e fuqisë së zhurmës (L_{WA}) në dB i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt

3. Prurjen maksimale në m^3/h të rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, të shoqëruar nga dy shigjeta në drejtime të kundërta që përfaqësojnë njësitë e ventilimit me dy drejtime. Skicimi i etiketave për njësitë e ventilimit të banesave të përcaktuar në pikat 1 deri në 2 është si më poshtë:



Ku:

Etiketa është 75 mm e gjerë dhe 150 mm e gjatë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme. Sfondi është me ngjyrë të bardhë.
Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, sipas shembullit në vijim: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % e zezë.
Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1 **Shtrirja e kufirit të etiketës BE:** 3,5 pt — ngjyra: Cyan 100 % — këndet e rrumbullakëta: 2,5 mm

2 **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

3 **Logoja e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00.
Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + logoja e energjisë: gjerësia: 62 mm, lartësia: 12 mm.

4 **Kufiri i nën-logos:** 1 pt — ngjyra: cian 100 % — gjatësia: 62 mm.

5 **Shkallët A+–G:**

– Shigjeta: lartësia: 6 mm, hapësira: 1 mm — ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e shtatë 00-XX-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,

– Teksti: shkronjat janë në formatin Calibri bold 13 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë

6 **Klasa specifike e konsumit të energjisë**
  - Shigjeta: gjerësia: 17 mm, lartësia: 9 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
  - Teksti: shkronjat janë në formatin Calibri bold 18,5 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë; Simbolet '+': shkronjat janë në formatin Calibri bold 11 pt, në ngjyrë të bardhë të rreshtuara në një rresht të vetëm.

7 **Niveli i fuqisë së zhurmës në dB:**
  - Kufiri: 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — këndet e rrumbullakëta: 2,5 mm;
  - Vlera: shkronjat janë në formatin Calibri bold 16 pt, 100 % në ngjyrë të zezë;
  - 'dB': shkronjat janë në formatin Calibri regular 10 pt, 100% në ngjyrë të zezë.

8 **Prurja maksimale në m^3/h:**
  - Kufiri: 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — këndet e rrumbullakëta: 2,5 mm;
  - Vlera: shkronjat janë në formatin Calibri bold 16 pt, 100 % në ngjyrë të zezë;
  - 'm^3/h': shkronjat janë në formatin Bold Calibri 16 pt, 100 % në ngjyrë të zezë;
  - Një ose dy shigjeta
    - Secila gjerësi: 10 mm, secila lartësi: 10 mm.
    - Ngjyra: cian 100%.

9 **Energjia:**
  - Teksti: shkronjat janë në formatin Calibri regular 6 pt, kapitale, në ngjyrë të zezë.

10 **Periudha e referencës:**
  - Teksti: shkronjat janë në formatin Calibri bold 8 pt.

11 **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**

12 **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**

13 Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 62 × 10 mm.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Skeda informative e produktit

Informacioni në skedën informative të produktit të njësisë së ventilimit të banesave i përmendur në pikën 1(b) të kreut III, jepet sipas rendit të mëposhtëm dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që ofrohet me produktin.

a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;
b) Identifikuesi i modelit të furnizuesit, d.m.th., kodi, zakonisht alfanumerik, i përdorur për të dalluar një model specifik të njësisë së ventilimit të banesave nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër të furnizuesit;
c) Konsumi specifik i energjisë (SEC) në kWh /(m ^{2} .a) për çdo zonë klimatike të aplikueshme dhe klasën e konsumit specifik të energjisë;
ç) Tipologjia e deklaruar në përputhje me kreun 2 të kësaj rregulloreje (me një drejtim ose me dy drejtime);
d) Lloji i motorëve të instaluar ose të planifikuar për t'u instaluar (motor me shumë shpejtësi ose motor me shpejtësi të ndryshueshme);
dh) Lloji i sistemit të rikuperimit të nxehtësisë (rikuperues, rigjenerues, ose asnjë);
e) Efiçenca termike e rikuperimit të nxehtësisë (në % ose "nuk zbatohet" nëse produkti nuk ka sistem të rikuperimit të nxehtësisë);
ë) Prurja maksimale në m^3 /orë;
f) Fuqia elektrike e motorit të ventilatorit, duke përfshirë të gjitha pajisjet e kontrollit të motorit, në prurjen maksimale (W);
g) Niveli i fuqisë së zhurmës (L_{WA}), i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
gj) Prurja referente në m^3 /s;
h) Diferenca e presionit të referente në Pa;
i) Energjia elektrike hyrëse specifike në W/(m^3 /h);
j) Faktori i kontrollit dhe tipologjia e kontrollit në përputhje me përcaktimet dhe klasifikimin përkatës të dhënë në Tabelën 1 të Shtojcës VII;
k) Norma maksimale e deklaruar rrjedhjeve të brendshme dhe të jashtme (%) të njësive të ventilimit me dy drejtime ose të rikthimit (vetëm për shkëmbyesit rigjenerues të nxehtësisë), dhe normat e rrjedhjeve të jashtme (%) për njësitë e ventilimit me një drejtim me kanal;
l) Norma e përzierjes e njësive të ventilimit me dy drejtime pa kanale ajri që nuk synohet të lidhen me kanale ajri në anën e furnizimit ose të shkarkimit të ajrit;
ll) Pozicioni dhe përshkrimi i paralajmërimit pamor të filtrit për njësitë e ventilimit të banesave të destinuara për përdorim me filtra, duke përfshirë tekstin që tregon rëndësinë e ndërrimeve të rregullta të filtrit në shërbim të performancës dhe efiçencës së energjisë së njësisë;
m) Për sistemet e ventilimit me një drejtim, udhëzime për instalimin e grilave të rregullueshme të furnizimit/shkarkimit në fasadë për furnizimin/shkarkimin e ajrit të ambientit;
n) Adresa e internetit për udhëzime para montimit/çmontimit;
nj) Vetëm për njësitë pa kanale ajri: ndjeshmëria e rrymës së ajrit ndaj variacioneve të presionit në + 20 Pa dhe – 20 Pa;
o) Vetëm për njësitë pa kanale ajri: ngjeshja e brendshme/jashtme e ajrit në m^3/h;
p) Konsumi vjetor i energjisë elektrike (në kWh energji elektrike/a);

q) Kursimi vjetor për ngrohje (në kWh energji parësore/a) për çdo lloj klime ("mesatare", "e ngrohtë", "e ftohtë").

SHTOJCA IV
Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(c) të kreut III përfshin:

a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;
b) Identifikuesin e modelit të furnizuesit, d.m.th., kodin, zakonisht alfanumerik, të përdorur për të dalluar një model specifik të njësisë së ventilimit të banesave nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër të furnizuesit;
c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;
ç) Metodat e tjera të llogaritjes, standardet e matjes dhe specifikimet e përdorura, sipas rastit;
d) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;
dh) Parametrat teknikë për matjet, të përcaktuara në përputhje me Shtojcën VII, sipas rastit;
e) Dimensionet e përgjithshme;
ë) Specifikimin e llojit të njësisë së ventilimit të banesave;
f) Klasën specifike të konsumit të energjisë të modelit siç përcaktohet në Shtojcën I;
g) Konsumin specifik të energjisë (SEC) për secilën zonë klimatike të aplikueshme;
gj) Nivelin e fuqisë së zhurmës (L_{WA});
h) Rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me Shtojcën VII.

Furnizuesit mund të përfshijnë informacion shtesë në fund të listës së mësipërme.

SHTOJCA V

Informacioni që jepet në rastet kur përdoruesi fundor nuk shikon produktin të ekspozuar, përjashtuar rastet përmes internetit

1. Kur përdoruesit fundorë nuk shikojnë produktin e shfaqur, përjashtuar rastet përmes internetit, informacioni jepet në rendin e mëposhtëm:
   a) Klasa e konsumit specifik të energjisë së modelit siç përcaktohet në Shtojcën I;
   b) Konsumi specifik i energjisë (SEC) në kWh /(m^2 .a) për çdo zonë klimatike të aplikueshme;
   c) Prurja maksimale (në m^3 /orë);
   ç) Niveli i fuqisë së zhurmës (L_{WA}) në dB(A) i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.
2. Kur jepen informacione të tjera të përfshira në skedën informative të produktit, ato janë në formën dhe radhitjen e specifikuar në Shtojcën III.
3. Madhësia dhe formati i shkronjave, në të cilat shkruhet ose paraqitet informacioni i përmendur në këtë Shtojcë, është i tillë që të jenë të lexueshme.

SHTOJCA VI

Informacioni që jepet në rast të shitje, dhënie me qera, ose blerje me këste përmes internetit

1. Etiketa e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me kreun III (1)(a) paraqitet në mekanizmin e shfaqjes pranë çmimit të produktit sipas afateve kohore të treguara në kreun III (2) dhe (3). Madhësia e etiketës është e tillë që të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe është proporcionale me madhësinë e specifikuar në Shtojcën III. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin imazhi i përdorur për aksesimin e tij përputhet me specifikimet e dhëna në pikën 3 të kësaj Shtojce. Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi imazh.
2. Imazhi që përdoret për të aksesuar etiketën në rastin e ekranit të ndërlidhur:
   a) Është një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë së produktit në etiketë;
   b) Tregon klasën e efiçencës së energjisë së produktit në ngjyrë të bardhë në të njëjtën madhësi fonti si ajo e përdorur për çmimin; dhe
   c) Është në një nga dy formatet e mëposhtme:



3. Imazhi Në rastin e ekranit të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:
   a) Imazhi i përmendur në pikën 3 të kësaj Shtojce shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit;
   b) Lidhjet e imazhit me etiketën;
   c) Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, rrotullimit të mausit ose zgjerimit të ekranit me prekje mbi imazh;
   ç) Etiketa shfaqet nga një dritare e re, skedë e re, faqe e re ose nga shfaqja e ekranit të integruar;
   d) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;
   dh) Shfaqja e etiketës ndalohet me anë të një opsioni mbylljeje ose mekanizmi tjetër standard të mbylljes;
   e) Teksti alternativ për pamjen grafike, që do të paraqitet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e eficencës së energjisë së produktit në të njëjtën madhësi shkronjash si ajo e përdorur për çmimin.

4. Skeda informative e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(b) të kreut III shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia është e tillë që skeda informative e produktit të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Skeda informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin lidhja e përdorur për të hyrë në skedën informative të

produktit tregon qartë dhe në mënyrë të lexueshme “Skeda informative e produktit”. Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, skeda informative e produktit do të shfaqet në klikimin e parë të mausit, rrotullimin e mausit ose zgjerimin e ekranit me prekje mbi link.

SHTOJCA VII

Matjet dhe llogaritjet

1. Konsumi specifik i energjisë (SEC) llogaritet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:
$SEC = t_a \times pef \times q_{net} \times MISC \times CTRL^x \times SPI - t_h \times \Delta T_h \times \eta_h^{-1} \times c_{air} \times (q_{ref} - q_{net} \times CTRL \times MISC \times (1 - \eta_t)) + Q_{defr}$
ku:

- *SEC*-i është konsumi specifik i energjisë për ventilim për m^2 sipërfaqe dyshemeje me ngrohje të një banese ose ndërtese [kWh/m^2 .a]
- t_a janë orët vjetore të punës [h/a];
- *pef* është faktori kryesor i energjisë për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike [-];
- q_{net} është kërkesa neto e normës së ventilimit për m^2 sipërfaqe të dyshemesë me ngrohje [m^3 /hm^2];
- *MISC* është një faktor tipologjik i përgjithshëm i mbledhur, që përfshin faktorët e efektivitetit të ventilimit, rrjedhjen e kanalit dhe infiltrimin shtesë [-];
- *CTRL* është faktori i kontrollit të ventilimit [-];
- *x* është një eksponent që merr parasysh lidhjen jolineare midis energjisë termike dhe kursimit të energjisë elektrike, në varësi të karakteristikave të motorit dhe të shtytësit [-];
- *SPI* është fuqia elektrike specifike [kW/(m^3 /h)];
- t_h është totali i orëve të sezonit të ngrohjes [h];
- ΔT_h është ndryshimi mesatar i temperaturës së brendshme (19 °C) dhe të jashtme gjatë një sezoni ngrohjeje, minus 3 K korrigjim për përfitimet diellore dhe ato të brendshme [K];
- η_h është efiçenca mesatare e ngrohjes së hapësirës [-];
- c_{ajrit} është kapaciteti termik specifik i ajrit nën presion dhe dendësi konstante [kWh /(m^3 K)];
- q_{ref} është norma e referencës së ventilimit natyror për m^2 sipërfaqe të dyshemesë me ngrohje [m^3 /hm^2];
- η_t është eficenca termike e rikuperimit të nxehtësisë [-];
- Q_{defr} është energjia vjetore e ngrohjes për m^2 sipërfaqe dyshemeje me ngrohje [kWh/m^2 .a] për shkrirje, bazuar në një ngrohje me rezistencë të ndryshueshme elektrike.
$Q_{defr} = t_{defr} \times \Delta T_{defr} \times c_{ajrit} \times q_{net} \times pef$
ku:
  - t_{defr} është kohëzgjatja e periudhës së shkrirjes, d.m.t.,h kur temperatura e jashtme është nën – 4 °C [h/a]; dhe
  - ΔT_{defr} është diferenca mesatare e shprehur në K ndërmjet temperaturës së jashtme dhe – 4 °C gjatë periudhës së shkrirjes.

  Q_{defr} zbatohet vetëm për njësitë me dy drejtime me shkëmbyes nxehtësie; për njësi me një drejtim ose njësi me shkëmbyes rikuperues nxehtësie, $Q_{defr} = 0$.

SPI dhe η_t janë vlera që dalin nga testet dhe metodat e llogaritjes.

Parametrat e tjerë dhe standardet e tyre janë dhënë në Tabelën 1. SEC për klasifikimin e etiketave bazohet në klimën "mesatare".

2. Konsumi vjetor i energjisë elektrike për 100 m^2 sipërfaqe dyshemeje (AEC) (në kWh/a elektrike në vit); dhe ngrohja vjetore e kursyer ((AHS), që do të thotë kursimi vjetor i konsumit të energjisë për ngrohje (në kWh vlerë kalorifike bruto e lëndës djegëse në vit) llogariten si më poshtë, duke përdorur përkufizimet e dhëna në pikën 1, dhe vlerat e paracaktuara të dhëna në Tabelën 1, për çdo lloj klime (mesatare, e ngrohtë dhe e ftohtë):

$$AEC = t_a \times q_{net} \times MISC \times CTRL^X \times SPI + Q_{defr}$$

$$AHS = t_h \times \Delta T_h \times \eta_h^{-1} \times c_{air} \times (q_{ref} - q_{net} \times CTRL \times MISC \times (1 - \eta_t))$$

Tabela 1

Parametrat e llogaritjes së SEC-së

Tipologjia e përgjithshme					**MISC**
Njësitë e ventilimit me kanale ajri					**1,1**
Njësitë e ventilimit pa kanale ajri					**1,21**
Kontrolli i ventilimit					**CTRL**
Kontroll manual (pa DCV)					**1**
Kontrolli i orës (pa DCV)					**0,95**
Kontrolli qendror i kërkesës					**0,85**
Kontrolli i kërkesës lokale					**0,65**
Motor & shtytës					**x-vlera**
Ndezje/fikje dhe një shpejtësi					**1**
2-shpejtësi					**1,2**
3-shpejtësi					**1,5**
Shpejtësi të ndryshueshme					**2**
Klima	**t_h në h**	**ΔT_h në K**	**t_{defr} në h**	**ΔT_{defr} në K**	**Q_{defr} në kWh/am²**
E ftohtë	**6 552**	**14,5**	1 003	5,2	**5,82**
Mesatare	**5 112**	**9,5**	168	2,4	**0,45**
E ngrohtë	**4 392**	**5**	-	-	-
Elementët e paracaktuar					**vlerë**
Kapaciteti termik specifik i ajrit, c_{air} në kWh/(m³ K)					**0,000344**
Kërkesa për ventilim neto për m^2 sipërfaqe dyshemeje me ngrohje, q_{neto} në m^3/hm^2					**1,3**
Norma e referencës e ventilimit natyral për m^2 sipërfaqe dyshemeje me ngrohje, q_{ref} në m^3/hm^2					**2,2**
Orët vjetore të punës, t_a në h					**8 760**
Faktori parësor i energjisë – prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, *pef*					**2,5**
Eficenca e ngrohjes së hapësirës, η_h					**75 %**

Shkrirja përdoret vetëm për njësitë me dy drejtime me shkëmbyes rikuperues nxehtësie dhe llogaritet si:

$$Q_{defr} = t_{defr} \times \Delta t_{defr} \times c_{air} \times q_{neto} \times pef.$$

Për njësitë me një drejtim ose njësitë me shkëmbyes rikuperues nxehtësie, $Q_{defr} = 0$

SHTOJCA VIII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë lidhen vetëm me verifikimin e parametrave të matur nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut dhe nuk do të përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik. Vlerat dhe klasat në etiketë ose në skedën informative të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik. Kur verifikohet përputhshmëria e një modeli produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston një njësi të vetme të ventilimit të banesave
2. Modeli përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse:
    a) vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin se vlerat korresponduese të dhëna në raportet e testimit; dhe
    b) vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën informative të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e efiçencës së energjisë nuk është më e favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara;
    c) kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në tabelën 1.
3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet e tjera të barasvlefshme konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.
4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zgjedh tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve të ndryshme të barasvlefshme.
5. Modeli konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 1.
6. Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet e tjera të barasvlefshme konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të dhëna në Shtojcën VII.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në tabelën 1 dhe përdor vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 6 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë. Nuk do të zbatohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 1

Parametri	Tolerancat e verifikimit
SPI	Vlera e matur nuk janë më shumë se 1,07 herë vlera maksimale e deklaruar.
NJVB me efiçencë termike	Vlera e matur është jo më pak se 0,93 herë vlera minimale e deklaruar.
Niveli i fuqisë së zhurmës	Vlera e matur nuk është më shumë se vlera maksimale e deklaruar plus 2 dB.

ANEKS NR.10

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN E ENERGJISË PËR NGROHËSIT E UJIT, REZERVUARËT E UJIT TË NGROHTË DHE PAKETAT E NGROHËSVE TË UJIT DHE PAJISJEVE DIELLORE"[1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1.Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin e energjisë dhe dhënien e informacionit plotësues për produktet për ngrohësit e ujit me kapacitet ngrohës të renditur ≤ 70 kW, rezervuarët e ujit të ngrohtë me një vëllim depozitimi ≤ 500 litra dhe paketat e përbëra nga ngrohësit e ujit dhe pajisjet diellore ≤ 70 kW.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

a) Ngrohësit e ujit të projektuar posaçërisht për funksionim me lëndë djegëse të gazta ose të lëngta të prodhuara kryesisht nga biomasa;
b) Ngrohësit e ujit që përdorin lëndë djegëse të ngurta;
c) Ngrohësit e ujit duhet të përmbushin kërkesat për tw cilwt konsiderojnw rregullat për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes që vjen nga aktivitetet industriale.
d) Ngrohës i kombinuar" është një ngrohës hapësire që është projektuar për të ofruar gjithashtu nxehtësi për të ofruar ujë të ngrohtë të pijshëm ose sanitar në nivele të temperaturës, sasi dhe shpejtësi të caktuar rrjedhjeje gjatë intervaleve të caktuara, dhe është i lidhur me një furnizim të jashtëm me ujë të pijshëm ose sanitar;
e) Ngrohësit e ujit që nuk plotësojnë profilin e ngarkesës me energjinë më të vogël të referencës, siç specifikohet në Tabelën 3 të Shtojca III;
f) Ngrohësit e ujit të projektuar vetëm për përgatitjen e pijeve dhe/ose ushqimeve të ngrohta.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1.	**"Ngrohës uji"** është një pajisje që: (a) Eshtë e lidhur me një furnizues të jashtëm të ujit të pijshëm ose sanitar;

1 Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 812/2013 e Komisionit, datë 18 shkurt 2013, për plotësimin e Direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin e energjisë për ngrohësit e ujit, rezervuarët e ujit të ngrohtë, paketat e ngrohësve të ujit dhe pajisjeve diellore". Numri CELEX 02013R0812, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 239, datë 06.09.2013, f. 83.

	(b)Prodhon dhe transmeton nxehtësi për të siguruar ujë të pijshëm ose sanitar të ngrohtë në nivele të caktuara të temperaturës, sasi dhe normë të caktuar fluksi gjatë periudhave të caktuara; dhe (c) Eshtë e pajisur me një ose më shumë prodhues të nxehtësisë;
2.	"**Prodhues i nxehtësisë"** është pjesa e një ngrohësi uji që prodhon nxehtësinë duke përdorur një ose më shumë nga proceset e mëposhtme: (a) Djegia e lëndëve djegëse fosile dhe/ose lëndëve djegëse të biomasës; (b) Përdorimi i efektit Xhaul në elementët e ngrohjes me rezistencë elektrike; (c)Kapja e nxehtësisë së mjedisit nga një burim ajri, burim uji ose burimi tokësor dhe/ose nxehtësia e mbetjeve;
3.	**"Prodhimi i vlerësuar i nxehtësisë"** është fuqia e deklaruar të nxehtësisë së ngrohësit të ujit kur siguron ngrohjen e ujit në kushtet standarde, i shprehur në kW;
4.	**"Vëllimi i depozitimit"** (V) është vëllimi i vlerësuar i një rezervuari për depozitimin e ujit të ngrohtë, i shprehur në litra;
5.	**"Kushtet standarde të vlerësimit"** janë kushtet e funksionimit të ngrohësve të ujit për përcaktimin e prodhimit të vlerësuar të nxehtësisë, efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit dhe nivelit të fuqisë së zhurmës, si dhe të rezervuarëve për depozitimin e ujit të ngrohtë në funksion të përcaktimit të humbjes termike;
6.	**"Biomasa"** është fraksioni i biodegradueshëm i produkteve, mbetjeve dhe mbeturinave me origjinë biologjike nga bujqësia (duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore), pylltarinë dhe industritë e lidhura përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe pjesën e biodegradueshme të mbetjeve industriale dhe bashkiake;
7.	**"Lëndë djegëse e biomasës"** është një lëndë djegëse e gaztë ose të lëngta e prodhuar nga biomasa;
8.	**"Lëndë djegëse fosile"** është një lëndë djegëse e gaztë ose të lëngta me origjinë fosile;
9.	**"Rezervuari për depozitimin e ujit të ngrohtë"** është një enë për ruajtjen e ujit të ngrohtë për qëllime të ngrohjes së ujit dhe/ose të hapësirës, duke përfshirë çdo element shtesë, i cili nuk është i pajisur me ndonjë prodhues nxehtësie, me përjashtim të ndoshta një ose disa ngrohësve rezervë me zhytje;
10.	**"Ngrohës rezervë me zhytje"** është një ngrohës me rezistencë elektrike me efekt Xhaul që është pjesë e një depozite të ujit të ngrohtë dhe prodhon nxehtësi vetëm kur burimi i jashtëm i nxehtësisë është i ndërprerë (përfshirë ndërprerjen gjatë periudhave të mirëmbajtjes) ose jashtë funksionit, ose që është pjesë e një depozite të ujit të ngrohtë diellor dhe siguron nxehtësi kur burimi i nxehtësisë diellore nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nivelet e kërkuara të temperaturës;
11.	**"Pajisje diellore"** është një sistem i vetëm diellor, një kolektor diellor, një rezervuar diellor për depozitimin e ujit të ngrohtë ose një pompë në lidhjen e kolektorit, të cilat vendosen në treg si produkte të ndara;
12.	**"Sistemi i vetëm diellor"** është një pajisje që ka një ose më shumë kolektorë diellorë dhe rezervuarë diellorë për depozitimin e ujit të ngrohtë diellor dhe mundësisht me pompa në

	lidhjen e kolektorit dhe pjesë të tjera, e cila vendoset në treg si një njësi dhe nuk është e pajisur me ndonjë prodhues të nxehtësisë me përjashtim të një ose disa ngrohësve zhytës rezervë;
13.	**"Paketë e përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore"** është një paketë që i ofrohet përdoruesit fundor që përmban një ose më shumë ngrohës uji dhe një ose më shumë pajisje diellore;
14.	**"Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit"** (η_{wh}) është raporti ndërmjet energjisë së dobishme të siguruar nga një ngrohës uji ose një pakete e përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore dhe energjisë së nevojshme për prodhimin e tij, i shprehur në %;
15.	**"Niveli i fuqisë së zhurmës"** (L_{WA}) është niveli i fuqisë së zhurmës i ponderuar në shkallën A, brenda dhe/ose jashtë, i shprehur në dB;
16.	**"Humbja termike"** (S) është fuqia e ngrohjes që humb një rezervuar depozitimin e ujit të ngrohtë në temperatura të dhëna të ujit dhe mjedisit, e shprehur në W;
17.	**"Ngrohës uji me pompë nxehtësie"** është një ngrohës uji që përdor nxehtësinë e që del nga një burim ajri, burim uji ose burim tokësor dhe/ose nxehtësinë e mbetjeve për prodhimin e nxehtësisë.
18.	**"Ngrohës i zakonshëm i ujit"** është një ngrohës uji që prodhon nxehtësi duke përdorur djegien e lëndëve djegëse fosile dhe/ose të biomasës dhe/ose efektin Xhaul në elementët e ngrohjes me rezistencë elektrike;
19.	**"Ngrohës diellor i ujit"** është një ngrohës uji i pajisur me një ose më shumë kolektorë diellor, rezervuar depozitimi uji të ngrohtë nga dielli, prodhues të nxehtësisë dhe mundësisht pompa në rrjetin e kolektorit dhe pjesë të tjera, një ngrohës uji diellor që vendoset në treg si një njësi;
20.	**"Profili i ngarkesës"** është një sekuencë e caktuar e nxjerrjes së ujit, siç specifikohet në Tabelën 3 të Shtojcës VI; çdo ngrohës uji plotëson, të paktën, një profil ngarkese;
21.	**"Nxjerrja e ujit"** është një kombinim i caktuar i shpejtësisë së rrjedhjes së ujit të dobishëm, temperaturës së ujit të dobishëm, përmbajtjes së energjisë së dobishme dhe temperaturës maksimale, siç specifikohet në Tabelën 3 të Shtojcës VI;
22.	**"Shpejtësia e rrjedhjes së ujit të dobishëm"** (f) është norma minimale e shpejtësisë, e shprehur në litra për minutë, për të cilën uji i ngrohtë kontribuon në energjinë e referencës, siç specifikohet në Tabelën 3 të Shtojcës VI;
23.	**"Temperatura e ujit të dobishëm"** (T_m) është temperatura e ujit, të shprehur në gradë Celsius, në të cilën uji i ngrohtë fillon të kontribuojë në energjinë e referencës, siç specifikohet në Tabelën 3 të Shtojcës VI;
24.	**"Përmbajtja e energjisë së dobishme"** (Q_{tap}) është përmbajtja energjetike të ujit të ngrohtë, e shprehur në kWh, e dhënë në një temperaturë të barabartë ose më të lartë se temperatura e dobishme të ujit dhe me normë të fluksit të ujit të barabartë ose më të lartë se norma e dobishme e fluksit të ujit, siç specifikohet në Tabelën 3 të Shtojcës VI;

25.	**"Përmbajtja energjetike e ujit të ngrohtë"** është produkti i kapacitetit specifik të nxehtësisë së ujit, ndryshimi mesatar i temperaturës midis ujit të ngrohtë dhe të ujit të ftohtë, dhe masa totale e ujit të ngrohtë të prodhuar;
26.	**"Temperatura e pikut (*T_f*)** është temperatura minimale e ujit, e shprehur në gradë Celsius, që duhet arritur gjatë shkarkimit së ujit, siç specifikohet në Tabelën 3 të Shtojcës VI;
27.	**"Energjia e referencës" (*Q_{ref}*)** është masa e përmbajtjes së energjisë së dobishme të shkarkimit së ujit, e shprehur në kWh, në një profil ngarkese të caktuar, siç specifikohet në Tabelën 3 të ShtojcësVI;
28.	**"Profili maksimal i ngarkesës"** është profili i ngarkesës me energjinë më të madhe të referencës që një ngrohës uji është në gjendje të sigurojë duke përmbushur kushtet e temperaturës dhe normën e rrjedhjes të atij profili të ngarkesës;
29.	**"Profili i deklaruar i ngarkesës"** është profili i ngarkesës që aplikohet gjatë përcaktimit të efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit;
30.	**"Koefiçienti i konvertimit" (*CC*)** është një koefiçient që pasqyron efiçencën mesatare të prodhimit prej 40% të përmendur në ligjin për efiçencën e energjisë vlera e koefiçientit të konvertimit është *CC* = 2,5;
31.	**"Konsumi ditor i energjisë elektrike" (*Q_{elec}*)** është konsumi i energjisë elektrike gjatë 24 orëve rresht nën profilin e deklaruar të ngarkesës dhe në kushtet e dhëna klimatike, i shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare;
32.	**"Konsumi ditor i lëndës djegëse" *(Q_{fuel})*** është konsumi i lëndës djegëse për 24 orë rresht nën profilin e deklaruar të ngarkesës dhe në kushtet e dhëna klimatike, i shprehur në kWh në terma të *GCV-së*, dhe për qëllimet e pikës 4 të Shtojcës VII i shprehur në GJ (Gigajoule) në terma të *GCV*-së;
33.	**"Vlera kalorifike bruto" (*GCV*)** është sasia totale e nxehtësisë që çlirohet nga një njësi sasie lënde djegëse kur digjet plotësisht me oksigjen dhe kur produktet e djegies kthehen në temperaturën e mjedisit; kjo sasi përfshin nxehtësinë e kondensimit të çdo avulli të ujit që përmban lënda djegëse dhe të avullit të ujit të formuar nga djegia e hidrogjenit që gjendet në lëndën djegëse;
34.	**"Kontroll inteligjent"** është një pajisje që përshtat automatikisht procesin e ngrohjes së ujit me kushtet individuale të përdorimit me qëllim të reduktimit të konsumit të energjisë;
35.	**"Përputhshmëria e kontrollit inteligjent" (*smart*)** është masa e përmbushjes së kritereve të përcaktuara në pikën 5 të Shtojcës VII për një ngrohës uji të pajisur me kontroll inteligjent;
36.	**"Faktor i kontrollit inteligjent" (*SCF*)** është përfitimi i efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit për shkak të kontrollit inteligjent sipas kushteve të përcaktuara në pikën 3 të Shtojcës VI;
37.	**"Konsumi javor i energjisë elektrike me kontrolle inteligjente"** ($Q_{elec,week,smart}$) është konsumi javor i energjisë elektrike i një ngrohësi uji me funksionin e kontrollit inteligjent të aktivizuar, i shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare;

38.	**"Konsumi javor i lëndës djegëse me kontrolle inteligjente"** ($Q_{fuel,ëeek,smart}$) është konsumi javor i lëndës djegëse i një ngrohësi të ujit me funksionin e kontrollit inteligjent të aktivizuar, i shprehur në kWh në terma të *GCV-së*;
39.	**"Konsumi javor i energjisë elektrike pa kontrolle inteligjente"** ($Q_{elec,week}$) është konsumi javor i energjisë elektrike i një ngrohësi uji me funksionin e kontrollit inteligjent të çaktivizuar, i shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare;
40.	**"Konsumi javor i lëndës djegëset pa kontrolle inteligjente"** ($Q_{fuel,week}$) është konsumi javor i lëndës djegëse i një ngrohësi të ujit me funksionin e kontrollit inteligjent të çaktivizuar, i shprehur në kWh në terma të *GCV*-së;
41.	**"Konsum vjetor i energjisë elektrike"** (*AEC*) është konsumi vjetor i energjisë elektrike i një ngrohësi të ujit nën profilin e deklaruar të ngarkesës dhe në kushtet e dhëna klimatike, i shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare;
42.	**"Konsum vjetor i lëndës djegëse"** (*AFC*) është konsumi vjetor i lëndës djegëse fosil dhe/ose i biomasës së një ngrohësit të ujit nën profilin e deklaruar të ngarkesës dhe në kushtet e dhëna klimatike, i shprehur në GJ në terma të *GCV*-së;
43.	**"Term i korrigjimit të mjedisit"** (P_{cor}) është një term që merr parasysh faktin se vendi ku është instaluar ngrohësi i ujit nuk është një vend izotermik, i shprehur në kWh;
44.	**"Humbja e nxehtësisë në gjendje gatishmërie"** (P_{stby}) është humbja e nxehtësisë së një ngrohësi të ujit me pompë nxehtësie në gjendjen e funksionimit pa kërkesë për ngrohje, e shprehur në kW;
45.	**"Kushte mesatare klimatike", "kushte klimatike më të ftohta" dhe "kushte klimatike më të ngrohta"** janë temperaturat dhe kushtet globale të rrezatimit diellor përshkruar sipas skenarëve të ndryshëm klimatikë që ndikojnë në kërkesën për energji dhe masat e eficencës.
46.	**"Konsumi vjetor i energjisë" (Q_{tota})** është konsumi vjetor i energjisë së një ngrohësi uji diellor, i shprehur në kWh në terma të energjisë primare dhe/ose kWh në terma të *GCV*-së;
47.	**"Kontributi vjetor i ngrohjes jo-diellore"** (Q_{nonsol}), është kontributi vjetor i energjisë elektrike (i shprehur në kWh në terma të energjisë primare)dhe/ose lëndëve djegëse (i shprehur në kWh në terma të *GCV*-së) në prodhimin e nxehtësisë së dobishme të një ngrohësi uji diellor ose të një pakete të përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore, duke marrë parasysh sasinë vjetore të nxehtësisë së kapur nga kolektori diellor dhe humbjet e nxehtësisë së rezervuarit të ujit të ngrohtë diellor;
48.	**"Kolektor diellor"** është një pajisje e projektuar për të përthithur rrezatimin diellor global dhe për të transmetuar energjinë e nxehtësisë së prodhuar tek një masë të lëngta që kalon përmes tij; karakterizohet nga zona e hapjes së kolektorit, efiçenca me zero humbje, koefiçienti i rendit të parë, koefiçienti i rendit të dytë dhe modifikuesi i këndit të rrezatimit;

49.	**"Rrezatimi diellor global "** është shkalla e energjisë totale hyrëse diellore, direkte dhe të shpërndarë, në një plan kolektori me këndin e pjerrësisë 45 gradë dhe me orientim jugor të sipërfaqes së Tokës, e shprehur në W/m^2 ;
50.	**"Zona e hapjes së kolektorit"** (A_{sol}) është zona maksimale e projektuar përmes së cilës rrezatimi diellor i papërqëndruar hyn në kolektor, i shprehur në m^2;
51.	**"Efiçenca me zero humbje"** (η_0) është efiçenca e kolektorit diellor, kur temperatura mesatare e fluidit të kolektorit diellor është e barabartë me temperaturën e mjedisit;
52.	**"Koefiçienti i rendit të parë"** (a_1) është koefiçienti i humbjes së nxehtësisë së një kolektori diellor, i shprehur në $W/(m^2 K)$;
53.	**"Koefiçienti i rendit të dytë"** (a_2) është koefiçienti që mat varësinë e temperaturës së koefiçientit të rendit të parë, i shprehur në $W/(m^2 K^2)$;
54.	**"Modifikues i këndit të rrezatimit"** (IAM) është raporti i prodhimit të nxehtësisë së dobishme të kolektorit diellor në një kënd të caktuar rrezatimi dhe prodhimit të tij të nxehtësisë së dobishme në një kënd rrezatimi prej 0 gradësh;
55.	**"Këndi i rrezatimit"** është këndi ndërmjet drejtimit ndaj diellit dhe drejtimit pingul me hapjen e kolektorit diellor;
56.	**"Rezervuari i ujit të ngrohtë diellor"** është një rezervuar i ruajtjes së ujit të ngrohtë që ruan energjinë e nxehtësisë së prodhuar nga një ose më shumë kolektorë diellor;
57.	**"Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit të prodhuesit të nxehtësisë"** ($\eta_{wh,nonsol}$) është efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit të një prodhuesi të nxehtësisë që është pjesë e një ngrohësi uji diellor, e shprehur në %, e vendosur në kushte mesatare klimatike dhe pa përdorur produktin e nxehtësisë diellore;
58.	**"Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse"** (Q_{aux}), për qëllimin e Figurës 1 të Shtojcës III e referuar si "energjia elektrike ndihmëse", është konsumi vjetor i energjisë elektrike i një ngrohësi uji diellor ose i një sistemi që është vetëm diellor që ndodh për shkak të konsumit të energjisë nga pompa dhe nga konsumi i energjisë në gjendjen e gatishmërisë, i shprehur në kWh në terma të energjisë përfundimtare;
59.	**"Konsumi i energjisë elektrike të pompës"** ($solpump$) është konsumi i vlerësuar i energjisë elektrike i pompës në ciklin e kolektorit të një ngrohësi uji diellor ose të një sistemi që është vetëm diellor, i shprehur në W;
60.	**"Konsumi i energjisë në gjendje gatishmërie"** ($solstandby$) është konsumi i vlerësuar i energjisë elektrike i një ngrohësi diellor të ujit ose i sistemit vetëm me energji diellore kur pompa dhe prodhuesi i nxehtësisë janë joaktivë, i shprehur në W;
61.	**"Identifikuesi i modelit "**është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një ngrohës ujit specifik,rezervuar uji të ngrohtë, pajisjen diellore ose paketën e modelit të përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare, me të njëjtin emër furnizuesi ose me të njëjtin emër të shitësit.
62.	**"Mekanizmi i shfaqjes"** është çdo ekran, duke përfshirë ekranin e prekshëm, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;

63.	**"Ekran i mbivendosur"** është një ndërfaqe vizuale ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrokullisje të mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje të një imazhi ose grupi të dhënash tjetër;
64.	**"Ekran i prekshëm"** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si ai i një kompjuteri tablet, kompjuterit me prekje ose një smartphone;
65.	**"Tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një grafiku që lejon që informacioni të paraqitet në formë jo grafike ku pajisjet e ekranit nuk mund të japin grafikun ose si një ndihmë për aksesueshmërinë.

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit që vendosin në treg ngrohës uji dhe/ose i vënë ata në shërbim, duke përfshirë ata që janë të integruar në paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore, sigurojnë që:

a) Për çdo ngrohës uji ofrohet një etiketë e printuar që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1.1 të Shtojcës II dhe që përputhet me klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të përcaktuara në pikën 1 të Shtojcës I, ku: për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, etiketa e printuar jepet në paketimin e prodhuesit të nxehtësisë; për ngrohësit e ujit të destinuar për përdorim në paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore, për çdo ngrohës uji jepet një etiketë e dytë që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës II;

c) Për çdo ngrohës uji jepet një skedë informative e produktit, siç përcaktohet në pikën 1 të Shtojcës III, ku: për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, skeda informative e produktit jepet për prodhuesin e nxehtësisë; për ngrohësit e ujit të destinuar për përdorim në paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore, jepet një skedë informative e dytë, siç përcaktohet në pikën 4 të Shtojcës III;

d) Strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjes së tregut u jepet me kërkesë dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 1 të Shtojcës IV;

e) Çdo reklamë që lidhet me një model specifik të ngrohësit të ujit dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model;

f) Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik ngrohës uji dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model.

g) një etiketë elektronike në formatin dhe që përmban informacionin e përcaktuar në pikën 1.1 të shtojcës II, vihet në dispozicion tregtarëve për çdo model ngrohës uji, në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë për ngrohjen e ujit të përcaktuara në pikën 1 të shtojcës I;

h) Një dokument elektronik produkti siç përcaktohet në pikën 1 të shtojcës III u vihet në dispozicion tregtarëve për çdo model ngrohës uji, ku për modelet e ngrohësve të ujit të

pompës së nxehtësisë, skeda informative e produktit u vihet në dispozicion tregtarëve të paktën për gjeneruesin e nxehtësisë.

Për çdo ngrohës uji, sigurohet një etiketë elektronike që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 1.2 të Shtojcës II për çdo ngrohës uji sipas klasave të efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të përcaktuara në pikën 1 të Shtojcës I, ku: etiketa elektronike për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie duhet të jepet në paketimin e prodhuesit të nxehtësisë.

2. Furnizuesit që vendosin në treg depozitat e ujit të ngrohtë dhe/ose i vënë në shërbim, sigurojnë që:

a) Për çdo depozitë të ujit të ngrohtë sigurohet një etiketë e printuar që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në pikën 2.1 të Shtojcës II, dhe që është në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë të përcaktuara në pikën 2 të Shtojcës I;

b) Jepet një skedë informative e produktit, siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës III;

c) Strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjes së tregut u jepet me kërkesë dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës IV;

e) Çdo reklamë që lidhet me një model të veçantë depozite të ujit të ngrohtë dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë për atë model;

g) Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik depozite të ujit të ngrohtë dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë për atë model.

h) një etiketë elektronike në formatin dhe që përmban informacionin e përcaktuar në pikën 2.1 të shtojcës II vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model rezervuari të ujit të nxehtë në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë të përcaktuara në pikën 2 të shtojcës I;

i) një skedë informative e produktit, siç përcaktohet në pikën 2 të shtojcën III, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model të rezervuarit të ujit të ngrohtë.

Për çdo depozite të ujit të ngrohtë, sigurohet një etiketë elektronike që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit, siç përcaktohet në pikën 2.2 të Shtojcës II, sipas klasave të efiçencës së energjisë të përcaktuara në pikën 2 të Shtojcës I.

3. Furnizuesit që vendosin në treg pajisjet diellore dhe/ose i vënë ato në shërbim sigurojnë që:

a) Produkti të pajiset me një skedë informative, siç përcaktohet në pikën 3 të Shtojcës III;

b) Strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut ti vihet në dispozicion dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 3 të Shtojcës IV.

c) një kartë elektronike produkti, siç përcaktohet në pikën 3 të shtojcës III, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model pajisjeje diellore.

4. Furnizuesit që vendosin në treg paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore dhe/ose i vënë ato në shërbim sigurojnë që:

a) Për çdo paketë të përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore sigurohet një etiketë elektronike që përputhet me formatin dhe përmbajtjen e informacionit të përcaktuar në

pikën 3 të Shtojcës II, dhe që është në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të përcaktuara në pikën 1 të Shtojcës I;

b) Për çdo paketë të përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore jepet një skedë informative e produktit, siç përcaktohet në pikën 4 të Shtojcës III;
c) Strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjes së tregut u jepet, me kërkesë, dokumentacioni teknik, siç përcaktohet në pikën 4 të Shtojcës IV;
d) Çdo reklamë që lidhet me një paketë specifike të modelit të përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model;
f) Çdo material teknik promovues në lidhje me një paketë specifike të modelit të përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model.
g) një etiketë elektronike në formatin dhe që përmban informacionin e përcaktuar në pikën 3 të shtojcës II vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model që përfshin një paketë ngrohës uji dhe pajisje diellore, në përputhje me klasat e efiçencës së energjisë për ngrohjen e ujit të përcaktuara në pikën 1 të shtojcës I;
h) një dokument elektronik i produktit siç përcaktohet në pikën 4 të shtojcës III vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model që përfshin një paketë ngrohës uji dhe pajisje diellore.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

1. Tregtarët e ngrohësve të ujit sigurojnë që:

a) Çdo ngrohës uji, në pikën e shitjes, mban etiketën e dhënë nga furnizuesit në përputhje me Kreun 3(1), siç përcaktohet në pikën 1 të Shtojcës II, në anën e jashtme të pjesës së përparme të pajisjes, në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme në mënyrë të qartë;
c) Kur përdoruesi fundor nuk mund të presë të shohë ngrohësin e ujit të shfaqur, ngrohësit e ujit të ofruar për shitje, me qira ose për qira-blerje shiten me informacionin e dhënë nga furnizuesit në përputhje me pikën 1 të Shtojcës III me përjashtim të rasteve kur bëhet oferta përmes internetit, do të zbatohen dispozitat në Shtojcës IX;
e) Çdo reklamë që lidhet me një model specifik të ngrohësit të ujit dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model;
f) Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik ngrohës uji dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknik përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit në kushtet mesatare klimatike për atë model.

2. Tregtarët e depozitave të ujit të ngrohtë sigurojnë që:

a) Çdo depozitë e ujit të ngrohtë, në pikën e shitjes, mban etiketën e dhënë nga furnizuesit në përputhje me Kreun III, pika 2, siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës II, në pjesën e jashtme të pjesës së përparme të pajisjes, në një mënyrë të qartë dhe dukshme;
c) Kur përdoruesi fundor nuk mund të presë të shohë të shfaqur depozitën e ujit të ngrohtë, atëherë depozitat e ujit të ngrohtë të ofruara për shitje, me qira ose për qira-blerje shiten me informacionin e dhënë nga furnizuesit në përputhje me pikën 2 të Shtojcës III, me përjashtim të rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, rast në të cilin do të zbatohen dispozitat në Shtojcën IX;
d) Çdo reklamë që lidhet me një model të veçantë depozite të ujit të ngrohtë dhe që përmban informacione të lidhura me energjinë ose çmimin, përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë për atë model;
f) Çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik depozite të ujit të ngrohtë dhe që përshkruan parametrat e tij specifik teknikë përfshin një referencë të klasës së efiçencës së energjisë për atë model.

V. MATJET DHE METODAT E LLOGARITJES

Informacioni që jepet në përputhje me krerët III dhe IV merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes, siç përcaktohet në Shtojcën VI dhe Shtojcën VII.

VI. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I
KLASAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË

1. KLASAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË PËR NGROHËSIT E UJIT

Klasa e efiçencës së energjisë për ngrohjen së ujit të një ngrohësi uji përcaktohet në bazë të efiçencës së tij të energjisë së ngrohjes së ujit siç përcaktohet në Tabelën 1.
Për ngrohësit diellorë të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie në kushte mesatare klimatike, efiçenca energjetike e ngrohjes së ujit të një ngrohës uji llogaritet në përputhje me pikën 3 të Shtojcës VII.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësve të ujit, të kategorizuara sipas profileve të ngarkesës së deklaruar, η_{wh} *në %*

	3XS	XXS	XS	S	M	L	XL	XXL
A +++	$\eta_{wh} \geq 62$	$\eta_{wh} \geq 62$	$\eta_{wh} \geq 69$	$\eta_{wh} \geq 90$	$\eta_{wh} \geq 163$	$\eta_{wh} \geq 188$	$\eta_{wh} \geq 200$	$\eta_{wh} \geq 213$
A ++	$53 \leq \eta_{wh} < 62$	$53 \leq \eta_{wh} < 62$	$61 \leq \eta_{wh} < 69$	$72 \leq \eta_{wh} < 90$	$130 \leq \eta_{wh} < 163$	$150 \leq \eta_{wh} < 188$	$160 \leq \eta_{wh} < 200$	$170 \leq \eta_{wh} < 213$
A +	$44 \leq \eta_{wh} < 53$	$44 \leq \eta_{wh} < 53$	$53 \leq \eta_{wh} < 61$	$55 \leq \eta_{wh} < 72$	$100 \leq \eta_{wh} < 130$	$115 \leq \eta_{wh} < 150$	$123 \leq \eta_{wh} < 160$	$131 \leq \eta_{wh} < 170$
A	$35 \leq \eta_{wh} < 44$	$35 \leq \eta_{wh} < 44$	$38 \leq \eta_{wh} < 53$	$38 \leq \eta_{wh} < 55$	$65 \leq \eta_{wh} < 100$	$75 \leq \eta_{wh} < 115$	$80 \leq \eta_{wh} < 123$	$85 \leq \eta_{wh} < 131$
B	$32 \leq \eta_{wh} < 35$	$32 \leq \eta_{wh} < 35$	$35 \leq \eta_{wh} < 38$	$35 \leq \eta_{wh} < 38$	$39 \leq \eta_{wh} < 65$	$50 \leq \eta_{wh} < 75$	$55 \leq \eta_{wh} < 80$	$60 \leq \eta_{wh} < 85$
C	$29 \leq \eta_{wh} < 32$	$29 \leq \eta_{wh} < 32$	$32 \leq \eta_{wh} < 35$	$32 \leq \eta_{wh} < 35$	$36 \leq \eta_{wh} < 39$	$37 \leq \eta_{wh} < 50$	$38 \leq \eta_{wh} < 55$	$40 \leq \eta_{wh} < 60$
D	$26 \leq \eta_{wh} < 29$	$26 \leq \eta_{wh} < 29$	$29 \leq \eta_{wh} < 32$	$29 \leq \eta_{wh} < 32$	$33 \leq \eta_{wh} < 36$	$34 \leq \eta_{wh} < 37$	$35 \leq \eta_{wh} < 38$	$36 \leq \eta_{wh} < 40$
E	$22 \leq \eta_{wh} < 26$	$23 \leq \eta_{wh} < 26$	$26 \leq \eta_{wh} < 29$	$26 \leq \eta_{wh} < 29$	$30 \leq \eta_{wh} < 33$	$30 \leq \eta_{wh} < 34$	$30 \leq \eta_{wh} < 35$	$32 \leq \eta_{wh} < 36$
F	$19 \leq \eta_{wh} < 22$	$20 \leq \eta_{wh} < 23$	$23 \leq \eta_{wh} < 26$	$23 \leq \eta_{wh} < 26$	$27 \leq \eta_{wh} < 30$	$27 \leq \eta_{wh} < 30$	$27 \leq \eta_{wh} < 30$	$28 \leq \eta_{wh} < 32$

G	$\eta_{wh} < 19$	$\eta_{wh} < 20$	$\eta_{wh} < 23$	$\eta_{wh} < 23$	$\eta_{wh} < 27$	$\eta_{wh} < 27$	$\eta_{wh} < 27$	$\eta_{wh} < 28$

2. KLASAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË SË DEPOZITAVE TË UJIT TË NGROHTË

Klasa e efiçencës së energjisë së një depozite të ujit të ngrohtë përcaktohet në bazë të humbjes së qëndrueshme të energjisë, siç përcaktohet në Tabelën 2.

Tabela 2

Klasat e efiçencës së energjisë së depozitave të ujit të ngrohtë

Klasa e efiçencës së energjisë	Humbje termike S në Watt, me vëllim ruajtjeje V të shprehur në litra
A+	$S < 5,5 + 3,16 \cdot V^{0,4}$
A	$5,5 + 3,16 \cdot V^{0,4} \leq S < 8,5 + 4,25 \cdot V^{0,4}$
B	$8,5 + 4,25 \cdot V^{0,4} \leq S < 12 + 5,93 \cdot V^{0,4}$
C	$12 + 5,93 \cdot V^{0,4} \leq S < 16,66 + 8,33 \cdot V^{0,4}$
D	$16,66 + 8,33 \cdot V^{0,4} \leq S < 21 + 10,33 \cdot V^{0,4}$
E	$21 + 10,33 \cdot V^{0,4} \leq S < 26 + 13,66 \cdot V^{0,4}$
F	$26 + 13,66 \cdot V^{0,4} \leq S < 31 + 16,66 \cdot V^{0,4}$
G	$S > 31 + 16,66 \cdot V^{0,4}$

SHTOJCA II
Etiketat

1. Ngrohës uji

1.1. Etiketa 1

1.1.1. ***Ngrohësit e zakonshëm të ujit në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A-ja deri tek G-ja***



I, II
III
IV
VI, V
VII

(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

III. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

IV. Funksioni i ngrohjes së ujit, duke përfshirë profilin e ngarkesës së deklaruar të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI;

V. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së

ngrohjes së ujit të ngrohësit të ujit vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

VII. Konsumi vjetor i energjisë elektrike në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëset në GJ në terma *GCV*, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VII;

IX. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në mjedise të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

X. Për ngrohësit e zakonshëm të ujit që janë në gjendje të punojnë vetëm gjatë orëve ja pikut, mund të shtohet piktogrami i përmendur në pikën 4 pika d/10 të kësaj shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e zakonshëm të ujit duhet të jenë në përputhje me pikën 4 të kësaj shtojce.

1.1.2. ***Ngrohësit diellorë të ujit në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A-ja deri tek G-ja***



I, II

III

IV

VII, V

VI

(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Funksioni i ngrohjes së ujit, duke përfshirë profilin e ngarkesës së deklaruar të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI;

IV. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësit të ujit vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

V. Konsumi vjetor i energjisë elektrike në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëse në GJ në terma të *GCV*-së, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VII;

VI. Harta diellore evropiane që shfaq tre zona treguese globale të rrezatimit diellor;

VII. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në mjedise të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit diellorë të ujit janë në përputhje me pikën 5 të kësaj shtojce.

1.1.3. ***Ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A-ja deri tek G-ja***



I, II

III

IV

VII, V

VIII, VI

a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Funksioni i ngrohjes së ujit, duke përfshirë profilin e ngarkesës së deklaruar të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI;

IV. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësit të ujit vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

V. Konsumi vjetor i energjisë elektrike në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëse në GJ në terma të *GCV*-së, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VII;

VI. Harta e temperaturës evropiane që shfaq tre zona treguese të temperaturës;

VII. Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në mjedise të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VIII. Për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie që janë në gjendje të punojnë vetëm gjatë orëve jashtë pikut, mund të shtohet piktogrami i përmendur në pikën 6(d)(11) të kësaj shtojce.

a) Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie janë në përputhje me pikën 6 të kësaj shtojce. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

1.2. Etiketa 2

1.2.1. ***Ngrohësit e zakonshëm të ujit në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A+ deri tek F-ja***



I, II

III

IV

VI, V

VII

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.1(a) të kësaj shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e zakonshëm të ujit janë në përputhje me pikën 4 të kësaj shtojce.

1.2.2. ***Ngrohësit diellorë të ujit në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A + deri tek F-ja***



I, II

III

IV

VII, V

VI

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.2(a) të kësaj shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit diellorë të ujit janë në përputhje me pikën 5 të kësaj shtojce.

1.2.3. ***Ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A+ deri tek F-ja***



I, II

III

IV

VII, V

VIII, VI

(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 1.1.3(a) të kësaj shtojce.

b)Aspektet e projektimit të etiketës për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie janë në përputhjpikën (6 të kësaj shtojce.

2. DEPOZITAT E UJIT TË NGROHTË

2.1. Etiketa 1 për depozitat e ujit të ngrohtë në klasat e efiçencës së energjisë nga A-ja deri tek G-ja



I, II

III

IV

V

VI

)

(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

III. Funksioni i ruajtjes së ujit;

IV. Klasa e efiçencës së energjisë, e përcaktuar në përputhje me pikën 2 të Shtojcës I; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së depos së ujit të ngrohtë vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

V. Konsumi e energjisë për ruajtjen e temperuarës së ujit në W, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VI. Vëllimi i depozitës së ujit të ngrohtë në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për depozitat e ujit të ngrohtë janë në përputhje me pikën 7 të kësaj shtojce.

2.2. Etiketa 2 për depozitat e ujit të ngrohtë në klasat e efiçencës së energjisë nga A+ deri tek F-ja



(a) Në etiketë përfshihet informacioni i renditur në pikën 2.1(a) të kësaj shtojce.

(b)Aspektet e projektimit të etiketës për depozitat e ujit të ngrohtë janë në përputhje me pikën 7 të kësaj shtojce.

3. PAKETAT E PËRBËRA NGA NGROHËS UJI DHE PAJISJE DIELLORE

Etiketa për paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A^{+++} deri tek G-ja



(a)Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Emrin ose marka tregtare e shitësit dhe/ose furnizuesit;

II. Identifikuesi i modelit(ve) të shitësit dhe/ose të furnitorit;

III. Funksioni i ngrohjes së ujit, duke përfshirë profilin e ngarkesës së deklaruar të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI;

IV. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit e ngrohësit të ujit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I;

V. Treguesi nëse një kolektor diellor dhe një depozitë e ujit të ngrohtë mund të përfshihen, apo jo, në paketën e përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore;

VI. Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit e paketës së përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore, e përcaktuar në përputhje me pikën 4 të Shtojcës III; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të paketës së përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore të vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e klasës përkatëse të efiçencës energjetike.

(b) Aspektet e projektimit të etiketës për paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore janë në përputhje me pikën 8 të kësaj shtojce. Klasat e fundit nga E-ja deri tek G-ja në shkallën A^{+++} deri tek G-ja mund të hiqen për paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore në klasat e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit nga A^{+++} deri tek D-ja.

4. Projektimi i etiketës për ngrohësit e zakonshëm të ujit është si më poshtë:



Ku:

(a)Etiketa duhet të jetë, së paku, 105 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është në ngjyrë të bardhë.

(c)Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian,ngjyrë e purpurt,ngjyrë e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % në ngjyrë të purpurt, 100 % e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.

(d)Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶**Shtrirja e kufirit të etiketës BE:** 4 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸**Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 86 mm, lartësia: 17 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 86 mm.

❺**Funksioni i ngrohjes së ujit:**

-**Piktogrami** siç përshkruhet, duke përfshirë profilin e deklaruar të ngarkesës të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI: shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, 100% në ngjyrë të zezë.

❻**AG ose A^{+}-F:**

- **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm
- **Ngjyrat:**
- Klasa më e lartë: X-00-X-00,
- Klasa e dytë: 70-00-X-00,
- Klasa e tretë: 30-00-X-00,
- Klasa e katërt: 00-00-X-00,
- Klasa e pestë: 00-30-X-00,
- Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
- Klasa e fundit: 00-XX-00,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❼**Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit:**

-**Shigjeta:** gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 24 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❽**Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,

-**Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,

-**Vlera "YZ":** në formatin Calibri bold 15 pt, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti "dB":** në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❾**Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit ose GJ/vit:**

-**Kufiri:** 2 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,

-**Vlera "WXYZ" ose "YZ":** në formatin Calibri bold, të paktën, 20 pt, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti "kWh/vjetor" ose "GJ/vjetor":** Calibri regular, të paktën, 15 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

⑩ **Nëse është e aplikueshme, përshtatja jashtë pikut:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Korniza:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

⑪ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Rregullores:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

⑫ **Emri i furnizuesit ose marka tregtare.**

⑬**Identifikuesi i modelit të furnizuesit:**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 86 × 12 mm.

5. Projektimi i etiketës për ngrohësit diellorë të ujit është si më poshtë:



Ku:

(a)Etiketa është, së paku, 105 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është në ngjyrë të bardhë.

(c)Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, ngjyrë e purpurt, ngjyrë e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % ngjyrë e purpurt, 100 % ngjyrë e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.

(d)Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶**Shtrirja e kufirit të etiketës BE:** 4 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸**Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 86 mm, lartësia: 17 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 86 mm.

❺**Funksioni i ngrohjes së ujit:**

-**Piktogrami** siç përshkruhet, duke përfshirë profilin e deklaruar të ngarkesës të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI: shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, 100% në ngjyrë të zezë.

❻**AG ose A^{+}-F:**

- **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim .

❼**Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit:**

-**Shigjeta:** gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 24 pt, shkronja kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❽**Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,
- **Vlera "YZ":** shkronjat në formatin Calibri bold 15 pt, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti "dB":** Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❾**Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit ose GJ/vit:**

42. **"Ngrohës anti-kondensim"** është ngrohësi që parandalon kondensimin në pajisjen frigoriferike;

43. **"Ngrohës kundër kondensimit i kontrolluar nga ambienti"** është një ngrohës kundër kondensimit ku kapaciteti i ngrohjes varet ose nga temperatura e ambientit ose nga lagështia e mjedisit, ose nga të dyja;
44. **"Energjia ndihmëse"** (Eaux) është energjia e përdorur nga një ngrohës kundër kondensimit i kontrolluar nga ambienti, e shprehur në kilovat orë në vit (kWh/a);
45. **"Shpërndarëse"** është një pajisje që shpërndan material të ftohtë ose të ngrirë sipas kërkesës nga një pajisje frigoriferike, siç është shpërndarësi i kubave të akullit ose shpërndarës i ujit të ftohtë;
46. **"Ndarja me temperatura të ndryshueshme"** është ndarja e destinuar për t"u përdorur si dy (ose më shumë) lloje ndarjesh alternative (për shembull, një ndarje që mund të jetë ose për ushqime të freskëta ose për ngrirje) dhe që mund të rregullohet nga përdoruesi për të ruajtur vazhdimisht nivelin e temperaturës së funksionimit që përdoret për çdo lloj ndarje të deklaruar. Ndarja e destinuar për t"u përdorur si një lloj ndarje e vetme që mund të plotësojë edhe kushtet e ruajtjes së llojeve të tjera të ndarjeve (për shembull ndarja për ftohje që mund të plotësojë edhe kërkesat me 0-yll) nuk është ndarje me temperaturë të ndryshueshme;
47. **"Rrjeti"** është një infrastrukturë e komunikimit me një topologji lidhjesh, një arkitekturë, duke përfshirë komponentët fizikë, parimet organizative, procedurat dhe formatet e komunikimit (protokollet);
48. **"Ndarja me 2-yje"** është një pjesë e ndarjes me 3 ose 4 yje, e cila nuk ka derën ose kapakun e vet të veçantë të hyrjes, dhe që temperaturën të synuar dhe kushtet e ruajtjes prej -12 °C;
49. **"Klasë klimatike"** është gama e temperaturave të ambientit, ashtu siç përcaktohet në pikën 1(j) të Shtojcës III, në të cilat synohet të përdoren pajisjet frigoriferike, dhe për të cilat plotësohen njëkohësisht kushtet e kërkuara të magazinimit në të gjitha ndarjet siç përcaktohet në Tabelën 3 të Shtojcës III;
50. **"Periudhë e shkrirjes dhe rikuperimit"** është periudha nga fillimi i një cikli kontrolli të shkrirjes deri në rivendosjen e kushteve të qëndrueshme të funksionimit;
51. **"Vetë-shkrirja"** është një veçori me anë të së cilës ndarjet shkrihen pa ndërhyrjen e përdoruesit për të filluar heqjen e akumulimit të akullit në të gjitha cilësimet e kontrollit të temperaturës, ose për të rivendosur funksionimin normal. Largimin i ujit nga shkrirja bëhet në mënyrë automatike;
52. **"Lloji i shkrirjes"** është metoda për të hequr akumulimin e akullit mbi avulluesin apo avulluesit e një pajisjeje frigoriferike. Kjo quhet shkrirje automatike ose shkrirje manuale;
53. **"Shkrirja manuale"** është mospasja e funksionit të shkrirjes automatike;
54. **"Pajisje frigoriferike me zhurmë të ulët"** është një pajisje frigoriferike pa komprimin të avullit dhe me një çlirim zhurme akustike në ajër më të ulët se 27 decibel, e matur me A, që i referohet 1 pico vat (dB(A) për 1 pW);
55. **"Konsumi i energjisë në gjendje të qëndrueshme"** (Pss) është konsumi mesatar i energjisë në kushte të qëndrueshme, shprehur në vat (W);
56. **"Konsumi shtesë i energjisë së shkrirjes dhe rikuperimit"** (ΔEdf) është konsumi mesatar shtesë i energjisë për një operacion shkrirjeje dhe rikuperimi, i shprehur në vat orë (W orë);

57. **"Intervali i shkrirjes"** (tdf) është intervali mesatar përfaqësues, i shprehur në orë (h), midis një momenti aktivizimi të ngrohësit të shkrirjes, dhe momentit tjetër në dy cikle të njëpasnjëshme të shkrirjeje dhe rikuperimit. Ose, nëse nuk ka ngrohës të shkrirjes, një moment i çaktivizimit të kompresorit dhe tjetrit në dy cikle të njëpasnjëshme të shkrirjes dhe rikuperimit;
58. **"Faktori i ngarkesës"** (L) është një faktor që merr parasysh ngarkesën shtesë frigoriferike (përtej asaj që prietet tashmë përmes temperaturës mesatare më të lartë të ambientit për testim, ngarkesa e ftohjes nga futja e produkteve ushqimore të ngrohta, sipas vlerave të përcaktuara në pikën 3(a) të Shtojcës III;
59. **"Konsum standard vjetor i energjisë"** (SAE) është konsumi vjetor referues i energjisë së një pajisjeje frigoriferike, i shprehur në kilovat orë në vit (kWh/a), i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës III;
60. **"Parametër i kombinuar"** (C) është një parametër modelimi që merr parasysh efektin e sinergjisë kur kombinohen lloje të ndryshme ndarjesh në një pajisje, sipas vlerave të përcaktuara në Tabelën 4 të Shtojcës III;
61. **"Faktori i humbjes së nxehtësisë së dyerve"** (D) është një faktor kompensimi për pajisjet e kombinuara sipas numrit të ndarjeve të ndryshme të temperaturës ose numrit të dyerve të jashtme, cilado qoftë më e ulët dhe siç përcaktohet në Tabelën 5 të Shtojcës III. Për këtë faktor, "ndarja" nuk i referohet nënndarjes;
62. **"Pajisje e kombinuar"** është një pajisje frigoriferike që ka më shumë se një lloj ndarjesh nga të cilat të paktën një ndarje është e pa ngrirë;
63. **"faktori i shkrirjes"** (Ac) është një faktor kompensimi që merr parasysh nëse pajisja frigoriferike ka shkrirje automatike ose shkrirje manuale, apo jo, sipas vlerave të përcaktuara në Tabelën 5 të Shtojcës III;
64. **"faktor i integruar"** (Bc) është një faktor kompensimi që merr parasysh nëse pajisja frigoriferike është e integruar ose e lirë, apo jo, sipas vlerave të përcaktuara në Tabelën 5 të Shtojcës III;
65. **"Pajisje e pavarur"** është një pajisje frigoriferike që nuk është një pajisje e integruar;
66. **"Mc "** dhe **"Nc "** janë parametrat e modelimit që marrin parasysh varësinë e vëllimit të përdorimit të energjisë, sipas vlerave të përcaktuara në Tabelën 4 të Shtojcës III
67. **"Parametër termodinamik"** (rc) është një parametër modelimi që korrigjon konsumin standard vjetor të energjisë në një temperaturë ambienti prej 24 °C, sipas vlerave të përcaktuara në Tabelën 4 të Shtojcës III;
68. **"Dimensionet e përgjithshme"** është hapësira e zënë nga pajisja frigoriferike (lartësia, gjerësia dhe thellësia) me dyer ose kapakë të mbyllur, të shprehur në milimetra (mm);
69. **"Koha e rritjes së temperaturës"** është koha që kërkohet, pasi të jetë ndërprerë funksionimi i sistemit frigoriferik, që temperatura në një ndarje me 3 ose 4 yje të rritet nga -18 në -9 °C e shprehur në orë (h);
70. **"Cilësimi i dimrit"** është një funksion kontrolli për një pajisje të kombinuar me një kompresor dhe një termostat, i cili mund të përdoret sipas udhëzimeve të furnizuesit në

temperaturat e ambientit nën +16 °C, dhe që është i përbërë nga një pajisje ose funksion çelësi që garanton se, edhe nëse nuk do të kërkohet për ndarjen ku ndodhet termostati, kompresori të vazhdojë të punojë për të mbajtur temperaturat e duhura të ruajtjes në ndarjet e tjera,;

71. **"Ngrirje e shpejtë"** është një veçori që mund të aktivizohet nga përdoruesi fundor sipas udhëzimeve të furnizuesit, i cili ul temperaturën e ruajtjes së ndarjeve të pajisjes se ngrirjes për të realizuar një ngrirje më të shpejtë të produkteve ushqimore të pa ngrira;
72. **"Ndarje e pajisjes se ngrirjes"** ose "ndarje me 4 yje" nënkupton një ndarje të ngrirë me temperaturë të synuar dhe kushte magazinimi prej -18 °C e cila plotëson kërkesat për kapacitetin e ngrirjes;
73. **"Mekanizmi i shfaqjes"** nënkupton çdo ekran, duke përfshirë ekranin e prekshëm, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për t'i shfaqur përdoruesit përmbajtjen e internetit;
74. **"Ekran i prekshëm"** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si p.sh., ai i një kompjuteri tablet, kompjuteri me ekran me prekje ose i një telefoni inteligjent;
75. **"Ekran i mbivendosur"** nënkupton ndërfaqen vizuale ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrokullisje të mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje të një imazhi ose grupi tjetër të dhënash;
76. **"Tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një grafiku që bën të mundur që informacioni të paraqitet në formë jo grafike kur pajisjet e ekranit nuk mund të japin grafikun ose si një ndihmë për aksesueshmërinë, siç është hyrja në aplikacionet e sintezës së zërit.
77. **"Vlerat e deklaruara"** jane vlerat e ofruara nga furnizuesi për parametrat teknikë të deklaruar, të llogaritur ose të matur, në përputhje me nenin 6 të Ligjit 52/2024, dhe në përputhje me pikën 1 (d) të Kreun III dhe Shtojcën V të kësaj rregullore, për verifikimin e përputhshmërisë nga autoritetet.

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit e pajsijeve frigoriferike duhet të sigurojnë që pajisjet të kenë:

(a) Çdo pajisje frigoriferike të pajiset me një etiketë të printuar në formatin e përcaktuar në Shtojcës II;

(b) Parametrat e fletës së informacionit të produktit, të përcaktuara në Shtojcës IV, të futen në bazën e të dhënave të produktit;

(c) Skeda e informacionit të produktit vihet në dispozicion në formë të printuar nëse kërkohet në mënyrë të veçantë nga shitësi;

(d) Përmbajtja e dokumentacionit teknik, të përcaktuar në Shtojcës V, futet në bazën e të dhënave të produktit;

(e) Çdo reklamë pamore për një model të veçantë të pajisjeve frigoriferike përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë që gjenden në etiketë, në përputhje me Shtojcës VI dhe Shtojcës VII;

(f) Çdo material teknik promovues që lidhet me një model të veçantë të pajisjeve frigoriferike, duke përfshirë materialin teknik promovues në internet që përshkruan parametrat teknikë të veçantë të tij, që përfshin klasën e efiçencës së energjisë së atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë që gjenden në etiketë, në përputhje me Shtojcës VI;
(g) Për çdo model pajisjeje frigoriferike, shitësve u vihet në dispozicion një etiketë elektronike në formatin e përcaktuar në Shtojcës II, dhe që përmban informacionin e përcaktuar po aty;
(h) Për çdo model pajisjeje frigoriferike tregtarëve u vihet në dispozicion një fletë elektronike informacioni për produktin, ashtu siç përcaktohet në Shtojcës IV.
2. Klasa e efiçencës së energjisë bazohet në indeksin e efiçencës së energjisë të llogaritur në përputhje me Shtojcën I.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

Tregtarët e pajisjeve frigoriferike duhet të sigurojnë që:
(a) Çdo pajisje frigoriferike, që ndodhet në pikën e shitjes, duke përfshirë edhe panairet tregtare, mban etiketën e siguruar nga furnizuesit sipas pikës 1(a) të Kreut III e cila shfaqet për pajisjet e integruara në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme në mënyrë të qartë dhe për të gjitha pajisjet e tjera frigoriferike në mënyrë të tillë që të jenë e dukshme në mënyrë të qartë në pjesën e jashtme të pjesës së përparme ose të sipërme të pajisjes frigoriferike;
(b) Në rast të shitjes në distancë, etiketa dhe skeda informative e produktit sigurohen të jenë në përputhje me Shtojcat VI dhe VII;
(c) Çdo reklamë vizuale për një model të veçantë të pajisjes frigoriferike duke përfshirë edhe reklamën në internet, përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë që gjenden në etiketë, sipas Shtojcës VI;
(d) Çdo material teknik promovues lidhur me një model të veçantë të pajisjes frigoriferike, duke përfshirë materialin teknik promovues në internet, i cili përshkruan parametrat e tij specifikë teknikë duke përfshirë klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës të energjisë që gjenden në etiketë, sipas Shtojcës VI.

V. DETYRIMET E PLATFORMAVE PRITËSE TË INTERNETIT

Kur një ofrues i shërbimit pritës, lejon shitjen e drejtpërdrejtë të pajisjeve frigoriferike përmes faqes së tij të internetit, ofruesi i shërbimit bën të mundur shfaqjen e etiketës elektronike dhe fletës elektronike të informacionit të produktit të ofruar nga shitësi, të vendosur mbi mekanizmin e ekspozimit, në përputhje me dispozitat e Shtojcës VII, si dhe informojë tregtarin për detyrimin e tij për t"i ekspozuar ato.

VI. METODAT E MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni që jepet në përputhje me krerët III dhe IV merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën III.

VII. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I
Klasat e efiçencës së energjisë dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër

Klasa e efiçencës së energjisë së pajisjeve frigoriferike do të përcaktohet në bazë të indeksit të efiçencës të energjisë (EEI) siç përcaktohet në Tabelën 1.

Tabela 1
Klasat e efiçencës së energjisë së pajisjeve frigoriferike

Klasa e efiçencës së energjisë	Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI)
A	EEI ≤ 41
B	41 < EEI ≤ 51
C	51 < EEI ≤ 64
D	64 < EEI ≤ 80
E	80 < EEI ≤ 100
F	100 < EEI ≤ 125
G	EEI > 125’

EEI i një pajisjeje frigoriferike do të përcaktohet sipas pikës 5 të Shtojcës III.

Tabela 2
Klasat e emetimit të zhurmës akustike në ajër

Emetimi i zhurmës akustike në ajër	Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër
< 30 dB(A) për 1 pW	A
≥ 30 dB(A) re 1 pW dhe < 36 dB(A) re 1 pW	B
≥ 36 dB(A) re 1 pW dhe < 42 dB(A) re 1 pW	C
≥ 42 dB(A) për 1 pW	D

SHTOJCA II
Etiketa për pajisjet frigoriferike

1. ETIKETA PËR PAJISJET FRIGORIFERIKE, PËRVEÇ PAJISJEVE PËR RUAJTJEN E VERËS

1.1. Etiketa:



1.2. Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. Kodi QR;

II. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

III. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

IV. Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;

V. Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar sipas Shtojcës I;

VI. Konsumi vjetor i energjisë (*AE*), i shprehur në kWh në vit dhe i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VII.

-Shuma e vëllimeve të ndarjeve të ngrira, të shprehura në litra dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

- Nëse pajisja frigoriferike nuk përmban ndarje të ngrira, hiqet piktogrami dhe vlera në litra tek Shtojca VI;

VIII.

-Shuma e vëllimeve të ndarjeve të ftohjes dhe ndarjeve të pa ngrira, të shprehura në litra dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

-Nëse pajisja frigoriferike nuk përmban ndarje të pa ngrira dhe ndarje për ftohje, hiqen piktogrami dhe vlera në litra tek Shtojca VII;

IX. Emetimet e zhurmës akustike në ajër, të shprehura në dB(A) me referencë 1 pW dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt. Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër, siç përcaktohet në Tabelën 2;

X. Numri i kësaj rregulloreje.

2. Etiketa PËR PAJISJET E RUAJTJES SË VERËS

2.1. Etiketa:



2.2. Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. kodi QR;

II. Emrin e furnizuesit ose markën tregtare;

III. Identifikuesin e modelit të furnizuesit;

IV. Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;

V. Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar sipas Shtojcës II;

VI. *AE*-në, e shprehur në kWh në vit dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VII. Numrin e shisheve standarde të verës që mund të ruhen në pajisjen e ruajtjes së verës;

VIII. Emetimet e zhurmës akustike në ajër, të shprehura në dB(A) re 1 pW dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt. Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër, siç përcaktohet në Tabelën 2;

IX. Numri i kësaj rregulloreje.

3. SKICAT E ETIKETAVE

3.1. Skica e etiketës për pajisjet frigoriferike, me përjashtim të pajisjeve të ruajtjes së verës



3.2. Skica e etiketës për pajisjet e ruajtjes së verës



3.3. Ku:

(a) Etiketa është 96 mm të gjera dhe 192 mm të larta, megjithatë kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi i etiketës është 100% i bardhë.

(c) Shkronjat janë në formatin Verdana dhe Calibri.

(d) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketën janë siç tregohet në skicat e etiketës për pajisjet frigoriferike dhe për pajisjet e ruajtjes së verës.

(e) Ngjyrat janë CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, sipas shembullit në vijim: 0,70,100,0: 0% cian, 70% e purpurt, 100% e verdhë, 0% e zezë.

(f) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurave të mësipërme):

❶ Ngjyrat e logos së BE-së janë si më poshtë:

- Sfondi: 100,80,0,0;
- Yjet: 0,0,100,0;

❷ Ngjyra e logos së energjisë është: 100,80,0,0;
❸ Kodi QR është 100% në ngjyrë të zezë;
❹ Emri i furnizuesit është 100% në ngjyrë të zezë dhe me shkronjat në formatin Verdana Bold, 9 pt;
❺ Identifikuesi i modelit është 100% në ngjyrë të zezë dhe me shkronjat në formatin Verdana Regular 9 pt;
❻ Shkalla nga A-ja deri tek G-ja është si më poshtë:
- Shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë janë 100 % në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja të llojit Calibri Bold 19 pt; shkronjat përqendrohen në një bosht në distancën 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave;
- Ngjyrat e shigjetave të shkallës nga A-ja deri tek G-ja janë si më poshtë:
  - Klasa-A: 100,0,100,0;
  - Klasa-B: 70,0,100,0;
  - Klasa-C: 30,0,100,0;
  - Klasa-D: 0,0,100,0;
  - Klasa-E: 0,30,100,0;
  - Klasa-F: 0,70,100,0;
  - Klasa-G: 0,100,100,0;

❼ Ndarësit e brendshëm kanë një nuancë prej 0,5 pt dhe ngjyra është 100% e zezë;
❽ Shkronja e klasës së efiçencës së energjisë është 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja të llojit Calibri Bold 33 pt. Shigjeta e klasës së efiçencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse shkallës A deri në G pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës e cila është 100 % në ngjyrë të zezë;
❾ Vlera vjetore e konsumit të energjisë është me shkronjat në formatin Verdana Bold 28 pt; "kWh/vit" shkruhet me shkronjat në formatin Verdana Regular 18 pt. Vlera dhe njësia janë në qendër dhe 100% në ngjyrë të zezë;
❿ Piktogramet janë siç tregohen në modelet e etiketave dhe si më poshtë:
- Vijat e piktogrameve kanë një nuancë prej 1,2 pt ndërkohë që ato dhe tekstet (numrat dhe njësitë) janë 100 % në ngjyrë të zezë;
- Teksti nën piktogram(et) është me shkronja të zeza të llojit Verdana 16 pt ku njësia është me shkronja të llojit Verdana Regular 12 pt, dhe është e përqendruar nën piktogram;
- Për pajisjet frigoriferike, përveç pajisjeve për ruajtjen e verës : nëse pajisja përmban vetëm ndarje të ngrira ose vetëm ndarje të pa ngrira, duhet të tregohet vetëm piktogrami përkatës në rreshtin e sipërm, siç përcaktohet në pikat 1.2 VI dhe VII dhe në qendër midis dy kufijve vertikal të etiketës së energjisë;
- Piktogrami i emetimit të zhurmës akustike në ajër : numri i decibelëve në altoparlant është me shkronjat në formatin Verdana Bold 12 pt, ndërkohë që njësia "dB" është me shkronjat në formatin Verdana Regular 9 pt; gama e klasave të zhurmës (A deri në D) përqendrohet nën piktogram, ku shkronja e klasës së zhurmës që përdoret është me shkronjat në formatin

Verdana Bold 16 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të zhurmës janë të llojit Verdana Regular 10 pt;

11. Numri i rregullores është 100 % në ngjyrë të zezë dhe me shkronjat në formatin Verdana Regular 6 pt.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Matjet dhe metodat e llogaritjet

Për qëllime të verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e kësaj rregulloreje, matjet dhe llogaritjet kryhen sipas standardeve të harmonizuara evropiane të miratuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, të cilat marrin parasysh teknologjinë moderne përgjithësisht të njohur, dhe janë në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

1. Kushtet e përgjithshme të testimit:

(a) Në rastin e pajisjeve frigoriferike me ngrohës kundër kondensimit që mund të ndizen dhe fiken nga përdoruesi fundor, ngrohësit kundër kondensimit duhet të ndizen dhe - nëse rregullohen - të vendosen në ngrohje maksimale dhe të përfshihen në konsumin vjetor të energjisë (AE) si konsum ditor i energjisë (E_{daily});
Kur një parametër deklarohet në përputhje me Ligjin Nr. 52/2024 dhe në përputhje me Tabelën 7 të Shtojcës V, vlera e deklaruar duhet të përdoret nga furnizuesi për llogaritjet në këtë shtojcë

(b) Në rastin e pajisjeve frigoriferike me ngrohës kundër kondensimit të kontrolluar nga ambienti, ngrohësit elektrikë kundër kondensimit të kontrolluar nga ambienti fiken ose çaktivizohen, kur është e mundur, gjatë matjes së konsumit të energjisë;

(c) Në rastin e pajisjeve frigoriferike me shpërndarës që ndizen dhe fiken nga përdoruesi fundor, shpërndarësit ndizen gjatë testit të konsumit të energjisë, por nuk vihen në punë;

(d) Për matjen e konsumit të energjisë, ndarjet e temperaturës së ndryshueshme funksionojnë në temperaturën më të ulët që vendosen nga përdoruesi fundor për të ruajtur vazhdimisht, siç përcaktohet në Tabelën 3, shkallën e temperaturës së tipit të ndarjes që ka temperaturën më të ulët;

(e) Në rastin e pajisjeve frigoriferike që lidhen me një rrjet, aktivizohet moduli i komunikimit , por nuk ka nevojë të ketë një lloj specifik komunikimi ose shkëmbimi të dhënash, ose të dyja këto, gjatë testit të konsumit të energjisë. Gjatë testit të konsumit të energjisë sigurohet që njësia të jetë e lidhur me rrjetin;

(f) Për performancën e ndarjeve të ftohjes:

(1) Në rastin e një ndarje të temperaturës së ndryshueshme e vlerësuar si ndarje për ushqime të freskëta dhe/ose për ftohje, indeksi i efiçencës të energjisë (EEI) përcaktohet për çdo kusht të temperaturës dhe zbatohet vlera më e lartë;

(2) Ndarja e ftohjes është në gjendje të kontrollojë temperaturën e saj mesatare brenda një shkalle të caktuar pa rregullime të kontrollit të saj nga ana e përdoruesit; kjo mund të verifikohet gjatë testeve të konsumit të energjisë në temperaturën e ambientit 16 °C dhe 32 °C;

(g) Për ndarjet e vëllimet të rregullueshëm, kur vëllimet e dy ndarjeve janë të rregullueshme në lidhje me njëra-tjetrën nga përdoruesi fundor, konsumi i energjisë dhe vëllimi testohen kur vëllimi i ndarjes me temperaturën më të lartë të synuar rregullohet në vëllimin e saj minimal;

(h)Kapaciteti specifik frigoriferik llogaritet si 24 herë pesha e ngarkesës së lehtë të asaj ndarjeje, e pjesëtuar me kohën e ngrirjes për të ulur temperaturën e ngarkesës së lehtë nga +25 në –18 °C, në një temperaturë ambienti prej 25 °C, e shprehur në kg/24 h dhe e rrumbullakosur në një shifër dhjetore;

(i) për ndarjet me 4 yje, koha e ngrirjes për të ulur temperaturën e ngarkesës së lehtë nga +25 në –18 °C, në një temperaturë ambienti prej 25 °C, duhet të jetë e tillë që kapaciteti i ngrirjes i rezultuar të jetë në përputhje me kërkesën e përcaktuar në Kreun II, pika 39.

(j) Për përcaktimin e klasave klimatike, akronimi për shkallën e temperaturës së ambientit, domethënë SN, N, ST ose T:

(1) Temperatura e zgjatur (SN) ka një shkallë temperature nga 10 °C deri në 32 °C;

(2) Temperatura e butë (N) ka një shkallë temperature nga 16 °C deri në 32 °C;

(3) Subtropikale (ST) ka një shkallë temperature nga 16 °C deri në 38 °C; dhe

(4)Tropikal (T) ka një shkallë temperature nga 16 °C deri në 43 °C.

(k)pesha e lehtë e ngarkesës për çdo ndarje me 4 yje duhet të jetë:

- 3,5 kg/100 l të vëllimit të ndarjes me 4 yje të vlerësuar, të rrumbullakosura deri në 0,5 kg më të afërt, dhe
- 2 kg për një ndarje me 4 yje me një vëllim për të cilin 3,5 kg/100 l çon në një vlerë më të ulët se 2 kg;
- në rastin që pajisja frigoriferike përfshin një kombinim të ndarjeve me 3 dhe 4 yje, shuma e peshave të ngarkesës së lehtë do të rritet në mënyrë që shuma e peshave të ngarkesës së lehtë për të gjitha ndarjet me 4 yje të jetë:
- 3,5 kg/100 l të vëllimit të përgjithshëm të të gjitha ndarjeve me 4 dhe 3 yje, të rrumbullakosura deri në 0,5 kg më të afërt, dhe
- 2 kg për një vëllim total të të gjitha ndarjeve me 4 dhe 3 yje, për të cilat 3,5 kg/100 l çon në një vlerë më të ulët se 2 kg.

2. Kushtet e ruajtjes dhe temperaturat e synuara për llojin e ndarjes:

Tabela 3 përcakton kushtet e ruajtjes dhe temperaturën e synuar për llojin e ndarjes.

3. Përcaktimi i *AE-së* :

(a)Për të gjitha pajisjet frigoriferike, përveç pajisjeve frigoriferike me zhurmë të ulët:

Konsumi i energjisë përcaktohet duke testuar në një temperaturë ambienti prej 16 °C dhe 32 °C. Për të përcaktuar konsumin e energjisë, temperaturat mesatare të ajrit në çdo ndarje janë të barabarta ose nën temperaturat e synuara të specifikuara në Tabelën 3 për çdo lloj ndarje të pretenduar nga furnizuesi. Vlerat mbi dhe nën temperaturat e synuara mund të përdoren për të vlerësuar konsumin e energjisë në temperaturën e synuar për çdo ndarje përkatëse me interpolim, sipas rastit.

Komponentët kryesorë të konsumit të energjisë që duhen përcaktuar janë:

- Një grup vlerash të konsumit të energjisë në gjendje të qëndrueshme (P_{ss}) në Ë dhe të rrumbullakosura në një numër dhjetor, secila në një temperaturë specifike të ambientit dhe në një grup temperaturash të ndarjes, të cilat nuk janë domosdoshmërisht temperaturat e synuara;

- Konsumi përfaqësues i shkrirjes dhe rikuperimit të energjisë (ΔE_{df}), në Wh dhe të rrumbullakosura në një shifër dhjetore, për produktet me një ose më shumë sisteme automatike të shkrirjes (secila me ciklin e vet të kontrollit të shkrirjes) të matur në një temperaturë ambienti prej 16 °C ($\Delta E_{d\text{-}f16}$) dhe 32 °C ($\Delta E_{d\text{-}f32}$);
- Intervali i shkrirjes (t_{df}), e shprehur në h dhe e rrumbullakosur në tre shifra dhjetore, për produktet me një ose më shumë sisteme shkrirjeje (secila me ciklin e vet të kontrollit të shkrirjes) të matur në një temperaturë ambienti prej 16 °C ($t_{d\text{-}f16}$) dhe 32 °C ($t_{d\text{-}f32}$). t_{df} përcaktohen për çdo sistem sipas një game të caktuar kushtesh;
- Për çdo test të kryer mblidhen P_{ss} dhe ΔE_{df} për të formuar një konsum ditor të energjisë në një temperaturë të caktuar ambienti $E_T = 0{,}001 \times 24 \times (P_{ss} + \Delta E_{df}/t_{df})$, të shprehur në kWh/24h, specifike për cilësimet e aplikuara;
- E_{aux}, i shprehur në kWh/a dhe i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore. E_{aux} është i kufizuar në ngrohësin kundër kondensimit të kontrolluar nga ambienti dhe përcaktohet nga konsumi i energjisë së ngrohësit në një numër kushtesh të temperaturës dhe lagështisë së ambientit, shumëzuar me probabilitetin që kjo temperaturës dhe gjendje lagështisë së ambientit të ndodhë dhe të mblidhet; ky rezultat shumëzohet më pas me një faktor humbje për të llogaritur rrjedhjen e nxehtësisë në ndarje dhe heqjen e saj të mëvonshme nga sistemi i ftohjes.

Tabela 3

Kushtet e ruajtjes dhe temperatura e synuar për llojin e ndarjes

Grupi	**Lloji i ndarjes**	**Shënim**	**Kushtet e ruajtjes**		T_c
			Tmin	***Tmax***	
Emri	***Emri***	***nr.***	*°C*	*°C*	*°C*
Ndarjet e pa ngrira	Qilar	(1)	+14	+20	+17
	Magazinë vere	(2) (6)	+5	+20	+12
	Bodrum	(1)	+2	+14	+12
	Ushqim i freskët	(1)	0	+8	+4
Ndarja e ftohjes	Ftohja	(3)	-3	+3	+2
Ndarje të ngrira	0-yje dhe krijimi i akullit	(4)	*na*	0	0
	1-yll	(4)	*na*	-6	-6

	2-yje	([4])([5])	*na*	-12	-12
	3-yje	([4])([5])	*na*	-18	-18
	ngrirësi (4 yje)	([4])([5])	*na*	-18	-18
n.a.=nuk zbatohet					

Secili prej këtyre parametrave përcaktohet nëpërmjet një testi të veçantë ose grup testesh. Të dhënat e matjes mesatarizohen gjatë një periudhe prove, të cilat merret pasi pajisja të ketë qenë në punë për një kohë të caktuar. Për të përmirësuar efiçencën dhe saktësinë e testimit, nuk fiksohet kohëzgjatja e periudhës së testimit; ajo duhet të jetë e tillë që pajisja të jetë në gjendje të qëndrueshme gjatë kësaj periudhe testimi. Kjo vërtetohet duke ekzaminuar të gjitha të dhënat brenda kësaj periudhe testimi kundrejt një sërë kriteresh stabiliteti dhe nëse mund të mblidhen të dhëna të mjaftueshme në këtë gjendje të qëndrueshme.

AE, e shprehur në kWh/a dhe e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore llogaritet si më poshtë:

$AE = 365 \times E_{daily}/L + E_{aux}$

me

- Faktorin e ngarkesës L = 0,9 për pajisjet frigoriferike vetëm me ndarje të ngrira dhe L = 1,0 për të gjitha pajisjet e tjera; dhe
- Me $E_{daily,}$ e shprehur në kWh/24h dhe e rrumbullakosur në tre shifra dhjetore të llogaritura nga E_T në një temperaturë ambienti prej 16 °C (E_{16}) dhe në një temperaturë ambienti prej 32 °C (E_{32}) si më poshtë:

$E_{daily} = 0{,}5 \times (E_{16} + E_{32})$

ku E_{16} dhe E_{32} përftohen nga interpolimi i testit të energjisë në temperaturat e synuara të përcaktuara në Tabelën 3.

(b) Për pajisjet frigoriferike me zhurmë të ulët:

Konsumi i energjisë përcaktohet siç parashikohet në pikën 3(a), por në një temperaturë ambienti prej 25 °C në vend të temperaturës 16 °C dhe 32 °C.

E_{daily} , e shprehur në kWh/24h dhe e rrumbullakosur në tre shifra dhjetore për llogaritjen e *AE*-së është si më poshtë:

$E_{daily} = E_{25}$

ku E_{25} është E_T në një temperaturë ambienti prej 25 °C dhe e nxjerrë nga interpolimi i testeve të energjisë në temperaturat e synuara të renditura në tabelën 3.

4. Përcaktimi i konsumit standard vjetor të energjisë (*SAE*):

(a) Për të gjitha pajisjet frigoriferike:

SAE, e shprehur në kWh/a dhe e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore, llogaritet si më poshtë:

$$SAE = C \times D \times \sum_{c=1}^{n} A_c \times B_c \times [V_c/V] \times (N_c + V \times r_c \times M_c)$$

ku

-c është numri i indeksit për një lloj ndarjeje që varion nga 1 në n, ku n është numri total i llojeve të ndarjeve;

-V_c, i shprehur në dm ^{3} ose litra dhe i rrumbullakosur në numrin e parë dhjetor është vëllimi i ndarjes;

-V, i shprehur në dm ^{3} ose litra dhe i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt është vëllimi ku:

$V \leq \sum_{c=1}^{n} V_c$

- r_c, N_c, M_c dhe C janë parametra të modelimit specifik për çdo ndarje me vlera të përcaktuara në Tabelën 4; dhe

-A_c, B_c dhe D janë faktorët e kompensimit me vlerat e përcaktuara në Tabelën 5.

Gjatë kryerjes së llogaritjeve të mësipërme, për ndarjet e temperaturës së ndryshueshme, zgjidhet lloji i ndarjes me temperaturën më të ulët të synuar, për të cilën është deklaruar e përshtatshme.

(b) Parametrat e modelimit për llojin e ndarjes për llogaritjen e *SAE*-së:

Parametrat e modelimit janë paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4

Vlerat e parametrave të modelimit për llojin e ndarjes

Lloji i ndarjes	r_c (1)	N_c	M_c	C
Qilar	0,35	75	0,12	Ndërmjet 1,15 dhe 1,56 për pajisjet e kombinuara me ndarje me 3 ose 4 yje (2), 1,15 për pajisjet e tjera të kombinuara, 1,00 për pajisjet e tjera frigoriferike
Magazinë e verës	0,60			
Bodrum	0,60			
Ushqim i freskët	1,00			
Ftohje	1,10	138	0,12	
0-yje dhe krijimi i akullit	1,20	138	0,15	
1-yll	1,50			
2-yje	1,80			

3-yje	2,10			
Ngrirësi (4-yje)	2,10			

(c)Faktorët e kompensimit për llojin e ndarjes në llogaritjen e *SAE*-së*:*

Faktorët e kompensimit janë paraqitur në Tabelën 5.

Tabela 5

Vlerat e faktorëve të kompensimit për llojin e ndarjes

Lloji i ndarjes	$N_F c$		B_c		D			
	Shkrirja manuale	**Shkrirja automatike**	**Pajisje e pavarur**	**Pajisja e integruar**	**≤ 2 ([3])**	**3 ([3])**	**4 ([3])**	**> 4 ([3])**
Qilar		1,00	1,00	1,02	1,00	1,02	1035	1,05
Magazinë e verës								
Bodrum								
Ushqim i freskët								
Ftohje				1,03				
0-yje dhe krijimi i akullit	1,00	1,10		1,05				
1-yll								
2-yje								
3-yje								
Ngrirësi (4-yje)								

5. Përcaktimi i EEI-së:

EEI-ja, e shprehur në % dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore, e llogaritur si:

EEI = *AE/SAE*.

---

(1) T_{min} dhe T_{max} janë vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së provës (mesatare ndaj kohës dhe ndaj një grupi sensorësh).

(2) Ndryshimi mesatar i temperaturës gjatë periudhës së provës për çdo sensor nuk është më shumë se ± 0,5 kelvin (K). Gjatë periudhës së shkrirjes dhe rikuperimit, mesatarja e të gjithë sensorëve nuk lejohet të rritet më shumë se 1,5 K mbi vlerën mesatare të ndarjes.

(3) T_{min} dhe T_{max} janë vlera të menjëhershme gjatë periudhës së testimit.

(4) T_{max} është vlera maksimale e matur gjatë periudhës së provës (maksimumi ndaj kohës dhe ndaj një grupi sensorësh).

(5) Nëse ndarja është e tipit të shkrirjes automatike, temperatura (e përcaktuar si maksimumi i të gjithë sensorëve) nuk lejohet të rritet më shumë se 3,0 K gjatë një periudhe shkrirjeje dhe rikuperimi.

(6) T_{min} dhe T_{max} janë vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së provës (mesatarja ndaj kohës për secilin sensor) dhe përcaktojnë intervalin maksimal të lejuar të funksionimit të temperaturës

(1) $rc = (Ta - Tc)/20$, me T_a = 24 °C dhe T_c me vlerat e përcaktuara në tabelën 3.

(2) C për pajisjet e kombinuara me ndarje me 3 ose 4 yje përcaktohet si më poshtë:

ku *frzf* është vëllimi i ndarjes me 3 ose 4 yje V_{ff} si fraksion i V me $frzf = V_{ff}/V$:

- nëse $frzf \leq 0{,}3$ atëherë $C = 1{,}3 + 0{,}87 \times frzf$;
- ose nëse $0{,}3 < frzf < 0{,}7$ atëherë $C = 1{,}87 - 1{,}0275 \times frzf$;
- Dhe $C = 1{,}15$.

(3) Numri i dyerve ose ndarjeve të jashtme, cila prej tyre të jetë më e ulëta.

SHTOJCA IV
Skeda e informacionit të produktit

Në bazë të pikës 1(b) të Kreut III, furnizuesi duhet të fusë në bazën e të dhënave të produktit informacionin e përcaktuar në Tabelën 6. Nëse pajisja frigoriferike përmban ndarje të shumta të të njëjtit lloj, rreshtat për këto ndarje përsëriten. Nëse një lloj i caktuar ndarjeje nuk është e pranishme, parametrat dhe vlerat e ndarjes janë "-".

Tabela 6
Skeda e informacionit të produktit

<table>
<tr><td colspan="5">Emri i furnizuesit ose marka tregtare:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Adresa e furnizuesit (2) :</td></tr>
<tr><td colspan="5">Identifikuesi i modelit:</td></tr>
<tr><td colspan="5">Lloji i pajisjes frigoriferike:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Pajisja me zhurmë të ulët:</td><td>[po/jo]</td><td>Lloji i projektit:</td><td>[i integruar/i pavarur]</td></tr>
<tr><td colspan="2">Pajisje për ruajtjen e verës:</td><td>[po/jo]</td><td>Pajisje të tjera frigoriferike:</td><td>[po/jo]</td></tr>
<tr><td colspan="5">Parametrat e përgjithshëm të produktit:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Parametri</td><td>Vlera</td><td>Parametri</td><td>Vlera</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Dimensionet e përgjithshme (milimetra)</td><td>Lartësia</td><td>X</td><td rowspan="3">Vëllimi total (dm³ ose l)</td><td rowspan="3">x</td></tr>
<tr><td>Gjerësia</td><td>X</td></tr>
<tr><td>Thellësia</td><td>X</td></tr>
<tr><td colspan="2">EEI</td><td>X</td><td>Klasa e efiçencës të energjisë</td><td>[A/B/C/D/E/F/G] (3)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Emetimet e zhurmës akustike në ajër (dB(A) referuar 1 pW)</td><td>X</td><td>Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër</td><td>[A/B/C/D] (3)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Konsumi vjetor i energjisë (kWh/a)</td><td>x, xx</td><td>Klasa klimatike:</td><td>[e zgjatur e butë/e butë/subtropikale/tropikale]</td></tr>
</table>

Temperatura minimale e ambientit (°C), për të cilën është e përshtatshme pajisja frigoriferike		x (3)	Temperatura maksimale e ambientit (°C), për të cilën është e përshtatshme pajisja frigoriferike		x (3)
Cilësim dimëror		[po/jo]			
Parametrat e ndarjes:					
Lloji i ndarjes		**Parametrat dhe vlerat e ndarjes**			
		Vëllimi i ndarjes (dm³ ose l)	**Cilësimi i rekomanduar i temperaturës për ruajtjen e optimizuar të ushqimit (°C) Këto cilësime nuk kundërshtojnë kushtet e ruajtjes të përcaktuara në Tabelën 3 të Shtojcës III**	**Kapaciteti i ngrirjes (kg/24 orë)**	**Lloji i shkrirjes (shkrirja automatike = A, shkrirja manuale = M)**
Qilar	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
Maganazina e verës	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
Bodrum	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
Ushqim i freskët	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
Ftohtë	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
0-yje ose prodhim akulli	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]

1-yll	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
2-yje	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
3-yje	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
4-yje	[po/jo]	x, x	x	x, xx	[A/M]
Seksioni me 2 yje	[po/jo]	x, x	x	-	[A/M]
Ndarje me temperaturë të ndryshueshme	llojet e ndarjeve	x, x	x	x, xx (për ndarje me 4 yje) ose -	[A/M]
Për ndarje me 4 yje					
Pajisje për ngrirje të shpejtë			[po/jo]		
Parametrat e burimit të dritës (1) (2):					
Lloji i burimit të dritës			[lloji]		
Klasa e efiçencës të energjisë			[A/B/C/D/E/F/G]		
Kohëzgjatja minimale e garancisë së ofruar nga prodhuesi (2):					
Informacion shtesë:					

SHTOJCA V
Dokumentacioni teknik

1. Dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(d) të Kreut III përfshin elementët e mëposhtëm:
(a) një përshkrim të përgjithshëm të modelit që lejon që ai të identifikohet pa mëdyshje dhe lehtësisht;
(b)referenca ndaj standardeve të harmonizuara të aplikuara ose standardeve të tjera të matjes të përdorura;
(c)masat paraprake specifike që duhen marrë kur modeli montohet, instalohet, mirëmbahet ose testohet;
(d)vlerat për parametrat teknikë të përcaktuar në Tabelën 7; këto vlera konsiderohen si vlera të deklaruara për qëllim të procedurës së verifikimit në Shtojcës VIII;
(e)detajet dhe rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me Shtojcës III;
f)kushtet e testimit nëse nuk përshkruhen mjaftueshëm në pikën (b);
g) modelet ekuivalente, nëse ka, përfshirë identifikuesit e modeleve.
Këta elementë do të përbëjnë gjithashtu pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi do të vendosë në bazën e të dhënave.

Tabela 7

Informacion shtesë që duhet të përfshihet në dokumentacionin teknik

Një përshkrim i përgjithshëm i modelit frigoriferik, që të mjaftojë që ai të identifikohet pa mëdyshje dhe lehtësisht :			
Specifikimet e produktit:			
Specifikimet e përgjithshme të produktit:			
Parametri	Vlera	Parametri	Vlera
Konsumi vjetor i energjisë (kWh/a)	x,xx	EEI (%)	x,x
Konsumi standard vjetor i energjisë (kWh/a)	x,xx	Parametri i kombinuar	x,xx
Koha e rritjes së temperaturës (h)	x,xx	Faktori i ngarkesës	x,x
Faktori i humbjes së nxehtësisë nga dera	x,xxx	Klasa klimatike	[temperate e zgjeruar / temperate / subtropikale / tropikale]

Lloji i ngrohësit kundër kondensimit	[ndezje-fikje manuale/ambient/tjetër/asnjë]	Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër	x
Specifikimet shtesë të produktit për pajisjet frigoriferike, me përjashtim të pajisjeve frigoriferike me zhurmë të ulët:			
Parametri	Vlera		
Konsumi ditor i energjisë në 32 °C (kWh/24 h)	x,xxx		
Specifikime shtesë të produktit për pajisjet ftohëse me zhurmë të ulët:			
Parametri	Vlera		
Konsumi ditor i energjisë në 25 °C (kWh/24 h)	x,xxx		
Specifikime shtesë të produktit për pajisjet për ruajtjen e verës:			
Parametri	Vlera	Parametri	Vlera
Lagështia e brendshme (%)	[intervali]	Numri i shisheve	X

Nëse pajisja ftohëse përmban disa ndarje të të njëjtit lloj, rreshtat për këto ndarje përsëriten. Nëse një lloj i caktuar ndarjeje nuk është i pranishëm, vlerat e parametrave të ndarjes shënohen me "–".

Specifikimet e ndarjes:								
	Parametrat dhe vlerat e ndarjes							
Lloji i ndarjes	Temperatura e synuar (°C)	Vëllimi i ndarjes (dm³ ose l)	Kapaciteti i ngrirjes (kg/24 h)	Parametri termodinamik (r_c)	N_c	M_c	Faktori i shkrirjes (A_c)	Faktori i integrimit B_c
Qilar	+17	x,x	-	0,35	75	0,12	1,00	x,xx
Maganazina e verës	+12	x,x	-	0,60	75	0,12	1,00	x,xx
Bodrum	+12	x,x	-	0,60	75	0,12	1,00	x,xx
Ushqim i freskët	+4	x,x	-	1,00	75	0,12	1,00	x,xx
Ftohje e shpejtë	+2	x,x	-	1,10	138	0,12	1,00	x,xx
0-yje ose prodhim akulli	0	x,x	-	1,20	138	1,15	x,xx	x,xx
1-yje	-6	x,x	-	1,50	138	1,15	x,xx	x,xx
2-yje	-12	x,x	-	1,80	138	1,15	x,xx	x,xx

3-yje	-18	x,x	-	2,10	138	1,15	x,xx	x,xx
4-yje	-18	x,x	x,x	2,10	138	1,15	x,xx	x,xx
Seksioni me 2 yje	-12	x,x	-	2,10	138	1,15	x,xx	x,xx
Ndarje me temperatur ë të ndryshueshme	X	x,x	x,x (për ndarje 4-yje) ose –	x,xx	x	x,xx	x,xx	x,xx
Shuma e vëllimeve të ndarjes/ndarjeve "chill" dhe të ndarjeve jo të ngrira [l ose dm³]:		x						
Shuma e vëllimeve të ndarjes/ndarjeve të ngrira [l ose dm³]:		x						

2.Kur është marrë informacioni i përfshirë në dokumentacionin teknik për një model të caktuar:

(a) Nga një model që ka të njëjtat karakteristika teknike të rëndësishme për informacionin teknik që do të jepet, por është prodhuar nga një prodhues tjetër; ose

(b) Me llogaritje në bazë të projektimit ose ekstrapolimit nga një model tjetër i të njëjtit prodhues ose një prodhuesi tjetër; ose të dyja.

Dokumentacioni teknik përfshin detajet e një llogaritjeje të tillë, vlerësimin e ndërmarrë nga prodhuesi për të verifikuar saktësinë e llogaritjes dhe, sipas rastit, deklaratën e identitetit midis modeleve të prodhuesve të ndryshëm.

(1) vetëm për produktet me një ose më shumë sisteme të shkrirjes automatike

SHTOJCA VI

Informacioni që duhet dhënë në reklamat vizuale, në materiale promovuese teknike, në shitjet në distancë, përveç shitjeve në distancë në internet

1.Në reklamat vizuale, për qëllime të garantimit të respektimit të kërkesave të përcaktuara në pikën 1(e) të Kreut III dhe pikën 1(c) të Kreut IV, klasa e efiçencës të energjisë dhe gama e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë tregohet siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj Shtojce.

2.Në materialin teknik promovues, për qëllime të garantimit të respektimit të kërkesave kërkesat e përcaktuara në pikën 1(f) të Kreut III dhe pikën 1(d) të Kreut IV, klasa e efiçencës së energjisë dhe gama e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë tregohet siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj Shtojce.

3.Çdo shitje e bazuar në letër në distancë duhet të tregojë klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj Shtojce.

4.Klasa e efiçencës të energjisë dhe gama e klasave të efiçencës së energjisë paraqiten, siç tregohet në Figurën 1, me:

(a) Një shigjetë, që përmban shkronjën e klasës së efiçencës të energjisë në ngjyrë 100% të bardhë, të llojit Calibri Bold dhe me një madhësi shkronje që është ekuivalente me atë të çmimit, kur tregohet çmimi;

(b) Ngjyrën e shigjetës që përputhet me ngjyrën e klasës së efiçencës të energjisë;

(c)Gamën e klasave të disponueshme të efiçencës së energjisë në ngjyrë 100% të zezë; dhe,

(d) Madhësia është e tillë që shigjeta të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi prej 0,5 pt me ngjyrë 100% të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe germën e klasës së efiçencës të energjisë.

Si përjashtim, nëse reklama vizuale, materiali promovues teknik ose shitja në distancë e bazuar në letër është e printuar në një ngjyrë, shigjeta mund të jetë njëngjyrëshe në atë reklamë vizuale, në atë material promovues teknik ose në atë shitje në distancë të bazuar në letër.

Figura 1

Shigjeta me ngjyra/njëngjyrëshe majtas/djathtas, me gamën e klasave të efiçencës të energjisë të treguar



5.Shitja në distancë e bazuar në telemarketing duhet të informojë në mënyrë specifike klientin për klasën e efiçencës të energjisë së produktit dhe për gamën e klasave të efiçencës të energjisë të disponueshme në etiketë, dhe se klienti mund ta aksesojë etiketën e plotë dhe fletën e informacionit të produktit përmes një faqe interneti me akses falas, ose duke kërkuar një kopje të printuar.

6.Për të gjitha situatat e përmendura në pikat 1 deri në 3 dhe 5, duhet të jetë e mundur që klienti të marrë, sipas kërkesës, një kopje të printuar të etiketës dhe fletën e informacionit të produktit.

SHTOJCA VII

Informacioni që duhet dhënë në rastin e shitjeve në distancë përmes internetit

1.Etiketa elektronike e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas pikës 1(g) të Kreut III shfaqet në mekanizmin e ekspozimit në afërsi të çmimit të produktit. Përmasa është e tillë që etiketa të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë dhe është proporcionale me madhësinë e specifikuar në pikën 3(1) dhe 3(2) të Shtojcës II për pajisjet frigoriferike. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, në të cilin rast imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 3 të kësaj shtojce. Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje në imazh.

2.Imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë në rastin e ekranit të ndërlidhur, siç tregohet në Figurën 2:

(a) Eshtë një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë së produktit në etiketë;

(b) Tregon klasën e efiçencës së energjisë së produktit në shigjetë në ngjyrë 100% të bardhë, me shkronja të llojit Calibri Bold dhe me një madhësi shkronje ekuivalente me atë të çmimit;

(c) Ka gamën e klasave të disponueshme të efiçencës së energjisë në ngjyrë 100% të zezë; dhe,

(d) Ka një nga dy formatet e mëposhtme dhe madhësia e tij është e tillë që shigjeta është e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi të dukshëm në ngjyrë të zezë 100% të vendosur rreth shigjetës dhe germës së klasës së efiçencës së energjisë:

Figura 2

Shigjeta me ngjyrë majtas/djathtas, me gamën e treguar të klasave të efiçencës së energjisë



3.Në rastin e një ekrani të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:

(a) imazhi i përmendur në pikën 2 të kësaj Shtojce shfaqet në mekanizmin e ekspozimit në afërsi të çmimit të produktit;

(b) Imazhi lidhet me etiketën e përcaktuar në Shtojcës II;

(c) Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, rrotullimit të mausit ose zmadhimit të imazhit në ekranin me prekje;

(d)Etiketa shfaqet me anë të hapjes, skedës së re, faqes së re ose ekranit të ndërlidhur të inkuadruar;

(e) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;

(f) Ndalimi i shfaqjes së etiketës bëhet me anë të opsionit të mbylljes ose mekanizmit tjetër standard të mbylljes;

(g) Teksti alternativ i grafikut, i cili paraqitet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e efiçencës së energjisë së produktit me një përmasë shkronje të barabartë me atë të çmimit.

4. Skeda elektronike e informacionit të produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas pikës 1(b) të Kreut III shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit. Përmasa është e tillë që skeda e informacionit të produktit të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Skeda e informacionit të produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur ose duke iu referuar bazës së të dhënave të produktit, rast në të cilin lidhja e përdorur për të hyrë në fletën e informacionit të produktit tregon qartë dhe në mënyrë të lexueshme "Fletën e informacionit të produktit". Nëse përdoret një ekran i ndërlidhur, skeda e informacionit të produktit shfaqet në klikimin e parë të mausit, rrotullimin e mausit ose zmadhimin e ekranit me prekje në link.

SHTOJCA VI
Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Struktura përgjegjese për mbikqyrjen e tregut duhet të përdorë procedura të besueshme të sakta dhe të ripërtërithme të matjeve që marrin parasysh metoda të pranuara bashkëkohore duke përfshirë edhe metodat e përcaktuara në dokumenta/standarde të harmonizuara, numrat e referimit të të cilave janë botuara ne Fletoren Zyrtare.

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë shtojcë lidhen vetëm me verifikimin e parametrave të deklaruar nga Strukturat përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut Tregut dhe nuk përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik. Vlerat dhe klasat në etiketë ose në fletën e informacionit të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik.

Kur modeli është projektuar në mënyrë që të jetë në gjendje të zbulojë që është duke u testuar (p.sh., duke njohur kushtet e testimit ose ciklin e testimit) dhe të reagojë në mënyrë specifike duke ndryshuar automatikisht performancën e tij gjatë testit me objektivin për të arritur një nivel më të favorshëm për secilin nga parametrat e specifikuar në këtë rregullore ose të përfshira në dokumentacionin teknik ose të përfshirë në ndonjë nga dokumentacioni i ofruar, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen si të papajtueshme.

Kur verifikohet përputhshmëria e modelit të një produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut zbatojnë procedurën e mëposhtme:

(1) Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut verifikojnë një njësi të vetme të modelit.

(2) Modeli konsiderohet se i plotëson kërkesat e zbatueshme nëse:

(a) Vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik (vlerat e deklaruara), dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit; dhe

(b) Vlerat e publikuara në etiketë dhe në fletën e informacionit të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, ndërkohë që klasa e treguar e efiçencës të energjisë dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe

(c) Kur Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut testojnë njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (që janë vlerat e parametrave përkatës të matur në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 8.

(3) Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a) dhe (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.

(4) Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut zgjedhin tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve ekuivalente.

(5) Modeli konsiderohet se plotëson kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 8.
(6) Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.
(7) Struktura përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut vendos masa administrative në përputhje me ligjin nr.52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" në rastet e konstatimit të mospërputhjes së modelit sipas pikave 3 dhe 6

Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut përdorin metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcës III.

Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut zbatojnë vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 8 dhe përdorin vetëm procedurën e përcaktuar në pikat 1 deri në 7 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë. Për parametrat e dhënë në Tabelën 8, nuk zbatohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 8

Tolerancat e verifikimit për parametrat e matur

Parametrat	**Tolerancat e verifikimit**
Vëllimi total dhe vëllimi i ndarjes	Vlera e përcaktuar (1) nuk duhet të jetë më shumë se 3 % ose 1 litër më e ulët - cilado qoftë vlera më e madhe - se vlera e deklaruar.
Kapaciteti ngrirës	Vlera e përcaktuar (1) nuk duhet të jetë më e ulët se 10 % se sa vlera e deklaruar.
E_{32}	Vlera e përcaktuar (1) nuk duhet të jetë më e lartë se 10 % se sa vlera e deklaruar.
Konsumi vjetor i energjisë	Vlera e përcaktuar (1) nuk duhet të jetë më e lartë se 10 % se sa vlera e deklaruar.
Lagështia e brendshme e pajisjeve të ruajtjes së verës (%)	Vlera e përcaktuar (1) nuk duhet të ndryshojë nga vlera e deklaruar për më shumë se 10%.
Emetimet e zhurmës akustike në ajër	Vlera e përcaktuar (1) nuk duhet të jetë më shumë se 2 dB(A) për 1 pW më shumë se vlera e deklaruar.
Koha e rritjes së temperaturës	Vlera e përcaktuar (1) nuk duhet të jetë më shumë se 15 % më e lartë se vlera e deklaruar.

(1) në rastin e tre njësive shtesë të testuara siç përcaktohet në pikën 4, vlera e përcaktuar nënkupton mesataren aritmetike të vlerave të përcaktuara për këto tre njësi shtesë.

ANEKS NR.13

RREGULLORE
"PËR
"ETIKETIMIN ENERGJETIK TË PAJISJEVE FRIGORIFERIKE ME FUNKSION TË SHITJES DIREKTE"[1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin dhe dhënien e informacionit plotësues të produktit për pajisjet frigoriferike elektrike me funksion të shitjes direkte, duke përfshirë pajisjet e shitura për ngrirjen e artikujve të ndryshëm nga produktet ushqimet.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për produktet e mëposhtme:
(a)Pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte që furnizohen nga burime të tjera të energjisë, përveç energjisë elektrike;
(b)Pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte që nuk përdorin cikël ftohje me kompresim të avullit;
(c)Komponentët në distancë, të tilla si njësia e kondensimit, kompresorët ose avulluesit, me të cilat duhet të lidhet një pajisje frigoriferike në distancë;
(ç)Pajisje frigoriferike për përpunimin e ushqimit me funksion të shitjes direkte;
(d)Pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte të testuara dhe të miratuara posaçërisht për ruajtjen e barnave ose mostrave shkencore;
(dh) Pajisje frigoriferike me funksion shitje të drejtpërdrejtë për shitjen dhe ekspozimin e produkteve ushqimore të gjalla, si pajisje frigoriferike për shitjen dhe ekspozimin e peshqve dhe gjallesave të tjera të mjedisit ujor, akuariumet frigoriferike dhe depozitat e ujit.
(e) Pajisje frigoriferike për ruajtjen e sallatave;
(ë)Pajisje frigoriferike të organizuar me sportele horizontale, për shërbime me ruajtje të integruar, të krijuar për të punuar në temperatura të funksionimit në të ftohtë;
(f)Pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte që nuk kanë sistem të integruar për prodhimin e ftohjes dhe funksionojnë duke kanalizuar ajrin e ftohur që prodhohet nga një njësi e jashtme ftohëse ajri; kjo nuk përfshin komponentet e veçuar dhe as nuk përfshin makinat shitëse frigoriferike të kategorisë 6, me funksion të shitjes, siç përcaktohet në Shtojcën III, Tabela 4;
(g) Frigorifer këndorë/të lakuar dhe rrotullues (carousel);
(h)Makina frigoriferike me funksion të shitjes që janë projektuar për të punuar në temperaturat e ngrirjes;
(i)Frigorifer banak për ekspozimin e peshkut me akull të copëtuar;

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2019/2018 e Komisionit, datë 11 mars 2019, për plotësimin e Rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin e energjisë të pajisjeve frigoriferike me funksion të shitjes direkte". Numri CELEX 02019R2018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 05.12.2019, f. 155.

(j)Frigorifer profesional magazinimi, njësitë kondensuese dhe ftohësit ne kontekstin e kerkesave për projektimin ekologjik të tyre.
(k)Pajisje për ruajtjen e verës dhe minibare.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Derë e jashtme"** është pjesa e një pajisjeje frigoriferike me funksion shitje direkte që mund të zhvendoset ose hiqet për të lejuar të paktën futjen e ngarkesës nga pjesa e jashtme në brendësi ose nxjerrjen e ngarkesës nga pjesa e brendshme në pjesën e jashtme të pajisjes frigoriferike me funksioni i shitjes direkte;
2. **"Ekran i mbivendosur"** është një ndërfaqe vizuale ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrokullisje të mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje të një imazhi ose grupi të dhënash tjetër;
3. **"Ekran i prekshëm"** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si ai i një kompjuteri tablet, kompjuterit me prekje ose një smartphone;
4. **"Frigorifer"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte që ruan vazhdimisht temperaturën e produkteve të ruajtura në kabinet në temperaturën e funksionimit të ftohtë;
5. **"Frigorifer për përpunimin e ushqimit me funksion të shitjes direkte"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte e testuar dhe miratuar posaçërisht për kryerjen e përpunimit të ushqimit, si p.sh. prodhuesit e akulloreve ose makinat shitëse frigoriferike të pajisura me mikrovalë ose prodhuesit e akullit; kjo nuk përfshin pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte të pajisura me një ndarje të projektuar posaçërisht për kryerjen e përpunimit të ushqimit e cila është e barabartë me më pak se 20% të vëllimit neto total të pajisjes;
6. **"Frigorifer minibar"** është një pajisje frigoriferike me një vëllim total maksimal prej 60 litrash, e cila është e destinuar primare për ruajtjen dhe shitjen e produkteve ushqimore në dhomat e hoteleve dhe ambiente të ngjashme.
7. **"Frigorifer për ruajtjen e sallatave**" është një pajisje frigoriferike me funksion te shitjes direkte me një ose më shumë dyer ose kapakë të sirtarëve në rrafshin vertikal që ka prerje në sipërfaqen e sipërme, në të cilat futen kosha magazinimi për ruajtjen e përkohshme dhe aksesim të lehtë të produkteve ushqimore, si p.sh. mbushje picash ose artikuj sallate;
8. **"Frigorifer banak horizontal për shërbime magazinimi të integruar"** është një pajisje frigoriferike horizontale për shërbim, i cili përfshin magazinimin në frigorifer i cili është të paktën 100 litra për metër (m) gjatësi dhe që zakonisht vendoset në bazën e frigoriferit banak të shërbimit;

9. **"Frigorifer banak horizontal"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte horizontale, i hapur në pjesën e sipërme dhe i aksesueshëm nga lart;
10. **"Frigorifer këndorë/të lakuar"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte që përdoret për të arritur vazhdimësinë gjeometrike midis dy pajisjeve frigoriferike lineare që janë në një kënd me njëri-tjetrin dhe/ose që formojnë një kurbë. Një ndarje këndore nuk ka një bosht ose gjatësi të dallueshme gjatësore pasi përbëhet vetëm nga një formë mbushëse dhe nuk është projektuar për të funksionuar si një njësi frigoriferike e pavarur. Dy skajet e ndarjes këndore janë të prirura në një kënd midis 30° dhe 90°;
11. **"Frigorifer rrotullues (carousel)"** është një frigorifer supermarketi me formë rrethore/cirkulare, i cili mund të instalohet si njësi e pavarur ose si njësi lidhëse midis dy frigoriferëve linearë të supermarketit. Frigoriferët rrotullues (carousel) mund të pajisen gjithashtu me një sistem rrotullimi, i cili mundëson shfaqjen e produkteve ushqimore në 360°.
12. **"Frigorifer supermarketi"** është një pajisje ftohëse me funksion shitjeje direkte, e destinuar për shitjen dhe ekspozimin e produkteve ushqimore dhe artikujve të tjerë në aplikime tregtare me pakicë, si p.sh. në supermarkete. Ftohësit e pijeve, makinat shitëse të ftohura, vitrinat për servirjen e akullores dhe ngrirëset për akullore nuk konsiderohen frigoriferë supermarketi.
13. **"Frigorifer banak për ekspozimin e peshkut me akull të copëtuar"** është një pajisje frigoriferike për shërbimin horizontal të asistuar, i projektuar dhe i tregtuar posaçërisht për ekspozimin e peshkut. Karakterizohet nga fakti se ka në majë të saj një shtrat akulli të copëtuar që përdoret për të ruajtur temperaturën e peshkut të freskët të shfaqur, dhe gjithashtu ka një dalje të integruar kullimi;
14. **"Frigorifer pijesh"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte e projektuar për të ftohur, me një shpejtësi të caktuar, pije të paketuara që nuk prishen, me përjashtim të verës, të cilat vendosen në temperaturën e ambientit, për shitje në temperatura të përcaktuara nën temperaturën e ambientit. Një frigorifer pijesh ju lejon të aksesoni pijet drejtpërdrejt përmes anëve të hapura ose përmes një ose më shumë dyerve, sirtarëve ose të dyjave. Temperatura brenda ftohësit mund të rritet gjatë periudhave, me qëllim të kursimit të energjisë, duke pasur parasysh natyrën e pijeve që nuk prishen;
15. **"Frigorifer ngrirës për akullore"** është një pajisje frigoriferike horizontale e mbyllur e destinuar për të ruajtur dhe/ose ekspozuar dhe shitur akulloren e paketuar paraprakisht, ku aksesi nga konsumatori në akulloren e parapaketuar arrihet duke hapur një kapak jo transparent ose transparent. nga lart, me një vëllim neto $\leq$ 600 litra (L) dhe, vetëm në rastin e frigoriferëve ngrirës të akulloreve me kapak transparent, një vëllim neto pjesëtuar me TDA $\geq$ 0,35 metra (m);
16. **"Frigorifer i integruar"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte që ka një sistem ftohjeje integrale që përfshin një kompresor dhe njësi kondensimi;

17. **"Frigorifer banak për ekspozim akullore"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte në të cilën akullorja mund të ruhet, ekspozohet dhe grumbullohet, brenda kufijve të temperaturës së përcaktuar siç përcaktohet në Shtojcën III, Tabela 4;
18. **"Frigorifer vertikal"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte me një hapje ekrani vertikal ose të pjerrët;
19. **Frigorifer gjysmë vertikal"** është një ndarje vertikal me një hapje ekrani vertikale ose të pjerrët, lartësia e përgjithshme e të cilit nuk i kalon 1,5 metra (m);
20. **"Frigorifer me funksion të kombinuar"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte, e cila kombinon drejtimet e shfaqjes dhe hapjes nga një pajisje frigoriferike vertikale dhe horizontale;
21. **"Frigorifer ngrirës"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte që ruan vazhdimisht temperaturën e produkteve të ruajtura në frigorifer në temperaturën e ngrirë të funksionimit;
22. **"Frigorifer me sistem rrotullimi"** është një pajisje frigoriferike supermarketi e cila mundëson që mallrat të shfaqen drejtpërdrejt në paletat ose rrotullat e tyre të cilat mund të vendosen brenda pajisjes nëpërmjet një mekanizmi rrëshqitës, lëkundës ose hequr pjesën e përparme të poshtme, aty ku është përshtatur;
23. **"Faktor i klasës klimatike" (CC)** është një faktor korrigjimi që llogarit ndryshimin në kushtet e ambientit për të cilat është projektuar pajisja frigoriferike;
24. **"Indeks i efiçencës së energjisë" (EEI)** është një numër treguesi për efiçencën relative të energjisë të një pajisjeje frigoriferike me funksion të shitjes direkte të shprehur në përqindje (%), i llogaritur në përputhje me pikën 2 të shtojcës IV;
25. "**Kapak transparent"** është një derë e bërë nga një material transparent që mbulon të paktën 75% të sipërfaqes së derës dhe që lejon përdoruesin përfundimtar të shohë qartë sendet përmes saj;
26. **"Kodi i përgjigjes se shpejtë" (QR)** është një barkod matricë të përfshirë në etiketën e energjisë të një modeli produkti që lidhet me informacionin e këtij modeli në pjesën publike të bazës së të dhënave të produktit;
27. "**Konsumi vjetor i energjisë" (AE)** është konsumi mesatar ditor i energjisë shumëzuar me 365 (ditë në vit) i shprehur në kilovat orë në vit (kWh/v), i llogaritur në përputhje me pikën 2/b të shtojcës III;
28. **"Konsumi ditor i energjisë" (Edaily)** është energjia e përdorur nga një pajisje frigoriferike me funksion shitje direkte gjatë 24 orëve në kushtet e referencës, e shprehur në kilovat orë në ditë (kWh/24h);
29. **"Konsum standard vjetor i energjisë" (SAE)** është konsumi vjetor i referencës së energjisë së një pajisjeje frigoriferike me funksion shitje direkte, i shprehur në kilovat orë në vit (kWh/a), i llogaritur në përputhje me pikën 2(c) të shtojcës III;
30. **"Koeficienti i temperaturës" (C)** është një faktor korrigjimi që llogarit ndryshimin në temperaturën e funksionimit;

31. **"M" dhe "N"** janë parametrat e modelimit që marrin parasysh sipërfaqen totale të shfaqjes ose varësinë nga vëllimi i përdorimit të energjisë, me vlerat e përcaktuara në tabelën 3, shtojca III;
32. **"Makina frigoriferike me funksion të shitjes"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte, e projektuar për të pranuar pagesat e konsumatorëve ose monedhat për të blerë ushqime të ftohta dhe artikuj të tjerë;
33. **"Makina frigoriferike me funksion të shitjes me shumë temperatura"** është një makinë frigoriferike me funksion shitjen e produkteve që përfshin të paktën dy ndarje me temperatura të ndryshme funksionimi;
34. **"Mekanizmi i shfaqjes"** është çdo ekran, duke përfshirë ekranin e prekshëm, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;
35. **"Ndarje"** është një hapësirë e mbyllur brenda një pajisjeje frigoriferike me funksion të shitjes direkte, e ndarë nga ndarjet e tjera nga një ndarje, kontejner ose konstruksion i ngjashëm, i cili është drejtpërdrejt i aksesueshëm përmes një ose më shumë dyerve të jashtme dhe mund të ndahet vetë në nënndarje. Për qëllimin e kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, "ndarje" i referohet si ndarjeve ashtu edhe nënndarjeve;
36. **"Nënndarje"** është një hapësirë e mbyllur në një ndarje që ka një diapazon të ndryshëm të temperaturës së funksionimit nga ndarja në të cilën ndodhet;
37. **"Njësi kondensimi"** është një produkt që integron të paktën një kompresor elektrik dhe një kondensator, të aftë për të ftohur dhe për të ruajtur vazhdimisht temperaturën e ulët ose mesatare brenda një pajisje ose sistemi frigoriferik, duke përdorur një cikël kompresimi avulli pasi të lidhet me një avullues dhe një pajisje zgjerimi.
38. **"Njësi frigoriferike e veçuar"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte e cila përbëhet nga një montim i komponentëve të prodhuar në fabrikë që për të funksionuar si një pajisje frigoriferike me funksion shitje të drejtpërdrejtë duhet të lidhet veçmas me komponentët e veçuar (njësia e kondensimit dhe/ ose kompresor dhe/ose avullues) të cilat nuk janë pjesë përbërëse e frigoriferit;
39. **"Njësi frigoriferike rrotulluese"** është një njësi supermarketi në formë rrethore/qarkulluese, e cila mund të instalohet si një njësi e pavarur ose si një njësi që lidh dy pajisje frigoriferike lineare supermarketi. Këto njësi mund të pajisen edhe me një sistem rrotullimi i cili e bën të dukshëm shfaqjen e produkteve ushqimore në 360°;
40. **"Njësi frigoriferike supermarketi"** është një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte e destinuar për shitjen dhe ekspozimin e produkteve ushqimore dhe artikujve të tjerë në pikat e shitjes me pakicë, si në supermarkete. Frigoriferët e pijeve, makinat frigoriferike për shitje, frigoriferët banak të ekspozimit të akulloreve dhe frigorifer ngrirës për akullore nuk konsiderohen si pajisje frigoriferike supermarketi.
41. **"P"** është një faktor korrigjimi që llogarit dallimet midis pajisjeve frigoriferike integrale dhe të largëta;
42. **"Paketë M"** është një paketë testimi të pajisur me një pajisje matëse të temperaturës;

43. **"Pajisje për ruajtjen e verës"** është një pajisje frigoriferike me vetëm një lloj ndarje për ruajtjen e verës, me kontroll të saktë të temperaturës për kushtet e ruajtjes dhe temperaturën e synuar, dhe e pajisur me masa kundër dridhjeve.
44. **"Pajisje frigoriferike me funksion shitje direkte"** është një pajisje frigoriferike me një ose më shumë ndarje që kontrollohen në temperatura specifike, të ftohur nga transmetimi natyral ose i detyruar nëpërmjet një ose më shumë mjeteve që konsumojnë energji dhe të destinuara për ekspozim dhe shitje me ose pa shërbim të asistuar, produkte ushqimore dhe artikuj të tjerë në temperatura të specifikuara nën temperaturën e ambientit për klientët, të aksesueshme drejtpërdrejt e hapur ose nëpërmjet një ose më shumë dyerve ose sirtarëve ose të dyjave, duke përfshirë pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte me zona të përdorura për ruajtjen e produkteve ushqimore dhe artikujve të tjerë që nuk janë të aksesueshëm nga klientët, duke përjashtuar frigoriferët minibar dhe pajisjet për ruajtjen e verës;
45. **"Pikë shitje"** është një vendndodhje ku shfaqen ose ofrohen për shitje, me qira ose për blerje me qira pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte;
46. **"Produkte ushqimore"** janë ushqimet, përbërësit ushqimorë, pijet, duke përfshirë verën, dhe artikuj të tjerë të destinuar kryesisht për konsum, të cilat kërkojnë ftohje në temperatura të caktuara;
47. **"Sipërfaqja totale e ekspozimit (TDA)"** është sipërfaqa totale e dukshme të produkteve ushqimore dhe artikujve të tjerë, duke përfshirë sipërfaqen e dukshme përmes lustrimit, të përcaktuar nga shuma e sipërfaqeve të projektuara horizontale dhe vertikale të vëllimit neto, të shprehura në metra katrorë (m2);
48. **"Testuar dhe miratuar në mënyrë specifike"** është produkti i cili përputhet me të gjitha kërkesat e mëposhtme:
    (a)është projektuar dhe testuar në mënyrë specifike për kushtet ose aplikimin e përmendur të funksionimit.
    (b)shoqërohet me prova, për t'u përfshirë në dokumentacionin teknik në formën e një certifikate, një marke miratimi të tipit ose një raport testimi, që produkti është miratuar në mënyrë specifike për gjendjen ose aplikimin e përmendur të funksionimit;
    (c)është vendosur në treg posaçërisht për kushtet ose aplikimin e përmendur të funksionimit, siç dëshmohet të paktën nga dokumentacioni teknik, informacioni i dhënë për produktin dhe çdo material reklamues ose marketing;
49. **"Temperatura e funksionimit"** është temperatura e referencës brenda një ndarje gjatë testimit;
50. **"Temperatura e funksionimit në ftohje"** është temperaturë midis -3,5 gradë Celsius (°C) dhe 15 gradë Celsius (°C) për pajisjet e pajisura me sisteme menaxhimi të energjisë për kursimin e energjisë dhe midis -3,5 gradë Celsius (°C) dhe 10 gradë Celsius (°C) për pajisjet që nuk janë të pajisura me sisteme menaxhimi të energjisë për kursimin e energjisë;
51. **"Temperaturë e funksionimit në ngrirje"** është temperatura nën -12 gradë celsius (°C);

52. **"Tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një grafiku që lejon që informacioni të paraqitet në formë jo grafike ku pajisjet e ekranit nuk mund të japin grafikun ose si një ndihmë për aksesueshmërinë.
53. **"Vlerat e deklaruara"** janë vlerat e dhëna nga furnizuesi për parametrat teknikë të deklaruar, të llogaritur ose të matur në përputhje me Kreun 4(1)(d) dhe shtojcës III të kësaj rregulloreje.
54. **"Vëllimi bruto"** është vëllimi brenda veshjeve të brendshme të ndarjes pa pajisje të brendshme dhe me derë ose kapak të mbyllur, në decimetra kub (dm3) ose litra (L);
55. **"Vëllimi neto"** është vëllimi që përmban produkte ushqimore brenda kufirit të ngarkesës;

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit e pajisjeve frigoriferike me funksion të shitjes direkte duhet të sigurojnë që:
   a) çdo pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte të pajiset me një etiketë të printuar në formatin, siç përcaktohet në Shtojcën III;
   b) parametrat e skedës informative të produktit, siç përcaktohet në Shtojcën IV, regjistrohen në pjesën publike të bazës së të dhënave të produkteve;
   c) skeda informative e produktit do të vihet në dispozicion në formë të printuar, nëse kërkohet në mënyrë specifike nga tregtari;
   d) përmbajtja e dokumentacionit teknik, të përcaktuar në shtojca III, futet në bazën e të dhënave të produktit;
   e) çdo reklamë pamore për një model specifik të një pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcën III;
   f) çdo material teknik reklamimi në lidhje me një model specifik të pajisjeve frigoriferike me funksion të shitjes direkte, duke përfshirë materiale teknik reklamimi ose material tjetër reklamimi në internet, përfshirë klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketën, në përputhje me Shtojcën VI dhe Shtojcën VII;
   g) një etiketë elektronike në formatin dhe që përmban informacionin, siç përcaktohet në Shtojcën II, do të vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo pajisje frigoriferike me një model funksioni të shitjes direkte;
   h) një skedë elektronike informative për produktin, siç përcaktohet në Shtojcën IV, u vihet në dispozicion tregtarëve për çdo pajisje frigoriferike me një model funksioni të shitjes direkte.

2. Klasa e efiçencës së energjisë do të bazohet në indeksin e efiçencës së energjisë të llogaritur në përputhje me shtojcën I.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

Tregtarët sigurojnë që:
(a)çdo pajisje frigoriferike me funksion të shitjes direkte, në pikën e shitjes së pajisjes, duke përfshirë panairet tregtare, përmban etiketën e dhënë nga furnizuesit, në përputhje me pikën 1(a) të Kreun III, me etiketën ose klasën e energjisë që shfaqet në mënyrë që të jetë qartësisht e dukshme, dhe për pajisje të tjera frigoriferike me funksion të shitjes direkte në mënyrë të tillë që të jenë e dukshme në pjesën e jashtme të pjesës së përparme ose të sipërme të pajisjes frigoriferike;
(b)në rast të shitjes në distancë, jepet etiketa dhe skeda informative e produktit, në përputhje me shtojcat VI dhe VII;
(c)çdo reklamë vizuale për një model specifik të një pajisjeje frigoriferike me funksion të shitjes direkte, përfshirë në internet, përmban klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të vendosura dukshëm në etiketë, në përputhje me shtojcat VI dhe VII;
(d)çdo material teknik reklamimi ose material tjetër reklamues për një model specifik të një pajisjeje frigoriferike me funksion të shitjes direkte, duke përfshirë dhe materialin teknik të reklamimit në internet, i cili përshkruan parametrat e tij specifikë teknikë përfshin klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës energjetike të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcat VI dhe VII.

V. PËRGJEGJËSITË E PLATFORMAVE PRITËSE TË INTERNETIT

Ofruesi i shërbimit pritës që mundëson shitjen e pajisjeve frigoriferike me funksion shitjes së drejtpërdrejtë përmes faqes së tij të internetit, shfaq etiketën elektronike dhe skedën informative elektronike të produktit të ofruar nga tregtari në mekanizmin e ekspozimit, në përputhje me dispozitat e Shtojcës VII

VI. METODAT MATJES

Informacioni i dhënë në përpujthje me Kreun IV dhe V do të përftohet nëpërmjet metodave të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme të matjes dhe llogaritjes, bazuar në metodat e njohura moderne të matjes dhe llogaritjes, të përcaktuara në shtojcën III.

VII. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR QËLLIME TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I
Klasat e efiçencës së energjisë

Klasa e efiçencës së energjisë së një pajisjeje frigoriferike me funksion të shitjes direkte do të përcaktohet në bazë të EEI-së së saj siç përcaktohet në Tabelën 1.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë të pajisjeve frigoriferike me funksion të shitjes direkte

Klasat e efiçiencës së energjisë	**EEI**
A	EEI < 10
B	10 ≤ EEI < 20
C	20 ≤ EEI < 35
D	35 ≤ EEI < 50
E	50 ≤ EEI < 65
F	65 ≤ EEI < 80
G	EEI ≥ 80

EEI i Energjisë i një pajisjeje frigoriferike me funksion shitje direkte do të përcaktohet në përputhje me pikën 2 të shtojcës III.

SHTOJCA II
Etiketë për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte

1. **Etiketa për pajisjet frigoriferike me funksion shitje direkt, përveç frigoriferëve të pijeve dhe frigoriferëve ngrirës të akulloreve**

1.1 Etiketa



Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I.Kodi QR;
II.Emri i furnizuesit ose marka tregtare;
III. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;
IV. Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;
V.Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me Shtojcën I;
VI.AE në kWh në vit dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;
VII.

- për makinat frigoriferike me funksion të shitjes: shuma e vëllimeve neto të të gjitha ndarjeve me temperatura të funksionimit në të ftohtëtemperatura të funksionimit në të ftohtë, e shprehur në litra (L) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

- -për të gjitha pajisjet e tjera frigoriferike me funksion të shitjes direkte: shuma e sipërfaqeve të ekranit me temperatura të funksionimit në të ftohtë temperatura të funksionimit në të ftohtë, e shprehur në metra katrorë (m2) dhe e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;
- -për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte që nuk përmban ndarje me temperatura funksionimi në të ftohtë temperatura të funksionimit në të ftohtë: piktogrami dhe vlerat në litra (L) ose metra katrorë (m2) në pikën VII janë hequr;

VIII.

- për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte me të gjitha ndarjet me temperaturë funksionimi në të ftohtë që kanë të njëjtën klasë të temperaturës, me përjashtim të makinave frigoriferike me funksion të shitjes:
- temperatura në krye: temperatura më e lartë e paketës më të ngrohtë M të ndarjes(ve) me temperatura të funksionimit në të ftohtë, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt,temperatura të funksionimit në të ftohtësiç përcaktohet në Tabelën 4;
- temperatura në fund: temperatura më e ulët e paketës M më të ftohtë të ndarjeve me temperatura të funksionimit në të ftohtët në të ftohtë, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, ose temperatura minimale më e lartë e të gjitha paketave M të ndarjes(eve) me temperatura të funksionimit në të ftohtët në ftohtë, në gradë Celsius (°C) dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 4;
- për makinat frigoriferike me funksion të shitjes:
- temperatura në krye: temperatura maksimale e produktit e matur e ndarjes (ve) me temperatura të funksionimit në të ftohtët në të ftohtë, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 4;
- temperatura në fund: temperatura është përjashtuar;
- për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte që nuk përmbajnë ndarje me temperatura të funksionimit në të ftohtët në të ftohtë, piktogrami dhe vlerat në gradë Celsius (°C) në pikën VIII nuk duhet të hiqen;

IX.

- -për të gjitha pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte, me përjashtim të makinave frigoriferike me funksion të shitjes: shuma e sipërfaqeve të ekranit me temperatura funksionimit në të ngrirë, e shprehur në metër katror (m2) dhe e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;
- -për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte që nuk përmban ndarje me temperatura funksionimit në të ngrirë: piktogrami dhe vlerat në metra katrorë (m2) në pikën IX janë hequr;

X.

- për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte me të gjitha ndarjet me temperatura funksionimit në të ngrirëqë kanë të njëjtën klasë të temperaturës, me përjashtim të makinave frigoriferike me funksion të shitjes:
- -temperatura në krye: temperatura më e lartë e paketës M në të ngrohtë të ndarjes(eve) me temperatura funksionimit në të ngrirë, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 4;
- -temperatura në fund: temperatura më e ulët e paketës M në të ftohtë të ndarjes (ve) me temperatura funksionimit në të ngrirë, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, ose temperatura minimale më e lartë e të gjitha paketave M të ndarjeve me temperatura funksionimit në të ngrirë, në gradë Celsius (°C) dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 4;
- për makinat frigoriferike me funksion të shitjes:
- temperatura në krye: temperatura maksimale e produktit e matur të ndarjeve me temperatura të ngrira të funksionimit, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 4;
- temperatura në fund: temperatura është përjashtuar;
- për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte që nuk përmban ndarje me temperatura funksionimit në të ngrirë: piktogrami dhe vlerat në gradë Celsius (°C) në pikën X janë hequr;

XI. Numri i Rregullores së Deleguar të Komisionit për etiketimin e pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte që është "2019/2018".

2. Etiketa për frigoriferët e pijeve

2.1. Etiketa:



2.2. **Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:**

I.Kodi QR;

II. Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

III. Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

IV. Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;

V.Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me Shtojcën I;

VI.AE në kWh në vit dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

VII.shuma e vëllimeve bruto të të gjitha ndarjeve me temperatura të funksionimit në të ftohtë, e shprehur në litra (L) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VIII.temperatura mesatare më e lartë e ndarjes së të gjitha ndarjeve me temperatura të funksionimit në të ftohtë, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 5;

IX.temperatura më e ngrohtë e ambientit, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 6;

X. Numri i Rregullores së Deleguar të BE-së për etiketimin e pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte që është "2019/2018";

3. Etiketa për frigoriferët ngrirës të akulloreve

3.1. Etiketa:



3.2 **Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:**

I.Kodi QR;

II.Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

III.Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

IV.Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;

V.Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me Shtojcën I;

VI.AE në kWh në vit dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

VII.shuma e vëllimeve neto të të gjitha ndarjeve me temperatura të ngrira të punës, e shprehur në litra (L) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VIII.temperatura mesatare më e lartë e ndarjes së të gjitha ndarjeve me temperatura të ngrira të funksionimit, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 7;

IX.temperatura maksimale e ambientit, në gradë Celsius (°C) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, siç përcaktohet në Tabelën 8;

X. Numri i Rregullores së Deleguar të BE-së për etiketimin e pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte që është "2019/2018"

4. SKICA E ETIKETAVE

4.1. Skica e etiketës për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte, me përjashtim të frigoriferëve të pijeve dhe frigoriferëve ngrirës të akulloreve:



4.2. Skica e etiketës për frigoriferët e pijeve:



4.3. Skica e etiketës për frigoriferët ngrirës për akullore:



4.4. Ku:

(a)Etiketat duhet të jenë të paktën 96 mm të gjera dhe 192 mm të larta. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj megjithatë duhet të mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b)Sfondi i etiketës është 100% në ngjyrë të bardhë.

(c)Shkronjat janë Verdana dhe Calibri.

(d)Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketën janë siç tregohen në dizajnet e etiketës në pikat 4.1 deri në 4.3.

(e)Ngjyrat janë CMYK - cian, purpurtë, ngjyrë e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull: 0,70,100,0: 0% cian, 70% e purpurt, 100% ngjyrë e verdhë, 0% ngjyrë e zezë.

(f)Etiketat plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurave të mësipërme):

1. Ngjyrat e logos së BE-së do të jenë si më poshtë:

-sfondi: 100,80,0,0;

-Yjet: 0,0,100,0;

2. Ngjyra e logos së energjisë duhet të jetë: 100,80,0,0;
3.Kodi QR duhet të jetë 100% në ngjyrë e zezë;
4.Emri i furnizuesit është 100% në ngjyrë e zezë dhe në formatin Verdana Bold, 9 pt;
5.Identifikuesi i modelit duhet të jetë 100% në ngjyrë e zezë dhe në formatin Verdana Regular 9 pt;
6.Shkalla nga A-ja deri tek G-ja është si më poshtë:
-Shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë duhet të jenë 100 % të bardha dhe me shkronja Calibri Bold 19 pt; shkronjat duhet të përqendrohen në një bosht në 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave;
-Ngjyrat e shigjetave të shkallës nga A-ja deri tek G-ja do të jenë si më poshtë:
-A-klasa: 100,0,100,0;
-B-klasa: 70,0,100,0;
-C-klasa: 30,0,100,0;
-D-klasa: 0,0,100,0;
-E-klasa: 0,30,100,0;
-F-klasa: 0,70,100,0;
-G-klasa: 0,100,100,0;
7. Ndarësit e brendshëm duhet të kenë një peshë prej 0,5 pt dhe ngjyra duhet të jetë 100% ngjyrë e zezë;
8.Shkronja e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja Calibri Bold 33 pt. Shigjeta e klasës së efiçencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën A deri në G duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës energjetike duhet të vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës e cila duhet të jetë 100 % në ngjyrë e zezë;
9.Vlera vjetore e konsumit të energjisë do të jetë në formatin Verdana Bold 28 pt; 'kWh/vit' do të jetë në formatin Verdana Regular 18 pt. Ato duhet të jenë të përqendruara dhe 100% në ngjyrë të zezë;
10.Piktogramet duhet të jenë siç tregohen si në modelet e etiketave dhe si më poshtë:
-Vijat e piktogrameve duhet të kenë një peshë prej 1,2 pt dhe ato dhe tekstet (numrat dhe njësitë) duhet të jenë 100 % në ngjyrë të zezë;
-Numrat nën piktograme do të jenë me shkronja në ngjyrë të zezë, në formatin Verdana 16 pt me njësitë në Verdana të rregullt 12 pt dhe ato do të jenë të përqendruara nën piktograme;
-Vlerat e temperaturave duhet të jenë në formatin Verdana Bold 12 pt me '°C' në formatin Verdana Regular 12 pt dhe do të vendosen ose në anën e djathtë të piktogramit të termometrit ose brenda piktogramit që përfaqëson temperaturën e ambientit;
-Për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte, me përjashtim të frigoriverëve të pijeve dhe frigoriferëve ngrirës të akulloreve: nëse pajisja përmban vetëm ndarje të ngrira ose vetëm ndarje të pa ngrira, vetëm piktogramet përkatëse, siç përcaktohet në pikën 1.2 VII, VIII, IX dhe X, duhet të tregohen dhe të përqendrohen ndërmjet ndarësit të brendshëm poshtë konsumit vjetor të energjisë dhe fundit të etiketës së energjisë;

11.Numri i Rregullores së deleguar të BE-së është 100 % në ngjyrë e zezë dhe në Verdana Regular 6 pt.

(ç) Ngjyrat duhet të jenë CMYK - cian, purpurtë, e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull: 0-70-100-0: 0% cian, 70% purpurtë, 100% e verdhë, 0% e zezë.

(d) Etiketat duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurave të mësipërme):

❶ ngjyrat e logos së BE-së do të jenë si më poshtë:
- sfondi: 100,80,0,0;
- yjet: 0,0,100,0;

❷ ngjyra e logos së energjisë duhet të jetë: 100,80,0,0;

❸ emri i furnizuesit duhet të jetë 100% në ngjyrë e zezë dhe në formatin Verdana Bold 8 pt – 5 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla);

❹ identifikuesi i modelit duhet të jetë 100 % në ngjyrë e zezë dhe në formatin Verdana Regular 8 pt – 5 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla);

❺ shkalla A deri në G do të jetë si më poshtë:
- shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë duhet të jenë 100 % në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja në formatin Calibri Bold 10,5 pt – 7 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla); shkronjat duhet të përqendrohen në një bosht në 2 mm - 1,5 mm (me madhësi standarde - etiketë me madhësi të vogël) nga ana e majtë e shigjetave;
- ngjyrat e shigjetave të shkallës A deri në G do të jenë si më poshtë:
  - A-klasa: 100,0,100,0;
  - B-klasa: 70,0,100,0;
  - C-klasa: 30,0,100,0;
  - D-klasa: 0,0,100,0;
  - E-klasa: 0,30,100,0;
  - F-klasa: 0,70,100,0;
  - G-klasa: 0,100,100,0;

❻ ndarësit e brendshëm duhet të kenë një madhësi prej 0,5 pt dhe duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë;

❼ shkronja e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë 100% në ngjyrë të bardhë dhe në formatin Calibri Bold 16 pt – 10 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla). Shigjeta e klasës së efiçencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën A deri në G duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës energjetike duhet të vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës e cila duhet të jetë 100 % në ngjyrë të zezë;

❽ vlera e konsumit të energjisë duhet të jetë në formatin Verdana Bold 12 pt; 'kWh/1 000h' do të jetë në formatin Verdana Regular 8 pt – 5 pt (me madhësi standarde – etiketë me përmasa të vogla), 100 % në ngjyrë të zezë;

❾ kodi QR duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë;

⑩ numri i Rregullores së deleguar të BE-së duhet të jetë 100 % në ngjyrë ezezë dhe në formatin Verdana Regular 5 pt.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Matjet dhe metodat e llogaritjes

Për qëllime të verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e kësaj rregulloreje, matjet dhe llogaritjet kryhen sipas standarde të harmonizuara evropiane të miratuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, që marrin parasysh metodat më të fundit të njohura përgjithësisht, dhe janë në përputhje me dispozitat e përcaktuara më poshtë.
Kur një parametër deklarohet në përputhje me Ligjin Nr. 52/2024 dhe në përputhje me Tabelën 11 të Shtojcës V, vlera e deklaruar duhet të përdoret nga furnizuesi për llogaritjet në këtë shtojcë.

1. Kushtet e përgjithshme për testim
(a)kushtet e mjedisit duhet të korrespondojnë me Setin 1, me përjashtim të frigoriferëve ngrirës të akulloreve dhe frigorifer banak për ekspozim të akulloreve që do të testohen në kushtet e ambientit që korrespondojnë me Setin 2, siç përcaktohet në Tabelën 2.
(b)kur një ndarje mund të vendoset në temperatura të ndryshme, ajo duhet të testohet në temperaturën më të ulët të funksionimit.
(c)makina frigoriferike me funksion të shitjes me ndarje me vëllime të ndryshueshme do të testohen me volumin neto të ndarjes me temperaturën më të lartë të funksionimit të rregulluar në volumin e saj minimal neto.
(d)për frigoriferët e pijeve, shpejtësia e specifikuar e ftohjes duhet të jetë sipas kohës së rikuperimit të gjysmës së ringarkimit.

Tabela 2
Kushtet e mjedisit

	Temperatura e llambës së thatë, °C	**Lagështia relative, %**	**Pika e vesës, °C**	**Masa e avullit të ujit në ajër të thatë, g/kg**
Set 1	25	60	16,7	12,0
Set 2	30	55	20,0	14,8

2. Përcaktimi i IEE:
(a)Për të gjitha pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte, EEI, e shprehur në % dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore, është raporti i AE (në kWh/a) dhe SAE referencë (në kWh/a) dhe llogaritet si :
EEI = AE/SAE.
(b)AE, e shprehur në kWh/a dhe e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore, llogaritet si më poshtë:
$AE = 365 \times E_{daily}$;
me:
-E_{daily} është konsumi i energjisë i pajisjes frigoriferike me funksion të shitjes direkte për 24 orë, i shprehur në kWh/24 orë, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore dhe i matur sipas kushteve të temperaturës të tabelës 4 për klasën përkatëse të temperaturës.

(c)SAE shprehet në kWh/a dhe rrumbullakoset në dy shifra dhjetore. Për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte me të gjitha ndarjet që kanë të njëjtën klasë të temperaturës dhe për makinat shitëse frigoriferike, SAE llogaritet si më poshtë:

$$SAE = 365 \times P \times (M + N \times Y) \times C;$$

Për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte me më shumë se një ndarje që kanë klasa të ndryshme të temperaturës, me përjashtim të makinave shitëse frigoriferike, SAE llogaritet si më poshtë:

$$SAE = 365 \times P \times \sum_{c=1}^{n} (M + N \times Y_c) \times C_c)$$

ku:

(1) c është numri i indeksit për një lloj ndarjeje që varion nga 1 në n, ku n është numri total i llojeve të ndarjeve.

(2) Vlerat e M dhe N janë dhënë në tabelën 3.

Tabela 3

Vlerat M dhe N

Kategoria	**Vlera për M**	**Vlera për N**
Frigorifer pijesh	2,1	0,006
Frigorifer ngrirës për akullore	2,0	0,009
Makina frigoriferike me funksion të shitjes	4,1	0,004
Frigorifer banak për ekspozim akullore	25,0	30,400
Frigorifer me funksion të kombinuar për supermarket	9,1	9,100
Frigorifer banak horizontal për supermarkete	3,7	3,500
Frigorifer banakë ngrirës vertikale dhe të kombinuara për supermarkete	7,5	19,300
Frigorifer ngrirës horizontale për supermarkete	4,0	10,300
Frigorifer me sistem rrotullimi	9,2	11,600

(3)Vlerat e C, koeficienti i temperaturës janë dhënë në tabelën 4.

Tabela 4

Kushtet e temperaturës dhe vlerat përkatëse të koeficientit të temperaturës, C

(a) Frigoriferët e supermarketeve					
Kategoria	**Klasa e temperaturës**	**Temperatura më e lartë e paketës M më të ngrohtë (°C)**	**Temperatura më e ulët e paketës M më të ftohtë (°C)**	**Temperatura minimale më e lartë e të gjitha paketave M (°C)**	**Vlera për C**
Frigorifer të kombinuar vertikal për supermarket	M2	≤ +7	≥ –1	n.a.	1,00
	H1 dhe H2	≤ +10	≥ –1	n.a.	0,82
	M1	≤ +5	≥ –1	n.a.	1,15
Frigorifer horizontal për supermarket	M2	≤ +7	≥ –1	n.a.	1,00
	H1 dhe H2	≤ +10	≥ –1	n.a.	0,92
	M1	≤ +5	≥ –1	n.a.	1,08
Frigorifer ngrirës vertikal dhe të kombinuar, për supermarket	L1	≤ –15	n.a.	≤ –18	1,00
	L2	≤ –12	n.a.	≤ –18	0,90
	L3	≤ –12	n.a.	≤ –15	0,90
Frigorifer ngrirës horizontal për supermarket	L1	≤ –15	n.a.	≤ –18	1,00
	L2	≤ –12	n.a.	≤ –18	0,92
	L3	≤ –12	n.a.	≤ –15	0,92
Frigoriferë supermarketi vertikalë dhe të kombinuar	M0	≤ +4	≥ –1	n.a.	1,30
Frigoriferë supermarketi horizontalë	M0	≤ +4	≥ –1	n.a.	1,30

(b) Frigorifer banak për ekspozim akulloresh				
Klasa e temperaturës	**Temperatura më e lartë e paketës M më të ngrohtë (°C)**	**Temperatura më e ulët e paketës M më të ftohtë (°C)**	**Temperatura minimale më e lartë e të gjitha paketave M (°C)**	**Vlera për C**

G1	-10	-14	n.a.	1,00
G2	-10	-16	n.a.	1,00
G3	-10	-18	n.a.	1,00
L1	-15	n.a.	-18	1,00
L2	-12	n.a.	-18	1,00
L3	-12	n.a.	-15	1,00
S	Klasifikimi i veçantë			1,00

(c) Makina frigoriferike me funksion të shitjes		
Klasa e temperaturës	**Temperatura maksimale e matur e produktit (Tv) (°C)**	**Vlera për C**
Kategoria 1	7	$1+(12-T_V)/25$
Kategoria 2	12	
Kategoria 3	3	
Kategoria 4	$(T_{V1}+T_{V2})/2$ (*1)	
Kategoria 6	$(T_{V1}+T_{V2})/2$ (*1)	

(d) pajisje të tjera frigoriferike me funksion të shitjes direkte	
Kategoria	**Vlera për C**
Pajisje të tjera	1,00

(4)Koeficienti Y llogaritet si më poshtë:
(a)për frigoriferët e pijeve:
Yc është vëllimi ekuivalent i ndarjeve të frigoriferëve të pijeve me temperaturën e synuar Tc, (Veq c), e llogaritur si më poshtë:

$$\mathbf{Y_c = Veq_c = GrossVolume_c \times ((25 - Tc)/20) \times CC;}$$

ku Tc është temperatura mesatare e klasifikimit të ndarjes së ndarjes dhe CC është faktori i klasës klimatike. Vlerat për Tc janë paraqitur në tabelën 5. Vlerat për CC janë paraqitur në tabelën 6.

Tabela 5

Klasat e temperaturës dhe temperaturat mesatare përkatëse të ndarjes (Tc) për frigoriferët të pijeve

Klasa e temperaturës	***Tc* (°C)**
K1	+3,5

K2	+2,5
K3	-1,0
K4	+5,0

Tabela 6

Kushtet e funksionimit dhe vlerat CC për frigoriferët e pijeve

Temperatura më e ngrohtë e ambientit (°C)	**Lagështia relative e ambientit (%)**	***CC***
+25	60	1,00
+32	65	1,05
+40	75	1,10

b) për frigoriferët ngrirës të akulloreve:

Yc është vëllimi ekuivalent i ndarjeve të frigoriferëve ngrirës të akulloreve me temperaturën e synuar Tc, (Veq_c), e llogaritur si më poshtë:

$$\mathbf{Y_c = Veq_c = NetVolume \times ((12 - Tc)/30) \times CC;}$$

ku Tc është temperatura mesatare e klasifikimit të ndarjes së ndarjes dhe CC është faktori i klasës klimatike. Vlerat për Tc janë paraqitur në tabelën 7. Vlerat për CC janë paraqitur në tabelën 8.

Tabela 7

Klasat e temperaturës dhe temperaturat përkatëse mesatare të ndarjes (Tc) për frigoriferët ngrirës të akulloreve

Klasa e temperaturës		***Tc* (°C)**
Temperatura më e ngrohtë e paketës M është më e ftohtë ose e barabartë me në të gjitha testet (përveç testit të hapjes së kapakut) (°C)	**Rritja më e ngrohtë e temperaturës maksimale e paketës M e lejuar gjatë provës së hapjes së kapakut (°C)**	
-18	2	-18,0
-7	2	-7,0

Tabela 8

Kushtet e funksionimit dhe vlerat përkatëse të CC për frigoriferët ngrirës të akulloreve

	Minimumi		**Maksimumi**		***CC***
	Temperatura e ambientit (°C)	**Lagështia relative e ambientit (%)**	**Temperatura e ambientit (°C)**	**Lagështia relative e ambientit (%)**	
	16	80	30	55	1,00
			35	75	1,10

Frigoriferët ngrirës të akulloreve me kapak transparent			40	40	1,20
Frigorifer ngrirës të akulloreve me kapak jo transparent	16	80	30	55	1,00
			35	75	1,04
			40	40	1,10

(c)për makina frigoriferike me funksion të shitjes:
Y është vëllimi neto i makinave frigoriferike me funksion të shitjes, i cili është shuma e vëllimeve të të gjitha ndarjeve brenda të cilave gjenden produktet drejtpërdrejt të disponueshme për shitje dhe vëllimi nëpër të cilin kalojnë produktet gjatë procesit të shpërndarjes, i shprehur në litra (L) dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt.
(d)për të gjitha pajisjet e tjera frigoriferike me funksion të shitjes direkte:
Yc është shuma TDA e të gjitha ndarjeve të së njëjtës klasë të temperaturës së pajisjes frigoriferike me funksion shitje të drejtpërdrejtë, e shprehur në metra katrorë (m2) dhe e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore.
(5)Vlerat për P janë paraqitur në tabelën 9.

Tabela 9

Vlerat P

Lloji i banakut	***P***
Frigorifer i integruar supermarketi	1,10
Pajisje të tjera frigoriferike me funksion të shitjes direkte	1,00

SHTOJCA IV
Skeda informative e produktit

Në bazë të pikës 1(b) të Kreut 3, furnizuesi duhet të vendosë në bazën e të dhënave të produktit informacionin e përcaktuar në Tabelën 10.

Tabela 10
Skeda informative e produktit

<table>
<tr><td colspan="5">Emri i furnizuesit ose marka tregtare (1) , (2):</td></tr>
<tr><td colspan="5">Adresa e furnizuesit (1) , (2):</td></tr>
<tr><td colspan="5">Identifikuesi i modelit (1):</td></tr>
<tr><td colspan="3">Përdorimi:</td><td colspan="2">Shfaqja dhe shitja</td></tr>
<tr><td colspan="5">Lloji i pajisjes frigoriferike me funksion të shitjes direkte:
[Frigorifer pijesh/ngrirës akulloresh/ Banakë për ekspozim akullore / supermarketi/makina frigoriferike]</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kodi i familjes së banakut, sipas standardeve të harmonizuara ose metodave të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme në përputhje me shtojcën III.</td><td colspan="2">Për shembull: [HC1/…/HC8], [VC1/…/VC4]</td></tr>
<tr><td colspan="5">Parametrat specifikë të produktit
(Frigoriferët e pijeve: plotësoni pikën 1, frigoriferëve ngrirës të akulloreve: plotësoni pikën 2, Banakë për ekspozim akullore: plotësoni pikën 3, frigorifer të supermarketit: plotësoni pikën 4, makinat frigoriferike me funksion të shitjes: plotësoni pikën 5. Nëse pajisja frigoriferike me funksionin e shitjes direkte përmban ndarje që punojnë në temperatura të ndryshme, ose një ndarje që mund të vendoset në temperatura të ndryshme, linjat duhet të përsëriten për çdo ndarje ose cilësim të temperaturës):</td></tr>
<tr><td colspan="5">1. Frigorifer për pijet:</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Vëllimi bruto (dm3 ose L)</td><td colspan="4">Kushtet e mjedisit për të cilat pajisja është e përshtatshme (sipas tabelës 6)</td></tr>
<tr><td>Temperatura më e ngrohtë (°C)</td><td colspan="3">Lagështia relative (%)</td></tr>
<tr><td>x</td><td>x</td><td colspan="3">x</td></tr>
<tr><td colspan="5">2. Frigorifer ngrirës për akullore me [kapak transparent/kapak jo transparent]:</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Vëllimi neto (dm3 ose L)</td><td colspan="4">Kushtet e mjedisit për të cilat pajisja është e përshtatshme (sipas tabelës 8)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Gama e temperaturës (°C)</td><td colspan="2">Gama e lagështisë relative (%)</td></tr>
<tr><td>minimale</td><td>maksimale</td><td>minimale</td><td>maksimale</td></tr>
</table>

x	x	x	x	x
3. Frigorifer banak për ekspozim akullore				
Sipërfaqja totale e shfaqjes (m2)	Klasa e temperaturës (sipas tabelës 4(b))			
x,xx	[G1/G2/G3/L1/L2/L3/S]			
4. [E integruar/Distancë] [horizontal/vertikal (përveç gjysmë-vertikal)/gjysmë-vertikal/i kombinuar] frigorifer supermarketi, i futur: [po/jo]:				
Sipërfaqja totale e shfaqjes (m2)	Klasa e temperaturës (sipas tabelës 4 (a))			
x,xx	[frigorifer: [M2/H1/H2/M1]/ngrirës: [L1/L2/L3]]			
5. Makina frigoriferike me funksion të shitjes, [frigorifer me fronte të mbyllura për kanaçe dhe shishe ku mbahen nëproduktet/xhama frigoriferik me ballë për [kanaçe dhe shishe, ëmbëlsira dhe ushqime/krejtësisht për ushqime që prishen]/multi-temperaturë për [plotësoni llojin e produkteve ushqimore është i destinuar për]/makinat e kombinuara që përbëhen nga kategori të ndryshme makinerish në të njëjtin strehë dhe fuqizohen nga një frigorifer për [plotësoni llojin e produkteve ushqimore për të cilat është menduar]:				
Vëllimi (dm3 ose L)	Klasa e temperaturës (sipas tabelës 4(c))			
x	kategori [1/2/3/4/6]			
Parametrat e përgjithshëm të produktit:				
Parameter	Vlera	Parameter	Vlera	
Konsumi vjetor i energjisë (kWh/a)(2)	x,xx	Temperatura(t) e rekomanduara për ruajtjen e optimizuar të ushqimit (°C) (Këto cilësime nuk duhet të kundërshtojnë kushtet e temperaturës të përcaktuara në shtojcën III, Tabela 4, 5 ose 6, sipas rastit)	x	
EEI	x,x	Klasa e efiçencës së energjisë	[A/B/C/D/E/F/G] (2)	
Parametrat e burimit të dritës (2), (2):				
Lloji i burimit të dritës	[Teknologjia e ndriçimit]			
Klasa e efiçencës së energjisë	[A/B/C/D/E/F/G]			
Kohëzgjatja minimale e garancisë së ofruar nga furnizuesi (2), (2)				
Informacione shtese (2), (2):				
Lidhja në internet në faqen e internetit të furnizuesit, gjendet:				
(1) nëse baza e të dhënave të produktit gjeneron automatikisht përmbajtjen përfundimtare të kësaj qelize, furnizuesi nuk duhet t'i vendosë këto të dhëna.				

(2) nëse pajisja frigoriferike me funksion të shitjes direkte ka ndarje të ndryshme që punojnë në temperatura të ndryshme, duhet të sigurohet konsumi vjetor i energjisë i njësisë së integruar. Nëse sistemet e veçanta të frigoriferit ofrojnë ftohje për ndarje të veçanta të së njëjtës njësi, konsumi i energjisë i lidhur me secilin nënsistem duhet të sigurohet gjithashtu aty ku është e mundur.

SHTOJCA V
Dokumentacioni teknik

1. Dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(d) të Kreut 3 përfshin elementët e mëposhtëm:
(a)një përshkrim të përgjithshëm të modelit që lejon që ai të identifikohet pa mëdyshje dhe lehtësisht;
(b)referenca ndaj standardeve të harmonizuara të aplikuara ose standardeve të tjera të matjes të përdorura;
(c)masat paraprake specifike që duhen marrë kur modeli montohet, instalohet, mirëmbahet ose testohet;
(d)vlerat për parametrat teknikë të përcaktuar në Tabelën 11; këto vlera konsiderohen si vlera të deklaruara për qëllim të procedurës së verifikimit në shtojcën VIII;
(e)detajet dhe rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me shtojcën III;
(f)kushtet e testimit nëse nuk përshkruhen mjaftueshëm në pikën (b);
(g)modele ekuivalente, nëse ka, duke përfshirë identifikuesit e modelit.
Këta elementë do të përbëjnë gjithashtu pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi duhet të vendosë në bazën e të dhënave.

Tabela 11

Parametrat teknikë të modelit dhe vlerat e deklaruara të tyre për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte

Një përshkrim i përgjithshëm i pajisjes frigoriferike me modelin e funksionit të shitjes direkte, i mjaftueshëm që ajo të identifikohet pa mëdyshje dhe lehtësisht:			
Specifikimet e produktit			
Specifikimet e përgjithshme të produktit:			
Parameter	Vlera	Parameter	Vlera
Konsumi vjetor i energjisë (kWh/a)	x,xx	Konsumi standard vjetor i energjisë (kWh/a)	x,xx
Konsumi ditor i energjisë (kWh/24h)	x,xxx	Kushtet e ambientit	[Set 1/Set 2]
M	x,x	N	x,xxx
Koeficienti i temperaturës (C)	x,xx	Y	x,xx
P	x,xx	Temperatura e synuar (Tc) (°C)*	x,x
Faktori i klasës klimatike (CC)*	x,xx		
Informacion shtesë:			

Referencat e standardeve të harmonizuara ose metoda të tjera të besueshme të sakta dhe të riprodhueshme të aplikuara:			
Kur është e përshtatshme, identifikimi dhe nënshkrimi i personit të autorizuar për të lidhur furnizuesin:			
Një listë e modeleve ekuivalente, duke përfshirë identifikuesit e modelit:			
Vetëm për frigoriferët e pijeve dhe frigoriferët ngrirës të akulloreve			
Specifikimet shtesë të produktit për frigoriferët e pijeve:			
Parameter			Vlera
Vëllimi bruto (dm^3 or L)			x
Kushtet e ambientit për të cilat pajisja është e përshtatshme (sipas tabelës 6)		Temperatura më e ngrohtë (°C)	x
		Lagështia relative (%)	x
Specifikimet shtesë të produktit për frigorifer ngrirës akulloresh me [kapak transparent/kapak jo transparent]:			
Parameter			Vlera
Vëllimi neto (dm^3 or L)			x
Kushtet e ambientit për të cilat pajisja është e përshtatshme (sipas tabelës 8)	Gama e temperaturës (°C)	Minimum	x
		Maximum	x
	Gama e lagështisë relative (%)	Minimum	x
		Maximum	x
Specifikimet shtesë të produktit për			
Parameter			Vlera
Sipërfaqja totale e shfaqjes (m^2)			x,xx
Klasa e temperaturës			XY
Specifikime shtesë të produktit për frigoriferët e supermarketeve			
Parameter			Vlera
Sipërfaqja totale e shfaqjes (m^2)			x,xx
Klasa e temperaturës			XY
Specifikimet shtesë të produktit për makinat frigoriferike me funksion të shitjes:			
Parameter			Vlera
Klasa e temperaturës			XY
Volume (dm^3 or L)			x

2. Kur është marrë informacioni i përfshirë në dokumentacionin teknik për një model të caktuar:

(a)nga një model që ka të njëjtat karakteristika teknike të rëndësishme për informacionin teknik që do të jepet, por është prodhuar nga një prodhues tjetër; ose
(b)duke llogaritur në bazë të projektimit ose ekstrapolimit nga një model tjetër i të njëjtit ose të një prodhuesi të ndryshëm, ose të dyja, dokumentacioni teknik do të përfshijë detajet e një llogaritjeje të tillë, vlerësimin e ndërmarrë nga prodhuesi për të verifikuar saktësinë e llogaritjes dhe, sipas rastit, deklaratën e identitetit midis modeleve të prodhuesve të ndryshëm.

SHTOJCA VI

Informacioni që jepet në reklamat pamore, materialet promovuese teknike dhe në shitjet në distancë, përveçse shitjeve në distancë në internet.

1. Në reklamat pamore për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte, për qëllime të sigurimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 (e) të Kreut 3 dhe në pikën (c) të Kreut 4, klasa e efiçencës së energjisë dhe gama e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë do të tregohen siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
2. Në materialin teknik promovues ose material tjetër promovues për pajisjet frigoriferike me funksion të shitjes direkte, për qëllime të sigurimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 (f) të Kreut 3 dhe në pikën (d) të Kreut 4, klasa e efiçencës së energjisë dhe gama e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë duhet të tregohet siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
3. Çdo shitje në distancë e pajisjeve frigoriferike me bazë letre me funksion shitje direkte duhet të tregojë klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
4. Klasa e efiçencës së energjisë dhe gama e tyre duhet të tregohen, siç tregohet në Figurën 1, me:
(a)një shigjetë që përmban germën e klasës së efiçencës së energjisë, me ngjyrë të bardhë, Calibri Bold dhe me një madhësi shkrimi të paktën ekuivalente me atë të çmimit, nëse çmimi tregohet, në të gjitha rastet e tjera madhësia e shkronjave qartësisht të dukshme dhe të lexueshme;
(b)ngjyra e shigjetës që përputhet me ngjyrën e klasës së efiçencës së energjisë;
(c)gamën e klasave të disponueshme të efiçencës së energjisë në 100% në ngjyrë të zezë; dhe
(d)madhësia duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës energjetike duhet të vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi prej 0,5 pt në ngjyrë të zezë rreth shigjetës dhe germën e klasës së efiçencës së energjisë.
Me përjashtim, nëse reklama vizuale, materiali promovues teknik ose material tjetër promovues ose shitje në distancë me bazë letre printohen në pikturë njëngjyrëshe, shigjeta mund të jetë pikturë njëngjyrëshe në atë reklamë vizuale, material teknik promovues, material tjetër promovues ose shitje në distancë me bazë letre.

Figura 1

Shigjeta me ngjyra/njëngjyrëshe majtas/djathtas, me gamën e klasave të efiçencës së energjisë të treguar



5. Shitja në distancë duhet të informojë në mënyrë specifike klientin për klasën e efiçencës së energjisë të produktit dhe për gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, dhe se klienti mund të aksesojë etiketën e plotë dhe skedën informative të produktit përmes një aksesi të lirë, faqe interneti, ose duke kërkuar një kopje të printuar.

6. Për të gjitha situatat e përmendura nga pikat 1 deri në 3 dhe pikën 5, duhet të jetë e mundur që klienti të marrë, sipas kërkesës, një kopje të printuar të etiketës dhe fletën e informacionit të produktit.

Shtojca VII
Informacioni që jepet në rastin e shitjeve në internet

1. Etiketa e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(g) të Kreut 3 duhet të shfaqet në mekanizmin e ekspozimit në afërsi me çmimin e produktit, nëse tregohet çmimi, dhe në të gjitha rastet e tjera në afërsi me produktin. Madhësia duhet të jetë e tillë që etiketa të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe duhet të jetë proporcionale me madhësinë e specifikuar në pikën 4 të shtojcës II. Etiketa shfaqet duke përdorur një ekran të ndërthurur, në të cilin rast imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 3 të kësaj shtojce. Nëse aplikohet ekrani i ndërlidhur, etiketa do të shfaqet në klikimin e parë të mausit, në rrotullimin e mausit ose në zgjerimin e ekranit me prekje në imazh.
2. Imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë në rastin e një ekrani të ndërthurur, siç tregohet në Figurën 2, duhet:
(a) të jetë një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë të produktit në etiketë;
(b)Të tregojë klasën e efiçencës së energjisë të produktit në shigjetën me ngjyrë të bardhë, Calibri Bold dhe me një madhësi fonti të barabartë me atë të çmimit, nëse çmimi tregohet, në të gjitha rastet e tjera një madhësi shkrimi qartësisht të dukshme dhe të lexueshme; dhe
(c)të ketë gamën e klasave të disponueshme të efiçencës së energjisë në 100% në ngjyrë të zezë; dhe,
(d)të ketë një nga dy formatet e mëposhtme, dhe madhësia e tij duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë duhet të vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi të dukshëm, 100% në ngjyrë të zezë, të vendosur rreth shigjetës dhe germën e klasës së efiçencës së energjisë:

Figura 2
Shembull i shigjetës majtas/djathtas me ngjyrë, me gamën e klasave të energjisë të treguar



3. Në rastin e një ekrani, sekuenca e shfaqjes së etiketës do të jetë si më poshtë:
(a)Imazhi i përmendur në pikën 2 të kësaj shtojce do të shfaqet në mekanizmin e ekspozimit në afërsi të çmimit të produktit, nëse çmimi tregohet, dhe në të gjitha rastet e tjera në afërsi me produktin;
(b)imazhi duhet të lidhet me etiketën e përcaktuar në shtojcën II;
(c)etiketa do të shfaqet pas një klikimi të mausit, rrokullisjes së mausit ose zgjerimit të prekshëm të ekranit në imazh;
(d)etiketa do të shfaqet me anë të hapjes, skedës së re, faqes së re ose ekranit të futur;
(e)për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, do të zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;

(f)etiketa do të pushojë së shfaquri me anë të opsionit të mbylljes ose mekanizmit tjetër standard të mbylljes;
(g)teksti alternativ për grafikun, që do të shfaqet në rast të mosafishimit të etiketës, do të jetë klasa e efiçencës së energjisë së produktit në një madhësi shkrimi ekuivalent me atë të çmimit, nëse tregohet çmimi, dhe në të gjitha rastet e tjera një madhësia e shkronjave të dukshme dhe të lexueshme.
4. Skeda informative e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(h) të Kreut 3 duhet të shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi me çmimin e produktit, nëse tregohet çmimi, dhe në të gjitha rastet e tjera në afërsia me produktin. Madhësia duhet të jetë e tillë që skeda informative e produktit të jetë qartë e dukshme dhe e lexueshme. Skeda informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur ose duke iu referuar bazës së të dhënave të produktit, në të cilin rast lidhja e përdorur për të hyrë në skedën informative të produktit duhet të tregojë qartë dhe në mënyrë të lexueshme "Skeda informative e produktit". Nëse përdoret një ekran i ndërlidhur, skeda informative e produktit do të shfaqet në klikimin e parë të mausit, rrokullisjen e mausit ose zgjerimin e ekranit me prekje në lidhje.

SHTOJCA VIII
Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë kanë të bëjnë vetëm me verifikimin nga Struktura përgjegjese për mbikqyrjen e tregut të vlerave të deklaruara. Këto toleranca nuk do të përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknikose në interpretimin e këtyre vlerave me synimin për të arritur pajtueshmërinë ose për të komunikuar performancë më të mirë. Vlerat dhe klasat e publikuara në etiketë ose në skedën informative të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara në dokumentacionin teknik.

Kur modeli është projektuar në mënyrë që të jetë në gjendje të zbulojë që është duke u testuar (p.sh., duke njohur kushtet e testimit ose ciklin e testimit) dhe të reagojë në mënyrë specifike duke ndryshuar automatikisht performancën e tij gjatë testit me objektivin për të arritur një nivel më të favorshëm për secilin nga parametrat e specifikuar në këtë rregullore ose të përfshira në dokumentacionin teknik ose të përfshirë në ndonjë nga dokumentacioni i ofruar, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen si të papajtueshme.

Kur verifikohet përputhshmëria e modelit të një produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

(1) Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut verifikon një njësi të vetme të modelit.
(2) Modeli konsiderohet se i plotëson kërkesat e zbatueshme nëse:

(a) vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik sipas pikës 3 të nenit 3 të ligjit 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji (vlerat e deklaruara), dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit; dhe; dhe
(b) Vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën informative të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, ndërkohë që klasa e treguar e efiçencës të energjisë dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe
(c) Kur Struktura përgjegjëse për mbikqyrjes e tregut teston njësitë e modelit, vlerat e përcaktuara (që janë vlerat e parametrave përkatës të matur në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 12.
(3)Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a) dhe (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.

(4)Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut zgjedh tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve ekuivalente.
(5)Modeli konsiderohet se plotëson kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 12.
(6)Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.
(7) Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut vendos masa administrative në përputhje me ligjin nr.52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", në rastet e konstatimit të mospërputhjes së modelit sipas pikave 3 dhe 6 të kësaj shtojce.

Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcës III.

Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut zbaton vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 12 dhe përdorin vetëm procedurën e përcaktuar në pikat 1 deri në 7 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë. Për parametrat e dhënë në Tabelën 12, nuk zbatohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 12

Tolerancat e verifikimit për parametrat e matur

Parametrat	**Tolerancat e verifikimit**
Vëllimi neto dhe vëllimi neto i ndarjes kur është e mundur	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 3 % ose 1 L më e ulët - cilado qoftë vlera më e madhe - se vlera e deklaruar.
Vëllimi bruto dhe vëllimi bruto i ndarjes kur është e aplikueshme	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 3 % ose 1 L më e ulët - cilado qoftë vlera më e madhe - se vlera e deklaruar
TDA dhe TDA e ndarjes aty ku është e aplikueshme	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 3 % më e ulët se vlera e deklaruar.
E_{daily}	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 10 % më e lartë se vlera e deklaruar
AE	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 10 % më e lartë se vlera e deklaruar.
([1]) në rastin e tre njësive shtesë të testuara siç përcaktohet në pikën 4, vlera e përcaktuar nënkupton mesataren aritmetike të vlerave të përcaktuara për këto tre njësi shtesë.	

ANEKS NR.14

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË TELEFONAVE INTELIGJENTË DHE TABLETAVE"[1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin e telefonave inteligjentë dhe tabletave, si dhe dhënien e informacionit plotësues të produktit për telefonat inteligjentë dhe tabletat me prekje.
Kjo rregullore nuk zbatohet për produktet e mëposhtme:

(a) telefona celularë dhe tableta me një ekran kryesor fleksibël të cilin përdoruesi mund ta shpalosë dhe t'i rrotullojë pjesërisht ose plotësisht;
(b) telefonat inteligjentë (smartphone) për komunikim të sigurisë së lartë.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"telefon celular"** është një pajisje elektronike dore pa kabull, e cila ka karakteristikat e mëposhtme:

a) është projektuar për komunikim zanor me rreze të gjatë ose mbi një rrjet telekomunikacioni celular ose një rrjet telekomunikacioni të bazuar në satelit, që kërkon një kartë SIM, eSIM ose mjete të ngjashme për të identifikuar palët e lidhura;
b) është projektuar për përdorim me bateri dhe lidhet me rrjetin elektrik nëpërmjet një furnizimi të jashtëm me energji dhe/ose transmetimi i energjisë pa kabull është kryesisht për qëllime të karikimit të baterisë;
c) nuk është projektuar për t'u mbajtur në kyçin e dorës;

2. **"telefon inteligjent (smartphone)"** është një telefon celular, i cili ka karakteristikat e mëposhtme:

a) karakterizohet nga lidhja e rrjetit pa kabull, përdorimi celular i shërbimeve të internetit, një sistem operativ i optimizuar për përdorim në dorë dhe aftësia për të pranuar aplikacione softuerike origjinale dhe të palëve të treta;

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 2023/1669 e Komisionit, datë 16 qershor 2023, për plotësimin e Rregullores (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për etiketimin e energjisë të telefonave inteligjent dhe tabletave". Numri CELEX 02023R1669, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 214, datë 31.08.2023, f. 9.

b) ka një ekran të integruar me prekje me një madhësi diagonale të shikueshme prej 10,16 centimetra (ose 4,0 inç) ose më shumë, por më pak se 17,78 centimetra (ose 7,0 inç);
c) kur pajisja ka një ekran të palosshëm ose ka më shumë se një ekran, të paktën njëri prej ekraneve bie në diapazonin e madhësisë në modalitetin e hapur ose të mbyllur;

3. **"telefon inteligjent (smartphone) për komunikime të sigurisë së lartë"** është një smartphone, i cili ka karakteristikat e mëposhtme:

a) është akredituar, ose miratuar nga organet e konformitetit të miratura Europiane ose është në proces akreditimi ose miratimi tjetër për të transmetuar, përpunuar ose ruajtur informacionin e klasifikuar;
b) është i destinuar vetëm për përdoruesit profesionistë;
c) është i aftë të zbulojë ndërhyrje fizike në pajisje, duke përfshirë për zbulimin e ndërhyrjeve të paktën një kontrollues, instalime elektrike të lidhura me të, qark fleksibël të bordit për mbrojtjen nga shpimi të integruar në shasinë e pajisjes dhe qark kundër ndërhyrjes të integruar në skedën e qarkut qëndror;

4. **"përdorues profesionist"** është çdo person fizik ose juridik, të cilit një produkt i është vënë në dispozicion për përdorim gjatë aktiviteteve të tyre industriale ose profesionale;
5. **"tabletë me prekje"** është një pajisje që është projektuar për transportueshmëri dhe ka karakteristikat e mëposhtme:

a) ka një ekran të integruar të ndjeshëm ndaj prekjes me një madhësi diagonale të dukshme më të madhe ose të barabartë me 17,78 centimetra (ose 7,0 inç) dhe më pak se 44,20 centimetra (ose 17,4 inç);
b) nuk ka një tastierë të integruar, të lidhur fizikisht në konfigurimin e saj të projektuar;
c) ai kryesisht mbështetet në një lidhje rrjeti pa tel;
d) ushqehet nga një bateri e brendshme dhe nuk ka për qëllim të punojë pa bateri; dhe
e) është vendosur në treg me një sistem operativ të krijuar për platforma celulare, identike ose analoge me telefonat inteligjentë (smartphon);

6. **"pika e shitjes"** është vendndodhja fizike ku shfaqen ose ofrohen për shitje, qera ose blerjen me këste, njësitë e telefonave inteligjentë ose tabletave me prekje;
7. **"vlerat e deklaruara"** janë vlerat e dhëna nga furnizuesi për parametrat teknikë të deklaruar, të llogaritur ose të matur në dokumentacionin teknik, sipas nenit 3, pika 3, Ligji nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" dhe në përputhje me kreun III, pika 1/d, dhe Shtojcën V të kësaj rregulloreje, për verifikimin e pajtueshmërisë nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.
8. **"qëndrueshmëria e baterisë për cikël"** është koha gjatë së cilës një telefon inteligjent ose tabletë mund të funksionojë duke ekzekutuar një skenar të përcaktuar testimi me një bateri të mbushur plotësisht, përpara se pajisja të fiket automatikisht për shkak të baterisë së zbrazur, e shprehur në orë (h);
9. **"kapaciteti i vlerësuar"** është sasia e energjisë elektrike e deklaruar nga prodhuesi që një bateri mund të ofrojë gjatë një periudhe 5-orëshe kur matet në kushte të specifikuara, e shprehur në miliamper-orë (mAh);

10. **"kapaciteti i mbetur"** i baterisë është kapaciteti i baterisë duke ruajtur performancën maksimale normale dhe i matur në raport me gjendjen kur produkti ishte i ri;
11. **"qëndrueshmëria e baterisë në cikle"** është numri i cikleve të karikimit/shkarkimit që një bateri mund të përballojë derisa kapaciteti i saj elektrik i përdorshëm të arrijë 80% të kapacitetit të saj të vlerësuar, e shprehur në cikle;
12. **"ENDdevice [h]"** është qëndrueshmëria e baterisë për cikël e llogaritur si një vlerë mesatare vjetore bazuar në qëndrueshmërinë e matur për funksione të caktuara, duke përfshirë gjendjen e gatishmërisë, e shprehur në orë;
13. **"C"** është një masë e normës me të cilën një bateri karikohet në raport me kapacitetin e saj, e përcaktuar si rryma e karikimit e ndarë me kapacitetin, e shprehur në 1/h
14. **"tensioni nominal"** është tensioni i një baterie i matur në pikën e mesme midis gjendjes së saj të karikuar plotësisht dhe të zbrazur plotësisht bazuar në normën e shkarkimit 0,2 C;
15. **"tensioni përfundimtar për testin e qëndrueshmërisë së baterisë në cikle"** është tensioni i përcaktuar në qark të mbyllur, në të cilin përfundon një shkarkim i baterisë gjatë testit;
16. **"treguesi i efiçencës së energjisë"** është raporti midis qëndrueshmërisë së baterisë për cikël (ENDdevice) dhe tensionit nominal të baterisë të shumëzuar me kapacitetin e saj të vlerësuar;
17. **"vlerësimi i mbrojtjes ndaj depërtimit"** është shkalla e mbrojtjes që ofron një mbështjellës ndaj depërtimit të objekteve të forta të huaja dhe/ose ndaj depërtimit të ujit, e matur sipas metodave të standardizuara të testimit dhe e shprehur me një sistem kodimi që tregon nivelin e kësaj mbrojtjeje;
18. **"gjendja e plotë e hapjes"** është një gjendje e pajisjes ku pjesët e lëvizshme të saj, si ekranet dhe tastierat, janë të hapura, të shpalosura ose të zgjatura në mënyrë të njëjtë, në mënyrë të tillë që sipërfaqja e projektuar e gjatësisë dhe gjerësisë të maksimizohet;
19. **"garanci"** është çdo ndërmarrje nga shitësi ose furnizuesi ndaj konsumatorit për të bërë një nga sa vijon:
    a) rimbursim të çmimit të paguar;
    b) zëvendësim, riparim ose trajtim në çfarëdo mënyre të telefonit inteligjent ose tabletit, nëse nuk plotëson specifikimet e përcaktuara në deklaratën e garancisë ose në reklamën përkatëse;

20. **"pjesë këmbimi"** është një pjesë të veçantë që mund të zëvendësojë një pjesë me funksion të njëjtë ose të ngjashëm në një telefon inteligjent (smartphone) ose tablet. Funksionaliteti i telefonit inteligjent ose tabletave rikthehet ose përmirësohet kur pjesa zëvendësohet nga një pjesë rezervë. Pjesë këmbimi mund të jenë pjesë të përdorura;
21. **"çmontim"** është një proces ku një produkt ndahet në pjesë dhe/ose përbërës të tij në mënyrë të tillë që më pas të mund të rimontohet dhe të vihet në funksion;
22. **"mbërthyes"** është një pajisje harduerike ose substancë që mekanikisht, magnetikisht ose me mjete të tjera lidh ose rregullon dy ose më shumë objekte, në pjesë ose komponente.

Një pajisje harduerike e cila përveç kësaj shërben për një funksion elektrik do të konsiderohet gjithashtu një mbërthyes;

23. **"mbërthyes i ripërdorshëm"** është një mbërthyes që mund të ripërdoret plotësisht në rimontim për të njëjtin qëllim dhe që nuk dëmton as produktin, as vetë fiksimin gjatë procesit të çmontimit ose rimontimit në një mënyrë që e bën ripërdorimin e tyre të shumëfishtë të pamundur;
24. **"mbërthyes i rifurnizuar"** është një mbërthyes i lëvizshëm që furnizohet pa kosto shtesë me pjesën rezervë që synohet të lidhë ose rregullojë; ngjitësit konsiderohen si lidhës të rifurnizuar nëse furnizohen me pjesën rezervë në një sasi që është e mjaftueshme për rimontim, pa kosto shtesë;
25. **"mbërthyes i heqshëm"** është një mbërthyes që nuk është një mbërthyes i ripërdorshëm, por heqja e të cilit nuk e dëmton produktin ose nuk lë mbetje që ndalojnë rimontimin;
26. **"hap"** është një operacion që përfundon me heqjen e një pjese (ose tufe pjeshësh) ose me ndryshimin e mjetit; çdo vendosje e një pjese larg vendndodhjes së saj fillestare, edhe nëse kjo kërkon shkëputje të pjesshme ose heqje nga priza, do të konsiderohet gjithashtu si heqje;
27. **"përditësimi i sigurisë"** është një përditësim i sistemit operativ, duke përfshirë përditësimet e sigurisë, nëse janë të rëndësishme për një pajisje të caktuar, qëllimi kryesor i të cilave është të ofrojë siguri të shtuar për pajisjen;
28. **përditësim korrigjues"** është një përditësim i sistemit operativ, duke përfshirë përditësimet korrigjuese, qëllimi i të cilave është të sigurojë korrigjime të defekteve, gabimeve ose keqfunksionimeve në sistemin operativ;
29. **"përditësimi i funksionalitetit"** është një përditësim i sistemit operativ, qëllimi kryesor i të cilit është zbatimi i funksionaliteteve të reja;
30. **"bateri"** është çdo pjesë që përbëhet nga një ose disa qeliza baterie, duke përfshirë, sipas modelit të produktit, një qark elektronik me sensorë të lidhur me baterinë për menaxhimin e baterisë, mbështjellësen, mbajtësen e baterisë, stafat fiksuese, mbrojtëset, materialet e ndërfaqes termike dhe lidhjet elektrike me grupe të tjera të pajisjes;
31. **"mbulesë e pasme"** ose **"grupi i mbulesës së pasme"** është mbështjellësja kryesore e pjesës së pasme, duke përfshirë një ose më shumë nga elementët e mëposhtëm, sipas modelit të produktit: korniza, një shtresë mbulese e pasme e ngjitur në trupin kryesor të kapakut të pasmë, mbulesat e lenteve të kamerës me pamje nga pas, antenat e printuara, stafat e fiksimit, mburojat, guarnicionet, lidhjet elektrike me grupe të tjera të pajisjes dhe materialet e ndërfaqes termike;
32. **"mikrofon ndihmës"** është një mikrofon që nuk është thelbësor për sinjalet zanore të përdoruesit, por ofron funksione dytësore, të tilla si, por pa u kufizuar në, reduktimi i zhurmës së ambientit;
33. **"grupi i kamerës së përparme"** është çdo pjesë që përbëhet nga një ose disa kamera të orientuara drejt përdoruesit të pajisjes, duke përfshirë, në varësi të modelit të produktit:
    a) komponentët e kamerës dhe sensorët përkatës;

b) komponentë ndriçues (elektrik dore);
c) komponente optike;
d) komponentët mekanikë të nevojshëm për funksione të tilla si stabilizimi i imazhit dhe fokusimi;
e) mbështjellëset e modulit;
f) stafa fiksimi;
g) mburoja;
h) dritat sinjalizuese;
i) mikrofona ndihmës;
j) lidhjet elektrike me grupime të tjera të pajisjes;

34. **"grupi i kamerës së pasme"** është çdo pjesë që përbëhet nga një ose disa kamera të orientuara në anën e pasme të pajisjes, duke përfshirë, në varësi të modelit të produktit:
    a) komponentët e kamerës dhe sensorët përkatës;
    b) komponentë ndriçues (elektrik dore);
    c) komponente optike;
    d) komponentët mekanikë të nevojshëm për funksione të tilla si stabilizimi i imazhit dhe fokusimi;
    e) mbështjellëset e modulit;
    f) stafa fiksimi;
    g) mburoja;
    h) mikrofona ndihmës;
    i) lidhjet elektrike me grupime të tjera të pajisjes;
35. **"lidhës i jashtëm audio"** është një lidhës për sinjalet audio për t'u lidhur me një kufje ose altoparlantë të jashtëm ose pajisje të ngjashme audio, duke përfshirë, në varësi të modelit të produktit, stafa fiksimi, guarnicione dhe lidhje elektrike me grupime të tjera të pajisjes;
36. **"portë e jashtme e karikimit"** është një portë për karikimin e baterisë me kabull, e përdorur ndoshta edhe për shkëmbimin e të dhënave dhe karikimin në krah të kundërt të një pajisjeje tjetër, e cila përbëhet nga një prizë USB-C dhe një mbështjellëse të lidhur dhe duke përfshirë në varësi të modelit të produktit,stafat e fiksimit, guarnicionet dhe lidhjet elektrike me grupime të tjera të pajisjes;

37. **"buton mekanik"** është një çelës mekanik ose një grup çelësash mekanikë që mund të shtypen ose një buton rrëshqitës që mund të lëvizet mekanikisht për të ndezur ose fikur funksione të tilla si volumi, ndezja e kamerës ose ndezja ose fikja e pajisje dhe duke përfshirë, në varësi të modelit të produktit, stafa fiksimi, guarnicione dhe lidhje elektrike me grupime të tjera të pajisjes;
38. **"mikrofon(at) kryesor"** është/janë mikrofon(i/et) i/e destinuar për sinjalet zanore të përdoruesit, duke përfshirë, në varësi të modelit të produktit, guarnicionet dhe lidhjet elektrike me grupimet e tjera të pajisjes;

39. **"altoparlant"** janë të gjithë altoparlantët dhe pjesët mekanike për të gjeneruar zë, duke përfshirë, në varësi të modelit të produktit, mbështjellësen e modulit, guarnicionet dhe lidhjet elektrike me grupime të tjera të pajisjes;
40. **"grupimi i menteshës"** është një pjesë që lejon një pajisje të paloset duke ruajtur integritetin e saj funksional, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, mbështjellëset e moduleve;
41. **"mekanizëm mekanik i palosjes së ekranit"** është një pjesë që lejon një pajisje, duke përfshirë ekranin e saj, të paloset duke ruajtur integritetin e saj funksional;
42. **"karikues"** është një furnizues i jashtëm me energji elektrike për të ngarkuar baterinë dhe për të siguruar energji elektrike për një telefon celular, telefon pa kabull ose tabletë me prekje;
43. **"grupimi i ekranit"** është grupimi i njësisë së ekranit dhe aty ku është e rëndësishme njësinë e dixhitalizimit të panelit të përparmë, duke përfshirë, në varësi të modelit të produktit:
    a) pllakën e pasme;
    b) mburojat;
    c) kornizën e ekranit;
    d) njësi të dritës së pasme;
    e) qarkun elektronik duke përfshirë:
    i. qarkun e integruar të ekranit, por duke përjashtuar funksionalitetin e njësisë kryesore të përpunimit të grafikës;
    ii. kontrollorët e rreshtave dhe kolonave;
    iii. qarku i sinjalit me prekje;
    iv. lidhjet elektrike me grupime të tjera të pajisjes;
44. **"riparues profesionist"** është një operator ose ndërmarrje që kryen riparimin dhe mirëmbajtjen profesionale të telefonave inteligjentë ose tabletave, qoftë si shërbim ose me qëllim rishitjen e mëvonshme të pajisjes së riparuar;
45. **"informacion për riparimin dhe mirëmbajtjen"** përfshin informacionin e riparimit dhe mirëmbajtjes të Shtojcës I, pika B 1.1(2e) dhe të pikes D 1.1 (2e), që prodhuesit, importuesit ose përfaqësuesit e autorizuar ofrojnë akses në lidhje me produktin përkatës;

46. **"data e vendosjes në treg"** është data e vendosjes në treg të njësisë së parë të një modeli produkti;
47. **"data e përfundimit të vendosjes në treg"** është data e vendosjes në treg të njësisë së fundit të një modeli produkti;
48. **"mjet pronësor"** është një mjet që nuk është i disponueshëm për t'u blerë nga publiku i gjerë ose për të cilin çdo patentë e zbatueshme nuk është e disponueshme për t'u licencuar me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese;
49. **"vegla bazë"** është një kaçavidë për kokat me kanal, një kaçavidë për vida kryq, një kaçavidë për kokat e prerjes heksalobulare, një çelës me fole gjashtëkëndore, një çelës të

kombinuar, pincë të kombinuar, pincë të kombinuar për heqjen e telave dhe shtrëngimin e terminalit, pincë me hundë gjysmë të rrumbullakët, prerëse diagonale, pincë me shumë kapje, pincë bllokuese, një levë, piskatore, lente zmadhues, një sfungjer dhe një kazmë;

50. **"mjet i disponueshëm në treg"** është një mjet që është i disponueshëm për t'u blerë nga publiku i gjerë dhe nuk është as një mjet bazë dhe as një mjet pronësor;
51. **"mbulesë mbrojtëse e veçantë"** është një mbulesë mbrojtëse që mund të dërgohet me një telefon inteligjent ose tablet, por nuk shërben si pjesë e kërkuar e mbështjellëses dhe nuk konsiderohet pjesë përbërëse e produktit.

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

A. **Furnizuesit sigurojnë që:**

1. Çdo telefon inteligjent ose tabletë pajiset me një etiketë të printuar sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën II;
2. Vlerat e parametrave të skedës informative të produktit, të përcaktuara në Shtojcën IV, regjistrohen në pjesën publike të bazës së të dhënave të produktit;
3. Skeda informative e produktit vihet në dispozicion në formë të printuar në rast kërkese nga tregtari;
4. Përmbajtja e dokumentacionit teknik, siç përcaktohet në Shtojcën V, regjistrohet në bazën e të dhënave të produktit;
5. Çdo reklamë pamore për një model specifik të smartphone-ve ose tabletave përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcat VI dhe VII;
6. Çdo material teknik promovues për një model specifik të smartphone-ve ose tabletave, përfshirë materialin teknik promovues në internet, që përshkruan parametrat teknikë të tij, përfshin klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI;
7. Një etiketë elektronike në formatin dhe me përmbajtje informacioni siç përcaktohet në Shtojcën II, vihet në dispozicion tregtarëve për çdo model telefoni inteligjent (smartphone) ose tableti;
8. Një skedë informative për produktin, u vihet në dispozicion tregtarëve në format elektronik për çdo model telefoni inteligjent (smartphone) ose tableti siç përcaktohet në Shtojcën V;

B. Klasa e efiçencës së energjisë dhe klasa e qëndrueshmërisë ndaj rënies së përsëritur, siç përcaktohet në Shtojcën I, llogariten sipas Shtojcës IV.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

Tregtarët sigurojnë që:

1. Çdo telefoni inteligjent (smartphone) dhe tabletë, e paraqitur në pikën e shitjes, duke përfshirë panairet tregtare, është e pajisur me etiketën e dhënë nga furnizuesi në përputhje me pikën (1) të kreut III(A), të vendosur në afërsi të produktit ose në pjesën e sipërme të produktit, ose e vendosur në mënyrë që etiketa të jetë qartësisht e dukshme dhe e identifikueshme me modelin specifik;
2. Për shitjet në distancë, etiketa dhe skeda informative e produktit sigurohen në përputhje me Shtojcat VI dhe VII;
3. Çdo reklamë pamore për një model specifik të smartphone-ve ose tabletave, përfshirë ato në internet, përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI;
4. Çdo material teknik promovues për një model specifik të telefonave inteligjent (smartphone-ve) ose tabletave, përfshirë materialin teknik promovues në internet, që përshkruan parametrat teknikë të tij, përfshin klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI.

V. MATJET DHE METODAT E LLOGARITJES

Informacioni që sigurohet në përputhje me krerët III dhe IV merret përmes metodave të matjes dhe llogaritjes që janë të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, të cilat marrin parasysh metodat e njohura të matjes dhe llogaritjes, siç përcaktohet në Shtojcën III.

VI. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA I
Klasat e efiçencës së energjisë

A. Klasa e efiçencës së energjisë së një telefoni inteligjent ose një tableti me prekje përcaktohet në bazë të Indeksit të tij të Efiçencës së Energjisë (EEI) siç përcaktohet në Tabelën 1 për telefonat inteligjentë dhe Tabelën 2 për tabletat me prekje. EEI-ja e një telefoni inteligjent ose një tableti me prekje përcaktohet në përputhje me Shtojcën III, pika 1.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë së smartphonëve

Klasa e Efiçiencës së Energjisë	**Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI)**
A (më efiçente)	EEI > 2,70
B	2,30 < EEI ≤ 2,70
C	1,95 < EEI ≤ 2,30
D	1,66 < EEI ≤ 1,95
E	1,41 < EEI ≤ 1,66
F	1,20 < EEI ≤ 1,41
G (me pak efiçente)	EEI ≤ 1,20

Tabela 2

Klasat e efiçencës së energjisë së tabletave me prekje

Klasa e Efiçiencës së Energjisë	**Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI)**
A (më efiçente)	EEI > 7,90
B	6,32 < EEI ≤ 7,90
C	5,06 < EEI ≤ 6,32
D	4,04 < EEI ≤ 5,06
E	3,24 < EEI ≤ 4,04
F	2,59 < EEI ≤ 3,24
G (me pak efiçente)	EEI ≤ 2,59

B. Klasa e besueshmërisë së rënies së lirë të përsëritur të një telefoni inteligjent ose një tableti me prekje përcaktohet në bazë të numrit të rënieve pa defekt siç përcaktohet në Tabelën 3. Numri i rënieve pa defekt përcaktohet në përputhje me Shtojcën III, pika 4.

Tabela 3

Klasa e besueshmërisë së rënies së lirë të përsëritur të telefonave inteligjentë dhe tabletave me prekje

	Bie pa defekt

Klasa e besueshmërisë së rënies së lirë të përsëritur	Telefon inteligjent (smartphone) jo i palosshëm	Tabletë me prekje që nuk paloset	Telefon inteligjent (Smartphone) i palosshëm	Tabletë e palosshme me prekje
A (më e forta)	n ≥ 270	n ≥ 208	n ≥ 210 (në gjendje të pazgjeruar) dhe n ≥ 45 (në gjendje plotësisht të zgjatur)	n ≥ 182 (në gjendje të pazgjeruar) dhe n ≥ 20 (në gjendje plotësisht të zgjatur)
B	180 ≤ n < 270	156 ≤ n < 208	140 ≤ n < 210 (në gjendje jo të zgjatur) dhe 35 ≤ n < 45 (në gjendje plotësisht të zgjatur)	130 ≤ n < 182 (në gjendje jo të zgjatur) dhe 15 ≤ n < 20 (në gjendje plotësisht të zgjatur)
C	90 ≤ n < 180	104 ≤ n < 156	70 ≤ n < 140 (në gjendje të pazgjeruar) dhe 25 ≤ n < 35 (në gjendje plotësisht të zgjatur)	78 ≤ n < 130 (në gjendje të pazgjeruar) dhe 10 ≤ n < 15 (në gjendje plotësisht të zgjatur)
D	45 ≤ n < 90	52 ≤ n < 104	35 ≤ n < 70 (në gjendje të pazgjeruar) dhe 15 ≤ n < 25 (në gjendje plotësisht të zgjatur)	52 ≤ n < 78 (në gjendje të pazgjeruar) dhe 5 ≤ n < 10 (në gjendje plotësisht të zgjatur)
E (më pak e fortë)	-	n < 52	-	n < 52 (në gjendje të pazgjeruar) dhe n < 5 (në gjendje plotësisht të zgjatur)

C. Klasa e riparueshmërisë së një telefoni inteligjent ose një tableti me prekje përcaktohet në bazë të indeksit të riparueshmërisë siç përcaktohet në tabelën 4. Indeksi i riparueshmërisë përcaktohet në përputhje me Shtojcën III, pika 5.

Tabela 4

Klasat e riparueshmërisë së telefonave inteligjentë dhe tabletave me prekje

Klasa e Riparimit	Indeksi i riparimit (R)
A (më i riparueshëm)	R ≥ 4,00
B	4,00 > R ≥ 3,35
C	3,35 > R ≥ 2,55
D	2,55 > R ≥ 1,75
E (më pak i riparueshëm)	1,75 > R ≥ 1,00

SHTOJCA II
Etiketë për telefonat inteligjentë dhe tabletat me prekje

1. ETIKETA PËR TELEFONAT INTELIGJENTË DHE TABLETAT ME PREKJE
Etiketa:



Informacioni i mëposhtëm përfshihet në etiketën për telefonat inteligjentë (smartphone) dhe tabletat me prekje:

(I) Një kod QR;
(II) Marka tregtare;
(III) Identifikuesi i modelit të furnizuesit;
(IV) Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A në G;
(V) Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me Shtojcën I;
(a)vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik në përputhje me nenin 3 pika 3 të ligjit Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" (vlerat e deklaruara), dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit;

(b)vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën informative të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e efiçencës së energjisë, klasa e besueshmërisë së rënies së lirë të përsëritur dhe klasa e riparueshmërisë nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara;

(c) kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (që janë vlerat e parametrave përkatës të matur në testim dhe vlerat e llogaritura nga ato matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 10;

(ç)kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston pesë njësi të modelit për besueshmërinë e rënies së lirë të përsëritur, vlerat e përcaktuara (që janë vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga ato matje) përputhen me shkallën përkatëse të kalimit siç është dhënë. në tabelën 11;

(d)kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston pesë njësi të modelit për qëndrueshmërinë e baterisë në cikle, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara (që janë vlerat e parametrave përkatës të matur në testim dhe vlerat e llogaritura nga ato matje) përputhen me vlerat përkatëse. tolerancat e verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 10.

3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a), (b) dhe (d) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet barazvlefshme konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.
4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zgjedh tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim, me përjashtim të rezultatit të indeksit të riparueshmërisë. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve të barazvlefshme. Për sa i përket indeksit të riparueshmërisë, nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zgjedh një njësi shtesë të të njëjtit model për testim.
5. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(ç) nuk arrihet, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zgjedh pesë njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, pesë njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve të barazvlefshme.
6. Modeli konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse për tre njësitë e testuara në përputhje me pikën 4, aty ku është e zbatueshme, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 10, me përjashtim të rezultatit të indeksit të riparueshmërisë , ku modeli do të konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse vlera e përcaktuar përputhet me tolerancën përkatëse të dhënë në Tabelën 10.
7. Modeli konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme nëse për pesë njësitë e testuara në përputhje me pikën 5, aty ku është e zbatueshme, shkalla e kalueshmërisë përputhet me vlerat përkatëse të dhëna në Tabelën 11.
8. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 6 ose 7 nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet e barazvlefshme konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore, me përjashtim të rezultatit të indeksit të riparueshmërisë, ku modeli konsiderohet se nuk përputhet me këtë rregullore.
9. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut vendos masa administrative në përputhje me ligjin Nr.52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" në rastet e konstatimit të mospërputhjes së modelit.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën III.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në tabelën 10 dhe normën e kalueshmërisë të përcaktuar në tabelën 11 dhe përdorin vetëm procedurën e përcaktuar në pikat 1 deri në 9 për kërkesat e përmendura në këtë Shtojcë. Për

parametrat në Tabelën 10, nuk zbatohen toleranca të tjera, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 10

Tolerancat e verifikimit për parametrat e matur

Parametrat	**Tolerancat e verifikimit**
qëndrueshmëria e baterisë për cikël (pajisja END [h])	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 3 % më e ulët se vlera e deklaruar.
qëndrueshmëria e baterisë në cikle – cilësimet e paracaktuara [ciklet]	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 20 cikle më e ulët se vlera e deklaruar.
kapaciteti i vlerësuar i baterisë (I vendosur [mAh])	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 10 % më e lartë se vlera e deklaruar.
Tensioni nominal [V]	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 2 % më e lartë se vlera e deklaruar.
Tensioni përfundimtar për qëndrueshmërinë e baterisë në testin e cikleve [V]	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 2 % më e lartë se vlera e deklaruar.
treguesi i riparueshmërisë (R)	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më shumë se 4 % më e ulët se vlera e deklaruar.

Tabela 11

Normat e kalimit për rezistencën ndaj rënieve aksidentale

Parametrat	**Tolerancat e normës së kalimit**
rezistenca ndaj rënieve aksidentale	Vlera e përcaktuar që korrespondon me vlerën e deklaruar duhet të plotësohet nga të paktën 80% e njësive të testuara.

ANEKS NR.15

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË MAKINAVE THARËSE PËR PËRDORIM SHTËPIAK"[1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin dhe dhënien e informacionit plotësues për tharëset për përdorim shtëpiak që funksionojnë me energji elektrike, me gaz, si dhe tharëset për përdorim shtëpiak të instaluara në një dollap (incaso), tharëset për përdorim shtëpiak me shumë kazan dhe tharëset për përdorim shtëpiak që funksionojnë me energji elektrike, të cilat mund të punojnë gjithashtu me bateri.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
   (a) Pajisjet për përdorim shtëpiak me funksion të kombinuar larje-tharje dhe pajisjet tharëse me centrifugim për përdorim shtëpiak.
   (b) tharëse për përdorim shtëpiak që funksionojnë me bateri, të cilat mund të lidhen me rrjetin elektrik përmes një transformatori të pavarur AC/DC.

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Rrjeti e energjisë elektrike"** është tërësia e linjave, nënstacioneve, pajisjeve të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë linjat e interkoneksionit sipas Ligjit Nr. 43/2015;
2. **"Tharëse për përdorim shtëpiak"** është një pajisje në të cilën rrobat thahen duke u rrotulluar në një kazan cilindrik rrotullues nëpër të cilin kalon ajri i nxehtë;
3. **"Tharëse për përdorim shtëpiak e parashikuar për tu instaluar në një mobilje"** është një pajisje që është projektuar, testuar dhe tregtuar ekskluzivisht në përputhje me karakteristikat si më poshtë:

a) për t'u instaluar në një mobilje ose të mbështjellë (sipër dhe/ose poshtë, dhe anët) me panele;
b) për t'u lidhur mirë në anët, në pjesën e sipërme ose në dyshemenë e ndarjeve ose paneleve;

Kjo rregullore është përafruar plotësisht me Rregulloren e Delegatuar të Komisionit Nr 2023/2534 e datës 13 korrik 2023 që plotëson Rregulloren Nr 2017/1369 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me etiketimin energjetik të tharëseve për përdorim shtëpiak dhe shfuqizimin e Rregullores së deleguar të Komisionit (BE) Nr 392/2012. Numri CELEX 32023R2534, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. *2023/2534*, datë 22.11.2023, f. 1.

c) të jetë e pajisur me një derë ballore të integruar me pajisjen tharëse ose të pajiset me një panel të përparmë të veçuar nga pajisja tharëse;

4. **"Pajisje e integruar Larëse-Tharëse për përdorim shtëpiak"** është një pajisje e integruar që kombinon funksionet e larjes dhe të tharjes së rrobave në të njëjtin kazan, e projektuar kryesisht për përdorim shtëpiak;
5. **"Tharëse me centrifugim"** e njohur me emrin tregtar si "tharëse centrifugale" është një pajisje në të cilën uji largohet nga rrobat nëpërmjet veprimit centrifugal në një kazan cilindrik rrotullues dhe kullohet përmes një pompe automatike ose nga graviteti e cila është projektuar për t'u përdorur kryesisht për qëllime jo profesionale;
6. **"Program"** është seria e veprimeve që janë të përcaktuaradhe të deklaruara nga furnizuesi si të përshtatshme për tharjen e disa llojeve të tekstilit;
7. **"Pikë shitje"** është vendi ku tharëset për përdorim shtëpiak ekspozohen, ofrohen për shitje, qira ose blerje me këste
8. **"Tharëse për përdorim shtëpiak me shumë daulle"** është një tharëse për përdorim shtëpiak e pajisur me më shumë se një kazan, në të njëjtën njësi ose në njësi të veçanta;
9. **"Tharëse me ajër"** është një tharëse për përdorim shtëpiak që thith ajër të pastër, e kalon atë mbi rrobat dhe e nxjerr ajrin e lagësht te përftuar në dhomë ose jashtë;
10. **'Tharëse me kondensim"** është një tharëse për përdorim shtëpiak që ka një pajisje (duke përdorur kondendesator ose çdo mjet tjetër), për largimin e lagështirës nëpërmjet ajrit të përdorur në procesin e tharjes;
11. **"Tharëse me gaz"** është një tharëse për përdorim shtëpiak që përdor gaz për të ngrohur ajrin e brendshëm;
12. **"Indeksi i Efiçencës së Energjisë" ose "IEE"** është raporti i konsumit vjetor të energjisë ndaj konsumit të energjisë të një cikli standard të tharjes për një model specifik të tharëseve për përdorim shtëpiak;
13. **"Cikël tharjeje"** është procesi i plotë i tharjes, sipas përcaktimit në programin e zgjedhur, i përbërë nga një sërë veprimesh të ndryshme duke përfshirë ngrohjen dhe largimin e ujit;
14. **"Kohëzgjatja e programit"** është koha nga fillimi i programit të zgjedhur deri në përfundim të tij, duke përjashtuar çdo vonesë të programuar nga përdoruesi, derisa të aktivizohet një tregues i përfundimit të programit dhe përdoruesi të ketë akses në produktin e tharë
15. **"Kapaciteti nominal"** është masa maksimale në kilogram, e deklaruar nga prodhuesi, importuesi ose përfaqësuesi i autorizuar, në intervale prej 0,5 kilogramësh, të rrobave të thata të një lloji të caktuar, të cilat mund të trajtohen në një tharëse për përdorim shtëpiak sipas programit të përzgjedhur kur është e ngarkuar sipas udhëzimeve të prodhuesit;
16. **"Ngarkesë e plotë"** është kapaciteti nominal për një program të caktuar që ka një tharëse për përdorim shtëpiak;
17. **"Ngarkesë e pjesshme"** është gjysma e kapacitetit nominal të një tharëse për përdorim shtëpiak, për një program të caktuar;
18. **"Efiçenca e kondensimit"** është raporti midis masës së kondensuar të lagështirës në tharëset me kondensim dhe masës së lagështirës së larguar nga ngarkesa në fund të një cikli tharjeje;

19. **"Kodi i përgjigjes së shpejtë" ose "kodi QR"** është një barkod matricë, në përbërjen e etiketës së energjisë së një model produkti nëpërmjet të cilit shfaqet informacioni mbi këtë model në bazën e të dhënave të këtij produktit;
20. **"Opsion i stakuar"** është një gjendje në të cilën tharësja për përdorim shtëpiak është e lidhur me rrjetin elektrik por nuk ofron asnjë funksion, duke përfshirë kushtet e mëposhtme:
a. kushtet që ofrojnë vetëm një tregues i opsionit joaktiv;
b. kushtet që ofrojnë vetëm funksione të destinuara për të siguruar përputhshmërinë elektromagnetike;
21. "**Opsion i ndezur"** është një gjendje ku tharësja për përdorim shtëpiak është e lidhur me rrjetin elektrik dhe ofron të gjitha funksionet të cilat mund të vazhdojnë për një kohë të pacaktuar ose disa prej tyre si më poshtë:
a) funksioni i riaktivizimit ose funksioni i riaktivizimit dhe treguesi i funksionit të aktivizuar të riaktivizimit;
b) funksioni i riaktivizimit përmes lidhjes me rrjetin ("gatishmëria e rrjetit");
c) informacioni ose shfaqja e statusit;
ç) funksioni evidentues për masat emergjente;
22. **"Funksioni mbrojtës i rrudhave"** është një funksion i tharëses për përdorim shtëpiak, pas përfundimit të një programi, për parandalimin e krijimit të tepërt të rrudhave në tekstilet e thara;
23. **"Fillimi me vonesë"** është një gjendje ku përdoruesi ka zgjedhur një vonesë të specifikuar në fillim ose në fund të ciklit të tharjes të programit të zgjedhur;
24. **"Mekanizmi i shfaqjes"** është një ekran, duke përfshirë ekranin e prekshëm, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;
25. **"Ekran i mbivendosur"** është një shfaqje vizuale ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrokullisje të mausit ose me një zgjerim të ekranit me prekje të një imazhi ose grupi të dhënash tjetër;
26. **"Ekran me prekje"** është një ekran që i përgjigjet komandave te pajisjes nëpërmjet prekjes, si në rastin e një kompjuteri tablet ose një smartphone;
27. **"Tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një imazhi grafik që lejon që informacioni të paraqitet në formë jo grafike kur një pajisje ekrani nuk mund të japë imazhin grafik ose si një ndihmë për aksesueshmërinë, si p.sh. të dhëna për aplikacionet e sintezës së zërit;
28. **"Programi ekologjik"** është një program që është në gjendje të thajë rrobat e pambukut nga një përmbajtje lagështire fillestare e ngarkesës prej 60% deri në një përmbajtje lagështire përfundimtare të ngarkesës prej 0%.
29. **"Përmbajtja fillestare e lagështirës"** është sasia e lagështirës që përmban ngarkesa në fillim të ciklit të tharjes;
30. **"Përmbajtja përfundimtare e lagështirës"** është sasia e lagështirës që përmbahet në ngarkesë në fund të ciklit të tharjes;
31. **"Garanci"** është çdo veprim i ndërmarrë nga tregtari ose furnizuesi për konsumatorin për të rimbursuar çmimin e paguar, ose për të zëvendësuar,

riparuar ose trajtuar tharësen për përdorim shtëpiak në çfarëdo mënyre, nëse ajo nuk plotëson specifikimet e përcaktuara në deklaratën e garancisë ose në reklamat përkatëse;

32. **"vlerat e deklaruara"** janë vlerat e ofruara nga furnizuesi për parametrat teknikë të deklaruar, të llogaritur ose të matur sipas konformitetit te kryer nga organet përkatëse;
33. **"Koeficienti i konvertimit"** (CC) është koeficienti i paracaktuar për energjinë primare në kWh energji elektrike. Vlera e koeficientit të konvertimit është CC = 1,9.

III. DETYRIMET E FURNIZUESVE.

1. Furnizuesit e tharëseve për përdorim shtëpiak sigurojnë që pajisjet të kenë:

a) çdo tharëse për përdorim shtëpiak pajiset me një etiketë të printuar në formatin e përcaktuar në Shtojcën II d, ndërsa tharëset për përdorim shtëpiak me shumë kazan pajisen me një etiketë të printuar në formatin e përcaktuar në përputhje me Shtojcën IX;

b) vlerat për parametrat e skedës informative të produktit, të përcaktuara në Shtojcën IV, vendosen në pjesën publike të bazës së të dhënave të produktit;

c) me kërkesë të tregtarëve, skeda informative e produktit u vendoset në dispozicion në formë të printuar;

ç) përmbajtja e dokumentacionit teknik të përcaktuar në shtojcën V vendoset në skedën informative të të dhënave të produktit;

d) çdo reklamë vizuale në lidhje me një model specifik të tharëses për përdorim shtëpiak përmban klasën dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë në përputhje me shtojcat VI dhe VII;

dh) çdo material teknik promovues lidhur me një model specifik të tharëseve për përdorim shtëpiak, duke përfshirë materialin teknik promovues të afishuar në internet, i cili përshkruan parametrat e tij specifik teknik, përfshin klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI;

e) tregtarëve u vendoset në dispozicion një etiketë elektronike e cila përmban informacionin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën II, për çdo model të tharëseve për përdorim shtëpiak;

ë) tregtarëve u vendoset në dispozicion një skedë informative elektronike për produktin, siç përcaktohet në Shtojcën IV, për çdo model të tharëseve për përdorim shtëpiak .

2. Klasa e efiçencës së energjisë, klasa e emetimit të zhurmës akustike nga ajri ose sipas rastit, klasa e efiçencës së kondensimit, siç përcaktohet në shtojcën I, llogariten në përputhje me Shtojcën III.

3. Nga data 1 Qershor 2025, furnizuesit që prodhojnë tharëse për përdorim shtëpiak në Republikën e Shqipërisë duhet të plotësojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën

VII dhe ta shfaqin në faqen e tyre të internetit përpara se të hedhin në treg një ndriçues të prodhuar pas kësaj date;

4. Për furnizuesit që eksportojnë produktet e prodhuara në Bashkimin Europian, duhet të plotësojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën VII në bazën e të dhënave europiane të produkteve përpara se të hedhin në treg një ndriçues të prodhuar pas kësaj date.

IV. DETYRIMET E TREGTARËVE.

Tregtarët e tharëseve për përdorim shtëpiak sigurojnë që:

(a) çdo tharëse për përdorim shtëpiak në pikën e shitjes dhe/ose e ekspozuar në panairet tregtare, të jetë e pajisur me etiketën e vendosur nga furnitorët në përputhje me pikën 1/a të Kreut III si dhe me etiketën e vendosur në pajisjet e integruara larëse-tharëse për përdorim shtëpiak, në pozicion qartësisht të dukshëm në pjesën e jashtme të përparme ose në pjesën e sipërme të pajisjes;

(b) në rast të shitjes në distancë, etiketa dhe skeda e informative e produktit sigurohen të jenë në përputhje me shtojcat VI dhe VII;

(c) çdo reklamë vizuale për një model specifik të tharëseve për përdorim shtëpiak, duke përfshirë edhe reklamën në internet, përmban klasën e efiçencës së energjisë dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcën VI;

(d) çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik të tharëses për përdorim shtëpiak, duke përfshirë materialin promovues teknik në internet, i cili përshkruan parametrat e tij specifik teknik, përfshin klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, në përputhje me shtojcaVI.

V. METODAT E MATJES DHE LLOGARITJES.

Informacioni që jepet në përputhje me krerët III dhe IV merret me metoda të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më moderne të matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën III.

VI. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR QËLLIM MBIKQYRJEN E TREGUT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

VII. SHFUQIZIMI

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Vendimi Nr. 296, datë 03.04.2013.

SHTOJCA I

Klasa e efiçencës së energjisë, klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër dhe klasa e efiçencës së kondestimit.

1. KLASA E EFIÇENCËS SË ENERGJISË

Klasa e efiçencës së energjisë së një tharëseje për përdorim shtëpiak përcaktohet në bazë të indeksit të efiçencës së energjisë ("EEI") siç përcaktohet në Tabelën 1.
EEI përcaktohet në përputhje me seksionin 1 të Shtojca III.

Tabela 1

Klasa e efiçencës së energjisë

Klasa e efiçencës së energjisë	Indeksi i efiçencës së energjisë ("EEI")
A (më efiçent)	EEI ≤ 43
B	43 < EEI ≤ 50
C	50 < EEI ≤ 60
D	60 < EEI ≤ 70
E	70 < EEI ≤ 85
F	85 < EEI ≤ 100
G (më pak efiçent)	EEI > 100

2. KLASA AKUSTIKE LIDHUR ME SHKARKIMIN ZHURMAVE NË AJËR

Emetimi i zhurmës akustike në ajër të një tharëseje për përdorim shtëpiak përcaktohet si vlera mesatare e vjetore (LWA) e fuqisë së zërit në programin ekologjik me ngarkesë të plotë gjatë ciklit të tharjes, e shprehur në dB(A) dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër do të përcaktohet në bazë të LWA siç përcaktohet në Tabelën 2.

Tabela 2

Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër

Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër	**Zhurma (dB(A))**
A	$L_{WA} \leq 60$
B	$60 < L_{WA} \leq 64$
C	$64 < L_{WA} \leq 68$
D	L_{WA} > 68

3. KLASA E EFIÇENCËS SË KONDENSIMIT

Klasa e efiçencës së kondensimit përcaktohet në bazë të efiçencës vjetore të kondensimit siç përcaktohet në tabelën 3.

Tabela 3

Klasa e efiçencës së kondensimit

Klasa e efiçencës së kondensimit	**Efiçenca e vjetore e kondensimit**
A	Ct ≥ 94
B	88 ≤ Ct < 94
C	82 ≤ Ct < 88
D	Ct < 82

SHTOJCA II
Etiketa

A. Etiketa për tharëset për përdorim shtëpiak me kondensim
1. Etiketa për tharëset për përdorim shtëpiak me kondensim

Figura 1



1.1. Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I Kodi QR;

II Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

III Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

IV Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A-ja tek G-ja;

V Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me Shtojcën I; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë të tharëses do të vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

VI Konsumi mesatar vjetor i energjisë për 100 cikle tharjeje në kWhkWh, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me Shtojcën III; në rastin e tharëseve me gaz, konsumi mesatar vjetor i energjisë (gaz dhe energji elektrike) për 100 cikle tharjeje në kWhkWh, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me shtojcën III.

VII Klasa e efiçencës të kondensimit e përcaktuar në përputhje me Shtojcën I, me logon dhe vlerën përkatëse të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt dhe të llogaritur në përputhje me Shtojcën III;

VIII Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër të ciklit të tharjes së programit ekologjik, me logon dhe vlerën përkatëse në dB(A), e përcaktuar në përputhje me seksionin 4 të shtojcës III;

IX Kapaciteti i vlerësuar, në kg, për programin ekologjik me ngarkesë të plotë;

X Programi ekologjik në h:min (orë:minuta) i rrumbullakosur në minutën më të afërt;ekologjik

XI Numri i kësaj rregulloreje, i cili është '2023/2534'.

1.2.Kur një modeli i është dhënë një "Etikete ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

2. Skicimi i etiketave për tharëset me kondensim

Figura 2



Ku:

(a) Etiketa është së paku 96 mm e gjerë dhe 192 mm e lartë, megjithatë kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme;

(b) Sfondi i etiketës është 100% i bardhë;

(c) Shkronjat janë në formatin Verdana;

(ç) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketën janë siç tregohet në skicimin e etiketës për tharëset per përdorim shtëpiak për ;

(d)Ngjyrat janë CMYK – cian, purpurt, e verdhë dhe e zezë sipas shembullit në vijim: 0,70,100,0: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % e zezë;

(dh) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat referohen figurës 2).

❶Ngjyrat e logos së BE-së janë si më poshtë:
- Sfondi: 100,80,0,0;
- Yjet: 0,0,100,0;

❷ Ngjyra e logos së energjisë është: 100,80,0,0;

❸ Kodi QR është 100% në ngjyrë të zezë;

❹ Emri i furnizuesit është 100% në ngjyrë të zezë dhe shkronjat janë në formatin Verdana, 9 pt;

❺ Identifikuesi i modelit është 100% në ngjyrë të zezë e me shkronjat në formatin Verdana Regular 9 pt;

❻ Shkalla nga A-ja deri tek G-ja është si më poshtë:
- Shkronjat e shkallës së eficencës së energjisë janë 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronjat në formatin Verdana Bold 16 pt; shkronjat pozicionohen në një bosht 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave;
- Ngjyrat e shigjetave të shkallës nga A-ja deri tek G-ja janë si më poshtë:
  - Klasa-A: 100,0,100,0;
  - Klasa-B: 70,0,100,0;
  - Klasa-C: 30,0,100,0;
  - Klasa-D: 0,0,100,0;
  - Klasa-E: 0,30,100,0;
  - Klasa-F: 0,70,100,0;
  - Klasa-G: 0,100,100,0;

❼ Ndarësit e brendshëm janë 80 mm të gjerë, kanë një nuancë prej 0,5 pt dhe ngjyra është 100% e zezë;

❽ Shigjeta treguese e klasës së efiçencës së energjisë është 100% në ngjyrë të zezë. Shkronja në shigjetën e klasës së eficencës së energjisë është 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja në formatin Verdana Bold 26 pt, e cila vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës. Shigjeta trguese e klasës së eficencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën nga A-ja deri tek G-ja pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara ne te njëjtin drejtim.

❾ Vlera e konsumit të vjetore të energjisë për 100 cikle tharje është me shkronja në ngjyrë të zezë Verdana Bold 28 pt; "kWh" është me shkronja në formatin Verdana Regular 18 pt; numri "100" në piktogramin që përfaqëson 100 cikle është me shkronja në formatin Verdana Regular 14 pt. Teksti është i pozicionuar në kolonë dhe në ngjyrë të zezë 100%;

❿ Piktogramet janë siç jepen në modelet e etiketave dhe si më poshtë:
- i. a) Vijat e piktogrameve kanë një nuancë prej 1,2 pt, ndërkohë që ato dhe tekstet (numrat dhe njësitë) janë 100 % në ngjyrë të zezë;

- ii. b) Shkallët nga A deri në D të piktogramit të eficencës së kondensimit dhe piktogramit të emetimit të zhurmës akustike në ajër janë të rreshtuara në një bosht vertikal në anën e majtë të ikonës, me shkronjën e klasës së eficencës së zbatueshme me Verdana Bold 12 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të eficencës në formatin Verdana Regular 8 pt;
- iii. c)Numri i piktogramit të eficencës së kondensimit është me shkronja në ngjyrë të zezë Verdana Bold 9 pt dhe njësia matëse në formatin Verdana Regular 9 pt, ku numri dhe njësia janë të pozicionuar pranë njëri-tjetrit dhe të qëndërzuar brenda piktogramit;

iv. numri i piktogramit të emetimit të zhurmës akustike në ajër është me shkronja në ngjyrë të zezë Verdana Bold 12 pt dhe njësia Verdana Regular 9 pt, me numrin dhe njësinë pranë njëra-tjetrës dhe të qëndërzuar brenda piktogramit;

v. numri i piktogramit të kapacitetit të vlerësuar është me shkronja të zeza Verdana Bold 16 pt dhe njësia matëse me Verdana Regular 12 pt, ku numri dhe njësia janë të pozicionuar pranë njëri-tjetrit dhe të qëndërzuar nën piktogram;

vi. numri i kohëzgjatjes së piktogramit të programit ekologjik është me shkronja Verdana Bold 16 pt, në ngjyrë të zezë, pika dhe do të qëndërzohet nën piktogram;

⓫ Numri i Rregullores është 100 % në ngjyrë të zezë dhe shkronjat janë në formatin Verdana Regular 6 pt.

B. Etiketa për tharëset për përdorim shtëpiak pa kondensim

1. Etiketa për tharëset për përdorim shtëpiak pa kondensim

Figura 3



1.1.Informacioni i mëposhtëm do të përfshihet në etiketë:

I Kodi QR;
II Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

III Identifikuesi i modelit të furnizuesit;
IV Shkalla e klasave të efiçencës së energjisë nga A-ja tek G-ja;
V Klasa e efiçencës së energjisë e përcaktuar në përputhje me Shtojcën II; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë të tharëses për përdorim shtëpiak do të vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;
VI Konsumi mesatar i vjetore i energjisë për 100 cikle tharjeje në kWh, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me Shtojcën III; në rastin e tharëseve me gaz, konsumi mesatar i vjetore i energjisë (gaz dhe energji elektrike) për 100 cikle tharjeje në kWh, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me shtojcën III.
VII Klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër të ciklit të tharjes së programit ekologjik, me logon dhe vlerën përkatëse në dB(A), e përcaktuar në përputhje me seksionin 4 të shtojcës III;
VIII Kapaciteti i vlerësuar, në kg, për programin ekologjik me ngarkesë të plotë;
IX Programi ekologjik në h:min (orë:minuta) i rrumbullakosur në minutën më të afërt;
X Numri i kësaj rregulloreje, i cili është '2023/2534'.

1.2. Një kopje e etiketës ekologjike të produktit, shtohet kur modelit i është dhënë një etiketë ekologjike.

2. Skicimi i etiketës për tharëset për përdorim shtëpiak pa kondensim

Figura 4



Ku:

(a) Etiketa është së paku 96 mm e gjerë dhe 192 mm e lartë, megjithatë kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme;

(b) Sfondi i etiketës është 100% i bardhë;

(c) Shkronjat janë në formatin Verdana;

(ç) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketën janë siç tregohet në skicimin e etiketës për tharëset për përdorim shtëpiak (Fig 4) ;

(d) Ngjyrat janë CMYK – cian, purpurt, e verdhë dhe e zezë sipas shembullit në vijim: 0,70,100,0: 0 % cian, 70 % e purpurt, 100 % e verdhë, 0 % e zezë;

(dh) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat referohen figurës 4).

❶ Ngjyrat e logos së BE-së janë si më poshtë:
- Sfondi: 100,80,0,0;
- Yjet: 0,0,100,0;

❷ Ngjyra e logos së energjisë është: 100,80,0,0;

❸ Kodi QR është 100% në ngjyrë të zezë;

❹ Emri i furnizuesit është 100% në ngjyrë të zezë dhe shkronjat janë në formatin Verdana, 9 pt;

❺ Identifikuesi i modelit është 100% në ngjyrë të zezë dhe me shkronjat në formatin Verdana Regular 9 pt;

❻ Shkalla nga A-ja deri tek G-ja është si më poshtë:

- Shkronjat e shkallës së eficencës së energjisë janë 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronjat në formatin Verdana Bold 16 pt; shkronjat pozicionohen në një bosht 4,5 mm nga ana e majtë e shigjetave;

- Ngjyrat e shigjetave të shkallës nga A-ja deri tek G-ja janë si më poshtë:
  - Klasa-A: 100,0,100,0;
  - Klasa-B: 70,0,100,0;
  - Klasa-C: 30,0,100,0;
  - Klasa-D: 0,0,100,0;
  - Klasa-E: 0,30,100,0;
  - Klasa-F: 0,70,100,0;
  - Klasa-G: 0,100,100,0;

❼ Ndarësit e brendshëm janë 80 mm të gjerë, kanë një nuancë prej 0,5 pt dhe ngjyra është 100% e zezë;

❽ Shigjeta treguese e klasës së efiçencës së energjisë është 100% në ngjyrë të zezë. Shkronja në shigjetën e klasës së eficencës së energjisë është 100% në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja në formatin Verdana Bold 26 pt, e cila vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës. Shigjeta treguese e klasës së eficencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën nga A-ja deri tek G-ja pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara në të njëjtin drejtim.

❾ Vlera e konsumit të vjetore të energjisë për 100 cikle tharje është me shkronja në ngjyrë të zezë Verdana Bold 28 pt; "kWh" është me shkronja në formatin Verdana Regular 18 pt; numri "100" në piktogramin që përfaqëson 100 cikle është me shkronja në formatin Verdana Regular 14 pt. Teksti është i pozicionuar në kolonë dhe në ngjyrë të zezë 100%;

❿ Piktogramet janë siç jepen në modelet e etiketave dhe si më poshtë:
- i. Vijat e piktogrameve kanë një nuancë prej 1,2 pt, ndërkohë që ato dhe tekstet (numrat dhe njësitë) janë 100 % në ngjyrë të zezë;
- ii. Shkallët nga A deri në D të piktogramit të eficencës së kondensimit dhe piktogramit të emetimit të zhurmës akustike në ajër janë të rreshtuara në një bosht vertikal në anën e majtë të ikonës, me shkronjën e klasës së eficencës së zbatueshme me Verdana Bold 12 pt dhe shkronjat e tjera të klasave të eficencës në formatin Verdana Regular 8 pt;
- iii. Numri i piktogramit të eficencës së kondensimit është me shkronja në ngjyrë të zezë Verdana Bold 9 pt dhe njësia matëse në formatin Verdana Regular 9 pt, ku numri dhe njësia janë të pozicionuar pranë njëri-tjetrit dhe të qëndërzuar brenda piktogramit;
- iv. numri i piktogramit të emetimit të zhurmës akustike në ajër është me shkronja në ngjyrë të zezë Verdana Bold 12 pt dhe njësia Verdana Regular 9 pt, me numrin dhe njësinë pranë njëra-tjetrës dhe të qëndërzuar brenda piktogramit;
- v. numri i piktogramit të kapacitetit të vlerësuar është me shkronja të zeza Verdana Bold 16 pt dhe njësia matëse me Verdana Regular 12 pt, ku numri dhe njësia janë të pozicionuar pranë njëri-tjetrit dhe të qëndërzuar nën piktogram;

vi. numri i kohëzgjatjes së piktogramit të programit ekologjik është me shkronja Verdana Bold 16 pt, në ngjyrë të zezë, pika dhe do të qëndërzohet nën piktogram;

⓫ Numri i rregullores është 100 % në ngjyrë të zezë dhe shkronjat janë në formatin Verdana Regular 6 pt.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Metodat e matjes dhe llogaritjes

Për qëllime të verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e kësaj rregulloreje, matjet dhe llogaritjet kryhen sipas standardeve të harmonizuara evropiane te miratuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, të cilat marrin parasysh teknologjinë moderne përgjithësisht të njohur, dhe janë në përputhje me dispozitat e mëposhtme.
Kur një parametër deklarohet në përputhje me nenin 5/pika 3 të Ligjit Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" dhe në përputhje me Tabelën 5 të Shtojcës V, vlera e deklaruar e tij do të përdoret nga furnizuesi për llogaritjet në këtë Shtojcë.
Konsumi i energjisë, Indeksi i Efiçencës së Energjisë IEE, efiçenca e kondensimit, kohëzgjatja e programit, përmbajtja përfundimtare e lagështirës dhe emetimet e zhurmës akustike në ajër maten dhe/ose llogariten duke përdorur programin ekologjik të identifikueshëm në përzgjedhësen e programit që gjendet në ekranin e prekshëm dhe nëpërmjet lidhjes së rrjetit në varësi të funksioneve të ofruara nga tharësja për përdorim shtëpiak dhe pa modifikim të mëtejshëm të cilësimit të përmbajtjes përfundimtare të lagështirës .
Llogaritja e konsumitvjetor të energjisë, kohëzgjatja e programit, përmbajtja përfundimtare e lagështirës dhe efiçenca e kondensimit kryhet në bazë të tre cikleve të tharjes me ngarkesë të plotë dhe katër cikleve të tharjes me ngarkesë të pjesshme.
Kapaciteti nominal i deklaruar për programin ekologjik nuk duhet të jetë më i ulët se kapaciteti i vlerësuar më i lartë nominal i deklaruar referuar të gjitha programeve të pambukut të tharëses për përdorim shtëpiak.

1. INDEKSI I EFIÇENCËS SË ENERGJISË
Për llogaritjen e indeksit të efiçencës së energjisë (EEI) së një modeli tharëseje për përdorim shtëpiak, konsumi i vjetore i energjisë për cikël tharjeje referuar programit ekologjik me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme krahasohet me konsumin standard të energjisë për cikël tharjeje.

(a) EEI llogaritet dhe rrumbullakoset deri në një shifër pas presjes dhjetore si më poshtë:
$EEI = (E_{tC}/SE_C) \times 100$

ku:
E_{tC} = konsumi i vjetore i energjisë për cikël tharjeje,
SE_C =konsumi standard i energjisë për cikël tharjeje.

(b) SE_C llogaritet në kWh, i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore si më poshtë:

(i)për tharëset për përdorim shtëpiak për të gjitha tharëset që nuk janë me ajër:
$SE_C = 0{,}46 \times c^{0.63}$

(ii)për tharëset me ajër:

$$SE_C = 0{,}46 \times c^{0.63} \times \left(1 - \frac{Tt}{60} \times 0.83\right)$$

Ku:

c është kapaciteti i vlerësuar i tharëses për përdorim shtëpiak për programin ekologjik,

T_t është kohëzgjatja e vjetore e programit për programin ekologjik.

(c) E_{tC} llogaritet në kWh dhe rrumbullakoset deri në dy shifra pas presjes dhjetore si më poshtë:

$$E_{tC} = 0{,}24 \times E_{dry} + 0.76 \times E_{dry1/2}$$

ku

E_{dry} = konsumi i energjisë i programit ekologjik me ngarkesë të plotë, në kWh, i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore,

$E_{dry\ ½}$ = konsumi i energjisë i programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme, në kWh, i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore .

(d) Për tharëset me gaz, Edry dhe Edry1/2 llogariten si më poshtë

$$E_{dry} = \frac{Eg_{dry}}{CC} + Eg_{dry,a}$$

$$E_{dry1/2} = \frac{Eg_{\frac{dry1}{2}}}{CC} + Eg_{\frac{dry1}{2},a}$$

ku

Eg_{dry} = konsumi i gazit i programit ekologjik me ngarkesë të plotë, në kWh, i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore;

$Eg_{dry1/2}$ = konsumi i gazit i programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme, në kWh i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore;

$Eg_{dry,\ a}$ =konsumi ndihmës i energjisë elektrike i programit ekologjik me ngarkesë të plotë, në kWh, i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore;

$Eg_{dry½,a}$ =konsumi ndihmës i energjisë elektrike i programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme, në kWh, i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore,

CC (koeficienti i konvertimit)=1,9.

(e) T_t për programin ekologjik llogaritet në minuta, të rrumbullakosura në minutën më të afërt, si më poshtë:

$T_t = 0{,}24 \times T_{dry} + 0.76 \times E_{dry1/2}$

ku
T_{dry}= kohëzgjatja e programit për programin ekologjik me ngarkesë të plotë, në minuta dhe e rrumbullakosur në minutën më të afërt,
$E_{dry\,½}$=kohëzgjatja e programit për programin ekologjik me ngarkesë të pjesshme, në minuta dhe e rrumbullakosur në minutën më të afërt.

(f) Konsumi mesatar i vjetore i energjisë për 100 cikle tharje të tharëses elektrike për përdorim shtëpiak me energji elektrike, llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt:

$E_{tc} \times 100$

Konsumi mesatar i vjetore i energjisë për 100 cikle tharjeje të tharëses me gaz llogaritet si më poshtë dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt, llogaritet si më poshtë:

$[0.24 \times (E_{dry} + Eg_{dry,a}) + 0.76 \times (Eg_{dry1/2} + Eg_{dry1/2,a})] \times 100$

ku

E_{gdry} =konsumi i gazit për programin ekologjik me ngarkesë të plotë, në kWhkWh , rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore;

$Eg_{dry1/2}$ =konsumi i gazit për programin ekologjik me ngarkesë të pjesshme, në kWhkWh, i rrumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore;

$Eg_{dry,\,a}$ =konsumi i energjisë elektrike ndihmëse i programit ekologjik me ngarkesë të plotë, në kWhkWh dhe i rrumbullakosur deri në dy shifra dhjetore,

$Eg_{dry½,a}$ =konsumi i energjisë elektrike ndihmëse i programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme, në kWhkWh, dhe i rrumbullakosur deri në dy shifra dhjetore.

(g) Përmbajtja mesatare përfundimtare e lagështirës μ_{tdry} për programin ekologjiklogjik llogaritet në përqindje, e rrumbullakosur në një shifër dhjetore, si më poshtë:

$$\mu t = \frac{(3\ x\ \mu_{dry} + 4\ x\ \mu_{dry1/2}}{7}$$

ku

μ dry=Përmbajtja përfundimtare e lagështirës për programin ekologjik me ngarkesë të plotë, në përqindje dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.

μ dry=Përmbajtja përfundimtare e lagështirës për programin ekologjik me ngarkesë të pjesshme, në përqindje dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.

2. EFIÇENCA E KONDENSIMIT

Efiçenca e kondensimit të një programi (C_t) është raporti midis masës së lagështirës së kondensuar të mbledhur në rezervuarin e një tharëseje me kondensim dhe masës së lagështirës që i është hequr ngarkesës nga programi, ku kjo e fundit është diferenca midis masës së lagështirës së ngarkesës të testuar para tharjes dhe masës së lagështirës së ngarkesës së testuar pas tharjes.

C_t llogaritet si përqindje dhe rrumbullakoset në përqindjen më të afërt të plotë si më poshtë:

$$\mathbf{C_t = 0{,}24 \times C_{dry} + 0.76 \times C_{dry1/2}}$$

ku

C_{dry} =Efiçenca mesatare e kondensimit të programit ekologjik me ngarkesë të plotë;

$\mathbf{C_{dry1/2}}$ =Efiçenca mesatare e kondensimit të programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme.

3. OPSIONET ME FUQI TË ULËT

Matet konsumi i energjisë së gjendjes së fikur (P_o) i gjendjes së gatishmërisë (P_{sm}) dhe, aty ku kërkohet, gjendjes së fillimit me vonesë ($P_{ds.}$). Vlerat e matura shprehen në Wat dhe rrumbullakosen në dy shifra dhjetore.

Gjatë matjeve të konsumit të energjisë në opsionet me fuqi të ulët, kontrollohen sa më poshtë:

(a) shfaqja ose jo e informacionit;

(b) aktivizimi ose jo i një lidhjeje rrjeti.

Nëse gjendja e gatishmërisë përfshin shfaqjen e informacionit ose statusit, ky funksion do të ofrohet gjithashtu kur ofrohet gatishmëria në rrjet. Nëse tharësja siguron funksion mbrojtës nga rrudhat, ky funksion ndërpritet duke hapur derën e pajisjes ose çdo ndërhyrje tjetër të përshtatshme, 15 minuta përpara matjes së konsumit të energjisë.

4. SHKARKIMI AKUSTIK I ZHURMAVE NË AJËR

Shkarkimi akustik i zhurmës në ajër gjatë ciklit të tharjes së një tharëseje për përdorim shtëpiak do të llogaritet për programin ekologjik me ngarkesë të plotë, duke përdorur standarde të harmonizuara, numrat e referencës së të cilave janë publikuar për këtë qëllim në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, ose duke përdorur të tjera të besueshme. , metoda të sakta dhe të riprodhueshme, të cilat marrin parasysh teknologjinë moderne të njohur përgjithësisht.

Shkarkimet akustike të zhurmës në ajër do të maten në dB(A) në lidhje me 1 pW dhe do të rrumbullakosen në numrin e plotë më të afërt.

SHTOJCA IV
Skeda informative e produktit

Sipas pikës 1 (b) të kreut 3, pjesa e të dhënave që ka skeda informativee tharëses per përdorim shtëpiak hidhet në bazën e të dhënave të produktit nga furnizuesi sipas Tabelës 3.
Manuali i përdorimit ose literatura tjetër e ofruar me produktin tregon qartë lidhjen me modelin në bazën e të dhënave të produktit si një Link (URL) i lexueshëm nga njerëzit ose si kod QR ose nëpërmjet dhënies së numrit të regjistrimit të produktit.

Tabela 4
Përmbajtja, renditja dhe formati i fletës informative të produktit

<table>
<tr><td colspan="6">Emri i furnizuesit ose marka tregtare:</td></tr>
<tr><td colspan="6">Adresa e furnizuesit (1) :</td></tr>
<tr><td colspan="6">Identifikuesi i modelit (1):</td></tr>
<tr><td colspan="3">Teknologjia e tharëses</td><td colspan="3">[elektrik me ajrim, me kondensim elektrik, me gaz]</td></tr>
<tr><td colspan="6">Parametrat e përgjithshëm të produktit:</td></tr>
<tr><td>Parametri</td><td colspan="2">Vlera</td><td>Parametri</td><td colspan="2">Vlera</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Kapaciteti i vlerësuar (2) (kg)</td><td rowspan="3" colspan="2">x,x</td><td rowspan="3">Dimensionet (1), (3) në cm</td><td>Lartësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Gjerësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Thellësia</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Indeksi efiçencës së energjisë (EEI)</td><td colspan="2">x,x</td><td>Klasi I efiçencë së energjisë</td><td colspan="2">[A/B/C/D/E/F/G]</td></tr>
<tr><td>Efiçenca e kondensimit (%) (2) (nëse është e aplikueshme)</td><td colspan="2">xx</td><td>Klasa e efiçencës së kondensimit (nëse është e aplikueshme) (2)</td><td colspan="2">[A/B/C/D]</td></tr>
<tr><td>Konsumi i vjetore i energjisë në kWh për cikël tharjeje (8). Konsumi aktual i energjisë do të varet nga mënyra se si përdoret pajisja.</td><td colspan="2">x,xx</td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">Kohëzgjatja e programit (2) (orë: minuta)</td><td>Kapaciteti i vlerësuar</td><td>x:xx</td><td rowspan="2">Lloji</td><td colspan="2" rowspan="2">[i integruar/i lirë]</td></tr>
<tr><td>Gjysma</td><td>x:xx</td></tr>
<tr><td>Shkarkimi akustik i zhurmës në ajër (2) (dB(A) re 1 pW)</td><td colspan="2">x</td><td>Klasa e shkarkimit akustik të zhurmës në ajër (</td><td colspan="2">[A/B/C/D] (4)</td></tr>
<tr><td>Opsioni jashtë funksionit (nëse aplikohet) (W)</td><td colspan="2">x,xx</td><td>Opsioni i gatishmërisë (nëse është e aplikueshme) (Ë)</td><td colspan="2">x,xx</td></tr>
</table>

Fillimi me vonesë (W) (nëse është e aplikueshme)	x,xx	Gatishmëria në rrjet (Ë) (nëse është e aplikueshme)	x,xx
Për tharëset për përdorim shtëpiaktë pajisura me një pompë nxehtësie, emri kimik ose emërtimi i pranuar industrial i gazit ftohës të përdorur, pa cenuar Rregulloren (BE) Nr.			
Lidhje në internet për informacionin mbi disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për riparuesit profesionistë dhe përdoruesit përfundimtarë (1) (3) (5)			https://xxx
Lidhja në internet për udhëzimet e riparimit për përdoruesit fundorë (1) (3) (6)			https://xxx
Lidhje në internet për çmimet treguese para taksave (1) (3) (7)			https://xxx
Kohëzgjatja minimale e garancisë së ofruar nga furnizuesi (1) (3)			
Informacion shtesë (1) (3)			
Lidhje me faqen e internetit të furnizuesit, ku gjendet informacioni në pikën 6 të Shtojcës II të Rregullores së Komisionit (BE) 2023/2533 (3) (2):			

Emri i furnizuesit ose marka tregtare:					
Adresa e furnizuesit:					
Identifikuesi i modelit:					
Teknologjia e tharëses elektrik, gaz)			**(Elektrike, me ajër, kondesator**		
Parametrat e përgjithshëm të produktit:					
Parametri	Vlera		Parametri	Vlera	
Kapaciteti i vlerësuar (kg)	Kapaciteti i vlerësuar		Dimensionet në cm	Lartësia	x
	Gjysma			Gjerësia	x
Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI)	x,x		Klasa e eficencës së energjisë	[A/B/C/D/E/F/G]	
Efiçenca e kondensimit (%) (nëse është e aplikueshme)	xx		Indeksi i performancës së tharjes	x, xx	
Konsumi vjetor i energjisë në kWh [për cikël], i cili	x, xx		Konsumi i ujit në litra [për cikël], bazuar në	x, x	

varet nga mënyra se si përdoret pajisja.		programin ekologjik. Konsumi faktik i ujit do të varet nga mënyra se si përdoret pajisja dhe nga fortësia e ujit.	
Kohëzgjatja e programit (h:min)	x:xx	Lloji	[i integruar/i paintegruar]
Shkarkimet akustike të zhurmës në ajër (dB(A) në lidhje me 1 pW)	x	Klasa e shkarkimit akustik të zhurmës në ajër	[A/B/C/D]
Opsioni i fikur (W)	x, xx	Opsioni i gatishmërisë (W)	x, xx
Fillimi me vonesë (W) (nëse aplikohet)	x, xx	Gatishmëria e rrjetëzuar (W) (nëse aplikohet)	x, xx
Kohëzgjatja minimale e garancisë së ofruar nga furnizuesi:			

SHTOJCA V
Dokumentacioni teknik

1. Për tharëset elektrike për përdorim shtëpiak, dokumentacioni teknik i përmendur në kreun III, pika 1/d, përfshin informacionin e mëposhtëm:
(a)një përshkrim të përgjithshëm të modelit në mënyrë që ai të identifikohet lehtësisht dhe pa dyshime;
(b)referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara ose standardeve të tjera të matjes të përdorura;
(c)masat paraprake specifike që duhen marrë kur modeli montohet, instalohet, mirëmbahet ose testohet;
(ç)detajet dhe rezultatet e llogaritjeve të kryera sipas Shtojcës III;
(d)kushtet e testimit, kur ato nuk janë përshkruar mjaftueshëm në referencat e dhëna sipas pikës (b) të këtij seksioni;
(dh)një listë e të gjitha modeleve ekuivalente duke përfshirë identifikuesin e modelit.
(e)vlerat për parametrat teknikë të përcaktuar në tabelën 5, të cilat konsiderohen si vlera të deklaruara për efekt të procedurës së verifikimit të përcaktuar në Shtojca VIII.
Informacioni i dhënë në përputhje me pikat (a) deri (e) do të përbëjë pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi duhet të vendosë në bazën e të dhënave, në përputhje me nenin 9, pika 5 të Ligjit Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji".

Tabela 5
Informacioni që duhet të përfshihet në dokumentacionin teknik për tharëset elektrike për përdorim shtëpiak

PARAMETRI	NJËSIA	VLERA
Kapaciteti i vlerësuar për programin ekologjik, në intervale 0,5 kg (c)	kg	x,x
Konsumi i energjisë i programit ekologjik me ngarkesë të plotë (E_{dry})	kWhkWh/ cikli i tharjes	x,xx
Konsumi i energjisë i programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme ($E_{dry,½}$	kWhkWh/ cikli i tharjes	x,xx
Konsumi i vjetore i energjisë i programit ekologjik (EtC E_{tC})	kWhkWh/ cikli i tharjes	x,xx
Konsumi standard i energjisë i programit ekologjik (SEC SE_C)	kWhkWh/ cikli i tharjes	x,xx
Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI)	-	x,x

Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik me ngarkesë të plotë (Tdry T_{dry})	h:min	x:xx
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjikme ngarkesë të pjesshme ($T_{dry½}$)	h:min	x:xx
Kohëzgjatja vjetore e programit për programin ekologjik (T_t)	h:min	x:xx
Efiçenca mesatare e kondensimit të programit ekologjik me ngarkesë të plotë (Cdry) (nëse është e aplikueshme)	%	xx
Efiçenca mesatare e kondensimit të programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme (Cdry½) (nëse është e aplikueshme)	%	xx
Efiçenca e peshuar e kondensimit të programit ekologjik (Ct) (nëse është e aplikueshme)	%	xx
Shkarkimi akustik i zhurmës në ajër gjatë programit ekologjik	dB(A) në lidhje me 1 pW	x
Konsumi i energjisë në gjendjen e çaktivizimit (Po) (nëse ka)	W	x,xx
Konsumi i energjisë në gjendjen e gatishmërisë (Psm) (nëse ka)	W	x,xx
A përfshin "gjendjen e gatishmërisë" shfaqjen e informacionit?	-	po/jo
Konsumi i energjisë në "gjendjen e gatishmërisë" në gjendjen e gatishmërisë në rrjet (P_{nsm}) (nëse është e aplikueshme)	W	x,xx
Konsumi i energjisë në fillimin e vonuar (P_{ds}) (nëse ka)	W	x,xx

2. Për tharëset që operojnë me gaz, dokumentacioni teknik i referuar në kreun III pika1/d, duhet të përfshijë informacionin e renditur në paragrafin 1, pikat (a) deri (f) të kësaj shtojce dhe informacionin sipas Tabelës 6 për programin ekologjik. Vlerat në Tabelën 6 konsiderohen si vlera të deklaruara për qëllim të procedurës së verifikimit në shtojcën VIII.
Informacioni i dhënë në pikën 2 të kësaj shtojce do të përbëjë pjesët specifike të detyrueshme të dokumentacionit teknik që furnizuesi duhet të përfshijë në bazën e të dhënave.

Tabela 6

Informacioni që duhet të përfshihet në dokumentacionin teknik për tharëset me gaz

PARAMETER	UNIT	VALUE
Kapaciteti i vlerësuar për programin ekologjik, në intervale 0,5 kg (c)	kg	x,x
Konsumi i gazit i programit ekologjik me ngarkesë të plotë (Egdry)	kWh/ cikli i tharjes	x,xx
Konsumi i gazit i programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme ($E_{gdry,½}$)	kWh/ cikli i tharjes	x,xx
Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse i programit ekologjik me ngarkesë të plotë	kWh/ cikli i tharjes	x,xx
Konsumi i energjisë elektrike ndihmëse i programit ekologjik me ngarkesë të pjesshme	kWh/ cikli i tharjes	x,xx
Konsumi vjetor i energjisë i programit ekologjik (EtC)	kWh/ cikli i tharjes	x,xx

Konsumi standard i energjisë i programit ekologjik (SEC)	kWh/ cikli i tharjes	x,xx
Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI)	-	x,x
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik me ngarkesë të plotë (T_{dry})	h:min	xxx
Kohëzgjatja e programit për programin ekologjik me ngarkesë të pjesshme ($T_{dry½}$)	h:min	xxx
Kohëzgjatja vjetore e programit për programin ekologjik (T_t)	h:min	xxx
Shkarkimi akustik i zhurmës në ajër gjatë programit ekologjik	dB(A) re 1 pW	x
Konsumi i energjisë në gjendjen e çaktivizimit (Po) (nëse ka)	W	x,xx
Konsumi i energjisë në gjendjen e gatishmërisë (P_{sm}) (nëse ka)	W	x,xx
A përfshin "gjendja gatishmërisë" shfaqjen e informacionit?	-	po/jo
Konsumi i energjisë në gjendjen e gatishmërisë në gjendje të gatishmërisë në rrjet (P_{nsm}) (nëse ka)	W	x,xx
Konsumi i energjisë në "fillimin me vonesë" (P_{ds}) (aty ku është e aplikueshme)	W	x,xx

3. Informacioni i përfshirë në dokumentacionin teknik për një model të veçantë tharëseje për përdorim shtëpiak është marrë duke përdorur një nga metodat e mëposhtme:
- Nga një model që ka të njëjtat karakteristika teknike që janë të rëndësishme për informacionin teknik që do të jepet, por që është gjeneruar nga një furnizues tjetër;
(b) Me anë të llogaritjes në bazë të projektimit ose ekstrapolimit nga një model tjetër i të njëjtit furnizues ose i një furnizuesi të ndryshëm. Kur informacioni i përmendur në pikën 1 merret duke përdorur ndonjë nga metodat e përcaktuara në pikat (a) dhe (b), dokumentacioni teknik përfshin detajet e llogaritjes, vlerësimin e ndërmarrë nga furnitorët për të verifikuar saktësinë e llogaritjen dhe, sipas rastit, deklarimin e identitetit ndërmjet modeleve të furnitorëve të ndryshëm.

SHTOJCA VI

Informacioni që jepet në reklamat pamore në materialet promovuese teknike dhe në shitjet në distancë, përjashtuar në internet

1. Në reklamat pamore, për qëllim të sigurimit të respektimit të kërkesave të përcaktuara në kreun III, pika 1/ (e) dhe kreun IV, pika (c) tregohet klasa e efiçencës së energjisë dhe gama e klasave të efiçencës së energjisë të disponueshme në etiketë, siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
2. Në materialin teknik promovues, për qëllime të garantimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara në kreun 3(1), pika (f) dhe në kreun 4, pika (d), klasa e efiçencës së energjisë dhe diapazoni i klasave të disponueshme të efiçencës së energjisë në etiketë tregohen siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
3. Në rastin e shitjes në distancë me bazë letre, klasa e efiçencës së energjisë dhe gama e klasave të efiçencës energjetike të disponueshme tregohen në etiketë siç përcaktohet në pikën 4 të kësaj shtojce.
4. Në rastet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3, klasa e efiçencës së energjisë dhe gama i klasave të efiçencës së energjisë paraqiten, siç tregohet në Figurën 1,
në përputhje me specifikimet e mëposhtme:

i. Një shigjetë, që përmban shkronjën e klasës së efiçencës së energjisë në ngjyrë 100% të bardhë, me shkronjat në formatin Calibri Bold, dhe me një madhësi shkronje, të paktën, ekuivalente me atë të çmimit, kur tregohet çmimi;
ii. ngjyra e shigjetës që përputhet me ngjyrën e klasës së efiçencës së energjisë;
iii. diapazoni i klasave të disponueshme të efiçencët të energjisë duhet të jetë 100% në të zezë;
v. Gamën e klasave të disponueshme të eficencës së energjisë në ngjyrë 100% të zezë; dhe,

Madhësia duhet të jetë e tillë që shigjeta të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi prej 0,5 pt në ngjyrë 100% të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe shkronjës së klasës së eficencës së energjisë.
Si përjashtim, nëse reklama vizuale, materiale promovuese teknike ose shitje në distancë me bazë letre janë printuar në pikturë njëngjyrëshe, atëherë shigjeta mund të jetë pikturë njëngjyrëshe në atë reklamëpamore, material promovues teknik ose shitje në distancë me bazë letre.

Figura 5

Shigjeta majtas/djathtas me ngjyrë/njëngjyrëshe, me gamën e treguar të klasave të efiçencës së energjisë



5. Shitja në distancë e bazuar në telemarketing duhet të informojë në mënyrë specifike klientin për klasën e Efiçencës energjetike të produktit dhe për gamën e klasave të efiçencës energjetike të disponueshme në etiketë, dhe se klienti mund të aksesojë etiketën dhe skedën informative të produktit përmes faqes së internetit të bazës së të dhënave të produktit ose duke kërkuar një kopje të printuar.

6. Për të gjitha situatat e përmendura në pikat 1 deri në 3 dhe 5, duhet të jetë e mundur që klienti të marrë, sipas kërkesës, një kopje të printuar të etiketës dhe skedën informative të produktit.

SHTOJCA VII

Informacioni që jepet në rastin e shitjeve në distancë në internet

1. Etiketa elektronike e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas pikës 1(g) të kreut 3 shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit. Përmasa është e tillë që etiketa të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë dhe është proporcionale me përmasën e specifikuar në pikën 2 të Shtojcës III. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë respekton specifikimet e përcaktuara në pikën 2 të kësaj shtojce. Nëse aplikohet ekrani i ndërlidhur, atëherë etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose në zgjerimin e ekranit me prekje mbi imazh.

2. Imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë në rastin e ekranit të ndërlidhur, siç tregohet në Figurën 6:

i. Eshtë një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e eficencës së energjisë së produktit në etiketë;
ii. Tregon klasën e eficencës së energjisë së produktit në shigjetë në ngjyrë 100% të bardhë, me shkronjat në formatin Calibri Bold dhe me një madhësi shkronjash ekuivalente me atë të çmimit;
iii. Tregon gamën e klasave të disponueshme të eficencës së energjisë së në ngjyrë 100% të zezë;
iv. Disponohet në një nga dy formatet e mëposhtme dhe përmasa e tij është e tillë që shigjeta të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Shkronja në shigjetën e klasës së eficencës së energjisë vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një kufi të dukshëm në ngjyrë 100% të zezë të vendosur rreth shigjetës dhe germën e klasës së eficencës së energjisë:

Figura 6

Shigjeta me ngjyrë majtas/djathtas, me gamën e treguar të klasave të eficencës së energjisë



3. Në rastin e ekranit të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:

(a) Imazhi i përmendur në pikën 2 të këtij kësaj shtojce paraqitet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit;
(b) Imazhi lidhet me etiketën e përcaktuar në Shtojcën I;
(c) Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, pas rrotullimit të mausit ose pas zgjerimit të ekranit me prekje mbi imazh;
(ç)Etiketa shfaqet me anë të një dritareje të re, skedës së re, faqes së re ose ekranit të ndërlidhur;
(d) Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;
(dh) Shfaqja e etiketës ndalohen me anë të opsionit të mbylljes ose mekanizmit tjetër standard të mbylljes;
(e)Teksti alternativ për grafikun, i cili do të shfaqet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e eficencës së energjisë së produktit në një madhësi shkronje të barabartë me atë të çmimit.
4. Skeda informative elektronike e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas Kreukreut III, pika 1/(h) shfaqet në mekanizmin e ekranit në afërsi të çmimit të produktit. Përmasa është e tillë që skeda informative e produktit të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Fleta informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur ose duke iu referuar bazës së të dhënave të produktit, rast në të cilin lidhja e përdorur për të hyrë në skedën informative të produktit duhet të tregojë në mënyrë qartë dhe të lexueshme “Skeda informative e produktit”. Nëse përdoret një ekran i ndërlidhur, kjo skedë shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi lidhje.

SHTOJCA VIII
Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut duhet të përdorë procedura të besueshme të sakta dhe të ripërtërithme të matjeve që marrin parasysh metoda të pranuara bashkëkohore duke përfshirë edhe metodat e përcaktuara në dokumenta/standarde të harmonizuara, numrat e referimit të të cilave janë botuara ne Fletoren Zyrtare.

1. Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë lidhen vetëm me verifikimin e vlerave të deklaruara të parametrave nga Struktura përgjegjese për mbikqyrjen e tregut dhe nuk do të përdoren nga furnizuesi si një tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik ose në interpretimin e këtyre vlerave me synimin për të arritur një pajtueshmëri ose për të komunikuar performancë më të mirë me çdo kusht.

2. Vlerat dhe klasat e publikuara në etiketë ose në skedën informative të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik.

3. Kur një model është projektuar në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të zbulojë se është duke u testuar (për shembull duke njohur kushtet e testimit ose ciklin e provës së tharjes), dhe të reagojë në mënyrë specifike duke ndryshuar automatikisht performancën e tij gjatë testit me objektivin për të arritur një nivel më të favorshëm për secilin nga parametrat e specifikuar në këtë rregullore ose të përfshirë në dokumentacionin teknik ose të përfshirë në ndonjë nga elementët e dokumentacionit të ofruar, atëherë vetë modeli si dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen të papajtueshme me kërkesat.

4. Si pjesë e verifikimit të përputhshmërisë së një modeli produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, struktura përgjegjese për mbikqyrjen e tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

(a) Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut verifikojnë një njësi të vetme të modelit;

(b)modeli do të konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme kur ai plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

(i)vlerat e deklaruara të dhëna në dokumentacionin teknik në përputhje me nenin 9, pika (3) të ëLigjit Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e të deklaruara, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit;

(ii)vlerat e publikuara në etiketë dhe në skedën informative të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e efiçencës të energjisë, klasa e efiçencës së kondensimit dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara;

(iii)vlerat e përcaktuara, që janë vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje përputhen me:

a. kriteret e vlefshmërisë të përcaktuara në Tabelën 7;
b. tolerancat përkatëse të verifikimit të përcaktuara në tabelën 7.

5. Kur rezultatet e përmendura në paragrafin 4(b), pikat (i) ose (ii) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.
6. Kur rezultati i përmendur në paragrafin 4(b), pika (iii) nuk arrihet, Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut zgjedhin tre njësi shtesë të të njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund të jenë të një ose më shumë modeleve ekuivalente.
7. Modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore nëse vlera e përcaktuar për përmbajtjen mesatare përfundimtare të lagështirës për programin ekologjik nuk përputhet me kriteret e vlefshmërisë siç janë dhënë në Tabelën 7 për një nga tre njësitë shtesë. të përmendura në pikën 6. Në këtë rast, njësitë e tjera të pa testuara ende nuk kanë nevojë të testohen. Modeli do të konsiderohet se përputhet nëse vlera e përcaktuar për përmbajtjen përfundimtare të lagështirës përputhet me kriteret e vlefshmërisë siç janë dhënë në Tabelën 7 për secilën nga tre njësitë shtesë.
8. Modeli do të konsiderohet se përputhet me kërkesat e zbatueshme kur për tre njësitë e përmendura në pikën 6, mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të verifikimit të përcaktuara në tabelën 7.
9. Kur rezultati i përmendur në pikën 8 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente do të konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregullore.
10. Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut vendos masa administrative në përputhje me ligjin Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" ne rastet e konstatimit te mospërputhshmërinë se modelit sipas paragrafëve 2, 3, 5, 7 ose 9.
11. Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën III.
12. Struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut zbaton vetëm kriteret e vlefshmërisë dhe tolerancat e verifikimit të përcaktuara në tabelën 7 dhe do të përdorë vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 9 për kërkesat e përmendura në këtë shtojcë. Për parametrat e përcaktuar në Tabelën 7, nuk do të zbatohen kritere të tjera të vlefshmërisë ose toleranca verifikimi, si ato të përcaktuara në standardet e harmonizuara ose në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 7
Tolerancat e verifikimit dhe kriteret e vlefshmërisë

Parametri	**Kriteret e vlefshmërisë**
Përmbajtja mesatare e lagështirës përfundimtare të programit ekologjik μ_t	Vlera e përcaktuar do të matet dhe llogaritet dhe të jetë më e ulët se 1,5 %.
Parametri	**Tolerancat e verifikimit**
E_{dry} and $E_{dry½}$	Vlera e përcaktuar* nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të E_{dry} dhe $E_{dry½}$ me më shumë se 6 %.
Eg_{dry} and $Eg_{dry½}$	Vlera e përcaktuar* nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të E_{gdry} dhe $Eg_{dry½}$ me më shumë se 6 %.
$Eg_{dry,a}$ and $Eg_{dry½,a}$	Vlera e përcaktuar* nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të $E_{gdry,a}$ dhe $E_{gdry½,a}$ me më shumë se 6 %.
C_t	Vlera e përcaktuar* nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar e C_t për më shumë se 6 %.

T_{dry} and $T_{dry½}$	Vlera e përcaktuar* nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të T_{dry} dhe $T_{dry½}$ me më shumë se 6 %.
P_o	Vlera e përcaktuar* e konsumit të energjisë Po nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 0,10 W.
P_{sm}	Vlera e përcaktuar* e konsumit të energjisë Psm nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 10 % nëse vlera e deklaruar është më e lartë se 1,00 W, ose më shumë se 0,10 W nëse vlera e deklaruar është më e ulët ose e barabartë me 1,00 W.
P_{ds}	Vlera e përcaktuar* e konsumit të energjisë Pds nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 10 % nëse vlera e deklaruar është më e lartë se 1,00 W, ose më shumë se 0,10 W nëse vlera e deklaruar është më e ulët ose e barabartë me 1,00 W.
Shkarkimet akustike të zhurmës në ajër	Vlera e përcaktuar* nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar për më shumë se 2 dB për 1 pW.
*Kur testohen tre njësi shtesë në përputhje me pikën 6, vlera e përcaktuar nënkupton mesataren aritmetike të vlerave të përcaktuara për këto tre njësi shtesë.	

SHTOJCA IX
Tharëse për përdorim shtëpiak me shumë kazan

Dispozitat e shtojcave I dhe II, duke ndjekur metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën III, do të zbatohen për çdo kazan. Dispozitat e shtojcave I dhe II do të zbatohen për secilën prej kazanëve në mënyrë të pavarur, përveç rasteve kur kazanët ndërtohen në të njëjtën dollap dhe mund të funksionojnë, në programin ekologjik, vetëm njëkohësisht. Në rastin e fundit, këto dispozita do të zbatohen në tërësi për tharësen për përdorim shtëpiak me shumë kazan, si më poshtë:

(a)Kapaciteti nominal i tharëses me shumë kazane në tërësi do të jetë shuma e kapaciteteve nominale të çdo kazani;

(b)konsumi i energjisë së tharëses me shumë kazane në tërësi duhet të jetë shuma e konsumit të energjisë për çdo kazan;

(c)Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI) i tharëses shtëpiake me shumë kazan në tërësi do të llogaritet duke përdorur kapacitetin e vlerësuar dhe konsumin e energjisë të pikave (a) dhe (b) më sipër. Klasa e efiçencës së energjisë zbatohet për të gjithë tharësen shtëpiake me shumë kazan;

(ç)kohëzgjatja e programit të tharëses shtëpiake me shumë kazane në tërësi do të jetë kohëzgjatja e programit më të gjatë ekologjik që funksionon në çdo kazan;

(d)përmbajtja përfundimtare e lagështirës së programit ekologjik do të matet individualisht për çdo kazan të tharëses për përdorim shtëpiak me shumë kazane;

(dh)gjendjen e fuqisë së ulët, shkarkimet akustike të zhurmës në ajër dhe klasa e emetimeve akustike të zhurmës në ajër do të zbatohen për të gjitha tharëset shtëpiake me shumë kazan.

skeda informative e produktit dhe dokumentacioni teknik do të përfshijnë dhe paraqesin së bashku informacionin e kërkuar sipas Shtojcës IV dhe Shtojcës V, përkatësisht, për të gjithë kazanet për të cilët zbatohen dispozitat e kësaj shtojce.

Dispozitat e shtojcave VI dhe VII do të zbatohen për secilën prej kazaneve për të cilat zbatohen dispozitat e kësaj shtojce.

Procedura e verifikimit e përcaktuar në Shtojcën VIII do të zbatohet për tharëset për përdorim shtëpiak me shumë kazan si një e tërë, me kriteret e vlefshmërisë dhe tolerancat e verifikimit që zbatohen për secilin prej parametrave të përcaktuar në zbatim të kësaj shtojce.

ANEKS NR.16

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN ENERGJETIK TË FURRAVE DHE ASPIRATORËVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK [1]

I. QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për etiketimin dhe dhënien e informacionit plotësues të produktit për furrat për përdorim shtëpiak, elektrike dhe me gaz (përfshirë rastin kur integrohen në soba) dhe për aspiratorët elektrik për përdorim shtëpiak, duke përfshirë rastin kur shiten për qëllime jo shtëpiake.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

a) furrat që përdorin burime energjie të ndryshme nga energjia elektrike ose gazi;
b) furrat që ofrojnë një funksion "ngrohje me mikrovalë";
c) furrat e vogla;
ç) furrat portative;
d) furrat e ruajtjes së nxehtësisë;
dh) furrat të cilat nxehen me avull si funksion kryesor i ngrohjes;
e) furrat e projektuara për përdorim vetëm me gaze të "familjes së tretë (propan dhe butan).

II. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"Furrë"** është një pajisje ose pjesë e një pajisjeje që përfshin një ose më shumë zgavra që përdorin energji elektrike dhe/ose gaz, në të cilën gatuhet ushqimi duke përdorur mënyrën konvencionale ose atë me fryrje me ventilator;
2. **"Zgavër"** është ndarja e mbyllur, në të cilën mund të kontrollohet temperatura për përgatitjen e ushqimit;
3. **"Furrë me shumë zgavra"** është një furrë me dy ose më shumë zgavra, secila prej të cilave nxehet nëmënyrë të pavarur;
4. **"Furrë e vogël"** është një furrë ku të gjitha zgavrat kanë një gjerësi dhe thellësi më të vogël se 250 mm ose një lartësi më të vogël se 120 mm;

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren deleguese (BE) 65/2014 e Komisionit, datë 1 tetor 2013, për plotësimin e Direktivës 2010/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për etiketimin energjetik të furrave shtëpiake dhe aspiratorëve". Numri CELEX 02014R0065, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 029, datë 31.01.2014, f. 1.

5. **"Furrë portative"** është një furrë me një masë produkti më të vogël se 18 kilogram, me kusht që të mos jetë projektuar për instalime të integruara;
6. **"Ngrohje me mikrovalë"** është ngrohja e ushqimit duke përdorur energji elektromagnetike;
7. **"Opsioni konvencional"** është mënyra e funksionimit të një furre vetëm duke përdorur mënyrën natyrale të qarkullimit të ajrit të nxehtë brenda zgavrës së furrës;
8. **"Opsioni me fryrje me ventilator"** është opsioni i furrës kur një ventilator i integruar qarkullon ajrin e nxehtë brenda zgavrës së furrës;
9. **"Cikël"** është periudha e ngrohjes së një ngarkese të standardizuar në një zgavër të një furre në kushte të përcaktuara;
10. **"Sobë"** është një pajisje e përbërë nga një furrë dhe një pianurë që përdor gaz ose energji elektrike;
11. **"Opsioni i funksionimit"** është statusi i një furre gjatë përdorimit;
12. **"Aspiratori"** është një pajisje, që vihet në punë nga një motor që e kontrollon, dhe që është e destinuar për të mbledhur ajrin e ndotur sipër pianurës, ose që përfshin një sistem me thithje poshtë që instalohet pranë vendeve të gatimit, pianurave dhe pajisjeve të ngjashme të gatimit, që thith avujt poshtë dhe i nxjerr jashtë me anë të një tubacioni të brendshëm të shkarkimit;
13. **"Opsioni i funksionimit automatik gjatë periudhës së gatimit"** është gjendja në të cilën fluksi i ajrit të aspiratorit gjatë periudhës së gatimit kontrollohet automatikisht nëpërmjet sensorit/sensorëve, duke përfshirë lagështinë, temperaturën, etj.;
14. **"Aspirator plotësisht automatik"** është një aspirator në të cilin fluksi i ajrit dhe/ose funksione të tjera kontrollohen automatikisht përmes sensorit/sensorëve gjatë 24 orëve duke përfshirë periudhën e gatimit;
15. **"Pika e efiçencës më të mirë"** (BEP) është pika e funksionimit të aspiratorit me efiçencë maksimale të dinamikës së lëngjeve (FDE_{hood});
16. **"Efiçenca e ndriçimit"** (LE_{hood}) është raporti ndërmjet ndriçimit mesatar të sistemit të ndriçimit të aspiratorit për përdorim shtëpiak dhe fuqisë së sistemit të ndriçimit në lux/W;
17. **"Efiçenca e filtrimit të yndyrës"** (GFE_{hood}) është përqindja relative e yndyrës që mbetet brenda filtrave të yndyrës së aspiratorit;
18. **"Opsioni i fikur"** është gjendja në të cilën pajisja është e lidhur me burimin e energjisë elektrike, por nuk kryen asnjë funksion ose jep vetëm një tregues të gjendjes së opsionit joaktiv, ose kryen vetëm funksione të destinuara për të siguruar përputhshmërinë elektromagnetike.
19. **"Opsioni i gatishmërisë"** është gjendja ku pajisja është e lidhur me burimin e energjisë elektrike, varet nga energjia e sjellë nga burimi i energjisë elektrike për të funksionuar sipas destinacionit dhe ofron vetëm funksionin e riaktivizimit, ose funksionin e riaktivizimit dhe vetëm një tregues të funksionit të aktivizuar të riaktivizimit, dhe /ose informacion ose shfaqjen e statusit që mund të vazhdojë për një kohë të pacaktuar;
20. **"Funksioni i riaktivizimit"** është funksioni që lehtëson aktivizimin e opsioneve të tjera, duke përfshirë opsionin aktiv, me anë të telekomandës duke përfshirë

telekomandën, sensorin e brendshëm ose kohëmatësin në një gjendje që kryen funksione shtesë, duke përfshirë funksionin kryesor;

21. **"Shfaqja e informacionit ose statusit"** është një funksion i vazhdueshëm që jep informacion ose tregon statusin e pajisjes në një ekran, duke përfshirë orët;
22. **"Pika e shitjes"** është vendi ku pajisjet ekspozohen dhe/ose ofrohen për shitje ose me qira.

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE

1. Furnizuesit sigurojnë që:

A. Lidhur me etiketat, skedën informative të produktit dhe dokumentacionin teknik:

a) Për furrat shtëpiake:

i. çdo furrë për përdorim shtëpiak e cila vendoset në treg pajiset me etiketën/etiketat e printuara që përmbajnë informacion në formatin e përcaktuar në pikën 1 të shtojcës III për çdo zgavër të furrës;
ii. për furrat për përdorim shtëpiak të vendosura në treg vihet në dispozicion një skedë informative për produktin, siç përcaktohet në pikën A të shtojcës IV;
iii. me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut vihet në dispozicion dokumentacioni teknik siç përcaktohet në pikën A të shtojcës V;
iv. çdo reklamë për një model specifik të furrës për përdorim shtëpiak përmban klasën e efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin;
v. çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik të furrës për përdorim shtëpiak që përshkruan parametrat e saj specifik teknik përfshin klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli;
vi. një etiketë elektronike, në formatin dhe me përmbajtje informacioni sipas përcaktimeve të pikës 1 të shtojcës III, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo zgavër të çdo modeli furre për përdorim shtëpiak;
vii. një skedë informative për produktit, u vihet në dispozicion tregtarëve në format elektronik për çdo model furre për përdorim shtëpiak, siç përcaktohet në pikën A të Shtojcës IV.

b) Për aspiratorët për përdorim shtëpiak:

i. çdo aspirator për përdorim shtëpiak i cili vendoset në treg pajiset me një etiketë të printuar që përmban informacion në formatin e përcaktuar në pikën 2 të Shtojcës III;
ii. për aspiratorët për përdorim shtëpiak të vendosur në treg vihet në dispozicion një skedë informative për produktin, siç përcaktohet në pikën B të Shtojcës IV;
iii. me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut vihet në dispozicion dokumentacioni teknik siç përcaktohet në pikën B të Shtojcës V;
iv. çdo reklamë për një model specifik të aspiratorit për përdorim shtëpiak përmban klasën e efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin;

v. çdo material teknik promovues në lidhje me një model të veçantë të aspiratorit për përdorim shtëpiak që përshkruan parametrat e tij specifik teknik përfshin klasën e efiçencës së energjisë së atij modeli;
vi. një etiketë elektronike, në formatin dhe me përmbajtje informacioni sipas përcaktimeve të pikës 2 të shtojcës III, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model të aspiratorit për përdorim shtëpiak;
vii. një skedë informativepër produktin, u vihet në dispozicion tregtarëve në format elektronik për çdo model aspiratori për përdorim shtëpiak, siç përcaktohet në pikën B të Shtojcës IV.

B. Lidhur me klasat e efiçencës:

a) Për furrat për përdorim shtëpiak, klasa e efiçiencës së energjisë së zgavrës së furrës përcaktohet sipas pikës 1 të Shtojcës I dhe të pikës 1 të Shtojcës II.

b) Për aspiratorët shtëpiak:
i. Klasat e efiçencës së energjisë përcaktohen sipas pikës 2(a) të Shtojcës I dhe pikës 2.1 të Shtojcës II;
ii. Klasat e efiçencës së dinamikës së lëngjeve përcaktohen sipas pikës 2(b) të Shtojcës I dhe pikës 2.2 të Shtojcës II;
iii. Klasat e efiçencës së ndriçimit përcaktohen sipas pikës 2(c) të Shtojcës I dhe pikës 2.3 të Shtojcës II;
iv. Klasat e efiçencës së filtrimit të yndyrës përcaktohen sipas pikës 2(d) të Shtojcës I dhe pikës 2.4 të Shtojcës II.

C. Lidhur me formatet e etiketave:

a) Për furrat për përdorim shtëpiak të vendosura në treg nga data 1 janar 2015, formati i etiketës për zgavrën e furrës përcaktohet në pikën 1 të Shtojcës III;

b) Për aspiratorët për përdorim shtëpiak, formati i etiketës është siç përcaktohet në pikën 2 të Shtojcës III, sipas afatit të mëposhtëm:
i. Për aspiratorët për përdorim shtëpiak të vendosur në treg nga data 1 janar 2015, me klasa efiçence të energjisë A, B, C, D, E, F dhe G etiketat janë sipas pikës 2.1.1 të Shtojcës III.
ii. Për aspiratorët për përdorim shtëpiak të vendosur në treg nga data 1 janar 2015, me klasa efiçence të energjisë A+, A, B, C, D, E dhe F etiketat janë sipas pikës 2.1.2 të Shtojcës III.
iii. Për aspiratorët për përdorim shtëpiak të vendosur në treg nga data 1 janar 2015, me klasa efiçence të energjisë A++, A+, A, B, C, D dhe E etiketat janë sipas pikës 2.1.3 të Shtojcës III.
iv. Për aspiratorët për përdorim shtëpiak të vendosur në treg nga data 1 janar 2015, me klasa efiçence të energjisë A+++, A++, A+, A, B, C dhe D etiketat janë sipas pikës 2.1.4 të Shtojcës III.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE

1. Tregtarët sigurojnë që:
A. Për furrat për përdorim shtëpiak:

a) çdo furrë e paraqitur në pikën e shitjes është e pajisur me etiketën përkatëse për çdo zgavër të ofruar nga furnizuesit sipas pikes (a) të kreut III të vendosur në pjesën e përparme ose të sipërme të pajisjes, ose në afërsi të pajisjes, në mënyrë që etiketa të jetë qartësisht e dukshme dhe e identifikueshme si etiketa që i përket modelit pa pasur nevojë të lexohet emri i markës dhe numri i modelit në etiketë;
b) kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, furrat e ofruara për shitje ose me qira, siç specifikohet në nenin 6 të ligjit nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" shiten me informacionin e dhënë nga furnizuesit sipas Shtojcës VI të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, rast në të cilin zbatohen dispozitat e Shtojcës VII;
c) çdo reklamë e çdo forme ose mjeti të shitjes dhe marketingut në distancë në lidhje me një model specifik furre përmban një referencë të klasës së efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin;
ç) çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik që përshkruan parametrat teknikë të një furre përfshin klasën e efiçencës së energjisë së modelit.

B. Për aspiratorët për përdorim shtëpiak:

a) çdo aspirator për përdorim shtëpiak i paraqitur në pikën e shitjes shoqërohet me etiketën e dhënë nga furnizuesit sipas kreut III (1)(b)(i) të vendosur në pjesën e përparme ose të sipërme të pajisjes, ose në afërsi të pajisjes në mënyrë që të jenë qartësisht të dukshme dhe të identifikueshme si etiketa që i përket modelit pa pasur nevojë të lexohet emri i markës dhe numri i modelit në etiketë;
b) kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, aspiratorët për përdorim shtëpiak të ofruar për shitje ose me qira, siç specifikohet në nenin 6 të ligjit nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji" shiten me informacionin e dhënë nga furnizuesit sipas Shtojcës VI të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur oferta bëhet përmes internetit, rast në të cilin zbatohen dispozitat e Shtojcës VII;
c) çdo reklamë e çdo forme ose mjeti të shitjes dhe marketingut në distancë në lidhje me një model specifik të aspiratorit për përdorim shtëpiak përmban një referencë të klasës së efiçencës së energjisë, nëse reklama paraqet informacione të lidhura me energjinë ose çmimin;
ç) çdo material teknik promovues në lidhje me një model specifik, i cili përshkruan parametrat teknik të një aspiratori për përdorim shtëpiak, përfshin klasën e efiçencës së energjisë së modelit.

V. METODAT E MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni që jepet në përputhje me krerët III dhe IV merret nëpërmjet procedurave të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më të avancuara të matjes dhe llogaritjes.

VI. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VIII të kësaj rregulloreje.

VII. SHFUQIZIMI

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Vendimi Nr. 191, datë 4.4.2018.

SHTOJCA I
Klasat e efiçencës së energjisë

1. FURRA PËR PËRDORIM SHTËPIAK

Klasat e efiçencës së energjisë së furrave për përdorim shtëpiak përcaktohen veçmas për çdo zgavër sipas vlerave të përcaktuara në Tabelën 1 të kësaj Shtojce. Efiçenca e energjisë e furrave përcaktohet sipas pikës 1 të Shtojcës II.

Tabela 1

Klasa e Efiçencës së Energjisë	Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI_{cavity})
A+++ (më efiçente)	$\mathbf{EEI_{cavity}} < 45$
A++	$\mathbf{EEI_{cavity}} < 62$
A+	$\mathbf{EEI_{cavity}} < 82$
A	$82 \leq \mathbf{EEI_{cavity}} < 107$
B	$107 \leq \mathbf{EEI_{cavity}} < 132$
C	$132 \leq \mathbf{EEI_{cavity}} < 159$
D (më pak efiçente)	$\mathbf{EEI_{cavity}} \geq 159$

2. ASPIRATORËT PËR PËRDORIM SHTËPIAK

a) Klasat e efiçencës së energjisë së aspiratorëve shtëpiak përcaktohen sipas vlerat e përcaktuara në Tabelën 2 të kësaj Shtojce. Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{hood}) së aspiratorëve shtëpiak llogaritet sipas pikës 2.1 të Shtojcës II.

Tabela 2

Klasat e efiçencës së energjisë së aspiratorëve shtëpiak

Klasa e Efiçencës së Energjisë	Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{hood})			
	Etiketa 1	**Etiketa 2**	**Etiketa 3**	**Etiketa 4**
A+++ (më efiçente)				$\mathbf{EEI_{hood}} <$ 30
A++			$EEI_{hood} < 37$	$EEI_{hood} <$ 37
A+		$EEI_{hood} < 45$	$EEI_{hood} < 45$	$EEI_{hood} <$ 45
A	$EEI_{hood} < 55$	$EEI_{hood} < 55$	$EEI_{hood} < 55$	$EEI_{hood} <$ 55
B	EEI_{hood} I < 70	$EEI_{hood} < 70$	$EEI_{hood} < 70$	$EEI_{hood} <$ 70
C	$EEI_{hood} < 85$	$EEI_{hood} < 85$	$EEI_{hood} < 85$	$EEI_{hood} <$ 85
D	$85 \leq EEI_{hood} <$ 100	$85 \leq EEI_{hood} <$ 100	$85 \leq EEI_{hood} <$ 100	$EEI_{hood} \geq 85$

E	$EEI_{hood} < 110$	$EEI_{hood} < 110$	$EEI_{hood} \geq 100$	
F	$EEI_{hood} < 120$	$EEI_{hood} \geq 110$		
G (më pak efiçente)	EEI_{hood} I ≥ 120			

b) Klasat e efiçencës së dinamikës së lëngjeve të një aspiratori për përdorim shtëpiak përcaktohen sipas Efiçencë së tij të dinamikës së lëngjeve (FDE_{hood}) si në Tabelën 3 në vijim.

Tabela 3

Klasat e Efiçencës Dinamike të Lëngjeve për aspiratorët shtëpiak

Klasat e efiçencës së dinamikës së lëngjeve	**Efiçenca e Dinamikës së Lëngjeve (FDE_{hood})**
A (më efiçente)	$FDE_{hood} > 28$
B	$FDE_{hood} \leq 28$
C	$FDE_{hood} \leq 23$
D	$FDE_{hood} \leq 18$
E	$8 < FDE_{hood} \leq 13$
F	$4 < FDE_{hood} \leq 8$
G (më pak efiçente)	$FDE_{hood} \leq 4$

c) Klasat e efiçencës së ndriçimit të një aspiratori për përdorim shtëpiak përcaktohen sipas efiçencës së tij të ndriçimit (LE_{hood}) si në Tabelën 4 në vijim.

Tabela 4

Klasat e efiçencës së ndriçimit për aspiratorët për përdorim **shtëpiak**

Klasa e efiçencës së ndriçimit	**Efiçenca e ndriçimit (LE_{hood})**
A (më efiçente)	$LE_{hood} > 28$
B	20 $LE_{hood} \leq 28$
C	$16 < LE_{hood} \leq 20$
D	$12 < LE_{hood} \leq 16$
E	$8 < LE_{hood} \leq 12$
F	$4 < LE_{hood} \leq 8$
G (më pak efiçente)	$LE_{hood} \leq 4$

d) Klasat e efiçencës së filtrimit të yndyrave të një aspiratori për përdorim shtëpiak përcaktohen sipas Efiçencës së Filtrimit të Yndyrës (GFE_{hood}) si në Tabelën 5 në vijim.

Tabela 5

Efiçenca e Filtrimit të Yndyrës (GFE_{hood}) për aspiratorët për përdorim **shtëpiak**

Klasa e Efiçencës së Filtrimit të Yndyrës	**Efiçenca e Filtrimit të Yndyrës (%)**
A (më efiçente)	$GFE_{hood} > 95$

B	$GFE_{hood} \leq 95$
C	$GFE_{hood} \leq 85$
D	$GFE_{hood} \leq 75$
E	$GFE_{hood} \leq 65$
F	$GFE_{hood} \leq 55$
G (më pak efiçente)	$GFE_{hood} \leq 45$

SHTOJCA II
Matjet dhe llogaritjet

Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të respektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, matjet dhe llogaritjet bëhen duke përdorur një metodë të besueshme, të saktë dhe të riprodhueshme që merr parasysh metodat e matjes dhe të llogaritjes që janë moderne dhe të njohura përgjithësisht, duke përfshirë standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian. Ato plotësojnë përkufizimet teknike, kushtet, ekuacionet dhe parametrat e përcaktuar në këtë Shtojcë.

1. FURRAT PËR PËRDORIM SHTËPIAK

Konsumi i energjisë i zgavrës së një furre për përdorim shtëpiak matet për një cikël të standardizuar, në një opsion konvencional dhe në një opsion me fryrje me ventilator, nëse është i disponueshëm, duke ngrohur një masë të standardizuar të njomur me ujë. Verifikohet që temperatura brenda zgavrës së furrës të arrijë cilësimin e temperaturës së termostatit dhe/ose të ekranit të kontrollit të furrës brenda kohëzgjatjes së ciklit të provës. Në llogaritjet e mëposhtme përdoret konsumi i energjisë për cikël që korrespondon me opsionin që ka performancën më të mirë (opsionin konvencional ose opsionin me fryrje me ventilator).
Për çdo zgavër të një furre për përdorim shtëpiak, Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{cavity}) llogaritet sipas formulave të mëposhtme:
Për furrat elektrike për përdorim shtëpiak:

$$EEI_{cavity} = \frac{EC_{electric\ cavity}}{SEC_{electric\ cavity}} \times 100$$

$$SEC_{electric\ cavity} = 0.0042 \times V + 0.55 \text{ (kWh)}$$

Për furrat për përdorim shtëpiak me gaz:

$$EEI_{cavity} = \frac{EC_{gas\ cavity}}{SEC_{gas\ cavity}} \times 100$$

$$SEC_{gas\ cavity} = 0.044 \times V + 3.53 \text{ (MJ)}$$

Ku:
- **EEI_{cavity}** = Indeksi i Efiçencës së Energjisë për çdo zgavër të një furre për përdorim shtëpiak, në %, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore,
- **$SEC_{electric\ cavity}$** = Konsumi standard i energjisë (energjia elektrike) që nevojitet për të ngrohur një masë të standardizuar në një zgavër të një furre për përdorim shtëpiak të ngrohur me energji elektrike gjatë një cikli, i shprehur në kWh, i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore,
- **$SEC_{gas\ cavity}$** = Konsumi standard i energjisë që nevojitet për të ngrohur një masë të standardizuar në një zgavër të një furre për përdorim shtëpiakeme gaz gjatë një cikli, i shprehur në MJ, i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore,
— **V** = Vëllimi i zgavrës së furrës për përdorim shtëpiak në litra (L), i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt,

- **$EC_{electric\ cavity}$** = Konsumi i energjisë që nevojitet për të ngrohur një masë të standardizuar në një zgavër të një furre për përdorim shtëpiak të ngrohur me energjie elektrike gjatë një cikli, i shprehur në kWh, i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore,
- **$EC_{gas\ cavity}$** = Konsumi i energjisë që kërkohet për të ngrohur një masë të standardizuar në një zgavër me gaz të një furre për përdorim shtëpiak gjatë një cikli, i shprehur në MJ, i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore.

2. ASPIRATORËT PËR PËRDORIM SHTËPIAK

2.1. Llogaritja e Indeksit të Efiçencës së Energjisë (EEI_{hood})

Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{hood}) llogaritet si:

$$EEI_{hood} = \frac{AEC_{hood}}{SAEC_{hood}} \times 100$$

dhe rrumbullakoset në numrin e parë dhjetor.
Ku:
- $SAEC_{hood}$ është konsumi Standard Vjetor i Energjisë i aspiratorit për përdorim shtëpiak në kWh/vit, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.
- AEC_{hood} është Konsumi Vjetor i Energjisë i aspiratorit për përdorim shtëpiak në kWh/vit, i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.

Konsumi Standard Vjetor i Energjisë ($SAEC_{hood}$) i një aspiratori për përdorim shtëpiak llogaritet si:

$$SAEC_{hood} = 0.55 \times (W_{BEP} + W_L) + 15.3$$

Ku:
- W_{BEP} është fuqia elektrike e aspiratorit për përdorim shtëpiak në pikën më të mirë të efiçencës, në Wat dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.
- W_L është vlera nominale e fuqisë elektrike të sistemit të ndriçimit të aspiratorit për përdorim shtëpiak në sipërfaqen e gatimit, në Wat dhe e rrumbullakosur në numrin e parë dhjetor.

Konsumi Vjetor i Energjisë (AEC_{hood}) i një aspiratori për përdorim shtëpiak llogaritet si:

(i) Për aspiratorët për përdorim shtëpiak plotësisht automatik:

$$AEC_{hood} = \left[\frac{(W_{BEP} \times t_H \times \mathrm{f}) + (W_L \times t_L)}{60 + 1000} + \frac{P_0 \times (1440 - t_H \times \mathrm{f})}{2 \times 60 + 1000} + \frac{P_S \times (1440 - t_H \times \mathrm{f})}{2 \times 60 + 1000}\right] \times 365$$

(ii) Për të gjithë aspiratorët e tjerë për përdorim shtëpiak:

$$AEC_{hood} = \left[\frac{W_{BEP} \times (t_H \times \mathrm{f}) + (W_L \times t_L)}{60 + 1000}\right] \times 365$$

Ku:
- t_L është koha mesatare e ndriçimit në ditë, në minuta ($t_L = 120$),
- t_H është koha mesatare e funksionimit në ditë për aspiratorët për përdorim shtëpiak, në minuta ($t_H = 60$),

-P_o është fuqia elektrike në opsionin e fikur të aspiratorit për përdorim shtëpiak, në Wat dhe e rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore,
-P_s është fuqia elektrike në opsionin e gatishmërisë së aspiratorit për përdorim shtëpiak, në Wat dhe e rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore,
-f është faktori i rritjes së kohës, i llogaritur dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore, si:

$$f = 2 - \frac{(FDE_{hood} \times 3.6)}{100}$$

2.2. Llogaritja e Efiçencës së Dinamikës së Lëngjeve (FDE_{hood})

Efiçenca e Dinamikës së Lëngjeve (FDE_{hood}) në pikën më të mirë të efiçencës llogaritet me formulën e mëposhtme dhe rrumbullakoset në shifrën e parë dhjetore:

$$FDE_{hood} = \frac{(Q_{BEP} \times P_{BEP})}{(3600 \times W_{BEP})} \times 100$$

Ku:
-Q_{BEP} është norma e fluksit të intervalit të brendshëm në pikën më të mirë të efiçencës, e shprehur në m^3/h dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore,
-P_{BEP} është diferenca e presionit statik të aspiratorit për përdorim shtëpiak në pikën më të mirë të efiçencës, e shprehur në Pa dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt,
-W_{BEP} është fuqia elektrike e aspiratorit për përdorim shtëpiak në pikën më të mirë të efiçencës, e shprehur në Wat dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.

2.3. Llogaritja e Efiçencës së Ndriçimit (LE_{hood})

Efiçenca i Ndriçimit (LE_{hood}) e një aspiratori për përdorim shtëpiak është raporti ndërmjet ndriçimit mesatar dhe fuqisë nominale elektrike e sistemit të ndriçimit. Ajo llogaritet në lux për Wat dhe rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt, si:

$$LE_{hood} = \frac{E_{middle}}{W_L}$$

Ku:
-E_{middle} është ndriçimi mesatar i sistemit të ndriçimit në sipërfaqen e gatimit i matur në kushte standarde, në lux dhe i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt,
-W_L është vlera nominale e fuqisë elektrike së sistemit të ndriçimit të aspiratorit për përdorim shtëpiak në sipërfaqen e gatimit, në Wat dhe e rrumbullakosur në numrin e parë dhjetor.

2.4. Llogaritja e Efiçencës së Filtrimit të Yndyrës (GFE_{hood})

Efiçenca i filtrimit të yndyrës (GFE_{hood}) e një aspiratori për përdorim shtëpiak është sasia relative të yndyrës që ruhet brenda filtrave të yndyrës së aspiratorit. Ajo llogaritet dhe rrumbullakoset në shifrën e parë dhjetore si:

$$GFE_{hood} = \left[\frac{w_g}{(w_r + w_t + w_g)}\right] \times 100\ [\%]$$

Ku:

- w_g = masa e vajit në filtrin e yndyrës, ku përfshihen të gjitha copëzat e shkëputshme, në g dhe të rrumbullakosura në shifrën e parë dhjetore,
- w_r = masa e vajit e mbetur në rrugët e thithjes së aspiratorit, në g dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore,
- w_t = masa e vajit e mbetur në filtrin absolut, në g dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore.

2.5. Zhurma

Vlera e zhurmës (në dB) matet si emetimet vjetore të fuqisë akustike në shkallën A në ajër (vlera mesatare e ponderuar – L_{WA}) të aspiratorit për përdorim shtëpiak në cilësimin më të lartë të përdorimit normal, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt.

SHTOJCA III
Etiketa

1. ETIKETA E FURRAVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1.1. Furrat elektrike për përdorim shtëpiak

1.1.1. Prezantimi i etiketës - për çdo zgavër të një furre elektrike për përdorim shtëpiak



I,II

III

IV

V, VI

1.1.2. *Informacion i etiketës — furrat elektrike për përdorim shtëpiak*

Etiketa përfshin informacionin e mëposhtëm:

I. Emrin e furnizuesit ose markën tregtare;
II. Identifikuesin e modelit të furnizuesit, ku "identifikuesi i modelit" është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model specifik furre për përdorim shtëpiak nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër furnizuesi;
III. Burimi i energjisë i furrës për përdorim shtëpiak;
IV. Klasa e efiçencës së energjisë së zgavrës e përcaktuar sipas Shtojcës I. Koka e shigjetës që përmban shkronjën treguese duhet të vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;
V. Vëllimi i përdorshëm i zgavrës në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
VI. Konsumi i energjisë për cikël i shprehur në kWh/cikël (konsumi i energjisë elektrike) për funksionin(et) e ngrohjes (konvencionale dhe, nëse ekziston, me konveksion me fryrje ajri) së zgavrës bazuar në ngarkesën standarde të përcaktuar sipas procedurave të provës, të rrumbullakosura në shifrën e dytë dhjetore ($EC_{electric\ cavity}$).

1.1.3. *Skicimi i etiketës — furrat elektrike për përdorim shtëpiak*

Skicimi i etiketës për çdo zgavër të furrave elektrike për përdorim shtëpiak është si në figurën e mëposhtme:



Ku:

(i)Etiketa është, së paku, 85 mm e gjerë dhe 170 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(ii) Sfondi është i bardhë.

(iii)Ngjyrat janë CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, dhe ndjekin shembullin në vijim: 00-70-X-00: 0% cian, 70% e purpurt, 100% e verdhë, 0% e zezë.

(iv)Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Shtrirja e kufirit:** 4 pt — ngjyra: cian 100 % — këndet e rrumbullakëta: 3 mm.
2. **Logoja e BE-së:** ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Logoja e energjisë:** ngjyra: X-00-00-00; piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 70 mm, lartësia: 14 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — gjatësia: 70 mm.
5. **Shkalla e klasave të energjisë**

   Shigjeta: lartësia: 5,5 mm, hapësira: 1 mm - ngjyrat:
   - Klasa më e lartë: X-00-X-00
   - Klasa e dytë: 70-00-X-00
   - Klasa e tretë: 30-00-X-00
   - Klasa e katërt: 00-00-X-00
   - Klasa e pestë: 00-30-X-00
   - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
   - Klasa e fundit: 00-XX-00

   Teksti: shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale dhe në ngjyrë të bardhë; Simboli "+":në formatin Calibri bold 12 pt, në ngjyrë të bardhë, i rreshtuar në një rresht të vetëm.
6. **Klasa e efiçencës së energjisë**

   Shigjeta: gjerësia: 20 mm, lartësia: 10 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;

   Teksti: shkronjat në formatin Calibri bold 24 pt, shkronja kapitale dhe në ngjyrë të bardhë; Simboli "+": në formatin Calibri bold 18 pt, në ngjyrë të bardhë, i rreshtuar në një rresht të vetëm.
7. **Konsumi i energjisë për cikël**

   Kufiri: 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 3 mm.

   Vlera: shkronjat në formatin Calibri bold 19 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
8. **Vëllimi**

   Kufiri: 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 3 mm.

   Vlera: shkronjat në formatin Calibri bold 20 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
9. **Ylli:** në formatin Calibri regular 6 pt, 100% në ngjyrë të zezë.
10. **Numri i rregullores:** në formatin Calibri bold 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
12. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**
13. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit** vendosen në një hapësirë prej 70 × 13 mm.

1.2. Furrat për përdorim shtëpiak me gaz

1.2.1. *Prezantimi i etiketës - për çdo zgavër të furrës për përdorim shtëpiak që operon me gaz*



I, II

III

IV

V, VI

1.2.3. ***Informacioni i etiketës***

Etiketa përfshin informacionin e mëposhtëm:

I. Emrin e furnizuesit ose markën tregtare;

II. Identifikuesin e modelit të furnizuesit, ku "identifikuesi i modelit" është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model specifik furre për përdorim shtëpiak nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër të furnizuesit;

III. Burimin e energjisë i furrës për përdorim shtëpiak;

IV. Klasën e efiçencës së energjisë së zgavrës e përcaktuar sipas Shtojcës I. Koka e shigjetës që përmban shkronjën treguese vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë;

V. Vëllimin e përdorshëm të zgavrës në litra, të rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

VI. Konsumin e energjisë për cikël të shprehur në MJ/cikël dhe në kWh/cikël ([1]) (konsumin e gazit) për funksionin(et) e ngrohjes (konvencionale dhe, nëse ekziston, konveksioni me fryrje ajri) të zgavrës bazuar në ngarkesën standarde të përcaktuar sipas procedurave të provës, të rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore ($EC_{gas\ cavity}$).

1.2.3. ***Skicimi i etiketës - furrat për përdorim shtëpiak me gaz***

Skicimi i etiketës për çdo zgavër të një furre për përdorim shtëpiak që operon me gaz është si në figurën e mëposhtme:



0

Ku:

i. Etiketa është, së paku, 85 mm e gjerë dhe 170 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

ii. Sfondi është i bardhë.

iii. Ngjyrat janë CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, dhe ndjekin shembullin në vijim: 00-70-X-00: 0% cian, 70% e purpurt, 100% e verdhë, 0% e zezë.

iv. Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Shtrirja e kufirit:** 4 pt — ngjyra: cian 100 % — këndet e rrumbullakëta: 3 mm.

2. **Logoja e BE-së:** ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Logoja e energjisë:** ngjyra: X-00-00-00; piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etike energjisë: gjerësia: 70 mm, lartësia: 14 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — gjatësia: 70 mm.
5. **Shkalla e klasave të energjisë**
   Shigjeta: lartësia: 5,5 mm, hapësira: 1 mm
   Ngjyrat:
   - Klasa më e lartë: X-00-X-00
   - Klasa e dytë: 70-00-X-00
   - Klasa e tretë: 30-00-X-00
   - Klasa e katërt: 00-00-X-00
   - Klasa e pestë: 00-30-X-00
   - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
   - Klasa e fundit: 00-XX-00

   Teksti: shkronjat në formatin Calibri bold 18 pt, kapitale dhe në ngjyrë të bardhë; Simboli "+": në formatin Calibri bold 12 pt, në ngjyrë të bardhë, rreshtuar në një rresht të vetëm.
6. **Klasa e efiçencës së energjisë**
   Shigjeta: gjerësia: 20 mm, lartësia: 10 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;
   Teksti: shkronjat në formatin Calibri bold 24 pt, kapitale dhe në ngjyrë të bardhë; Simboli "+" formatin Calibri bold 18 pt, në ngjyrë të bardhë, e rreshtuar në një rresht të vetëm.
7. **Konsumi i energjisë për cikël**
   Kufiri: 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 3 mm.
   Vlera: në formatin Calibri bold 19 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
8. **Vëllimi**
   Kufiri: 1,5 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 3 mm.
   Vlera: në formatin Calibri bold 20 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
9. **Ylli:** në formatin Calibri regular 6 pt, 100% në ngjyrë të zezë.
10. **Numri i rregullores:** në formatin Calibri bold 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
11. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
12. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**
13. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit** vendosen në një hapësirë 70 × 13 mm.

2. ETIKETA E ASPIRATORËVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

2.1. Formatet e etiketave

2.1.1 *Aspiratorët për përdorim shtëpiak në klasat e efiçencës së energjisë A deri në G*



I, II

III

IV

V, VI,

2.1.2 *Aspiratorët për përdorim shtëpiak në klasat e efiçencës së energjisë A+ deri në F*



2.1.3 *Aspiratorët për përdorim shtëpiak në klasat e efiçencës së energjisë A++ deri në E*



2.1.4 ***Aspiratorët për përdorim shtëpiak në klasat e efiçencës së energjisë A+++ deri në D***



I, II

III

IV

V, VI, VII, VIII

2.2. Informacioni i etiketës — aspiratorët *për përdorim* shtëpiak

Etiketa përfshin informacionin e mëposhtëm:

I. Emrin e furnizuesit ose markën tregtare;

II. Identifikuesin e modelit të furnizuesit, ku "identifikuesi i modelit" është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model specifik të aspiratorit vendas nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose tjera me të njëjtin emër të furnizuesit;

III. Klasën e efiçencës së energjisë së aspiratorit për përdorim shtëpiak, e përcaktuar sipas Shtojcës I. Koka e shigjetës që përmban klasën e efiçencës së energjisë të aspiratorit për përdorim shtëpiak vendoset në të njëjtën lartësi me majën e shigjetës së efiçencës së klasës përkatëse të energjisë;

IV. Konsumin vjetor të energjisë (AEC_{hood}) të llogaritur sipas Shtojcës II, në kWh të rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

V. Klasën e Efiçencës së Dinamikës së Lëngjeve të përcaktuar sipas Shtojcës I;

VI. Klasën e Efiçencës së Ndriçimit të përcaktuar sipas Shtojcës I;

VII. Klasën e Efiçencës së Filtrimit të Yndyrës të përcaktuar sipas Shtojcës I;

VIII. Vlerën e zhurmës, të përcaktuar sipas pikës 2.5 të Shtojcës II, të rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

2.3. Skicimi i etiketës - aspiratorët *për përdorim* shtëpiak

Skicimi i etiketës është si në figurën e mëposhtme:



Ku:

(i)Etiketa është, së paku, 60 mm e gjerë dhe 120 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(ii) Sfondi është i bardhë.

(iii)Ngjyrat janë CMYK - cian, e purpurt, e verdhë dhe e zezë, dhe ndjekin shembullin në vijim: 00-70-X-00: 0% cian, 70% e purpurt, 100% e verdhë, 0% e zezë.

(iv)Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1. **Shtrirja e kufirit:** 3 pt — ngjyra: cian 100 % — këndet e rrumbullakëta: 2 mm.
2. **Logoja e BE-së:** ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.
3. **Logoja e energjisë:** ngjyra: X-00-00-00; piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 51 mm, lartësia: 10 mm.
4. **Kufiri i nën-logos:** 1 pt — ngjyra: cian 100 % — gjatësia: 51 mm.
5. **Shkalla e klasave të energjisë**

   Shigjeta: lartësia: 4 mm, hapësira: 0.75 mm - ngjyrat:
   - Klasa më e lartë: X-00-X-00
   - Klasa e dytë: 70-00-X-00
   - Klasa e tretë: 30-00-X-00
   - Klasa e katërt: 00-00-X-00
   - Klasa e pestë: 00-30-X-00
   - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00
   - Klasa e fundit: 00-XX-00

   Teksti: shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt, kapitale dhe në ngjyrë të bardhë; Simboli "+": në formatin Calibri Bold 7 pt, në ngjyrë të bardhë, rreshtuar në një rresht të vetëm.
6. **Klasa e efiçencës së energjisë**

   Shigjeta: gjerësia: 15 mm, lartësia: 8 mm, 100 % në ngjyrë të zezë;

   Teksti: shkronjat në formatin Calibri bold 17 pt, shkronja kapitale dhe në ngjyrë të bardhë; Simboli "+": në formatin Calibri bold 12 pt, në ngjyrë të bardhë, i rreshtuar në një rresht të vetëm.
7. **Konsumi i energjisë për cikël**

   Kufiri: 1 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 2.5 mm.

   Vlera: në formatin Calibri bold 21 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe në formatin Calibri regular 8 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
8. **Efiçenca e dinamikës së lëngjeve**

   Piktogrami siç përshkruhet

   Kufiri: 1 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 2.5 mm.

   Vlera: në formatin Calibri regular 6 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe në formatin Calibri bold 11.5 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
9. **Efiçenca e ndriçimit**

   Piktogrami siç përshkruhet

   Kufiri: 1 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 2.5 mm.

   Vlera: në formatin Calibri regular 6 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe në formatin Calibri bold 11.5 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.
10. **Efiçenca e filitrimit të yndyrës**.

    Piktogrami siç përshkruhet

    Kufiri: 1 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 2.5 mm.

Vlera: në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe në formatin Calibri bold 11.5 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

11. **Niveli i zhurmës**

Piktogrami siç përshkruhet

Kufiri: 1 pt — ngjyra: cian 100 % — kënde të rrumbullakëta: 2.5 mm.

Vlera: në formatin Calibri regular 6 pt, 100 % në ngjyrë të zezë; dhe në formatin Calibri bold 11.5 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

12. **Numri i rregullores:** në formatin Calibri bold 8 pt, 100 % në ngjyrë të zezë
13. **Emri i furnizuesit ose marka tregtare**
14. **Identifikuesi i modelit të furnizuesit**
15. Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 51 × 9 mm.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA IV
Skeda informative e produktit

A. SKEDA INFORMATIVE E FURRAVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1. Informacioni në skedën informative të furrave për përdorim shtëpiak i përmendur në kreun III jepet siç përcaktohet më poshtë dhe në rendin e specifikuar më poshtë, dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që jepet me produktin:

(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b) Identifikuesi i modelit të furnizuesit që është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model specifik të furrës për përdorim shtëpiak nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër të furnizuesit dhe me vlera të ndryshme të deklaruara për cilindo nga parametrat e përfshirë në etiketën e furrës për përdorim shtëpiak (pika 1 të Shtojcës III);

(c) Indeksi i efiçencës së energjisë (EEIcavity) për çdo zgavër të modelit i llogaritur sipas pikës 1 të Shtojcës II dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore; indeksi i deklaruar i efiçencës së energjisë nuk tejkalon indeksin e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(ç) Klasa e efiçencës së energjisë së modelit për çdo zgavër siç përcaktohet në Tabelën 1 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e favorshme se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(d) Konsumi i energjisë sipas ciklit për çdo zgavër, nëse ekziston, në opsionin konvencional dhe në opsionin e konveksionit me fryrje me ventilator (konsumi i matur i energjisë shprehet në kWh (furra elektrike dhe me gaz) dhe në MJ (furra me gaz), i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore); vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(dh) Numri i zgavrave; burimi(et) e nxehtësisë për zgavër; dhe vëllimi i secilës zgavër.

2. Përjashtimisht, Kur një modeli i është dhënë një "Etiketë Ekologjike", mund të shtohet një kopje e etiketës ekologjike të saj.

3. Një skedë informative mund të mbulojë një numër modelesh furrash për përdorim shtëpiak të furnizuara nga i njëjti furnizues.

4. Në rastet kur informacioni i përfshirë në skedën informative të produktit jepet në formën e një kopje të etiketës së çdo zgavre (me ngjyra ose bardh e zi), jepet gjithashtu edhe informacioni i renditur në pikën 1, i pa shfaqur tashmë në etiketë.

B. SKEDA INFORMATIVE E ASPIRATORËVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1. Informacioni në skedën informative të aspiratorëve për përdorim shtëpiak i përmendur në kreun III(1)(b)(ii) jepet siç përcaktohet më poshtë si dhe në rendin e specifikuar më poshtë dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që jepet me produktin:

(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b)Identifikuesi i modelit të furnizuesit që është kodi, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model specifik të aspiratorit për përdorim shtëpiak nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose emër të furnizuesit dhe me vlera të ndryshme të deklaruara për cilindo nga parametrat e përfshirë në etiketën e aspiratorit për përdorim shtëpiak (pika 2 e Shtojcës III);

(c)Konsumi Vjetor i Energjisë (AEC_{hood}) i llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II, në kWh/vit dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(ç) Klasa e Efiçencës së Energjisë, siç përcaktohet në Tabelën 2 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e favorshme se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(d)Efiçenca e Dinamikës së Lëngjeve (AEC_{hood}) e llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II, e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e lartë se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(dh)Klasa e Efiçencës së Dinamikës së Lëngjeve, siç përcaktohet në Tabelën 3 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e mirë se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(e)Efiçenca e Ndriçimit (LE_{hood}) e llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II, në lux/Wat dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e lartë se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(ë)Klasa e Efiçencës së Ndriçimit, siç përcaktohet në Tabelën 4 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e mirë se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(f)Efiçenca e Filtrimit të Yndyrës e llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II, në përqindje dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e lartë se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(g) Klasa e Efiçencës së Filtrimit të Yndyrës, siç përcaktohet në Tabelën 5 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e mirë se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(gj) Fluksi i ajrit (në m^3 /h, dhe i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt), me shpejtësi minimale dhe maksimale në përdorim normal, përjashtuar përdorimin intensiv ose të rritur; vlerat e deklaruara nuk duhet të jenë më të larta se vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(h)Fluksi i ajrit (në m^3 /h, nëse është i disponueshëm, dhe i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt), në cilësimin intensiv ose të rritur; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e lartë se vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(i)Emetimet e fuqisë akustike në ajër të ponderuara në shkallën A (në dB të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt), me shpejtësinë minimale dhe maksimale të disponueshme në përdorim normal; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(j)Nëse janë të disponueshme, emetimet e fuqisë akustike në ajër të ponderuara në shkallën A (në dB të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt), në cilësimin intensiv ose të

rritur; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(k) Nëse është i disponueshëm, konsumi i energjisë në modalitetin e fikur (P_o), në Wat dhe i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore; vlerat e deklaruara nuk duhet të jenë më të ulëta se vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(l)Nëse është i disponueshëm, konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë (P_s), në Wat dhe i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore; vlerat e deklaruara nuk duhet të jenë më të ulëta se vlerat e raportuara në dokumentacionin teknik në Shtojcën V.

2. Një skedë informative mund të mbulojë një numër modelesh të aspiratorëve për përdorim shtëpiak që furnizohen nga i njëjti furnizues.
3. Në rastet kur informacioni i përfshirë në skedën informative të produktit mund të jepet në formën e një kopje të etiketës (qoftë me ngjyra ose bardh e zi), jepet gjithashtu edhe informacioni i renditur në pikën 1, i pa shfaqur tashmë në etiketë.

SHTOJCA V
Dokumentacioni Teknik

A. DOKUMENTACION TEKNIK I FURRAVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1. Dokumentacioni teknik i përmendur në kreun III përfshin, së paku:

a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

b) Një përshkrim i përgjithshëm i modelit të pajisjes, i mjaftueshëm që ai të identifikohet pa mëdyshje dhe me lehtësi, duke përfshirë identifikuesin e modelit të furnizuesit (d.m.th., kodin, zakonisht alfanumerik) që dallon një model specifik furre shtëpiake nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër të furnizuesi dhe me vlera të ndryshme të deklaruara për cilindo nga parametrat e përfshirë në etiketën e furrës shtëpiake (pika 1 e Shtojcës III);

c) Parametrat teknikë për matjet janë si më poshtë:

i. Numri i zgavrave; vëllimi i secilës zgavër; burimi(et) e nxehtësisë për zgavër; funksioni(et) e ngrohjes (konvencional dhe/ose me konveksion me fryrje ajri) për zgavër;

ii. Konsumi i energjisë për cikël për çdo zgavër, nëse është i disponueshëm, në opsionin konvencional dhe në opsionin me konveksion me fryrje me ventilator; konsumi i matur i energjisë shprehet në kWh (furra elektrike dhe me gaz) dhe në MJ (furra me gaz), e rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore;

iii. Indeksi i efiçencës së energjisë (EEI_{cavity}) për çdo zgavër të furrës për përdorim shtëpiak i llogaritur sipas pikën 1 të Shtojcës II dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

iv. Klasa e efiçencës së energjisë për çdo zgavër të furrës për përdorim shtëpiake siç përcaktohet në Tabelën 1 të Shtojcës I;

ç) Një kopje e llogaritjes dhe e rezultateve të llogaritjeve të kryera sipas Shtojcës II;

d) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

e) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

f) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin.

2. Furnizuesit mund të përfshijnë informacion shtesë në fund të listës së mësipërme.

B. DOKUMENTACIONI TEKNIK I ASPIRATORËVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1. Dokumentacioni teknik i përmendur në kreun III(1)(b)(iii) përfshin, së paku:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b)Një përshkrim të përgjithshëm të modelit të pajisjes, i mjaftueshëm që ai të identifikohet pa mëdyshje dhe me lehtësi, duke përfshirë identifikuesin e modelit të furnizuesit (d.m.th., kodin, zakonisht alfanumerik) i cili dallon një model të veçantë të aspiratorit vendas nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose me të njëjtin emër të furnizuesit dhe me

vlera të ndryshme të deklaruara për cilindo nga parametrat e përfshirë në etiketën e aspiratorit për përdorim shtëpiak (pika 2 e Shtojcës III);

(c)Parametrat teknikë për matjet si më poshtë:

(1)Indeksi i Efiçencës së Energjisë (EEI_{hood}) i llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(2) Klasa e Efiçencës së Energjisë, siç përcaktohet në Tabelën 2 të Shtojcës I;

(3)Konsumi Vjetor i Energjisë (AEC_{hood}) i llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II, në kWh/vit dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(4)Faktori i rritjes së kohës (f), sipas pikës 2 të Shtojcës II dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(5)Efiçenca e Dinamikës së Lëngjeve (FDE_{hood}) e llogaritur sipas pikën 2 të Shtojcës II dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(6)Klasa e Efiçencës së Dinamikës së Lëngjeve, siç përcaktohet në Tabelën 3 të Shtojcës I;

(7)Norma e matur e fluksit të aspiratorit për përdorim shtëpiak në pikën më të mirë të efiçencës (Q_{BEP}), në m^3 /h dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(8)Vlera e matur e diferencës së presionit statik të aspiratorit për përdorim shtëpiak në pikën më të mirë të efiçencës (P_{BEP}), në Pa dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(9)Vlera e matur e fuqisë elektrike të aspiratorit për përdorim shtëpiak në pikën më të mirë të efiçencës (W_{BEP}), në Wat dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(10)Ndriçimi mesatar i sistemit të ndriçimit në sipërfaqen e gatimit (E_{middle}), në lux dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(11)Konsumi nominal i energjisë së sistemit të ndriçimit në sipërfaqen e gatimit (W_L), në Wat dhe i rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(12)Vlera e matur e Efiçencës së Ndriçimit (LE_{hood}) e llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II, në lux/Wat dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(13) Klasa e Efiçencës së Ndriçimit, siç përcaktohet në Tabelën 4 të Shtojcës I;

(14)Vlera e matur e Efiçencës së Filtrimit të Yndyrës (GFE_{hood}) e llogaritur sipas pikës 2 të Shtojcës II dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(15)Klasa e Efiçencës së Filtrimit të Yndyrës, siç përcaktohet në Tabelën 5 të Shtojcës I;

(16)Nëse është i disponueshëm, konsumi i energjisë në modalitetin fikur (P_o), në Wat dhe i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore;

(17)Nëse është i disponueshëm, konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë (P_s), në Wat dhe i rrumbullakosur në shifrën e dytë dhjetore;

(18)Emetimet e fuqisë akustike në ajër të ponderuara në shkallën A me shpejtësinë minimale dhe maksimale të disponueshme në përdorim normal, në dB dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

(19)Nëse është e pranishme, emetimet e fuqisë akustike në ajër të ponderuara në shkallën A në cilësimet intensive ose të rritura, në dB dhe të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

(20)Vlerat e fluksit të ajrit të aspiratorit për përdorim shtëpiak me shpejtësi minimale dhe maksimale të disponueshme në përdorim normal, në m^3 /h dhe të rrumbullakosura në shifrën e parë dhjetore;

(21) Nëse është e disponueshme, vlera e fluksit së ajrit të aspiratorit për përdorim shtëpiak në cilësimet intensive ose të rritura, në m^3 /h dhe e rrumbullakosur në shifrën e parë dhjetore;

(ç) Një kopje të llogaritjeve dhe rezultateve të llogaritjeve të kryera sipas Shtojcës II;

(d) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(e) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(ë) Identifikimi dhe nënshkrimi i personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin.

2. Furnizuesit mund të përfshijnë informacion shtesë.

SHTOJCA VI
Informacioni që jepet në rastet kur produkti nuk i shfaqet përdoruesit fundor, përjashtuar rastet përmes internetit

A. FURRAT PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1. Informacioni i përmendur në kreun IV(1)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b)Identifikuesi i modelit të furnizuesit, d.m.th., identifikuesi i modelit të furrës specifike për përdorim shtëpiak për të cilën zbatohen shifrat e cituara më poshtë;

(c)Klasa e efiçencës së energjisë së modelit për çdo zgavër siç përcaktohet në Tabelën 1 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e favorshme se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(ç)Konsumi i energjisë për cikël për çdo zgavër, nëse është i disponueshëm, në opsionin konvencional dhe në opsionin me konveksion me fryrje me ventilator; konsumi i matur i energjisë shprehet në kWh (furra elektrike dhe me gaz) dhe në MJ (furra me gaz), i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(d) Numri i zgavrave; burimi(et) e nxehtësisë për zgavër; vëllimi i secilës zgavër.

2. Kur jepen edhe informacione të tjera të përfshira në skedën e informative të produktit, ato duhet të jenë në formën dhe rendin e specifikuar në Shtojcën IV.
3. Madhësia dhe formati i shkronjave në të cilin shkruhet ose tregohet i gjithë informacioni i përmendur në këtë Shtojcë, duhet të jenë të lexueshme.

B. ASPIRATORËT PËR PËRDORIM SHTËPIAK

1. Informacioni i përmendur në kreun IV(2)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b)Identifikuesi i modelit të furnizuesit, d.m.th., identifikuesi i modelit të aspiratorit specifik, për të cilin aplikohen shifrat e cituara më poshtë;

(c)Klasa e efiçencës së energjisë së modelit siç përcaktohet në Tabelën 2 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e favorshme se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(ç)Konsumi vjetor i energjisë i modelit në kWh, siç përcaktohet në pikën 2.1 të Shtojcës II; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(d)Klasa e Efiçencës së Dinamikës së Lëngjeve të modelit siç përcaktohet në Tabelën 3 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e favorshme se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(dh)Klasa e efiçencës së ndriçimit të modelit siç përcaktohet në Tabelën 4 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e favorshme se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(e)Klasa e efiçencës së filtrimit të yndyrës së modelit siç përcaktohet në Tabelën 5 të Shtojcës I; klasa e deklaruar nuk duhet të jetë më e favorshme se klasa e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V;

(ë)Emetimet e fuqisë akustike në ajër të ponderuara në shkallën A (vlera mesatare e ponderuar – L_{WA}) të një aspiratori për përdorim shtëpiak me shpejtësi minimale dhe maksimale të disponueshme në përdorim normal, në dB të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt; vlera e deklaruar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e raportuar në dokumentacionin teknik në Shtojcën V.

2. Kur jepen edhe informacione të tjera të përfshira në skedën informative të produktit, ato duhet të jenë në formën dhe rendin e specifikuar në Shtojcën IV.
3. Madhësia dhe formati i shkronjave në të cilën shkruhet ose paraqitet i gjithë informacioni i përmendur në këtë Shtojcë, duhet të jenë të lexueshme.

SHTOJCA VII

Informacioni që jepet në rastin e shitjes, qiradhënies ose blerjes me këste, përmes internetit

1. Për qëllimet e pikave 2 deri në 5 të kësaj Shtojce zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(a)"Mekanizmi i shfaqjes" është çdo ekran, duke përfshirë ekranin me prekje, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;

(b)"Ekran i ndërlidhur" është ndërfaqja vizuale ku një imazh ose grup të dhënash aksesohet me një klikim të mausit, me rrotullim të mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi një imazh ose grup tjetër të dhënash;

(c)"Ekran me prekje" është një ekran që i përgjigjet prekjes, si p.sh., ai i një kompjuteri tablet, kompjuteri me ekran ose një i një telefoni inteligjent;

(d)"Tekst alternativ" është teksti i ofruar si një alternativë ndaj një grafiku që bën të mundur që informacioni të paraqitet në formë jo grafike kur pajisjet e ekranit nuk mund të paraqesin grafikun ose që shërben si një ndihmë për aksesueshmërinë, siç është rasti i hyrjes në aplikacionet e sintezës së zërit.

2. Etiketa e përshtatshme e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas kreut III(1)(a)(vi) ose 3(1)(b)(vi) shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi me çmimin e produktit sipas afatit të përcaktuar në nenin 3(3). Për furrat, etiketa e përshtatshme tregohet për çdo zgavër të furrës. Madhësia është e tillë që etiketa të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe të jetë proporcionale me madhësinë e specifikuar në Shtojcën III. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë përputhet me specifikimet e përcaktuara në pikën 3 të kësaj Shtojce. Nëse aplikohet ekrani i ndërlidhur, etiketa shfaqet me klikimin e parë të mausit, me rrotullimin e mausit ose me zgjerimin e ekranit me prekje mbi imazh.

3. Imazhi i përdorur për të hyrë në etiketë në rastin e ekranit të ndërlidhur:

(a)Është një shigjetë në ngjyrën që korrespondon me klasën e efiçencës së energjisë së produktit në etiketë;

(b)Tregon në shigjetë klasën e efiçencës së energjisë së produktit në ngjyrë të bardhë në një madhësi shkronje të barabartë me atë të çmimit; dhe

(c) Ka një nga dy formatet e mëposhtme:





4. Në rastin e ekranit të ndërlidhur, radha e shfaqjes së etiketës është si më poshtë:

(a)Imazhi i përmendur në pikën 3 të kësaj Shtojce shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit;

(b) Imazhi lidhet me etiketën;

(c)Etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, rrotullimit të mausit ose zgjerimit të ekranit me prekje mbi imazh;

(ç)Etiketa shfaqet me anë të një dritareje të, skede të re, ose me anë të një faqeje të re ose ekranit të integruar;

(d)Për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen konventat e pajisjes për zmadhimin me prekje;

(dh)Shfaqja e etiketës ndalon me anë të opsionit të mbylljes ose mekanizmit tjetër standard të mbylljes;

(e)Teksti alternativ për grafikun, i cili do të shfaqet në rast të mosshfaqjes së etiketës, është klasa e efiçencës së energjisë së produktit në një madhësi shkronje të barabartë me atë të çmimit.

5. Etiketa e përshtatshme e produktit e vënë në dispozicion nga furnizuesit sipas kreut III(1)(a)(vii) ose 3(1)(b)(vii) shfaqet në mekanizmin e shfaqjes në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia është e tillë që etiketa e produktit të jetë e dukshme dhe e lexueshme në mënyrë të qartë. Etiketa e produktit mund të shfaqet duke përdorur një ekran të ndërlidhur, rast në të cilin lidhja e përdorur për aksesin në etiketë tregon qartë dhe në mënyrë të lexueshme togfjalëshin "Etiketa e produktit". Nëse përdoret ekrani i ndërlidhur, etiketa e produktit shfaqet me klikimin e parë të mausit, rrotullimin e mausit ose zgjerimin e ekranit me prekje mbi lidhje.

SHTOJCA VIII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë lidhen vetëm me verifikimin nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut të vlerave të deklaruara dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesi si tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik ose për të interpretuar këto vlera me synimin e arritjes së përputhshmërisë ose për të komunikuar performancë më të mirë. Vlerat dhe klasat e publikuara në etiketë ose në skedën e informacionit të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara në dokumentacionin teknik.

Gjatë verifikimit të përputhshmërisë së një modeli produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore të Deleguar, për kërkesat e referuara në këtë Shtojcë, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston një njësi të vetme për model.
2. Modeli konsiderohet se respekton kërkesat e aplikueshme:

(a) Vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik sipas pikës 3 të nenit 9 të Ligjit 52/2024, dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit; dhe

(b) Vlerat e publikuara në etiketë dhe në fletën e informacionit të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e eficencës së energjisë dhe klasa e emetimit të zhurmës akustike në ajër nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe

(c) Kur Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 6.

3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen se nuk respektojnë këtë rregullore.
4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zgjedh tre njësi shtesë të së njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund t'i përkasin një ose më shumë modeleve të ndryshme, të cilat janë renditur si produkt i barasvlershëm në dokumentacionin teknik të furnizuesit.
5. Modeli quhet se respekton kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 6.
6. Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet e barasvlershme konsiderohen se nuk janë sipas kësaj rregulloreje.
7. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut jep të gjithë informacionin përkatës pa vonesë, pasi të merret një vendim për mosrespektimin e kërkesave nga ana e modelit sipas pikave 3 dhe 6 të kësaj Shtojce.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën II.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 6 dhe përdor vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 7 për kërkesat e referuara në këtë Shtojcë. Nuk lejohet zbatimi i asnjë tolerance tjetër, përfshirë ato të përcaktuara në standarde të harmonizuara apo në ndonjë metodë tjetër matjeje. *Tabela 6*

Tabela 6

Tolerancat e verifikimit

Parametrat e matur	**Tolerancat e verifikimit**
Masa e furrës (M)	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të M me më shumë se 5 %.
Vëllimi i zgavrës së furrës (V)	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar e V me më shumë se 5 %.
$EC_{electric\ cavity}$, $EC_{gas\ cavity}$	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të $EC_{electric\ cavity}$, $EC_{gas\ cavity}$ me më shumë se 5%.
W_{BEP} , W_L	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të W_{BEP} , W_L me më shumë se 5%.
Q_{BEP} , P_{BEP}	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar e Q_{BEP} , P_{BEP} me më shumë se 5%.
Q_{max}	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të Q_{max} me më shumë se 8 %.
E_{middle}	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar e E_{middle} me më shumë se 5 %.
GFE_{hood}	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar e GFE_{hood} me më shumë se 5 %.
P_o , P_s	Vlera e përcaktuar e konsumit të energjisë P_o dhe P_s nuk e kalon vlerën e deklaruar me më shumë se 10 %. Vlera e përcaktuar e konsumit të energjisë P_o dhe P_s më pak ose e barabartë me 1,00 W nuk e kalon vlerën e deklaruar për më shumë se 0,10 W.
Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}	Vlera e përcaktuar nuk kalon vlerën e deklaruar.

ANEKS NR.17

RREGULLORE
"PËR
ETIKETIMIN E GOMAVE NË LIDHJE ME EFIÇENCËN E KARBURANTIT DHE PARAMETRAVE TË TJERË"[1]

I. QËLLIMI

1. Kjo rregullore përcakton një kornizë për dhënien e informacionit mbi parametrat e gomave nëpërmjet etiketimit për të lejuar përdoruesit fundorë të bëjnë një zgjedhje të informuar kur blejnë goma, me qëllim të:
   a) rritjes së sigurisë;
   b) mbrojtjes të shëndetit;
   c) rritjes efikasitetit ekonomik dhe mjedisor të transportit rrugor;
   ç) promovimit të gomave me nivel të ulët zhurmash, me jetëgjatësi të konsiderueshme dhe efiçente në konsumin e karburantit;

II. FUSHA E ZBATIMIT

1. Kjo rregullore do të zbatohet për gomat C1, gomat C2 dhe gomat C3 të cilat vendosen në treg.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
   a) goma profesionale për terrene të vështira.
   b) gomat e projektuara për t'u montuar vetëm në automjete të regjistruara për herë të parë përpara datës 1 Tetor 1990;
   c) goma rezervë për përdorim të përkohshëm të tipit T;
   ç) gomat shpejtësia e të cilave është më pak se 80 km/h;
   d) gomat, diametri nominal i buzës së të cilave nuk i kalon 254 mm ose është 635 mm ose më shumë;
   dh) gomat e pajisura me elementë shtesë për të përmirësuar vetitë e traksionit, si p.sh. gomat me gozhda;
   e) gomat e projektuara vetëm për t'u vendosur në automjete të destinuara ekskluzivisht për gara;
   ë) gomat e përdorura, përveç rasteve kur goma të tilla janë të importuara.
   f) gomat e riveshura, deri në miratimin e një metodologjie për vlerësimin e performancës së tyre.
3. Ministri përgjegjës për energjinë miraton një udhëzim për metodologjinë e vlerësimit të performancës së gomave të riveshura.

[1] Kjo rregullore është përafruar plotësisht me rregulloren (BE) 2020/740 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 Maj 2020, "Per etiketimin e gomave në lidhje me efiçencën e karburantit dhe parametrave të tjerë" duke ndryshuar rregulloren (EU) 2017/1369 dhe shfuqizimin e rregullores (EC) No. 1222/2009". Numri CELEX 02020R0740, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 177, datë 05.06.2020, f. 1.

III. PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e përcaktuar në ligjin nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"baza e të dhënave të produktit"** nënkupton një koleksion të dhënash në lidhje me produktet, i cili organizohet në mënyrë sistematike dhe përbëhet nga një pjesë publike e orientuar nga konsumatori, ku është informacioni në lidhje me parametrat e produktit individual e aksesueshme me mjete elektronike, një portal online për aksesueshmërinë dhe një pjesë përputhshmërie, me të specifikuar qartë kërkesat për akses dhe siguri;
2. **"bërje e disponueshme e produktit në treg** sipas pikës 1 të nenit 3 të ligjit "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji";
3. **"distributor"** nënkupton një person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, përveç furnizuesit, i cili e vë një produkt të disponueshëm në treg;
4. **"dokumentacioni teknik"** sipas pikës 3 të nenit 3 të ligjit "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji";
5. **"etiketa e gomave"** nënkupton një diagramë grafike, në formë të printuar ose elektronike, përfshirë në formën e një ngjitësi, e cila përfshin simbole për të informuar përdoruesit përfundimtarë për performancën e një gome ose grupi gomash në lidhje me parametrat e përcaktuar sipas shtojcës 1;
6. **"fletë e informacionit të produktit"** nënkupton një dokument standard që përmban informacionin e përcaktuar në Shtojcën III në formë të shtypur ose elektronike;
7. **"furnizues"** sipas pikës 7 të nenit 3 të ligjit "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji";
8. **"goma C1, goma C2 dhe goma C3"** do të thotë goma që i përkasin klasave përkatëse konkretisht:
   I. **"goma të klasës C1"** goma të projektuara kryesisht për automjetet e kategorive M1, N1, O1 dhe O2;
   II. **"gomat e klasës C2"** - gomat e projektuara kryesisht për automjetet e kategorive M2, M3, N, O3 dhe O4 me një indeks të kapacitetit të ngarkesës në formacion të vetëm $\leq$ 121 dhe simbolin e kategorisë së shpejtësisë $\geq$ 'N';
   III. **"gomat e klasës C3"** - gomat e projektuara kryesisht për automjetet e kategorive M2, M3, N, O3 dhe O4 me një nga indekset e mëposhtme të kapacitetit të ngarkesës;

   Një gomë mund të klasifikohet në më shumë se një klasë me kusht që të plotësojë të gjitha kërkesat përkatëse të secilës klasë në të cilën është klasifikuar.
9. **"goma rezervë për përdorim të përkohshëm të tipit T"** nënkupton një gomë rezervë për përdorim të përkohshëm të projektuar për përdorim në presione të fryrjes më të larta se ato të vendosura për gomat standarde dhe të përforcuara;
10. **"gomë e riveshur"** nënkupton një gomë të përdorur që ritrajtohet duke zëvendësuar pjesën e konsumuar me material të ri;

11. **"gomë profesionale për terrene të vështira"** nënkupton një gomë me përdorim të veçantë që përdoret kryesisht në kushte të vështira jashtë rrugës;
12. **"identifikues i llojit të gomave"** nënkupton një kod, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një lloj gome specifike nga llojet e tjera të gomave që kanë të njëjtin emër tregtar ose të njëjtën markë tregtare me atë të furnizuesit;
13. **"importues"** sipas pikës 10 të nenit 3 të ligjit "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji";
14. **"lloji ekuivalent i gomave"** nënkupton një lloj gome që vendoset në treg nga i njëjti furnizues si një lloj tjetër gome me një identifikues të ndryshëm të llojit të gomave dhe që ka të njëjtat karakteristika teknike që janë të rëndësishme për etiketën e gomave dhe të njëjtin informacion të produktit.
